



# KLSH ANALIZA VJETORE 2015



Tiranë, 2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

# KLSH ANALIZA VJETORE 2015

Tiranë, 2016

Titulli:

# KLSH ANALIZA VJETORE 2015

Redaktoi: Armanda BEGAJ

Elisa METAJ

Realizoi në kompjuter: Armanda BEGAJ

Seria: botime KLSH 02/2016/53

©Mundësohet përdorimi i materialeve të këtij botimi,

kundrejt citimit të burimit, KLSH.

ISBN: 978-9928-159-42-7

Shtypur në Shtypshkronjën: ILAR

Tiranë, 2016

PËRMBAJTJA

Faqe

HYRJE	7
PËRSHËNDETJE	
Fjala përshëndetëse e Presidentit të Republikës, SH.T.Z. Bujar NISHANI	11
Fjala e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar LESKAJ	17
Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë, z. Erion BRAÇE	23
Fjala përshëndetëse e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës, z. Adriatik LLALLA	26
Fjala përshëndetëse e Kryetares së Autoritetit të Konkurrencës, znj. Lindita LATI	28
Fjala përshëndetëse e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent SEJKO	31
Fjala përshëndetëse e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, z. Shkëlqim GANAJ	33
Fjala përshëndetëse e Ministrit të Drejtësisë, z. Ylli MANJANI	35
Fjala përshëndetëse të Avokatit të Popullit, z. Igli TOTOZANI	37
Fjala përshëndetëse e Audituesit të Përgjithshëm në detyrë të ZAP-it të Kosovës, z. Artan VENHARI	40
RAPORTI I PERFORMANCËS INSTITUCIONALE, PËR VITIN 2015 (mbajtur nga Kryetari i KLSH-së, z. Bujar LESKAJ)	45
AUDITIMET ME IMPAKTET MË TË RËNDËSISHME DHE ME EFEKTE TË KONSIDERUESHME NË MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT	
A. AUDITIMI NË SEKTORIN ENERJITIK	
1. AUDITIMI NË MINISTRINË E EKONOMISË DHE INDUSTRIË Marrëveshja e zgjidhjes me mirëkuptim CEZ-RSH <i>Referues: Muhamed KAVAJA, Manjola NAÇO, Ermal YZEIRAJ</i>	163
2. AUDITIMI NË AKBN DHE ALBPETROL Mbi veprimtarinë në sektorin hidrokarbur <i>Referues: Alush ZAÇE, Valentina GOLEMI, Artan TOPJANA</i>	169

3.	AUDITIMI NË OSHEE <i>Referues: Fatmir ILJAZI, Yllka PULASHI, Mimoza BEDINI</i>	177
4.	AUDITIMI NË MBLEDHJEN E RENTËS MINERARA <i>Referues: Albana AGOLLI, Joniada Goçaj, Artan MIRASHI</i>	183
B.	AUDITIMI NË FINANCAT PUBLIKE	
5.	AUDITIMI I EKZEKUTIMIT DHE MENAXHIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT Borxhi publik për vitin 2014 <i>Referues: Luljeta NANO, Bexhet ZEQIRI, Andrea KRISTO</i>	198
6.	AUDITIMI MBI PËRDORIMIN E INSTRUMENTIT TË LETËRKREDIVE, DETYRIMET E PRAPAMBETURA, IPSAS DREJT EPSAS <i>Referues: Fatmir ZILJA, Aulona JANI, Nerënxa LLAPASHTICA</i>	206
C.	AUDITIMI NË SISTEMIN E SHËNDETËSISË	
7.	AUDITIMI NË AGJENCINË KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË BARNAVE DHE PAISJEVE MJEKSËSORE, NË FONDIN E DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE QSUT <i>Referues: Mariola LLESHI, Selime BREGU, Ymer STAFJA</i>	220
D.	AUDITIMI NË ADMINISTRIMIN E PRONAVE	
8.	AUDITIMI NË ZVRPP <i>Referues: Selfo ZENELI, Qemal SHEHU, Qemal META</i>	226
9.	AUDITIMI NË NJQV-BASHKITË <i>Referues: Bajram LAMAJ, Kristaq GJURGJAJ, Skënder MUÇJA</i>	244
E.	AUDITIMI NË SISTEMET INFORMATIKE	
10.	PËRDORIMI I QASJES SË VIZUALIZIMIT TË TË DHËNAVE NË AUDITIMET IT <i>Referues: Kozma KONDAKÇIU, Marenglen SINANI</i>	250
F.	ARRITJET NË AUDITIMET E PERFORMANCËS	
11.	IMPAKTET E AUDITIMIT TË PERFORMANCËS SI SHTYLLA MODERNIZIMI INSTITUCIONAL <i>Referues: Rinaldo MUÇJA, Gjovalin PREÇI, Alfred ZYLFI</i>	255
12.	FORCIMI I LIGJIT PËRMES ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË KLSH-së Projekti i QUIL dhe USAID për rekomandimet e KLSH-së <i>Referues: Erald KAPRI, Niko NAKO, Nikoleta PIRANJANI</i>	264

13. FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE NËPËRMJET PZHV <i>Referues: Edvin STEFANI, Artur HASANBELLIU, Sali AGAJ</i>	281
14. ETIKA DHE INTEGRITETI NË KLSH <i>Referues: Miranda HAXHIA, Bashkim SPAHIJA, Ibrahim NDREU</i>	296
15. KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA <i>Referues: Irena ISLAMI, Amantja PATOZI, Alma SHEHU</i>	300
16. KONTROLLI I CILËSISË <i>Referues: Koço SOKOLI, Pullumb BEQIRAJ, Prof. Dr. Jorgji BOLLANO</i>	319

AUDITUESIT E RINJ NË KLSH:

KONTRIBUTI, INOVACIONI NËN MOTON: "UNË, KLSH DHE EUROSAI"

Fjala e hapjes nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Zbatimit të Standardeve, z. Ermaj YZEIRAJ	341
1. Kuadri i matjes së performancës së SAI-t <i>Referues: Ina SOKOLI, Marcela MORA</i>	346
2. Bashkëveprimi KLSH – Media, një mjet për rritjen e përgjegjshmërisë së qeverisë dhe besueshmërisë së institucionit tek publiku <i>Referues: Jonild HOXHAI</i>	352
3. Lidhja me ISSAI-ve dhe IPSAS-eve. Pse është e rëndësishme? <i>Referues: Aulona JONUZ</i>	356
4. Sfidat e marrëdhënies auditues – subjekt i audituar <i>Referues: Jorida ZHEGU, Yaron FISHMAN</i>	362
5. SAI në një shoqëri multikulturore <i>Referues: Melina KABO</i>	371
6. Ndikimi i Teknologjisë në profilin profesional të një audituesi <i>Referues: Eni KABASHI, Yrjada JAHJA.</i>	379
7. Trajnimet në KLSH <i>Referues: Armindia BUSHI</i>	385
8. Kontrolli i Lartë i Shtetit në procesin gjyqësor <i>Referues: Flavio XHUVELI</i>	393
9. Auditimi i Teknologjisë së Informacionit <i>Referues: Benard HAKA, Elira CUKALLA</i>	400
10. Informatizimi i procesit të auditimit <i>Referues: Ildir DERVISHI</i>	406

11.	Përfitimet nga bashkëpunimet me partnerët <i>Referues: Redina KARAPICI</i>	412
12.	Strategjia e Komunikimit të një SAI – sipas praktikës në KLSH <i>Referues: Xhuljeta ÇELAJ</i>	417
13.	Problematikat e ndeshura gjatë auditimit dhe “shfrytëzimi” i tyre për përmirësimin e proceseve në të ardhmen <i>Referues: Erion MUHO, Alfonc GABILI</i>	423
14.	Zhvillimi i qëndrueshëm është zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar nevojat e së ardhmes <i>Referues: Blerina KËRÇUKU, Kris ANASTASI</i>	431
15.	Komunikimi i SAI-t. Përfshirja e Publikut <i>Referues: Elisa METAJ, Amantja PATOZI</i>	440
16.	Strategjia e Auditimit të Përputhshmërisë <i>Referues: Rezart GOLEMAJ, Julian ADILI</i>	445
17.	Ndërtimi i kapaciteteve dhe ndikimi në performancën e KLSH <i>Referues: Aikida LLAKAJ</i>	452
	MESAZHI I KRYETARIT TË KLSH-së, Z. BUJAR LESKAJ PËR AUDITUESIT E RINJ TË KLSH-së	455
	PASQYRIMI NË MEDIAN VIZIVE, TË SHKRUAR DHE ELEKTRONIKE I ANALIZËS VJETORE TË KLSH PËR 2015, 1-2 SHKURT 2016	461
	FJALORI I SHKURTIMEVE	471

## HYRJE

Dr. Josef Moser, Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i Gjykatës Austriake të Auditimit, në fjalën e tij në Simpoziumin e 22<sup>-të</sup> të OKB-INTOSAI, mbajtur në Vjenë, në mars 2013, cilëson se: *"Në një kohë që burimet publike janë duke u bërë gjithnjë e më të pakta, qytetarët me të drejtë pyesin:*

*1. Si mundet qeverisja publike të jetë e projektuar në mënyrë më efektive dhe më ekonomike, si dhe*

*2. Çfarë kontributi mund të japë institucioni suprem i auditimit (SAI) në këtë drejtim?*

*Në përgjigje të këtyre pyetjeve, ne si SAI duhet të zhvillojmë propozime dhe zgjidhje për më shumë qeverisje ekonomike dhe efektive publike, në bazë të punës sonë të auditimit. Ne duhet t'i integrojmë këto propozime për zgjidhje në mënyrë sa më efektive që të jetë e mundur, në procesin e reformës së Qeverisë".*

Ky cilësim është thelbi i misionit tonë si SAI. Në bazë të Deklaratës së Limës, Kushtetutës së Institucioneve Supreme të Auditimit, e cila në Nenin 16, pika 1 të saj shpreh: *"Institucioni Suprem i Auditimit duhet të mandatohet nga Kushtetuta për të raportuar gjetjet e tij çdo vit.... Ky raport duhet të publikohet"*, KLSH paraqet përpara lexuesit analizën e veprimtarisë së tij për vitin 2015, sidomos gjetjet dhe rekomandimet e tij kryesore për përmirësimin e qeverisjes publike.

Në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t dhe misionin tonë kushtetues, paraqesim përpara publikut të gjerë gjetjet kryesore nga auditimet që kemi kryer gjatë vitit 2015, rekomandimet dhe masat që kemi propozuar, përpjekjet për përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet thellimit të luftës ndaj korrupsionit, partneritetet me institucionet simotra të zhvilluara evropiane, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve tanë. Është viti i katërt rradhazi që kemi zgjedhur si format të analizës sonë vjetore hapjen e plotë dhe të pakushtëzuar ndaj mediave dhe qytetarit, nëpërmjet



zhvillimit të analizave të departamenteve të auditimit pranë universiteteve publike të disa rretheve kryesore të vendit, me pjesëmarrjen e gazetarëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Kjo transparencë, krahas monitorimit të thellë të veprimtarisë së KLSH, dhënies llogari për çdo lek të harxhuar nga institucioni përpara qytetarëve dhe grupeve më të angazhuara të tyre, që janë shoqatat e shoqërisë civile, gjykojmë se i shërben rritjes së besimit të publikut ndaj punës dhe rezultateve të KLSH, si dhe në plan më të gjerë, shton besimin e qytetarëve ndaj qeverisjes.

Me këtë botim të analizës vjetore KLSH 2015, japim një bilanc të plotë të aktivitetit njëvjeçar të institucionit, nëpërmjet referimeve të drejtuesve dhe audituesve më të përgatitur të tij, duke vlerësuar me syçelësi atë që kemi arritur, por edhe duke evidentuar, me anë të analizës SWOT, mangësitë dhe dobësitë që kemi, duke reflektuar mbi to, me qëllim përmirësimin efektiv të punës në të ardhmen.


Dëshiroj të falënderoj të gjithë ata pedagogë, studentë, gazetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile që na ndoqën në analizat tona të Departamenteve të Auditimit në Tiranë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, si dhe personalitetet e jetës politike dhe publike shqiptare që vlerësuan Analizën Vjetore Institucionale të KLSH, për vitin 2015, të zhvilluar në Tiranë, dhe na nderuan me pjesëmarrjen e tyre: Presidentin e Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z. Bujar Nishani; Ambasadorin e SHBA-ve, z. Donald Lu; Kryetarin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit, z. Erjon Braçe; Prokurorin e Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, z. Adriatik Llalla; Inspektorin e Përgjithshëm të ILDKPKI, z. Shkëlqim Ganaj; Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko; Kryetaren e Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës, znj. Lindita Lati; Avokatin e Popullit, z. Igli Totozani; Ministrin e Drejtësisë, z. Ylli Manjani, si dhe shumë akademikë, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të shoqërisë civile, etj. Mesazhet e përcjella prej tyre kanë rëndësi parësore për ne, jo vetëm për vlerësimin e punës dhe rezultateve të deritanishme, për përkrahjen dhe inkurajimin e audituesve tanë, por edhe për drejtimet dhe rekomandimet e vjera që dhanë dhe që do t'i vlejnjë përmirësimin të punës së institucionit në të ardhmen.

Viti 2015 ishte viti i parë i zbatimit të ligjit të ri integral të KLSH, tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t, si dhe viti i konsolidimit të reformave dhe arritjeve të viteve 2012-2014, vit në të cilin institucioni fitoi gradualisht shprehitë

dhe fizionominë e një institucioni modern auditimi me qasje tërësisht evropiane dhe përfundimtare.

Për këtë progres të dukshëm, të evidentuar dhe nga Progres Raporti 2015 i Bashkimit Evropian, falenderimi im shkon jo vetëm tek të gjithë audituesit dhe punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilët me punën e përkushtuar dhe profesionalizmin e tyre kanë bërë të mundur përmbushjen e objektivave strategjike të institucionit dhe për vitin 2015, por edhe për ndihmën e çmuar të dhënë nga Kuvendi, sidomos nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, si dhe për përkrahjen dhe partneritetin e aleatit tonë të natyrshëm e të përhershëm, median si vizive, ashtu edhe të shkruar të vendit.

Bujar LESKAJ





FJALA PËRSHËNDETËSE E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, SH.T.Z. BUJAR NISHANI

“Shtetin do ta bëjmë të gjithë me kontribute personale dhe profesionale të përditshme, sepse standardin e shtet-formimit nuk e kemi vetëm për sot!”



Faleminderit z. Kryetar, së pari për konsideratat dhe ftesën,  
z. Ministrër i Drejtësisë,  
z. Kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat,  
z. Ambasador,  
të nderuar drejtues të Institucioneve kushtetuese të vendit, deputetë, profesorë të pranishëm,  
të nderuar auditues!

E prita me shumë kënaqësi ftesën dhe jam sot këtu në përfaqësim të Institucionit të Presidentit të Republikës për disa arsye.

Së pari, për të vlerësuar të gjithë punën tuaj dhe drejtuesve tuaj, të gjithë kontributin, të gjithë investimin profesional, qytetar, institucional të dhënë gjatë viteve që jeni në këtë pozicion.

Së dyti, jam këtu për të konfirmuar rëndësinë e madhe që ka institucioni juaj, puna juaj e përditshme, produkti i punës tuaj të përditshme.

Së treti, pikërisht me bindjen e thellë për pritshmëritë shumë të larta që kanë në tërësi, shoqëria dhe aktorët e shoqërisë, për institucionin, për punën, për produktin dhe për angazhimin e punës tuaj.



Janë tre dimensione, të cilat i gjej me vlerë për t'i prezantuar si konfirmim i mbështetjes së vazhdueshme që Institucioni i Presidenti të Republikës, brenda tagrit të tij kushtetues dhe vokacionit institucional që ka, do të vijojë të garantojë këtë mbështetje, inkurajim dhe vullnet për të qenë i angazhuar në çdo aspekt i cili do të jetë i nevojshëm për të konfirmuar vullnetin, garancinë dhe profesionalizmin e punës suaj.

Gjatë këtyre dekadave të funksionimit të Institucioni të KLSH-së, në fund të fundit, në themel dhe në objektiv ka pasur gjithmonë të njëjtin synim, shtet-formimin. Në 25 vitet e fundit, kemi hyrë padyshim në një sistem krejt të ri të shtet-formimit tonë, i cili solli sfida dhe rrethana krejt të ndryshme me ato të viteve apo dekadave të shkuara, rrugëtime që Institucioni juaj ka kaluar dhe e rriti akoma më shumë përgjegjshmërinë nga njëra anë, sofistifikimin nga ana tjetër dhe vështirësinë pse jo, të atyre interesave që konkurrojnë me njëra-tjetrën në funksion të shtet-formimit. Por jam i bindur që ju asnjëherë nuk keni harruar, dhe nuk duhet të harroni ju dhe të gjithë të tjerët, çdo aktor tjetër dhe të gjithë operatorët e shoqërisë shqiptare se në rrethanat dhe në kohën aktuale standardi i shtet-formimit mbizotëron mbi çdo interes tjetër privat apo institucional, apo publik i grupeve të ndryshme të shoqërisë, sepse standardin e shtet-formimit nuk e kemi vetëm për sot, standardin e shtet-formimit e kemi për një perspektivë afatmesme dhe afatgjatë dhe dëshiroj të konfirmoj faktin se ju, pikërisht ju, njerëzit brenda këtij institucioni, keni fatin, keni shansin, keni rastin dhe përgjegjësinë për të dhënë kontributin personal, profesional dhe njerëzor, pikërisht për këtë perspektivë afatmesme dhe afatgjatë të shtetit tonë. Ne jemi përgjegjës sot për standardin që ndërtojmë, jemi përgjegjës edhe për standardin që do të kenë dhe do të lemë trashëgim brezave të ardhshëm për shtetin dhe shtetin do ta bëjmë ne me kontribute të përditshme.



Nuk nguroj të them që keni arritur një standard më të arrirë, më të përparuar, dhe ndoshta jeni ndër institucionet më të para që keni ngritur në një shkallë më të lartë çështjen e asaj që përbën sfidën më të madhe të shoqërisë sonë besimin. Nuk është e lehtë të arrihet besimi. Po përsëri duhet të kemi në vëmendjen tonë se pikërisht besimi jemi pikërisht ne, individët, institucionet, komuniteti, shoqëria që mund të arrijë, dhe pa besim do të jetë shumë vështirë në radhë të parë të iniciojmë dhe të prezantojmë të gjithë rezultatet e kapaciteteve tona intelektuale dhe përmes angazhimit tonë institucional do ta kemi të vështirë të koordinojmë punën me institucionet partnere dhe agjencitë partnere, do ta kemi shumë të vështirë të bindim partnerët për përparimin tonë dhe mbi të gjitha do të vijë tek ajo që është sfida e sfidave tona, frenimin e perceptimeve të gabuara, të cilat nuk i përkasin një realiteti, megjithëse realitetin nuk e kemi të shkëlqyer.

Si qytetar, si një njeri në politikë, si njeri i angazhuar për të kontribuar për vendin në pozicionin që kam pasur dhe në pozicionin që kam, edhe si President i Republikës që ka një produkt që është evident sot për sa i takon ndëshkueshmërisë nga ana e institucionit tuaj. Nga ana tjetër dua të them që puna juaj në adresimin tim të verifikimit dhe identifikimit të korrupsionit apo paligjshmërisë ndaj përfaqësuesve të caktuar të administratës publike nuk do të thotë që ne kemi tërësisht një administratë publike të korruptuar dhe të inkriminuar. Jo! Dhe dëshiroj që ta mbani fort në vëmendje këtë që të mos frenoheni edhe nga perceptimet që vijnë në kontekstin njerëzor dhe shoqëror!

Padyshim që përgjegjësia është dhe do të jetë individuale e cilitdo, i cili në shfrytëzim të postit dhe besimit që ka marrë në administrim të parave dhe interesave publike abuzon me to, dhe aty duhet të jeni të ashpër, të drejtpërdrejtë, por kjo nuk duhet t'ju frenojë me pjesën që ju mund të konsideroheni si njerëz që po inkriminoni një administratë. Jo! Administrata e shtetit shqiptar ka brenda saj njerëz të shkëlqyer me integritet dhe profesionistë, të cilët padyshim duhet të gjejnë gjithnjë e më shumë vendin më të përshtatshëm të kontributit të tyre. Nga ana tjetër identifikimi dhe goditja e fenomeneve të korrupsionit dhe paligjshmërisë, nuk inkriminon dhe nuk mund të na inkriminojë gjithë shtetin tonë. Jo, kurrsesi!

Kemi një shtet dhe një vend që ka marrë sakrificat më të mëdha për t'u ndërtuar dhe shpeshherë perceptimet që ekzistojnë në adresë të shtetit shqiptar dhe vendit tonë nuk përkojnë me realitetet, pa dyshim, por ne pikërisht duhet të synojmë atë që

thamë, rritjen e besimit dhe krijimin e besimit në mënyrë të tillë që të ndryshojmë këto raporte të padrejta shpeshherë të perceptimeve, jo në përputhje me realitetin që ka sot Shqipëria.

Kjo nga pikëpamja njerëzore dhe e përgjegjshmërisë e cila nuk duhet të ndalojë dhe nuk duhet të kompromentojë veprimtarinë fundore, të plotë të hetimit, investigimit dhe denoncimit të çdo akti me përgjegjësi ligjore. Nga ana tjetër kjo kërkon një nivel të lartë kurajoje dhe profesionalizmi dhe integriteti nga ju që keni fate kaq të rëndësishme të jetës shoqërore, publike dhe shtetërore të vendit. Unë do të inkurajoja që nga Kryetari, drejtuesi juaj, tek të gjithë drejtuesit e tjerë të departamenteve, drejtorive, por dhe tek institucione të monitorimit tuaj, varësisë suaj, siç është Kuvendi i Shqipërisë të cilët krahas koordinimit, bashkëpunimit me secilin prej jush, me secilin punonjës, nga ai që përfaqëson statusin më të lartë administrativ në institucion dhe deri tek ai i statusit më të thjeshtë, të injektojë vlerësimin, kurajën, mbështetjen, mbrojtjen dhe trajtimin.

Është shumë i rëndësishëm thjeshtimit i mënyrës sesi komunikojmë midis institucioneve, si komunikojmë midis instrumenteve të shtetit, si e ndërtojmë të gjithë network-un e legjislationit, si i ndërtojmë instrumentet tona, sa më shumë t'i komplikojmë gjërat shpeshherë të infektuar nga tendenca krejt pa rezultate, pa eficiencë të kohës, e komplikojmë veprimtarinë në tërësi të shoqërisë dhe të shtetit përmes këtij ndërlikimi. Sa më shumë t'i bëjmë të thjeshta, aq më shumë e lehtësojmë punën, aq më lehtë e identifikojmë problemin dhe aq më të madhe e vëmë dhe identifikojmë përgjegjësinë që ka gjithsecili nga individit deri tek institucioni në raportet akt-veprimtari-përgjegjshmëri-përgjegjësi.

Do t'u adresohesha të gjithë drejtuesve të institucioneve menaxhuese, përfaqësuese të interesit publik të qytetarëve, të marrin përsipër në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe sa më të thjeshtë të jetë e mundur përgjegjësitë që u takojnë. Raporti individ-institucion, e kam fjalën për individin të cilit i jepet fati dhe shansi të përfaqësojë forcën e institucionit, mandatin e institucionit, është i përkohshëm në të. Nuk kemi më njerëz të përjetshëm në poste dhe pozicione të përjetshme. Ndoshta koha e jetës së gjithsecilit prej nesh përpara është shumë më e gjatë sesa koha që konsumojmë në një pozicion të caktuar ku ushtrojmë përgjegjësi funksionale dhe institucionale. Ajo që do të lëmë si kontribut është mënyra sesi sillemi institucionalisht, individualisht nga pikëpamja e përgjegjshësisë, e profesionalizmit dhe e dëshirës për kontribut. Ndaj, thashë, i shoh në këtë kontekst

kaq të thjeshtë. Përgjegjësia është kolektive në mënyrën sesi i trajtojmë dhe i koordinojmë përballjen me sfidat, pa dyshim. Askush, në kontekstin individual, nuk mundet të performojë në kompleksitet, identifikim, verifikim, penalizim të problematikave që dëmtojnë shoqërinë tonë. Prandaj, do të desha të adresohemi tek praktikat më të mira të mundshme dhe më të thjeshta të mundshme të angazhimeve dhe kontributeve tona.

E vlerësoj shumë praninë e Ambasadorit Lu edhe të përfaqësuesve të tjerë të misioneve dhe agjencive diplomatike në Shqipëri, si partnerë të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm dhe domosdoshëm në proceset e përparimit të vendit. Ne kemi nevojë edhe për konsultim, edhe për debat, edhe për diskutim, por mbi të gjitha kemi nevojë për të adoptuar praktikat më të mira dhe rezultative dhe eficiente që ekzistojnë.

Shpeshherë interesat individuale konkurrojnë në mënyrë shumë të ashpër interesat e shtetit dhe vendit. Njerëzit që angazhohen dhe punojnë në administratën publike, nga hierarkia më e lartë deri tek ajo bazike, pa dyshim duhet të kuptojmë se brezat tanë sot janë ende breza që duhet të sakrifikojnë. Ky është një realitet, i cili ka një mijë e një arsye, por analizimi dhe ngërthimi tek arsyet nuk na çon përpara. Do të vazhdojë të mbajë dhe breza të tjerë si breza që duhet të sakrifikojnë. Duhet të kuptojmë dhe të marrim përsipër pikërisht këtë kontribut mbi bazën e kësaj sakrifice. Sakrificë në raport mes konkurrencës midis interesit të shtetit, interesit të së ardhmes dhe interesave tona individuale dhe personale të cilat nuk mund t'i zhbëjmë, nuk mund t'i zhdukim. Ato janë dhe do të mbeten aty me gjithsecilin prej nesh derisa të ekzistojmë. Dhe garanci që kjo konkurrencë të mos jetë e dëmshme nuk mund të jetë individi, garanci duhet të jenë instrumentet, mekanizmat të ndërtuara mbi bazën e praktikave dhe e vullneteve të mira, dhe mbi bazën e angazhimeve sipas përkatësisë, pozicionit dhe institucionit që përfaqëson secili prej nesh: në legjislativ, ekzekutiv, drejtësi, administratë publike, jetë private dhe këtu e kam fjalën për angazhimet e biznesit. Pra, në një lloj harmonizimi, i cili vjen dhe duhet të vijë përmes rregullave të konkluduara në mënyrë të përbashkët, do të përbëjë garancinë e madhe që pikërisht të besojmë dhe pranojmë atë sakrificë që i takon gjeneratës sonë apo gjeneratave të sotme me një gatishmëri edhe për të marrë produktin e këtij kontributi, por më së tepër për të pranuar në koshiençë, formim, kulturë civile, qytetare dhe maturim publik se përfitojnë më shumë interesat e gjeneratave të ardhura se në fund të fundit janë po aq të lidhura me ne saç kemi po aq të lidhur ne me vetveten.



Ajo që ekziston është shteti, institucionet që kemi, janë njerëzit që përbëjnë institucionet, shtetin, përbëjnë shoqërinë të cilët i kanë të gjitha kapacitetet intelektuale dhe njerëzore. Meritojmë pa dyshim standarde shumë më të lartë të profilit, të produktit të punës së tyre, por duhet të gjejmë racionalitetin e kombinimit dhe krahasimit dhe e barazpeshimit të tyre.

Duhet të jemi krenarë për sa ka arritur dhe ka bërë Shqipëria dhe shteti ynë. Të gjithë i dimë sfidat e mëdha që kemi për të cilat nuk duhet të jemi aspak të tutur dhe të paangazhuar dhe indiferentë për të marrë përsipër e për t'i çuar përpara. Një individ i veçuar mua më duket shumë i pafuqishëm për të bërë gjëra të mira, por një individ kur është i angazhuar nëpër institucione, kur gjen brenda këtij institucioni një garanci për të vënë në jetë potencialet e tij qytetare dhe intelektuale, për të gjetur të realizuar frymëzimin e tij në kontekstin e integritetit personal. Dhe kur gjen një infrastrukturë në tërësi, e cila e garanton këtë dinamizëm, gjërat duhet të bëhen dhe mund të bëhen shumë herë më mirë.

Shpreh bindjen e palëkundur se Shqipëria do të ecë pa diskutim gjithmonë e më shumë përpara, por e rëndësishme është se me çfarë shpejtësie do ta mbajmë përparimin dhe ecjen e saj para. Dhe me çfarë shëndeti dhe konsolidimi do ta mbajmë ecjen përpara të shoqërisë, shtetit dhe institucioneve tona. Koha për individin kalon dhe ikën shumë shpejt, kurse shteti dhe vendi ynë është i përjetshëm, por le ta shfrytëzojmë për mirë dhe për kontribute pozitive atë periudhë të shkurtër që gjithsecili prej nesh e ka në jetën dhe në dinamikën e tij të përditshme. Dhe duke qenë se këto potenciale janë shumë herë më të mëdha se sa pikëpyetjet që kemi përpara nuk ka pse këto pikëpyetje të mos zgjidhen në rrugën dhe në mënyrën e duhur dhe me efektshmërinë e duhur.

Në përfundim, shpreheh mbështetjen e plotë të Institucionit të Presidentit të Republikës së bashku me bindjen se çdo institucion e ofron dhe do ta ofrojë këtë mbështetje: Kuvendi, Qeveria shqiptare, agjencitë ligjzbatuese, sepse KLSH-ja, veçanërisht nën drejtimin e zotit Leskaj ka vendosur një standard shumë të mirë të shkëmbimit të përvojave me partnerët dhe partneritet me institucionet e vendeve të tjera, duke shtuar se ajo që e jetëson këtë dinamizëm është puna e çdo audituesi, e çdo të angazhuari, sepse pa të do të ishte e vështirë që një institucion të jepte rezultate në atë rrugë dhe në atë mënyrë që e duam që të gjithë për të funksionuar më së miri.

Ju faleminderit dhe suksese!

FJALA E KRYETARIT TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT,

Z. BUJAR LESKAJ

I nderuar Shkëqesia Juaj Zoti President i Republikës,  
 i nderuar Ambasador, z. Lu,  
 i nderuar Kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, z. Braçe,  
 i nderuar Prokuror i Përgjithshëm, z. Llalla,  
 i nderuar Ministër i Drejtësisë, z. Manjani,  
 të nderuar drejtues të Institucioneve kushtetuese të vendit, deputetë, profesorë të pranishëm,  
 të dashur kolegë auditues!



Në këtë periudhë shumë delikate të rritjes ekonomike të vendit dhe të përpjekjeve të mbarë shoqërisë sonë, të ndihmuar nga aleatët tanë strategjikë, për të rritur përgjegjshmërinë e qeverisjes publike, si institucion suprem i auditimit, si SAI, detyrimin tonë e shohim jo ndaj partive politike, por ndaj qytetarit dhe Kuvendit, me misionin, forcën dhe moralin që na ka dhënë Kushtetuta, për të kthyer besimin publik ndaj qeverisjes. Në përcjelljen me vërtetësi të gjetjeve, rekomandimeve dhe mesazheve nga auditimet e KLSH të vitit 2015, por edhe të viteve të

mëparshme falënderojmë të gjitha mediat e vendit, aleatin tonë të përhershëm dhe ndër më kryesorët.

Shumëkush mund të pyesë se përse rekomandimet e KLSH do të mund të rrisin

besimin e qytetarit tek qeverisja publike. Përgjigjen për këtë e jep Dr. Jozef Moser, Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAIT, i cili thotë se: *"Institucionet supreme të auditimit, SAI-t mund të shfrytëzojnë plotësisht potencialin e tyre për të kontribuar në qeverisjen e mirë publike vetëm nëse, duke u bazuar në punën e tyre të auditimit, ata gjithashtu angazhohen në veprimtari këshillimore dhe ofrojnë rekomandime specifike për subjektet e audituara dhe për vendim-marrësit"*.

Ndër rekomandimet më kryesore që kemi dhënë vitin e kaluar, përmendim:

(a) marrjen e nismës ligjore për ngritjen e një Këshilli Fiskal, i cili të gëzojë statusin e një institucioni publik të pavarur dhe të ketë një pavarësi operacionale të qartë e rigoroze nga politika. Një rekomandim të tillë e dha në janar 2016 edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, në Raportin e tij "Country Report" Nr. 16/5 për Vlerësimin e Transparencës Fiskale. Besojmë se një strukturë e tillë e pavarur dhe profesionale do të ndihmonte për një qëndrueshmëri dhe kredibilitet të financave publike, për të përmirësuar planifikimin e treguesve makroekonomikë dhe të parashikimeve buxhetore, duke konsideruar me vëmendjen e duhur risqet fiskale që kalon vendi.

(b) për të tretin vit në vijimësi, kemi rekomanduar që Ministria e Finances të paraqesë në Kuvend një nismë ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të treguesit të borxhit publik ndaj PBB-së, në nivelin tavan 60 %, dhe arritjen e këtij niveli të shtrirë në kohë, në terma afatgjatë.

(c) Në kushtet e përgjegjësisë financiare të ulët të zyrtarëve publikë, i kemi rekomanduar Kuvendit për të dytin vit në vijimësi hartimin e ligjit "Për përgjegjësinë materiale", në të cilin të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me kryerjen e detyrave zyrtare. Mungesën e theksuar të përgjegjshmërisë financiare në vend e evidentoi edhe Progres Raporti i Bashkimit Evropian i vitit 2015. Jemi të sigurtë se me hapat për realizimin e plotë të reformës në drejtësi, kjo përgjegjësi do të shtohet, pasi reforma duhet të vijojë edhe në këtë drejtim.

(d) Me qëllim rritjen e cilësisë dhe profesionalizmit të informacionit financiar dhe fiskal, duke synuar uljen e risqeve fiskale, kemi kërkuar që të ngrihet një sektor i veçantë, brenda Drejtorisë së Thesarit në Ministrinë e Financave, i cili të mundësojë përshtatjen e pasqyrave të nxjerra nga sistemi i integruar në formën e Pasqyrave të

Konsoliduara të Shtetit. Ky sektor duhet të ketë si funksion edhe kontrollin e saktësisë së pasqyrave të përgatitura nga institucionet publike, për ta vënë nën monitorim dhe kontroll profesional këtë proces të rëndësishëm. Pak muaj më vonë, në janar 2016, FMN në Raportin e tij për Vlerësimin e Transparencës Fiskale në Shqipëri udhëzoi unifikimin e raportimit financiar dhe fiskal.

(e) Duke pasur parasysh vlerat e pozicionimit të SAI-t si këshilltar për qeverisjen, kemi kërkuar që privatizimi i AlbPetrol të realizohet, duke ftuar kompani me potenciale dhe kredenciale të larta profesionale nga aleatët strategjikë të vendit tonë (veçanërisht ato me traditë të konsoliduar në sektorin e naftës, si SHBA, Mbretëria e Bashkuar apo Gjermania).

Kemi rekomanduar po ashtu që të ringrihet Instituti i Kërkimeve të Naftës, si një institut shkencor, i cili të mbështesë të gjitha vendimmarrjet për zhvillimet e sektorit të hidrokarbureve në vendin tonë dhe të bashkëpunojë me Kuvendin dhe Qeverinë për hartimin e strategjive afatmesme dhe afatgjata në këtë sektor.

Kemi rekomanduar ngritjen e një komisioni ad-hoc të pavarur, me ekspertë teknikë dhe ekonomikë, i cili të mund të vlerësojë realisht dhe saktësisht dëmin nga aktiviteti nën administrimin e CEZ a.s., si edhe mundësinë më të mirë për një rimëkëmbje të OSHEE-së mbi baza të monitorimit të kujdesshëm të të gjithë treguesve. Kemi kërkuar një disiplinë të fortë financiare dhe një kontroll të vazhdueshëm nga Kuvendi, për çdo investim dhe vendim-marrje strategjike për OSHEE-në, dhe për efekt të kësaj discipline, kemi kallëzuar penalisht ndonjë anëtar të Qeverisë apo drejtues të lartë institucioni për vendim-marrje në dëm të theksuar të Buxhetit të Shtetit. Edhe pse jemi anatemuar nga segmente të politikës, i qëndrojmë pikë për pikë gjetjeve dhe rekomandimeve tona në sektorin energjetik dhe faktet e kohëve të fundit na kanë dhënë të drejtë ne. Jemi të hapur për raportim në Kuvend për këtë çështje.

Gjatë vitit 2015, kemi përfunduar dhe evaduar 158 auditime, nga të cilat auditimet e përputhshmërisë dhe ato të performancës shënuan rritje përkatësisht me 50% dhe 25%, në krahasim me një vit më parë.

Kemi zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik të përgjithshëm në shumën totale prej 125,8 miliard lekë ose 919.9 milion euro, nga të cilat janë rekomanduar për zhdëmtim 428 milion euro. Shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e

subjekteve të audituara, kanë qenë në shumën e përgjithshme 35.3 miliard lekë ose 257.7 milion euro. Këto shkelje financiare përgjithësisht i përkasin periudhave 2013-2015 dhe pjesërisht periudhës kohore 2011-2013. Dëmi ekonomik i zbuluar nga KLSH për periudhën 2012-2015 është 8 herë më i madh se vlera e dëmit të zbuluar për periudhën e katër viteve 2008-2011.

Këto janë shifra që duhet të na ndërgjegjësojnë për sfidat e mëdha që na presin në disiplinimin e financave publike dhe harxhimin me ekonomicitet, efektshmëri dhe eficiencë të parasë së taksapaguesve shqiptarë.

Krahas rritjes së forcës këshilluese, ne duhet të japim llogari për çdo lek të harxhuar nga veprimtaria jonë. Për vitin 2015, për çdo një lek të shpenzuar për institucionin e KLSH, janë kërkuar për t'u zhdëmtuar në Buxhetin e Shtetit 180 lekë, ose në vlerë totale 58.7 miliard lekë, apo 428.4 milion euro, ndërkohë që në vitin 2010 institucioni kërkonte për çdo lek të harxhuar 10.4 lekë zhdëmtim. Kujtoj që në llogaritje nuk është përfshirë dëmi ekonomik prej 479 milion euro të marrëveshjes së lidhur nga MEI për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve me CEZ a.s. Ky tregues jep qartë dobinë e auditimeve të KLSH. Krahasuar në vite, mesatarja e treguesit të eficiencës (dobishmërisë) së institucionit për katër vitet 2012-2015 është 4.2 herë më e lartë se mesatarja e katër viteve 2008-2011. Shprehur ndryshe, në katër vitet e fundit, për çdo lek të taksapaguesit shqiptar që harxhohet për KLSH kemi zbuluar dhe kërkuar për zhdëmtim dhe arkëtim në Buxhet mbi 4 herë më shumë fonde se sa në katër vitet 2008-2011.

Të ndërgjegjshëm për pozicionin dhe rolin tonë, kur ka ardhur koha më shumë se kurrë të shihemi të gjithë si në pasqyrë përpara opinionit publik, si institucione publike (ndoshta duke përdorur instrumentin e vetëvlerësimit INTOSAIN, të cilin kemi dy vjet që e zbatojmë në KLSH), mendojmë se duhet të punojmë shumë më tepër, sidomos me përpjekjet për të luftuar anti-kulturën e pandëshkueshmërisë, për të kontribuar modestisht në reformën tërësore në sistemin e drejtësisë, e cila nuk do të kishte ardhur në stadin e sotëm të realizimit, pa investimin dhe kontributin e Ambasadorit të SHBA-ve në Shqipëri, z. Donald Lu, të cilin në emër të audituesve të KLSH e falënderojmë në mënyrë të veçantë për këtë kontribut.

Jemi po ashtu të ndërgjegjshëm, të kontribuojmë dhe në sfidën kryesore të shoqërisë shqiptare sot, luftën kundër korrupsionit. Krahasuar me periudhën katërvjeçare 2008-2011, kallëzimet penale të KLSH të katër viteve 2012-2015 janë rritur me 3.2 herë. Por shqetësim kryesor për ne është niveli i ulët i zbatueshmërisë

së masave të propozuara nga KLSH për largim nga detyra apo nga shërbimi civil për zyrtarë të lartë të Shtetit të denoncuar si të korrumpuar apo abuzues me interesat publike, dhe për këtë do të paraqesim listat e këtyre zyrtarëve të lartë që ende mbahen në administratën shtetërore, pranë komisioneve të Kuvendit.

Ndjekja sistematike e zbatimit të rekomandimeve të KLSH ka qenë një shqetësim i përhershëm i Bashkimit Evropian, i shprehur me forcë edhe në të dy Progres Raportet e fundit për Shqipërinë të viteve 2014 dhe 2015. Dua të theksoj se edhe gjatë vitit 2015, kemi gjetur mirëkuptim dhe kemi marrë mbështetjen e duhur nga Komisioni i Kuvendit për Ekonominë dhe Financat.

Në përshëndetjen e tij drejtuar KLSH në 90 vjetorin e krijimit në maj 2015, Auditori i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit Qeveritar të SHBA-së, z. Gene L. Dodaro theksoi se: *"Institucionet Supreme të Auditimit janë vitalë për të ndihmuar përmirësimin e performancës së qeverisë, për të arritur më shumë transparencë, si dhe për të siguruar përgjegjshmëri në kontekstin e sfidave aktuale... Ata sot janë pozicionuar si kurrë më parë, për të bërë diferencën... Ne nuk bëjmë politika. Ato i ka Kongresi. Ne auditojmë realizimin e politikave dhe programeve të Qeverisë"*.

Auditimet e performancës së KLSH në vitet 2012-2015 kanë njohur zhvillim sasior dhe cilësor, duke u rritur mbi 2.5 herë në krahasim me periudhën 2008-2011 si numër auditimesh dhe afro 4 herë si numër institucionesh publike të mbuluara me auditim. Gjatë vitit 2015, kemi realizuar 12 auditime performance, në një kohë kur nuk kishim asnjë auditim të tillë në vitin 2011. Fokusi ynë për këtë vit është përqëndrimi i auditimeve të performancës kryesisht në marrëveshjet koncesionare, në partneritetet publik-privat dhe në performancën e borxhit publik, me synim shëndoshjen e mëtejshme të financave publike dhe uljen e risqeve fiskale të vendit.

Viti 2015 ka qenë viti i parë i zbatimit të ligjit të ri integral të KLSH, viti i konsolidimit të progresit të institucionit drejt një trupe auditimi tërësisht të pavarur, kurajoze dhe të përkushtuar për përmirësimin e qeverisjes publike tek ne, e cila zbaton me rigorozitet standardet ndërkombëtare ISSAI.

Krahas përparësive, jemi të ndërgjegjshëm edhe për dobësitë tona. Kështu, ende nuk kemi arritur të japim opinion për pasqyrat financiare të Shtetit.


Mbi bazën e treguesve të plotësuar të performancës së një SAI, të sigurtë në ndihmën dhe mbështetjen e Institucionit të Presidentit, të Kuvendit dhe të gjitha strukturave të tjera publike dhe të shoqërisë civile e qytetarëve, si dhe të aleatëve

tanë strategjike SHBA dhe BE, e shohim me besim të plotë punën tonë në të ardhmen.

Presidenti Abraham Linkoln, një ndër etërit e demokracisë amerikane, ka thënë: *"Administratori i Shtetit, kur është i përgjegjshëm, ka me vete publikun. Qeverisja jonë qëndron si në pasqyrë, përpara opinionit publik. Cilido administrator që mund të ndryshojë për mirë opinionin publik mbi një shërbim apo veprim shtetëror që ka kryer, ka ndryshuar për mirë qeverinë"* (10 dhjetor 1856, Fjalim në Çikago). Dhe detyra jonë, si shërbestarë të publikut, është të kontribuojmë të gjithë për mirëqeverisjen.

Ju faleminderit!

FJALA PËRSHËNDETËSE E KRYETARIT TË KOMISIONIT PËR EKONOMINË DHE  
FINANCAT NË KUVENDIN E SHQIPËRISË, Z. ERION BRAÇE



Z. President,

z. Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit,

të nderuar auditues,

Natyrisht që sot është një ditë e gjatë pune për ju pavarësisht se jeni investuar të analizoni punën e departamenteve tuaja edhe muaj më herët. Unë do të doja të theksoja këtu se gjatë vitit 2015 e në vijim keni një ligj të ri, një ligj që është forcuar jashtë mase, me qëllim që t'i japë institucionit funksionalitet, pavarësi politike, pavarësi financiare dhe çdo instrument tjetër, me qëllim që institucioni juaja të bëjë detyrën e ngarkuar nga kushtetuta dhe ligji. Pra kemi forcuar pavarësinë institucionale të institucionit, dhe natyrisht është në dorën tuaj ta forconi këtë pavarësi gjatë çdo dite të punës tuaj. Kemi forcuar pavarësinë financiare të institucionit, tashmë është vetë institucioni që e harton buxhetin e tij dhe natyrisht është vetë institucioni që zbaton buxhetin e tij, madje duke ju dhënë mundësinë që edhe të vendosni ju se ku do të përdorni paratë e buxhetit të shtetit, paratë publike për të kryer sa më mirë punën tuaj çdo ditë. Kemi forcuar pavarësinë e institucionit edhe nga pikëpamja e rekrutimit dhe garantimit të burimeve njerëzore, pra është vetë institucioni që përzgjedh audituesit dhe natyrisht nuk ka më asnjë ndërhyrje që të ndikojë drejtpërdrejt deformimin e institucionit tuaj gjatë tuaj. Kemi zgjeruar dhe garantuar gamën e auditimeve që ju ushtroni, duke i dhënë institucionit jo vetëm pavarësinë për planet operationale të auditimit gjatë vitit, por mbi të gjitha për të bërë të mundur edhe auditimin e performancës që është shumë i rëndësishëm për një qeverisje, shumë i rëndësishëm për mënyrën e përdorimit të parave publike, por në anën tjetër të auditimit të sistemeve elektronike drejt së cilit qeverisje po shkon. Nuk mundet që inovacioni teknologjik të shërbejë për gjë tjetër veçse sa për transparencën e parave publike, kështu që auditimi juaj edhe mbi këto sisteme është i garantuar dhe duhet të jetë eficient sa më parë. Natyrisht që zgjidhëm me



ligj edhe problemin shumë vjeçar të auditimit të ndaluar të një sektori sensitiv siç është ai i financave publike, veçanërisht në fokus të ardhurat që vijnë nga tatimet e doganat, dhe natyrisht ju keni tani të gjithë lirinë që të auditoni edhe atje, qoftë në mënyrën e mbledhjes së të ardhurave dhe natyrisht performancën e këtyre institucioneve jetike për buxhetin e shtetit.

Pra ju kemi dhënë të gjithë bazën ligjore, gjithë mundësinë financiare dhe burimeve njerëzore që ju të kryeni detyrat tuaja për ta bërë institucionin sa më funksional dhe efikas në përmbushje të detyrimit të tij kushtetues.

Siç e shihni këtu në panel janë pothuajse të gjithë institucionet më të rëndësishme financiare dhe ligjzbatuese të shtetit. Natyrisht këtu ne na bashkon vetëm një çështje, interesi publik. Liria dhe konkurenca në tregje, veçanërisht në tregjet e mallrave dhe shërbimeve, mbrojtja e këtyre parimeve pra të lirisë dhe konkurrencës në tregje me fokus përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarit natyrisht që është interes publik. Hetimi dhe ndëshkimi i konfliktit të interesave në vendim marrje, veçmas në kontrata publike, apo më tutje akoma në kontrata që koncesionojnë veprimtari shërbimesh apo pasurish publike natyrisht që është interes publik. Hetimi i parave, i pasurive që vijnë nga shkelja e ligjit, apo në anën tjetër edhe nga konflikti i interesave, natyrisht që përbën interes publik. Përdorimi i parave, i çdo qindarke të qytetarit të Republikës së Shqipërisë që ndajnë për buxhetin e shtetit, natyrisht që përbën interes publik. Eficienca e përdorimit të këtyre parave natyrisht që përbën interes publik.

Natyrisht në rast se të gjitha institucionet do të bashkëpunonin si sot dhe të kryenin detyrën e tyre interesi publik dhe do të kthehet në element prioritar në të gjithë veprimtarinë e shtetit shqiptar. Natyrisht që ka mangësi në këtë pjesë, dhe institucioni juaj duhet të jetë i pari, ashtu si dhe të gjithë institucionet që janë këtu në radhë për të bërë detyrën e tyre, atë që ju ka ngarkuar ligji në përmbushje të interesit publik. Tri pikë më shumë në indeksin e perceptimit të qytetarit për korrupsionin, se sa një vit më parë, apo 110 milion dollarë të kursyer nga buxheti i shtetit, janë elemente në drejtimin e duhur, por nuk mjaftojnë. Ne duhet të jemi të përgjegjshme për çdo qindarkë.

Natyrisht që ju keni përpara një sfidë shumë të rëndësishme ju sfidojnë qytetarët, ju sfidon pritshmëria e tyre. Secili nga qytetarët e Republikës së Shqipërisë pret prej vitesh të tëra që të bëhet drejtësi për paratë që ata paguajnë në buxhetin e shtetit. është shumë i rëndësishme ky element. Ashtu siç edhe puna juaj ka

domosdoshmërisht nevojë për drejtësi, është jetike kjo gjë me qëllim që i gjithë munda juaja të mos shkojë dëm. Institucioni i Autoritetit të Konkurrencës ka nevojë pa diskutim për drejtësinë civile. Ne e kemi diskutuar në Komisionin tonë, është çështje publike, mënyra e zvarritjes së proceseve gjyqësore që bëjnë drejtësinë në treg dhe që Autoriteti i Konkurrencës i ka çuar përpara. Ashtu siç institucioni i Inspektoriatit i Lartë i Deklarimit të Pasurisë ka nevojë për drejtësi penale dhe civile. Ashtu siç Guvernatori i Bankës së Shqipërisë që udhëheq të gjithë sistemin bankar në këtë vend, ka nevojë për drejtësi civile, për ta adresuar deri në fund çështjen e kredive të këqija në këtë vend.

Pra për ta mbyllur secili prej nesh që jemi këtu, secili prej institucioneve që janë këtu, ka nevojë për drejtësi. Natyrisht drejtësia është ligjore, është penale dhe civile por ne fund fare është ne vemendje, ne sy te te gjithë publikut. Është e vërtetë që drejtësi popullore nuk ka. Drejtësia që japin njerëzit ushtrohet një herë në katër vjet me vota, por natyrisht të gjithë që jemi këtu, ju së pari, kemi një qëllim të vetëm dhe këtë qytetarët e presin: Të prekim të paprekshmit pavarësisht çfarë statusi politik kanë patur apo çfarë statusi politik kanë, pavarësisht se çfarë funksioni kanë sot. Ka njerëz që me funksione fare fare të ulta në nivelin administrativ dhe ekzekutiv, administrojnë çështje që vlejné me miliona e me miliona euro.

Kjo është ajo që duhet të bëni, të prekni të paprekshmit, dhe jo vetëm juve por i gjithë sistemi i agjencive ligjzbatuese në këtë vend.

Në rast së bëjmë këtë pa diskutim kemi përmbushur të gjitha detyrimet që burojnë nga kushtetuta dhe ligji.

Ju kemi dhënë më shumë liri qytetarëve, të mbrojtur nga ky rrjet institucionesh prej korrupsionit.

Faleminderit!

FJALA PËRSHËNDETËSE E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS,  
Z. ADRIATIK LLALLA



I nderuar Shkëlqesia Juaj Zoti President i  
Republikës,  
i nderuar z. Ambasador Lu,  
i nderuar z. Leskaj,  
të nderuar të pranishëm,

Prokuroria e konsideron KLSH si një ndër partnerët kryesorë në luftën kundër krimit financiar. Në vlerësimin tonë, ky institucion ka ekspertizën më të mirë për të identifikuar abuzimin financiar dhe shpërdorimin e detyrës në institucionet shtetërore.

Në përfundim të auditeve të shumta që kryen KLSH, kur ka konstatuar shkelje ligjore ka bërë kallëzim për ndjekje penale, tashmë shumë nga këto kallëzime janë kthyer në akuza penale për një numër të konsiderueshëm zyrtarësh të niveleve të ndryshme.

Mbi bazën e kallëzimit të KLSH dhe veprimeve të shumta hetimore të kryera nga Prokuroria u krijuan dyshime të bazuara në prova se ish-Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe disa zyrtarë të tjerë të kësaj ministrie kishin kryer veprat penale të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës dhe për këto arsye u arrestuan.

Prokuroria vlerëson se KLSH ka kapacitetet e duhura për të dhënë kontribut edhe më të madh sa i përket korrupsionit në nivele të larta të administratës shtetërore.

Të gjithë institucionet shtetërore kanë detyrimin ligjor dhe moral para opinionit publik dhe partnerëve ndërkombëtarë për të dëshmuar se askush nuk është i paprekshëm. Për të treguar aftësinë tonë në këtë drejtim, është shumë e

rëndësishme që të punojmë dhe vëmë para përgjegjësisë ligjore çdo zyrtar që abuzon me detyrën.


Në këtë aspekt, është e qartë që Prokuroria ka detyrën kryesore të dërgojë para gjykatës zyrtarët e përfshirë në korrupsion dhe abuzim me detyrën. Por, roli i Prokurorisë nuk mund të realizohet vetëm. Nuk mund të ketë efikasitet të lartë pa prurjet e institucioneve të tjera. Dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit është një prej atyre strukturave që mund të japë një kontribut thelbësor në evidentimin e shkeljeve të ligjit në radhën e zyrtarëve të lartë.

Prokuroria e ka mbështetur dhe do të vijojë të mbështesë çdo iniciativë të Kontrollit të Lartë të Shtetit për auditimin e institucioneve qendrore. Këtë mbështetje po e tregojmë dita-ditës, duke trajtuar me përgjegjësi ligjore dhe seriozitetin maksimal kallëzimet e këtij institucioni për zyrtarë drejtues, lidhur me tendera dhe konçensione publike.

Duke shprehur vlerësimin për aktivitetin e deritanishëm, ju inkurajojmë që të vijoni të jeni më agresiv në zbulimin e aferave financiare që mund të kryhen në administratën shtetërore. Prokuroria, ju garanton se do të jetë aleati juaj kryesor në luftën kundër korrupsionit në çdo nivel.

Ju faleminderit për vëmendjen!

FJALA PËRSHËNDETËSE E KRYETARES SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS,  
ZNJ. LINDITA LATI



I nderuar z. Kryetar Leskaj,  
Shkëlqesia Juaj z. President Nishani,  
Shkëlqesia Juaj z. Ambasador Lu,  
të nderuar z. Braçe, z. Manjani.  
të nderuar kolegë, z. Llalla, z. Totozani, z. Sejko,  
z. Ganaj,  
të nderuar profesorë, auditues e pjesëmarrës!

Duke Ju falenderuar për ftesën, për të qënë pjesë e procesit të analizës vjetore dhe të reflektimit të institucionit që Ju drejtoni, do të theksoja se viti i kaluar ka qënë një vit i rëndësishëm për bashkëpunimin ndërinstitucional i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Autoritetin e Konkurrencës.

Viti 2015 shënoi:

Disa procese hetimore dhe monitorime janë realizuar nga instituoni i mbrojtjes së konkurrencës, pas shqetësimeve të adresuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Disa autoritete kontraktuese kanë përcjellë konstatimet dhe rekomandimet e audituesve të shtetit, të cilat evidentonin problematika në funksionimin e tregut të prokurimeve publike.

Qeverisja, si koncept, përcakton kush ka fuqinë, kush merr vendime, mënyrën se si dëgjohen aktorët e tjerë dhe se si kontrollohet përgjegjshmëria.

Një qeverisje e mirë sjell: manaxhim të mirë, performancë të mirë, një kujdesje të mirë për paratë publike, përfshirje të publikut dhe si rrjedhojë një rezultat të përgjithshëm të mirë ekonomik.

Mekanizmat që garantojnë një qeverisje të mirë përbëhen nga tre elementë kyç:

rregullat e brendshme dhe kufizimet, të tilla si sistemet e auditimit, pavarësia e sistemit gjyqësor dhe i Bankës Qëndrore, rregullat për shërbimin civil dhe buxhetin;

“zëri” - e drejta e votës dhe partnershipi, përdorimi i instrumentit të vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj publikut; dhe

konkurrenca - sisteme konkurruese në ofrimin e shërbimit për publikun.

Sektori publik luan një rol jetik për shoqërinë. Në shumicën e ekonomive, shpenzimet publike përbëjnë një pjesë të rëndësishme të produktit të përgjithshëm bruto, ndërsa entitetet e sektorit publik janë pjesëmarrës të rëndësishëm në tregun e kapitaleve, të mallrave e shërbimeve, si dhe në tregun e punës.

Eficienca e përdorimit të fondeve publike është e lidhur në një masë të konsiderueshme me nivelin e konkurrencës në tregun e prokurimeve publike si dhe me zbatimin e parimeve bazë të ekonomisë së tregut: atë të transparencës, së mosdiskriminimit dhe trajtimin e barabartë të të gjithë ofertuesve të produktit apo shërbimeve.

Pa dyshim, një rol shumë vendimtar luajnë punonjësit e administratës së autoritetit kontraktor, të cilët mund të shkaktojnë kufizimin e konkurrencës nëpërmjet specifikimeve jo të arsyeshme, duke u udhëhequr nga interesi i përfitimit personal.

Për mirëfunksionim të tregut të prokurimeve publike, që është gjithashtu pjesë e mirëqeverisjes, është e domosdoshme të merren në konsideratë dy sfida kryesore që janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën:

sigurimi i integritetit gjatë procesit të prokurimit (d.m.th eliminimi i korrupsionit tek nënpunësit e administratës që realizojnë procesin); dhe

promovimi i konkurrencës efektive midis ofertuesve, duke përfshirë parandalimin dhe ndalimin e marrëveshjeve të ndaluara apo sjelljet e bashkërenduara midis furnizuesve dhe heqjen e barrierave administrative apo praktikave, të cilat në mënyrë të panevojshme kufizojnë konkurrencën reale dhe efektive.

Këto dy sfida janë sa të ndërlydhura me njëra-tjetrën aq edhe të ndara, duke marrë si bazë shkaqet e shfaqjes, të cilat duhet që të njihen dhe të merren në konsideratë nga politikbërësit.

Autoriteti i Konkurrencës në Shqipëri paraqet një eksperiencë relativisht të pasur krahasuar me vitet e funksionimit dhe të zbatimit të Ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Këto eksperiencë lidhen me ndërhyrjet për të ndaluar sjelljet anti-konkurrese nga disa operatorë gjatë procesit të prokurimeve publike: si p.sh. në tregun e makinave të reja, atë të sigurisë fizike, ndertimi i infrastrukturës rrugore, etj.

Gjithashtu edhe duke përdorur instrumentin e advokacisë së konkurrencës nëpërmjet rekomandimeve për përmirësime ligjore dhe respektimin e filozofisë së konkurrencës: në formulimin e kriterëve apo në përcaktimin e madhësisë së loteve, si dhe për rritjen e transparencës së procedurave si në rastin e blerjes së energjisë elektrike nga kompania që e shpërndan.

Të nderuar kolegë,

Mirëqeverisja është detyrimi ynë i përbashkët, prandaj bashkëpunimi real ndër-institucional përbën një instrument shumë të rëndësishëm dhe jetik.

Rritja e eficiencës së aseteve dhe të fondeve publike është sfida jonë e përbashkët për vitin 2016 e më tej, si një domosdoshmëri jetike për rritjen ekonomike dhe mirëqënien e qytetarit.

Institucioni i konkurrencës i uron punë të mbarë dhe suksese Aditit të Lartë të Shtetit në ditën e sotme dhe në vitin në vijim.

FJALA PËRSHËNDETËSE E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË,

Z. GENT SEJKO



I nderuar z. President i Republikës së Shqipërisë,  
i nderuar z. Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit,  
i nderuar z. Ministër i Drejtësisë,  
i nderuar z. Ambasador i Shteteve të Bashkuara të  
Amerikës,  
i nderuar z. Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe  
Financave,  
të nderuar drejtues të institucioneve të larta  
shtetërore,  
të nderuar deputetë, profesorë dhe të pranishëm!

Është një kënaqësi e veçantë të jem sot i pranishëm dhe të përshëndes analizën vjetore të veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) për vitin 2015. Ky institucion renditet ndër institucionet më të rëndësishme kushtetuese të Shtetit Shqiptar, dhe me një objektiv që do ta konsideroja mjaft të lartë: miradministrimin e financave publike të vendit.

Përdorimi me efektivitet i fondeve publike, certifikimi i tyre konform ligjeve që rregullojnë veprimtarinë ekonomike dhe financiare të sektorit publik, komunikimi i vazhdueshëm me publikun në lidhje me parregullsitë dhe përgjegjësitë e rastit, janë drejtimet kryesore ku është orientuar veprimtaria e Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë viteve të fundit. Në këtë kontekst dëshiroj të theksoj se roli dhe misioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit janë të një rëndësie të veçantë, ndaj dhe çështjet e ngritura nga raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit duhen analizuar me kujdes, në mënyrë që ato të jenë jo vetëm të nevojshme, por edhe parandaluese për institucionet të cilat i nënshtrohen auditimit nga ana e kontrollit të shtetit.

Në cilësinë e drejtuesit të një institucioni financiar siç është Banka Qendrore e vendit, dëshiroj të theksoj se bashkëpunimi mes dy institucioneve ka qenë i frytshëm, në lartësinë që imponon dinamika e zhvillimeve të momentit dhe atyre të perspektivës.



Në mënyrë të vazhdueshme ne jemi përpjekur bashkarisht që përfundimet e arritura, si dhe rekomandimet e lëna nga ana e KLSH-së, të jenë sa më të dobishme, të natyrës udhëzuese, ndihmuese dhe korigjuese. Bazuar edhe në eksperiencën e kohës, vlerësoj se ky kombinim përbën thelbin e punës së çdo institucioni auditimi. Kam besuar dhe vazhdoj të besoj se auditimi është një levë shumë e rëndësishme, e cila shërben për të perfeksionuar më tej qeverisjen e sektorit publik. Kontrolli i Lartë i Shtetit me rolin e tij ka ndikuar dhe do të vazhdojë të ndikojë në indentifikimin e problemeve të ndryshme në institucionet publike, në zbulimin e shmangieve ligjore e rregullative, me efekt financiar, dhe në korigjimin e tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të standardeve ndërkombëtare.

Në vijim do të dëshiroja të ndalesha dhe tek roli i Kontrollit të Lartë të Shtetit në të ardhmen, i cili jam i sigurt se do të kontribuojë më shumë në drejtim të perfeksionimit të tre dimensioneve kryesore të qeverisjes së sektorit publik: atij mbikëqyrës, atij analizues dhe atij largpamës.

Më konkretisht, në drejtim të mbikëqyrjes, dilema e madhe është nëse entitetet publike janë duke përmbushur misionin e tyre në zbulimin dhe parandalimin e korrupsionit ose jo.

Në drejtim të analizës, dilema e madhe është nëse këto institucione janë duke marrë vendime të përgjegjshme në lidhje me politikat ekonomike, programet zhvillimore, operacionet dhe rezultatet e arritura.

Në drejtim të largpamësisë, dilema më e madhe është nëse janë përcaktuar drejt drejtimet dhe sfidat kryesore me të cilat audituesit duhet të përballen në të ardhmen.

Në këtë kontekst do të doja të theksoja se përafrimi i rolit auditues me standardet më të mira ndërkombëtare dhe bashkëkohore, njohja e specifikave dhe karakteristikave të subjekteve të audituara, si dhe intensifikimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstitutional gjatë procesit janë disa elementë që do të vazhdojnë të luajnë një rol kyç në punën dhe rezultatet e këtij institucioni. Në përfundim më lejoni të shpreh se kam besim të plotë që nëpërmjet nxitjes së faktorëve të sipërpërmendur, Kontrolli i Lartë i Shtetit do të vazhdojë të jetë në lartësinë e detyrës dhe sfidave që imponon koha dhe do të përmbushë me sukses misionin e tij në drejtim të përmirësimit të qeverisjes së institucioneve.

Duke ju falenderuar për vëmendjen, më lejoni t'ju uroj edhe një herë z. Leskaj suksese të mëtejshme në punën tuaj gjatë vitit 2016.

FJALA PËRSHËNDETËSE E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM TË ILDKPKI,  
Z. SHKËLQIM GANAJ



I nderuar zoti President,  
i nderuar zoti Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit,  
të nderuar pjesëmarrës!

Kam kënaqësi të veçantë të jem sot në një eveniment kaq të rëndësishëm, siç është Analiza Vjetore institucionale 2015.

Është e qartë tashmë që KLSH nën drejtimin e z. Leskaj ka arritur rezultate impresionuese jo vetëm në identifikimin e shkelësve të ligjit, abuzatorë të financave publike, por gjithashtu, dhe çka është shumë e rëndësishme, në rrugën e reformimit dhe modernizimit të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në përputhje të plotë me parimet dhe standardet ndërkombëtare.

Për shumë kohë institucionet e pavarura dhe drejtuesit e tyre, më së shumti, kanë munguar në krijimin e një vizioni të ri, institucional, modern. Ato janë drejtuar keq, pa përgjegjësi morale dhe profesionale, në frymën e inercisë të drejtimit dhe të përuljes ndaj pushtetit, si dhe duke shmangur bashkëpunimin mes tyre.

Mungesa e vizionit, ecja qorrazi, pa ditur se ku do të rrugëtojë institucioni, dhe se ku është destinacioni i tij final, kanë çuar edhe në performanca dhe rezultate të dobta institucionale.

Vizioni reformator dhe modernizues i kryetarit të KLSH-së, zotit Leskaj, i ka ndryshuar faqen institucionit, duke i rikthyer atij dinjitetin e munguar. Së bashku me rezultatet e qarta, çdo vit në rritje dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera ligjzbatuese, edhe komunikimi publik është përmirësuar ndjeshëm.

Mediat pasqyrojnë gjithnjë e më shumë çështje konkrete të referuara në Prokurori dhe aktivitete ndërkombëtare të KLSH-së. Kjo gjë tregon jo vetëm vlerësim pozitiv, por edhe kontribuon në rritjen e besimit të publikut të gjerë në punën e institucionit.

Unë dëshiroj të ndalem dhe të theksoj veçanërisht bashkëpunimin e shkëlqyer që dy institucionet tona, kanë ndërmjet tyre.

Ndonëse, fokusi i punës së tyre është i ndryshëm, misioni kryesor, ai i transparencës në qeverisje dhe lufta kundër korrupsionit, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave kontrolluese, i bashkon duke i bërë luftëtarë të një kauze të përbashkët: atë të qeverisjes së mirë, që sot më shumë se kurrë e kërkojnë qytetarët dhe taksapaguesit shqiptar.

Komunikimi periodik, larg burokracive të panevojshme, pa pengesa artificiale, është kthyer tashmë në një normë midis dy institucioneve tona.

Rastet e shkëmbimit të informacioneve për zyrtarë të korruptuar ose që ushtrojnë funksionet publike në konflikt interesi kanë qenë të shumta e të vazhdueshme dhe kanë marrë në çdo rast zgjidhjet adekuate ligjore.

Duke mos dashur të zgjatem më shumë, sepse sot në fakt është dita juaj, shpreh edhe njëherë vlerësimin e thellë për punën tuaj.

Suksese të mëtejshme.

Ju faleminderit!

FJALA PËRSHËNDETËSE E MINISTRIT TË DREJTËSISË,  
Z. YLLI MANJANI



I nderuar z. President,  
z. Ambasador,  
i nderuar z. Leskaj!

Asnjë qeveri nuk është e imunizuar nga gabimi, apo qoftë dhe nga krimi, kështu që nga kjo pikëpamje nevoja për audit, kontrolle dhe për verifikimin e vazhdueshëm të mënyrës se si përdoren fondet publike çdo qeveri e ka të pashmangshme, madje e ka të domosdoshme. Kështu që nga kjo pikëpamje përgëzimet e mia dhe në emër të Qeverisë Shqiptare ndaj Kontrollit të Lartë të Shtetit për çdo rresht, paragraf, pikë apo presje që ka në rekomandimet e tij.

Padyshim që konstatimet tuaja janë detyrim për ne, kjo është e padiskutueshme. Natyrisht që shkelja e ligjit është e larmishme dhe për ne nuk është e rëndësishme të lidhet detyrimisht me shumat përkatëse, se nga njëherë e kemi ngarkuar opinionin publik me shuma marramëndëse, duket sikur ka ndodhur ndonjë hata edhe pse nuk e përjashtoj edhe ndodhjen e hatasë, por ka disa gjëra që duhet t'i sqarojmë mirë.

Në komentin publik, në analizën publike ende për fat të keq nuk kemi hequr dorë nga parimet e drejtësisë popullore, ku tregohet gishti krejt papritur ose në mënyrë të pritur publikisht dhe menjëherë sapo del në televizion shpallësh fajtor. Kjo është një praktikë komuniste, 24 karatëshe, e cila del nga parimet e diktaturës dhe të drejtësisë popullore dhe këtë gjë sigurisht që nuk mund ta pranojmë sot në një mjedis demokratik, për shkak se jetojmë në një kohë tjetër dhe zakonisht analiza publike e nisur nga këto premisa besoj që e përkeqëson situatën.

Kemi ardhur në një pikë që kemi më shumë persona të arrestuar në sistemin tonë të burgjeve sesa të dënuar dhe kjo nuk është sukses i drejtësisë penale. Ka një

zgjdhje të cilën Qeveria Shqiptare dhe jam i sigurt që edhe parlamenti në mënyrë konsensuale shumë shpejt do t'i ofrojë prokurorisë shqiptare, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe kujtdo denoncuesi tjetër, që të hetoj krimin e organizuar dhe në mënyrë të veçantë korrupsionin e qeverisë. S'ka më diskutim kjo histori, do ta realizojmë në mënyrë konsensuale që nesër askush mos të ketë arsye për të thënë që po e bëjmë politikisht, por do ta bëjmë siç e ka bërë Rumania, Kroacia dhe vende të tjera, që ne kemi mundësinë për t'i marrë këto modele dhe t'i korrektojmë vendimet e tyre nëse ka ndonjë gabim.

Ne jemi të interesuar më shumë sesa çdokush tjetër që kushdo që shkel ligjin të shkojë para drejtësisë. Ky është një instrument që jemi të angazhuar 100 përqind për ta bërë një orë e më parë. Shkelja e ligjit nuk mund të çojë detyrimisht në veprimtari penale.

Vepra penale është njëra gjë, por morali i zyrtarit publik që gjendet në akuzë jo detyrimisht penale, por kapet me shkelje të ligjit, sigurisht që nuk mund të jetë nëpunësi i administratës publike. Jo vetëm për institucionet që unë kam në varësi, por në tërësi i kam sugjeruar Qeverisë që rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit të jenë të zbatueshme, në kuptimin e masës disiplinore. Çdo shoqëri ka një moral dhe morali i zbatimit të ligjit është i padiskutueshëm!

Drejtësia popullore thoshte se çfarë thotë populli bën partia. Ka rënë ky system, nuk ekziston më. Sot është drejtësia e ligjit dhe në bazë të ligjit mund të hysh në burg, ose mund të mos hysh në burg, por ama edhe kur nuk hyn në burg s'mund të jesh nëpunës publik nëse kapesh me shkelje të ligjit. Ky është morali i vetëm që na vë ne përpara standardit demokratik korrekt.

E fundit që kam është që ne kemi shumë nevojë për audite performance. Auditi i performancës nuk çon detyrimisht në etiketimin shkelës ligji apo abuzues. Çdo objektiv qeverisë, çdo objektiv politik ose politikash është i lidhur me para publike dhe këto para publike kanë nevojë që të auditohen më së miri, kanë nevojë që ta përmirësojnë qeverisjen në drejtim të realizimit të objektivit ashtu siç duhet dhe që përkthehet pastaj në shërbime sa më të mira publike.

Për këtë ndihma e Kontrollit të Lartë të Shtetit është e pazëvendësueshme. Kështu që nga kjo pikëpamje ju përsënderes, ju urojë punë të mbarë dhe në bashkëpunimin tonë të përvitshëm të jemi sa më eficientë.

FJALA PËRSHËNDETËSE E AVOKATIT TË POPULLIT,  
Z. IGLI TOTOZANI



I nderuar z. President,  
i nderuar z. Kryetar,  
z. Ambasador,  
të nderuar kolegë!

E prita me shumë kënaqësi ftesën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, zotit Bujar Leskaj, për të marrë pjesë në këtë analizë të punës së institucionit tuaj, jo thjesht si një qokë, që shpesh behet në të tilla raste, por si pjesë e një filozofie të re, që ky institucion ka përqafuar, duke u bërë më transparent dhe duke u afruar në standardet dhe konceptin e qëllimit për të cilin është krijuar, pra që t'i shërbejë të drejtave themelore të qytetarëve për një qeverisje sa më efikase në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.

Unë besoj se rreshtohemi në të njëjtën linjë. Kemi përgjegjësinë për të qenë aleatë në krah të qytetarëve e në mbrojtje të interesave të tyre. Sikundër kemi detyrimin të bëhemi kundërshtarët më të rreptë të abuzimit, arrogancës, dhe paaftësisë së shumë zyrtarëve, të cilët ulen e ngrihen në karrige pushteti, pa kuptuar kurrë se punët e qeverisë nuk janë për të mbushur xhepat personale, por për të rritur mirëqënien e qytetarëve.

Fatkeqësisht, mendoj se jemi në një situatë më të vërtetë emergjence. Korrupsioni e ka gërryer shoqërinë në atë pikë sa qytetari ka humbur besimin. Këtë situatë edhe për shkak të detyrave tona institucionale ne e konstatojmë rëndom në ankesat e shumta që qytetarët adresojnë përditë pranë nesh.

Këtë qytetari e ndjen, në shëndetësi, në arsim, në kontaktin me zyrtarin e korruptuar apo të paaftë. Por qytetari këtë e ndjen në mënyrë indirekte edhe në

shkatërimin e pronës dhe të biznesit të tij, kur paratë shpërdorohen për investime infrastrukturore gjysmake apo elektorale. Të korruptuarit nuk duhet të mbeten pa u ndëshkuar.

Do desha të ndaja me ju me këtë rast, duke e çmuar shumë të rëndësishëm një shembull konkret, i cili shpreh jo vetëm perceptimin tim, por të të gjithë banorëve që unë takova në rastin e daljes së fundmi nga shtrati të lumit Shkumbin. Në atë zonë, janë shkatërruar disa ura me pasoja katastrofike për mijra banorë, të cilëve ju është ndërprerë, (dhe vazhdon fatkeqësisht të jetë i tillë), jeta e përditshme, biznesi, shkolla e fëmijëve, etj. Në këtë lumë, pavarësisht përmbytjeve në vite vazhdon të qëndrojnë në këmbë dhe të funksionojë një urë e ndërtuar në shekullin e 17-të, ndërkohë që ato të ndërtuara së fundmi nuk qëndrojnë në këmbë. E pra, kjo vjen era korrupsion dhe në këtë rast nuk janë vjedhur ca para, por shkon përtej, pasi ka sjellë shkeljen e të drejtës themelore të banorëve të zonës, të përmbushin nevojat e jetesës, të shkollimit apo të biznesit të tyre, të cilën ja garanton Kushtetuta e Shqipërisë.

E tregova këtë shembull për të gjetur në këto raste mundësitë, për të bashkëpunuar e ndërvepruar mes institucioneve tona, të fokusura thelbësisht në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ky është një mision joni i përbashkët.

Në këtë kuadër, respektimi i pavarësisë së institucioneve të pavarura, forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare të tyre, zbatimi i standardeve dhe praktikave më të mira, është dhe mbetet një perpjekje dhe sfide e vazhdueshme e institucioneve tona.

Konstatoj me kënaqësi, se Kontrolli i Lartë i Shtetit vitet e fundit ka bërë një punë të lavdërueshme dhe efikase, duke u spikatur dukshëm si një institucion i pavarur dhe me rezultate të larta në luftën kundër korrupsionit dhe keqmenaxhimit të fondeve publike.

Është kjo pavarësi që institucioni juaj ka siguruar, që sot shumë zyrtare nga niveli me i ulët e deri në funksionarë të lartë politikë, kanë përfunduar në Prokurori për shpërdorim të fondeve publike, apo dhe shumë të tjerë janë ndëshkuar me masa administrative.

Por, një luftë jo e vogël, presionin e të cilës e ndiejmë shumë edhe ne si institucion i pavarur, është perpjekja e vazhdueshme që duhet bërë, në ndryshimin e filozofisë së vetë qeverisjes, e cila shpesh herë pavarësinë dhe rekomandimet tona i shohin si

një bezdisje dhe sulme ndaj tyre dhe jo si një frymë bashkëpunimi në përsosje të punës së tyre.


Dhe në rastin tuaj institucionet duhet të jenë tërësisht të vetëdijshëm mbi rëndësinë që kanë rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit si një instrument i domosdoshëm në mbrojtjen e fondeve shtetërore, duke inkurajuar në këtë mënyrë një qeverisje më të mirë në sektorin publik.

Gjej rastin të falenderoj dhe të vlerësoj ftesën që kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj na ka drejtuar së fundi për një bashkëpunim të ngushtë midis institucioneve tona, ku komisionerët dhe ekspertët e Avokatit të Popullit do të ftohen të trajtojnë çështje të rëndësishme si vlerësimi dhe mënyra e trajtimit të letrave dhe ankesave të qytetarëve nga KLSH, apo vlerësimin e marrëdhënieve të punës në KLSH në këndvështrimin e respektimit të të drejtave të njeriut.

Në cilësinë e Avokatit të Popullit, dua të shpreh edhe një herë mbështetjen e fuqishme për punën dhe rolin e pazëvendësueshëm të KLSH, në mirëpërdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore dhe t'ju uroj suksese në punën tuaj të përditshme.



FJALA PËRSHËNDETËSE E AUDITUESIT TË PËRGJITHSHËM NË DETYRË TË ZYRËS SË  
AUDITUESIT TË PËRGJITHSHËM TË KOSOVËS, Z. ARTAN VENHARI



I nderuar z. Leskaj,  
të nderuar të ftuar e pjesëmarrës!

Është një kënaqësi e veçantë që unë së bashku me 9 auditues nga Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës jemi sot të pranishëm dhe të paraqesim dhe disa arritjet tona, në këtë analizën vjetore të veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) për vitin 2015.

Sfidat për një ISA (institucionet Supreme të Auditimit) janë:

- Të kuptuarit e kontekstit brenda të cilit veprojmë;
- Të jemi pjesëmarrës aktivë në shtetformim;
- Përkrahim qeverisjen e mirë dhe transparencën;
- Raportet tona të kenë vlerë të shtuar;
- Të përkrahim auditorë tanë në zhvillimin e tyre.

Kështu që hapat e nevojshëm të zhvillimit janë:

- Krijimi i strategjisë – ku dëshirojmë të jemi;
- Zhvillimi i platformës për përmbushjen e atij synimi;
- Sidoqoftë, duhet mbajtur mend që veprojmë me burime të kufizuara – prandaj duhet përcaktuar prioritetet;
- Duhet lëvizur në krah me institucionet tjera (zhvillim i përbashkët).

Elementet e ISA-ve janë:

Kompetenca: Zhvillimi i një organizate e bazuar në njohuri. Nevojë për të ruajtur reputacionin e mirë, siguruar besueshmërinë, dhe për të mbajtur integritetin;

Pavarësia: Pavarësia është vendimtare për integritetin dhe besueshmërinë e nevojshme dhe për të pasur besimin e shoqërisë në punën tonë;

Objektiviteti: Të gjitha komunikimet, me shkrim apo edhe me gojë, duhet të paraqiten në mënyrë neutrale, të drejtë, konstruktive dhe të baraspeshuar. Duhet të përqipemi të jemi të saktë dhe të besueshëm.

Strategjia jonë zhvillimore

Strategjia jonë zhvillimore është lidhur ngushtë me aspiratat tona për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (2015-2020).

Kemi përcaktuar 3 objektiva (shtylla):

1. Sigurimi i pronësisë vendore dhe qëndrueshmërisë Institucionale;
2. Kontribuimi në qeverisjen e mirë; dhe
3. Zhvillimi dhe ruajtja e cilësisë.

Shtylla 1 – Sigurimi i pronësisë vendore dhe qëndrueshmëria institucionale.

- Programi për certifikimin e auditorëve të rregullsisë, i bazuar në SNISA;
- Manuali i auditimit të performancës, i azhurnuar, i cili përfshin një kapitull të ri rreth auditimit të vlerës së parasë në sistemet e prokurimit, së shpejti edhe TI;
- Programin për certifikim të auditorëve të performancës, i bazuar në SNISA (Standardet Ndërkombëtare të ISA), i cili ka filluar të zbatohet.
- Një strukturë organizative që na lejon të punojmë në lidhje me prioritetet sipas agjendës evropiane

Ne vazhdimisht rristrukturojmë organizatën tonë për të promovuar arritjen e objektivave tona. Si një institucion i orientuar drejt rezultateve, ne e zhvillojmë veprimtarinë tonë duke u fokusuar në prodhimin dhe rezultatet dhe ndikimin e tij.

Ne synojmë të rishikojmë rregullisht progresin tonë në zbatimin e Strategjisë tonë të Zhvillimit Korporativ për të parë se çfarë është arritur dhe për të azhurnuar planin tonë të veprimit sipas nevojës.

Një numër i partnerëve dhe palëve të interesit të jashtëm kontribuojnë për arritjen e misionit, vizionit dhe objektivave tona, ose përfitojnë nga kjo. Këta partnerë dhe palë të interesit përfshijnë jo vetëm Kuvendin dhe institucionet qeveritare por edhe shoqërinë civile, organizatat donatore, mjetet e informacionit dhe publikun në përgjithësi.

Ne do të jemi një partner aktiv në mbledhjet e Rrjetit të ISA-ve të Vendeve Kandidate dhe Vendeve të Mundshme Kandidate të Evropës dhe Azisë Qendrore, si një forum i rëndësishëm për të rritur shkëmbimin dhe bashkëpunimin mes ISA-ve në rajon.

Shtylla 2 – Kontribuimi në forcimin e qeverisjes së mirë, pra:

- Mbështetja e menaxhimit të shëndoshë financiar në administratën publike; rritja e llogaridhënies publike dhe transparencës, si dhe zhvillimi i menaxhimit nga rezultatet;
- Promovimi i ndryshimeve efektive në sektorin publik ku nuk ka zhvillim apo ka ngecje në fushat e menaxhimit financiar, transparencës dhe llogaridhënies,

realizohet përmes: Auditimit të Rregullësisë për qeverinë Qendrore dhe atë Lokale; Auditimit të Performancës; Auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit; Auditimit të fondeve të donatorëve; Raportimit vjetor për auditimin; Bashkëpunimit me Kuvend; etj.

Shtylla 3 – Zhvillimi dhe ruajtja e cilësisë së organizatës dhe auditimit.

Qeverisja e mirë korporative është thelbësore për çdo organizatë efektive. Dy elementet kyçe të qeverisjes së mirë janë cilësia dhe efikasiteti i veprimeve.

Raportimi Vjetor i Performancës përmbledh rezultatet e punës të ZAP-it dhe e krahason performancën me vitet e mëparshme.

	2008	2014
Buxheti	€1,204,239 (realizimi 71.6%)	€2,130,753 (realizimi 99%)
Punonjësit	80	146
Produktet	Auditime të rregullësisë	Auditime të rregullësisë; Auditime të Performansës, Auditime Menaxheriale, Auditime të sistemeve, Raporti Vjetor i performansës së ZAP, Dokumente diskutuese, Strategjia e Zhvillimit Korporativ, Udhëzuesi/Manuali i Auditimit të Performansës, Politikat e zhvilluara të Komunikimit, Udhëzuesi/Manuali i Auditimit të Rregullësisë, Kodi i Mirësjelljes
Prodhimi	25 Raporte	110 Raporte
Cilësia	Nuk kishte të vendosur	Njësia e Auditimit të Metodologjisë me cilësi të zhvilluar
Shërbimet lidhur me auditimin	Nuk kishte të vendosur	Pjesëmarrja në grupe punuese në Kuvend (Grupe Parlamentare) dhe në Qeveri për të përkrahur proceset dhe sistemet
Rrjetet	EURORAI	EUROSAI, Rrjeti i shteteve kandidate dhe potenciale/aspiruese

Për të ruajtur besimin në kompetencën e punës sonë, është jetike të ketë një sistem rigoroz, të besueshëm dhe gjithëpërfshirës për vlerësimin e cilësisë së punës së vet.

Zhvillimi i ZAP si një qendër e njohurive dhe ekspertizës në fushën e MFP-së, kryhet nëpërmjet mobilizimit të resurseve tona (auditorëve) për të krijuar njohuri në fusha të ndryshme dhe fokus në zhvillimin e stafit me aftësitë më të larta.

Fushat në fokus ku ne jemi fokusuar janë: Reforma në Administratën Publike; Ofrimi efektiv i shërbimeve publike; Planifikimi dhe buxhetimi; Raportimi, kontabiliteti dhe auditimi; Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike; Mbrojta e interesave financiare të BE-së; dhe Makroekonomia.

Sidoqoftë, pika më e rëndësishme për institucionet tona mbetet cilësia dhe përfshirja në punë të përditshme në ISA-ve, si dhe përfshirja e axhendës së cilësisë përgjatë tërë institucionit pjesërisht edhe përmes ngritjes së nivelit të njohurive dhe përfshirjes së hisedarëve të tjerë në zhvillimin e strategjive dhe hartimit të raporteve janë të një rëndësie të lartë.

## RAPORTI I PËRFORMANCËS INSTITUCIONALE PËR VITIN 2015

Mbajtur nga Kryetari i KLSH-së, z. Bujar LESKAJ

Qëndrueshmëria e financave publike dhe besueshmëria e qeverisjes janë kthyer sot në sfida qendrore dhe qëllim më vete për Bashkimin Evropian, për vendet e tjera të zhvilluara dhe vendet në zhvillim. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Ban Ki-Moon ka theksuar se *"Besimi ndërmjet qytetarëve, ndërmjet shteteve, dhe në vetë konceptin e qeverisjes është një nga nevojat më vitale për paqen dhe prosperitetin e njerëzimit"*.



E ndodhur përpara pasojave të krizës botërore ekonomike dhe financiare 2008-2012 (e cila u shkaktua dhe nga informacioni i mangët apo i devijuar fiskal dhe financiar) dhe domosdoshmërisë së disiplinimit të mëtejshëm të financave publike dhe rritjes së transparencës fiskale e financiare të qeverisjes kudo në botë, OKB ka gjykuar se partnerët më të rëndësishëm të qeverive në botë, në përballimin e këtyre sfidave janë SAI-t dhe organizata e tyre mbarëbotërore, INTOSAI. Më 22 dhjetor 2011 dhe me 19 dhjetor 2014, në kuadrin e Axhendës së saj të Zhvillimit Post 2015, Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) ka miratuar dy rezoluta për

institucionet supreme të auditimit, Rezoluta A/66/209 "*Nxitja e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit*" dhe Rezoluta A/69/228: "*Promovimi dhe fuqizimi i eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, me anë të forcimit të institucioneve të larta të auditimit*".

Një çështje thelbësore sot në punën e një SAI, është përcaktimi i saktë i matësve të performancës dhe efektivitetit të auditimit. Treguesit më të mirë dhe më gjithëpërfshirës janë treguesit që marrin parasysh efektivitetin dhe rrezikun, me gjithë problemet që shoqërojnë auditimin.

Në përshëndetjen e tij drejtuar KLSH në 90 vjetorin e krijimit në maj 2015, Auditori i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit Qeveritar të SHBA-së, z. Gene L. Dodaro theksoi se: "*Institucionet Supreme të Auditimit janë vitalë për të ndihmuar përmirësimin e performancës së qeverisë, për të arritur më shumë transparencë, si dhe për të siguruar përgjegjshmëri në kontekstin e sfidave aktuale*".

Një dimension tjetër, atë këshillues të SAI-ve, e ka përcaktuar në Simpoziumin OKB-INTOSAI të vitit 2013, Dr. Jozef Moser, Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAIT ka cilësuar se "*SAI-t mund të shfrytëzojnë plotësisht potencialin e tyre për të kontribuar në qeverisjen e mirë publike vetëm nëse, duke u bazuar në punën e tyre të auditimit, ata gjithashtu angazhohen në veprimtari këshillimore dhe ofrojnë rekomandime specifike për subjektet e audituara dhe për vendim-marrësit*".

Orientuar nga këto drejtime bazë të punës së një SAI, analiza e veprimtarisë së KLSH për vitin 2015 po kryhet bazuar në Dokumentin Standard të Matjes së Performancës së SAI-ve (dokument ky i lançuar dhe promovuar nga Kongresi INCOSAI 21 i organizatës INTOSAI i tetorit 2013, i cili po përdoret gjerësisht nga SAI-t e zhvilluara për të vlerësuar rezultatet e tyre), si dhe në Analizën SWOT, e cila na lejon të identifikojmë pikat e forta dhe të dobëta të aktivitetit auditues dhe të menaxhimit institucional.

Dokumenti standard i INTOSAI-t ka një grup prej 24 treguesish për të matur performancën e SAI-ve, kundrejt praktikave më të mira ndërkombëtare në shtatë fusha:

- (1) Performanca e SAI-ve;
- (2) Pavarësia dhe Korniza Ligjore;
- (3) Strategjia për Zhvillimin Organizativ;

- (4) Standardet e Auditimit dhe Metodologjia;
- (5) Menaxhimi dhe Strukturat Mbështetëse;
- (6) Burimet Njerëzore dhe Komunikimi, si dhe
- (7) Menaxhimi i Palëve të Interesuara.

KLSH, në bazë të kornizës së treguesve të performancës së SAI-ve, si dhe të mjedisit dhe kushteve specifike të vendit, ka përcaktuar 14 tregues kryesore performance në dy kolonat e veprimtarisë së tij, puna audituese dhe menaxhimi institucional, dhe pikërisht:

1. Auditimet dhe ecuria e tyre;
2. Dëmi ekonomik i zbuluar dhe dobishmëria;
3. Rekomandimet me impakt të lartë;
4. Numri i rekomandimeve;
5. Niveli i zbatimit të rekomandimeve;
6. Kallëzimet penale;
7. 7 Auditimet e performancës;
8. Zhvillimi i burimeve njerëzore;
9. Kontrolli i cilësisë;
10. Transparenca dhe komunikimi;
11. Aftësia për partneritet (me partnerë vendas dhe të huaj);
12. Kërkimi shkencor dhe botimet;
13. Kuadri ligjor;
14. Strategjia e KLSH.

Analiza vjetore KLSH 2015 zgjodhi qasjet dhe instrumentet më inovative të aplikuar nga komuniteti i INTOSAIT, në përmbushje të kërkesave të dy Rezolutave të OKB-së të viteve 2011 dhe 2014, për forcimin dhe mbështetjen e institucioneve supreme të auditimit, si dhe të standardeve ndërkombëtare të fushës, ISSAI. Rezolutat A/66/209 dhe A/69/228 inkurajojnë shtetet anëtare dhe institucionet e Kombeve të Bashkuara për të vazhduar dhe intensifikuar bashkëpunimin e tyre me SAI-t, duke përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve, në mënyrë që të promovohet qeverisja e mirë në të gjitha nivelet, duke siguruar eficiencë, llogaridhënie, efektivitet dhe transparencë, përmes forcimit të SAI-ve.

Viti 2015 është viti i dytë i aplikimit nga KLSH të Instrumentit të vetëvlerësimit të Integritetit INTOSAIT, një metodologji e përdorur sot gjerësisht nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-t) me të përparuar të organizatës EUROSAT e më gjerë.



Faza e parë e analizës vjetore u zhvillua në dhjetor 2015 në formën e workshope-ve të departamenteve të veçantë të auditimit të KLSH. Kjo qasje u karakterizua nga transparenca, informimi i publikut dhe pjesëmarrja e gjerë e palëve të interesit. Analizat në nivel departamenti u organizuan në mjediset universitare publike të Shkodrës, Vlorës Elbasanit dhe Tiranës, me përfaqësues nga fusha akademike, pedagogë dhe studentë si dhe përfaqësues të medias, duke marrë dhe një funksion shtesë edukues dhe trajnues, me impakt konsolidimin e kapaciteteve të audituesve.

Organizimi i workshopeve departamentale krijoi mundësinë që audituesit të marrin një informacion jo vetëm për treguesit e konsoliduar të performancës së Departamentit, por analiza e veprimtarisë audituese u prezantua në teknologjinë powerpoint nga vetë audituesit, duke pasqyruar njëherazi rezultatet e misioneve të auditimit dhe metodologjitë e përdorura në funksion të arritjes së rezultateve.

Raporti i Analizës Vjetore është një përmbledhje e rezultateve kryesore të arritura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij për periudhën Janar-Dhjetor 2015. Ai është konceptuar mbi bazën e Kuadrit të Matjes së Performancës (PMF) së SAI-ve, Analizës SWOT dhe metodologjisë së vetëvlerësimit të integritetit INTOSAINIT.

Treguesit, krahas niveleve të arritura vjetore, janë vendosur në raporte krahasimore dinamike me treguesit e veprimtarisë së viteve të mëparshme, çka mundëson një informacion të shtrirë në kohë dhe ndihmon në perceptimin e tendencave dhe ritmeve të zhvillimit të procesit auditues.

Matja e punës nëpërmjet treguesve të performancës, të cilët përmbledhin standardet ISSAI dhe praktikatat e tjera më të mira të përcaktuara nga INTOSAI, jep një pasqyrë të të gjitha fushave më të rëndësishme të aktivitetit dhe rezultateve të një SAI.

Ajo përfshin si proceset e brendshme të institucionit (mënyrën e organizimit, zbatimin e rregullores së brendshme, zhvillimin e burimeve njerëzore, etj.), ashtu edhe komunikimet me jashtë (partneritetet, komunikimin me qytetarët dhe publikun, etj.) dhe rezultatet.

Matjet objektive të performancës në formën e treguesve, e bëjnë të përshtatshëm edhe krahasimin e performancës së aktivitetit të SAI-t në intervale të dhëna kohe.

Raporti jep edhe fokusin e veprimtarisë audituese të KLSH në vitin 2016, i cili, krahas zhvillimit të auditimit financiar, do të ndjekë me përkushtim realizimin e

rekomandimeve të institucionit për largimin nga puna të zyrtareve të lartë të kapur në korrupsion ose abuzim me pronën publike, si dhe do të kryejë auditimet e performancës të përqendruara kryesisht në marrëveshjet koncesionare, në partneritetet publik-privat dhe në performancën e borxhit publik, me synim shëndoshjen e mëtejshme të financave publike të vendit dhe uljen e risqeve fiskale.

## I. ANALIZA SWOT<sup>1</sup>

Analiza SWOT është një nga instrumentet menaxheriale që stafi drejtues i KLSH-së përdor në identifikimin e faktorëve potencialisht ndikues mbi objektivat e synuara dhe në asistimin e vendim-marrjes për përbushjen e tyre.

Po bëhen përpjekje për implementimin e teknikave të tjera menaxheriale si: PESTLE (faktorët politikë, ekonomikë, socialë, teknologjikë, ligjorë dhe mjedisorë) apo Balance Scorecard.<sup>2</sup>

Analiza kryhet çdo vit, në rang institucional dhe departamental, për të qartësuar dhe unifikuar perceptimin e mjedisit brenda dhe jashtë sferës ndikuese së KLSH-së.


---

<sup>1</sup>"AnalizaSWOT" është instrument strategjik në duart e menaxhimit të institucionit që si realizohet analiza SWOT ?

Për të realizuar një SWOT analizë të suksesshme duhet që të identifikohet qartë fusha e realizimit të analizës me qëllim që ajo të jetë sa më reale dhe sa më e dobishme. Nëse qëllimi është që të shihet raporti mes kompanisë dhe disa konkurrentëve të caktuar, atëherë hapi më i mirë është fillimisht identifikimi i konkurrentëve dhe pastaj realizimi i matjeve në raport me secilin konkurrent. Në mënyrë analoge kryhet analiza edhe sa i përket segmenteve të caktuara të tregut. Realizimi i një analize të përgjithshme duke i marrë për bazë analizat specifike do të jepte një pasqyrë të biznesit në përgjithësi, kurse realizimi i kësaj analize pa analiza specifike si bazë do ishte më e komplikuar dhe më pak preciz.

Pas caktimit të fushës së analizës, duhen identifikuar të gjithë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në performancën e ndërmarrjes. Faktorët e jashtë klasifikohen si mundësi dhe kërcënime (opportunities and threats) dhe janë jashtë kontrollit menaxherial të institucionit. Faktorët e brendshëm klasifikohen si fuqi dhe dobësi (strengths and weaknesses) dhe mund ndikohen direkt ose indirekt nga institucioni. Qëllimi final është balancimi i faktorëve të jashtëm me ata të brendshëm për të maksimizuar suksesin. Ky balancim realizohet përmes strategjisë e më tej përmes planeve taktike e atyre operacionale. Një drejtues vizionar është i aftë të shndërrojë kërcënimet në mundësi dhe dobësitë në fuqi.

<sup>2</sup>Balanced scorecard është një sistem menaxhimi dhe planifikimi strategjik, që përdoret në mjediset e biznesit dhe industriale, institucionet qeveritare dhe OJF për të sinkronizuar aktivitetet operacionale me vizionin dhe strategjinë organizative, përmirësuar komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe kontrolluar e monitoruar realizimin e planeve dhe politikave.



Për periudhën Janar – Dhjetor 2015, analiza SWOT, në trajtë të zgjeruar, konstatoi:

## Fuqitë

1. Mandat i qartë kushtetues – Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në pjesën e XIV-të të saj, nenet 162-165, përcakton në mënyrë të qartë, eksplicite dhe pa ekuivoke pavarësinë institucionale, fokusin e punës dhe detyrat funksionale, si edhe pozicionin e Kryetarit të KLSH-së në marrëdhëniet me organet më të larta shtetërore të RSH-së. Një mandat i tillë është baza e punës audituese, që për kryefjalë të saj ka pavarësinë, objektivitetin, paanësinë dhe profesionalizmin e opinioneve që jep në tipe të ndryshme auditimesh.
2. Pavarësia e sanksionuar përmes një mandati të qartë dhe të fuqishëm, në bazë të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH” – Ligji i ri Institucional, miratuar pas debatesh të shumta në Komisionet Parlamentare në Nëntor të vitit 2014, zgjeron duke përpunuar, detajuar e plotësuar pavarësinë institucionale të shprehur në Kushtetutë.

Ligji zgjeron më së pari sferën audituese të KLSH-së, duke prezantuar dy tipe bashkëkohore auditimi, atë të performancës dhe teknologjisë së informacionit. Përdor në mënyrë të përkëmbyer termin “kontroll” me termin “auditim”, në përqsje me standardet ndërkombëtare audituese dhe praktikat më të mira të

SAI-eve homologe. Specifikon aksesin në grumbullimin, analizimin dhe publikimin e informacionit, përfshirë edhe atë konfidencial. Adreson transparencën në marrëdhënien me të tretët dhe thekson etikën e integritetin profesional të punonjësve dhe ekspertëve të KLSH-së.

3. Vizion dhe Plan Strategjik të miratuar dhe implementuar në kohë – vizioni strategjik institucional, formuluar në planin strategjik, synon që KLSH të përmbushë maksimalisht rolin e vet kushtetues, atë të rritjes së përgjegjshmërisë për të gjithë komunitetin të cilit i shërben.

Për përmbushjen e këtij vizioni, KLSH ka formuluar planin strategjik 2013-2017, e ka përditësuar atë në 2015 dhe e ka detajuar me Planin e Veprimit 2015-2017. Plani strategjik ka formuluar objektiva të cilat adresojnë kuadrin ligjor dhe rregullativ, rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike në funksion të përmirësimit të auditimit, luftën ndaj korrupsionit, impaktin në Kuvend, Qeveri, palë interesi dhe publik, etj. Po kështu, strategjia e zhvillimit insitucional të KLSH-së 2013-2017 dhe e ripunuar 2015-2017 konvergon me strategjinë e INTOSAI-t 2011-2016 dhe atë EUROSAI 2011-2017.

4. Kornizë rregullative dhe udhëzuese nën frymën INTOSAIN, për të promovuar integritetin, si karakteristikë kyçe e besimit të perceptuar nga Kuvendi dhe palët e interesit – KLSH ka miratuar së fundmi Rregulloren e re Institucionale, e cila vjen në frymën e IntoSAINT. IntoSAINT është një instrument vetë-vlerësimi që SAI duhet ta përdorë për vlerësimin e risqeve ndaj integritetit dhe maturitetit të sistemeve për të menaxhuar këto risqe. Rregullorja e re institucionale, së bashku me Kodin e ri të Etikës, miratuar në Prill 2015, përdorin këtë taktikë menaxheriale për të dizenuar një politikë adekuate integriteti, duke rritur ndërkohë ndërgjegjësimin e stafit auditues në këtë drejtim.
5. Lidership nëpërmjet shembullit, transformues dhe me inteligjencë emocionale në rang institucional dhe departamental – Stafi drejtues i KLSH-së është pjesë integrale e rutinës së përditshme audituese, duke vënë në jetë moton e INTOSAI-t: “Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë”. Udhëheqja përmes shembullit forcon frymën e grupit, shërben si faktor motivues dhe rrit besimin e transparencën e ndërsjellë epror-vartës dhe midis kolegësh. Inteligjenca emocionale mundëson komunikimin e sinqertë, diversitetin e vlerave dhe qëndrimeve, optimizmin dhe empatinë.

6. Strukturë e qartë formale dhe e shtresëzuar optimalisht në 2 linja autoriteti dhe 3 nivele vendim-marrëse – Organizimi hierarkik i autoritetit në një organizatë është kritik në ndarjen e roleve dhe përgjegjësi, menaxhimin e integritetit profesional e personal, si dhe suksesin e organizatës si të tërë. Në përputhje me frymën IntoSAINT, në KLSH ekzistojnë dy linja vertikale hierarkike: një për funksionet primare audituese dhe një për funksionet mbështetëse. Secila linjë është e ndarë në 3 nivele vendimarrëse:

1. Kryetari,
2. Sekretari/Drejtori i Përgjithshëm dhe
3. Drejtorët e Departamenteve/Drejtorive.

Një shtresëzim i tillë është fleksibël, optimalisht burokratik dhe mundëson rrjedhjen e shpejtë dhe formale të informacionit.

7. Menaxherë me grada shkencore, përvojë të gjatë institucionale dhe njohuri të thelluara në fushën e auditimit – Niveli i lartë dhe i mesëm drejtues në KLSH ka të punësuar 2 profesorë të asociuar në lëmin e jurisprudencës dhe ekonomisë, 3 doktorë shkencash dhe një sërë zyrtarësh të tjerë me mastër shkencor apo profesional në fushën e shkencave sociale, ekonomike, juridike, komunikimit, etj. Drejtuesit e departamenteve apo drejtorive kanë minimalisht mbi 3 vjet që okupojnë këto pozicione dhe një pjesë e tyre vijnë nga bota akademike, ndërsa pjesa tjetër kanë avancuar gradualisht në këto poste brenda KLSH-së, duke investuar punë dhe përkushtim për një periudhë kohore mbi 15 vjet.

8. Standarde Ndërkombëtare Auditimi që aplikohen drejtpërsëdrejti në punën audituese – KLSH mbështetet në ISSAI-et për përmbushjen e funksionit të vetë primar auditues. Një qasje e tillë parametrizon punën audituese, e bën atë të krahasueshme dhe lexueshme nga partnerët e huaj, rrit besimin në palë interesi dhe profilin në mjedisin e jashtëm. Standardet Ndërkombëtare janë përkthyer, përshtatur dhe publikuar nga vetë KLSH, si pjesë e transparencës dhe përgjegjshmërisë në punën e saj audituese.

9. Auditues me përvojë dhe formim të larmishëm akademik – Stafi auditues i KLSH-së dominohet nga ekonomistë, juristë, inxhinierë të fushave të ndryshme dhe vitet e fundit po plotësohet edhe me sociologë, informaticienë, gazetarë, etj. Spektri i gjerë i formimit të audituesve shton perspektivat në trajtimin e

problematikave audituese, sidomos në auditimet e performancës, apo të auditimeve që përmbajnë elementë të performancës. Ekspierenca në auditim është kritike në gjenerimin e një gjykimi të shëndoshë dhe ruajtjen e spekticizmit profesional, sikurse kërkohet nga standardet audituese.

10. Kryerja e auditimeve të përbashkëta dhe paralele me SAI me përvojë në fushën e auditimeve të performancës dhe të tjera – KLSH ka shtuar së tepërmi bashkëpunimet me SAI-et e tjera rajonale dhe europiane në funksionin auditues. Departamenti i Auditimit të Performancës ka kryer auditime paralele me SNAO-n, ECA-n, ZAP-in, SAI-n maqedonas, malazet dhe boshnjak në auditimet e “Sigurisë Rrugore” dhe “Eficiencës së Energjisë”. I njëjti departament po përgatitet të vijojë bashkëpunimin në një auditim të ri me ECA-n, ndërkohë që edhe në projektin IPA janë parashikuar auditime të tilla, nën mentorimin e SAI-ve polake, kroate, holandeze, etj. Bashkëpunimi në nivel profesional me kolegët e huaj është vital në implementimin e standardeve ndërkombëtare dhe praktikave bashkëkohore audituese.
11. Trajnim dhe edukim i vazhdueshëm me theks praktik i stafit – Stafi i KLSH-së (auditues dhe mbështetës) duhet të përmbushë objektivin institucional prej 25 ditë trajnimi në vit, ku të paktën 5 ditë janë trajnim i pandërprerë për çështje të caktuara. Trajnimit i nënshtrohen të gjitha nivelet e punonjësve në KLSH, pa dallim posti, senioriteti, etj. Trajnimi kryhet në bashkëpunim me ekspertë të huaj dhe vendas, të certifikuar në sferën e auditimit dhe/ose grumbullimit, analizimit dhe raportimit të informacionit.
12. Shkëmbim i përvojave të auditimit dhe praktikave më të mira, nëpërmjet promovimit dhe analizës së vazhdueshme – Departamentet audituese në KLSH, përmes mbledhjeve, workshopeve dhe punës në grupe raportojnë periodikisht për informacionet, subjektet dhe metodologjitë audituese. Shkëmbimi i informacionit përmes diskutimeve apo prezantimeve interaktive ndihmon procesin planifikues, auditues dhe raportues, duke gjeneruar njëkohësisht ide të reja.
13. Mentorim i strukturuar i audituesve të rinj nga kolegë me përvojë – Çdo auditues i lartë, kryeauditues dhe drejtor në KLSH ka nën mentorim një auditues të ri, për një periudhë 4-mujore. Një organizim i tillë pune ndihmon audituesit e rinj të integrohen më shpejt, ulin riskun e gabimeve, nxisin frymën e bashkëpunimit dhe krijimin e një klime profesionale dhe dashamirëse pune.

14. Testime periodike të strukturuar për rifreskimin dhe shtimin e njohurive audituese me synim mbajtjen e postit aktual të punës dhe avancimin në karrierë – Vendi i punës në KLSH është funksion linear i dijeve dhe aplikimit të suksesshëm të njohurive audituese. Përveç raporteve objektive, të balancuara dhe me impakt të gjerë në palë interesi, një mënyrë tjetër e promovimit të vlerave profesionale është testimi periodik i njohurive të nxëna përmes trajnimeve, studimit autodidakt dhe mentorimit nga auditues me përvojë. Testime të tilla kryhen minimalisht dy herë në vit dhe bëhen pjesë e dosjes personale të çdo audituesi, duke i shërbyer angazhimit të mëtejshëm në funksionet audituese dhe të tjera.
15. Shtim i botimeve profesionale dhe shkencore në lëmin e auditimit, si edhe prani e rritur në median e shkruar – KLSH është përgjegjëse jo vetëm për evidentimin e vlerës së shtuar nga aktiviteti publik, por edhe për nxitjen e përgjegjshmërisë në menaxhimin e fondeve publike. Këtë aspekt edukues, institucioni e realizon ndër të tjera edhe përmes botimit të Revistës Shkencore “Auditimi Publik”, botimeve të artikujve në gazeta e revista brenda e jashtë vendit, si edhe organizimit apo pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe workshop-e me kolegë studiues, profesionistë dhe specialistë vendas dhe të huaj.

## Dobësitë

---

1. Vështirësi në implementimin e ISSAI-eve – Pavarësisht përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit ligjor e rregullativ, implementimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit mbetet ende një sfidë institucionale. Vështirësitë qëndrojnë në studimin e kujdesshëm dhe integral të ISSAI-eve nga të gjitha strukturat brenda KLSH-së, interpretimin e tyre brenda kontekstit shqiptar të auditimit të aktivitetit ekonomik publik, si edhe aksesit të kufizuar në informacion që shpeshherë ofrojnë subjektet nën auditim.
2. Vështirësi në dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të subjekteve të audituara – KLSH nuk jep opinion për pasqyrat financiare të subjekteve që auditohen financiarisht. Kjo për shkak të profesionalizmit ende të kufizuar të audituesve financiarë.
3. Delegimi i dy apo më shumë detyrave paralele tek vartësit, duke sjellë

shfokusim nga puna audituese – Angazhimi në një sërë frontesh pune, për të rritur profilin dhe impaktin institucional ka bërë që punonjësit të angazhohen njëkohësisht në disa punë paralele. Ky shfokusim sjell vonesa, cilësi të dobët pune, demotivim, inefektivitet dhe rrit shanset për gabime.

4. Perceptim jo i plotë dhe nga të gjithë i vizionit dhe strategjisë institucionale, nën frymën e kuadrit të ri rregullator – Punonjësit e KLSH-së kanë ende mangësi në kuptimin dhe ndarjen e të njëjtit vizion me eprorët, kolegët dhe veten e tyre përgjatë kohës. Dinamika e aktiviteteve institucionale, qarkullimi ndër-departmental, studimi i dobët i publikimeve profesionale dhe diferencat në formim, janë disa nga shkaqet e devijimeve nga vizioni i përbashkët.
5. Studim i pamjaftueshëm i dokumenteve audituese dhe qasje jo e plotë ndaj problemeve të konstatuara – Vërehet ende një studim sipërfaqësor dhe mekanik i evidencës audituese, mangësi në teknikat e mbledhjes dhe analizimit të informacionit, të cilat çojnë për rrjedhojë në një gjurmim jo të plotë të së vërtetës. Përgjithësisht ka një qasje reaktive ndaj problemeve të konstatuara.
6. Mungesë e aplikimit të auditimit me bazë risku dhe mangësi në metodologjinë audituese – Auditimi është disiplinë e konsoliduar teorike dhe praktike, është një fushë dinamike dhe në ekspansion. Për rrjedhojë, metodologjitë e reja, tashmë lehtësisht të përdorshme edhe për shkak të teknologjisë së informacionit, duhen mësuar e aplikuar me përparësi. KLSH ka mangësi në këtë drejtim, një pjesë të trashëguara dhe një pjesë për shkak se stafi është rezistent ndaj ndryshimit të shpejtë.
7. Siguri e pamjaftueshme e kontrollit të cilësisë – ISSAI 40 adreson ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të cilësisë. Në KLSH sistemi është ngritur, por për shkak të fluksit të madh të informacionit auditues, kapaciteteve të kufizuara njerëzore dhe mjedisit dinamik, kontrolli i cilësisë vazhdon të mbetet kritik në dhënien e sigurisë për raportet e auditimit, kjo veçanërisht në fushat e reja audituese.
8. Mangësi në formulimin logjik të gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve – Një raport auditimi duhet të jetë i balancuar, i argumentuar, objektiv dhe i shkruajtur me gjuhë të thjeshtë dhe nga perspektiva e lexuesit. Në KLSH mungon një njësi e specializuar për redaktimin kuptimor dhe letrar të raporteve të auditimit. Kjo dobësi është edhe rrjedhojë e problemeve në



kontrollin e cilësisë.

9. Kapacitete të pamjaftueshme në përpunimin elektronik të të dhënave – Në KLSH është ngritur dhe përmirësuar vazhdimisht sistemi IT, por aksesimi, përpunimi, analizimi, ndarja, publikimi, protokollimi dhe inventarizimi elektronik i të dhënave lë për të dëshiruar. Faktorë problematikë në këtë drejtim është pjesërisht mosha e stafit dhe pjesërisht avancimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit.
10. Mospërputhja e konstatuar e trajnimeve me nivelin dhe perspektivën e audituesve - Trajnimet jo gjithnjë i përgjigjen kërkesave dhe nevojave të audituesve. Pavarësisht se është ngritur dhe funksionon drejtoria e trajnimeve dhe metodologjisë, numri i kufizuar i punonjësve të angazhuar në këtë drejtori nuk krijon mundësinë e përgatitjes dhe ndjekjes rigoroze të një kalendari vjetor trajnimesh. Po kështu, trajnimet e ofruar nga partnerët e huaj, jo gjithnjë i përshtaten nivelit dhe profilit të audituesve.
11. Bazë të dhënash jo tërësisht e besueshme dhe e përditësuar e trajnimeve të stafit – Kjo mangësi është rrjedhojë e kufizimit në kapacitete të drejtorisë së trajnimeve, aplikimit minimal të teknologjisë së informacionit nga audituesit dhe mosevidentimit në kohë të ditëve, temave dhe lektorëve të trajnimit.
12. Komunikim i izoluar i drejtorive mbështetëse me stafet audituese – Drejtoritë mbështetëse, veçanërisht ato të Burimeve Njerëzore, Metodologjisë, Publikimeve, Kontrollit të Cilësisë, etj., duhet të rrisin komunikimin me stafet audituese të të gjitha niveleve. Përgjithësisht, komunikime të tilla iniciohen vetëm nga Kryetari.

## Mundësitë

---

1. Promovim i faktorëve motivues në vendin e punës – Stafi drejtues i KLSH-së mund të përdorë më mirë dhe më me efektivitet faktorët e jashtëm motivues si: vlerësimi i aftësive, delegimi i përgjegjësisë, avancimin në karrierë, shpërblimin moral dhe material.
2. Rritja e frymës së grupit në vendim-marrje – Në vijim të faktorëve motivues, vendim-marrja konsensuale i shërben ndarjes së të njëjtit vizion, përkushtimit më të madh në punë dhe rritjes së shanseve për sukses.

3. Perceptim unik i zinxhirit të vlerës në administratën publike – Për shkak të mandatit ligjor dhe aksesit në informacion, KLSH ka një mundësi unike në përfitim të një panorame të plotë të aktivitetit ekonomik publik. Kjo panoramë i krijon mundësi KLSH-së të ngrejë një bazë të dhënash në nivel kombëtar, bëjë analiza makroekonomike dhe faktorizohet në dhënien e konsulencës gjatë vendimmarrjes publike.
4. Rritje e impaktit në publik, për shkak të kufizimit të ndikimit nga ndërhyrjet e jashtme – KLSH është një institucion i depolitizuar dhe departizuar. Si e tillë ajo mund të shtojë edhe më influencën e raportimeve të veta, duke u ngritur profesionalisht mbi këtë premisë. Kjo pavarësi ligjore duhet kombinuar me rritjen e aftësive të stafit auditues, për ta transformuar nga një mundësi potenciale në një realitet të prekshëm.
5. Implementimi i Projektit IPA 2013 – Mbështetje për modernizimin institucional, por dhe një sfidë për KLSH-në – Në kuadër të asistencës për Shqipërinë dhe të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit, IPA 2013, komponenti i I-rë, KLSH ka fituar një financim nga Bashkimi Evropian për *“Forcimin e kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm”* me vlerë 2.11 milion euro. Projekti i binjakëzimit do të implementohet nga dy SAI partnere evropiane, NIK-u polak dhe SAI kroat, me të cilët KLSH ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë vitet e fundit. Projekti do të jetë një mbështetje e rëndësishme teknike për zbatimin e ligjit të ri, diversifikimin e mëtejshëm të llojeve të auditimeve të KLSH-së dhe rritjen e kapaciteteve audituese në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Auditimit ISSI dhe praktikat më të mira të fushës.

Pritshmëritë nga implementimi i projektit të binjakëzimit do të shtrihen në komponentët e mëposhtëm:

- a) Rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit rregullativ për veprimtarinë audituese, institucionale.
- b) Zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe kapaciteteve të raportimit dhe konkretisht:
  - b.1) Zhvillimi i manualit të auditimit të mashtimit dhe korrupsionit;
  - b.2) Zhvillimi i manualit të auditimit financiar dhe ligjshmërisë dhe kryerja e auditimeve pilot;

- b.3) Përmirësimi i metodologjisë së auditimit të performancës dhe kryerja e auditimeve pilot;
  - b.4) Zhvillimi i metodologjisë së auditimit IT dhe kryerja e auditimeve pilot.
  - c) Përmirësimi i raportimit të auditimit, kontrollit dhe sigurimit të cilësisë.
  - d) Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe rritja e ndikimit nëpërmjet komunikimit.
6. Inkurajim i institucioneve homologe, organizatave, shoqatave të ndryshme dhe njësive akademike për aktivitete të përbashkëta trajnimi dhe shkëmbimi eksperience – KLSH ka organizuar vazhdimisht konferenca, workshope të hapura dhe tryeza të rrumbullakëta me pjesëmarrje të aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile. Një traditë e tillë duhet konsoliduar më tej dhe kthyer në kulturë institucionale për krijimin e një profili transparent, vlerështues dhe bashkëkohor.
7. Inkurajim i pjesëmarrjes së ekspertëve të fushës dhe OJF-ve në probleme specifike auditimi – KLSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me mjaft OJF dhe ka kontraktuar ekspertë të jashtëm, specialistë në fusha të caktuara. Një bashkëpunim i tillë duhet forcuar edhe më tej në të ardhmen për rritur profesionalizimin në auditim, trajnuar kapacitetet dhe shtuar impaktin e raporteve audituese në palë interesi.
8. Monitorimi i instrumenteve financiarë të njohura në sektorin privat, por ende të pazhvilluara dhe parregulluara në sektorin publik - Sfida kryesore lidhet me buxhetin e shtetit, pasi e konsiderojmë një aspekt të rëndësishëm në ciklin e reformimit të strukturave financiare dhe ligjore që qeverisin zbatimin e tij. Jemi investuar dhe do ta intensifikojmë rolin tonë në reformën buxhetore, rregullimin financiar dhe fiskal dhe çdo fushë tjetër të lidhur me shpenzimet publike sidomos në referencë të strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike për periudhën 2014-2020. Prioriteti i këtyre reformave është “fokusi në rezultate” duke thjeshtuar rregullat e financimit, duke rritur kushtëzimin dhe maturimin e buxhetit të BE-së. Ato sjellin një numër të konsiderueshëm të çështjeve për përgjegjshmërinë dhe auditimin publik.

1. Perceptim i dobët nga publiku dhe palët e interesit – Pavarësisht investimit në komunikim që KLSH ka bërë gjatë viteve të fundit, ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim. Mosperceptimi apo perceptimi i dobët i punës së KLSH-së kërcënon arritjen e një sërë objektivash të planit strategjik.
2. Konsolidimi i mëtejshëm i kulturës së mosndëshkueshmërisë midis zyrtarëve të nivelit të lartë – Mbetet ende problem zbatimi dhe ndjekja e rekomandimeve që KLSH iu ngarkon institucioneve qeveritare. Edhe pse organizmat ndërkombëtare e kanë ngritur shpeshherë këtë problem, kërcënimi vazhdon ende të sabotojë punën audituese të KLSH-së.
3. Risk në rritje për shkak të numrit të lartë të auditimeve dhe zgjerimit të spektrit të tyre bazuar në Ligjin e Ri Institucional – Zgjerimi dhe thellimi i funksioneve audituese, tashmë të mandatuara edhe në Ligj, duhet menaxhuar me kujdes, për të minimizuar riskun e gabimeve.
4. Pamjaftueshmëri kapacitetesh njerëzore dhe logjistike për të mbuluar me auditim shumicën e institucioneve publike – Është e pamundur që KLSH të mbulojë me auditime të të gjitha llojeve, aktivitetin ekonomik publik në Shqipëri. Për këtë arsye, përzgjedhja e subjekteve dhe temave audituese duhet bërë në përputhje me burimet e kufizuara në dispozicion.

## II. VEPRIMTARIA AUDITUESE

Veprimtaria audituese është analizuar përmes treguesve të performancës, sipas praktikave më të mira të përcaktuara nga INTOSAI, që jep një pamje të aktivitetit dhe rezultateve të një SAI. Matjet e performancës në formën e treguesve, i bëjnë rezultatet të përshtatshme dhe të krahasueshme me performancën e aktivitetit të SAI-t në mënyrë dinamike si dhe me SAI-et simotra, duke krijuar kështu një sistem të unifikuar vlerash e standardesh, sikurse e shpreh edhe motoja e INTOSAIT: “Nga eksperiencia e përbashkët, përfitojnë të gjithë”.

Ky dimension vlerësimi lidhet ngushtësisht me raportimin e auditimeve sipas llojit të tyre, auditim përputhshmërie, financiar, performance. Përgjithësisht indikatorët e këtij dimension kryesisht lidhen me numrin e auditimeve, pra veprimtarinë

audituese dhe me reflektimin/reagimin e subjekteve ndaj rekomandimeve të KLSH, duke sjellë një qasje tjetër të perceptimit të punës audituese si vlerë e shtuar për subjektet.

Ne kemi përdorur treguesit e mëposhtëm të rezultateve për të matur dhe raportuar performance tonë.

1. Mbulimi me auditim aspekt që lidhet me shtrirjen e auditimeve, në numër dhe sipas llojeve. Një aspekt tjetër është edhe shtrirja e auditimeve sipas departamenteve pra sa auditime kemi realizuar në institucionet e qeverisjes së përgjithshme dhe sa në njësitë e pushtetit vendor, sa në administratën tatimore dhe doganore dhe sa në shoqëritë me kapital shtetëror. Këtu kemi vlerësuar edhe aspektin e raportimeve dhe komunikimit të rezultateve të auditimit.
2. Tregues që vlerësojnë dobishmërinë e auditimeve të realizuara. Ndikimi dhe efekti i rekomandimeve të lëna bazuar në përqindjen e rekomandimeve të realizuara.

#### A. ANALIZA MBI AUDITIMET E REALIZUARA

---

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën Janar - Dhjetor 2015, ka evaduar 158 auditime nga 155 auditime të planifikuara, nga të cilat:


- 120 auditime përputhshmërie, ligjshmërie dhe rregullshmërie financiare
- 12 auditime financiare;
- 12 auditime tematike;
- 12 auditime performance;
- 2 auditime IT.

*Tabela 1: Auditime sipas llojit*

Nr.	Përshkrimi	2015		2014	2013
		Plan	Fakt	Fakt	Fakt
1	Auditime përputhshmërie	120	120	131	118

	(ligjshmërie dhe rregullshmërie)				
2	Auditime financiare	12	12	12	21
3	Auditime performance	10	12	8	6
4	Auditim tematik	10	12	9	8
5	Auditime IT	3	2	-	-
	<b>Totali</b>	<b>155</b>	<b>158</b>	<b>160</b>	<b>153</b>

Për vitin 2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer 174 auditime në total, nga të cilat 158 janë përfunduar edhe evaduar, 5 auditime janë përfunduar por pa evaduar edhe 11 auditime janë në proces, ose në total 52% më shumë se viti 2014.



Auditimet e performancës në vitet 2012-2015 kanë njohur zhvillim cilësor dhe sasior, duke u rritur mbi 2,5 herë në krahasim me periudhën 2008-2011 referuar numrit të auditimeve dhe afro 4 herë referuar numrit të institucioneve të mbuluara

me këtë lloj auditimi. Zhvillimi i auditimeve është në linjë dhe në përputhje të plotë me objektivat e paravendosura në planin strategjik 2013-2017 dhe me planin vjetor të vitit 2015.


Për herë të parë KLSH, në vitin 2015, dha opinion për pasqyrat financiare të përgatitura nga institucionet publike, pavarësisht faktit se ky auditim u realizua në disa njësi varësie (pra jo në Institucione qendrore), iniciativa është pozitive. Kjo zgjedhje kishte për qëllim të minimizonte riskun operacional në realizimin e këtij lloj auditimi.

Në lidhje me auditimet e përputhshmërisë të ushtruara gjatë viti 2015, vlerësohet se arritën të plotësonin kriteret metodologjike të këtij auditimi duke garantuar siguri sipas standardeve më të mira të INTOSAI-it. Përvoja e krijuar e kombinuar me një bazë të re metodologjike i ofrojnë audituesve një guidë të qartë për veprimtarinë audituese. Ky konsolidim metodologjik dhe praktik i arritur është reflektuar edhe në realizimin e numrit të auditimeve të planifikuara për tu realizuar, bazuar në planin vjetor të auditimeve.

Nisur nga auditimet sipas niveleve të administrimit shtetëror, administratës fiskale dhe shoqërive me kapital shtetëror, për vitin 2015, situata paraqitet si në tabelën e mëposhtme

*Tabela 2: Veprimtaria audituese e KLSH-së sipas institucioneve*

Nr	Përshkrimi	2015	2014
1	<i>Ministri dhe institucionet qendrore</i>	33	41
2	<i>Institucionet e qeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor</i>	61	63
3	<i>Drejtori dhe degët e tatim-taksave e të doganave</i>	17	23
4	<i>Institucione financiare dhe shoqëri me kapital të përbashkët shtetëror</i>	20	18
	<i>Njësi dhe projekte me financime të huaja</i>	10	9
5	<i>Subjekte të mbrojtjes së mjedisit</i>	5	6



Auditimet sipas kategorizimit të mësipërm në volum (shprehur në përqindje) zënë:

- në ministri dhe institucione qendrore 21% të totalit të auditimeve;
- auditimet në institucionet e administratës së qeverisjes vendore e në njësi të tjera në nivel vendor 39% të totalit të auditimeve;
- auditimet në drejtoritë e degët e tatimeve e doganave 11%;
- në institucionet financiare dhe në shoqëritë me kapital të përbashkët shtetëror 13%;
- në njësitë dhe projektet me financime të huaja 6%;
- në subjektet të mbrojtjes së mjedisit 3%;
- auditimet e performancës në institucionet qendrore dhe vendore zënë 8% të totalit të auditimeve.

Viti 2015 ishte fillimi i punës për krijimin e një kornize rregullatore institucionale në përputhje të plotë me një model europian dhe të konsoliduar të një Institucioni Suprem Auditimi. Metodologjia audituese e KLSH-së reflektoi kërkesat e standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe çdo praktikë apo përvojë që përsos qasjen tonë në auditim me plotësimin e misionit tonë si “Watch Dogs” të financave publike dhe se si mund të rrisim llogaridhënien dhe forcojmë përgjegjshmërinë



institucionale në sektorin publik.

Aplikimi i instrumentit:

Treguesit e performancës të lidhur me Dimensionin A (Raportimi i auditimeve) lidhen me aspekte të mbulimit me auditim të sektorëve apo fushave të vlerësuara me risk në planifikimin vjetor të auditimeve; reflektimin e planit strategjik të KLSH për mbulimin me auditim të subjekteve, në plotësim të misionit të saj Kushtetues. Indikatorët apo treguesit e lidhur me Dimensionin A, matin apo vlerësojnë mandatin e KLSH në terma të mbulimit me auditim, evadimin dhe publikimin e rezultateve të auditimit dhe nivelin e implementimit të rekomandimeve bazuar në një proces të kujdesshëm dhe të mirë rregulluar të ndjekjes së zbatimit të tyre. Në përfundim duke i parë të gjithë treguesit e vlerësuar sipas departamenteve në kontekstin Institucional, për auditimet e përputhshmërisë dhe ligjshmërisë financiare niveli i indikatorit vlerësohet i moderuar.

## B. MBI IMPAKTIN E KLSH NË FUSHËN E MANAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE DHE EKONOMISË

---

Një nga aspektet ku fokusohet puna audituese është ajo e dhënies së rekomandimeve të cilat do të përmirësonin sistemet dhe operacionet në manaxhimin e financave publike. KLSH në auditimet e realizuara gjatë vitit 2015, ka kërkuar përmes rekomandimeve ndërhyrje që synojnë përmirësimin e kuadrit rregullator dhe reflektojnë praktikatat më të mira në menaxhimin e financave publike, duke adresuar 35 rekomandime për përmirësime ligjore kryesisht të lidhur me zbatimin e buxhetit por dhe ndërhyrje të rëndësishme sidomos në sektorë nevralgjik për vendin. Karakteristikë e vitit 2015 është ndërhyrja në shumë ligje dhe akte nënligjore, në plotësim të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, duke bërë që niveli i rekomandimeve për përmirësime ligjore të ishte në nivel më të ulët se vitet e mëparshme.

Disa nga aspektet më të rëndësishme ku KLSH, gjykon se ka ndikuar në përmirësimin e sektorëve më delikatë dhe me impakt në financat publike janë:

B/1 NË FUSHËN E FINANCAVE PUBLIKE

1. Ndërhyrjes për të siguruar qëndrueshmëri fiskale, aq e rëndësishme për financat publike kemi kërkuar që nga Ministria e Financave procesi i përgatitjes së projektbuxhetit të mos udhëhiqet nga zbatimi formal i kërkesave të lidhura me etapat e përgatitjes së tij, por të bazohet në një analizë të të detajuar në drejtim të përmbushjes jo vetëm të treguesve të projekt buxheteve afatmesme por që të jenë në të njëjtën linjë me strategjitë e financave publike, duke e bërë jo vetëm drejtimin të dukshëm por edhe arritjet të matshme. Projekt buxheti duhet të jetë sa më realist duke eliminuar ndryshimet që i ndodhin atij gjatë vitit me anë të akteve normative.

Kemi kërkuar hartimin e një kuadri rregullator fiskal, i cili të synojë reduktimin e nivelit të borxhit publik në nivele të përcaktuara, në mënyrë që brenda një periudhë disa vjeçare të sigurohet që indikator i borxhit publik ndaj PBB të arrijë në nivelin 60%. Kjo do të kërkonte paraqitjen e një iniciative ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të niveleve të pranueshëm të borxhit publik ndaj PBB-së, shoqëruar me një nivel variance të pranueshme në referencë të kushteve makroekonomike të vendit.

Referuar faktit që këta tregues janë sinjale alarmi dhe shërbejnë si indikatorë për të sinjalizuar kapacitetin e qeverisë qendrore për të ndërhyrë në raste krize duke synuar evitimin e humbjes së besueshmërisë së vendit ndër kreditorët e huaj dhe duke mundësuar monitorimin dhe identifikimin e nivelit të borxhit të jashtëm të qeverisë, i cili në rastet kur është shumë i lartë, mund të ndikojë në transferimin e të ardhurave fiskale nga shpenzimet me ndikim në ecurinë ekonomike drejt amortizimit të borxhit të jashtëm, i rekomandohet një analizë e plotë e thelluar në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë për të patur skenarë shpëtimi nëse vlerësohet një situatë e përkeqësuar apo në përkeqësim.

Menaxhimi efektiv i financave publike është në fokus të veprimtarisë audituese të KLSH-së. Rekomandimet e adresuara në vitet e fundit Kuvendit dhe Ministrisë së Financave kanë patur për objekt respektimin dhe zbatimin e targeteve të dokumentit të Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020. Qasja këshillimore e institucionit të KLSH-së është orientuar drejt përmbushjes së objektivave të kësaj Strategjie me fokus hartimin dhe zbatimin e një

buxhetit të mirëbalancuar dhe të qëndrueshëm shoqëruar me, reduktimin e raportit të Borxhit Publik ndaj PBB-së, duke menaxhuar në mënyrë efektive financat publike dhe zhvillimin e forcimit të sistemit të kontrollit të brendshëm publik dhe auditimit të brendshëm

Kemi kërkuar që në Raportin e Buxhetit të vitit 2013, krijimin e një institucioni të pavarur Këshillin Fiskal, që do të siguronte këshillimin dhe orientimin e qeverisë ndaj pilitikave makro që do të garantonin qëndrueshmërinë fiskale, dhe inkurajojmë përshtetimin e konstituimit të një institucioni të tillë.

2. Nisur nga nivelet shqetësuese të borxhit publik është kërkuar ndërhyrje e kujdesshme lidhur me manaxhimin e borxhit publik në koordinim të plotë me Politikën Makroekonomike. Është viti i katërt në të cilin po kërkojmë me këmbëngulje ndërhyrje për të mbajtur nën kontroll nivelet e borxhit publik dhe sidomos një strategji efektive në adresimin e risqeve potencial që ka ky aspekt i financave publike. Orientimin kryesisht në drejtim të titujve qeveritarë me afat të gjatë maturimi të cilët përmirësojnë strukturën e borxhit të brendshëm dhe mund të reduktojnë riskun e rifinancimit, pasi ky risk është i lidhur me nivelin e lartë të instrumenteve të cilat maturohen brenda një viti, por kërkojmë një planifikim të kujdesshëm të nevojave për huamarrje të brendshme, bazuar në analiza të plota dhe vlerësim të kujdesshëm të niveleve të likuiditetit në dispozicion (konstatohen nivele të larta të depozitës qeveritare). Ndërkohë që ripërsërisim kërkesën që Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave të unifikojnë dhe plotësojnë kërkesat për raportim të borxhit mbi të njëjtat kritere, në mënyrë që analizat të jenë të krahasueshme.

Ministria e Financave, në kuadër të mbajtjes nën kontroll të risqeve të portofolit, menaxhimit të riskut të kursit të këmbimit, prioritet duhet të jetë mbajtja nën kontroll e borxhit të jashtëm. duke vendosur tavan vjetor për totalin e borxhit të jashtëm në përbërje të borxhit publik në përputhje dhe strategjinë afatmesme të menaxhimit të borxhit publik.

Konstatohet që sektori i energjisë është mbështetur me politika dhe angazhime qeveritare për daljen nga kriza e likuiditetit, në të cilën operatorët e energjisë ndodhen prej disa vitesh (*financime të brendshme e të jashtme, si dhe VKM nr. 198, datë 03.04.2014 "Për faljen e detyrimeve..."*) nga KESH sh.a. nuk është mundur të shlyehet asnjë detyrim për fondet e nënhuazuara me burim financimin e huaj. Në vlerësimin tonë mbulimi i nevojave financiare të KESH sh.a., për blerje energjie nuk

duhet të vazhdojë të jetë huamarrja, ashtu siç është vepruar deri tani, por të synohet rregullimi i marrëdhënieve financiare brenda sektorit të energjisë dhe shlyerja e detyrimeve ndërmjet tyre. Ministria e Financave mund të iniciojë dhe ndihmojë në një proces negociimi me kreditorët për rishikimin e termave dhe kushteve të portofolit të overdrafteve.

3. Lidhur me Përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara financiare të shtetit, kemi konstatuar mungesë të një baze të unifikuar të mbajtjes së kontabilitetit, adresime të ndryshme të përgjegjësive për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara të Qeverisë. Konstatohet mungesa disa vjeçare e pasqyrave të konsoliduara të shtetit, problematikë që në gjykimin tonë ndikon jo vetëm në nivelin e transparencën, por është e lidhur ngushtësisht me ndjekjen e kujdesshme të financave publike dhe analizën e treguesve makroekonomik. Kontabiliteti nga institucionet e qeverisjes së përgjithshme në Shqipëri realizohet aktualisht mbi bazë cash për të ardhurat dhe mbi bazë të të drejtave të konstatuara për shpenzimet. Raportimi Financiar është i orientuar drejt mënyrës së buxhetimit dhe kontrollit të zbatimit të buxhetit të shtetit (...)", kjo duke u nisur dhe nga përcaktimet ligjore të mësipërme. Në "Strategjinë për Menaxhimin e Financave publike 2014-2020" theksohet se: *"Një parakusht për raportim të mirë është kontabilizimi i saktë. Gjatë periudhës të planifikuar 7-vjeçare, standardet e kontabilitetit do të rishikohen gradualisht me ambicien e përputhshmërisë së plotë eventuale me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit IPSAS, pasi këto të jenë miratuar përfundimisht çka mund të ndodhë vetëm në periudhën e ardhshme të planifikimit"* – ndërkohë që në vijim të po kësaj strategjie flitet për EPSAS jo për IPSAS. IPSAS nuk janë të detyrueshme, por eksperiencia ka treguar se cilësia e raportimit dhe impakti pozitiv që ka raportimi financiar ka në procesin e vendimmarrjes, është më e lartë në ato vende që përdorin IPSAS. Kohët e fundit Komisioni Evropian vendosi të përgatisë Standardet Evropiane të Kontabilitetit Publik, EPSAS - SEKP) bazuar në IPSAS - SNKSP. Kuadri konceptual i SEKP - EPSAS parashikohet të vihet në funksionim në vitin 2019 dhe shumica e standardeve deri nga fundi i vitit 2020. Nisur nga ky kontekst kemi rekomanduar implementimin e standardeve të harmonizuara të kontabilitetit rritës (duke konsideruar që Kontabiliteti publik në Shqipëri aktualisht kryhet mbi bazën e cash për të ardhurat dhe mbi bazën e cash-it të modifikuar për shpenzimet). Nisur nga fakti që, standardet IPSAS janë përkthyer në shqip që në vitin 2006, por vijojnë të mos përfshihen në legjislacionin tonë dhe nga ana tjetër në gjithë këtë periudhë nuk

është punuar as për njohjen dhe përvetësimin e tyre nga punonjësit e administratës publike, kemi konsideruar të domosdoshme që të publikohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, menjëherë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik IPSAS, si baza kryesore metodologjike mbi të cilën do të hartohen pasqyrat financiare të shtetit. Ministria e Financave duhet të përgatisë dhe të hedhë për diskutim në nivele teknike draft-ligjin “Për Kontabilitetin Publik”, duke plotësuar kuadrin rregullator të nevojshëm për të arritur në një cilësi të caktuar të raportimit financiar në sektorin publik.

4. Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi, komunikimi dhe monitorimi janë vlerësuar nga KLSH në opinion të përgjithshëm, duke theksuar që administrata jonë publike, me gjithë përpjekjet, është ende larg standardeve dhe praktikave më të mira të fushës në drejtim të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

5. Ne kushtet e përgjegjësive financiare të ulët të zyrtarëve publikë, kemi rekomanduar Kuvendit në vijimësi për dy vitet e fundit radhazi hartimin e ligjit “Për përgjegjësinë materiale”, në të cilin të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.

Ajo çfarë ndodh në realitet në këto raste është që drejtuesit e niveleve të larta ushtrojnë pushtetin e tyre real në menaxhimin apo më saktë keqmenaxhimin e fondeve shtetërore, duke ndikuar apo influencuar në përcaktimin e planit të prokurimeve, rritjen artificiale të fondit limit, caktimit të punonjësve që do të jenë pjesë e njësive të prokurimit apo komisioneve të vlerësimit të ofertave (punonjës të cilëve u mungojnë njohuritë apo eksperiencia e duhur administrative dhe profesionale, punonjës të cilët kanë lidhje apo njohje të ngushta miqësore me drejtuesit e institucionit, militant partiak, punonjës të konstatuar me shkelje dhe që ndaj tyre ende nuk është marrë një masë disiplinore, punonjës që presin të promovohen në pozicione më të larta apo kyçe të administratës, punonjës të cilët nuk përballojnë presionin e eprorëve, si dhe punonjës të rinj ende të papërgjegjshëm për rëndësinë e vendimmarrjes së tyre në një procedurë tenderimi).

Kjo është arsyeja që për shumë raste skandaloze të shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimit, është e pamundur që përgjegjësia administrative, civile

dhe penale të shkojë deri në nivelet më të larta të administratës së institucioneve shtetërore, për shkak se drejtuesit e nivelit të lartë nuk janë asnjëherë pjesë e vendimmarrjes në këto raste por influencojnë indirekt atë. Pra janë vendimmarrësit e padukshëm të procedurave të prokurimit.

Referuar praktikës së deritanishme të auditimeve të KLSH si dhe gamës së gjerë të llojeve të përgjegjësive materiale që është konstatuar në sektorin publik, evidentohet një pamjaftueshmëri ligjore në rregullimin e plotë të elementëve, rasteve dhe procedurës që duhet ndjekur në evidentimin dhe rikuperimin e plotë apo të pjesshëm të dëmeve ekonomiko-financiare të shkaktuara nga vendimmarrja e gabuar apo e kundraligjshme e nëpunësve apo funksionarëve të lartë shtetërorë.

KLSH ka rekomanduar përgatitjen e një ligji për përgjegjësinë materiale të zyrtarëve të lartë publik që në vitin 2013 në Raportin për Zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Shtetit dhe e ka përsëritur këtë rekomandim edhe në Raportin për Zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Shtetit për vitin 2014, drejtuar Kuvendit, në tetor 2015.

6. Kemi rikërkuar përmirësime dhe ndërhyrje ligjore në Ligjin e Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë ta konceptojë rolin e saj jo në izolim dhe të segmentuar nga krejt aktiviteti ekonomiko-financiar makroekonomik në vend, por të monitorojë, analizojë dhe këshillojë aktivisht Qeverinë për çështje jetike që lidhen me inflacionin, siç mund të jenë: niveli i tatim-taksave, niveli i borxhit publik, niveli i investimeve publike, etj., pa cënuar në asnjë rast pavarësinë e saj institucionale. Kemi sugjeruar që të përkrahet eksperiencia e bankave qendrore të vendeve të zhvilluara, që përfaqësimi i administrimit në Këshillin Mbikëqyrës të bëhet vetëm nga Guvernatori, pasi gjykojmë se një përfaqësim i tillë do ti jepte hapësirën e nevojshme Këshillit Mbikëqyrës për të kryer saktësisht funksionet mbikëqyrëse që atij i atribuohen me ligj dhe shmang pozitën "dominuese" të administrimit në Këshillin Mbikëqyrës (3 anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës janë ligjërisht në nivelin më të lartë të administrimit). Ndarja e plotë e funksioneve të administrimit nga politikëbërja dhe mbikëqyrja sjellin efekte pozitive në nivelin e transparencës dhe llogaridhënies në mënyrën e administrimit të fondeve në dispozicion.

Me synim rritjen e besueshmërisë dhe përgjegjshmërisë në qeverisjen e Bankës, kemi kërkuar të bëhen përmirësime ligjore për të garantuar efektshmërinë e strukturës së auditit të brendshëm në dhënien e sigurive të arsyeshme mbi funksionet dhe sistemet e kontrollit brenda saj, duke transformuar funksionin e

Inspektorit të Përgjithshëm në një Komitet Auditimi të përbërë nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi. Kemi gjykuar se në kontekstin shqiptar, çdo strukturë e cila nuk i nënshtrohet votimit në parlament nuk do të sigurojë pavarësinë e synuar të këtij funksioni.

Në ligj duhet të shprehet domosdoshmëria e bashkëveprimit institucional të këtyre subjekteve të kontrollit (Auditimi i Brendshëm, i Jashtëm dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit) në funksion të ofrimit të një sigurie maksimale në kushtet e shfaqjes së risqeve të ndryshme të lidhura sidomos me veprimtarinë investuese dhe operacionale të Bankës si dhe për të rritur besueshmërinë në rezultatet financiare të Bankës Qendrore.

Nisur nga fakti se Këshilli i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë është një bord specifik me detyra të rëndësishme dhe komplekse të lidhura me drejtimin dhe monitorimin e një tregu të rëndësishëm si ai monetar, me reflektime të qarta dhe të mprehta në gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë, kemi kërkuar të vendoset kufizimi i plotë i pjesëmarrjes së tyre në këshilla dhe borde të tjerë përveç atyre të fushës akademike dhe shkencore por mund të synohet edhe që të jetë një bord me kohë të plotë me pjesëmarrje aktive në fushën akademike dhe shkencore. Gjithashtu kemi kërkuar plotësimi në ligj për llojin, masën dhe numrin total të shpërblimeve që mund të përfitohen nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, për të eliminuar rastet e keqinterpretimit të të drejtës që ligji përcakton në nenin 45.

Kemi nënvizuar, nevojën për përgjegjshmëri më të lartë në shpenzimin e fondeve dhe rritjen e efikasitetit në aktivitetin ekonomik të saj. Çdo ndryshim i ligjit organik të Bankës së Shqipërisë duhet të realizohet në bashkëpunim dhe konsultim të ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me Bankën Botërore dhe me Bankën Qendrore Evropiane.

### B/2 NË SEKTORIN ENERJITIK

Sektori energjetik si një prej sektorëve strategjikë në vend ka qenë në fokus të veprimtarisë dhe angazhimit të burimeve të auditimit nga KLSH për gjatë tre viteve të fundit duke synuar rritjen e përgjegjshmërisë së institucioneve shtetërore në mirëmanaxhimin e sektorëve që janë jetikë për ekonominë e një vendi.

1. Në Ministrinë e Energjetikës dhe Industrisë (MEI);
2. Në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN);
3. Në Korporatën Energjetike Shqiptare (KESH) sh.a.;
4. Në Operatorin e Sistemit Shpërndarjes Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.;
5. Në AlbPetrol sh.a.

Duke qenë se ky ka qenë sektori në të cilin KLSH ka arritur të konstatojë dëmet më të mëdha për shkak të mjaft shkeljeve dhe problematikave në administrim dhe vendimmarrje mbi të cilat ka dhënë edhe një sërë rekomandimesh të vlefshme për ndërhyrje. Më poshtë po japim rekomandimet kryesore:

#### SEKTORI HIDROKARBUR (AUDITIMI NË AKBN DHE MEI), ALBPETROL sh.a.

1. Nga auditimi i MH dhe LMH për vendburimin Patos–Marinëz, (MH e cila zë rreth 97% të prodhimit të naftës në vendin tonë, me tregues potencial të prodhimit të naftës dhe për rrjedhojë me ndikim në ekonominë dhe financat e shtetit), rezultoi se për periudhën nga fillimi i operacioneve të vlerësimit deri më tani, janë kryer një sërë ndryshimesh në Planet e Zhvillimit, për vitet 2005, 2009, 2011. Në rast se nuk do të kishim ndryshim të Planeve të Zhvillimit, Planeve të Punës dhe Buxhetit të kryer, Shteti Shqiptar do të kishte përfituar deri në fund të vitit 2014, përveç rentës minerare prej 199,4 milion USD edhe një shumë prej afro 305 milion USD, si pjesë e fitimit nga prodhimi i naftës (për shkak të Faktorit  $R < 1$ ) Nga auditimi me zgjedhje i vërtetimeve të përjashtimit nga TVSH dhe i kontratave përkatëse të vëna në dispozicion nga ana e AKBN-së, ka rezultuar se në këto vërtetime nuk është e argumentuar arsyeja përse shërbimet e ofruara nga nënkontraktori përbëjnë operacion hidrokarbur apo përmbajtja nuk të çon drejt një operacioni hidrokarbur për të cilat i kërkohet AKBN-së vërtetimi. KLSH ka evidentuar se AKBN ka lëshuar vërtetime përjashtimi në vlerën 316 milion lekë (vetëm në një kontratë dhe për një periudhë mjaft të kufizuar auditimi).

2. Përgjatë auditimit të Marrëveshjeve dhe Licencë Marrëveshje Hidrokarbure, KLSH është fokusuar mbi respektimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, për përjashtimet e Akcizës dhe t.v.sh.-në të operacioneve hidrokarbure të përdorimit të gazoililit (holluesit) në procesin teknologjik. Konstatuam se nisur nga sasitë e deklaruara të përdorura dhe asaj që duhej të përdorej në referencë të niveleve



teknike, rezulton se është përdorur rreth 100 000 m<sup>3</sup> hollues gazoil 1000 PPM më tepër nga nevojat reale teknologjike. Kjo sasi e shumëzuar me vlerën mesatare minimale të blerë nga furnitori që rezulton më çmim rreth 1000 USD/m<sup>3</sup>, jep vlerën prej 100 milion USD efekt i drejtpërdrejtë negativ në vlerësimin e faktorit R <1. Kjo sasi e pretenduar e përdorur (për arsye se i mungon monitorimi i strukturave të shtetit shqiptar për destinacionin final të përdorimit të saj që është deri në injektimin në pusin përkatës), lë shkak për të ngritur hipotezën e një evazioni fiskal dhe një kontrabande e bërë në tregun shqiptar dhe në të njëjtën kohë Albpetrol sh.a është kthyer në burim shitje naftë (duke shitur sasinë e PEP-it), duke mos u monitoruar në vite nga strukturat e shtetit, destinacioni final i kësaj naftë të shitur. Vlerës prej 100 milion USD, nuk i kemi shtuar diferencën e çmimit të holluesit të blerë dhe i shitjes së holluesit, pas kalimit të procesit teknologjik, pra pjesa e naftës së padeklaruar që duhet të ishte nxjerrë nga shtesa e holluesit kanë sjellë të ardhura të padeklaruar (evazion fiskal) në vlerën 81,682,623 USD.

3. Kjo situatë u verifikua edhe nga auditimi i dy kontratave Stream Oil & Gas dhe Transoilgroup Ltd që operojnë në fushën e nxjerrjes së naftës pasi është përdorur Hollues (Diezel 1000 ppm) në operacionet hidrokarbure por nuk konstatohet reflektim të kësaj sasive holluesi në sasinë e naftës së nxjerrë. Mungesa në të ardhurat rezulton për Stream Oil & Gas në 2.32 milion USD dhe 2.48 milion USD për Transoilgroup Ltd. Evazioni fiskal në këto raste shoqërohet me efekte të ndjeshme në Faktorin R, duke shumëfishuar dëmin ekonomik që i vjen shtetit shqiptar nga mungesa e kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së proceseve hidrokarbure.

4. Kemi konstatuar se strukturat shtetërore MEI, AKBN dhe AlbPetrol sh.a., kanë qënë pothuaj inekzistente, në drejtim të monitorimit të të gjithave operacioneve teknike, konform planeve të miratuara dhe të rezultateve financiare të lidhura me aktivitetin hidrokarbur. Ato janë mjaftuar vetëm me vëzhgimin vizual, sporadik pa u orientuar në kontrollin ligjor, financiar dhe tekniko-shkencor të implementimit të kësaj marrëveshje. Është e kuptueshme që Faktori R nuk mund të dalë asnjëherë i barabartë me 1 dhe për më tepër më i madh se 1, në rast se këto institucione nuk ushtrojnë funksionet që ju jep ligji, sidomos të lidhura me monitorimin dhe auditimin ligjor dhe financiar si garanci e vërtetësisë së shpenzimeve të kryera (aq më tepër që ky vendburim i Patos Marinzës, konsiderohet në fazën shteruese, fazë Depliti).

5. Nga auditimi "AlbPetrol" Patos sh.a., kemi konstatuar dëme të shkaktuara në

operacionet hidrokarbure. Kështu në lidhje me zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure për zonën Ballsh-Hekal, Gorisht-Kocul, Cakran-Mollaj dhe Vendburimi Delvinë, AKBN dhe AlbPetrol kanë miratuar kalimin e interesave të marrëveshjes nga Kompania Stream Oil & Gas Ltd tek Kompania TransAtlantic Albania Ltd, në kundërshtim me marrëveshjet hidrokarbure. Kompania TransAtlantic ka marrë përsipër shlyerjen e një pjese të detyrimit me vlerë 7,424 mijë USD, ose 942,940 mijë lekë, por jo detyrimet e plota, e për pasojë AlbPetrol ka pësuar humbje në vlerën 10,5 milion USD, ose 1,336,167 mijë lekë.

Nga ky auditim kanë rezultuar shpenzime të pa justifikuara me vlerë 121,326 mijë USD, për periudhën tetor-dhjetor 2012 dhe me vlerë 231,187 mijë USD për periudhën janar-shtator 2013. Nga ndarja e prodhimit për këtë zonë janë krijuar detyrime ndaj AlbPetrol në sasinë 39,220.31 ton naftë bruto në vlerë 15,679 mijë USD. Detyrimi i prodhimit para ekzistues (PPE) dhe pjesa e AlbPetrol për naftën bruto (PPA), i pa dorëzuar shoqërisë AlbPetrol deri me datë 31.03.2015, nga kontraktorët arrin në vlerën 220,818 mijë lekë.

Mbi shkeljet ligjore në zbatimin e marrëveshjeve tjera hidrokarbure të lidhura me kompanitë e huaja që operojnë në sektorin e kërkimit dhe nxjerrjes së naftës ka rezultuar se gjatë zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure për zonat Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul, Ballsh-Hekal dhe vendburimi i Delvinës, të zonës Patos-Marinës, Visokës, Kuçovës, duke filluar nga viti 2011, kontraktorët kanë krijuar detyrime në likuidimin e sasisë së naftës pjesë e AlbPetrol, nga ndarja e prodhimit sipas marrëveshjes. Detyrimet janë krijuar në periudha kur çmimi i naftës bruto ka qenë disa herë më i lartë se çmimi aktual. Detyrimet kanë ardhur duke u akumuluar dhe shlyerja e tyre në këtë periudhë, shoqërohet me humbje për arsye të rënies shumë të madhe të çmimit të karburanteve në Bursë. Për zonën Cakran-Mollaj, referuar programimit, prodhimi është zvogëluar në masën 25% nga parashikimi, për zonën Ballsh-Hekal është zvogëluar në masën 50% dhe për zonën Gorisht-Kocul është rritur në masën 50%. Ky rezultat vjen nga zvogëlimi i investimeve në operacionet hidrokarbure, megjithëse ato nuk raportohen me vlerë të vogël, sepse koeficienti R, është në nivelin më të vogël se 1. Ndërkohë që kontraktori nuk zbaton investimet e planifikuara, shpenzime fiktive përfshihen në kostot hidrokarbure, për më tej nuk likuidon as pjesën e AlbPetrol që vjen nga ndarja e prodhimit.

Konstatohet se sasi të naftës bruto që përfiton AlbPetrol, kanë ardhur në rënie për arsye se pusët e vjetra, të cilët vihen në dispozicion të kontraktorit për shfrytëzim

kanë ardhur në zvogëlim, ndërsa pusët e reja të cilat hapen nga Kontraktori kanë ardhur në rritje. Në stadin aktual, AlbPetrol përfiton vetëm rreth 5.8% të prodhimit, i cili pas disa vitesh (me daljen nga funksioni të puseve të vjetra) do të shkojë më pak se 2%.

Megjithëse në marrëveshje përcaktohet se gjatë operacioneve hidrokarbure, kontraktorët duhet të përdorin metoda dhe teknologji të pranuar ndërkombëtarisht, nga ana e AlbPetrol nuk janë marrë masa për plotësimin e këtyre kushteve të kontratave.

Nga auditimi ka rezultuar se AlbPetrol nuk ka informacion dhe të dhëna të mjaftueshme për statusin e asetëve të cilat kontraktorët i kanë të regjistruara në koston e operacioneve hidrokarbure. KLSH i ka rekomanduar AlbPetrol të kërkojë informacion të detajuar nga të gjithë kontraktorët për asetet e përfshira si vlerë në kostot hidrokarbure të cilat mund të jenë përdorur si kolateral për kreditim, me synim parandalimin e humbjeve në rastin e tërheqjes së mundshme të Kontraktorëve nga marrëveshja hidrokarbure. Nga auditimi i kryer në AlbPetrol janë konstatuar shkelje të ligjshmërisë me pasojë dëm ekonomik në vlerën 32,632,933 mijë lekë.

Nisur nga fakti që gjetjet e këtij auditimi dhe auditimeve të tjera që KLSH ka zhvilluar në AlbPetrol sha dhe MEI mbeten në tërësinë e tyre, tepër komplekse, si përsa i përket natyrës së tyre administrative ashtu dhe asaj ekonomike, duke pasur parasysh faktin që problematika e konstatuar në lidhje me faktorin "R" është një çështje e shtrirë ndër vite, duke marrë gjithashtu në konsideratë faktin që KLSH nuk ka juridiksion në auditimin e drejtpërdrejtë të kompanive private që operojnë në sektorin e hidrokarbureve por auditon vetëm në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e institucioneve shtetërore (i cili në këtë auditim ka qenë tepër i mangët si pasojë e faktit që për mosvënien e tij në dispozicion na është nxjerrë si justifikim pretendimi i ruajtjes së konfidencialitetit), KLSH i ka përcjellë institucioneve më të larta shtetërore, Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat si dhe Prokurorit të Përgjithshëm, një informacion më të detajuar në lidhje me problematikën e konstatuar, rekomandimet e dhëna nga KLSH, nevojën imediate të ndërveprimit institucional si dhe përgjegjësinë e strukturave dhe zyrtarëve shtetërorë ndër vite.

Duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit të hidrokarbureve për ekonominë e

vendit dhe sigurinë kombëtare, i kemi paraqitur strukturave më të larta shtetërore një platformë me rekomandime për reformimin dhe forcimin e kontrollit shtetëror në këtë sektor. Kemi kërkuar që, në rast të riaktivizimit të procedurave të privatizimit të AlbPetrol apo dhe në procedura të tilla të ngjashme në sektorin e hidrokarbureve, autoritetet shtetërore përgjegjëse të sigurohen të përfshijnë në këto procese, me përparësi të lartë, kompani me potenciale dhe kredenciale të larta profesionale nga aleatët strategjikë të vendit tonë (veçanërisht kompani me traditë të konsoliduar në këtë sektor, si nga SHBA, Mbretëria e Bashkuar apo Gjermania), si dhe të mundësojnë arritjen e transparencës reale të kompanive ofertuese pjesëmarrëse në garë. Në këtë mënyrë, vendi ynë do të siguronte jo vetëm përfitime ekonomike dhe financiare, por edhe politike.

Nga ana tjetër kemi rekomanduar rikrijimin e Institutit të Naftës, nga ana e Strukturave përgjegjëse të parashikohen nevojat për burimet njerëzore profesionale dhe të plotësohen ato me qëllim realizimin e auditimeve brenda afateve sa më të shkurtra nga dorëzimi i pasqyrave financiare për atë vit (për prodhimin) dhe brenda 3 muajve nga dorëzimi i raportit të kostove të rikuperueshme 3 mujore (për ato marrëveshje që janë në fazë kërkimi). Marrjen e masave për të vendosur instrumente monitorimi të efektshme dhe të kërkojë rivlerësimin objektiv të planeve të zhvillimit, operacioneve teknike dhe auditime financiare profesionale dhe të pavarura lidhur me kostot reale që përfshihen në aktivitetin hidrokarbur, për ti vënë në eficiencë marrëveshjet e lidhura. Në çdo rast të përcaktohet niveli i përgjegjësisë së individëve të përfshirë në këtë proces në mënyrë që ti prihet rruga formalitetit të këtyre monitorimeve ku interesat e shtetit shihen të fundit.

Duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit të hidrokarbureve për ekonominë e vendit dhe sigurinë kombëtare, i kemi paraqitur strukturave më të larta shtetërore një platformë me rekomandime për reformimin dhe forcimin e kontrollit shtetëror në këtë sektor.

Kemi kërkuar që, në rast të riaktivizimit të procedurave të privatizimit të AlbPetrol apo dhe në procedura të tilla të ngjashme në sektorin e hidrokarbureve, autoritetet shtetërore përgjegjëse të sigurohen të përfshijnë në këto procese, me përparësi të lartë, kompani me potenciale dhe kredenciale të larta profesionale nga aleatët strategjikë të vendit tonë (veçanërisht kompani me traditë të konsoliduar në këtë sektor, si nga SHBA, Mbretëria e Bashkuar apo Gjermania), si dhe të mundësojnë

arritjen e transparencës reale të kompanive ofertuese pjesëmarrëse në garë. Në këtë mënyrë, vendi ynë do të siguronte jo vetëm përfitime ekonomike dhe financiare, por edhe politike.

Kemi rekomanduar dëmshpërblimin e banorëve të fshatit Marinzë për dëmet nga shpërthimi i fontanës, si dhe ringritjen e Institutit Shkencor të Naftës, si një institut i mirëfilltë shkencor, i cili të mbështesë të gjitha vendimmarrjet e lidhura me zhvillimin e sektorit të hidrokarbureve në vendin tonë si dhe të bashkëpunojë me Kuvendin dhe qeverinë lidhur me hartimin e strategjive afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimeve në këtë sektor, duke bërë dhe rolin e oponentit teknik gjatë negociimit të marrëveshjeve, shqyrtimit të propozimeve dhe zhvillimit të operacioneve hidrokarbure. Duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit të hidrokarbureve për ekonominë e vendit dhe sigurinë kombëtare, i kemi paraqitur strukturave më të larta shtetërore një platformë me rekomandime për reformimin dhe forcimin e kontrollit shtetëror në këtë sektor.

Kemi kërkuar që, në rast të riaktivizimit të procedurave të privatizimit të AlbPetrol apo dhe në procedura të tilla të ngjashme në sektorin e hidrokarbureve, autoritetet shtetërore përgjegjëse të sigurohen të përfshijnë në këto procese, me përparësi të lartë, kompani me potenciale dhe kredenciale të larta profesionale nga aleatët strategjikë të vendit tonë (veçanërisht kompani me traditë të konsoliduar në këtë sektor, si nga SHBA, Mbretëria e Bashkuar apo Gjermania), si dhe të mundësojnë arritjen e transparencës reale të kompanive ofertuese pjesëmarrëse në garë. Në këtë mënyrë, vendi ynë do të siguronte jo vetëm përfitime ekonomike dhe financiare, por edhe politike.

Kemi konstatuar se Avokatura e Shtetit ende nuk ka vepruar në drejtim të ndjekjes së arkëtimit të garancisë nga shoqëria "Vetro Energy PTE Ltd" pas dështimit të procedurave të privatizimit të shoqërisë AlbPetrol sh.a., Patos. Në kushtet kur nga shtyrja e mëtejshme e koordinimit të institucioneve shtetërore apo krijimi i vonesave artificiale rrezikohet seriozisht dhe në mënyrë të pajustificueshme tejkalimi i afateve përkatëse procedurale të kërkimit dhe arkëtimit të garancisë prej 85 milion euro kemi rekomanduar që Avokatura e Shtetit, të veprojë në lidhje me iniciimin dhe ndjekjen me prioritet absolut nga ana e saj, të çështjes së arkëtimit të garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria "Vetro Energy PTE Ltd" në procedurat e privatizimit të shoqërisë AlbPetrol sh.a., Patos në vlerën 85 milion Euro.

SEKTORI I ENERGJISËAuditimi në MEI dhe Avokatin e Shtetit

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në auditimet e realizuara në MEI dhe Avokati i Shtetit, ka patur në fokus edhe procedurat e ndjekura dhe negociatat që sollën në përgatitjen e marrëveshjes së nënshkruar më datë 23.06.2014, nga Grupi i Punës i ngritur në bazë të VKM nr. 969 dt. 25.10.2013 “Për ngritje e grupit të punës për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjes ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe CEZ a.s.”, përcjellë për miratim në Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin e Shqipërisë.

Nga KLSH është audituar procesi i zhvillimit të negociatave, veprimtaria e grupit të punës dhe orientimi për zgjidhjen e marrëveshjes me mirëkuptim nga Qeveria dhe jo miratimi i saj nga Kuvendi i Shqipërisë.

Kemi konkluduar se në kushtet e mungesës së dokumentacionit të nevojshëm (minimalisht procesverbaleve të mbledhjeve të grupit të punës) mbi bazën e të cilit të mund të evidentohet dhe gjykohej në lidhje me punën e bërë nga ana e grupit të negocimit (argumentet dhe kundër argumentet e dhëna për pranimin apo refuzimin e pretendimeve të CEZ a.s., qëndrimin karshi pretendimeve të mëparshme të Shtetit Shqiptar, analizën e provave, dokumentacionit dhe ekspertizës së dhënë nga ekspertët e huaj të kontraktuar, si dhe atë të akumuluar gjatë gjithë kësaj kohe nga vetë institucionet shtetërore si ERE dhe Avokatura e Shtetit, e cila me shkresën nr. 526/34, datë 24.07.2013 depozitoi edhe një kallëzim penal pranë organit të Prokurorisë ndaj vetë përfaqësuesve të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a.) vihet në diskutim mbrojtja që grupi i punës i ka bërë interesave të ligjshme të Shtetit në këtë proces negocimi.

Auditimi u bazua në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit:

*ISSAI 400 “Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë”;*

*ISSAI 4000 “Standardi Auditimit të Përputhshmërisë”;*

*ISSAI 300 “Standardet e Fushës së Auditimit Shtetëror” (evidenca e auditimit);*

*ISSAI 1500 “Evidencat e Auditimit”;*

*ISSAI 200 “Standardet e përgjithshme të Auditimit Publik, kujdesi i duhur*

*profesional”;*

*ISSAI 1610 “Përdorimi i punës së audituesve të brendshëm”;*

*ISSAI 1620 “Përdorimi i punës së një eksperti auditimi, me qëllim dhënie opinionit, gjykimi dhe konkluzione auditimi me një siguri të arsyeshme, të mbështetur mbi evidenca kompetente”).*

Bazuar në këto standarde, KLSH shqyrtoi dhe përdori gjatë auditimit: korrespondencën zyrtare, materialet dhe raportet teknike të ekspertëve të kontraktuar nga Shteti shqiptar ku pasqyrohen pretendimet e palës shqiptare, pasqyrat financiare të publikuara të shoqërive të grupit CEZ a.s., procedurën e ndjekur në dakordësimin e kushteve në “Marrëveshjen e Mirëkuptimit”, si dhe materialet dhe observimet drejtuar grupit të auditimit, duke arritur në përfundimin që Shtetit Shqiptar i është shkaktuar një dëm ekonomik plotësisht i vlerësueshëm në masën 479 milion euro sipas përcaktimit më poshtë:

1. Në vlerën 95 milion euro për pagesë e dakortësuar në marrëveshje, të papabazuar në dokumentacion financiar për përdorimin e kredive dhe huave dytësore, apo njohje të drejtash nga CEZ Shpërndarje sh.a. (dëm ekonomik i parikuperueshëm);
2. Në vlerën 352 milion euro, si diferencë midis detyrimeve afat-shkurtra të njohura dhe të drejtave afat-shkurtra të njohura (mungesa në kapitalin qarkullues) të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a., sipas pasqyrave financiare të shoqërisë (dëm që do rëndojë gjendjen financiare të shoqërisë në të ardhmen);
3. Në vlerën 32 milion euro, për zhvlerësimin e vlerës së tregut të 24% të aksioneve të shtetit në CEZ Shpërndarje sh.a. Mos pretendimi i diferencës ndërmjet vlerës së aksioneve të Qeverisë Shqiptare gjatë privatizimit (CEZ a.s., ka paguar 102 milion euro për të kontrolluar 76% të paketës së operatorit të shpërndarjes, moment kur vlera e 24% të aksioneve të Shtetit Shqiptar ishte 32 milion euro) dhe vlerës zero të aksioneve të saj më 21 janar 2013, shoqërisë i është shkaktuar një dëm që do rëndojë gjendjen financiare të shoqërisë në një periudhë afatmesme).

Nisur nga kushti i “Marrëveshjes së Mirëkuptimit” se *Blerësi pranon dhe bie dakord që Shitësi nuk ka asnjë informacion në lidhje me gjendjen financiare, operationale*

apo çdo gjendje tjetër të shoqërisë dhe se me vazhdimin e blerjes së aksioneve të parashikuar sipas kësaj, Blerësi e bën këtë gjë në rrezikun dhe përgjegjësinë e tij. Si rrjedhim, Blerësi do të blejë dhe bie dakord të blejë Aksionet “siç janë” “ku janë” dhe “me të gjitha të metat”, shuma prej 95 milion euro është një dëm i parikuperueshëm, për shkak të njohjes së detyrimeve jo vetëm të pa dokumentuara por edhe në kushtet e shkeljes flagrante të detyrimeve të rrjedhura nën SPA, ndërsa shuma 384 milion euro është dëm ekonomik që do të rëndojë financat e shoqërisë (shtetit) për shumë kohë, duke kërkuar një regjim të fortë kontrolli financiar.

Nisur nga fakti se KLSH,  nuk mund të auditonte dokumentacion financiar dhe ligjor të kompanive me kapital aksioner 76% aksione private, CEZ Shpërndarje sh.a., apo kompanive private të cilat u krijuan gjatë aktivitetit të CEZ a.s., në Shqipëri (CEZ Trade dhe CEZ Albania), pasi në referencë të Kushtetutës, të nenit 163, gërma c “Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti”, i jemi drejtuar Kuvendit të Shqipërisë për:

Ngritjen e një komisioni ad-hoc të pavarur, me ekspertë teknik dhe ekonomik të cilët do të vlerësonin realisht dhe me saktësi dëmin nga aktiviteti nën administrimin e CEZ a.s., si dhe do të përcaktonin mundësinë më të mirë për një rimëkëmbje të Operatorit të Shpërndarjes mbi baza të monitorimit të kujdesshëm të të gjithë treguesve për periudhën e tanishme, duke përcaktuar në çdo rast përgjegjësitë individuale dhe institucionale për të gjithë aktorët që lejuan këtë situatë me të cilën financave publike u shtohet një dëm me efekte në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë. Të kërkohej një disiplinë e fortë financiare dhe një kontroll i vazhdueshëm nga Kuvendi, për çdo investim dhe vendimmarrje strategjike lidhur me Operatorin e Shpërndarjes, për të mundësuar me hapa konkretë përmirësimin e gjëndjes së verifikuar.

### Auditimi në OSHEE

Nga auditimi në shoqërinë Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE), sh.a., Tiranë, kemi konstatuar se përkundër angazhimit të kësaj shoqërie, për uljen e shpenzimeve dhe rritjes së të ardhurave, u konstatuan dhe shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore me një dëm ekonomik për shoqërinë CEZ Shpërndarje sh.a.,



Shoqëri në administrim të përkohshëm (aktualisht OSHEE) dhe buxhetit të shtetit në vlerën 4,467,003 mijë lekë, ose 32,000,880 euro.

Kemi konstatuar mungesë të ardhurash për shoqërinë OSHEE dhe për buxhetin e shtetit, të krijuar nga eksporti i energjisë nga KESH, dhe importit të energjisë nga OSHEE në vlerën 124,388 mijë lekë, ose 891,096 euro. Kemi konstatuar dëm në fushën e blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria CEZ Shpërndarje (status të përkohshëm) në vlerën 2,959,350 mijë lekë, ose 21,200,302 euro, shkaktuar si rrjedhojë blerjes së energjisë elektrike me çmime më të larta se ato të tregut.

Nga auditimi i blerjes së materialeve dhe pajisjeve elektrike nga shoqëria CEZ Shpërndarje, përgjatë vitit 2014, rezultoi që është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 608,596 mijë lekë ose 4,359,882 euro, si rrjedhojë e shkeljeve të procedurave të tenderimit të vendosura nga ERE në "Rregullore e Prokurimeve të CEZ Shpërndarje sh.a.", lidhur me trajtimin e procedurave si raste emergjente, realizimit të tyre me një fazë negociimi, kryerjes së shtesave të kontratave në vlera të konsiderueshme që arrinin deri në 50% apo 70% të vlerës së kontratës bazë, si dhe blerjes në disa raste të materialeve dhe pajisjeve elektrike pa zhvilluar procedura tenderimi.

Nga auditimi i pjesshëm për shkak të dokumentacionit të mangët ekonomiko-financiar, i disa prej kompanive të mbledhjes së borxhit të energjisë elektrike rezultoi që këto kompani kanë përfituar padrejtësisht nga CEZ Shpërndarje sh.a., së paku në vlerën 847,936 mijë lekë ose 6,074,478 euro, për të cilën grupi i auditimit të KLSH shprehet me rezervë si pasojë e mungesës së një inventari të plotë të llogarive (inventar fizik të aseteve dhe inventar kontabël) të Shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a., si në momentin e kalimit të kësaj shoqërie nën administrimin e përkohshëm të shtetit më datë 21.01.2013, ashtu edhe pas kësaj date deri në periudhën e përfundimit të këtij auditimi. Mosdisponimi i programeve autentike të Shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a., (SAP - Programi i kontabilitetit, Billing – Programi i faturimit dhe Mobirid- Programi i leximit të matësve), mbi bazën e të cilave kjo kompani menaxhonte dhe administronte aktivitetin e saj, që nga momenti i kalimit të kësaj shoqërie nën administrimin e përkohshëm të shtetit dhe deri më periudhën e përfundimit të këtij auditimi ka sjellë për pasojë ekzistencën e të dhënave kontradiktore në dokumentacionin e disponuar në OSHEE nga dega ekonomike, drejtoria ligjore dhe drejtoria e shitjes. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua që për katër kompanitë e audituara, nga ana e Shoqërisë CEZ

Shpërndarje sh.a., nuk disponohej dokumentacioni i plotë për justifikimin e pagesave të dhëna këtyre kompanive të mbledhjes së borxheve, duke ngritur kështu dyshime serioze për shumat e përfituara padrejtësisht prej këtyre kompanive nga Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a.

Në mungesë të ekzistencës së dokumentacionit të plotë justifikues për zbatimin e detyrimeve kontraktore të kompanive të mbledhjes së borxheve, vlera prej 847,936 mijë lekë konsiderohet si dëm ekonomik i përfituar në mënyrë të padrejtë nga ana e tyre.

### Auditimi në KESH

Përvec të dhënave të deklaruara nga auditimet në AKBN, dhe MEI në dëmin e këtij sektori përfshihen edhe dëmet e konstatuara nga auditimi në shoqërinë "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a., Tiranë. Kemi konstatuar se performanca e treguesve ekonomiko-financiar, nuk është aspak e kënaqshme me impakt krijimin e një situatë të vështirë financiare, e cila ka ardhur nga mungesa e likuiditeteve për shkak të detyrimeve të prapambetura financiare nga Shoqëria Ish-CEZ Shpërndarje sh.a., në vlerën 58,415,650 mijë lekë. Si pasojë e vendimeve të Entit Rregullator të Energjisë; nr. 149 dhe 150, datë 07.12.2011 "Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentralet e rinj, çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a i caktuar nga Enti Rregullator i Energjisë është 2.2 lekë/kwh ndërsa çmimi i blerjes së energjisë nga prodhuesit privat dhe ato konçensionare është respektivisht 9.3 lekë/kwh dhe 7.77 lekë/kwh. Kjo diferencë çmimi midis blerjes dhe shitjes me 7.1 lekë/kwh dhe 5.57 lekë/kwh ka sjell një efekt negativ financiar, në vlerën 4.898.858 mijë lekë. Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Shoqërinë KESH sh.a., ndërkohë nga organet drejtuese të saj, nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre. Nga auditimi u konstatuan shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore me një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, në vlerën 139,839 mijë lekë, si dhe një e ardhur e munguar për Shoqërinë KESH sh.a., në vlerën 5,726,096 mijë lekë.

**B/3 NË FUSHËN E SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Konstatuam se raporti Kontribues-Përfitues vazhdon të mbetet i përkeqësuar në nivelet 1 me 1.11 dhe larg treguesve të një skeme të shëndoshë sigurimesh, ndërsa deficitin e degës së pensioneve rezultojnë në lartë. Verifikohet se ndërmjet DPT, Drejtorive Rajonale të Degëve Tatimore, Inspektorateve të Punës si dhe Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore nuk ka bashkëpunim, koordinim, shkëmbim informacioni për këtë qëllim, për rrjedhojë nga indiferentizmi i këtyre institucioneve i krijohet buxhetit të shtetit një shmangie vjetore e madhe në kontribute, fakt që sjell thellim vit pas viti të deficitit të kësaj skeme. Mbi sa kemi konstatuar kemi rekomanduar ndërhyrje të menjëhershme në drejtim të rritjes së monitorimit realizimin e të ardhurave nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, si dhe të përgatiten edhe skenarë plotësues, nëse vihet re që skema nuk po reagon siç duhet me reformën e realizuar. Miradministrimi shikohet si mjeti më i mirë që do të sjellë kthesën në këtë skemë që deri tani ka qenë e dështuar dhe nuk ka realizuar misionin e saj. Kemi kërkuar realizimin e komunikimeve publike dhe periodike për nivelet e kontribuesve në skemë shoqërore me treguesin e raportit përfitues/kontribues, duke synuar që të dhënat e publikueshme dhe transparenca për publikun të bëhet duke analizuar rritjen e kontribuesve në skemë bazuar në sektorët nga vjen kjo rritje, pra në kontribues nga sektori publik, privat dhe të vetëpunësuar në bujqësi, çka do të mundësonte një perceptim të drejtë dhe në kohë për faktin nëse skema është duke rikuperuar numrin e kontribuesve që rezultojnë se mungon po t'i referohemi të dhënave të nivelit të forcave të punës së deklaruar nga Instituti i Statistikave.

Kemi kërkuar analizimin e problematikave të evidentuara nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe bashkëpunimi me organet e qeverisjes vendore, për evidentimin e gjithë bizneseve të vogla sipas zonave të veçanta dhe të shikohet mundësia e përcaktimit të politikave të diferencuara fiskale, për të stimuluar veçanërisht derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të çdo të punësuar apo vetëpunësuar.

## B/4 SEKTORI ARSIMIT TË LARTË

Nisur nga problematikat e konstatuara nga auditimi, duke vlerësuar rolin që ky Institucion duhet të ketë në vendosjen, plotësimin dhe mbajtjen e standardeve të larta dhe unifikuese për ciklin doktoral në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë në vend, kemi rekomanduar përcaktimin e qartë të kompetencave monitoruese të Ministrisë, duke synuar forcimin e rolit të këtij institucioni në mbarëvajtjen e programeve të ciklit të tretë të studimeve, i cili në gjykimin tonë fillimisht duhet të jetë cikël studimi me kohë të plotë.

Të theksohet detyrimi për krijimin e një database të veçantë, të unifikuar dhe përditësuar ku të jepen të dhëna për udhëheqësit, temat e doktoraturave dhe reçencat, i cili të jetë publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit. Duhet të ketë instrumente kontrolli publik të shoqëruara me identifikim/përcaktim përgjegjësie individuale dhe institucionale për proceset e fitimit/miratimit të titujve akademik, duke synuar rregullimin e plotë dhe afatgjatë të kërkimit shkencor dhe etapave/kushteve të përparimit në karrierën akademike.

Të përcaktohen kompetencat e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, në të gjitha rastet kur konstatohen parregullsi apo nivel i ulët i plotësimit të standardeve të përcaktuara apo kritereve të detyrueshme të vendosura për çdo Institucion Publik apo Privat të Arsimit të Lartë, duke specifikuar qartë për çdo fazë të monitorimit llojin e kufizimit dhe masën e tij.

## B/5 ADMINISTRIMI I SHOQËRIVE ANONIME (sh.a.)

Nisur nga problematikat e konstatuara në drejtim të kostituimit të Këshillave Mbikqyrës dhe të shpërblimit të tyre, KLSH i ka rekomanduar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes që të ndërmarrë iniciativën lidhur me ndryshimin e Ligjit nr. 10 264, datë 8.4.2010 "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar.

Kemi kërkuar rishikimin dhe ripunimin thelbësor të kuadrit rregullator me synim hartimin një Vendimi të ri të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimi të ri duke reflektuar të gjitha problematikat e këtyre 15 viteve pasi si VKM nr. 642 datë 11.10.2005 i ndryshuar me VKM nr 677 datë 03.10.2007 "Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore dhe Udhëzimi i Ministrit nr. 318 datë 08.04.2009

“Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore” datojnë që para daljes së Ligjit nr 10264 datë 08.04.2010.

Ndërhyrje kemi kërkuar në drejtim të përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes së kandidaturave nisur nga fakti se janë bërë emërimet të tilla ku disa individë sigurojnë pagesa mujore të konsiderueshme si shpërblime por që profesionalisht nuk japin dhe teknikisht nuk mund të japin ekspertizën e nevojshme pra marrin shpërblime për një punë që nuk e ofrojnë me impakt abuzivitetin e fondeve publike. Krahas sa më sipër, kemi rekomanduar që rishikimi dhe ndryshimi i kriterëve të përzgjedhjes së emërimit të anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës në sh.a. të synojë në përcaktimin e kriterëve specifike në drejtim të kualifikimeve, përvojës, eksperiencës dhe ekspertizës teknike që duhet të disponojë kandidati dhe që kanë lidhje organike me aktivitetin që zhvillon shoqëria anonime. Kriter parësor duhet që kandidati të jetë personalitet i fushës, të emërohet nga strukturat shtetërore që kanë në administrim shoqërinë anonime shtetërore.

Si kriter i veçantë duhet të jetë dhe orientimi i kandidaturave si profesorë të universiteteve publike që janë profesionistë të fushës, gazetarë ekonomikë etj, pra individë të spikatur në fushën dhe aktivitetin që mbulon shoqëria. Në kuadrin rregullator si për bordet, komisionet, këshillat e institucioneve të qeverisjes qendrore dhe shoqëritë anonime të vendoset kufizimi që për individët të cilët janë me statusin “pensionist” të mos emërohen anëtarë të bordeve, komisioneve, këshillave apo organeve të tjera kolegjiale mbikëqyrëse. Raste përjashtimore mund të jene vetëm fushat e artit dhe të kulturës dhe personalitetet ende aktivë të shkencës.

Në zbatimin e rekomandimeve të realizuara në fund të vitit u konstatua një nivel i ulët i zbatimit të këtyre rekomandimeve vetëm 25%, megjithëse rezultoi një nivel pranimi prej 85% të përmirësimeve të rekomanduara.

### C. NIVELI I DËMEVE TË KONSTATUARA PËR FINANCAT PUBLIKE



---

Nga auditimet e realizuara gjatë vitit 2015 janë konstatuar shkelje financiare që përgjithësisht i përkasin veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën kohore 2013-2015.

A. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 125,763,051 mijë lekë (ose 919.9 milion euro).

B. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 35,312,076 mijë lekë (ose 257.7 milion euro).


Nëse do të analizonim dëmin e konstatuar në vite do të shikonim një rritje të konsiderueshme të këtij treguesi gjatë vitit 2015, tregues i cili është në rritje për shkak të dëmit të konstatuar nga Marrëveshja CEZ, por jo vetëm. Kështu në grafik jepet pasqyrimi si i këtij treguesi me dhe pa dëmin e konstatuar nga auditimi në MEI.




Treguesi i dobisë së rezultateve të auditimit, si një nga treguesit më domethënës të performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit, i cili vë në raport shpenzimet buxhetore të institucionit me sasinë e fondeve të kërkuara për zhdëmtim nga KLSH për vitin 2015 rezulton të jetë: për çdo 1 (një) lek të shpenzuar për institucionin e KLSH janë kërkuar për t'u zhdëmtuar 180 lekë.

Në këtë tregues nuk është përfshirë dëmi prej 67,060 milion lekë apo 479 milion Euro, i konstatuar në MEI, shkaktuar nga Marrëveshja e Zgjidhjes me Mirëkuptim, të cilin e kemi klasifikuar si dëm pa mundësi arkëtimi. Nëse ky dëm do të përfshihej treguesi rezulton: për çdo një lek të shpenzuar për institucionin e KLSH-së janë kërkuar për t'u zhdëmtuar 385.8 lekë.

Nga një analizë krahasuese konstatohet: për vitet 2010-2011, për 1 lek të shpenzuar nga buxheti i shtetit janë kërkuar mesatarisht për zhdëmtim 19.1 lekë, ndërsa për vitet 2012-2013 për çdo 1 lek të shpenzuar është kërkuar për zhdëmtim 52.1 lekë dhe 2014-2015 për çdo 1 lek të shpenzuar është kërkuar për zhdëmtim 109.05 lekë.



Indikatori i efektivitetit për vitin 2015




Struktura e dëmit ekonomik sipas fushave ku është konstatuar, në një trend për tre vitet e fundit rezulton si më poshtë:

Tabela3: Struktura e dëmit ekonomik sipas fushave 000/lekë

	Struktura	2013		2014		2015	
		Vlerë	%	Vlerë	%	Vlerë	%
1	Në sektorin e tatimeve	125,820	1	278,789	2	12,612,237	10
2	Në sektorin e doganave	377,141	2	941,530	8	4,242,496	3
3	Në shpenzimet korente	137,078	1	405,843	4	399,592	0
4	Në prokurimet publike	354,099	2	678,118	6	2,621,594	2
5	Nga administrimi i pronës shtetërore dhe koncesionet	13,966,142	93	8,855,692	79	105,823,810	84
6	Në urbanistikë	129,545	1	38,432	0	63,322	0
Totali		15,089,825		11,198,404		125,763,051	





Ajo që konstatohet nga leximi i këtyre rezultateve është që edhe për këtë vit, pjesa më e madhe e dëmit vjen kryesisht tek fusha e menaxhimit të pasurisë shtetërore, ku rezulton se është konstatuar rreth 84% e dëmit total (66% i të cilit në sektorin energjisë dhe 18% në sektorin e hidrokarbureve).

Verifikimi i të njëjtit trend lidhur me dëmin në sektorin energjetik, tregon se ky sektor mbetet një sektor me risk dhe adreson domosdoshmërinë e një vëmendje të madhe mbi këto sektorë nevralgjik të ekonomisë.

Kështu në vitin 2014 dëmi në këtë sektor ishte në nivelin 79% të totalit të dëmit total të konstatuar (19% në sektorin energjisë dhe 60% në sektorin hidrokarbur), ndërsa në vitin 2013 po në këtë sektor dëmi ishte në rreth 92% të totalit të dëmit të konstatuar (79% në sektorin energjisë dhe 13% në sektorin hidrokarbur).

Për vitin 2015, një dëm të konsiderueshëm kemi konstatuar edhe në sektorin e tatimeve dhe doganave në rreth 13% të dëmit total të konstatuar, kundrejt 10% të dëmit të konstatuar në këto sektor për vitin 2014 dhe 3% të konstatuar në vitin 2013.

Po të analizojmë në vlerë trendin në rritje të dëmit në sektorin e tatimeve dhe doganave do të vërejmë një rritje me 14 herë krahasuar me shifrën e dëmit të konstatuar në vitin 2014. Kështu nga 1,220,319 mijë lekë të vitit 2014 konstatimet në këtë sektor kanë arritur në 16,854,733 mijë lekë në vitin 2015.

Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Barnave, Tiranë, në vlerën totale 72,103 mijë lekë, nga të cilat 92 mijë lekë nga mosndalimi i tatimit mbi të ardhurat dhe 34,506

mijë lekë e 37,505 mijë lekë si përfitime të padrejta rimbursimi nga shteti për dy kompani farmaceutike, nga diferenca midis çmimit/njësi të referencës nga lista e çmimeve për barnat e rimbursueshme dhe çmimit/njësi që duhej të tregtohej në fakt një medikament i caktuar, përfitime këto të shoqëruara me elementë të evazionit fiskal.

Bankën e Shqipërisë, në vlerën totale 11,453 mijë lekë nga efekti i moslogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale në shumën 1,056 mijë lekë dhe mos mbajtja e tatimit në burim për pagesat në favor të arkitektit për hartimin e projekteve të rikonstruksionit të objektit të Bankës Qendrore në shumën 10,397 mijë lekë.

Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Degët Doganore, Durrës, Fier, Vlorë, Kakavijë, Qafë-Thanë e Bllatë, në vlerën totale prej 3,337,003 mijë lekë, si detyrime doganore të papaguara, si pasojë e moslogaritjes dhe mosarkëtimit të rentës minerare për mineralet e eksportuara. Doganat, Renta Minerare, në vlerën 3,337,003 mijë lekë, nga moslogaritja dhe mosarkëtimi në fushën e rentës minerare në dogana.

Degët e Doganave Lezhë dhe Shkodër, në vlerat respektive 13,130 mijë lekë dhe 24,165 mijë lekë, si detyrime doganore të papaguara në zhdoganimet e disa artikujve të ndryshëm dhe si detyrime e penalitete të pa vendosura ndaj subjekteve që nuk kanë paguar t.v.sh.

Për vitin 2015, kemi rritje të konsiderueshme të vlerës së dëmit të konstatuar në fushën e prokurimeve publike krahasuar me vitin 2014. Kështu konstatohet se dëmi në prokurime arriti në 2,621,594 mijë lekë, krahasuar me 678,118 mijë lekë të konstatuar për vitin 2014 me një rritje 3.8 herë.

## AUDITIMET E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Gjatë vitit 2015 u realizuan për herë të parë dy auditime të sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Auditim i teknologjisë së informacionit në Agjencinë e Barnave dhe Paisjeve Mjekësore.

Auditim i teknologjisë së informacionit në Agjencinë e Prokurimeve Publike.

Si dhe disa auditime me përdorimin e teknikave CAAT dhe vizualizimit të informacionit.

Auditimi i kryer në Agjencinë e Barnave dhe Paisjeve Mjekësore ishte një Auditim Pilot i mbështetur nga Inisiativa për Zhvillim e INTOSAIT (IDI) i kryer pas trajnimit online një vjeçar.

Nga Auditimi në Agjencinë e Prokurimeve Publike veçojmë gjetjet kryesore dhe impaktin që ato japin në sistemin e prokurimit.

Nr	GJETJA	IMPAKTI
1.	Masat e marra nga APP për sigurimin e Planit të Vazhdueshmërisë së Biznesit (BCP) dhe Planit të Rimëkëmbjes nga Katastrofat (DRP) janë të pamjaftueshme. APP nuk zbaton Politikën e Menaxhimit të Ndryshimeve.	Ndërprerje e shërbimit, humbjen e informacionit dhe besueshmërisë.
2.	Në strukturën organizative dhe në detyrat funksionale të stafit të Agjencisë nuk është i rregulluar funksioni që garanton sigurinë e sistemit dhe mbrojtjen e informacionit e të integritetit të të dhënave që disponohen.	Keqtrajtimi i asetëve të informacionit, cënimi i integritetit të të dhënave të prokurimit, risk në qasje të paautorizuar në të dhënat.
3.	APP nuk ka politikën të pamjaftueshme të zhvillimit të Burimeve Njerëzore	Mungesa ose pamjaftueshmëria e politikave të zhvillimit të Burimeve Njerëzore, përbën kërcënim të sigurisë në fushën e teknologjisë së informacionit.
4.	Politikat mbi gjurmët (log-et) e Sistemit të prokurimit nuk zbatohen.	Risk në qasje të paautorizuar në të dhënat kërcënim të sigurisë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe mungesë transparence
5.	Mbajtja dhe sinkronizimi manual i kohës (orës) të Sistemit të Prokurimit.	Nuk garanton transparencën e nevojshme për procedurat e prokurimit.


Këto gjetje janë pranuar nga subjekti i cili ka nisur zbatimin e tyre në bashkëpunim me Bankën Botërore, e cila ka miratuar projektin për investime në sistemin e prokurimit (projekti i BB për APP).

ANALIZA ME VIZUALIZIM I RISKUT


Në auditimet e kryera gjatë vitit 2015 janë vërejtur probleme në zbatimin e procedurave të prokurimit publik.

Për të kryer një vlerësim të performancës së sistemit të prokurimit publik u krye një analizim i të dhënave të prokurimeve publike për vitin 2014 me përdorimin e teknikave kompjuterike CAAT si dhe përdorimin e vizualizimit të informacionit.

*Në vizualizimin e mëposhtëm vërehet shpërndarja e fondeve të prokurimeve publike për vitin 2014 sipas Operatorëve Ekonomikë*



Nga vizualizimi i gjendjes nëpërmjet paraqitjes së efektivitetit të prokurimeve për operatorët ekonomike për prokurimet e vitit 2014 (vlera në % e uljes së ofertës nga fondi limit) dallojmë tre zona me nivel risku të ndryshem të cilat paraqiten:




Vlerësojmë zonat e Operatorve Ekonomike nga:

- 0-5% mbart riskun e marrëveshjeve dhe mungesën e transparencës në procedurat e prokurimit;
- 5-20% me nivel të ulët risku;
- 20-46% me nivel të lartë risku mosplanifikim të saktë me pasojë mos efektivitet fondesh.


Efektiviteti i prokurimeve me bashkim operatorësh ekonomik

Ky bashkim përcaktohet nga kushtet që vendos operatori ekonomik për realizimin e prokurimit dhe mbart riskun e mungesës së transparencës uljen e konkurrencës.

Nga vizualizimi vërehet se të dy zonat e riskut (me efektivitet të ulët dhe ajo me efektivitet të lartë) janë zgjeruar me rezultat të përgjithshëm të zonave me risk 71% apo 84 raste.



Në Autoritetin kontraktor Ministria e Shëndetësisë janë zhvilluar 309 procedura prokurimi me fond limit 3,550 milion lekë, nga vizualizimi vërehet se vetëm katër firma kanë fituar 136 procedura (44%) apo 22% të fondit të shpenzuar.






Analizimi me vizualizim i shpërndarjes së fondeve në prokurimin e përqendruar të zhvilluar nga ky operator ekonomik për rastin e vaksinës antigrip për qendrat shëndetësore të vendit tregoi si rezultat paraprak se është kryer sipas ndarjes teritoriale


Në Autoritetin Kontraktor Ministria e Brendshme, për vitin 2014, janë zhvilluar 92 procedura prokurimi të mëdha me fond limit 4,325 milion lekë dhe fond të ofertuar prej 4,144 milion lekë.

Nga analiza veçojmë:

- 35% e prokurimeve me efektivitet nga 0 deri në 5% zonë e cila mbart riskun e marrëveshjeve dhe mungesën e transparencës në procedurat e prokurimit.
- 27% e prokurimeve me efektivitet nga 5 deri në 20% zonë të cilën e vlerësojmë me nivel të ulët risku.
- 38% e prokurimeve me efektivitet nga 20 deri në 58% zonë të cilën e vlerësojmë zonë me risk të lartë në mosplanifikim të saktë me pasojë mos efektivitet fondesh.



Në Autoritetin Kontraktor Ministria e Mbrojtjes konstatohet se 3 operatorë ekonomikë të kësaj zonë kanë fituar 28.5% të fondit total të prokuruar.



Analiza e zhvilluar për identifikimin e zonave me risk të lartë tregon se procedurat e prokurimit publik dhe sistemi i prokurimit elektronik si mjet për realizimin e tij shprehin dobësi dhe zhvillohet nën presionin e interesave për përfitime.



**D. REKOMANDIME TË ADRESUARA DHE ZBATIMI I TYRE**

Një nga treguesit kryesorë të performancës së auditimit është niveli i zbatimit të rekomandimeve. Në referencë të standardeve ndërkombëtare të auditimit ndjekja e zbatimit të rekomandimeve është një nga objektivat kryesore të veprimtarisë së institucioneve supreme të auditimit. Në punën tonë audituese kemi synuar që rekomandimet të kenë një ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e gjëndjes së subjekteve të audituara në funksion të mirëadministrimit të fondeve në dispozicion por dhe të një qeverisje sa më të mirë.


Tabela e mëposhtme jepen rekomandimet e adresuara subjekteve per harkun kohor 2013-2015.

Nr	Lloji i masës	2013	2014	2015
1	Propozime për ndryshim legjislacioni	82	88	35
2	Masa Organizative	2003	2 603	2510
3	Masa Administrative	236	302	276
4	Masa Disiplinore	925	1 135	1314
5	TOTALI (1 deri 4)	3246	4 128	4135
6	Masa zhëmtimi 000/lekë	15 077 225	11 085 084	58 703 079
7	Kallëzime Penale			
7.a	<i>Kallëzime Penale - nr.</i>	38	41	51
7.b	<i>Kallëzime Penale - persona</i>	94	149	159
7.c	<i>Kallëzime Penale 000/lekë</i>	1 166 061	5 069 494	85 837 736

**D.1 REKOMANDIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIM TË LEGJISLACIONIT**


Gjatë vitit 2015 janë rekomanduar gjithsej 35 propozime për ndryshim legjislacioni.

Nga analiza krahasimore rezulton se numri i rekomandimeve të dhëna përgjatë periudhës katër vjeçare 2012-2015 është rreth 25% më madhe se numri i rekomandimeve të dhëna gjatë periudhës katërvjeçare 2008-2011, gjithashtu vërejmë një rënie të zbatimit të rekomandimeve përgjatë periudhës katërvjeçare 2012-2015.



Spektri i propozimeve të rekomanduara nga KLSH është mjaft i gjërë përfshirë amendime kushtetuese, ndryshime të ligjeve bazë si dhe ndryshime të Vendimeve të Këshillit të Ministrave apo dhe akte të tjera rregullative.

Dinamika e treguesit të rekomandimeve të propozuara dhe të zbatuara për ndryshim legjislatoni në nivel vjetor për periudhën 2008-2015 paraqitet:




D.2 REKOMANDIME ME KARAKTER ORGANIZATIV

Rekomandimet për ndryshime organizative marrin rëndësi të veçantë për vetë karakterin parandalues që ato kanë. Masat e propozuara për ndryshime organizative në subjektet e audituara synojnë jo vetëm korrigjimin e rasteve të mosfunksionimit eficient të rregullave e kontroleve por për më tepër kanë si qëllim zhvillimin dhe përmirësimin në të ardhmen.

Përgjate vitit 2015, KLSH rezulton të ketë propozuar 2510 rekomandime, të cilat synojnë përmirësimin e sistemeve organizative të enteve të audituara.

Nga 2510 masa të rekomanduara gjithsej janë zbatuar plotësisht 758 prej tyre, pjesërisht 335, dhe janë në proces zbatimi 638 masa.


Përsa i përket masave të rekomanduara për periudhën 2012-2015, KLSH ka rekomanduar rreth 40 % masa më shumë se periudha katër vjeçare 2008-2011.



D.3 REKOMANDIME PËR MASAT ADMINISTRATIVE DHE DISIPLINORE

KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara për çdo subjekt të audituar, i ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 1590 masave disiplinore dhe administrative, të cilat sipas llojit dhe zbatimit të tyre, bazuar në njoftimet zyrtare

të insitucioneve përkatëse dhe rikontrollit të zbatimit të tyre në subjektet e audituara. Konstatohet një nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve në masën 43%. Niveli më i ulët konstatohet në masat administrative 29% krahasuar me ato disiplinore që rezultojnë në masën 46%.



Më konkretisht për vitet 2014 dhe 2015, Masat administrative dhe disiplinore paraqiten:

Po të krahasojmë të dhënat me vitin 2014, ku niveli zbatimit të masave disiplinore dhe administrative ka qenë rreth 64%, rezultojnë një nivel shumë më i ulët në zbatimin e këtyre masave. Kjo tregon se administrata nuk po reagon si duhet për të ndëshkuar përgjegjshmëritë institucionale.

Pavarësisht sa më sipër, institucionalisht jemi të vendosur të kërkojmë në vijimësi dhe në rrugë ligjore, zbatimin maksimalisht të rekomandimeve tona, veçanërisht zbatimin e këtyre rekomandimeve ndaj drejtuesve të mesëm apo të lartë, të paafte apo të korruptuar të njësive publike të audituara, duke kontribuar në formimin dhe forcimin e kulturës së ndëshkueshmërisë në administratën publike. Kjo kërkesë e domosdoshme për arritjen e një standardi të pranueshëm mirëqeverisjeje, imponon nevojën e pasjes së një vullneti të fortë dhe konstant institucional në mos tolerimin e asnjë rasti korrupsioni pavarësisht nivelit ku ai shfaqet apo shkallës së shtrirjes së tij.

Këtë vullnet dhe kontribut institucional, në forcimin e kulturës së

ndëshkueshmërisë, sidomos ndaj zyrtarëve të lartë të administratës shtetërore, shkelës flagrant të ligjit dhe mosbesues ndaj ekzistencës së forcës ndëshkuese të shtetit, Kontrrolli i Lartë i Shtetit e ka treguar në mënyrë konstante gjatë këtyre katër viteve të fundit ku në numrin e konsiderueshëm të rekomandimeve tona për dhënien e masave disiplinore, largimit nga detyra si dhe bërjes së kallëzimeve penale janë përfshirë nëpunës të nivelit të lartë drejtues të administratës shtetërore.


### E. KALLËZIMET PENALE

---

Në auditimet e realizuara përgjatë vitit 2015, janë konstatuar një sërë shkeljesh të qëllimshme të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi nga ana e një numri të konsiderueshëm nëpunësish dhe ish-nëpunësish të administratës shtetërore të të gjitha niveleve me pasojë jo vetëm shkaktimin e dëmeve ekonomiko-financiare ndaj buxhetit të shtetit por edhe dëmtimin e interesave të tjera ligjshme të shtetit Shqiptar, për të cilat KLSH ka depozituar pranë organit të Prokurorisë kallëzimet përkatëse penale.

Në total numri i kallëzimeve për vitin 2015 ka qenë 51 kallëzime penale për 159 persona, nga të cilët:

- 1 Ministër (Ministri i Energjisë dhe Industrisë),
- 1 Avokat i Përgjithshëm i Shtetit,
- 1 Sekretar i Përgjithshëm MAS,
- 38 Drejtor Drejtorie,
- 13 Kryetar Bashkie
- 2 Kryetar Komunash,





Ndërkohë që referuar kallëzimeve penale të kryera përgjatë vitit 2014 KLSH ka dërguar pranë organit të Prokurorisë 41 kallëzime penale për 149 persona, nga të cilët:

- 3 Drejtor të Përgjithshëm,
- 22 Drejtor Drejtorie,
- 2 Kancelar Universiteti,
- 3 Kryetar Komunash,
- 1 zv.Kryetar Bashkie, dhe
- 1 Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Në mënyrë të detajuar, sipas departamenteve të auditimit, kallëzimet penale paraqiten:


Departamenti i Auditimit	Viti 2013		Viti 2014		Viti 2015	
	Nr. i kallëzimeve	Nr. personave të kallëzuar	Nr. i kallëzimeve	Nr. personave të kallëzuar	Nr. i kallëzimeve	Nr. personave të kallëzuar
ALP	10	15	14	47	16	46
Niveli Vendor	23	70	16	62	21	87
Projektet	5	7	9	29	10	15
Dogana/Tatime	2	2	2	10	4	11
Total	38	94	41	149	51	159

Siç duket nga paraqitja grafike ka një rritje të kallzimeve si në auditimet e institucioneve të nivelit qendror dhe në atë vendor. Rritje është si në numër rastesh dhe në numër personash të kallzuar.




Për vitin 2015 *dëmi ekonomik* që i është shkaktuar buxhetit si pasojë e shkeljeve të trajtuara në këto kallzime penale arrin në 85.837.736.000 lekë nga 5.069.494.000 lekë që ka qenë për vitin 2014 dhe 1.166.061 lekë të vitit 2013.

Numri i kallëzimeve/persona të kallëzuar penalisht/dëmi i shkaktuar për vitet 2008-2015.



Ajo që vlen të përmendet, për vitin 2015 është rritja e cilësisë së përgatitjes së dosjes për kallëzim penal fakt që ka shkurtuar edhe kohën e përgatitjes së kallëzimeve. Duke bërë krahasimin e kallëzimeve penale të realizuara për periudhën 2008-2011, me kallëzimet penale të realizuara në periudhën 2012-2015 rezulton se ato janë rritur me 3.2 here.

Sipas grup viteve 2008-2011 dhe 2012-2015 numri i kallëzimeve/persona të kallëzuar penalisht paraqitet:





Në mënyrë të detajuar kallëzimet penale për vitin 2015 kanë qenë si më poshtë:

Nr		Subjekti	Persona në numër	Vepra penale	Dëmi në 000/lekë
Bashkia:					
1	10	Memaliaj	2	Neni 248 dhe 258 i KP "Shpërdorim detyre" dhe "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	5,035
2		Fier	4	Neni 248 dhe 258 i KP "Shpërdorim detyre" dhe "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	36,137
3		Rrëshen	4	Neni 248 dhe 258 i KP "Shpërdorim detyre" dhe "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	726
4		Pogradec	6	Neni 248 dhe 258 i KP "Shpërdorim detyre" dhe "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	7,981
5		Kucovë, Qarku Berat	5	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	9,847
6		Kavajë	7	Neni 258 i KP "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	9,605
7		Kavajë	5	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	
8		Kavajë		Për vlerësim	
9		Kukës	3	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	
10		Patos	4	Neni 258 i KP "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	903

Nr		Subjekti	Persona në numër	Vepra penale	Dëmi në 000/lekë
Komuna:					
11	5	Armen, Vlorë	1	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	6,177
12		Perondi, Qarku Berat	7	Neni 248 dhe 258 i KP "Shpërdorim detyre" dhe "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	14,340
13		Gryk-Çaje, Kukës	3	Neni 258 i KP "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	
14		Novoselë	3	Neni 248 dhe 258 i KP "Shpërdorim detyre" dhe "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	
15		Velipojë	10	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	
Institucione qendrore					
16	4	Dogana Tiranë	2	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	
17		DPD Berat	6	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	
18		DPD Tiranë	1	Për vlerësim	
19		DRT Berat	3	Neni 248 dhe 181/a I KP "Shpërdorim detyre" dhe "Moskryerja e detyrave nga organet tatimore"	
Institucione qendrore					
20	7	Ministria Arsimit dhe	2	Neni 248 dhe 258 i KP "Shpërdorim detyre" dhe "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në	78,745

**Kontrolli i Lartë i Shtetit**

Nr		Subjekti	Persona në numër	Vepra penale	Dëmi në 000/lekë
		Sporteve		tendera apo ankande publike"	
21		Ministria Arsimit dhe Sporteve	1	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	29,275
22		Ministria Brendshme	12	Neni 258 i KP "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	42,137
23		Ministria Brendshme		Për vlerësim	
24		Ministria Mbrojtjes	7	Neni 258 i KP "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	30,800
25		Ministria Mbrojtjes	5	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	89,571
26		MEI/ASH Tiranë	2	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	67,060,000
27	5	KESH Projekti "Fuqizimi i Digave"	1	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	85,396
28		OSHEE Tiranë	3	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	5,532,546
29		OST Tiranë	2	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	868,711
30		AlbPetrol Fier	1	Neni 248 dhe 258 i KP "Shpërdorim detyre" dhe "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	

Nr		Subjekti	Persona në numër	Vepra penale	Dëmi në 000/lekë
31		AKBN Tiranë	1	Për vlerësim	11,503,500
32	6	ZVRPP Sarandë	3	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	6,242
33		ZVRPP Elbasan	4	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	
34		ZVRPP Pogradec	5	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	
35		ZVRPP Fier	5	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	
36		ALUIZNI Korçë	3	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	
37		ALUIZNI Fier	3	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	
38	14	FSDKSH Tiranë	4	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	
39		ISSH Tiranë	3	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	544
40		Drejtoria Shërbimit të Trupit Diplomatik		Për vlerësim	
41		POSTA sh.a. Tiranë	1	Neni 248 dhe 164 i KP "Shpërdorim detyre" dhe "Shpërdorim kompetencash"	
42		POSTA sh.a. Tiranë	1	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	

**Kontrolli i Lartë i Shtetit**

Nr		Subjekti	Persona në numër	Vepra penale	Dëmi në 000/lekë
43		QKR Tiranë	2	Neni 258 i KP "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	8,208
44		QSUT Tiranë	3	Neni 258 i KP "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	10,803
45		Rezidenca Studentore Universitare Tiranë	2	Neni 248 dhe 258 i KP "Shpërdorim detyre" dhe "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	16,452
46		Shtypshkronja e Letrave me Vlerë	1	Neni 258 i KP "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	
47		Spitali Durrës	2	Neni 258 i KP "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	
48		Ujsjellës kanalizime Korçë	1	Neni 248 i KP "Shpërdorim detyre"	
49		AKK BARNAVE		Për vlerësim	
50		AKT Tiranë	1	Neni 248 dhe 258 i KP "Shpërdorim detyre" dhe "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"	15,533
51		ALBAFILM sh.a., Tiranë	3	Neni 248 dhe 186 i KP "Shpërdorim detyre" dhe "Falsifikimi i dokumenteve"	17,976
51		Kallëzime	160	Persona	85,487,190

## AUDITIMI I PERFORMANCËS NË KLSH

### Përkufizimi i Konceptit dhe Trendi Bashkëkohor

*“Auditimi i Performancës është një shqyrtim i pavarur i eficiencës dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizmave të saj, me fokus të veçantë ekonomikitetin dhe me synim përmirësimin”.* Ky është përkufizimi i përgjithshëm që jep INTOSAI në standardet e veta 3000-3100, të cilat adresojnë pikërisht këtë lloj auditimi në nivel institucionesh supreme të auditimit. Auditimi i performancës mbështetet mbi vendimet e marra ose objektivat e përcaktuara nga ekzekutivi dhe mund të kryhet për të gjithë spektrin e sektorit publik. Ai dallon nga auditet standarde financiare dhe ato të ligjshmërisë, sepse është më fleksibël në përzgjedhjen e subjekteve, objekteve, metodave dhe dhënien e opinionëve. Nga vetë natyra e tij, ky lloj auditimi ndërthur metodat investigative me ato shkencore të kërkimit dhe përpunimit të informacionit, operon mbi baza të larmishme dijesh dhe eksperiencash, është më i hapur ndaj gjykimeve dhe interpretimeve dhe nuk kryhet sipas një protokolli standard paraprak. Është kusht vital për cilësinë e këtij lloji auditimi, që të aplikohen perspektiva të ndryshme e për rrjedhojë dhe audituesit duhet të vijnë nga sfera të ndryshme të aktivitetit njerëzor.

Auditimi i performancës është një nga mënyrat moderne përmes të cilit taksapaguesit, financierët, vendim-marrësit, ekzekutuesit, media dhe shoqëria në përgjithësi “ushtrojnë kontroll” dhe penetrojnë në mënyrën se si kryhen punët dhe si arrihen rezultatet. Kriteret e këtij lloji auditimi janë të shumta dhe përmenden: vlera e shtuar, zinxhirët kompleksë të politikave, prania e risqeve, ndërhyrjet strukturore, obligimet ndërkombëtare, emergjenca sociale, materialiteti financiar, vizibiliteti i programit, mundësia për auditim, etj., etj.

Auditimi i performancës nuk ka si synim të kritikojë sipërmarrjet qeveritare. Duke evidentuar shkaqet, proceset, funksionet, kapitalin human dhe financiar të përfshirë në kryerjen e “biznesit” qeveritar, ky lloj auditimi synon korrektimet e duhura, aplikimin e teknikave më të fundit shkencore, përmirësimin e 3 “e”-ve dhe tek e fundit rritjen e mirëqënies sociale përmes aktivitetit ekonomik publik. Auditimi i performancës është në vetvete formë modernizimi për atë që auditohet dhe atë që auditon.

Por cilat janë shtyllat kryesore mbi të cilat mbështetet auditimi i performancës? Të gjitha programet dhe sipërmarrjet qeveritare (dhe pjesa më e madhe e proceseve

që ato gjenerojnë) munden, të paktën teorikisht, të analizohen nën lupën e një formule që përshkruan se si ato lëvizin nga një pozicion në tjetrin, duke shfrytëzuar burime të ndryshme, me qëllim arritjen e objektivave të caktuara. Në auditimin e performancës, formula që studion mbarëvajtjen e punëve mbështetet mbi dy pyetje-shtylla kryesore:

A po bëhen gjërat siç duhet?

A po bëhen gjërat që duhen?

Pyetja e parë fokuson kryesisht “prodhuesin” dhe adreson problemin nëse vendimet e marra po zbatohen siç duhet. Kjo pyetje zakonisht shoqërohet me një perspektivë normative, që do të thotë se audituesi kërkon të dijë nëse zbatuesi i procesit i është përmbajtur rregullave ose kërkesave. Me qëllim zgjerimin e analizës, pyetja mund të shtrihet edhe mbi faktin nëse aktivitetet e realizuara janë ato të duhurat – duke e marrë të mirëqenë që proceset e përzgjedhura janë të mira. Deri në këtë fazë të procesit, auditimi i performancës fokusohet kryesisht mbi ekonomicitetin dhe efiçiensën e operacioneve (aspekti mikro).

Objekti i analizës zgjerohet së tepërmi me pyetjen e dytë – nëse po bëhen apo jo gjërat e duhura. Me fjalë të tjera, nëse janë aplikuar politikat e duhura siç duhet, apo janë përdorur burimet adekuate. Kjo pyetje i referohet efektivitetit ose ndikimit në shoqëri. Në fakt, pyetja mund edhe të nënkuptojë se një sipërmarrje qeveritare – ose një masë e përzgjedhur për të arritur një objektiv specifik – po i ekspozohet riskut që të konstestohet nga audituesi. Një auditues performance, për shembull, mund të zbulojë një masë që është inefektive dhe jo në përputhje me objektivat. Por, në momentin që audituesi fillon të dyshojë nëse vetë përkushtimi publik është ose jo i arritshëm, ai/ajo duhet të tregojë kujdes për të mos tejkaluar kornizën e punës së vet duke shkëlur kufirin dhe duke u futur në territor politik.

Funksioni i auditimit të performancës nga Institucionet Supreme të Auditimit nisi të aplikohet në fundin e viteve 60, nga GAO amerikane. Ky lloj auditimi në Amerikë është shtrirë që prej atëherë në nivelet shtetërore dhe lokale të vendimmarrjes financiare. Shumë vende të tjera kanë sot një ekspertizë të pasur në auditet e performancës. Mund të përmenden NAO britanike, Bunderechnungshof-i gjerman e ai austriak, Algemene Rekenkamer-i holandez apo dhe Gjykata Sllovene e Auditimit. Në secilin e prej këtyre vendeve, auditimi i performancës së institucioneve publike siguron jo vetëm rritjen dhe përmirësimin ekonomik të vendit, por është një formë

e shprehjes së zbatimit të ligjit, rritjes së transparencës, përfshirjes sociale në vendimmarrje, pra tek e fundit një formë e aplikimit të demokracisë.

Një qeverisje e mirë shprehet përmes një performace të mirë dhe vendet e zhvilluara perëndimore e kanë kthyer fokusin e tyre pikërisht tek auditet e performancës. Dekadat e fundit kanë qenë dëshmitare të ndryshimeve të thella ekonomike, sociale, politike, klimatike e demografike. Lëvizjet e popullsisë, ndryshimi i moshës mesatare të saj, rritja e kufizimeve në energji, burime ekonomike e monetare, kërkesat për rritje të vazhdueshme të mirëqënies, etj., të gjitha këto kanë rritur ndërgjegjësimin e publikut për aktivitetin ekonomik qeveritar.

Të amplifikuara edhe nga kriza e viteve të fundit, performanca është bërë sot një çështje e të gjithëve, qofshin këta punonjës të sektorit privat apo atij publik. Pikërisht për këto arsye, në secilin prej vendeve të sipërpërmendura, këto lloj auditesh zënë rreth 30-40% të punës audituese. Me përdorimin e mjeteve moderne të komunikimit të informacionit, ndikimi që raportet e institucioneve supreme të auditit kanë mbi performancën ekonomike qeveritare është sot më i madh se ndonjëherë. Vetëm në Slloveni, Gjykata e Llogarive citohet nga mediat 8-10 herë në muaj për gjetjet e saj, duke qenë kështu një nga institucionet avangardë në ruajtjen e fondeve dhe transparencës publike. Në Holandë, raportet e auditëve të performancës citohen dhe futen në referencat e doktorantëve, planeve strategjike të zhvillimit të institucioneve, manualet e operacioneve, etj. Në Britani, auditet e performancës nuk kufizohen vetëm në çështjet apo institucionet britanike, por e kanë kthyer vëmendjen mbi probleme në rang planetar e global, siç janë problemet e klimës dhe ato të energjisë. Gjithçka ka vetëm një emërues të përbashkët: rritjen e ndërgjegjësimin të strukturave vendimmarrëse, me synim përmirësimin e bërjes së gjërave, në mënyrë shkencore dhe bashkëkohore.

Në vitet 2013, 2014 e 2015 auditimi i performancës është shndërruar në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Institucioni po përballet çdo ditë me një sfidë të fortë për ta përqëndruar punën tek auditimi i performancës, pse ai i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike. Sfidë më e madhe për këtë lloj auditimi është që ai mos të zbatohet thjesht si procedurë, por të konceptohet si një filozofi e të menduarit dhe vepruarit nga i gjithë stafi i KLSH-së. Një filozofi pune që konsideron se auditimi nuk është një qëllim në vetvete, por në rradhë të parë një




instrument parandalimi, instrument korrigjimi dhe këshillimi për institucionin që auditohet.

Fushat ku është orientuar veprimtaria audituese për periudhën 2012-2015:


1. Reformat qeveritare;
2. Projektet & shërbimet social-ekonomike;
3. Projektet infrastrukturore;
4. Projektet mjedisore & energjitike;
5. Projektet & shërbimet social-kulturore.

Gjatë periudhës Qershor 2014 – Dhjetor 2015, KLSH ka iniciuar, realizuar dhe evaduar në total 12 auditime performance.



Ecuria e auditimeve të performancës ka ardhur në rritje, si në terma të cilësisë, ashtu edhe të sasisë.





Nga një krahasim midis periudhave 2008-2011 dhe 2012-2015 konstatohet se përgjatë periudhës 4 vjeçare 2012-2015 numri i auditimeve është trefishuar ndërsa numri i institucioneve të audituar është katërfishuar.



Konstatohet një trend në rritje e auditiveve të performancës si dhe subjekteve të audituar duke rezultuar me një trefishim të numrit të auditimeve në vitin 2015 kundrejt vitit 2012.



Përgjatë vitit 2015 janë evaduar auditimet e më poshtme dhe në përfundim të auditimit KLSH ka adresuar mesazhet kryesore të auditimit.



### 1. Implementimi i Politikave Mjedisore

Mesazhi i Auditimit: Ministria e Mjedisit megjithëse ka hartuar kuadrin legjislativ të përafuar me kërkesat e fushës të BE-së, nuk ka realizuar plotësisht aktet nënligjore përkatëse, kryesisht lidhur me Direktivat mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Krimin Mjedisor. Veç sa më sipër, mungesa e zbatimit të legjislacionit mjedisor vazhdon të mbetet problem me ndikime të konsiderueshme negative në cilësinë e ajrit, për shkak të klimës së mos ndëshkueshmërisë së krimit mjedisor.

Performanca e institucioneve dhe punonjës përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin e cilësisë së ajrit është e ulët për shkak edhe të mungesës së fondeve, mospërputhjes së kërkesave të vendit të punës me përgatitjen profesionale të tyre

dhe për pasojë nivelin e ulët të ndëgjegjës juridike për të dhënë zgjidhje ligjore problemeve mjedisore.

Si rezultat, taksapaguesit dhe opinioni publik edhe pse gëzojnë të drejtën kushtetuese për t'u informuar mbi gjendjen e mjedisit në të cilin jetojmë, informohet dhe konsultohet në mënyrë jo të plotë për këto çështje.

---

## 2. Projekti për shërbimet bujqësore

Mesazhi i auditimit: Projekti i Shërbimeve Bujqësore 2003–2009 i ka arritur pjesërisht objektivat e veta për zhvillimin e bujqësisë dhe uljen e varfërisë së popullsisë rurale pasi: nuk ka siguruar zhvillimin e pritur në sektorin e farërave; ka dështuar në konsolidimin dhe lehtësimin e procedurave të tregut të tokës bujqësore; ka përmirësuar procesin e marketingut bujqësor vetëm në dy zona nga 6 të përfshira në projekt; ka qenë i fragmentarizuar dhe jo i qëndrueshëm transferimi i njohurive dhe teknologjive bujqësore, të gjitha këto si rezultat monitorimit të dobët nga paaftësia e Njësisë së Zbatimit të Projektit, si dhe ndikimet e këtyre investimeve pas përfundimit të projektit kanë qenë në nivele të ulta, për shkak të mungesës së strukturave monitoruese nga institucionet përfituese.

---

## 3. Trashëgimia Kulturore

Mesazhi i auditimit: Shumë pak është bërë nga entet përgjegjëse shtetërore në miratimin e politikave dhe monitorimin e vazhdueshëm të proceseve për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike dhe asaj Monumentale, pasuri e brezave, si detyrimi ynë madhor kundrejt së shkuarës dhe së ardhmes.

---

## 4. Eficienca e Energjisë

Mesazhi i auditimit: Megjithëse Shqipëria ka kryer jo plotësisht përafrimin e legjislacionit sipas kërkesave të BE-së dhe ka hartuar Draftplanin Kombëtar të Veprimit të Burimeve të Rinovueshme dhe Eficiencës së Energjisë, nuk ka arritur të përmirësojë qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike, pasi: Strategjia Kombëtare e Energjisë nuk është monitoruar dhe zbatuar sipas skenarëve përkatës; Plani Kombëtar i Veprimit prej më se tre vitesh nuk është miratuar akoma; ligji për burimet e rinovueshme vazhdon të jetë në proces përditësimi edhe pas më shumë

se dy vitesh pa aktet e tjera nënligjore; si dhe kanë munguar iniciativat publike në këtë fushë për shkak të performancës së dobët të MEI-t dhe AKBN-së nga mungesa e financimeve buxhetore dhe ndarjes e dublikimit të kompetencave administrative brenda dhe midis tyre.

---

### 5. Liberalizimi i shërbimit të kontrollit fizik të mjeteve

Mesazhi i auditimit: Qeveria shqiptare, të nxisë një plani veprimi në fushën e shërbimit të kontrollit teknik të mjeteve, përmirësimin e funksionimit të tregut të brendshëm duke promovuar shërbime të sigurta, me synim përfundimin e një qasjeje të re në shërbim të qytetarit.

---

### 6. Respektimi i të drejtës së autorit

Mesazhi i auditimit: Pavarësisht një plani të mirëdetajuar, pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Industriale dhe Intelektuale 2010-2015, që synonte përmirësimin e ndjeshëm të respektimit të së drejtës së autorit, vonesa në miratimin e një ligji të cilin do të reflektoheshin praktikatat më të mira botërore dhe evropiane, si dhe mungesa e koordinimit të veprimeve të institucioneve të ngarkuara me monitorimin e respektimit të kësaj të drejte, ka sjellë si pasojë respektimin në nivel të ulët të drejtave të autorëve/interpretuesve në fushën e muzikës dhe kinematografisë.

---

### 7. Efektiviteti i strategjisë kombëtare për barazinë gjinore

Mesazhi i auditimit: SKBGJ-DHBGJDHF rezulton të jetë pjesërisht efektive. Ekziston kuadri ligjor për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje por është i pa plotë dhe ka nevojë për përmirësim. Nuk funksionon mekanizmi i cili duhet të ofronte mbrojtjen administrative. Aktorët e MKR, policia, prokuroria duhet të marrin përsipër përgjegjësitë që iu ngarkon ligji. Burimet financiare dhe ato njerëzore janë të pa mjaftueshme. Niveli profesional i personave që ofrojnë shërbimet është në përputhje me pozicionet përkatëse por mungojnë trajnimet specifike profesionale dhe teknike të stafit sipas nevojave. Strukturat përgjegjëse kanë miratuar standardet e shërbimeve bazuar në ato ndërkombëtare por implementimi i tyre në terren lë për të dëshiruar. Ekzistojnë mundësitë që shërbimet sociale për këtë grup

shoqëror vulnerabil të ofrohen nga operatorët privatë të licencuar në këtë fushë dhe ku fitues përzgjidhet ofruesi i cilësisë më të lartë të shërbimit dhe jo çmimit më të ulët të tij.

---

#### 8. Performanca e Inspektoriatit Qendror Teknik

Mesazhi i auditimit: Mbrojtja e konsumatorit shqiptar në drejtim të furnizimit me naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre me cilësi brenda standardeve nga ana e ISHTI është e mangët, për shkak të kuadrit rregullator të pa bashkërenduar dhe harmonizuar mirë për funksionimin e këtij institucioni; të burimeve njerëzore të pa trajnuara, të pa testuara, të pakualifikuara dhe të keqmenaxhuara; zbatimit me mangësi të procedurave të inspektimit; mungesa e materialeve dhe modernizimit të pajisjeve laboratorike dhe kryerja e një numri të kufizuar të treguesve analizave; problemet në investimet dhe menaxhimin financiar, si dhe reduktimi i subjekteve të ndëshkuara dhe mos vjelja e gjobave.

---

#### 9. Performanca ekonomiko-financiare e QEZHEF

Mesazhi i auditimit: Pushteti vendor në bashkëpunim me Qeverinë, të nxisë një plani veprimi në unifikimin dhe përmirësimin e performancës së menaxhimit të shërbimit në çerdhe e kopshte me synim përfundim dhe një qasjeje të re në shërbim të fëmijës dhe personalitetit të tij, sepse kjo çështje na prek të gjithëve dhe të gjithë duhet të jemi pjesë e zgjidhjeve.

---

#### 10. Performanca e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Mesazhi i auditimit: AMF, në përmirësim të performancës së vet për arritjen e objektivave ligjorë kah garantimit të aftësisë paguese të tregut të sigurimeve, duhet të ndërtojë:

1. një kuadër rregullativ më efektiv në vendosjen e kriterit të aftësisë paguese, në përputhje me Direktivat e BE-së, që siguron qëndrueshmëri dhe besueshmëri më të lartë të tregut, si dhe ndërhyrjen në kohë të rregullatorëve për eliminimin e problemeve;
2. një sistem efektiv mbikëqyrës në monitorimin dhe verifikimin e besueshmërisë dhe transparencës së shëndetit financiar të tregut, duke kaluar fokusin nga

vlerësimi i përputhshmërisë tek profili dhe cilësia e menaxhimit të riskut të siguruesve;

3. skema më efektive dhe transparente në hetimin, vendim-marrjen dhe zbatimin e masave të zbatueshmërisë dhe që synojnë të japin siguri në respektimin e ligjit dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.
- 

### 11.Kurrikulat universitare dhe avancimi në karrierën akademike

Mesazhi kryesor i auditimit: Kurrikulat universitare reflektojnë shkëputjen e arsimit të lartë publik nga tregu i punës. Ato janë të pambështetura nga studime vendase dhe kanë frekuencë të lartë ndryshimi, duke mos krijuar një traditë të konsoliduar arsimimi.

Avancimi në karrierën akademike i studiuesve të rinj është fiktiv, artificial dhe pa vlerë të shtuar në tregun vendas e ndërkombëtar të kërkim-studimit apo tregut të punës.

---

### 12.Mbi efektivitetin dhe ekonomikitetin e ambienteve të marra me qira nga administrata doganore

Në përputhje me misionin e saj Administrata Doganore, duhet të ndryshojë këndvështrimin e saj në funksion të një zgjidhje afatgjatë e të përhershme të problemit, me qëllim minimizimin e kostove, duke patur në fokus rritjen e cilësisë së punës së administratës dhe shërbimit ndaj tatimpaguesve. Gjë e cila mund të arrihet nëpërmjet analizave të kosto/përfitim me një qëllim final përdorimin me efektivitet, eficeincë dhe ekonomikitet të parasë publike, si dhe maksimizimin e vlerës së saj.

Krahas sa më sipër janë ne proces auditimi dhe tre auditime te tjera dhe konkretisht:

1. Dëmshtëpërblimi për të përndjekurit politik;
2. Shërbimi i transportit publik në qytetin e Tiranës;
3. Arsimi i mesëm profesional në Shqipëri.

### III. MENAXHIMI INSTITUCIONAL

Boshti kryesor i filozofisë menaxheriale institucionale është fokusimi në përmbushjen e objektivave strategjike në kuadrin e reformimit institucional për përafrimin e kuadrit rregullator ligjor dhe metodologjik të veprimtarisë së KLSH-së në një linjë me standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

Dokumenti standard i INTOSAI-t ka një grup treguesish për të matur performancën e SAI-ve kundrejt praktikave më të mira ndërkombëtare në drejtim të menaxhimit institucional në gjashtë fusha:

1.Pavarësia dhe Korniza Ligjore, 2.Strategjia për Zhvillimin Organizativ, 3.Standardet e Auditimit dhe Metodologjia, 4.Menaxhimi dhe Strukturat Mbështetëse, 5.Burimet Njerëzore dhe Komunikimi, si dhe 6. Menaxhimi i Palëve të Interesuara.

KLSH, në bazë të kornizës së treguesve të performancës së SAI-ve, si dhe të mjedisit dhe kushteve specifike të vendit, ka përcaktuar 7 tregues kryesore performance në kolonën e veprimtarisë së menaxhimit institucional, dhe pikërisht: 1. Kuadri ligjor dhe 2. Strategjia e KLSH; 3. Zhvillimi i burimeve njerëzore; 4. Kontrolli i cilësisë; 5. Transparenca dhe komunikimi; 6. Aftësia për partneritet (me partnerë vendas dhe të huaj); 7. Kërkimi shkencor dhe botimet.

#### 1. Progresi i zhvillimit institucional pas miratimit të ligjit të ri 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

Ligji Organik i KLSH-së në vetvete reflekton praktikën më të mira të kuadrit rregullator të Institucioneve Supreme të Auditimit. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 154/2014, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH u angazhua tërësisht për hartimin e kuadrit rregullator për të përmbushur detyrimet e tij institucionale në plotësimin dhe miratimin e akteve përkatëse nënligjore në zbatim të këtij ligji si dhe orientimin e veprimtarisë institucionale në përputhje me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare ISSAI.

Menjëherë pas miratimit të ligjit organik të KLSH-së me Vendimet respektive të Kryetarit u ngritën grupet e punës për përgatitjen e finalizimin e disa dokumenteve bazike të veprimtarisë së KLSH-së dhe konkretisht hapi i parë ishte procesi i *rishikimi të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2013-2017* dhe planit të veprimit për periudhën 2015-2017 miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr 42 datë



31.03.3015.

Domosdoshmëria e rishikimit të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2013-2017 e KLSH-së, erdhi si pasojë e mosrealizimit të disa targeteve dhe aktiviteteve të planifikuara për tu realizuar gjatë viteve 2013-2014, dhe u krye pas dy vitesh, për shkak të dy faktorëve pengues që kategorizohen si faktorë të jashtëm dhe që nuk mund të ndikoheshin nga veprimtaria e KLSH-së. Përmendim:

- Miratimi me vonesë i Ligjit Organik "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".
- Mosbërja efektive e projektit të binjakëzimit IPA 2013 në afatet e parashikuara (Projektuar të fillohej në vitin e dytë të strategjisë, viti 2014 dhe në fakt është parashikuar të fillojë në mars 2016)

Në Raportin Bazë të Vlerësimit të Parimeve të Administratës Publike hartuar nga SIGMA OECD-së i cili ishte bazë për Raportin e Progresit të BE-së për Shqipërinë për vitin 2015 theksohet që:

*"Pavarësia, mandati dhe organizimi i KLSH-së janë të vendosura dhe të mbrojtura me Kushtetutë dhe me ligjin e ri për KLSH të 2015. KLSH ka zhvilluar Planin Zhvillimor Strategjik 2013-2017 në mënyrë që të përputhet me ISSAI-t. Zbatimi i këtij plani ka çaluar, kryesisht për shkak të faktorëve të jashtëm".* Strategjia e zhvillimit institucional dhe plani i veprimit është një nga dokumentet themelor, referues për zhvillimin dhe instalimin e politikave dhe sistemeve efektive dhe eficiente në KLSH.

Bazuar në Strategjinë e ripunuar *të gjitha politikat menaxheriale institucionale* janë fokusuar në implementimin e Objektivave Strategjike të KLSH-së dhe Planin e Veprimit, për periudhën në vijim.

## 2. Hartimi i Strategjisë së implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit

Në zbatim të objektivit strategjik "rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit" KLSH në mars të vitit 2013, ka nënshkruar Marrëveshjen e Angazhimit me përfaqësues të IDI dhe EUROSAT-t për Programin e "3i" Iniciativa e Implementimit të ISSAI-ve. Në kuadër të këtij programi, vendet anëtare të IDI, pjesë e të cilit është dhe Shqipëria, angazhohen për të hartuar Strategji, të cilat sigurojnë jo vetëm përshtatjen e Standardeve ISSAI, por mbi të gjitha pajtueshmërinë në implementimin e tyre.

Për këtë një grup i posaçëm u angazhua për hartimin e strategjisë dhe me Vendimin nr. 58, datë 30.06.2015 të Kryetarit është miratuar Strategjia dhe Plani i Veprimit të implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit 2015-2016, dhe hartimin e Standardeve Kombëtare të Auditimit në vitin 2017.

### 3. Hartimi i manualeve të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë

Në kuadër të zbatimit të kërkesave të Strategjisë së Menaxhimit institucional 2013-2017 (të ripunuar), të Strategjisë së Implementimit të ISSAlve dhe të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 Shtylla 6 "Mbikëqyrja e auditimit të jashtëm" u ngritën Grupet e punës për hartimin e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe Manualin e Auditimit Financiar.

Këto manuale aktualisht i janë dërguar Delegacionit Europian dhe SIGMA-s për dhënie mendimi dhe opinionin në funksion të përmirësimit të tyre.

*Të dy Manualet janë hartuar bazuar në kërkesat e standardeve ISSAI, të përcaktimit të prioriteteteve dhe hartimit të Strategjisë së Implementimit të Standardeve Ndërkombëtare ISSAI 2015-2016, në kërkesat e Udhërrëfyesve të IDI-t INTOSAI, ISSAI-ve dhe praktikave më të mira të fushës (Manuali i Gjykatës Europiane të Audituesve) dhe konkretisht:*

- *ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik" që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;*
- *ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë" që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;*
- *ISSAI 200 "Parimet themelore të auditimit financiar" që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare;*
- *ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë";*
- *ISSAI 4100 "Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë për auditimet që kryhen veçmas nga auditimi i pasqyrave financiare";*
- *Standarde Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;*

- *Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Europiane të Audituesve;*
- *Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e Përputhshmërisë dhe Auditimin Financiar";*
- *Praktikat më të mira të fushës.*

### *Aplikimi i instrumentit:*

Nga kryerja e vlerësimit bazuar në instrumentin e indikatorëve të performancës (Fusha e Standardeve dhe Metodologjisë së Auditimit) referuar dimensioneve dhe aspekteve të vlerësuara rezulton se si Manuali i Auditimit Financiar dhe Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë plotësojnë në nivele maksimale (4 pikë) kërkesat e dimensioneve si me poshtë:

- Standardet e Auditimit
- Etika dhe pavarësia
- Sistemi i kontrollit të cilësisë
- Menaxhimi dhe aftësitë e audituesve.

#### 4. Hartimi i Kodit të ri të etikës së KLSH-së

Referuar faktit se *Etika dhe integriteti janë komponentë kyç dhe parakushte* për krijimin e besimit tek Institucioni Suprem i Auditimit, KLSH përgjatë vitit 2015 u angazhua edhe në hartimin e një kodi të ri të etikës i cili u miratua me Vendimin e Kryetarit nr 56 datë 30.04.2015.

Kodi Etik i KLSH-së reflekton praktikatat më të mira të fushës duke u hartuar si një dokument integral ku janë përfshirë: Kodi Etik i KLSH-së, Kodi Etik i Gjykatës Europiane të Audituesve dhe ISSAI 30-Kodi i Etikës i INTOSAI-t.

Mund të konfirmohet se në Kodin e Etikës të KLSH-së për herë të parë një sërë parimesh dhe vlerash etike janë trajtuar në një profil dhe optikë bashkëkohore dhe në reflektim të sfidave me të cilat përballen audituesit publikë në nivel global.

Dimensioni etik në përgjithësi dhe ai integritetit në veçanti janë trajtuar jo vetëm si një kërkesë që duhet të përmbushet nga i gjithë stafi i KLSH-së por vlerat etike dhe integriteti janë trajtuar në një profil dhe nivel institucional si një nga përparësitë e veprimtarisë menaxheriale që tenton në krijimin e një stature institucionale që KLSH të jetë dhe funksionojë si model i ekسلencës etike dhe që udhëheq sipas shembullit.

## 5. Ndryshimet e strukturës organizative

Ndryshimet dhe zhvillimet që kanë ndodhur në ambientin veprues të KLSH-së gjatë viteve të fundit, pritshmëritë që erdhën si rezultat i miratimit të Ligjit të Ri, nxorën në pah nevojën për rishikim dhe përshtatje të strukturës organizative dhe formave të bashkëveprimit midis njësive të Institucionit. Tashmë KLSH disponon një strukturë organizative efektive, e cila përshtat më së miri qëllimet institucionale me detyrat dhe angazhimet e çdo njësie organizative: departamenti, drejtorie apo sektori, në kuadrin e objektivave strategjike të Institucionit.

Në funksion të arritjes së pritshmërive për modernizimin institucional si dhe implementimin e standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI është krijuar dhe funksionon Departamenti i Politikave të Auditimit, boshti kryesor i veprimtarisë të të cilit është hartimi i politikave të auditimit dhe mbështetja e Departamenteve të auditimit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre audituese.

Në funksion të objektivit të KLSH për të bërë pjesë të praktikave të saj audituese dhe Auditimet e Teknologjisë së Informacionit u jetësuan me krijimin e një drejtorie të veçantë atë të Drejtorisë së Auditimit të TI-së, si pjesë e Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Po kështu përgjatë vitit 2015 u ripunua thellësisht rregullorja e mëparshme dhe u hartua Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit Administrativ të KLSH-së miratuar me Vendimin e Kryetari nr. 85 datë 30.06.2015.

Kjo rregullore përmban rregullat për organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së bazuar në parimet e zbatimit me korrektesë të legjislacionit në fuqi, të rritjes së cilësisë së veprimtarisë audituese dhe rritjes së transparencës ndaj publikut.

## 6. Zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore të institucionit

Impakti i drejtpërdrejtë dhe rëndësia e madhe në cilësinë e veprimtarisë audituese, e ka shndërruar zhvillimin e burimeve njerëzore të institucionit, në një nga sfidat më të rëndësishme të KLSH-së.


Menaxhimi efektiv dhe profesional i Burimeve Njerëzore është jetik për të ndihmuar një institucion që ta arrijë këtë.

Duke u mbështetur në udhëzimet dhe praktikat më të mira për ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të Institucioneve Supreme të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vijuar të investojë në zhvillimin e burimeve njerëzore.

### *Zhvendosja e strukturës së punonjësve drejt trupës audituese*

Nga nja analizë e strukturës së burimeve njerëzore rezulton një zhvendosje gjithnjë e më e madhe drejt trupës audituese.

Në total numri i stafit Kryeauditues dhe atij Auditues në vitin 2015 është 123 punonjës (nga 119 në vitin 2014, 113 në vitin 2013, 110 punonjës në 2012 dhe 2011) që zë rreth 72% të numrit total të punonjësve, pra struktura e punonjësve ka vijuar të ndryshojë në favor të stafit auditues.




Klasifikuar sipas arsimimit, në strukturën organike për vitin 2015, punonjësit me arsim të lartë zenë 162 punonjës, ose në masën rreth 94.7% kundrejt numrit total të punonjësve, nga 157 punonjës, ose në masën rreth 95% që rezultojnë në vitin 2014, nga 149 apo 94% që rezultojnë në vitin 2013, 145 punonjës, ose në masën 93% në vitin 2012, dhe 141 punonjës ose 90% që rezultojnë në vitin 2011.

Të ndarë sipas profilit të diplomimit, klasifikimi i punonjësve me arsim të lartë paraqitet si më poshtë:

Profili i diplomimit	2011		2012		2013		2014		2015	
	në numër	në %	në numër	në %	në numër	në %	në numër	në %	në numër	në %
Financierë	26	16.6	35	22.4	37	23	36	21.6	34	20
Kontabilistë	19	12	18	11.5	15	9.3	13	8	10	5.8
Ekonomistë	53	34	44	28.2	43	26.7	43	26	47	27.4
Juristë	17	10.9	21	13.4	24	15	24	14.5	29	17
Inxhinierë	23	14.7	17	11	20	12.4	26	15.6	29	17
Diploma të tjera	9	5.7	9	5.7	9	5.6	13	7.8	13	7.6

Grafikisht struktura për vitet 2011-2015 paraqitet:



Me qëllim përmirësimin e performancës së tyre si dhe për të fituar njohuri, aftësitë dhe teknika të reja, si dhe në zbatim të Urdhëzimit të Kryetarit të KLSH-së, nr. 3, datë 15.09.2012, "Rekomandime për përsosjen arsimor-profesionale të audituesve të KLSH-së" një pjesë e punonjësve kanë përfunduar studimet në degë të dyta apo në certifikata të ndryshme të cilat bëjnë të mundur që ato ti përdorin aftësitë e tyre

që tashmë i kanë, në mënyrë më efektive në situata të reja dhe përkatësisht:

2 punonjës ka gradën Prof.As.Dr.;

3 punonjës kanë gradën "Doktor i Shkencave";

14 (8.1%) punonjës kanë një diplomë të dytë nga të cilët 9 në Drejtësi, 3 në Financë dhe 2 në fusha të tjera;

2 punonjës kanë Diplomë Ndërkombëtare në Kontabilitet dhe Auditim (CIPFA);

4 punonjës kanë certifikatën Kontabël i Miratuar dhe 1 punonjës ka certifikatën Ekspert Kontabël;

20 punonjës kanë certifikatën e Audituesit të Brendshëm;

6 punonjës kanë certifikatën e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme (5 punonjës ndjekin këtë kurs dhe në muajin mars pajisen në këtë certifikatë);

8 punonjës kanë certifikata të trajnimeve të zhvilluara on-line nga IDI (Iniciativa për zhvillim e INTOSAI-t);

4 auditues janë trajnuar (internship) pranë Gjykatës Europiane të Audituesve për një periudhë 5 mujore.

Pra në vitin 2015 vërehet një rritje e numrit të punonjësve që kanë marrë certifikata trajnimi në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme apo nga IDI.

### *Procesi i rekrutimit të punonjësve*

Duke vlerësuar e konsideruar si faktor të rëndësishëm menaxhimin e drejtë dhe racional të burimeve njerëzore për sigurimin e cilësisë së punës audituese, si dhe duke patur parasysh faktin që politikat për burimet njerëzore, duhet të mbështesin mbajtjen dhe zhvillimin e një stafi të kualifikuar dhe kompetent, të aftë për të zbatuar planet e auditimit në mënyrë sa më të efektshme, nga ana e institucionit për vitin 2015 ashtu sikundër vitet e kaluara u ndoqën politika korrekte, por edhe efektive në drejtim të rekrutimit të personelit me kualifikim arsimor të duhur e në përgjithësi me eksperiencë, për kryerjen me cilësi e kompetencë të detyrës audituese. Rekrutimi dhe përzgjedhja është pika e nisjes për menaxhimin e burimeve njerëzore. Ai është i lidhur ngushtë me strategjinë, strukturën dhe

funksionet e një SAI. Rekrutimi dhe përzgjedhja janë të rëndësishme pasi ato ndihmojnë SAI-n që të sigurohet që ai ka stafin e duhur me kualifikimet e duhura, aftësitë dhe përvojën për të plotësuar nevojat e tanishme dhe ato që ka në të ardhmen.

Gjatë vitit 2015 janë ndjekur të gjitha procedurat sipas rregullave dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi nëpunësit civil, për rekrutimin e 27 punonjësve, nga 25 punonjës që janë rekrutuar në vitin 2014, 21 punonjës që janë rekrutuar në vitin 2013 apo nga 25 të rekrutuar në vitin 2012.

Në zbatim të nevojave dhe ligjit organik të KLSH, gjatë vitit 2015 janë rekrutuar nëpërmjet akteve të emërimit apo kontratave të përkohshme me afat të përcaktuar 2 punonjës, gjatë vitit 2014 nëpërmjet akteve të emërimit apo kontratave të përkohshme me afat të përcaktuar 2 punonjës krahasuar me vitet 2013 ku janë rekrutuar nëpërmjet kontratave të përkohshme me afat të përcaktuar 6 punonjës, apo krahasuar me vitin 2012 ku janë rekrutuar 3 punonjës me akt emërimi dhe 8 punonjës me kontrata të përkohshme.

### *Zhvillimi dhe nxitja në karrierë*

Kujdes është treguar për zhvillimin e karrierës brenda institucionit, duke e vlerësuar si faktor të rëndësishëm që i shërben drejtimit më të mirë dhe rritjes së cilësisë së punës audituese. Tashmë në KLSH është instaluar sistemi, sipas të cilit zhvillimi profesional dhe përparimi në karrierë realizohet nëpërmjet sistemit të vlerësimit periodik të performancës dhe aftësive individuale, testimit të njohurive nga formimi profesional dhe konkurimit transparent (po aq i rëndësishëm sa procesi i rekrutimit) për pozicionet më të larta të punës .


Nisur nga standardet ndërkombëtare ku një institucion suprem auditimi duhet të ruajë dhe të zhvillojë një staf dinamik, duke përfshirë nxitjen e niveleve të synuara të lëvizjeve si dhe lehtësimin e stafit për të krijuar mundësi për promovimin dhe për integrimin e stafit të ri, gjatë vitit 2015 janë zhvilluar 6 testime dhe është miratuar ngritje në kategori për 27 auditues, gjatë vitit 2014 janë zhvilluar 6 testime dhe janë realizuar 20 ndryshime në kategori, gjatë vitit 2013 janë zhvilluar 3 testime dhe janë realizuar 23 ndryshime në kategori, duke ju dhënë në këtë mënyrë mundësinë zhvillimit të karrierave profesionale brenda institucionit, nëpërmjet konkurimit. Ndërkohë që numërohen 6 raste të uljes në kategori.



*Përbërja sipas funksioneve*


Për vitin 2015 përbërja e punonjësve sipas funksioneve dhe detyrave që kryejnë ka qenë:

- 16 Personel drejtues (ku përfshihen Kryetari, Drejtorët e Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve e të Drejtorive) që përbën 9.3% të numrit total të punonjësve, nga 13 në vitin 2014, 14 në vitin 2013, 2012 dhe 10 në vitin 2011.
- 9 Kryeauditues që përbën 5.3 % të numrit total të punonjësve në vitin 2015 nga 9 (5.4%) Kryeauditues në vitin 2014, 7 (4%) Kryeauditues në vitin 2013, 5 në vitin 2012 dhe 7 në vitin 2011.
- 114 Auditues (66.7%), nga 111 Auditues (67%) në vitin 2014/106 (66%) Auditues në vitin 2013, 105 në vitin 2012 dhe 106 në vitin 2011.
- 23 Punonjës mbështetës (përgjegjës sektori, specialistë, juristë, zëdhënës, punonjës shërbimi) që përbën 13.4% të numrit total të punonjësve për vitin 2015, nga 33 në 2014, nga 28 në 2013, 23 në vitin 2012 dhe 22 në vitin 2011.
- 9 Punonjës shërbimi që përbën 5.2% të numrit total të punonjësve, nga 8 (5%) në vitin 2014, 9 në vitin 2013, 2012 dhe 10 në vitin 2011.




Tregues të tjerë po aq të rëndësishëm për burimet njerëzore janë mosha e punonjësve të institucionit dhe raporti femra/meshkuj gjatë viteve 2011-2015 përkatësisht si më poshtë:

- Moshja mesatare në KLSH në fund të vitit 2015 është 43.8 vjeç nga 46.1 vjeç në vitin 2014, 46.21 vjeç që rezultonte në vitin 2013, 48 vjeç në vitin 2012 dhe 50 vjeç në vitin 2011.



- Vjetërsia në institucion është 7.2 vjet nga 8 vjet në vitin 2014, 8.2 vjet për person që ka qenë në vitin 2013, 5.5 në vitin 2012, 9.1 në vitin 2011.
- Rezultojnë 25 punonjës nën moshën 30 vjeç, nga moshja 31-50 vjeç janë 71 punonjës nga ndërsa mbi moshën 51 vjeç janë 75 punonjës.
- Raporti femra/meshkuj 39.7 % me 60.2% në vitin 2015 nga 39% me 61% që ishte në vitin 2014, 37% me 63 në vitin 2013, 32% me 68 % në vitin 2012, 33.5% me 66.5% në vitin 2011.



Rezultojnë të punësuar në Institutin 68 punonjëse femra, 11 prej të cilave në pozicione drejtuese (Sekretare e Përgjithshme, Drejtore e Përgjithshme, Drejtore Departamentit, Drejtore Drejtorie, Kryeaudituese, Përgjegjëse Sektori), 15

punonjëse femra në Departamente, Drejtori dhe Sektorë mbështetës e ndihmës dhe 42 punonjëse femra në pozicione audituese.

*Mbi veprimtarinë e Sektorit të Etikës dhe Integritetit*

Në funksion të sigurimit të një sistemi efektiv të etikës dhe integritetit si dhe forcimit të disiplinës në punë nga Sektori i Etikës dhe Integritetit gjatë vitit 2015, janë kryer gjithsej 711 inspektime nga të cilat 85 në KLSH dhe 626 në subjektet e auditimit në Tiranë dhe në rrethe.

Për të gjitha rastet e konstatuara për thyerje të disiplinës në punë nga audituesit, janë lajmëruar drejtorët e departamenteve përkatëse duke ju propozuar dhe fillimin e ecurisë për dhënie masë disiplinore në 14 raste.

Gjithashtu Sektori i Etikës dhe Integritetit ka kryer kontrole në drejtim të 8 (tetë) ankesave të ardhura në KLSH nga qytetarë të ndryshëm, ku mbas verifikimit të problemit në ankesa sipas rastit është kryer ballafaqimi përkatës duke i kthyer dhe përgjigje në rrugë zyrtare.

*Aplikimi i instrumentit:*

Nga kryerja e vlerësimit bazuar në instrumentin e indikatorëve të performancës për dimensionin e Menaxhimit të Stafit rezulton një vlerësim maksimal (4 pikë) për të gjitha kriteret që kanë të bëjnë me strukturën organizative të stafit;

-Miratimi e përshkrimeve të punës duke mbuluar përgjegjësitë për çdo punonjës;

-Rezultoni një sistem të menaxhimit të konfliktit të interesit (deklarata e Konfliktit të interesit);

-Zbatohen politika dhe procedura kontrolli jo vetëm për veprimtarinë audituese por edhe për zbatimin e kërkesave etike.

7. Trajnimi dhe Zhvillimi Profesional i Stafit.

KLSH përgjatë vitit 2015 ka vijuar të përcaktojë dhe aplikojë politika dhe procedura

për të zhvilluar dhe trajnuar punonjësit e tij për t'i aftësuar që të kryejnë detyrën e tyre në mënyrë efektive duke përcaktuar në këtë mënyrë bazat për avancimit profesional të stafit auditues. Trajnimi i stafit dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional ka qenë në fokus të zhvillimit institucional.

Ngritja e kapaciteteve përmes promovimit të të mësuarit dhe zhvillimit të metodologjisë është pjesë e rekomandimeve të të gjithë faktorëve ndërkombëtarë, e shprehur në strategjinë për zhvillim të KLSH-së.

Gjykata Evropiane e Audituesve, përmes direktivës numër 10/2012 pjesë e raportit "Mbi efektivitetin dhe zhvillimin e stafit në Komisionin Evropian" 2012 – 2013, sugjeron trajnimin e vazhdueshëm të stafit si element kyç në arritjen e rezultateve institucionale.

Komisioni Evropian e shih cilësinë e raporteve dhe rekomandimeve tona si një ndër kriteret për vlerësimin e performancës sonë si institucion. Gjithashtu zhvillimi ynë institucional shihet si një kriter që duhet të plotësohet nga një vend kandidat për Bashkimin Evropian. Komisioni shprehet se e bazon vendimmarrjen e tij në lidhje me politikat brenda BE-së, mbi statistika të certifikuara më parë nga SAI-t e vendeve përkatës, duke evidentuar rëndësinë e zhvillimit institucional.

Fondi Monetar Ndërkombëtar e thekson gjithashtu këtë, për Qeverinë Shqiptare, ku përmes Kodit të Transparencës Fiskale reflektohen praktikat më të mira mbarë botërore, në të cilin përmirësimi dhe niveli i lartë i audituesit të jashtëm siguron një risk më të vogël në vlerësimin e performancës qeveritare.

Në vijim të Rezolutës së Dytë të Kombeve të Bashkuara, kushtuar forcimit dhe mbështetjes së institucioneve supreme të auditimit dhe organizatës së tyre INTOSAI, dhe në zbatim të rekomandimeve të Progres Raporteve të Bashkimit Evropian institucioni ynë përjetoi një hap të madh përpara në përputhje me standardet INTOSAI dhe EUROSAI, përmes ligjit të ri.

Domosdoshmëria për trajnim shprehet qartazi dhe në ligjin e ri në nenin 8 pika 2, ku cilësohet "*Bashkëpunimi nënkupton anëtarësimin, pjesëmarrjen në formë të përshtatshme për auditimin, shkëmbimin e eksperiencave dhe kryerjen e trajnimeve të përbashkëta, ku në çdo rast Kontrolli i Lartë i Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat e Republikës së Shqipërisë*", në nenin 39 "*Trajnimet Profesionale*" ku cilësohet se "Punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit gëzojnë të drejtën për t'u trajnuar profesionalisht, sipas planifikimeve të bëra nga institucioni, në përputhje

me nevojat e evidentuara", si dhe se "Kontrulli i Lartë i Shtetit siguron një proces sistematik dhe të planifikuar të trajnimit, zhvillimit profesional dhe certifikimit, i cili përfshin shtimin dhe përditësimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për kryerjen me efektivitet të detyrave të auditimit, në bashkëpunim me ASPA-n, me institucione të tjera të larta të auditimit apo me organizata profesionale, vendase apo Ndërkombëtare".

Trajnimi në KLSH shihet si një faktor ndryshimi drejt një evolucioni ku secili anëtar i stafit të krijojë vetëbesim, nivel të lartë profesional, bashkërendim të forcave audituese dhe klimë bashkëpunimi.

### *Trajnimi i vazhdueshëm profesional*

Dimensioni i zhvillimit të vazhdueshëm profesional që kontribuon në rritjen e aftësive individuale, të grupit dhe të institucionit ishte shprehur në planin vjetor të trajnimeve për vitin 2015, i cili parashikonte jo vetëm sasinë e ditëve të trajnimit, seminareve dhe konferencave, por edhe një shtrirje të trajnimeve përgjatë gjithë vitit.

Treguesi i Performancës së pjesëmarrjes në trajnime e vendos KLSH-në në nivelet e larta të Institucioneve Homologe të Auditimit të Lartë Ndërkombëtar. Rezultatet e arritura tregojnë për një qasje të qëndrueshme dhe të suksesshme ndaj procesit të trajnimit, si rruga kryesore për zhvillimin profesional.


Duke iu referuar të dhënave informuese lidhur me pjesëmarrjen për periudhën 5 vjeçare, 2011- 2015, është shumë e dukshme se si reformimi i sistemit të trajnimeve si pjesë integrale e reformës institucionale në KLSH është zhvilluar e plotë, duke përfshirë çdo aspekt të ndërtimit dhe forcimit të kapaciteteve; shtrirja e tij ka qenë gjithëpërfshirëse duke i siguruar çdo individ të drejtën dhe mundësinë e të mësuarit dhe të trajnuarit.

Në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 (e ripunuar), politika e zhvillimit të kapaciteteve audituese është përkthyer në 3853 ditë trajnime, nga të cilat 2899 janë zhvilluar nga vetë KLSH dhe 954 ditë trajnime jashtë KLSH-së. Evolucioni i ditë trajnimeve në pesë vitet e fundit paraqitet:

**Ecuria e Trajnimit në 5 vitet e fundit në ditë persona të trajnuar**




Trajnime të organizuara në KLSH, nga ekspertë vendas dhe të huaj paraqitet:



Ecuria e trajnimeve ka arritur pjekurinë e saj, duke reflektuar një konsolidim të procesit. Ditët e trajnimit janë realizuar me një shtrirje përgjatë gjithë vitit duke mbuluar të gjithë personelin.

Grafiku i mëposhtëm tregon progresin tepër të rëndësishëm dhe të madh që është bërë lidhur me pjesëmarrjen në trajnime duke arritur në 27 ditë trajnime për person në vitin 2015:

### Progresi i pjesëmarrjes në trajnime, ditë mesatare trajnimi për punonjës



Gjatë vitit 2015 është mbuluar me trajnim i gjithë stafi i KLSH-së. Trajnimi përfshin të gjithë nivelet e administrimit dhe është hartuar në bazë të nevojave të përpiluara nga diskutimet me Drejtorët e Departamenteve dhe Kryeaudituesit. Për vitin 2016 mbetet që të punohet më tej drejt një përmirësimi të hartimit të planit duke identifikuar nevojat personale dhe zhvillimin individual të gjithsecilit. Trajnimi me module të diferencuara sipas eksperiencës dhe formimit profesional të gjithsecilit mbetet një sfidë për të ardhmen, e kufizuar kjo nga burimet e financimit dhe të trajnimit. KLSH është një institucion në të cilin përfshihen disa profesione si ai i ekonomistit, juristit, inxhinierit, informaticienit, matematicienit etj. Ky diversitet që në vetvete përbën një avantazh dhe duhet të orientohet përmes politikave trajnuese bashkërenduese dhe të diferencuara.

#### *Shkëmbimi i njohurive në funksion të zhvillimit profesional*

Sipas dimensionit të shkëmbimit të eksperiencave dhe bashkëpunimit me SAI në nivel rajonal dhe më gjerë, për gjatë vitit 2015 është realizuar një larmi e burimeve të informacionit.

Burimet kryesore jashtë institucionit ishin trajnimet nga ekspertë të jashtëm, nga institucione të tjera brenda vendit, trajnime dhe seminare jashtë vendit në bashkëpunim me institucionet homologe.


### Burimet kryesore të trajnimit



- Trajnime jashtë vendit
- Trajnime nga ekspertë të huaj
- Trajnime brenda institucionit
- Trajnime nga institucione të tjera brenda vendit
- e learning

Nga këto burime janë realizuar trajnime si në fushën e metodologjisë së auditimit, ashtu dhe në fushën e kuadrit rregullator të subjekteve të auditimit.

### Fusha e trajnimit




- Trajnime të fushës së subjektit të audituar
- Trajnime të metodologjisë audituese

Trajnimet janë realizuar nga një larmi burimesh dhe në të gjithë fushat e trajnimit. Nevojat për njohuri në fushën e metodologjisë audituese kanë predominuar në trajnimet e vitit 2015, kjo shprehje e faktit se audituesit kanë njohuri mbi kuadrin rregullator, por përmirësime priten në fushën e përjasjes ndaj subjekteve të auditimit.




### Burimet dhe metodologjia e trajnimit



Në qëllim të përfitimit të njohurive të reja dhe ndarjes së eksperiencës janë organizuar trajnime jashtë KLSH-së dhe brenda saj. Trajnime nga jashtë janë të organizuar në bashkëpunim me SAI homologe të vendeve të tjera apo institucione të tjera ndërkombëtare që ofrojnë trajnime të fushës së auditimit si dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare të fushës.

Rëndësi e veçantë i është dhënë organizimit të trajnimeve të posaçme për stafin e ri. Këto trajnime bëjnë të mundur që treguesi për 30 ditë trajnimi/person për stafin e sapo rekrutuar të arrihet për një periudhë kohore më pak se një vit.

### Tipi i trajnuesit




Në shkëmbim të eksperiencave të, reja në trajnimet e vitit 2015 janë organizuar trajnime nga ekspertë të jashtëm. Mbetet sfida rritja e trajnimeve nga trajnues jashtë KLSH-së me qëllim shkëmbimin e eksperiencave si dhe organizimi i "Vlerësimeve mes Kolegësh", apo *Peer Review*, që do të ofronte një informacion të rëndësishëm mbi ecurinë e punës, i cili do të shërbente në drejtim të zhvillimit profesional.

### *Metodologjia dhe format e trajnimeve*

Në përputhje me dimensionin e shumëllojshmërisë së procesit të trajnimit dhe zhvillimit të metodologjisë, me qëllim rritjen e nivelit të përthithjes së njohurive për zhvillimin e mëtejshëm profesional, gjatë vitit 2015, është kryer një punë e madhe në drejtim të zhvillimit të metodologjisë dhe diversifikimit të formave të trajnimit.

Trajnimet në vitin 2015 sipas llojeve të auditimit përshinë njohuri mbi 4 llojet e auditimit:

1. Auditimin e Sistemeve të IT
2. Auditimin e Përputhshmërisë
3. Auditimin Financiar
4. Auditimi i Performancës



Gjatë vitit 2015 janë realizuar tri forma të trajnimit profesional, ajo e trajnimit përmes kurseve on line, apo *e-learning*, *trajnimeve face-to-face*, apo trajnimeve me kontakt direkt dhe avancim profesional përmes shkëmbimit të eksperiencave të përbashkëta përmes pjesëmarrjes në *seminare – workshop-eve*.

*Trajnime në klasë me kontakt direkt, ose Face-to-Face.* Me një fleksibilitet në përshtatshmërinë për nevojat për trajnim, ky tip trajnimi ka zënë vendin kryesor në format e trajnimit të zhvilluara. Trajnimet e realizuara ishin në formën e trajnimeve në grupe të vogla, ku një vend të madh i lihet diskutimeve me interaktivitet mes trajnuesit dhe të trajnuarit. Transmetimi përmes materialeve në PowerPoint dhe video projektor, ka ofruar një metodologji që lehtëson procesin e përfitimit të dijeve. Në këtë dimension, gjatë vitit 2015, u krye dhe investimi duke shtuar një sallë të dedikuar trajnimeve, përmes tjetërsimit të ambienteve të pashfrytëzuara në pronësi të institucionit. Vlen të theksohet përfitimi nga kjo metodë trajnimi si pasojë e nivelit të lartë të bashkëveprimit trajnues – i trajnuar, ndonëse duhet të përmirësohet procesi i vlerësimit trajnues – i trajnuar.

Këto trajnime janë zhvilluar si brenda KLSH-së, ashtu dhe jashtë saj.

*Trajnime brenda vendit:* Trajnime që janë organizuar duke u mbështetur nga ekspertë të brendshëm e të jashtëm, nga organizata apo institucione kombëtare apo ndërkombëtare si më poshtë:

- o Trajnime në nivel institucional në KLSH: të cilat u organizuan mbi bazë ditore nga trajnues/auditues të lartë, kryeauditues dhe Drejtues të lartë të KLSH dhe u fokusuan në përditësimin e njohurive të fushave të veçanta dhe auditimit;
- o Trajnime brenda çdo Departamenti Auditimi individualisht në formën e tryezave të diskutimit profesional në terma të rasteve nga praktikat audituese;
- o Trajnime nga Ekspertë të huaj, që përfshinë trajtimin e tematikave specifike të profesionit të auditimit në formatin e prezantimeve të kombinuar me raste studimore nga eksperiencat e vendeve të tjera;

*Trajnime jashtë vendit:* Trajnime të organizuar në bashkëpunim me SAI homologe të vendeve të tjera apo institucione të tjera ndërkombëtare që ofrojnë trajnime të fushës së auditimit si dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare të fushës. Gjatë këtij viti u trajnuan jashtë vendit 136 persona, ose 83% e stafit auditues.

- o Trajnime të organizuara në formën e vizitave studimore dhe trajnimeve në

Institucionet Homologe SAI të vendeve të ndryshme në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit që KLSH ka nënshkruar dhe vijon të nënshkruajë me këto institucione për shkëmbim eksperiencash dhe të dijeve midis audituesve të vendeve të ndryshme. Gjykata Turke e Llogarive dhe NIK i Polonisë kanë vijuar të jenë ofruesit kryesorë për trajnime të stafit të KLSH pranë institucioneve të tyre duke u kthyer kështu dhe në mbështetësit më të fuqishëm në procesin e ndërtimit të kapaciteteve audituese të pajisura me njohuri dhe eksperiencë ndërkombëtare.

*Trajnime përmes kompjuterit, ose e-learning.* Trajnimet *online* u ofruan kryesisht nga CEF, SIloveni Këto trajnime ishin në fushën e buxhetimit, në të cilën u realizuan 188 ditë njerëz, apo 13 punonjës; një formë trajnimi e re, e cila po zë një vend gjithnjë e në rritje. Kjo formë ofron një bibliotekë të gjerë trajnimi, sipas nevojave të përdoruesit dhe përbën një sfidë për zhvillim në të ardhmen. Aktualisht është duke u punuar në drejtim të formimit të bibliotekës sonë virtuale, duke shfrytëzuar fondin e pasur të botimeve, materialet e trajnimeve brenda KLSH-së dhe eksperiencat e marra nga trajnimet nga jashtë.

*Konferenca – Seminare – workshop-e.* Shkëmbimi i eksperiencave të përbashkëta përbën tiparin kryesor të avancimit profesional.

- o Pjesëmarrja në Kongreset e Organizatave Profesionale Ndërkombëtare, INTOSAI, EUROSAL etj ka mundësuar prezantimin e KLSH me një profil të ri, të orientuar drejt një të ardhme për një auditim publik modern dhe të mbështetur fuqishëm në Standardet e INTOSAI-t ISSAI.

- o Seminare trajnimi të organizuara nga institucione publike ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të financave publike dhe auditimit. Megjithë mundësitë e limituara, KLSH është përpjekur të shfrytëzojë më së miri pjesëmarrjen në seminare dhe trajnime të organizmave profesionale ndërkombëtare për punonjës publikë sikurse është CEF/Qendra e Ekselencës në Financë, Trajnim "Auditimi i TI-së" ECA Luksemburg, trajnim "Menaxhimi Financave Publike" Hagë, Holandë, etj., si një traditë tashmë e konsoliduar, audituesit që kanë marrë pjesë në të tilla trajnime dhe seminare kanë shpërndarë midis kolegëve eksperiencat dhe njohuritë e fituara.

- o Pjesëmarrje dhe kontribut aktiv në takimet e Grupeve të Punës dhe Komisioneve të organizuara nga INTOSAI dhe EUROSAL; Politika e hapur ndaj eksperiencave ndërkombëtare në fushën e auditimit publike ka sjellë një ndryshim rrënjësor lidhur me konceptimin përfaqësimit të Auditimit Publik Shqiptar në rrjetet profesionale

ndërkombëtare. Angazhimi i stafi të KLSH në Grupe Pune, Task Force dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare, ka shkuar përtej pjesëmarrjes së thjeshtë, KLSH është vendosur në nivelet e kontribuuesve më aktiv duke treguar profesionalizëm të lartë. Sot KLSH është pjesë e disa Grupeve të punës të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t si dhe pjesë e Task Forcës për Etikën, etj.

Realizimi i dimensionit në këtë fushë sugjeron në nivel të kënaqshëm të angazhimit institucional, duke realizuar një përfaqësim në nivel të lartë të përfaqësimit ndërkombëtar.

### *Përshtatshmëria e trajnimeve me analizën e nevojave*

Në lidhje me dimensionin e përshtatshmërisë së llojit të temave të trajnimeve me nevojat për zhvillim dhe trajnim, gjatë këtij viti është bërë një punë e konsiderueshme. Programi i Veprimtarisë së Trajnimit të stafit të KLSH për vitin 2015 përcaktoi drejtimet kryesore të trajnimit përfshirë tematikat risi, pjesëmarrësit dhe kohën e zhvillimit të trajnimit si dhe trajnuesit. Duhet theksuar se, gjatë implementimit si rezultat i rishikimit dhe vlerësimit të herëpashershëm të nevojave të stafit u organizuan dhe trajnime jashtë programit të cilat kishin si qëllim, mbajtjen e trajnimit në terma realiste dhe sa më afër nevojave aktuale për njohuri në fushat specifike profesionale.

Si sfidë mbetet trajnimi i diferencuar me qëllim aplikimin e trajnimeve që marrin parasysh specifikat individuale profesionale dhe personale.

Trajnimet risi të këtij viti janë në fushën e teknologjisë së informacionit si "Manuali i Auditimit IT", "Përdorimi i Teknikave CAAT", në fushën e "Auditimit të Performancës", krahas temave në fushën e metodologjisë si ato "Mbi Auditimin Financiar", "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë", "Mbi auditimin në fushën e Prokurimeve, etj.

Trajnimet përfshinë njohuri mbi katër llojet e auditimit atë të Sistemeve të IT, Auditimin e Përputhshmërisë, Auditimin Financiar dhe Auditimin e Performancës.

Në të ardhmen do të synohet të hartohet një plani zhvillimi për çdo profesion apo auditues. Për këtë duhet kryer mbulimi me trajnime dhe kualifikime i të gjithë stafit të saj si në nivel drejtues, ashtu dhe zbatues dhe sipas karakteristikave të gjithsecilit, duke e bërë të gjithë stafin pjesëmarrës në planifikim.

Ristrukturimet e kryera gjatë vitit kanë patur parasysh zhvillimin profesional specifik të të gjithë personelit, duke i angazhuar në auditime apo departamente më të përshtatshme për secilin prej karakteristikave individuale, sipas kërkesave të përshtatshme në kompetencat e duhura për nivelet e ndryshme të stafit në çdo profesion apo kuadro.

*Aplikimi i instrumentit:*

Nga kryerja e vlerësimit bazuar në instrumentin e indikatorëve të performancës (*Ngritja e kapaciteteve përmes promovimit të të mësuarit dhe shkëmbimit të njohurive*) referuar dimensioneve dhe aspekteve të vlerësuara rezulton se Promovimi dhe Zhvillimi i Vazhdueshëm profesional si kontribues i përsosmërisë individuale, të grupit dhe të institucionit është realizuar në nivele të larta. Kërkesat dimensionale janë:

- Plan për Zhvillim Profesional dhe Trajnimi, vlerësuar me 3 nga 4 pikë të mundshme, ku si sfidë mbetet trajnimi i diferencuar në bazë të nevojave individuale;
- Procedura dhe Praktika për përzgjedhjen e stafit për trajnim bazuar në aplikimet dhe konsideratat e kompetencave të nevojshme, vlerësuar me 3 nga 4 pikë të mundshme, ku si sfidë mbetet përfitimi i informacionit mbi nevoja individuale të gjithsecilit;
- Monitorimi dhe vlerësimi i dijeve të përfuara nga trajnimi, vlerësuar me 3 nga 4 pikë të mundshme, ku si sfidë mbetet testimi i diferencuar sipas temave të trajnimit;
- Angazhimi në nivele të larta trajnuese, vlerësuar me 4 nga 4 pikë të mundshme, 28 ditë mesatare për individ me mbulim tërësor të stafit;
- Bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm dhe SAI homologe dhe shkëmbimi i eksperiencave, vlerësuar me 4 nga 4 pikë të mundshme, ku niveli i përfaqësimit institucional shfaqet i lartë;
- Nxitja e shkëmbimit të njohurive dhe ngritjen e kapaciteteve në mbështetje të dorëzimit të rezultateve, vlerësuar me 3 nga 4 pikë të mundshme, ku si sfidë mbetet rritja e informacionit mbi nivelin e trajnuesve dhe të procesit të përfitimit të dijeve nga të trajnuarit.

8. Kontrolli dhe Sigurimi i cilësisë

Kontrolli i sigurimit të cilësisë, si një proces i cili synon të garantojë një përmirësim të vazhdueshëm të punës audituese në zbatim të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit, ka qenë dhe mbetet në vazhdimësi një ndër objektivat kryesorë të veprimtarisë së KLSH-së.

Sigurimi i cilësisë, bazuar në standardet ndërkombëtare, është konsideruar si kërkesë e domosdoshme për të identifikuar objektivisht mangësitë, përmirësimet që duhen bërë dhe masat efektive që duhen marrë për përmirësimin e punës në të ardhmen, në mënyrë që të sigurohet një cilësi sa më e lartë e punës audituese dhe njëkohësisht t'i shërbejë ligjvënësit, ekzekutivit dhe publikut për t'u njohur me transparencën e përdorimit dhe administrimit të fondeve publike.

Në zbatim të ISSAI-t 40 "Kontrolli i cilësisë", Urdhërit të Kryetarit nr. 149, datë 03.12.2015 "Për Kontrollin e Sigurimit të Cilësisë", ndryshuar me Urdhërin nr. 155, datë 17.12.2015, grupi i shqyrtimit të dosjeve të auditimit për vitin 2015, përzgjedhi në mënyrë rastësore 44 dosje auditimi ose 27% të auditimeve të kryera dhe të evaduara brenda muajit dhjetor 2015.

Në grupin e shqyrtimit të cilësisë u përfshinë auditues me përvojë nga çdo departament auditimi si dhe u angazhuan ekspertë të jashtëm.

Për shqyrtimin e cilësisë së dosjeve, grupi i audituesve pati në dispozicion praktikën dokumentare të vitit të mëparshëm, por edhe tre tipe formularësh vlerësimi, që i përkasin llojeve të auditimit (ligjshmërie-rregullshmërie, financiar dhe performance).

Në zbatim të Urdhërit të Kryetarit nr. 149, datë 03.12.2015 i ndryshuar, raporti për sigurimin e cilësisë edhe për këtë vit do të shqyrtohet dhe do të analizohet nga çdo departament, ku përveç rezultateve dhe rekomandimeve të përgjithshme, do të analizohen dhe dosjet e secilit departament.

Një nga faktorët që ka ndikuar pozitivisht në sigurimin e cilësisë të punës audituese për vitin 2015, është edhe përgatitja e studiuar e programit vjetor të veprimtarisë së KLSH-së që lidhet me punën e bërë në përcaktimin e prioritetëve të mundshme, argumentimin dhe përfshirjen në programin e auditimit të subjekteve të auditimit mbi bazën e vlerësimit të riskut dhe përcaktimit të materialitetit, duke i kombinuar këto auditime edhe me detyrimet kushtetuese e ligjore që ka KLSH-ja, për auditimin

periodik të tyre.

Në hartimin e programit vjetor të auditimit të KLSH, janë mbajtur në vëmendje edhe ankesat dhe kërkesat për auditim të bërë nga publiku dhe subjekti, si dhe është marrë në konsideratë dhe interesi i lartë i publikut dhe medias për subjekte dhe çështje të ndryshme.

Hartimi e zbatimi i programeve të auditimit konform Rregullores së Brendshme të KLSH-së e manualeve të auditimit, përzgjedhja e përcaktimi i grupeve të auditimit me numrin e aftësitë e kërkuara që sigurojnë zbatimin e programit, nxjerrja e konkluzioneve të drejta dhe formulimi i drejtë i rekomandimeve, masat me karakter organizativ për përmirësimin e gjendjes të marra gjatë periudhës së auditimit, propozimet për përmirësimin e dispozitave ligjore e nënligjore, masat e marra nga subjektet për programimin e detyrave për zbatimin e rekomandimeve, flasin për një arritje të kënaqshme të sigurimit të cilësisë, si dhe të rritjes së besueshmërisë e objektivitetit të konkluzioneve dhe vendimeve të strukturave drejtuese e zbatuese të KLSH-së.

Referuar konstatimeve të rezultuara nga shqyrtimi i dosjeve të auditimit, konstatohet se krahas punës së bërë dhe rezultateve të arritura në drejtim të sigurimit të cilësisë, në procesin e programimit, zbatimit, raportimit të përfundimeve të auditimeve dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, u konstatuan edhe disa të meta e mangësi në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme dhe Manualet e Auditimit, ndaj të cilave kërkohet të reflektohet me masa konkrete tekniko-administrative të qëndrueshme, të cilat do të influencojnë në arritjen e një niveli më të lartë të sigurimit të cilësisë në të gjithë veprimtarinë e KLSH-së, të cilat konsistojnë në:

#### Faza e planifikimit të auditimit:

- Hartimi i programit të auditimit sa më i plotë dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme.

Në disa dosje auditimi ka rezultuar se edhe pse në programin vjetor janë detajuar arsyet pse është përzgjedhur subjekti, në dosje mungojnë të dhënat paraprake që i kanë shërbyer planifikimit të auditimit, metodat dhe teknikat e përdorura sipas kërkesave të rregullores së KLSH-së.

Në disa dosje auditimi, rezulton se në përputhje me Rregulloren e Brendshme është hartuar plani vjetor i departamentit ku përfshihen detyrat dhe periudha e përfundimit të tyre brenda vitit. Ndërsa në dosjet e auditimit bashkëlidhur këtij



plani nuk janë argumentet mbi përzgjedhjen e subjektit në bazë të materialitetit dhe riskut të përcaktuar mbi bazën e dokumentacionit të mbledhur.

- A është mbledhur informacioni paraprak për subjektin e audituar?

Në lidhje me këtë pikë të vlerësimit, rezulton se nga disa dosje të shqyrtuara nuk është inventarizuar ndonjë informacion paraprak që i nevojitet grupit të auditimit për të hartuar programin e auditimit me qëllim përcaktim sa më të saktë të çështjeve të auditimit, afatit të auditimit si dhe numrit të ekspertëve të jashtëm të nevojshëm për auditim.

Është konstatuar se grupi i auditimit nuk ka bërë mbledhjen e informacionit paraprak për subjektin e audituar dhe nuk është bërë analiza e fakteve ose e të dhënave të mjaftueshme, me qëllim arritjen e konkluzioneve të besueshme dhe të vlefshme rreth subjektit për hartimin e programit të auditimit, si rrjedhojë programet e auditimit janë të ngjashme pa u thelluar në veprimtarinë dhe specifikat e subjektit, gjë që ka sjellë shpesh përfshirjen e pikave pa risk në programin e auditimit.

Në disa dosje auditimi janë konstatuar mangësi në procesin e planifikimit e cila konsiston në faktin se në dosjen e auditimit nuk ka informacion paraprak.

Mungesa e këtij informacioni paraprak të grumbulluar për subjektin që do të auditohet para hartimit të programit ka bërë që në disa raste të mos ketë një përcaktim të saktë e objektiv, të drejtmeve të auditimit.

### Faza e kryerjes së Auditimit.

- Janë përdorur përshtatshëm procedurat dhe teknikat e auditimit për mbledhjen e provave.

Për mbledhjen e provave në përgjithësi janë përdorur përshtatshëm procedurat dhe teknikat e auditimit konformë Rregullores së Brendshme, por në disa ka rezultuar se; në dosjen e auditimit, nuk gjenden evidenca të mjaftueshme që shërbejnë si dokumentacion justifikues për punën audituese, si p.sh. akt rakordimet për të ardhurat dhe shpenzimet me degën e thesarit, evidencën e realizimit të investimeve, regjistrin e parashikimit dhe të realizimit të prokurimeve verifikime të ligjshmërisë së vendimeve, kontrata qiraje, aktverifikime dhe procesverbale të mbajtura nga subjekti, informacione të ndryshme, etj.

Në disa dosje auditimi, rezulton se nuk ka dokumente për metodat dhe teknikat e

auditimit si vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, verifikimin e transaksioneve, informacione, pyetësorë, etj., në përputhje me rregulloren e brendshme.

- Procesverbalet, aktverifikimet dhe dokumentet e tjera të punës audituese janë të mbajtura në përputhje me kërkesat e ligjit dhe rregullores së brendshme.

Në disa raste procesverbalet dhe aktverifikimet janë nënshkruar vetëm nga një auditues në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme.

Është konstatuar se në rastin e gjetjeve të trajtuara në aktverifikime nuk ka dalë përgjegjësia konkrete për arsye se konkluzionet dhe gjetjet janë të përgjithshme, pa rezultate konkrete dhe jo të adresuara në përputhje me detyrën funksionale të çdo punonjësi në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

#### Faza e Raportimit dhe Evadimit të materialeve të auditimit.



- Grupet e auditimit duhet të marrin masa për trajtime sa më të plota e të qarta të observacioneve të sjella nga subjektet dhe personat e ngarkuar me përgjegjësi.
- Grupet e auditimit duhet të marrin masa për të përmirësuar trajtimin dhe paraqitjen e Projektraporteve dhe në veçanti Raporteve Përfundimtare pasi janë shumë të gjata dhe janë kopje e thjeshtë e procesverbaleve dhe aktverifikimeve të mbajtura.
- Grupet e auditimit duhet të marrin masa për të faktuar realizimin dhe takimet përmbyllëse me subjektin para hartimit të Projektraportit.
- Nga grupet e auditimit të merren masa, që në projektvendim, për shkeljet e rënda ligjore të konstatuara, të propozojnë masë disiplinore për të gjithë personat e ngarkuar me përgjegjësi.
- Përgjegjësi i grupit të auditimit dhe anëtarët e grupit, të marrin masa për të plotësuar dosjen e auditimit me letrat e punës dhe shënimet e mbajtura nga audituesi.
- Me qëllim përmirësimit e paraqitjes sa më cilësore të materialeve të auditimit dhe evitimit të problematikave të hasura gjatë zbatimit të saj, duhet të përmirësohet plotësimi i Formularëve Standard.

Këto rekomandime janë strukturuar sipas nevojës për të ndërhyrë dhe përmirësuar

Manualet dhe udhëzuesit e veprimtarisë audituese, ashtu dhe në nevojën e audituesve për të përsosur njohuritë dhe dijet profesionale.

9. Mbi modernizimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit

Duke vlerësuar rolin e teknologjisë së informacionit për të gjithë veprimtarinë e saj, KLSH edhe gjatë vitit 2015 në zbatim të politikave të përcaktuara në planin strategjik ka kryer investime të konsiderueshme në fushën e teknologjisë së Informacionit, ku 61% të tyre zë zhvillimi i komunikimit, sigurisë dhe menaxhimit të rrjetit kompjuterik



KLSH pasi plotësoi nevojat me investimet e viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2015 duke shfrytëzuar edhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë TIKa-s, e cila akordoi në vitin 2014 një prej 15.9 milion lekë për: pc, laptop, printera dhe ngritjen e infrastrukturës së network, software-ve për analizimin e të dhënave, etj., do të kalojë me investimet e vitit 2016 në informatizimin dhe konsolidimin e përdorimit të teknologjisë së informacionit, në auditim.

Për realizimin e kësaj sfide, kemi angazhuar burime të brendshme, të cilat duke shfrytëzuar edhe eksperiencat e homologeve tanë të Gjykatës së Llogarive të Turqisë, NIK-ut të Polonisë, Zyrës së Auditimit të Zvicrës, kanë hartuar pas një analize të hollësishme të proceseve dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e informatizimit të Auditimit në KLSH.

Kryerja e këtij procesi padyshim jo vetëm që do ti japi një impakt thelbësor drejt rritjes së cilësisë dhe efektivitetit të auditimit dhe treguesve të tij, por edhe do ta rreshtojë institucionin ndër institucionet moderne.

## 10. Bashkëpunimi institucional


Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesuara

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka një qasje krejt të re ndaj komunikimit me publikun, referuar edhe standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, sipas të cilëve: .... *Një SAI i pavarur, efektiv dhe i besueshëm është një komponent thelbësor në një sistem demokratik, ku përgjegjshmëria, transparenca dhe integriteti janë pjesë e domosdoshme e një demokracie të qëndrueshme.... (ISSAI 12, "Vlerat dhe dobitë e SAI-ve-sjellja e ndryshimeve në jetën e qytetarëve), dhe ka rritur gradualisht transparencën e veprimtarisë së tij, duke arritur në fund të vitit 2015 që të jete i pranishëm 6.6 herë më shumë me informacione dhe mesazhe në median e shkruar dhe të pesëfishojë prezencën e tij në median audiovizive, krahasuar me vitin 2010.*

Një falenderim i veçantë në këtë drejtim shkon për të gjitha mediat, të cilat kanë qenë të hapura ndaj shkrimeve të audituesve të KLSH-së, duke i vendosur edhe në faqet e para të tyre, si vlerësim i cilësisë së shkrimeve dhe tematikës së trajtuar.

Gjatë 2015, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat tona për shtyp me një numër prej 922 artikuj, njoftime, editorialë dhe komente analitike, përkundrejt 867 gjithsej përgjatë 2014, ose 7% më shumë. Gazetarët u janë përgjigjur

prononcimeve tona, problematikave të dala nga auditimet e ushtruara nga ana jonë dhe aktiviteteve të ndryshme gjatë këtij viti. Transparenca e veprimtarisë së KLSH-së po rritet nga viti në vit dhe ne jemi gjithnjë e më të hapur e bashkëpunues me median. Kjo evidentohet lehtëazi edhe nëpërmjet shifrave të grafikut të mëposhtëm:



Prezenca e audituesve të KLSH-së në shtypin e përditshëm nuk është më një risi për KLSH-në, por është një nevojë e përhershme për audituesit, që gjetjet dhe rekomandimet e tyre kryesore të mund t'i shtjellojnë me shkrime dhe analiza në shtypin e përditshëm. Nga blogjet mbi temat që kanë zgjedhur për të dalë në publicistikën shqiptare dhe mënyrën e shtrimit të problemeve dhe zgjidhjet që japin, audituesit marrin ide dhe shtytje për shkrime të tjera.

Kjo është arsyeja që vëllimi i fundit i pranisë së audituesve të KLSH në shtypin e shkruar përmban gjithnjë e më shumë shkrime konkrete për problematikat që hasen më shpesh në jetën e përditshme të qytetarit që merr shërbime publike, por dhe që janë më të mprehtat, të cilat janë evidentuar nga auditimet e vitit të kaluar. Gjatë 2015, ne kemi qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetat me 116 shkrime shkrime, të shkruara nga 50 auditues të KLSH-së.

Shkrimet e botuara gjatë viteve 2013, 2014 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2015 janë botuar tashmë në 4 vëllime, me titull "Audituesit e KLSH-së në median e shkruar". Brenda tre mujorit të parë të këtij viti, do të botohet volumi i V-të që i

përket shkrimeve të botuara në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2015. Të katërta vëllimet janë pjesë e kolanës së botimeve të KLSH-së.

KLSH nxjerr çdo tre muaj buletin statistikor, në të cilin përfshihen dëmi ekonomik i konstatuar, të ardhurat e munguara, masat disiplinore dhe administrative të rekomanduara, si edhe kallëzimet penale të dorëzuara në Prokurori, për auditimet e përfunduara në periudhat respektive.

KLSH ka rritur bashkëpunimin dhe partneritetin me organizatat e shoqërisë civile në kryerjen e vrojtimeve dhe analizave të përbashkëta për nivelin e korrupsionit dhe shkallës së transparencës në administratën publike.

Nën shembullin e SAI-ve të zhvilluara evropiane dhe në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, të parimeve të transparencës së plotë dhe integritetit, mbështetur në standardin ISSAI 5600 "Udhëzim për Rishikimin mes Kolegëve", KLSH po përpiqet të angazhojë partnerë të ndryshëm (SAI dhe OJF të fushës) në mini "Peer Review", me qëllim përmirësimin e punës në drejtime të caktuara.

Në vijim të eksperiencës pozitive që kemi pasur në këtë drejtim në 2014, gjatë të cilit kemi realizuar katër *Mini Peer Review*, përkatësisht me Lëvizjen Europiane Shqipëri, KKK, Institutin "G&G" Group dhe Gazetën Ekonomia, në vitin 2015 "Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë", në bashkëpunim me USAID-in kanë realizura projektin "Forcimi i Ligjit përmes zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së", i cili mund të konsiderohet pa dyshim një Mini Peer Review e mirëfilltë.

Raporti Final i këtij projekti dhe rekomandimet e dhëna për KLSH-në në drejtim të përmirësimit të punës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së janë profesionale dhe dobi prurëse për ne. Si institucion jemi duke hartuar një plan veprimi të detajuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ana e QTIL.

Të gjitha këto projekte janë parë si *Mini Peer Review* dhe kanë nxjerrë produkte konkrete të bashkëpunimit me OJF-të, ku janë evidentuar përveç arritjeve dhe mangësitë e dobësitë. Të gjitha rekomandimet e dhëna nga këto organizata do të shikohen me prioritet nga KLSH me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen.

Gjithashtu, KLSH iu përgjigj pozitivisht vitin e kaluar kërkesës së INTOSAI-t, drejtuar të gjithë Institucioneve Supreme të Auditimit, anëtarë të kësaj organizate, nëpërmjet së cilës i ftonte që të ishin pjesë e një Peer Review për pavarësinë e SAI-ve. Kontrolli i Lartë i shtetit u vetë ofrua për të qenë pjesë e këtij procesi, duke

vlerësuar si parësore pavarësinë e SAI-ve për realizimin e misionit të tyre.

Kontrolli i Lartë i Shtetit është përzgjedhur nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit si përfaqësues i EUROSAT-t për të realizuar këtë proces. Procesi do të realizohet nga auditues të Gjykatës Austriake të Auditimit, në periudhën 8-19 shkurt 2016 dhe janë marrë të gjitha masat që ky proces të realizohet në kohë dhe me transparencë të plotë. Peer Review do të sigurojë KLSH një informacion të pavarur lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitetit të tij me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 1, 10, 11 dhe 12.

Gjatë vitit 2015, ne kemi lidhur marrëveshje bashkëpunime me Komitetin Shqiptar të Helsinkit edhe me Organizatën "Integrimi Urban", duke e çuar në 18 numrin e partnerëve tanë me të cilët kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Në zbatim të Marrëveshjes, KLSH do të angazhohet të bashkëpunojë me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, si një prej OJF-ve më me eksperiencë, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe më gjerë.

Nëpërmjet bashkëpunimit me Organizatën "Integrimi Urban", do të krijohet mundësia e shfrytëzimit të të dhënave të ndryshme të publikuara nga kjo organizatë, të cilat mund të shërbejnë si indicie për fillimin e auditimeve nga ana e KLSH-së.


Bashkëpunime me profesoratin e Universiteteve, me Organizatat e Profesionistëve të fushës dhe me OJF-të ka përvijuar ngushtë edhe përgjatë vitit 2015, duke vlerësuar maksimalisht kontributin e tyre për Revistën Shkencore të KLSH-së, Konferencat Shkencore të KLSH-së, trainimet, rekrutimet e stafit, etj. Një shembull konkret është edhe zhvillimi i analizës vjetore për vitin 2014 në ambientet e Universitetit "Ismail Qemali" në Vlorë dhe zhvillimi i fazës së parë të analizave të punës të Departamenteve të Auditimit në fund të vitit 2015 në Universitetet Publike në rrethe të ndryshme të vendit, si në: Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan; Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë; Universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër dhe në Universitetin e Tiranës.

Në rritjen e transparencës dhe informimin e publikut një rol të pazëvendësueshëm kanë luajtur botimet e KLSH-së, të cilat kanë arritur shifrën 51 botime në katër vjet.

Intensifikimi dhe rritja cilësore e komunikimit të KLSH-së ka sjellë rezultate, veçanërisht në rritjen e vëmendjes së medias për raportet e auditimit dhe për institucionin në tërësi, si edhe në rritjen e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucionit.

KLSH është shumë e hapur edhe ndaj ankesave të qytetarëve, të cilat na adresohen me postë të zakonshme ose elektronike. Këto letër-ankesa të qytetarëve, administrohen me profesionalizëm nga punonjësit e KLSH-së në funksion të tematikës që trajtojnë dhe qytetarët marrin në çdo rast përgjigje për shqetësimin e ngritur, me përjashtim të rasteve kur çështjet e ngritura nuk janë kompetencë e KLSH-së. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka trajtuar gjatë 2015, 382 *letra dhe ankesa*, për probleme të ndryshme, nga të cilat 130 *rezultuan jashtë kompetencave dhe juridiksionit të institucionit*. Nga 252 kërkesa dhe ankesa në kompetencë të KLSH, 143 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigja përkatëse, ndërsa 109 janë në procesin e verifikimit.

### Komunikimi me qytetarët



Në zbatim të planit të Zhvillimit strategjik të institucionit dhe me mbështetjen e projektit IPA të BE-së, KLSH do të ripunojë strategjinë e tij të komunikimit për të qenë sa më pranë Kuvendit, publikut dhe medias, duke sjellë vazhdimisht ide të reja, të cilat janë domosdoshmëri për të qenë inovativë, atraktivë dhe në koherencë me ndryshimet e shpejta të TI.

KLSH, siç u theksua, edhe në Kongresin YOUNG EUROSAI, do të përdorë gjithnjë e më shumë mjetet moderne të komunikimit si Face Book, Twitter, forumet e diskutimit *on line*, komunikimin e thjeshtë dhe konciz, sepse sot është koha e përcjelljes së shpejtë dhe e vizualizimit të informacionit.



Bashkëpunimi me SAI-et partnere dhe me ndërkombëtarët

Në zbatim të të gjitha orientimeve dhe realizimit të objektivave të dhëna nga Kryetari i KLSH-së, për vitin 2015, janë ndjekur të gjitha procedurat për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të përcaktuara ku veçojmë vizitat dhe pjesëmarrjen e Kryetarit të KLSH në aktivitetet e mëposhtme:

- Takim pune në zyrat e Auditimit të Qeverisë të SHBA, me z. Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i GAO-s;
- Pjesëmarrjen në Simpoziun e 23-të, të UN/INTOSAI, në Vjenë;
- Pjesëmarrjen në Konferencën e EUROSAI/OLACEFS, në Quito, Ekuador;
- Pjesëmarrjen në konferencën e V-të të EUROSAI-ARABOSAI, në datat 7-9 dhjetor 2015, në Doha, Katar;
- Pjesëmarrja në konferencën e 10-të “Mbi Menaxhimin e Borxhit” të Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD);
- Vizita Zyrtare në SAI-n Kroat;
- Vizite zyrtare në SAI-n Polak;
- Konferenca e 7 vjetore e ZAP-it të Kosovës, etj.

KLSH ka marrë pjesë në shumë grupe pune dhe aktivitete të organizuara nga INTOSAI dhe EUROSAI dhe konkretisht në grupin e punës për rishikimin e ISSAI 30 (Kodi i Etikës). KLSH ka qenë aktiv dhe ka paraqitur propozimet e tij në 3 takimet e zhvilluara gjatë vitit 2015. Versioni i përfunduar i ISSAI-t 30 do të paraqitet për miratim në Kongresin e ardhshëm të INTOSAI-t, që do të zhvillohet gjatë vitit 2016.

Gjatë vitit 2015, KLSH ka marrë pjesë në dy takime të grupit Task Force të EUROSAI-it për “Auditimin dhe Etikën” (TFA&E). Në cilësinë e anëtarit të këtij grupi dhe të interesit në rritje të institucionit për këtë çështje, KLSH ka ndjekur gjithnjë me interes aktivitetet e këtij grupi pune të rëndësishëm të EUROSAI-t, i cili trajton një prej çështjeve më aktuale për administratën publike, etikën, e cila është e lidhur direkt me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Trajtimi i kësaj teme është me rëndësi prioritare për institucionet supreme të Auditimit, të cilat janë të ngarkuara me mbikëqyrjen e menaxhimit të shëndoshë të financave publike.

KLSH ka qenë gjithashtu aktive dhe ka marrë pjesë në 2 Takimet e Grupit të punës për Auditimin e fondeve të alokuara për fatkeqësitë dhe katastrofat, në takimet e grupit të punës për auditimin e Mjedisit, në Grupin e Punës për auditimet IT, etj.

Përgjatë vitit 2015, theksojmë pjesëmarrjen e KLSH-së në 59 aktivitete të rëndësishme si Kongrese, Konferenca, Takime, seminare, trajnime, (këto të fundit edhe në kuadrin e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me SAI-et homologe), etj. Ndër më të rëndësishmet përmendim pjesëmarrjet në:

- Takimin e Punës "Komisioni Stabilizim Asociativ", në Bruksel;
- Seminarin mbi Integritetin dhe antikorrupsionin, zhvilluar në Hungari;
- Kongresin mbi prokurimet publike;
- Konferencën Young EUROSAI zhvilluar në Izrael, etj.

Përgjatë vitit 2015, ka vijuar bashkëpunimi i suksesshëm me SNAO-n dhe JWGAA dhe audituesit e KLSH-së kanë marrë pjesë në sesione të ndryshme trajnime, në workshope, etj.

Mjaft i rëndësishëm dhe frytdhënës është dhe pjesëmarrja e audituesve të KLSH në trajnimet e organizuara nga Gjykata Turke e Llogarive, ku gjatë vitit 2015 u trajnuan 36 auditues (176 auditues në vitet 2012-2015).

Referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar me NIK-un Polak 24 auditues u trajnuan pranë këtij institucioni lidhur me tema që lidhen me llojet e ndryshme të auditimit që realizohen nga ky institucion.

Gjatë vitit 2015 kanë marrë pjesë në aktivitetet jashtë vendit 136 auditues ose 775 ditë në total, thënë ndryshe të gjithë punonjësit e KLSH-së kanë qenë të paktën një herë jashtë vendit (me përjashtim të audituesve që për arsye personale të ndryshme nuk mund të udhëtonin jashtë vendit).

### *Internshipi i ECA-s dhe fellowship i GAO-s*

Përfitimi i statusit të vendit kandidat për nën BE, solli për KLSH-n edhe intensifikimin e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit konkret me ECA-n, Gjykatën Europiane të Audituesve. Një tjetër vlerë e shtuar kjo për institucionin ku KLSH përfiton nga përvoja më mirë prej institucioneve më prestigjioze evropiane. Për herë të parë, tre auditues të KLSH-së kanë qenë pjesë e strukturave të ECA-s për një periudhë 5 mujore, duke përfituar nga programet e internshipit të këtij institucioni, të drejtën për të kontribuar pranë departamenteve dhe drejtorive të ndryshme të ECA-s. Ky bashkëpunon po vijon dhe aktualisht një audituese e KLSH-së po e ndjek këtë program dhe gjatë vitit 2016 edhe tre auditues të tjerë të KLSH-së do të fillojnë në muajin mars internshipin pranë ECA-s.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi të suksesshëm, z.Vitor Caldeira, President i ECA-s me nderim të Kryetarit të KLSH-së, na nderoi me pjesëmarrjen e tij në ceremoninë e 90 vjetorit të KLSH-së, të zhvilluar në maj të vitit të kaluar.


KLSH ka rivendosur bashkëpunimin me GAO-n dhe në muajin mars të këtij viti, një audituese e KLSH-së do të marrë pjesë në një fellowship 4 mujor pranë kësaj zyre, që do të jetë pa dyshim një eksperiencë pozitive dhe shumë dobi prurëse për ne.

KLSH vjen në katër vitet e fundit 2012-2015 me një kolanë botimesh prej 51 titujsh. Çdo vit dinamika e botimeve të institucionit rritet me 10 përqind, duke ruajtur cilësinë, thellësinë e analizës, gjerësinë e informacionit dhe plotësinë e mesazheve të përmbajtura në çdo titull dhe përmbajtje libri. Botimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, krahas regjistrimit besnik të përmbajtjes së auditimeve të institucionit, të gjetjeve dhe rekomandimeve të çdo auditimi kryesor, përçojnë drejtimit strategjike të reformimit të tij, që janë rritja e kontributit për përmirësimin e qeverisjes publike, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit dhe ngritja e kapaciteteve të audituesve të KLSH-së në nivelin e një audituesi modern evropian.


### Botimet e KLSH-së përgjatë vitit 2015

Viti 2015 shënoi në 51 numrin e botimeve të KLSH-së duke i shtuar 16 botimet e vitit 2015, 35 botimeve të kryera në periudhën 2012-2014 me titujt e mëposhtëm:

- Analiza Vjetore e Punës 2014 Raporti Vjetor i Performancës, KLSH 2014 (Shqip/Anglisht);
- Revista Kërkimore Shkencore "Auditimi Publik", nr. 9, 10 dhe 11 (Shqip/Anglisht);
- Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës Indikatorët e Performancës;
- Manuali i Auditimit të IT;




- Cobit 4.1, Objektivat e Kontrollit për IT;
- Audituesit e KLSH-së në Shtypin e Përditshëm, Volumi III dhe Volumi IV;
- 90 Vjet KLSH, Ceremonitë dhe Aktivitetet;
- Album, 90 Vjet KLSH;
- Kodi i Etikës së INTOSAI-t (Issai 30), Kodi i Etikës së Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA) dhe Kodi i Etikës së KLSH-së;
- Standardet e Auditimit të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (GAO).




Ndër këta tituj vlen të veçojmë tre numra të *Revistës Shkencore "Auditimi Publik"*, e cila arriti në numrin 11 të saj. Këtë vit kanë vijuar bashkëpunimin me ne për realizimin e Revistës personalitete të fushës së Ekonomisë nga vendi si dhe personalitete të njohura dhe me eksperiencë nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) nga vende të rajonit e më gjerë, si Prof.Ass.Dr.Recai Akyel, zv.President i EUROSAT-t dhe President i Gjykatës Turke të Logarive; z. László Domokos, President i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Hungarisë, auditues nga SAI Kroat, nga Gjykata Gjermane e Auditimit, Prof.Dr. Ilia Kristo, Prof.Dr. Hysen Çela, Prof.Asoc. Adriatik Kotorri, auditues të KLSH-së, etj.

Me fokus në edukimin profesional të audituesve publikë, KLSH sjell tek lexuesit e interesuar, që përfshijnë jo vetëm audituesit por dhe studentët, profesionistët të

fushave të tjera të lidhura më auditimin, botimin e Standardeve të Auditimit të Qeverisë së SHBA, rishikim i vitit 2011, si udhëzues të këshillueshëm për t'u lexuar, studiuar dhe përdorur kur është e përshtatshme, pasi parimet dhe udhëzimet që ky botim sjell janë një prej praktikave më të zhvilluara ndërkombëtare të auditimit shtetëror, ato të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA.



KLSH do të vijojë të pasurojë kolanën e botimeve të tij edhe për vitin 2016, gjatë të cilit janë parashikuar të botohen 16 tituj dhe nëse projektohemi drejt së ardhmes, në fund të vitit 2018, kolona e botimeve të KLSH-së do të ketë 100 botime.



Ne po punojmë dhe jemi të bindur që KLSH do ti realizojë objektivat ambiciozë që i ka vendosur vetes në fushën e botimeve, si pjesë integrale e zbatimit të strategjisë 2013-2017 (rishikuar për periudhën 2015-2017) për rritjen e transparencës dhe komunikimit me publikun, me qëllim modernizimin e institucionit.

## Projekti i binjakëzimit nën programin IPA 2013

Në kuadër të asistencës për Shqipërinë dhe të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit, IPA 2013, komponenti i I-rë, KLSH ka fituar një financim nga Bashkimi Evropian për *"Forcimin e kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm"*, me vlerë 2.11 milion euro. Ky projekt binjakëzimi është ndër 7 projektet e përzgjedhur nga BE për t'u implementuar në mënyrë të decentralizuar nga institucionet e shtetit shqiptar dhe DKBMJ do të veprojë si homolog për partnerin e binjakëzimit.

Ky projekt i financuar nga BE, me kohëzgjatje 2 vjeçare, pritet të fillojë shumë shpejt dhe është pa diskutim një mbështetje e fortë por është njëkohësisht edhe një nga sfidat e radhës së KLSH-së, i cili ka treguar në vitet e fundit që po punon fort dhe po realizon cilësisht objektivat e tij, duke ecur në mënyrë të sigurt në rrugën e tij të modernizimit, atë të realizimit të *Auditimeve* të tij në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe praktikat më të mira të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

KLSH, si institucioni përfitues i projektit ka parashikuar në buxhetin e tij të vitit 2016 pjesën e bashkëfinancimit dhe ka ngritur strukturat përkatëse në KLSH që do të merren me menaxhimin dhe implementimin e projektit, duke bashkëpunuar gjithashtu me Ministrinë e Integritit dhe me drejtorinë e Kontraktimeve dhe Financimeve në Ministrinë e Financave, në mënyrë që të përmbushë në kohë dhe me cilësi të gjitha detyrat në etapat e ndryshme të implementimit të projektit.

## Kremtimi i 90 vjetorit të KLSH-së

Në datën 26 maj 2015, në sallën e Seancave Plenare të Kuvendit të Shqipërisë, u zhvillua ceremonia e 90 vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në këtë ceremoni morën pjesë personalitete të larta të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) nga Europa, drejtues të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) si dhe personalitete të larta të shtetit shqiptar, drejtues të Institucioneve të pavarura Shqiptare, deputetë, përfaqësues të OJF-ve, të profesionistëve të fushës së Ekonomisë dhe Auditimit dhe të Medias.



Një vlerësim dhe falenderim i veçantë për Presidentin e Republikës SH.T.Z. Bujar Nishani, Kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë z.Illir Meta, Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese z.Bashkim Dedja, ish Presidentin z.Bamir Topi, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe drejtues të pushtetit vendor, që vlerësuan këtë përvjetor dhe na nderuan me pjesëmarrjen e tyre.



Ceremoninë e nderuan me pjesëmarrjen e tyre, z. Josef Moser, President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe njëkohësisht Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t, z. Vitor Caldeira, President i Gjykatës Europiane të Audituesve, z. Recai Akyel, zv.President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive, z. Ivan Klesic, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t kroat, z. Milan Dabovic, President i SAI-t të Malit të Zi, z. Milenko SeGO, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Bosnje dhe Hercegovinës; z. Radoslav Sretenovic, President i SAI-t të Serbisë; z. Wojciech Kutyla, zv.President i NIK-ut Polak; z. Naser Ademi, zv.Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Maqedonisë, z. Cosmin Nicula, zv.President i SAI-t të Rumanisë, z. Artan Venhari, zv.Auditues i Përgjithshëm i ZAP-it të Kosovës, si dhe përfaqësues të institucioneve të rëndësishme të BE-së, si z. Robert Gielisse, nga DG Budget dhe z. Joop Vrolijk, nga SIGMA.

Një përshëndetje krejt e veçantë për 90 vjetorin e KLSH-së ishte ajo e z.Gene Dodaro, Kontrollorit të Përgjithshëm të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA, i cili nëpërmjet një video mesazhi i përcolli stafit të KLSH-së urimet për 90 vjetorin e institucionit.



Kujtesa institucionale e një organi kushtetues si KLSH është e një rëndësie parësore për të lexuar drejt vlerat dhe kontributin e tij përgjatë viteve, por edhe gabimet dhe momentet e kthimeve prapa. Për këtë arsye të gjitha ceremonitë e organizuara me këtë rast janë përmbledhur në dy botime të KLSH-së të vitit 2015, “90 vjetori i KLSH-së” dhe “Albumi i 90 vjetorit të KLSH-së”, të cilët na shërbejnë neve dhe audituesve që do të vijjnë në të ardhmen për të njohur më mirë institucionin por edhe opinionit publik dhe qytetarëve për të kuptuar më mirë rolin e këtij institucioni të rëndësishëm kushtetues.

#### *Aplikimi i instrumentit:*

##### *Fusha : Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesuar*

Nga kryerja e vlerësimit bazuar në instrumentin e indikatorëve të performancës për dimensionet: “Komunikimi i brendshëm” rezulton një vlerësim maksimal (4 pikë) për të gjitha kriteret që kanë të bëjnë me këtë dimension. Rezultoni një vlerësim i moderuar (3 pikë nga 4 të mundshme) për dimensionin e Komunikimit të jashtëm pasi KLSH në kuadër të implementimit të projektit IPA do të ketë si produkt “Strategjinë e komunikimit” që do të përfundojë brenda 2016.

Referuar dimensionit “Komunikimi me mediat, qytetarët dhe OJF-të”, KLSH rezulton e vlerësuar maksimalisht (4 pikë) në të gjitha kriteret.



IV. FOKUSI DREJT SË ARDHMES: Perspektiva dhe sfida 2016

Viti 2016 do të përbëjë një vit sfida për stafin e KLSH-së, në funksion të modernizimit dhe reformimit institucional.

Aplikimi i instrumentit të performancës institucionale na mundësoi të përcaktojmë drejt aspektet e zhvillimit institucional dhe drejtimet e progresit të KLSH-së në të ardhmen.

*KLSH përgjatë vitit 2016 veprimtarinë institucionale do ta fokusojë:*

Në drejtim të veprimtarisë audituese:

- Kryerja për herë të parë në historikun e veprimtarisë audituese të KLSH-së të auditimeve financiare (certifikimeve të pasqyrave financiare) në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare dhe me Manualin e Auditimit Financiar.
- Konsolidimi i auditimit të përputhshmërisë, duke aplikuar kërkesat e standardeve ndërkombëtare të auditimit në përputhje me manualin e ri të Auditimit të përputhshmërisë.
- Shtimi i numrit dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë në auditimet e performancës do të jetë në fokus të veprimtarisë audituese të KLSH-së përgjatë vitit 2015. Ngritja e kapaciteteve me synim kryerjen e auditimeve financiare do jetë një nga prioritetet e periudhave në vijim.
- Gjatë vitit 2016 KLSH do të vijojë me kryerjen dhe rritjen e kapaciteteve për auditimet TI në entet e sektorit publik.
- *Zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve të TI gjatë procesit auditues është një nga objektivat në të cilat do të përqendrohet menaxhimi institucional përgjatë vitit 2016. Për vitin 2016 do të implementohet projekti i menaxhimit të informatizuar të procesit të auditimit me një impakt të drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të veprimtarisë audituese.*
- *Thellimi i luftës kundër korrupsionit do të jetë në fokus të veprimtarisë tonë institucionale dhe krahas veprimtarisë audituese dhe modernizimit të tij, do të vazhdojë të thellojë luftën kundër korrupsionit, duke denoncuar aktet korruptive në publik, media, prokurori e më gjerë.*

Në fushën e metodologjisë dhe zhvillimit profesional, duke e konsideruar zhvillimin profesional si pjesë integrale e zhvillimit strategjik fokusi në të ardhmen

do të përqëndrohet në këto aspekte si:

- *Konsolidimi i komponentit të "Zhvillimit profesional".*
- Vijimi i aplikimit të modelit të trajnimit të orientuar drejt rezultateve
- Të mësuarit gjatë zhvillimit, që kërkon krijimin i një sistemi për të vlerësuar efektivitetin e trajnimit, progresin dhe përmirësimin e vazhdueshëm.
- Krijimin e një profili të lartë profesional dhe etik të Audituesit të Lartë Publik, pjesë e stafit të KLSH;
- Ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të ritmeve të veprimitarisë trajnuese, qasjen e tyre bashkëkohore dhe plotësimin në vijimësi të nevojave të stafit në formën dhe mënyrat më të përshtatshme;
- Metodologjia e zhvillimit të udhëhiqet nga veprimitaritë kërkimore shkencore dhe botimet e KLSH të kthehen në burim parësor të trajnimit dhe zhvillimit të stafit.

*Në fushën e komunikimit, botimeve dhe marrëdhënieve më jashtë,* qëllimi kryesor mbetet rritja e rolit parësor në sjelljen e ideve të reja, veçanërisht në fushën e komunikimit, në mënyrë që edhe në këtë fushë të jemi inovativë, duke gjetur mënyrën më efikase të komunikimit me Kuvendin, median, publikun, subjektet e audituara, etj.

Sfidat e së ardhmes e vënë fokusin në:

- Realizimi i 16 botimeve të parashikuara për 2016, duke ruajtur dhe përmirësuar cilësinë e tyre do të vazhdojë të mbetet një prioritet për institucionin sepse ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve audituese, krahas rritjes së transparencës me publikun.
- Për këtë vit janë parashikuar 16 botime, me të cilat kolona e botimeve të KLSH-së do të arrijë shifrën 67 dhe, nëse ecim me këtë ritëm, në fund të vitit 2018 kolona e botimeve të KLSH-së do të ketë 100 tituj.
- Implementimi i IPA që sigurisht do të ketë edhe vështirësi, duke pasur parasysh që do të jetë viti i parë i aplikimit;
- Realizimi i strategjisë së komunikimit të KLSH-së si output i IPA;
- Vijimi i implementimi me projekte konkrete i marrëveshjeve të bashkëpunimit me OJF-të dhe shoqatat e Profesionistëve të fushës dhe realizimi i Mini Peer Review-ve të tjera. Këtu mund të përmendim kërkesën që i kemi bërë së fundmi institucionit të Avokatit të Popullit, për realizimin e një mini Peer

Review nga ky institucion. Duke pasur parasysh rolin dhe misionin e Avokatit të Popullit, ne i kemi propozuar që të realizojnë një Peer Review, duke dërguar një grup komisionerësh të Avokatit të Popullit në KLSH, që mund të trajtonin një nga tematikat e mëposhtme:

- Vlerësimi dhe mënyra e trajtimit të letrave dhe ankesave të qytetarëve nga KLSH;
  - Vlerësimi i marrëdhënieve të punës në KLSH (rekrutimi, ngritjet në detyrë edhe në karrierat profesionale, etj.), në këndvështrimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut, kuadrit ligjor në fuqi, etj.
- Bashkëpunim konkret me përfaqësitë e Bankës Botërore dhe OSBE në Shqipëri, për mundësinë e projekteve të përbashkëta për zhvillimin e kapaciteteve audituese;
  - Realizimi i Konferencës së IV-t Shkencore të KLSH-së, "Analiza e Riskut";
  - Ruajtja e nivelit të shkrimeve të Revistës Shkencore të KLSH-së dhe përmirësimi i tyre, duke qenë sfidantë në radhë të parë me veten, në mënyrë që revista të ruajë karakterin e saj shkencor dhe emrin që ka krijuar.

AUDITIMET ME IMPAKTET MË TË RËNDËSISHME DHE ME EFEKTE TË  
KONSIDERUESHME NË MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE NË ZHVILLIMIN  
EKONOMIK TË VENDIT

A. AUDITIME NË SEKTORIN ENERGJITIK

1. AUDITIMI NË MINISTRINË E EKONOMISË DHE INDUSTRIË  
(Marrëveshja e zgjidhjes me mirëkuptim CEZ-RSH)

*Referues: Manjola NAÇO – Drejtor i Përgjithshëm,  
Muhamed KAVAJA – Kryeauditues,  
Ermal YZEIRAJ – Drejtor Drejtorie.*



Auditimi në Ministrinë e Ekonomisë dhe Industrisë, i programuar në planin vjetor të auditimit të KLSH dhe sipas Programit të Auditimit nr.118/1, datë 12.03.2015, u ushtrua mbi ligjshmërinë ekonomiko-financiare të aktivitetit të MEI për periudhën nga shtator 2013 deri 31 dhjetor 2014. Ky auditim mbi çështjen ÇEZ nga ana e

KLSH u ushtrua duke u kombinuar me auditimin në institucionin e Avokaturës së Shtetit.

Në këto dy auditime, KLSH ka audituar vetëm procesin e zhvillimit të negociatave, veprimtarinë e Grupit të Punës dhe orientimin për zgjidhjen e marrëveshjes me mirëkuptim nga Qeveria, dhe jo miratimin e saj nga Kuvendi i Shqipërisë.

Fokusi kryesorë në të dy këto auditime ka qenë:

- Procedurat e ndjekura dhe negociatat që sollën përgatitjen e marrëveshjes së nënshkruar nga Grupi i Punës, për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjes ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe CEZ a.s., më datë 23.06.2014
- Përcjelljen e kësaj Marrëveshje për miratim në Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin e Shqipërisë.

Për të arritur në konkluzionet e këtij auditimi nga KLSH janë bërë vlerësime dhe referenca në dokumenta të institucioneve të ndryshme të Shtetit Shqiptar, si: Korrespondenca ndërmjet institucioneve shtetërore; Raporte të audituesit të pavarur ndërkombëtar apo të konsulentit ligjor të kontraktuar nga Shteti Shqiptar; Analiza të pasqyrave financiare të publikuara të shoqërive në pronësi të CEZ a.s. Kjo gjë e bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 400 *"Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë"*, ISSAI 4000 *"Standardi Auditimit të Përputhshmërisë"*, ISSAI 300 *"Standardet e Fushës së Auditimit Shtetëror" (evidenca e auditimit)*, ISSAI 1500 *"Evidencat e Auditimit"*, ISSAI 200 *"Standardet e përgjithshme të Auditimit Publik, kujdesi i duhur profesional"*, ISSAI 1610 *"Përdorimi i punës së audituesve të brendshëm"*, ISSAI 1620 *"Përdorimi i punës së një eksperti auditimi"*, materialet dhe observimet drejtuar grupit të auditimit. Kjo për arsye se KLSH, nuk mund të auditonte dokumentacion financiar dhe ligjor të kompanive me kapital aksioner 76% aksione private, CEZ Shpërndarje sh.a., apo kompanive private të cilat u krijuan gjatë aktivitetit të CEZ a.s., në Shqipëri (CEZ Trade dhe CEZ Albania), pasi në referencë të Kushtetutës të nenit 163/gërma c *"Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti"*.

Paraqitja në mënyrë skematike e gjendjes në retrospektivë:

- Më datë 11.03.2009 është nënshkruar kontrata e shitjes së 76% të aksioneve midis METE-s si shitës i aksioneve dhe CEZ a.s., si blerës dhe investitor strategjik.
- Pas problematikave të vazhdueshme disa vjeçare, ERE në prill të 2012, fillon monitorimin e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a.
- Në përfundim të këtij procesi, konstatohet se gjendja kritike është shkaktuar kryesisht nga tejkalimi i shpenzimeve e keqadministrimi.

- Enti Rregullator i Energjisë (ERE) më datë 21.1.2013, ka vendosur heqjen e licencave dhe kalimin e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a., në administrim të përkohshëm.
- Në datë 27.02.2013 me Urdhërin nr.19 të Kryeministrit caktohet Avokatura e Shtetit si koordinator e Shtetit Shqiptar për zgjidhjen e problematikës ligjore me CEZ a.s., e cila së bashku me konsulentin ndërkombëtar DERAINS & Gharavi do të koordinonte hapat për përfaqësimin në arbitrazh ndaj ankimeve të mundshme që CEZ a.s., po përpiqej të formalizonte ndaj institucioneve të Shtetit Shqiptar. Më datë 15.05.2013 shoqëria CEZ a.s., Pragë, pas heqjes së licencave dhe vendosjes së shoqërisë nën administrim të përkohshëm, paditi e para Republikën e Shqipërisë në Gjykatën e Arbitrazhit UNCITRAL (*United Nations Commission on International Trade Law (Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën Tregtare Ndërkombëtare)*), duke ngritur një sërë pretendimesh ligjore dhe financiare.
- METE më 04.09.2013, ka përzgjedhur shoqërinë BDO LLP si ekspert financiar për të bërë vlerësimin financiar të pretendimeve të lidhura me CEZ a.s., që i ka kushtuar Shtetit në vlerën prej 40 milion lekë.
- METE, ka realizuar procedurën e prokurimit për shërbimin e vlerësimit të humbjeve teknike, më datë 30.05.2013 duke përzgjedhur si fitues shoqërinë BBH Berlin, dhe lidhi kontratën me këtë shoqëri më datë 25.11.2013 në vlerë 23 milion lekë.
- Grupi i Punës që në muajin Shkurt 2014, kishte në dispozicion raportin e vlerësimit të Ekspertit Financiar Ndërkombëtar BDO LLP.
- Strategjia e ndërtuar për t'u përballur me çështjen gjyqësore të hapur nga CEZ a.s. ndaj Shtetit Shqiptar, si dhe veprimet e institucioneve shtetërore morën drejtim tjetër, pasi me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.969 datë 25.10.2013 është vendosur të ngrihet grupi i punës dhe fillimi i procedurave të negociatave për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ a.s. Grupi i punës u nominua me emra konkretë në Urdhërin nr.228 në 2.12.2013 të Kryeministrit, pasuar me një Urdhër të mëvonshëm nr.181 datë 18.06.2014, i cili angazhonte në përbërje të Grupit të Punës dhe administratorët e shoqërive KESH sh.a., OST-s dhe administratorin e CEZ Shpërndarje sh.a. Grupi negociator do të kryesohej nga z. Damian Gjijnuri, Ministër i Energjisë dhe Industrisë. Këto procedura kanë përfunduar me nënshkrimin e Marrëveshjes me mirëkuptim nga Grupi i Punës më datë

23.06.2014, përcjelljen në Këshillin e Ministrave dhe miratimin e saj me Ligjin nr. 114/2014 datë 31.07.2014.

Referuar përmbajtjes së Marrëveshjes për Zgjidhjen me Mirëkuptim, të nënshkruar më datë 23.06.2014, nga Grupi i Punës, evidentohen fare qartë elementët e një marrëveshjeje tërësisht të pabarabartë dhe jo në proporcion me pretendimet e deri atëherëshme të Shtetit Shqiptar ndaj CEZ a.s., duke shkaktuar një dëm ekonomik në shumën 479 milion euro. Kjo e bazuar në rezultatet e auditimit në të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë.

Në dokumentacionin e procesit të vendimarrjes nga ana e Grupit të Punës mungon opinioni financiar dhe teknik Eksperteve BDO LLP & BBH Berlin. Ky opinion, që i kushtoi shtetit Shqipëtar 63 milion lekë, nuk u mor në konsideratë gjatë negocimit.

Dëmi ekonomik i shkaktuar Buxhetit të Shtetit nga Marrëveshja e Zgjidhjes me Mirëkuptim mes Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s., arrin në vlerën 479 milion euro nga të cilat:

- Në vlerën 95 milion euro për pagesë e dakortësuar në marrëveshje, të pabazuar në dokumentacion financiar për përdorimin e kredive dhe huave dytësore, apo njohje të drejtash nga CEZ Shpërndarje sh.a. (dëm ekonomik i parikuperueshëm);
- Në vlerën 352 milion euro, si diferencë midis detyrimeve afat-shkurtra të njohura dhe të drejtave afat-shkurtra të njohura (mungesa në kapitalin qarkullues) të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a., vlerë që përfshin edhe detyrimet për faturat e blerjes së energjisë dhe tarifave të transmetimit ndaj KESH dhe OST, të akumuluar gjatë administrimit të CEZ a.s., në një nivel 41,198,699,479 lekë bashkë me interesat ose 294 milion euro (dëm që do rëndojë gjëndjen financiare të shoqërisë në të ardhmen);
- Në vlerën 32 milion euro, për zhvlerësimin e vlerës së tregut të 24% të aksioneve të shtetit në CEZ Shpërndarje sh.a. Gjithashtu nga ky mision auditimi u arrit në konkluzionet se: mos pretendimi i diferencës ndërmjet vlerës së aksioneve të Qeverisë Shqiptare gjatë privatizimit (CEZ a.s., ka paguar 102 milion euro).

Në këtë vlerësim dëmi, janë marrë parasysh shumat saktësisht të përcaktuara dhe është abstraguar nga kosto shtesë e nevojshme për të rivitalizuar dhe kthyer në

parametra normal aktivitetin dhe rrjetin e keqadministruar nga CEZ a.s., të cilat nga përlllogaritjet e ERE-s (*cituar në raportin e ekspertit financiar ndërkombëtar*) mund të vlerësohen në një vlerë 185 miliard lekë dhe 218 miliard lekë, apo dëme që mund të vinë në të ardhmen nga ngjarje dhe fakte të cilat janë pasojë e keqadministrimit të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a., përgjatë viteve 2009-2012.

Megjithëse verifikohet rritja e humbjes me 66 miliard lekë (472 milion euro) nga Grupi i Punës nuk është dokumentuar asnjë pretendim i tillë, duke i lënë në këtë mënyrë Shtetit Shqiptar detyrimin për të paguar për keqmenaxhimin në vite të realizuar nga administratorët e emëruar nga CEZ a.s., Pragë, për kompaninë që privatizoi nën statusin e investitorit strategjik në fillim të vitit 2009. Situata e verifikuar ku shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a., jo vetëm ka një kapital neto negativ por është edhe në kushtet e paafësisë për të paguar detyrimet ndaj furnitorëve të cilat janë rritur ndjeshëm gjatë vitit 2012, tregon se shoqëria ishte në kushtet e falimentit. Nëse do të shkonte në likuidim, nga shoqëria CEZ a.s., nuk do të ishte rikuperuar ndonjë pjesë nga shuma e investuar. Me marrëveshjen e lidhur, risku i falimentit i ka kaluar i gjithi Shtetit Shqiptar, i cili edhe pagoi për të marrë këtë risk. Pra jo vetëm u trashëgua një shoqëri e falimentuar por paguam edhe para për të marrë përsipër humbjet dhe borxhet e trashëguara. Konstatohet një regjim trajtimi me standarde të dyfishta duke favorizuar shoqërinë mëmë CEZ a.s. dhe shoqëritë bija të krijuara në Shqipëri (CEZ Trade dhe CEZ Albania), duke njohur dhe likuiduar detyrimet e këtyre shoqërive dhe duke lënë me statusin debitor detyrimet e shoqërive anonime shtetërore KESH dhe OST të cilat kanë dhe nivelin më të lartë të detyrimeve të marra përsipër nga shteti nën këtë marrëveshje.

Keqmenaxhimin financiar të shoqërisë nën administrimin e CEZ a.s., e theksojnë edhe kontratat e lidhura me shoqëri të ndryshme të mbledhjes së borxhit, për të cilat nga ish Avokatja e Përgjithshme e Shtetit ishte depozituar Kallzim Penal. Këto kontrata rezultojnë të kenë realizuar një faturim në vlerën 621 milion lekë, sipas pasqyrave të siguruara nga eksperti i kontraktuar nga shteti ose 4.4 milion euro, kontrata në të cilat nivelet e tarifave të shërbimit konstatohet të variojnë nga 28% deri 50% të shumës së borxhit të mbledhur, kur është e vërtetueshme që tarifat normale të shërbimit të përmbartimit privat në Shqipëri janë ndërmejt 2-6% të borxheve mbi 500,000 lekë. Një gjë e tillë nga zhvillimet e fundit i jep plotësisht të drejtë dhe konkluzioneve të KLSH.



### Konkluzione të arritura në përfundim të këtij auditimi mund të përmendim:

Veprimet dhe mos veprimet e Grupit të Punës kanë bërë zero të gjitha pretendimet për detyrimet që CEZ a.s., i detyrohej palës shqiptare duke mos mbrojtur kështu interesat e Shtetit Shqiptar, ndërmjet mungesës së ballafaqimeve të fakteve në favor të shtetit, dhe duke përdorur standarde të dyfishta në vendimmarrje.

- Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në funksion dhe në zbatim të detyrave të tij ligjore si titullar i institucionit dhe anëtar i Grupit të Punës të ngarkuar me negocimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes për Zgjidhjen me Mirëkuptim, ka patur detyrimin dhe përgjegjësinë e veçantë që në kushtet e titullarit të Institucionit që kishte drejtuar për një kohë të gjatë të gjithë veprimtarinë ndërinstitucionale në drejtim të mbrojtjes së interesave të Shtetit Shqiptar në mosmarrëveshjen ndërmjet CEZ a.s. dhe Republika e Shqipërisë jo vetëm të mos nënshkruante një marrëveshjeje tërësisht të disfavorshme dhe në shpërfillje të plotë të pretendimeve dhe interesave të Shtetit Shqiptar por edhe të paralajmëronte dhe informonte edhe anëtarët e tjerë të Grupit të Punës, në lidhje me të gjitha ato përcaktime në marrëveshjeje në të cilat rrezikoheshin qartazi interesat e ligjshme të Shtetit Shqiptar.

Në përfundim të këtij auditimi nga ana e KLSH përveç adresimit të materjalit të auditimit për institucionin e Prokurorisë u la dhe rekomandimi për Kuvendin e Shqipërisë:

- Ngritjen e një komisioni ad-hoc të pavarur, me ekspertë teknik dhe ekonomik të cilët do të vlerësonin realisht dhe me saktësi dëmin nga aktiviteti nën administrimin e CEZ a.s., si dhe do të përcaktonin mundësinë më të mirë për një rimëkëmbje të Operatorit të Shpërndarjes mbi baza të monitorimit të kujdesshmëm të të gjithë treguesve për periudhën e tanishme, duke përcaktuar në çdo rast përgjegjësitë individuale dhe institucionale për të gjithë aktorët që lejuan këtë situatë me të cilën financave publike u shtohet një dëm me efekte në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë. Të kërkohet një disiplinë e fortë financiare dhe një kontroll i vazhdueshëm nga Kuvendi, për çdo investim dhe vendimarrje strategjike lidhur me Operatorin e Shpërndarjes, për të mundësuar me hapa konkretë përmirësimin e gjëndjes së verifikuar.

## 2. AUDITIMI NË AKBN DHE ALBPETROL “MBI VEPRIMTARINË NË SEKTORIN HIDROKARBUR”

*Referues: Alush ZAÇE - Kryeauditues,  
Valentina GOLEMI – Audituese e parë,  
Artan TOPJANA – Auditues i lartë.*

### Objekti i auditimit



Megjithë pengesat e krijuara nga strukturat që operojnë në sistemin e hidrokarbureve në lidhje me mosvënien në dispozicion të KLSH të dokumentacionit për auditim, nga ana e KLSH-së u arrit që gjatë vitit 2015 të auditohej veprimtaria e MEI, AKBN dhe AlbPetrol me objekt: *Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të*

*aktivitetit ekonomik e financiar mbi objektin e veprimtarisë së AKBN: “zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e post shfrytëzimit të tyre, në sektorin hidrokarbur” dhe “Zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik e financiar mbi objektin e veprimtarisë së AlbPetrol sh.a.”.*

Meqenëse proceset hidrokarbure dhe veprimtaria teknike e financiare për këto procese është e lidhur, e ndërlikuar dhe shtrihet në kohë, nga ana KLSH auditimet u realizuan pothuajse për periudhën e aktivitetit rreth 10 vjeçare të Marrëveshje Hidrokarbure (MH) dhe Licencë Marrëveshje Hidrokarbure (LMH).

### I. AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE - AKBN

Terreni dhe këmbëngulja e KLSH në plotësimin e misionit auditues

Të ndërgjegjshëm për interesimin e lartë të publikut në lidhje me këtë auditim ku Hidrokarburet sipas ligjit janë pasuri publike. Duke njohur problematikën strukturore administrative në sektorin hidrokarbur dhe kuadrin ligjor e rregullator e

mënyrën e mbajtjes e të arkivimit të dokumentacionit që vështirëson së tepërmi përdorimin e tij për qëllim auditimi.

Duke njohur lidhjet e ndërsjella difekteze rregullatore, institucionale ndërmjet MEI, AKBN dhe AlbPetrol sh.a., që ka rezultuar në krijimin e një trekëndëshi për pasimin tek njëri tjetri të përgjegjëseve institucionale, për mos përmbyshje të misionit në lidhje me administrimin e pasurive natyrore e ato hidrokarbure në veçanti.

Të ndodhur përpara faktit se në administratën e këtyre institucioneve përgjatë viteve ka pasur ndryshime të shpeshta të personelit drejtues.

Me qëllim që detyra audituese të realizohej plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e KLSH si dhe Standardet e auditimit për një Raport Përfundimtar auditimi sa më të plotë, kompetent e profesional, meqenëse në fushën e Hidrokarbureve kërkohen njohuri të veçanta profesionale.

### Problematika e "MH" dhe "LMH"

Nga auditimi është konstatuar se, në MH dhe LMH, në hartimin dhe miratimin e tyre nuk janë pasqyruar të dhëna teknike gjeologjike tipike të zonave shqiptare, duke mosreflektuar karakteristikat e zonës së kërkimit ose zonës së zhvillimit.

Mos pasja e një institucioni teknik - shkencor të pavarur shqiptar, nuk ka bërë të mundur paraprakisht të kemi studime të zonave mbi teknologjinë e prodhimit/kërkimit, të cilat mund të përdroreshin paraprakisht.

Në këto marrëveshje është kujdesur më shumë për të drejtat e kompanive, duke "harruar" të drejtat e Shtetit Shqiptar.

Këto MH nuk kanë parashikuar penalitetet për mosplotësime të kushteve si nga kompania hidrokarbure si dhe nga pala shtetërore në rastin AKBN (në kërkim) dhe AlbPetrol sh.a (në zhvillim), por është lënë vetëm me klauzolën "për t'iu drejtuar Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar".

Këto mangësi të MH krijojnë mundësinë që të mos vihen para përgjegjësisë e të penalizohen strukturat drejtuese në vite.

### Mundësia e vetme për efektivitet të "MH" dhe "LMH"

Pavarësisht faktit që Marrëveshjet Hidrokarbure për problematikën që përmbajnë dhe faktit të parashikimit të Faktorit R, ato kanë një mundësi që të ishin shumë korrekte vetëm nëqoftëse do të garantohej duke u kryer nga ana e palës shtetërore

(MEI, AKBN, ALBPETROL sh.a.) monitorimi dhe auditimi në mënyrë skrupuloze i çdo operacioni financiar të kompanive.

*Pra, kontrolli i shpenzimeve, rritja e të cilave në raport me të ardhurat, nuk lejojnë faktorin R të dalë 1.*

Gjendja e monitorimit nga ana e strukturave

Është konstatuar se, strukturat shtetërore MEI, AKBN dhe AlbPetrol sh.a., kanë qënë inekzistente, në drejtim të monitorimit të të gjithave operacioneve teknike, konform planeve të miratuara dhe të rezultateve financiare të lidhura me aktivitetin hidrokarbur. Ato janë mjaftuar vetëm me vëzhgimin vizual, sporadik pa u orientuar në kontrollin ligjor, financiar dhe tekniko-shkencor të implementimit të këtyre marrëveshjeve.

Konstatimet nga auditimi

Vetëm për vendburimin Patos – Marinëz, MH që jep rreth 95% të prodhimit të naftës në vendin tonë dhe ka tregues potencial të prodhimit të naftës në territorin shqiptar e për rrjedhojë ka ndikim në ekonominë e shtetit shqiptar, konstatohet se:

*Megjithëse treguesit e prodhimit të naftës kanë ardhur gjithnjë në rritje, për periudhën nga fillimi i aktivitetit të kësaj kompanie deri në momentin e Raportit Përfundimtar të Auditimit, Faktori R ka qënë gjithmonë  $R < 1$ .*

Nga analiza e përgjithshme, në drejtim të shikimit në detaj të Planeve të Zhvillimit dhe Planeve të Punës e Buxhetit të kryer, deri në fund të vitit 2014, ka një diferencë minimalisht, prej afro 305 milion USD që duhet t'i kishte derdhur Shtetit Shqiptar dhe AlbPetrol-it krahas vlerës së Rentës Minerare e cila deri në fund të qershorit vitit 2014 kap një vlerë prej 199,4 milion USD.

Kjo tregon dështim të këtyre politikave qeveritare në drejtim të mirë menaxhimit të burimeve natyrore kombëtare të vendit tonë, e cila duhet të ishte maksimizimi i fitimit për shtetin shqiptar.

Një problematikë tjetër është se kompania ka transferuar interesat e kësaj Marrëveshjeje Hidrokarbure tek bankat huadhënëse, në kundërshtim të plotë si me Marrëveshjen Hidrokarbure dhe bazën ligjore që operon në fushën hidrokarbure. Në lidhje me këtë problematikë nga ana e AKBN-së është kërkuar pranë kompanisë ecuria e kësaj huamarrje, miratimin (nëse ka miratime) nga institucionet respektive, si dhe listën e aseteve të vendburimit Patos-Marinzës. Deri në momentin që është

hartuar ky Raport Përfundimtar Auditimi, për këtë problematikë, nga AKBN vetëm sa është identifikuar kredimarrja nga kompania.

Shkaqet që kanë lejuar gjendjen

Ndryshimet në Planet e Zhvillimit të viteve 2006, 2009 dhe 2011, nuk janë bazuar në Marrëveshjen Hidrokarbure, ndërmjet AlbPetrol sh.a. dhe kompanisë për shfrytëzimin e vendburimit Patos–Marinëz.

Këto amendime kanë sjellë ndryshime në treguesit tekniko-financiar të pritshme të Kompanisë, që në thelb realizojnë ndryshime të Planit të Zhvillimit Afatgjatë, për arsye se vetë struktura dhe filozofia e MH është ndërtuar në një formë të tillë, që çdo ndërhyrje në të, prek Faktorin R.

Mos monitorim i vazhdueshëm mbi aktivitetin e kompanisë.

Mos realizim i asnjë auditimi financiar deri në fund të vitit 2014.

Përdorimi i gazoilit (holluesit) jashtë çdo lloj llogjike me një vlerë për vitin 2012 dhe 2013 prej rreth 135 milion USD për të gjitha kompanitë.

Në marrëveshjet e tjera nga auditimi konstatohet se gjendja është akoma më e mjerueshme.

Përdorimi i holluesit

Nuk është bërë konvertimi i sasisë së holluesit të përdorur me sasinë e naftës bruto të nxjerrë, vlera këto të konsiderueshme, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit gjithsej 89.5 milion USD.

Përdorimi i këtij holluesi me këto përmasa, përveç se konstatohet, ngre dyshimin për përdorim në destinacion tjetër, brenda tregut shqiptar, duke përfituar në mënyrë të padrejtë, nga përjashtimi i akcizës dhe TVSH, mbi këtë produkt importi, me ndikim në deformimin e tregut brenda shtetit.

Përfitime të padrejta nga t.v.sh.

Nga auditimi u konstatua dhe u rekomandua si masë për shpërblim dëmi vlera prej rreth 316 milion lekë, si përfitim i padrejtë i përjashtimeve nga t.v.sh., AKBN i ka dhënë miratimin për përjashtim në mënyrë të parregullt, për furnizimet jo vetëm të këtyre kompanive, por dhe nënkontraktorëve të tyre, duke mos argumentuar arsyen përse shërbimet e ofruar nga nënkontraktorët janë operacione hidrokarbure.

Mbi tërmetet në komunën Zharrë, Fier

Një dëm tjetër i pa rekuperueshëm me pasoja subsidence (fundosje) të sipërfaqes do të ndodhë për shkak të prishjes së ekuilibrit të forcave të brendshme në njësinë e kolektorit, çka do të çojë në shkatërrimin e shtresave litologjike, për rrjedhojë nuk kemi ruajtje të nëntokës, një nga kriteret bazë që qeveria duhet ta monitorojë në mënyrë skrupuloze, mbasi n.q.s. nuk do të mbahet qëndrim i menjëhershëm, do të kemi subsidence (fundosje) të sipërfaqes së tokës në zonën përkatëse, e shoqëruar në vazhdimësi me lëkundje sismike. Kjo është e sigurtë nga ana shkencore ku nuk shtrohet pyetja: A do të ndodhë? Por, kur do të ndodhë?

*(Ky është një konkluzion i shprehur që në Projektraportin e Auditimit të nisur, AKBN dhe MEI me shkresën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr.850/7 datë 09.03.2015, pra rreth 20 ditë më parë nga ndodhja e ngjarjes së Marinzës).*

Nga Auditimi u konstatua se strukturat përgjegjëse për monitorimin e proceseve hidrokarbure dhe vetë strukturat e MEI kanë qenë në dijeni se nga buronin këto lëkundje sismike por nuk kanë pasur vullnetin e dëshirën për ti identifikuar ato nëpërmjet provave dhe interpretimit shkencor të tyre.

Këto lloj lëkundjesh shkaktojnë një dëm të madh në zonën më të afërt, për arsyen se duke qenë në thellësi të vogla, komponentja vertikale është shumë më e rrezikshme se sa po e njëjta lëkundje me të njëjtën shkallë Rihter që shkaktohet nga lëkundje me qendër në thellësi të mëdha, mbasi në këto raste jep ndjeshmëri komponentja horizontale, duke shkaktuar dëme të mëdha edhe për banorët e zonës.

Konkluzion

*Shteti Shqiptar ka përfituar nga renta minerare nga kompania më e madhe rreth 200 milion USD, gjithashtu dhe vlerat e prodhimit paraekzistues PEP (Pre-Existing Production) në favor AlbPetroli sh.a., kjo për një aktivitet prej 10 vjetësh. Nëqoftëse llogarisim se dhe për njëzet vjet aktivitet me këtë performancë të kompanisë, shteti mund të përfitojë jo më shumë se 300 milion USD, duke pasur parasysh se vetëm për reabilitimin e zonës do të nevojiten më shumë se 500 milion USD, rezultati i mirëmanaxhimit e përfitimit nga burime hidrokarbure nga ana e shtetit është me 0 lekë dhe një faturë shëndetësore për tu paguar. Kjo është llogaritja e bërë mbi tregues makroekonomik në analizë të veprimtarisë së kompanisë më të mirë që operon në Shqipëri në fushën e shfrytëzimit të hidrokarbureve.*

Rekomandime për përmirësimin e gjendjes në AKBN

KLSH i ka kërkuar institucioneve më të lartë të shtetit, ndërhyrje të menjëhershme në AKBN dhe gjithë sektorin hidrokarbur, me ndryshime ligjore dhe strukturore përkatëse, si:

AKBN të ketë varësi të drejtpërdrejtë nga Kuvendi ose Kryeministri.

Të ringrihet Instituti Shkencor i Naftës, si një institut i mirëfilltë shkencor i cili të mbështesë të gjitha vendimmarrjet e lidhura me zhvillimet e sektorit të hidrokarbureve në vendin tonë si dhe të bashkëpunojë me Kuvendin dhe Qeverinë lidhur me hartimin e strategjive afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimeve në këtë sektor duke bërë dhe rolin e oponentit teknik gjatë negociimit të marrëveshjeve, shqyrtimit të propozimeve dhe zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, si dhe orientues dhe oponentë e kërkimeve shkencore që lidhen me burimet hidrokarbure. Ky institucion të funksionojë si një institut i pavarur dhe që mbulon kostot e tij nga buxheti i shtetit.

AKBN të marrë masat për ristrukturimin e Drejtorisë Hidrokarbure dhe MEI të marrë masa për miratimin e Rregullores së aktivitetit të kërkimit e zhvillimit të naftës dhe gazit në Shqipëri. MEI, AlbPetrol sh.a. dhe AKBN, në bashkëpunim me institucionet shkencore si Fakulteti i Gjeologji Minierave dhe Institutin Shkencor të Naftës, të marrin masat e nevojshme organizative për krijimin e një databaze të përditësuar në lidhje me depozitimet.

Nga ana e AKBN-së të analizohen me kujdes rastet e konstatuara nga auditimi lidhur me përjashtimin e padrejtë nga t.v.sh.-ja të kompanive që operojnë në sektorin e hidrokarbureve dhe nënkontraktorëve të tyre, duke kërkuar njëkohësisht rikuperimin e këtyre shumave në favor të buxhetit të shtetit.

Raporti Përfundimtar i Auditimit ju përcoll institucionit të Prokurorisë, me kërkesën që në shqyrtim të gjetjeve të konstatuara nga ky auditim të vlerësojë ekzistencën e elementëve të veprave penale të kryera nga drejtues apo nëpunës të AKBN-së duke i ardhur kështu në ndihmë dhe duke i shërbyer edhe hetimit të nisur aktualisht nga Prokuroria në lidhje me ngjarjet e ndodhura në Marinëz. Bashkëlidhur materialeve të dosjes së auditimit, i janë dërguar organit të Prokurorisë edhe shkresat që vërtetojnë dashjen dhe qëllimin e drejtuesve të AKBN-së dhe AlbPetrol-it në drejtim të pengimit të ushtrimit nga KLSH të këtij auditimi përgjatë vitit 2014.

## II. ALBPETROL

Nga auditimi është konstatuar se nuk është kthyer huaja e dhënë sipas kushteve të kontratave nga 4 shoqëri aksionare me vlerë 53.2 milion lekë.

Lidhur me rastet e pushimit kolektiv nga puna, ka sjellë penalizimin e shoqërisë nga ankimet në Gjykatë, me vlerë 26.7 milion lekë.

Në lidhje me administrimin dhe mosruajtjen e pronës shtetërore në administrim të Albetrol sh.a., me pasojë vjedhjen e rërës bituminoze në vlerën kontabile 16.1 milion lekë, të rezultuar si mungesë inventariale në pasqyrat financiare të vitit 2014 dhe të identifikuar në procesverbalet e inventarëve të kryera për qendrën QPN Patos.

Në zbatimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimin e kontratave përkatëse, janë konstatuar parregullsi ligjore shoqëruar me dëm ekonomik me vlerë 7 milion lekë.

Në bilancin e naftës bruto janë zbritur firo transporti dhe magazinimi mbi normat e përcaktuara ligjore, vlerë 2.25 milion lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të AlbPetrol sh.a.

Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure

Referuar periudhës së auditimit, për asnjë marrëveshje hidrokarbure, nuk është arritur faktori R 1.

Referuar marrëveshjeve hidrokarbure, Kontraktori ka bërë përpjekje për shmangien e detyrimeve duke transferuar interesat, me vlerë 10.5 milion USD.

Nga ana e AlbPetrol sh.a., janë audituar llogaritë e kontraktorëve për 3 zona në marrëveshje hidrokarbure, për periudhën tetor-dhjetor 2012 dhe janar-tetor 2013. Auditimi ka rezultuar me parregullsi në lidhje me paraqitjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure, për zonën e Patos-Marinëz, me vlerë 352,513,000 USD, për zonat "Çakran-Mollaj, Gorisht-Kocul, Ballsh-Hekal", me vlerë 33,222,091 USD dhe për zonën e Kuçovës, me vlerë 2,866,000 USD. AlbPetrol është mjaftuar vetëm me konstatimet e auditit, dhe nuk ka zbritur vlerat e mësipërme të përfshirë nga Kontraktorët si shpenzime në operacionet hidrokarbure, në kundërshtim me përcaktimet e marrëveshjeve hidrokarbure. Nga rishikimi i koeficientit R për zonën Patos-Marinëz duke zbritur shpenzimet e pa justifikuara, rezulton se nga ndarja e



fitimit, për Oeverinë Shqiptare Kontraktori duhet të likujdojë për llogari të Oeverisë Shqiptare vlerën 120.8 milion USD.

Duke filluar nga viti 2011, Kontraktorët kanë krijuar detyrime nga ndarja e prodhimit si pjesë e AlbPetrol, me vlerë 3,386 miliard lekë.

Konkluzione dhe rekomandime në AlbPetrol sh.a.

Referuar periudhës së këtij auditimi, në përfundim të tij ka rezultuar se gjatë zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure, prokurimeve, etj., është shkaktuar një dëm ekonomik me vlerë 32.6 miliard lekë. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe auditimi është krijuar një efekt financiar negativ me vlerë 5 miliard lekë.

Nisur nga niveli dhe përgjegjshmëria në ruajtjen e pronës publike në administrim të AlbPetrol, ka rezultuar një humbje të rërës bituminoze në sasinë 22,379 ton me vlerë 16.1 milion lekë, për të cilën KLSH ka depozituar kallzim penal për shpërdorim detyre për një nga drejtuesit e AlbPetrol sh.a.

Për përmirësimin drejtimit të shoqërisë, KLSH ka rekomanduar 29 masa organizative në drejtim të përmirësimit të monitorimit dhe kontrollit të zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure, të ruajtjes së pronës publike, menaxhimit të aseteve, si dhe dhënien e masës disiplinore për 36 punonjës për nivele të ndryshme drejtuese duke filluar që nga masa largim nga puna.

### 3. AUDITIMI NË OSHEE

*Referues: Fatmir ILJAZI – Kryeauditues,  
Ylika PULASHI – Kryeaudituese,  
Mimoza BEDINI – Audituese e parë.*

I nderuar z. Kryetar,

të dashur koleg dhe pjesëmarrës në këtë analizë!



Kam nderin dhe privilegjin, që në emër të grupit të auditimit dhe të departamentit, të paraqes rezultatet e auditimit të ushtruar në Shoqërinë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., Tiranë, për periudhën nga data 21.01.2013 deri më 30.06.2015, periudhë në të cilën kompania ka qenë në administrim nga shtetit.

Këto rezultate janë një pjesë e vogël, e atyre që ka arritur Departamenti për vitin 2015, rezultate të cilat janë arritur fal punës së të gjithë kolegëve, të drejtuar dhe menaxhuar me shumë kujdes nga drejtori i departamentit dhe ndihmës së pa kursyer të drejtorisë juridike.

Statusi juridik i shoqërisë

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., Tiranë, është person juridik që funksionon si shoqëri aksionare, organizimi i së cilës bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Kjo shoqëri është regjistruar si person juridik, në regjistrin tregtar datë 19.06.2007.

Më datën 23.06.2014 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë CEZ a.s., është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit. Kjo marrëveshje është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 428, datë 02.07.2014. Marrëveshja është miratuar me ligjin nr. 114/2014 "Për miratimin e marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë CEZ a.s.

Me urdhrin nr. 454, datë 22.10.2014 të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, aksionet e Shoqërisë OSHEE sh.a., janë 100 % në pronësi të Shtetit Shqiptar.

Aksioneri i shoqërisë është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), për llogari të Republikës së Shqipërisë.

### Rezultati i auditimit

Në përfundim të auditimit është konstatuar një dëm tërësor ekonomik në vlerën 32,039,440 euro, si dhe të ardhura të munguara për Shoqërinë OSHEE sh.a. dhe për Buxhetin e Shtetit në vlerën 5,630,713 euro.

Si rezultat i këtij dëmi, KLSH ka depozituar pranë organit të Prokurorisë, kallëzimin penal nr. 495/21, datë 25.09.2015 për ish administratorin e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a., si dhe dy ish drejtues të lartë të kësaj shoqërie, *për periudhën kur kjo shoqëri ka qenë nën administrim të përkohshëm të Shtetit Shqiptar.*

Më konkretisht, për periudhën objekt e auditimi është evidentuar keq menaxhimi i kësaj shoqërie për sa i përket: Blerjes së energjisë elektrike, zbatimit të procedurave të blerjes së materialeve dhe pajisjeve elektrike, zbatimit të procedurave të prokurimit publik, sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhënies së pagave dhe shpërblimeve, hartimin dhe mbajtjen e pasqyrave financiare, etj.

1) *Nga auditimi i blerjes së energjisë elektrike, rezultoi se është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 21,238,860 euro, si rrjedhojë e:*

a) *Blerjes së energjisë elektrike me çmime më të larta se ato të tregut.*

Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a. nuk ka zbatuar procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistem, për periudhën Janar-Korrik 2014, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 9,727,223.4 euro. Konkretisht blerja e energjisë elektrike është kryer me *çmime shumë më të larta se çmimet e tregut*, nga 7.94 euro deri në 13.12 euro për Mwh.

*b) Mbifaturimit të konsumatorëve*

I realizuar nëpërmjet uljes artificiale të humbjeve teknike, duke shkaktuar një dëmtim të interesave të ligjshme të shoqërisë KESH sh.a. dhe Buxhetit të Shtetit, për vitin 2014, në vlerën 11,082,687 euro.

Konkretisht për vitin 2014, u konstatua se në mënyrë artificiale janë ulur humbjet teknike, veprim i cili është kryer me fatura të dyshimta (mbi faturim, keq faturim, faturim të abonentëve pa adresë, si dhe abonentëve që nuk kanë arkëtuar asnjëherë, etj.).

- Ky faturim është bërë në mënyrë abuzive dhe të pasaktë, pasi reflekton një sasi të pa konsumuar të energjisë elektrike, por edhe një faturim fiktiv me abonent që nuk kanë arkëtuar asnjëherë (të cilët rezultojnë aktiv në sistemin e faturimit, ndoshta edhe nuk ekzistojnë fare, etj.).

*c) Blerjes së energjisë elektrike nga kompani të lidhura ndërmjet tyre.*

I realizuar nëpërmjet blerjes së energjisë elektrike nga tre kompani të lidhura ndërmjet tyre (një kompani mëmë dhe dy bija), për mbulimin e humbjeve të energjisë në sistemin e shpërndarjes për periudhën korrik 2014–mars 2015, duke shmangur konkurrencën, si pasojë e së cilës është shkaktuar një dëm ekonomik për llogari shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a. dhe më pas për shoqërinë OSHEE sh.a., në vlerën 428,950 euro.

2) Nga auditimi i blerjes së materialeve dhe pajisjeve elektrike nga shoqëria ÇEZ Shpërndarje, përgjatë vitit 2014, rezultoi që është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 4,359,882 euro, si rrjedhojë e shkeljeve të procedurave të tenderimit të vendosura nga ERE, realizimit të procedurave me një fazë negocimi, kryerjes së shtesave të kontratave në vlera të konsiderueshme që arrinin nga 50% deri në 70% të vlerës së kontratës bazë, si dhe blerjes në disa raste të materialeve dhe pajisjeve elektrike, pa zhvilluar procedura tenderimi.

3) Nga auditimi i pjesshëm për shkak të dokumentacionit të mangët ekonomiko-financiar, i disa prej kompanive të mbledhjes së borxhit të keq të energjisë elektrike, rezultoi që këto kompani kanë përfituar padrejtësisht nga Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a., së paku vlerën prej 6,074,478 euro, për të cilën grupi i auditimit është shprehur me rezervë, si pasojë e:

- Mungesës së një inventari të plotë të llogarive (inventar fizik të aseteve dhe inventar kontabël) të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a., si në momentin e kalimit të kësaj shoqërie nën administrimin e përkohshëm të Shtetit më datë 21.01.2013, ashtu edhe pas kësaj date deri në periudhën e përfundimit të këtij auditimi.
- Mos disponimit të programeve autentike të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a. (SAP - Programi i kontabilitetit, Billing – Programi i faturimit dhe Mobirid- Programi i leximit të matësve), mbi bazën e të cilave kjo kompani menaxhonte dhe administronte aktivitetin e saj, që nga momenti i kalimit të kësaj shoqërie nën administrimin e përkohshëm të Shtetit dhe deri në periudhën e përfundimit të këtij auditimi.
- Ekzistencës së të dhënave kontradiktore në dokumentacionin e disponuar në OSHEE, nga dega ekonomike, drejtoria ligjore dhe drejtoria e shitjes.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua që për katër kompanitë e audituara, nga ana e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a., nuk disponohej dokumentacioni i plotë për justifikimin e pagesave të dhëna këtyre kompanive të mbledhjes së borxhit të keq, *duke ngritur dyshime serioze për shumat e përfituara padrejtësisht prej këtyre kompanive nga Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a.*

Në mungesë të ekzistencës së dokumentacionit të plotë justifikues për *zbatimin e detyrimeve kontraktore* të kompanive të mbledhjes së borxhit të keq të energjisë elektrike, vlera *6,074,478 euro*, është konsideruar dëm ekonomik i përfituar në mënyrë të padrejtë nga ana e tyre.

Në lidhje me këtë konstatim, KLSH i ka rekomanduar Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të OSHEE, marrjen e masave të menjëhershme për të përfshirë në veprimtarinë e saj audituese, aktivitetin e të gjitha kompanive të mbledhjes së borxhit të keq të energjisë elektrike, duke analizuar në veçanti kallëzimin penal të Avokaturës së Shtetit, përcjellë organit të Prokurorisë me shkresën nr. prot. 526/34, datë 24.07.2013, si dhe të organizojë punën për auditimin e plotë të veprimtarisë administruese dhe menaxhuese, ekonomike dhe financiare të CEZ Shpërndarje sh.a., për periudhën e administrimit të përkohshëm të kësaj kompanie, duke filluar nga data 21.01.2013.

4) *Nga auditimi i zbatimit të kuadrit rregullator në dhënien e pagave dhe shpërblimeve* rezultoi se është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën *336,986 euro*, si

rrjedhojë e pagesave të tepërta për shpërblime në fund të vitit, si dhe një dëm ekonomik në vlerën 29,232 euro përsa i përket shpenzimeve të ndryshme operative.

5) *Nga auditimi i blerjes së energjisë elektrike në muajin dhjetor 2014*, u konstatuan të ardhura të munguara për shoqërinë OSHEE dhe për buxhetin e shtetit, të krijuar nga eksporti i energjisë nga KESH sh.a. dhe importit të energjisë nga OSHEE në vlerën 5,630,713 euro, ku OSHEE ka blerë energji elektrike me çmim 22,32 euro/Mwh më të lartë se sa çmimi i shitjes së KESH sh.a. në këtë periudhë.

#### 6) *Të tjera*

Veç sa më sipër, auditimi ka evidentuar që nga ana e CEZ Shpërndarje sh.a., nuk janë ndjekur procedurat për hartimin, miratimin e projekt-programit ekonomik dhe financiar, nuk është raportuar periodikisht në ERE; nuk është miratuar niveli i pagave të punonjësve në ministrinë përkatëse; ka diferenca në inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme; ekzistojnë mospërputhje e llogarive të arkëtueshme midis sistemit të faturimit dhe të dhënave të kontabilitetit për faturat e papaguara nga abonentët, si dhe mospërputhje e detyrimeve për huat afatgjata me Shoqërinë KESH sh.a. dhe OST; ka mangësi në zbatimin e procedurave të prokurimit publik dhe në zbatimin e kontratave, nuk është ngritur njëسيا e prokurimit; studimi i vlerës së kontratave për investimet nuk është plotësisht i saktë; nuk është hartuar dhe miratuar një plan strategjik auditimi dhe plan vjetor i punës së departamentit të auditit të brendshëm; ka mangësi në procedurat për blerjen e energjisë elektrike dhe mbledhjen e borxhit të shoqëruara me dëm ekonomik, etj.

#### 7) *Kallëzim penal*

Me shkresën nr. 495/21, datë 25.09.2015, KLSH ka depozituar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, kallëzimin penal për Arben Seferaj në cilësinë e ish-Administratorit të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a. (përgjatë vitit 2014), Enea Zafirin, në cilësinë e ish-Drejtorit të Departamentit të Shitjes në CEZ Shpërndarje sh.a. dhe Julian Zanaj, në cilësinë e ish Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse në CEZ Shpërndarje sh.a., të cilët në mospërmbushje të rregullt të detyrës së tyre funksionale kanë konsumuar elementët e figurës së veprave penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe më konkretisht për shkeljet e konstatuara në lidhje me:

- Blerjen e pajisjeve dhe materialeve elektrike emergjente për nevojat e shoqërisë, në vitin 2014;
- Moszbatimin e kuadrit rregullator për blerjet e energjisë elektrike, duke e blerë atë me çmime më të larta se ato të tregut, si dhe
- Uljen artificiale të humbjeve teknike, nëpërmjet mbifaturimit të konsumatorëve.

### *8) Masa organizative, zhdëmtimi dhe disiplinore*

Me Vendim nr. 119, datë 24.09.2015 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në lidhje me këtë auditim, janë dhënë rekomandime për 30 masa organizative, 16 masa të ndryshme disiplinore që variojnë nga zgjidhja e kontratës së punësimit deri në vërejtje, si dhe 9 masa zhdëmtimi *për të gjithë dëmin ekonomik te konstatuar*, masa të cilat bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. prot. 495/20, datë 24.09.2015, i janë dërguar për zbatim z. Adrian Çela, administrator i shoqërisë OSHEE sh.a., masa të cilat për zbatimin e tyre do ndiqen në vijimësi.

#### 4. AUDITIMI MBI MBLEDHJEN E RENTËS MINERARE

*Referues: Albana AGOLLI – Drejtore Departamenti,  
Joniada GOÇAJ – Audituese e parë,  
Artan MIRASHI – Auditues i lartë.*



Auditimi i mbledhjes së taksës së Rentës Minerare, u krye në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe 6 (gjashtë) Degë Doganore si dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve e 7 (shtatë) Drejtori Rajonale Tatimore.

Në hartën e burimeve minerale të Shqipërisë pasqyrohen: rreth 15 vendburime naftë, 6 vendburime gazi, 500 vendburime të mineraleve të ngurta, nga të cilat: 293 kromi, 108 bakri, 21 hekur-nikel, 45 qymyrguri, etj.



Mineralet kryesore mbi të cilat aplikohet rentë, paraqiten si më poshtë:

- Kromi: Rreth 30 milion ton rezervë, të shprehur në vlerë rreth 60 miliard dollarë.
- Bakri: Rreth 20 milion ton.
- Hekur-nikeli: Rreth 300 milion ton, në vlerë rreth 10 miliard dollarë.
- Guri Gëlqeror e dekorativ: i shfrytëzueshëm, në vlerë 1.1 miliard dollarë.
- Bitumi: Rreth 520 mijë ton bitum natyral, (aktualisht shfrytëzohet në Selenicë).





- Nafta: Rreth 400 milion tonë, në vlerë rreth 40 miliard dollarë (100 \$/ton).

Të dhënat mbi pasuritë minerare që aplikohet rentë janë marë nga Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore, Ministria e Energjitikës Komisionit ad-hoc ndërmistror dhe bursat në momentin e auditimit.

Mbulimi me auditim: Në auditimin tematik të mbledhjes së Taksës së Rentës Minerare në Dogana dhe Tatime janë audituar pothuajse 100% e Degëve Doganore dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore që deklarojnë dhe mbledhin Taksën e Rentës Minerare.

## 1. AUDITIM TEMATIK “MBI DEKLARIMIN DHE PAGESËN NË EKSPORT TË TAKSËS KOMBËTARE PËR RENTËN MINERARE”

Auditimi u krye në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Degët Doganore: Durrës, Fier, Vlorë, Kakavijë, Qafë Thanë dhe Bllatë.

Periudha e audituar: vitet 2013 – 2014.

Drejtimit Kryesore të auditimit:

- Mënyra e përcaktimit të vlerave të mineraleve të eksportuara;
- Plotësimi i materialit shoqërues së praktikës doganore;
- Informimi analitik me MF dhe rakordimi me përfituesit dhe derdhja në favor të tyre.

Arsyet e evazionit në këtë fushë:

- Llogaritja e vlerës së mineralit, si bazë për përcaktimin e rentës minerare, nuk bëhet në përputhje me vlerën e mineralit sipas çmimit të bursës apo çmimeve të përcaktuara nga Komisioni ad-hoc;
- Praktika doganore e eksportit për mineralet, nuk shoqërohet me dokumentacionin ligjor që përcakton cilësinë e mineralit, mbi të cilin përcaktohet çmimi;
- Mos rakordimi për pagesat e kryera të taksës së rentës minerare ndërmjet DD dhe DRT, kanë sjellë mosdeklarim të të ardhurave nga subjektet eksportuese.

## Gjetjet nga auditimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga auditimi tematik mbi deklarimin dhe pagesën në eksport të Taksës Kombëtare për Rentën Minerare, të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Degët e Doganore, Durrës, Fier, Vlorë, Kakavijë, Qafë Thanë dhe Bllatë, për periudhën 2013–2014, ka konstatuar mospërputhje në veprimtarinë e administratës doganore me kërkesat e kuadrit rregullator në procedura dhe të meta e mangësi, në zbatimin e legjislacionit dhe akteve administrative që rregullojnë eksportin e mineraleve si në drejtim të procesit të vlerësimit e pranimit të deklaratave doganore të eksportit nga subjektet eksportuese ashtu dhe në llogaritjen dhe arkëtimin e Taksës së Rentës Minerare, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën prej 3,321,665,015 lekë dhe të ardhura të munguara në buxhet në shumën prej 57,834,811 lekë, (ose në total 24,139,000 euro), si rezultat i mos llogaritjes dhe mos arkëtimin të taksës kombëtare për rentën minerare, për mineralet e eksportuara.

E ndarë sipas mineraleve e Degëve Doganore rezultojnë:

Nr.	Dega Doganore	Dëmi ekonomik në lekë	Minerali	Subjekte (numër)
1	Vlorë	3,312,447,182	Naftë bruto	3
2	Qafë Thanë	57,834,811	Hekur Nikel	15
3	Durrës	15,337,725	Krom	44

Për minerale të tjera (gur gëlqeror e ranor dhe gur dekorativ):

Nr.	Dega Doganore	Dëmi ekonomik në lekë	Subjekte (numër)
1	Kakavijë	7,736,736	27
2	Vlorë	825,206	9
3	Fier	655,891	6

Në Degën e Doganës Vlorë, ndër subjektet eksportuese të naftës bruto konstatohen subjekte që kanë deklaruar në eksportin e naftës bruto çmim dukshëm me të ulët nga çmimi bruto i kuotuar në bursë në kohën e eksportimit dhe të njoftuar zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, mbi bazën e të cilit, llogaritet dhe paguhet taksa kombëtare për rentën minerare sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi dhe në mënyrë specifike të VKM nr. 7, datë 04.01.2012 “Për Përcaktimin e Procedurave dhe të Dokumentacionit të Nevojshëm për Arkëtimin e Taksës së Rentës Minerare” me ndryshime. Si rezultat i diferencave të çmimit të deklaruar nga subjektet dhe çmimit të kuotuar në bursë dhe të njoftuar zyrtarisht nga DPD mbi bazën e të cilit duhej të llogaritej kjo taksë, rezulton se, të ardhurat nga taksa kombëtare mbi rentën minerare në eksportin e naftës bruto, janë më të ulëta në shumën prej 3,312,447,182 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, i shkaktuar respektivisht nga 3 subjekte.

Në Degën e Doganës Qafë Thanë, ndër subjektet eksportuese të mineralit Hekur Nikel, konstatohen subjekte që kanë deklaruar në eksportin e mineralit Hekur Nikel, çmimin mesatar rreth 9 \$/toni, FOB, i cili është dukshëm me i ulët nga çmimi i tregut të mineralit me përmbajtje nikeli të afërt me Mineralin e Hekur-Nikelit që nxirret në vendin tonë, të eksportuar sa më sipër, mesatarisht rreth 34 \$/ton deri 43 \$/ton, FOB, i evidentuar nga të dhënat e publikuara të periudhës dhe i përlllogarit sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi dhe në mënyrë specifike të VKM nr.7, datë 04.01.2012 “Për Përcaktimin e Procedurave dhe të Dokumentacionit të Nevojshëm për Arkëtimin e Taksës së Rentës Minerare” me ndryshime, në bashkëpunim me Drejtorinë e Vlerës në DPD. Si rezultat i diferencave të çmimit të deklaruar nga subjektet dhe çmimit mesatar të tregut sa më sipër, rezulton se, të ardhurat nga taksa kombëtare mbi rentën minerare në eksportin e mineralit, Hekur Nikel, janë më të ulëta në shumën prej 57,834,811 lekë, e cila përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e shtetit, i shkaktuar respektivisht nga 9 subjekte eksportuese gjatë vitit 2013, në shumën prej 16,258,086 lekë dhe nga 7 subjekte eksportuese gjatë vitit 2014, në shumën prej 41,576,725 lekë. Diferencat e konstatuara sa më sipër ndikojnë negativisht gjithashtu dhe në bazën e përlllogaritjes së vlerës së tatueshme nga administrata tatimore për efekt të llogaritjes dhe pagesës së detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Në Degën e Doganës Durrës, ndër subjektet eksportuese të mineralit të kromit, konstatohen subjekte që kanë deklaruar në eksportin e mineralit të kromit çmim

mesatar dukshëm me të ulët nga çmimi i përcaktuar nga Komisioni *ad-hoc* pranë MF, mbi bazën e të cilit, llogaritet dhe paguhet Taksa Kombëtare për rentën minerare sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi dhe në mënyrë specifike të VKM nr.7, datë 04.01.2012 “Për Përcaktimin e Procedurave dhe të Dokumentacionit të Nevojshëm për Arkëtimin e Taksës së Rentës Minerare” me ndryshime. Si rezultat i diferencave të çmimit të deklaruar nga subjektet dhe çmimit të përcaktuar nga Komisioni *ad-hoc* pranë MF, mbi bazën e të cilit duhej të llogaritej taksa mbi rentën minerare, rezulton se, të ardhurat nga taksa kombëtare mbi rentën minerare në eksportin e mineralit të kromit, janë më të ulëta në shumën prej 15,337,725 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, i shkaktuar nga 44 subjekte gjatë vitit 2013.

Në periudhën 2013 – 2014, në eksportimin e artikullit blloqe guri dhe pllaka guri, rezultuan eksporte me çmim mesatar dukshëm me të ulët nga çmimi i përcaktuar nga Komisioni Ad hoc pranë MF, mbi bazën e të cilit, llogaritet dhe paguhet Taksa Kombëtare për rentën minerare sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi dhe në mënyrë specifike të VKM nr. 7, datë 04.01.2012 “Për Përcaktimin e Procedurave dhe të Dokumentacionit të Nevojshëm për Arkëtimin e Taksës së Rentës Minerare” me ndryshime. Si rezultat i diferencave të çmimit të deklaruar nga subjektet dhe çmimit të përcaktuar nga Komisioni *ad-hoc* pranë MF, mbi bazën e të cilit duhej të llogaritej taksa mbi rentën minerare, rezulton se, të ardhurat nga taksa kombëtare mbi rentën minerare në eksportin e artikullit blloqe guri dhe pllaka guri, nëpërmjet *Degës së Doganës, Vlorë* janë më të ulëta në shumën prej 825,206 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, e shkaktuar nga 9 subjekte; nëpërmjet *Degës së Doganës, Fier* janë në shumën prej 655,891 lekë, dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, e shkaktuar nga 6 subjekte dhe, nëpërmjet *Degës së Doganës, Kakavijë* në shumën prej 7,736,736 lekë, dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, e shkaktuar nga 27 subjekte.

Nga auditimi u konstatua gjithashtu se, dokumentacioni shoqërues, bashkangjitur deklaratave të eksportit të mineraleve, është plotësuar nga subjektet dhe pranuar nga autoritetet doganore me të meta e mangësi si: praktika doganore nuk shoqërohet me dokumentacion bankar origjinal për likuidimin e taksës së rentës minerare në degët tatimore, nuk rezulton dokumentacion mbi rakordimin e pagesave të rentës midis degëve doganore e atyre tatimore, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”,

ndryshuar me Udhëzim Nr. 2, datë 12.3.2014, kontratat e shitblerjes të subjekteve eksportues të mineraleve, jo në të gjitha rastet janë bashkëlidhur praktikës apo të depozituara në Degën Doganore, raport analiza mbi % e mineralit, jo në të gjitha praktikat e audituara, është e bashkëlidhur deklaratës doganore, në degën e Doganës Durrës përmbajtja e  $\text{Cr}_2\text{O}_3$  deklarohet shumë më e ulët se % të  $\text{Cr}_2\text{O}_3$  e përcaktuar në lejet e shfrytëzimit sipas subjekteve ku, ka rezultuar se, i njëjti subjekt, me të njëjtën leje shfrytëzimi, ka deklaruar krom me përmbajtje  $\text{Cr}_2\text{O}_3$  shumë të ndryshme. Analizat laboratorike për përcaktimin e % të  $\text{Cr}_2\text{O}_3$  në mineralin e kromit kryhen nga laboratorë të pa akredituar, bashkangjitur raport analizave mungon dokumentacioni që të vërtetojë metodikën e marrjes së mostrave për analizë dhe së cilës sasi minerali i përkasin mostrat dhe analizat. Në Degët Doganore Fier, Kakavijë, Qafë Thanë, nuk është kryer rakordim me Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Bazë për llogaritjet: VKM nr. 7, datë 04.01.2012 "Për Përcaktimin e Procedurave dhe të Dokumentacionit të Nevojshëm për Arkëtimin e Taksës së Rentës Minerare" me ndryshime, si rezultat i diferencave të çmimit të deklaruar nga subjektet me çmimet e kuotuar në bursë ose çmimit mesatar të tregut dhe çmimit të përcaktuar nga Komisioni ad-hoc pranë MF, të njoftuar zyrtarisht nga DPD mbi bazën e të cilit duhej të llogaritej taksa mbi rentën minerare si dhe çmimet në bursa njoftuar zyrtarisht.

Në bazë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, finalizuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH Nr. 53, datë 30.04.2015, për përmirësimin e punës në të ardhmen i janë rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degëve Doganore marrja e masave si vijon:

- 5 masa organizative;
- 1 masë administrative.

Për verifikimin e çmimit të mineralit të hekur nikelit në bursa dhe rillogaritjen e taksës së rentës minerare (nga diferenca e çmimit të deklaruar nga subjektet dhe çmimit mesatar të tregut rezulton e arkëtuar më pak 57,834,811 lekë):

4 masa për shpërblim dëmi në vlerën 3,321,665,015 lekë, rekomanduar 100% për shpërblim.

Llogaritjen e borxhit doganor për taksën mbi rentën minerare dhe detyrimet për të ardhurat e munguara nga 9 subjekte gjatë vitit 2013, në shumën prej 16,258,086 lekë dhe, nga 7 subjekte gjatë vitit 2014, në shumën prej 41,576,725 lekë.

Për shumën prej 15,337,725 lekë, të shkaktuar nga 44 subjekte nëpërmjet Degës së Doganës Durrës, nga Autoriteti Doganor, kanë dalë vendimet përkatëse gjatë procesit të auditimit, pas dërgimit të Projekt Raportit të Auditimit.

- 15 masa disiplinore

Sugjerimet për përmirësimin e punës në këtë sektor në të ardhmen:

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Degët Doganore të marrin në analizë mosrealizimet dhe shkeljet ligjore për këtë taksë dhe të përcaktojnë përgjegjësitë e masat përkatëse për parandalimin e evazionit fiskal, që për periudhën e audituar paraqitet në vlerën e dëmit të konstatuar nga auditimi.
- DPD mbështetur në çmimet e tregjeve ndërkombëtare, të dhënat statistikore të AKBN-së, investigimet e tregut brenda dhe jashtë vendit, të bëjë azhurnimin dhe t’jua dërgojë Degëve Doganore të dhënat e disponueshme për çmimet sipas llojit të mineraleve, të dhënave të cilësisë e përmbajtjes së tyre.
- Praktikat Doganore të eksportit të shoqërohen me dokumentacionin e nevojshëm (origjinal ose i noterizuar), për pagesën e kryer në DRTatimore si dhe dokumentacionin për cilësinë e mineralit.
- Praktikat Doganore të eksportit të Mineralit të Kromit në llogaritjen e detyrimeve për Taksën Kombëtare të rentës minerare të bazohen në çmimin real të shitjes së këtij minerali dhe në të dhënat zyrtare për këtë qëllim.
- DPD të informojë Ministrinë e Financave, për shumën e arkëtuar të Taksës së rentës minerare sipas Degëve Doganore, subjekteve dhe NJQV-ve ku ushtrojnë aktivitetin këta subjekte.
- DPD, Drejtoria e Vlerës në zbatim të pikës 7 të VKM-së nr. 7 datë 04.01.2012, duhet të paraqesë vlerën e tregjeve të mineraleve për mineralet e Hekur Nikelit të eksportuar.
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave brenda afateve të përcaktuara të informoje Ministrinë e Financave, për shumën e arkëtuar të Taksës së Rentës Minerare sipas Degëve Doganore, subjekteve dhe NJQV-ve ku ushtrojnë aktivitetin këta subjekte. Në zbatim të ligjit për Buxhetin e Shtetit të përcaktojë shumën e fondeve që duhet alokuar për çdo NJQV.

Realizimi i rekomandimeve

A. Nga gjashtë masa organizative të rekomanduara

- një masë rezulton e zbatuar;
- dy masa rezultojnë të zbatuar pjesërisht;
- tre masa rezultojnë të pazbatuara.

B. Nga katër masa shpërblim dëmi në vlerën 3,321,665,015 lekë

- tre masa janë zbatuar në vlerën 6,779,918 lekë;
- një masë është në proces zbatimi;
- Për shumën prej 15,337,725 lekë, Dega e Doganës Durrës, ka nxjerë vendimet përkatëse pas dërgimit të Projekt Raportit të Auditimit;

C. Masa Administrative

- një masë e rekomanduar rezulton e pazbatuar.

D. Nga pesëmbëdhjetë masa disiplinore

- tre masa rezultojnë të zbatuara.
- dymbëdhjetë masa rezultojnë të pazbatuara.

2. AUDITIM TEMATIK “MBI ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT PËR TAKSËN E RENTËS MINERARE, REALIZIMIN E TË ARDHURAVE TATIMORE DHE VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE, TË AKTIVITETEVE QË NXJERRIN, TREGTOJNË DHE EKSPORTOJNË MINERALE E NËNPRODUKTE TË TYRE”

Auditimi u krye në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore, Tatim Paguesit e Mëdhenj, Tiranë, Durrës, Dibër, Kukës, Fier dhe Korçë.

Periudha e audituar: vitet 2013 – 2014.

Drejtimit Kryesore të auditimit:

- Evidentimi i shmangieve në lidhje me përputhshmërinë e veprimtarisë së DRT-ve me legjislacionin në fuqi.
- Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e procedurave të ndjekura gjatë kontrollit të subjekteve tatimpagues në terren, sipas legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara nga DPT.

- Evidentimi i mangësive në procedurat e ndjekura gjatë kontrollit operacional të subjekteve tatimpagues, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në Manualin e Kontrollit.
- Vlerësimi i bashkëpunimit të DRT me institucionet e tjera të përcaktuar me ligj dhe me palët e interesuara.

*Shënim: Për mungesë të specialistit të fushës dhe të kohës së auditimit, me miratim të Kryetarit të KLSH, nuk u ushtrua auditim për subjektet që prodhojnë dhe tregëtojnë hidrokarbure.*

Arsyet e evazionit në këtë fushë:

- Janë paraqitur shpenzime të panjohura si të njohura duke ndryshuar rezultatin financiar me efekte në llogaritjen dhe pagesën e tatim fitimit.
- Ka mos aplikim të saktë të penaliteteve të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet.
- Është konstatuar se vlera e deklaruar në eksportin e mineralit të kromit mbi të cilën janë llogaritur detyrimet për Taksën e Rentës Minerale është më e vogël se vlera që duhej deklaruar në tatime.
- Është konstatuar se vlera e deklaruar në shitje të mineraleve (gurë gëlqerore e ranore të përpunuar apo të papërpunuar) mbi të cilën janë llogaritur detyrimet për Taksën e Rentës Minerare është më e vogël se vlera që duhej deklaruar në tatime, sipas Komisionit ad-hoc.
- Drejtoritë Rajonale Tatimore, nuk kanë ushtruar kontrole të thelluara apo kontrole tematike në subjektet, objekt i rentës minerare.
- Shmangia e pagesës së taksës ka ardhur dhe si rezultat i mosverifikimit të shitjeve të mineraleve brenda vendit, ku ndryshe nga tatimet e tjera, subjektet plotësojnë vetëm një formular i cili nuk deklarohet online.

Gjetjet nga auditimi:

Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga auditimi tematik "Mbi zbatimin e legjislacionit për Taksën e Rentës Minerare, realizimin e të ardhurave tatimore dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të aktiviteteve që nxjerrin, tregëtojnë e eksportojnë minerale e nënprodukte të tyre", për periudhën 2013–2014, të




ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore, Tatim Paguesit e Mëdhenj, Tiranë, Durrës, Dibër, Kukës, Fier dhe Korçë, në dinamikën e veprimeve të përditshme në Drejtoritë Rajonale Tatimore të audituara, ka konstatuar se: deklaratimet e të ardhurave të realizuara në pasqyrat financiare nuk janë të sakta e nuk paraqesin realitetin; janë paraqitur shpenzime të panjohura si të njohura duke ndryshuar rezultatin financiar me efekte në llogaritjen dhe pagesën e tatim fitimit; ka mos aplikim të saktë të penalteteve të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; është konstatuar se vlera e deklaruar në eksportin e mineralit të kromit mbi të cilën janë llogaritur detyrimet për Taksën e Rentës Minerale është më e vogël se vlera që duhej deklaruar në tatime; është konstatuar se vlera e deklaruar në shitje të mineraleve (gurë gëlqerore e ranore të përpunuar apo të papërpunuar) mbi të cilën janë llogaritur detyrimet për Taksën e Rentës Minerale është më e vogël se vlera që duhej deklaruar në tatime të cilat kanë sjellë për pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në shumën 118,832,709 lekë (ose 855,000 euro), rekomanduar për shpërblim.

Nga të cilat: shuma prej 17,392,311 lekë nga mos deklarimet e të ardhurave dhe shpenzimeve në pasqyrave financiare; shuma prej 40,376,359 lekë nga mos aplikimi i drejtë i penalteteve përcaktuara në legjislacionin tatimor; shuma prej 61,064,039 lekë nga diferencat e vlerës të konstatuara në eksport si rezultat i mos llogaritjes dhe mos arkëtimit të taksës kombëtare për rentën minerare, për mineralet nënshtruara Taksës së Rentës Minerare.

E ndarë sipas DR Tatimore rezultojnë:

Nr.	Drejtorinë Rajonale Tatimore	Të ardhura të munguara në lekë	Subjekte (numër)
1	Dibër	37,659,103	16
2	Durrës	26,915,149	3
3	Kukës	24,376,870	7
4	Tiranë	18,254,352	12
5	Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj	11,259,815	5

## Të ardhura të munguara sipas Drejtorive Rajonale



Nga auditimi i ushruar në Drejtoritë Rajonale Tatimore mbi aktivitetin e subjekteve që deklarojnë e paguajnë Taksën Nacionale për Rentën Minerare, është konstatuar se:

- Nga 14 Drejtoritë Rajonale Tatimore të ardhurat për taksën e rentës minerare, në vitin 2013 vetëm 3 Drejtori kanë realizuar të ardhurat sipas programit, ndërsa 11 Drejtoritë e tjera paraqiten me mosrealizim të theksuar. Në vitin 2014 vetëm 4 Drejtori kanë realizuar të ardhurat sipas programit, ndërsa 10 Drejtoritë e tjera paraqiten me mosrealizim.
- Mos realizimi i kontrolleve fiskale ose tematike me objekt deklarimin e pagesën e taksës kombëtare për rentën Minerare.
- Probleme në deklarimet e të ardhurave të realizuara në pasqyrat financiare ku janë paraqitur shpenzime të panjohura si të njohura duke ndryshuar rezultatin financiar me efekte në llogaritjen dhe pagesën e tatim fitimit.
- Në raportet e kontrollit të realizuara në këta subjekte ka mosaplikim të saktë të penaliteteve të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet.
- Për subjektet që prodhojnë, përpunojnë e shesin inerte për periudhen e audituar viti 2013-2014, në dy DRT nga 41 subjekte gjithsej, 11 prej tyre rezultojnë me humbje dhe subjektet e tjera kanë paraqitur fitim minimal dhe tregues të ulët financiar e fiskal.

- Subjektet që kanë aktivitet të përzier (ndërtim dhe inerte); deklarimi i shitjeve të inerteve në raport me shitjet gjithsej, zë një peshë të vogël; dhe në situacionet e vetë subjektit nuk janë të argumentuar me dokumentacion shoqërues materialet inerte të përdorura (si shpenzime apo vetëm si të ardhura) me influencë në ndryshimin e gjendjeve materiale tek pasqyrat financiare;

Me gjithë ekzistencën e problemeve të mësipërme nuk janë bërë objekt analize e kontrolli në Drejtorinë e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë e Kontrollit Tatimor.

- Lidhur me procedurat e ndjekura për verifikimin e pasqyrave financiare dhe planifikimin për kontroll nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave u konstatua se, niveli i zbatimit të Udhëzuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 2747/1, datë 05.02.2014 ku përcaktohet: "Të dhënat nga shqyrtimi paraprak i pasqyrave financiare, sidomos për tatimpagues me humbje, normë të ulët rentabiliteti, si dhe tatimpagues të cilat gjykohen për verifikime të mëtejshme të deklarimeve në vend, të evidentohen dhe ti dërgohen për ndjekje të mëtejshme Drejtorisë së Kontrollit Tatimor", paraqitet në nivele të ulëta për subjektet problematikë. Kështu, nuk janë planifikuar dhe kontrolluar subjektet me gjendje më të lartë kreditore, me parregullsi në deklarim, me nivele të larta të detyrimeve të pashlyera.

- Në Programet e Kontrollit qoftë edhe në kontrollet e plota, është anashkaluar kontrolli i Taksës së Rentës Minerare ku në asnjë rast nuk është programuar e kontrolluar si pikë e veçantë apo edhe si nënpikë e kontrollit dhe për pasojë edhe kontrollet për këtë taksë kanë rezultuar të paplota e me të meta duke e bërë të pamundur mbledhjen e kësaj takse. Po kështu në nivele shumë të ulta për këta subjekte rezulton edhe kontrolli në teren.

- Rezulton një mungesë e theksuar e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të brendshme të saj, kryesisht Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit me Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, veprime këto që bien ndesh me kërkesat e Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore pjesa e II-të, pika 27, Drejtoritë Rajonale Tatimore.

- Rezulton një mungesë e theksuar e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të Sistemit Doganor dhe Sistemit Tatimor veçanërisht për marrjen dhe shpërndarjen e informacionit shtesë për vendimet që nxjerrin Degët Doganore për vlerësime në rritjen e vlerës së eksportit dhe të Taksës së Rentës Minerare, mbështetur kjo në

Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 71 pika "b" dhe në VKM nr. 7, datë 04.01.2012, pika 6.

Në bazë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, finalizuar me Vendimin nr. 132, datë 25.09.2015 të Kryetarit të KLSH, për përmirësimin e punës në të ardhmen i janë rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore, marrja e masave si vijon:

- 5 masa organizative;
- 5 masa për shpërblim dëmi në vlerën 118,832,709 lekë, rekomanduar 100% për shpërblim;
- 11 masa disiplinore.

Sugjerimet për përmirësimin e punës në këtë sektor në të ardhmen

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të analizojë nivelin e ulët të deklarimit të pagesës së Taksës së Rentës Minerare dhe të përfshijë në planifikimin vjetor kontrole tatimore në DRT-të me objekt Taksën e Rentës Minerare.

Në DRT të analizohet niveli i ulët i deklarimit të shitjeve dhe të ardhurave nga Taksa e Rentës Minerare për subjektet që i nënshtrohen kësaj takse dhe të merren masa konkrete për përmirësimin e gjendjes duke ushtruar kontrole tatimore në këta subjekte.

Në DPT dhe në DRT, ti jepet rëndësia e duhur kontrollit të Taksës së Rentës Minerare si dhe subjekteve që paguajnë rentë minerare, duke ushtruar kontrole në këto subjekte edhe nga Sektori i Terrenit.

DRT, të marrin masa të plota lidhur me organizimin dhe funksionimin bashkëpunues midis Drejtorive dhe Sektorëve në përbërje të saj, me qëllim rritjen e nivelit të kontrollit dhe të të ardhurave nga çdo tatim dhe taksë e programuar.

Nga DPT dhe DRT të merren masa për një bashkëpunim më të mirë me strukturat e Sistemit Doganor për marrjen dhe shpërndarjen e informacionit shtesë për vendimet që nxjerrin Degët Doganore, kjo edhe në zbatim të marrëveshjeve të përbashkëta të lidhura midis DPD dhe DPT.

Realizimi i rekomandimeve

A. Nga pesë masa organizative të rekomanduara:

- tre masa rezultojnë të zbatuara;
- një masë rezulton e zbatuar pjesërisht;
- një masë rezulton e pazbatuar.

B. Nga gjashtë masa shpërblim dëmi në vlerën 118,832 mijë lekë rezultojnë se janë pranuar dhe janë në proces zbatimi.

C. Nga njëmbëdhjetë masa disiplinore

- një masë rezulton e zbatuar.
- dy masa konsiderohen të realizuar pasi punonjësit janë larguar nga sistemi tatimor.
- tetë masa rezultojnë të pazbatuara.

Legjislacioni specifik:

- *Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" Seksioni i dytë "RENTA MINERARE", neni 40;*
- *Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;*
- *Ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" i ndryshuar;*
- *Udhëzimit nr.17, datë 20.05.2008 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" me ndryshime;*
- *Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" ;*
- *Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 "Për Tatimin mbi të Ardhurat";*
- *Ligj nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për Taksat Kombëtare" neni 4 "Niveli i taksave kombëtare";*
- *VKM nr. 7, datë 4.1.2012 "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e Taksës së Rentës Minerare";*

- Nr. 16365 Prot. me 17.10.2012, “Miratimi i vlerave referuese sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale nga komisionit Ad-Hoc mbi Rentën Minerale”.

Media e shkruar dhe vizive:

Në vite burimet e Rentës Minerare kanë qenë në fokus të mediave vizive dhe shtypit të shkruar.

Në maj 2014 “Monitor” bën një analizë mbi të ardhurat nga Renta Minerare; në qershor 2014 “Gazeta Shqip” shkruan në lidhje me zbutjen e fenomeneve sociale nga kthimi i përqindjes së Rentës; në gusht 2014 “Kosova Press” shkruan në lidhje me fitimin që merr Shteti Shqiptar nga renta e cila përbënte 2.6% e totalit të të ardhurave buxhetore; në nëntor 2014 “Shqiptarja.com” flet për uljen e eksportit të mineraleve; në shkurt–mars 2015 “Ora News” zhvilloi një emision–debat në lidhje me mospagimin e detyrimeve tatimore nga Bankers Petroleum dhe pagesa e ulët e Rentës Minerare.



B. AUDITIMI NË FINANCAT PUBLIKE

5. AUDITIMI I EKZEKUTIMIT DHE MENAXHIMIT TË BUXHETIT TË SHETIT  
(Borxhi publik për vitin 2014)

*Referues: Luljeta NANO – Drejtor i Përgjithshëm,  
Bexhet ZEQIRI – Drejtor Departamenti,  
Andrea KRISTO – Auditues i lartë.*



KLSH në funksion të përmbushjes së detyrimit kushtetues dhe ligjor paraqiti në Kuvend Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit të vitit 2014 sipas tre kolanave bazë të një buxheti:

*i) besueshmërisë, ii) transparencës, iii) përgjegjshmërisë.*

Transparenca dhe përgjegjësia e lartë në zbatimin e një buxheti Shteti përbëjnë shtyllat kryesore për ruajtjen e besueshmërisë së qeverisë në sytë e qytetarëve.

Me synim rritjen e kredibilitetit të buxhetit, gjetjet dhe rekomandimet tona në lidhje me zbatimin e buxhetit të vitit 2014 iu adresuan Kuvendit në përputhje me:

- 1) *Mandatin Kushtetues të KLSH-së;*
- 2) *Ligjin Organik të KLSH-së;*
- 3) *Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI;*
- 4) *Kërkesat e Manualit të Fondit Monetar Ndërkombëtar "Për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike";*
- 5) *Kodin e Transparencës Fiskale të FMN;*
- 6) *Dhjetë Parimet e Buxhetimit Publik të OECD.*

Në aspektin strukturor Raporti i Zbatimit të Buxhetit të vitit 2014 përmban:

- Opinionin e përgjithshëm mbi ekzekutimin e Buxhetit të Shtetit;
- Ecurinë e treguesve kryesorë makroekonomikë për vitin 2014, me një fokus të veçantë në menaxhimin e borxhit publik;
- Analizë të detajuar vlerësimi në lidhje me nivelin e mbledhjes së të ardhurave kryesore të buxhetit të shtetit;
- Analizë dhe trajtim të nivelit të realizimit të treguesve të konsoliduar të buxhetit të shtetit: i) Të ardhurat, ii) Shpenzimet, iii) Deficiti i përgjithshëm buxhetor për vitin 2014, të ecurisë së treguesve fiskalë me një fokus të veçantë në ecurinë dhe menaxhimin e borxhit publik, realizimin e shpenzimeve të investimeve publike dhe implikimet në deficitin buxhetor.
- Vlerësim mbi nivelin e shpenzimeve të kryera sipas klasifikimit ekonomik, duke i krahasuar ato edhe me nivelin e planifikimit të tyre, dhe shpenzimet faktike të vitit të kaluar;
- Mendime mbi raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar mbështetur në rezultatet përfundimtare të auditimeve të kryera për llogari të buxhetit të vitit 2014, mbi rregullaritetin dhe ligjshmërinë e transaksioneve, realizimin e të ardhurave dhe administrimin e shpenzimeve, mbajtjen dhe raportimin e borxhit publik, përdorimin e fondit rezervë të KM dhe kontigjencave, funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, etj.

Referuar fushës së mbulimit me auditime, ky raport përmbledhete rezultatet, konkluzionet dhe rekomandimet të cilat janë adresuar në njësitë shpenzuese të audituara.

Opinionin e përgjithshëm i KLSH-se mbi ekzekutimin e buxhetit të vitit 2014 ishte: "mbi ekzekutimin e buxhetit".

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2014, para miratimit të tij nga Kuvendi i Shqipërisë, shpreh opinionin e përgjithshëm se *përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit, zbatimi, ndjekja dhe rishikimi i tij, të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë dhe format e tjera të rrjedhura prej tyre si dhe kontrolli, kontabiliteti, raportimi, përgjithësisht janë kryer në respektim të kërkesave të Kushtetutës dhe ligjeve.*



Paralelisht me këtë opinion, kemi theksuar nevojën imediate të ndërhyrjes dhe ndjekjes së rekomandimeve të KLSH-së, të cilat synojnë ngritjen dhe konsolidimin e një sistemi modern dhe të integruar të menaxhimit financiar, rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike në përputhje me direktivat e integritit të Bashkimit Evropian.

Krahas sa më sipër KLSH i ka adresuar Kuvendit një sërë rekomandimesh në funksion të menaxhim efektiv të financave publike.

Menaxhimi efektiv i financave publike është në fokus të veprimtarisë audituese të KLSH-së. Rekomandimet e adresuara në vitet e fundit Kuvendit dhe Ministrisë së Financave kanë patur për objekt respektimin dhe zbatimin e targeteve të dokumentit të Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020. Qasja këshillimore e institucionit të KLSH-së është orientuar drejt përmbushjes së objektivave të kësaj Strategjie me fokus hartimin dhe zbatimin e një buxhetit të mirëbalancuar dhe të qëndrueshëm shoqëruar me, reduktimin e raportit të Borxhit Publik ndaj PBB-së, duke menaxhuar në mënyrë efektive financat publike dhe zhvillimin e forcimit të sistemit të kontrollit të brendshëm publik dhe auditimit të brendshëm. Në këtë prezantim në vëmendjen Tuaj do të sjell disa prej rekomandimeve kryesore të cilat KLSH ia ka adresuar Kuvendit dhe Ministrisë së Financave.

### Mbi ndërhyrjet gjatë zbatimit të buxhetit

Buxheti është një kontratë midis qytetarëve dhe qeverisë, besueshmëria e të cilit bazohet mbi qëndrueshmërinë e tij. *Ndryshimet që reflektohen nga miratimi i Akteve Normative cenojnë këtë aspekt të rëndësishëm të buxhetit, pra kredibilitetin e tij, kjo po ti referohemi parimeve të OECD. Shkak i këtyre ndërhyrjeve është praktika e programimit me terma optimiste dhe një proces jo i kujdesshëm, pa monitorimin e duhur nga strukturat në qendër dhe në bazë.* Ndryshimi në zërat buxhetorë, niveli i lartë i detyrimeve si dhe mundësia e qeverisë për të shkurtuar zëra të caktuar janë tregues të kredibilitetit të ulët.

Nisur nga sa cilësua kemi kërkuar përmirësimin e procesit të programimit të buxhetit në drejtim të garantimit të kredibilitetit të tij, nëpërmjet edhe një politikë fiskale të qëndrueshme, në respekt të plotë të objektivave fiskalë afat mesëm si dhe përdorimin e tij si një instrument efektiv për ta mbajtur qeverinë të përgjegjshme në arritjen e objektivave të saj.


Duhet të reflektohen objektiva fiskale të qartë që u lehtësojnë njerëzve të kuptuarit e kursit të qeverisë për politikat fiskale në të gjithë ciklin ekonomik, vetëm kështu gjykojmë se buxheti do të jetë një gur themeli në arkitekturën e besimit mes shtetit dhe qytetarëve të tij. Konsultimi me shoqërinë civile do ta ndihmojë procesin dhe përshpejtojë suksesin për të arritur një buxhet kredibël.

Mbi zbatimin e kriterit ligjor, që financimi i deficitit të jetë në nivel të njëjtë me shpenzimet kapitale. (Rregulli i artë)

Kemi konstatuar se për vitin 2014, deficitin buxhetor rezultoi 72,128 milion lekë kundrejt 66,940 milion lekë të një viti më parë, pra me rritje në nivelin 5,188 milion lekë. Deficitin buxhetor në buxhetin e realizuar është më i lartë se shpenzimet kapitale për 13,563 milion lekë, megjithëse ky kapërcim konstatohet edhe në programim.

Në muajin dhjetor, deficitin buxhetor është 30,808 milion lekë, ndërkohë që investimet e muajit dhjetor kanë rezultuar 17,245 milion lekë.

Niveli i deficitit mujor 2014/2013



Dinamika e deficitit të përgjithshëm buxhetor për periudhën 2010-2014 paraqitet në grafikun e mëposhtëm në raport ndaj PBB-së ku vihet re *tendenca e rritjes* sipas viteve.



Duke vlerësuar me kujdes ndikimin negativ që ka një nivel në rritje i deficitit buxhetor në rritjen ekonomike, por veçanërisht në rritjen e borxhit në nivel afatgjatë, duke vënë në rrezik përmbushjen e objektivave fiskalë kemi kërkuar nga Ministria e Financave një përqasje të kujdesshme dhe vëmendje maksimale, për të gjetur vazhdimisht në këto vite, mundësitë e mbajtjes së nivelit të deficitit në nivele të kontrollueshme.

Si mundësi kemi adresuar tkurrjen e kujdesshme të shpenzimeve buxhetore duke synuar në eliminimin e shpenzimeve që nuk përbëjnë vlerë të shtuar për financat publike, shoqëruar me masa për rritje të administrimit tatimor dhe doganor.

#### Mbi menaxhimin e borxhit publik

Auditimi i treguesve të borxhit publik dhe menaxhimi i tij është një nga drejtimet kryesore në të cilat fokusohet veprimtaria e audituese e KLSH-së në funksion të raportimit të buxhetit korent.


Për vitin 2014 konstatohet se indikator i borxhit publik, në fund të vitit 2014, rezultoi në rreth 69.2 % të PBB-së dhe referuar edhe mbështetjes buxhetore nga Banka botërore dhe FMN, ky borxh rezultoi në rreth 71.8% të PBB-së.

Borxhi i brendshëm rezultoi në 39.94% të PBB-së.

Borxhi i jashtëm rezultoi në 29.17% të PBB-së.

Grafiku i mëposhtëm tregon dinamikën e borxhit të qeverisjes qendrore ndaj PBB-së për harkun kohor të nga 2010 deri në vitin 2014.

## Borxhi i qeverisjes qendrore në % ndaj PBBB



Në drejtim të menaxhimit efektiv të borxhit publik KLSH i ka adresuar në mënyrë të përsëritur Ministrisë së Financave dhe Kuvendit rekomandimet në lidhje me:

- Marrjen e masave për hartimin e një kuadri rregullator fiskal, i cili të synojë reduktimin e nivelit të borxhit publik në nivele të përcaktuara në mënyrë që brenda një periudhë disa vjeçare të sigurohet që indikator i borxhit publik ndaj PBB të arrijë në nivelin 60% dhe kjo do të kërkonte paraqitjen e një iniciative ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të niveleve të pranueshëm të borxhit publik ndaj PBB-së, shoqëruar me një nivel ndryshimi të pranueshëm në referencë të kushteve makroekonomike të vendit.
- Po kështu i kemi rekomanduar Ministrin të Financave që, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, të kryejë një analizë e të thelluar të situatës, kjo me synim evitimin e humbjes së besueshmërisë së vendit ndër kreditorët e huaj nëse vlerësohet një situatë e përkeqësuar apo në përkeqësim.
- KLSH ka rekomanduar që në çdo rast vendimmarrjet në lidhje me marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë, të jenë vendimmarrje politike që sigurohen nëpërmjet ratifikimit të tyre në Kuvendin e Shqipërisë.
- Në drejtim të një menaxhimi efektiv të borxhit të brendshëm kemi rekomanduar orientimin kryesisht në drejtim të titujve qeveritarë me afat të gjatë

maturimi të cilët përmirësojnë strukturën e borxhit të brendshëm dhe mund të reduktojnë riskun e rifinancimit.

- Referuar konstatimit që borxhi i jashtëm regjistron një ritëm më të përshpejtuar rritës krahasuar me eksportin e mallrave dhe shërbimeve, të njëjtën prirje të përafërt tregojnë të dhënat e borxhit të jashtëm ndaj PBB ku prirja rritëse e stokut të borxhit të jashtëm ndaj PBB është më e përshpejtuar dhe ka divergjencë në trajektoren e këtyre dy treguesve.

- Për këtë i kemi rekomanduar Ministrisë e Financave në kuadër të mbajtjes nën kontroll të risqeve të portofolit, menaxhimit të riskut të kursit të këmbimit, prioritet duhet të jetë mbajtja nën kontroll e borxhit të jashtëm. duke vendosur tavan vjetor për totalin e borxhit të jashtëm në përbërje të borxhit publik në përputhje me strategjinë afatmesme të menaxhimit të borxhit publik.

#### *Mbi nënhuatë e KESH.*

Në lidhje me nënhuanë, garancinë shtetërore dhe huamarrjen vendore, konstatoam se gjatë vitit 2014, kompania KESH sh.a. nuk ka shlyer asnjë detyrim për marrëveshjet e nënhuasë. Theksohet se problematika e shlyerjes së detyrimeve vazhdon të jetë për shkak të situatës së rënduar financiare dhe mungesës së likuiditeteve (nuk shlyen detyrimet ndaj Ministrisë së Financave duke filluar nga 6/mujori i dytë i vitit 2011 e në vijim. Vetëm për kompaninë KESH sh.a. gjatë vitit 2014 janë paguar nga buxheti i shtetit 23.5 milion euro dhe janë rimbursuar rreth 5.7 milion euro, duke bërë që detyrimet neto të kompanisë të jenë 17.7 milion euro. KESH sh.a. ka të çelura rreth 190.5 milion euro linja overdrafti me garanci shtetërore në bankat e nivelit të dytë dhe 73 milion euro linja kredie, pa garanci shtetërore.

*Sa më sipër kemi rekomanduar se mbulimi i nevojave financiare të KESH sh.a. për blerje energjie nuk duhet të vazhdojë të jetë huamarrja, ashtu siç është vepruar deri tani, por të synohet rregullimi i marrëdhënieve financiare brenda sektorit të energjisë dhe shlyerja e detyrimeve ndërmjet tyre. Ministria e Financave mund të nisë dhe ndihmojë në një proces negocimi me kreditorët për rishikimin e termave dhe kushteve të portofolit të overdrafteve.*

*Mbi domosdoshmërinë e hartimit të ligjit "Për përgjegjësinë materiale"*

Nga auditimet e kryera, KLSH ka konstatuar mjaft probleme dhe shkelje të dispozitave ligjore në fonde të konsiderueshme publike, që kanë sjellë shpenzimin e tyre pa kriter dhe eficiencë, ose edhe më keq, shkuarjen dëm të një pjese të tyre, nga keq menaxhimi financiar. Jemi përpjekur të përcaktojmë përgjegjësitë materiale të nëpunësve publikë që kanë kontribuar në këto keqpërdorime të fondeve publike, duke propozuar masa në formën e sanksioneve, kundrejt parregullsive financiare të shkaktuara prej tyre dhe të konstatuara. Theksojmë se vlerësimi dhe matja e dëmit dhe adresimi i përgjegjësisë materiale kërkon procedura me konkrete, të detajuara.

Kemi rekomanduar ngritjen e një grupi pune me specialiste dhe përfaqësues të legjislativit, që do të vlerësojë dhe punojë për hartimin e Ligjit "Mbi përgjegjësinë materiale" në të cilën të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.

Gjykojmë se një ligj i tillë do të jetë një mjet efektiv dhe eficient nëpërmirësimin e qeverisjes publike, rritjen e përgjegjshmërisë dhe kufizimin e korrupsionit.

Ky rekomandim është adresuar Kuvendit me raportet e zbatimit të buxhetit për vitet 2013, 2014 si dhe me një sërë shkresash zyrtare përgjatë vitit 2015.

6. AUDITIMI MBI PËRDORIMIN E INSTRUMENTIT TË LETËRKREDIVE, DETYRIMET E PRAPAMBETURA, IPSAS DREJT EPSAS

*Referues: Fatmir ZILJA – Auditues i lartë,  
Aulona JANI – Audituese e parë,  
Nerënxa LLAPASHTICA – Audituese e parë.*

I. Realizimi i buxhetit të investimeve dhe përdorimi i Letër Kredisë (LC).



Nga auditimi u konstatua se:

A. Investimet kapitale për vitin 2014, janë realizuar në masën 60,749 milion lekë ose realizuar 5,255 milion lekë më pak se plani i ndryshuar nga dy Aktet Normative të buxhetit gjatë vitit 2014 (ndryshe 92%), dhe 4,728 milion lekë më pak se një vit më parë, të ndara në:

Investime me financim të brendshëm nga 36,093 milion lekë të planifikuar janë realizuar në masën 94% ose 2,129 milion lekë më pak. Ndërsa krahasuar me nivelin e vitit 2013, konstatohet se janë realizuar 2,737 milion lekë më pak;

Investime me financim të huaj nga 29,911 milion lekë të planifikuar janë realizuar në masën 89.5% ose 3,126 milion lekë më pak. Ndërsa krahasuar me nivelin e vitit 2013, konstatohet se janë realizuar 1,991 milion lekë më pak.

Kemi konstatuar se në çeljen e fondeve për investime kapitale ka ndodhur një ngurtësim nga Ministria e Financave, kështu me shkresën nr. 2112, datë 18.02.2014, drejtuar Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes "Mbi ngurtësimin e Shpenzimeve Kapitale", në zbatim të Ligjit të Buxhetit të vitit 2014 dhe udhëzimit plotësues nr. 3, datë 17.01.2014 "Mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2014", dhe në vijim të diskutimeve dhe marrëveshjes paraprake me FMN

është kërkuar ngurtësimi i vlerës prej 5 miliard lekë të shpenzimeve kapitale, me argumentin “për shkak të pasigurisë së të ardhurave në marrëveshje me FMN-në u përcaktua si instrument ngurtësimi i shpenzimeve kapitale në masën e të ardhurave të pasigurta”. Qeveria nën presionin e kreditorëve për nivelin e lartë të borxhit transferon të ardhurave fiskale nga shpenzimet me ndikim në ecurinë ekonomike drejt amortizimit të borxhit të jashtëm si garanci të aftësisë ripaguese.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, nr. 1833/4, datë 16.06.2014 “Për ç’ngurtësimin e shpenzimeve kapitale”, ka kërkuar nga Ministria e Financës: “... nisur nga niveli i ulët i realizimit të investimeve të planifikuara për vitin 2014, lutemi ç’ngurtësimin e plotë të shpenzimeve kapitale për të gjitha institucionet, për të cilat ky fond akoma nuk ju është ç’ngurtësuar, ose ç’ngurtësimi është bërë në mënyrë të pjesshme”.

Kjo situatë ka reflektuar zhvendosjen e investimeve me financim të brendshëm në 3 muajt e fundit të vitit, duke arritur nivelin më të lartë në muajin dhjetor. Kështu në muajin dhjetor 2014 janë realizuar 17,245 milion lekë investime, ose 28.4% e tyre, të ndara në shpenzime kapitale me financim të brendshëm realizuar në nivelin 13,302 milion lekë, ose 39.2% e tyre dhe në shpenzime kapitale me investim të huaj realizuar në 3,943 milion lekë, ose 14.7% të realizimit vjetor të tyre.

Kjo situatë e verifikuar është shoqëruar edhe me përdorimin e Letër Kredisë, si formë për realizimin e investimeve publike por jo vetëm. Nisur nga fakti se Letër Kredia ka të bëjë me bllokimin e fondeve në llogarinë e institucioneve shtetërore, në një bankë të nivelit të dytë, për llogari të operatorëve ekonomikë, në analizë të thelluar të situatës gjykojmë se jemi më shumë në kushtet e paradhënies se sa të letër kredisë. Ngurtësimi i fondeve në vlerën 3,426 milion lekë në llogari bankare të institucioneve për llogari të klientëve, në masën e plotë të shpenzimit/investimit dhe në kushtet kur punimet/shërbimet dhe mallrat nuk janë realizuar, është jo vetëm përdorim në kushte të një instrumenti të parregulluar në praktikën buxhetore, por dhe në shkelje të parimeve të anualitetit, transparencës dhe besueshmërisë, pasi janë referuar në treguesit fiskalë si *shpenzime potenciale*. Gjykojmë se arsyetimi i këtij parapagimi me “mos-djegjen” e fondeve, në favorizim të operatorëve privatë edhe duke krijuar hapësira për zbehje të kontrollit buxhetor dhe rregullave të menaxhimit dhe kontrollit financiar, është në rastin më të mirë naivitet, ose përpjekje për të ndryshuar realitetin.



Për sa më sipër kemi rekomanduar:

Ministria e Financave bazuar në parimet më të mira të qeverisjes buxhetore dhe referuar praktikave më të mira ndërkombëtare, të bëjë rregullimet e instrumenteve financiarë që mund të përdoren në zbatimin e buxhetit, duke përcaktuar qartë rastet kur mund të përdoren dhe të mos lihen hapësira interpretimi apo aspekte në gjykim të drejtimit.

Të sanksionohet që Letër Kreditë të jepen vetëm nga depozita e qeverisë dhe kundrejt kushteve të përgjithshme të përcaktuara mirë dhe qartë, në një marrëveshje midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Deri në plotësimin e rregullimit ligjor këto instrumente bankare duhet të minimizohen në zbatimin e buxhetit. Në këtë kontekst të gjitha pagesat e bëra me LC, në dy muajt e fundit të vitit, të transferuara në llogaritë bankare në bankat e nivelit të dytë, ngurtësuar në emër të institucioneve buxhetore, (në kushtet kur punimet/shërbimet dhe mallrat nuk janë realizuar brenda vitit ushtrimor) të reflektuara në treguesit e realizimit të shpenzimeve për vitin 2014, nuk duhet të paraqiten në treguesit fiskal si realizim buxhetor. Në këtë rast shpenzimet korrente në pasqyrat e treguesve fiskalë duhej të ishin 435,423 milion lekë, ndërsa shpenzimet kapitale në pasqyrat e treguesve fiskalë duhej të ishin 57,536 milion lekë.

B. Nga krahasimi i raportimit të realizimit të shpenzimeve kapitale me financim të huaj ndërmjet Ministrisë së Financës dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë Sipërmarrjes dhe Industrisë, rezultoi se ka diferenca të konsiderueshme, të cilat llogariten në vlerën prej 98 milion lekë.

Njësitë e Zbatimit të Projekteve nuk zbatojnë afatet kohore ligjore të raportimit, çka sjell mos pasqyrimin në kohë të treguesve fiskalë të qeverisë dhe deformim të shifrave zyrtare të publikuara, problematikë e vërejtur nga vitet e kaluara. Raportimi i shpenzimeve kapitale me Financim të Huaj në lidhje me evidentimin, regjistrimin, dhe raportimin e Financimeve të Huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj nuk bëhet në përputhje me udhëzimin e MF. Formularët plotësohen me gabime, mungojnë të dhënat e gjendjes së llogarisë së projekteve si në çelje ashtu edhe në mbyllje të periudhës raportuese, etj. Njësitë e Zbatimit të Projekteve nuk japin shpjegime në lidhje me mosrakordimin e Situacionit të Raportimit, etj.

Për sa më sipër kemi rekomanduar:

Ministria e Financës dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Sipërmarrjes dhe Industrisë të hartojnë një aktrakordimi "tip" me të dhëna të rakorduara me Njësitë e Zbatimit të Projekteve dhe degët e thesarit, në mënyrë që në mbyllje të periudhës ushtrimore, shifrat e raportimit të këtyre dy institucioneve të jenë të barabarta. Raportimi për treguesit e realizimit të planit të bëhet vetëm pas këtyre rakordimeve duke saktësuar në çdo moment të dhënat e raportuara me të dhënat e kontabilizuara dhe të paraqitura në pasqyrat financiare të shtetit, kjo sidomos në rastin e granteve.

## II. Përgatitja dhe paraqitja e llogarive të konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit.

Nga auditimi u konstatua se, Ministria e Financës për mbajtjen e kontabilitetit i referohet "Planit kontabël të Organeve të Pushtetit Lokal dhe Institucioneve Shtetërore Qendrore dhe Lokale dhe njësive që varen prej tyre" të miratuar me VKM nr. 48, datë 10.04.2008, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 248, datë 10.04.1998 të Këshillit të Ministrave". Duhet theksuar se VKM nr. 248, datë 10.04.1998 dhe VKM nr. 25, datë 20.01.2001 janë hartuar në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe neneve 3, 5, 74 të Ligjit nr. 7661, datë 19.1.1993 "Për kontabilitetin", ligj i cili është shfuqizuar me Ligjin nr. 9228, të datës 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006. Pra Plani Kontabël të cilit i referohet Ministria e Financave nuk ka bazë ligjore.

Në mungesë të një baze të unifikuar të mbajtjes së kontabilitetit, në adresime të ndryshme të përgjegjësive dhe në referencë të pozicioneve të cilat verifikuam shprehim opinionin që pasqyrat financiare të konsoliduara të gjeneruara nga Sistemi Financiar i Qeverisë (SIFQ) nuk pasqyrojnë gjendjen reale të Qeverisë. Në Ligjin nr. 9936, datë, 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 62 përcakton që "Ministri i Financave paraqet brenda muajit maj për miratim në Këshillin e Ministrave raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të shoqëruar me një informacion për arritjen e objektivave, situatën e menaxhimit dhe të kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimit të brendshëm, i cili përmban: Llogaritë e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit..., etj. Konstatohet mungesa disa vjeçare e

pasqyrave të konsoliduara të shtetit, problematikë që në gjykimin tonë ndikon jo vetëm në nivelin e transparencën, por është e lidhur ngushtësisht me ndjekjen e kujdesshme të financave publike dhe analizën e treguesve makroekonomik. Kontabiliteti nga institucionet e qeverisjes së përgjithshme në Shqipëri realizohet aktualisht mbi bazë cash për të ardhurat dhe mbi bazë të të drejtave të konstatuara për shpenzimet. Raportimi Financiar është i orientuar drejt mënyrës së buxhetimit dhe kontrollit të zbatimit të buxhetit të shtetit (...)", kjo duke u nisur dhe nga përcaktimet ligjore të mësipërme. Duke qenë se kjo problematikë është e mbartur në vite dhe pavarësisht rekomandimeve tona veçanërisht në 3 vitet e fundit nuk ka hapa konkretë në këtë drejtim, gjykojmë se duhet të ketë nga vetë institucioni nxjerrje të përgjegjësive për mos adresim të problematikës në nivelet vendimmarrëse dhe lënien në një gjendje të tillë të këtij aspekti që flet shumë për financat e shtetit, por edhe që ndihmon në transparencën e plotë të financave publike dhe certifikimin e rezultateve të publikuara në vijimësi si tregues fiskal.

Në "Strategjinë për Menaxhimin e Financave publike 2014-2020" theksohet se: *"Një parakusht për raportim të mirë është kontabilizimi i saktë. Gjatë periudhës të planifikuar 7-vjeçare, standardet e kontabilitetit do të rishikohen gradualisht me ambicien e përputhshmërisë së plotë eventuale me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit IPSAS, pasi këto të jenë miratuar përfundimisht çka mund të ndodhë vetëm në periudhën e ardhshme të planifikimit"* – ndërkohë që në vijim të po kësaj strategjie flitet për EPSAS jo për IPSAS. Qëllimi i standardeve është të përmirësojnë cilësinë e raportimit të përgjithshëm financiar nga institucionet e sektorit publik, duke çuar në vlerësime më të informuara të vendimeve të Qeverive për alokimin e burimeve, duke rritur në këtë mënyrë transparencën dhe përgjegjshmërinë. IPSAS nuk janë të detyrueshme, por eksperiencia ka treguar se cilësia e raportimit dhe impakti pozitiv që ky i fundit ka në procesin e vendimmarrjes, është më e lartë në ato vende që përdorin IPSAS. Kohët e fundit Komisioni Evropian vendosi të përgatisë Standardet Evropiane të Kontabilitetit Publik, EPSAS - SEKP) bazuar në IPSAS - SNKSP. Kuadri konceptual i SEKP - EPSAS parashikohet të vihet në funksionim në vitin 2019 dhe shumica e standardeve deri nga fundi i vitit 2020.

Nisur nga ky kontekst, në Strategjinë për menaxhimin e financave publike theksohet se: *"Për shkak të këtyre zhvillimeve të fundit në BE, qeveria shqiptare ka planifikuar të rishikojë gradualisht rregullat ekzistuese, duke filluar nga kuadri konceptual i bazuar në kalendarin e EUROSTAT, me qëllim përgatitjen për*

*miratimin e SEKP–EPSAS duke filluar nga viti 2021. Megjithëse plani kohor i strategjisë aktuale është deri në vitin 2020, do të merren masa përgatitore me qëllim miratimin gradual të këtyre standardeve ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë ne do të marrim në konsideratë kufizimet e realizueshmërisë në Shqipëri dhe shkallën e zbatimit të tyre nga vende të tjera evropiane”, duke vendosur kështu si objektiv afatgjatë kontabilizimin dhe raportimin në përputhje me EPSAS pas vitit 2021. Ndër të tjera specifikohet se, qeveria do të përgatisë një plan veprimi të veçantë për kalimin e detajuar dhe një udhërrëfyes për zhvendosjen drejt SEKP – EPSAS.*

Nisur nga sa konstatohet në praktikë flitet për kontabilitet publik të pa rregulluar dhe ku veprohet mbi gjykime individuale të pakontrolluara dhe të pa orientuara nga specifika të lidhura me sektorin publik, kur nuk ka programe të njëjta kontabël në përpunimin e të dhënave dhe përpunimin e informacionit kontabël, kur niveli i kapaciteteve që regjistrojnë transaksionet financiare është larg kërkesave të një administrate të zhvilluar, strategjia për të kaluar në standarde të patestuara akoma në vende ku kontabiliteti publik është jo vetëm i konsoliduar, por dhe merr një vëmendje të rëndësishme, mund të cilësohet pa frikë një sipërmarrje jo realiste, për të mos thënë futuriste.

Për sa më sipër kemi rekomanduar:

Një modernizim i vërtetë i menaxhimit të financave në sektorin publik kërkon domosdoshmërisht implementimin e standardeve të harmonizuara të kontabilitetit rritës (duke konsideruar që Kontabiliteti publik në Shqipëri aktualisht kryhet mbi bazën e cash për të ardhurat dhe mbi bazën e cash-it të modifikuar për shpenzimet). Është fakt që, standardet IPSAS janë përkthyer në shqip që në vitin 2006, por vijojnë të mos përfshihen në legjislacionin tonë dhe nga ana tjetër në gjithë këtë periudhë nuk është punuar as për njohjen dhe përvetësimin e tyre nga punonjësit e administratës publike. Në këtë kontekst e gjykojmë të domosdoshme që të publikohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, menjëherë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik IPSAS, si baza kryesore metodologjike mbi të cilën do të hartohen pasqyrat financiare të shtetit. Të ngrihet një drejtori e veçantë, brenda Drejtorisë së Thesarit që të mundësojë përshtatjen e pasqyrave të nxjerra nga sistemi i integruar në formën e Pasqyrave të Konsoliduara të Shtetit. Kjo drejtori duhet të ketë si funksion edhe kontrollin e saktësisë së pasqyrave të

përgatitura nga institucionet publike, për të vënë nën monitorim këtë proces të rëndësishëm.

Ndërkohë Ministria e Financave të përgatisë dhe të hedhë për diskutim në nivele teknike Draft-Ligjin "Për Kontabilitetin Publik", duke plotësuar kuadrin rregullator të nevojshëm për të arritur në një cilësi të caktuar të raportimit financiar në sektorin publik.

Duke vlerësuar faktin se përqendrimi i reformave vetëm në sistemet kontabël rrit riskun e limitimit të përfitimeve që këto reforma ofrojnë, pasi në rast se do të ndërmerren reforma në kontabilitetin publik, këto reforma paralelisht duhet të ndërmerren edhe në procesin e buxhetimit, njëkohësisht. Një pikë fillimi e mundshme për zhvillimin e buxhetimit dhe kontabilizimit, mbështetur mbi parimet e kontabilitetit rritës, mund të gjendet për shembull në ligjet për buxhetin të atyre vendeve anëtare të BE-së të cilat tashmë përdorin buxhetimin rritës. Të reformosh procesin e buxhetimit në sektorin publik në Shqipëri gjithashtu është vital pasi buxheti vjetor vijon të mbetet një ndër instrumentet financiar më të rëndësishëm të qeverisë.

III. Mbi auditimin e procesit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitin 2014.

Strategjia për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura miratuar me VKM nr. 50 datë 05.2.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit" u bazua në vlerën e shpallur nga qeveria si stoku i "borxhit të fshehur" prej 72.57 miliard lekë, vlerësuar nga Deloitte & Touch deri në gusht të vitit 2013. Ministria e Financave vijoj me saktësimin e kësaj vlere dhe plotësimin me detyrimet e kontabilizuara deri në fund të vitit 2013, dhe në Treguesve Fiskalë të Buxhetit të Konsoliduar për vitin 2014 detyrimet e prapambetura më datë 31.12.2013 rezultojnë të jenë në vlerën 71.5 miliard lekë. Bilanci i konsoliduar i shtetit që përgatitet nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, tregon 126.6 miliard lekë si gjendje e detyrimeve të kërkueshme në fund të vitit 2013 (Ilogaria 467). Konstatohet se shifrat janë të ndryshme në raportime të ndryshme duke vënë në diskutim vetë vlerën e deklaruar si borxh i fshehur ndaj biznesit dhe duke na çuar në opinionin se për hartimin e Strategjisë Qeveria Shqiptare ka marrë në konsideratë një shifër jo reale e cila nuk është saktësuar dhe vazhdon të jetë e paqartë akoma, megjithëse shteti

shqiptar për këtë shlyerjen e këtij borxhi të fshehur ka marr hua pranë Institucioneve Financiare Ndërkombëtare.

Në ligjin nr. 185/2013 “Për Buxhetin e vitit 2014”, parashikohej të shlyheshin gjatë vitit detyrime të prapambetura në vlerën 35 miliard lekë. Për të shlyer detyrimet e prapambetura, me Ligjin nr. 33/2014 “Për miratimin e huamarrjes prej 295.420.000 SDR, që Fondi Monetar Ndërkombëtar i akordon Shqipërisë për programin 36 mujor të ndihmës (EFF)”, Shteti Shqiptar ka miratuar marrëveshjen e huasë në vlerën 295.4 milion SDR<sup>3</sup>, (ose rreth 330 milion euro). Për vitin 2014 FMN ka disbursuar vlerën totale prej 7.4 miliard lekë, për të ulur detyrimet e prapambetura, ndërkohë që shlyerja e detyrimeve është realizuar në fund të vitit 2014 në vlerën 33 miliard e 913 mijë lekë (rreth 97%). Pra konstatohet se për vitin 2014, është realizuar fondi i parashikuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në masën 97%, nga i cili 21.9% janë përballuar nga fondet e FMN, dhe pjesa tjetër, në masën 78.1% është përballuar nga fondet e buxhetit të shtetit (Fondi i Kontigjencës).

Auditimi synonte konfirmimin e rregullshmërisë së pagesave të realizuara, dhe në përfundim arritëm në konkluzionin se procesi i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura ka ndjekur një linjë të shpërndarjes së përgjegjësisë deri në nivelin më të ulët menaxherial ndërsa kontrolli dhe monitorimi ka qenë përgjithësisht një formalitet pa gjurmë auditimi. Komiteti i Shlyerjes së Detyrimeve të Prapambetura ka deleguar me rregullore mjaft përgjegjësi të lëna nga strategjia e miratuar tek Njësia e krijuar për këtë qëllim pranë Ministrisë së Financave, kjo edhe për faktin se në VKM specifikohet se përgjegjësia për plotësimin e dokumentacionit dhe verifikimit është e njësive shpenzuese (edhe për njësitë e vartësisë). Në këto kushte përgjegjësia mbetet tek njësitë shpenzuese dhe Komiteti i Shlyerjes së Detyrimeve ka vepruar me miratime bazuar mbi lista Excel dhe konfirmime të njësive në bazë, pa marrë masa për të kontrolluar apo monitoruar procesin e verifikimit dhe saktësimin të vlerave nga këto njësi shpenzuese. Në këtë kontekst nxori edhe Udhëzimin nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” dhe ka konsideruar detyrime të prapambetura, që figuronin të tilla në pasqyrat financiare (bilancin) të vitit 2013, të korrigjuara me pagesat e kryera gjatë muajit Janar 2014, pasi institucionet kanë vazhduar të shlyejnë një pjesë të

---

<sup>3</sup> SDR - Special Drawing Rights, rezervë këmbimi ndërkombëtare

detyrimeve të prapambetura me fondet e planifikuara për vitin 2014. Nga auditimet tona kemi konstatuar konstatuar shkelje të parimeve të mirë përcaktuara në strategjinë e miratuar me VKM nr. 50, datë 05.02.2014, i ndryshuar.

Nga auditimi në *Ministrinë e Arsimit dhe Sportit*, u konstatua se në bilancin e vitit 2013 pasqyrohen detyrimet për furnitorë për punë dhe mallra në shumën 803,340,735 lekë, vlerë më e ulët se ajo e deklaruar si borxh i fshehur në këtë Ministri. Konstatohet se nuk janë pasqyruar detyrimet nga projektet për investime në arsim, të zhvilluara nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, pra në bilanc nuk janë paraqitur të gjitha detyrimet e krijuara referuar faturave të lëshuara deri më datë 31.12.2013, duke mos zbatuar kërkesat e Udhëzimit Për objektet e miratuara nga FZHR 2012, punimet e ndërtimit/rikonstruksionit kanë përfunduar por për shkak të mungesës së financimit, objektet nuk janë dorëzuar nga kontraktorët. Për këtë kategori konstatohet se janë konfirmuar detyrime të sistemit të arsimit (kryesisht detyrimet në projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, sipas raportimit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore) në shumën 802,809 mijë lekë, por nuk ka konfirmuar shumën 9,782 mijë lekë, pasi për këto detyrime nuk ekziston kontratë e lidhur nga MAS apo njësitë. Nuk konstatuam që nga Fondi i Zhvillimit Shqiptar apo vetë Ministria e Arsimit të kishte verifikuar raportimin e Njësive të Qeverisjes Vendore. Në detyrimet e konfirmuara janë raportuar si detyrime të Institucioneve të Arsimit të Lartë 76.079 mijë lekë, projekte të cilat kanë qenë të parashikuara të përballohen nga të ardhurat e veta të këtyre institucioneve e jo nga burimet e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve. Në raportim janë shtuar detyrime në shumën 369,152 mijë lekë, të cilat nuk ishin përfshirë në listën e konsideruar të rregullt nga Ministria e Financës, por që nga kontraktorët janë lëshuar fatura tatimore deri më 31.12.2013, kjo sipas raportimeve të Njësive të Qeverisjes Vendore. Konstatuam një mosrakordim i shumës së detyrimeve të prapambetura të raportuara në sistemin e Ministrisë së Financave me ato që janë raportuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në total për 53 milion lekë, ku diferenca më e madhe rezulton në detyrimet e prapambetura për shpenzimet korrente.

Konstatuam problematikë në likuidimin e shumës 32.504.427 lekë për kontratën midis "Albtelekom" sh.a. dhe MAS me objekt "Lidhja dhe furnizimi me internet i 2000 shkollave në arsimin para universitar" pasi nga dokumentacioni i audituar arrijmë në përfundimin se për këtë vlerë kompania ka faturuar shërbim të

parealizuar, i cili nuk është konfirmuar nga Blerësi/Shkolla/DAR/ZA dhe Grupi i Menaxhimit të Kontratës. Shuma e likuiduar në këto kushte në gjykimin tonë përbën dëm për buxhetin e shtetit.

Nga auditimi në Ministrinë e Mbrojtjes, konstatohet se në bilancin përmbledhës të vitit 2013 pasqyrohen detyrimet për furnitorë, punë dhe mallra në shumën 1,117 milion lekë, ndërsa si detyrime të prapambetura gjendje më 31.12.2013, referuar raportimeve statistikore në shumën 1,929 milion lekë. Problematikë e konstatuar në lidhje me detyrimet e deklaruara si borxh i fshehur është të të dhënat e raportuara, shuma prej 670 milion lekë, ose 35% e totalit të detyrimeve të raportuara si "borxh" i korrespondon detyrimeve për të cilët fatura është prerë nga data 1-31.12.2013. Në këtë shumë është përfshirë detyrimi për TVSH e Taksë Doganore në shumën 479 milion lekë, që i korrespondon faturës së datës 26.12.2013, e cila zë 25% të totalit të detyrimeve, detyrim i cili është shlyer me vendim të veçantë të KM. Në këto kushte përfshirja e shpenzimeve korrente të muajit dhjetor është bërë në shkelje të kërkesave ligjore të kësaj strategjie. Në pasqyrat financiare të vitit 2014, si rezultat i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, detyrimet për furnitorë për punë dhe mallra, janë në shumën 46 milion lekë, shumë e cila nuk përkon me detyrimet e raportuara si të prapambetura dhe të pa likuiduara më 31.12.2013. Rezulton se krahas uljes së disa detyrimeve ato për sigurimet shoqërore janë rritur me 74 milion lekë, kjo si rezultat i përfshirjes së këtyre detyrimeve në pasqyrat financiar të disa njësive të varësisë. Edhe pse janë pasqyruar në bilanc përsëri shifra nuk është e saktë dhe e rakorduar me organet e sigurimeve shoqërore dhe ato tatimore.

Nga auditimi i veprimeve të çeljes së fondeve dhe likuidimit të detyrimeve konstatohet se, në Ministrinë e Mbrojtjes, nga Drejtoria e Financës, nuk disponohet dokumentacion, si kontratë, faturë, akt marrje në dorëzim, etj., si dokumente vërtetuese të kryerjes së shpenzimit, por këto dokumente janë në secilën nga njësitë e varësisë së saj, pasi janë ato Autoritete Kontraktore që kanë kryer dhe ekzekutimin e veprimeve të likuidimit të detyrimeve kontraktore, pra në këtë drejtim nuk ka gjetur zbatim pika e 15 e strategjisë.

Nga auditimi në Ministrinë e Brendshme, konstatohet se në zbatim të Vendimit nr. 7, datë 22.05.2014 të Komitetit të detyrimeve të prapambetura" është çelur fond për Posta Shqiptare sh.a., në vlerën 54 milion lekë i cili ka qenë borxh i pa regjistruar në fund të vitit 2013.



Nga auditimi në Shërbimin Social Shtetëror, konstatojmë se vlera e akorduar në total për këtë institucion për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura është 37 milion lekë. Nga auditimi rezultoi se në pasqyrat financiare të vitit 2013 kjo vlerë nuk ishte e regjistruar dhe pavarësisht kësaj është përfshirë në strategji. Ajo që konstatojmë është se nga institucioni përgjegjës për verifikimin e dosjeve të këtyre detyrimeve nuk ka një evidencë të auditimeve të kryera për certifikimin e këtyre detyrimeve përpara njohjes dhe likuidimit nga Ministria e Financave.

Nga auditimi në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, konstatohet se për këtë institucion nuk është respektuar parimi FIFO, por nga Komiteti i detyrimeve janë përzgjedhur për likuidim detyrime në mënyrë rastësore. Nga ana e ministrisë nuk është kryer një verifikim i detyrimeve të raportuara dhe nuk u është kërkuar këtyre institucioneve të paraqesin bashkëlidhur me listën e detyrimeve edhe dokumentacionin mbështetës dhe verifikues së ekzistencës së detyrimit, në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 05.02.2014 pika 15.

Mbi rimbursimin e t.v.sh, kemi vlerësuar vetëm aspekte të procedurës së ndjekur nga ku është konstatuar se sipas strategjisë data e protokollimit të kërkesës për rimbursim nga t.v.sh pranë organit tatimor vlen si datë për njohjen e këtij detyrimi, kështu quhet detyrim i prapambetur, çdo kërkesë për rimbursim t.v.sh e paraqitur deri në datën 31.12.2013. Për vitin 2014 janë rimbursuar gjithsej 75 subjekte, kërkesa e të cilëve është dorëzuar gjatë vitit 2014, por për teprica kreditore që kanë lindur në vitin 2013, në këto raste është vepruar duke interpretuar në mënyrë të gjerë kuptimin e pikës 14, të VKM nr. 50, datë 05.02.2014, por jo të saktë të strategjisë. Kjo hapje krijon precedentë për pagesa nga strategjia për rimbursime të cilat duhet të mbulohen me fonde të vitit buxhetor, kjo sjell edhe pasaktësi (denatyron) deklarin e të ardhurave neto nga t.v.sh në pasqyrën fiskale. Nga auditimi i Vendimeve të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura është konstatuar se nuk ekziston vendimmarrje e tij për këtë qëllim. Për kategorinë rimbursimi i t.v.sh nga një verifikim me zgjedhje rastësore në listat e detyrimeve të prapambetura pranë Ministrisë së Financave për disa Drejtori Rajonale të Tatimeve ka rezultuar se në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, për rimbursimet e t.v.sh për 17 subjekte, është konstatuar se nuk është respektuar parimi FIFO. Në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, për rimbursimet e t.v.sh. 24 subjekteve, është konstatuar se edhe në këtë rast nuk është respektuar radha e pagesës brenda kësaj drejtorie. Në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Durrës, për

rimbursimet e t.v.sh. të 26 subjekteve, është konstatuar mos zbatimi i radhës së pagesës. Në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Elbasan: rezultoi nga verifikimi me zgjedhje i 19 subjekteve që kanë paraqitur kërkesën për miratimin e rimbursimit të TVSH ka rezultuar se nuk është respektuar parimi FIFO.

Për kategorinë "Të tjera" është konstatuar gjithashtu se në zbatim të Vendimit nr. 7 të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura datë 22.05.2014, janë çelur fondet për shlyerjen e kategorisë "Të tjera" (vendimet gjyqësore, shpronësime, emergjencia civile, etj.) pas konfirmimit zyrtar nga ministria përkatëse e linjës, por për këto nuk është zbatuar parimi FIFO. Likuidimet e detyrimeve sipas këtyre kategorive janë kryer në renditje rastësore.

Është konstatuar gjithashtu se vendimet gjyqësore për largime nga puna apo dëmshpërblime page janë ato që mbulojnë përqindjen më të madhe të detyrimeve me rreth 80 % të vlerës totale. Pjesa tjetër e shlyer e detyrimeve të prapambetura i përket vendimeve gjyqësore për investime, shpronësimeve dhe emergjencave civile. Në këtë rast gjykojmë se përfshirja e këtyre detyrimeve në strategjinë e detyrimeve të prapambetura nuk i shërbejnë objektivit për të cilin u hartua kjo strategji impaktit në investimet publike. Në këtë rast borxhi i marr për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ka shkuar për pagesa shpërblim heqje në punë ndërkohë që këto fonde duhet të paguheshin nga personat të cilët kanë bërë largime të paligjshme nga puna. Në këtë rast marrja përsipër nga shteti e kësaj pagese legjitimon vijimin e procedurave të pasakta të largimeve nga puna.

Nga auditimi është konstatuar risk i lartë operacional lidhur me mënyrën e mbajtjes dhe ndjekjes së stokut të detyrimeve të prapambetura në format Excel-i dhe me shumë ndërhyrje gjatë kohe duke bërë prezent në çdo moment gabimin njerëzor, ndërkohë që konstatohet se nuk ka një vendimmarrje institucionale për të bërë veprime plotësisht transparente dhe konsistente në këtë drejtim. Edhe ndjekja e pretendimeve është shumë e pamundur pasi procedurat e saktësisimit ngatërrojnë shumë institucione duke lënë pa përgjigje të interesuarit. Në këto kushte bazuar në vlerësimin që i bëmë situatës së mbajtjes dhe ndjekjes së detyrimeve dhe pamundësisë së njësisë për të na dhënë një shifër të saktë të stokut të mbetur kjo për arsye të mënyrës së mbajtjes që nuk ja mundësonin këtë informacion, gjykojmë se risku operacional është i lartë dhe kërkon një ndërhyrje të menjëhershme.

Në përfundim, konstatohet se procesi i vendimmarrjes së Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura është bazuar në materialet e përgatitura nga Njësia e cila nga ana e saj bazohej në listat e dërguara nga Njësitë Shpenzuese. Nuk ka gjurmë të monitorimit të këtij procesi dhe vlerësim të situatës në lidhje me stokun e saktë të këtyre detyrimeve që do të përfshiheshin në këtë strategji. Kjo mënyrë funksionimi ka cenuar saktësinë dhe besueshmërinë e këtij procesi pa u ndalur në efektivitetin dhe eficiencën e vetë strategjisë. Nisur nga auditimet e kryera pranë institucioneve (njësive shpenzuese) evidentohet se vendimmarrja e tij ka qenë shpesh herë në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 05.02.2015, i ndryshuar, konkretisht për sa i takon likuidimit të detyrimeve të pa regjistruara në bilancet e institucioneve më datë 31.12.2013; rimbussimit të t.v.sh për kërkesa të protokolluara pranë organeve tatimore gjatë vitit 2014; likuidime për detyrime të cilat prezantonin mungesë dokumentacioni dhe/ose kontrata/fatura.

Për sa i takon përlogaritjes së stokut të detyrimeve të prapambetura si edhe vlerës së mbetur të tij kërkesa jonë drejtuar Njësisë së Posaçme për të vënë në dispozicion përlogaritjen e saktë të detyrimeve të mbetura për shlyerje për vitin 2016 (viti i fundit i programi EEF të FMN) mbeti pa një shifër të konfirmuar, pasi e gjithë procedura e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura është interpretuar si një proces, i cili ka pësuar ndryshime me kalimin e kohës duke përfshirë në shlyerjen e detyrimeve edhe kategori shpenzimesh që nuk ishin parashikuar nga kjo strategji. Njësia e posaçme thekson se vetëm me rakordimin përfundimtar, në përfundim të procesit të shlyerjes së detyrimeve do të jetë i mundur sanksionimi i vlerës totale të shlyer në kuadër të strategjisë së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, fakt që tregon se Ministria ka dështuar në menaxhimin e këtij procesi të rëndësishëm dhe vlera e borxhit të marrë nuk përputhet me nivelin e stokut të detyrimeve.

Nga auditimi i të dhënave të publikuara në Pasqyrën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar për vitin 2014 janë konstatuar disa parregullsi të tjera në përlogaritjen e detyrimeve të likuiduara sipas muajve kështu të dhënat e publikuara kanë pasaktësi në përlogaritjen e diferencës plan/fakt të likuidimeve mujore të detyrimeve të prapambetura duke na rezultuar se përqindja e realizimit të detyrimeve të prapambetura ka një diferencë prej 1.10 %, ose në vlerën 23 milion lekë. Ndërkohë nga të dhënat e Bilancit të Konsoliduar, zëri Kreditorë të ndryshëm, tregon se gjendja në fund të vitit 2014 për këto lloj detyrimesh rezulton të jetë

128,369 milion lekë me një shtesë prej 1,791 milion lekë në krahasim me fundvitin 2013 fakt, që flet se strategjia deri tani nuk ka qenë efektive në uljen e stokut të detyrimeve të prapambetura.

Në fund të këtij auditimi në shumë institucione, nisur nga konstatimet dhe situata e verifikuar në plotësim të kërkesave të strategjisë arrijmë në bindjen se strategjia nuk ka arritur të përmbushë dy objektivat kryesorë për të cilat ajo u hartua pasi nuk konstatohet ndonjë ndikim në rritjen ekonomike nëpërmjet kanaleve të impulseve të likuiditetit në fushën e investimeve publike por edhe në parandalimin e akumulimit të detyrimeve të prapambetura në të ardhmen. Vlera e saktë e atyre që u konsideruan si borxh i fshehur i shtetit për shkak të mos regjistrimit në pasqyrat financiare nuk është arritur të sigurohet as në fillim, as në vijim, dhe as në momentin kur u mbyll ky mision auditimi, nga ana tjetër nga vetë të dhënat e përpunuara në bilancin e konsoliduar të shtetit nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit konstatohet se detyrimet e shtetit jo vetë nuk janë ulur, madje ato janë rritur në krahasim me fundin e vitit 2013. Kemi kërkuar ndërhyrje të studiuara të menjëhershme në mënyrë që të sigurohet rregullshmëria e synuar në këtë proces të rëndësishëm me efekte në borxhin publik dhe në zhvillimet makro të ekonomisë shqiptare, e rrethuar nga efektet e dukshme të krizës botërore financiare.

C. AUDITIMI NË SISTEMIN E SISTEMIN E SHËNDETËSISË

7. AUDITIMI NË AGJENCINË KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË BARNAVE DHE PAJISVEVE MJEKËSORE, NË FONDIN E DETYRUESHËM TË KUJDEMIT SHËNDETËSOR DHE QSUT

*Referues: Selime BREGU – Audituese e lartë,*

*Mariola LLESHI – Audituese e lartë,*

*Ymer STAFI – Auditues i lartë.*

Gjatë vitit 2015 janë kryer auditime në institucione të sistemit të shëndetësisë, në zbatim të programeve të auditimit, mbështetur në planin vjetor të auditimeve, ndër të tjera dhe në Agjencinë Kombëtare të kontrollit të Barnave dhe Materialeve Mjekësore, në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.



I. AUDITIMI NË AKBPM

*Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, ka për qëllim:*

- Garantimin e popullatës me barna të sigurta, cilësore dhe efikase;
- Kontrollin e prodhimit, import-eksporteve dhe shpërndarjen e barnave;
- Kontrollin dhe analizën e cilësisë së barnave që qarkullojnë në treg;
- Monitorimin e efikasitetit të barnave të përdorura;



- Garantimin e tregtimit të barnave me çmime të unifikuara dhe luftën kundër kontrabandës;
- Informimin dhe sensibilizimin e popullatës dhe institucioneve shtetërore;
- Transparencën, mosdiskriminimin, barazinë, nxitjen e konkuresces në të gjitha procedurat që ndjek institucioni,

#### KONSTATIME

*Së pari, në drejtim të procedurës së importimit të barnave e pajisjeve, u konstatua:*

- sasi barnash të peregjistruara, gjithsej në vlerën 2 301 413 euro, të cilat do të përdoren për mjekim spitalor. Për importimin e tyre janë dhënë nga Ministri i Shëndetësisë autorizimet përkatëse të importit në 7 raste;
- se importi është realizuar nga një kompani, që nuk është mbajtësi direkt i autorizimit të tregtimit nga prodhuesit;
- dhe se kjo kompani është përfshirë në një zinxhir importi të shpërndarë në shumë vende të deklaruara si vende origjine e barnave.

*Së dyti, në drejtim të procedurës së sekuestrimit të barnave, u konstatua:*

- mungesa e rregullave që përcaktojnë procedurën e sekuestrimit të barnave, e cila ka krijuar problematika dhe qëndrime subjektive në vlerësimin e sekuestrove të barnave, si në rastet e barit Vaxigripit, Tranxene dhe të ndonjë bari tjetër;
- mangësi të kësaj procedure në rregulloren e brëndshme të institucionit.

*Sa më lart, mungesa bëhet dhe më problematike në kushtet kur Agjencia duhet të administroheshin barna me vlerë 103,179,667 lekë, të konfiskuara dhe që janë gjendje në depot e saj.*

*Së treti: në lidhje me rregjistrimin e barit RISPERIDONE ORAL solution, nga auditimi i procedurave u konstatua:*

- mungesa dokumentare të lidhura me kërkesën për aplikimin për rregjistrimin e barit, si emri dhe kompania që aplikon për rregjistrim ose personi;

- se autorizimi nga kompania prodhuese C. M., si dhe dokumentet e barit janë fotokopje të panoterizuara, ku certifikata e origjinës tregon që dërguesi i barit është C. M.;
- dhe se origjina e barit specifikohet JORDANI dhe është konfirmuar nga Dhoma e Tregtisë së Irlandës!

*Së katërti, në lidhje me prodhimin dhe përdorimin e pullave, konstatohet se:*

- verifikimi dhe rakordimi mbi sasinë e pullave të shtypura, që nga shtypja, dorëzimi dhe evidentimi i pullave ndiqet vetëm nga një punonjëse;
- rakordimi nga sektori i financës bëhet vetëm në vlerë dhe jo në sasi, dokumentimi i procesit mbahet nga kjo punonjëse;
- procesi nuk është mbikëqyrur apo verifikuar asnjëherë me daljet nga magazina, pullat e shtypura, pullat e evidentuara si skarco dhe të ardhurat e arkëtuara nga pullat, duke ju referuar sasive të furnizuara nga kontraktori;
- pullat skarco kompensoheshin ose zëvendësoheshin nga kompania prodhuese fituese e tenderit të pullave, *duke rritur mundësinë e rrishtit të barnave të parregjistruara në treg.*

## II. AUDITIMI NË FSDKSH

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, është i vetmi institucion publik dhe autonom, i cili:



- menaxhon dhe zhvillon skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Shqipëri,
- si dhe kryen financimin e shërbimeve shëndetësore nga ofrues publikë dhe privatë, në përputhje me politikat kombëtare të kujdesit shëndetësor.

## KONSTATIME

*Së pari, në drejtim të veprimtarisë së monitorimit dhe kontrollit të rimbursimit të barnave në rrjetin farmaceutik, si një nga veprimtaritë me impakt të lartë ndaj qytetarëve, u konstatua se:*

- nuk janë kontrolluar disa nga farmacitë e "Top Listës", me vlera të larta të rimbursimit që shkojnë mbi 100 milion lekë;
- nuk janë kontrolluar farmacitë "Nek" dhe "Colis", ku numri i pacientëve dhe i recetave është i ulët, por me vlera të larta rimbursimi, respektivisht 47,558,450 lekë dhe 41,705,138 lekë, çka tregon për rimbursim të recetave me barna të alternativave të shtrenjta;
- në asnjë rast nuk është ushtruar kontroll në farmacinë e QSUT, mbi qarkullimin e barnave më të shtrenjta që tregtohen në to, të cilat arrijnë vlerën 1,835,591,414 lekë.

*Së dyti, në drejtim të zbatimit të skemës së rimbursimit, konstatohet se:*

- FONDI dhe njësitë e varësisë, rimbursojnë subjekte të ndryshme farmaceutike:
  - a. pa u verifikuar dhe saktësuar më parë mbi deklaratimet e tyre në sistemin elektronik e-farmacii;
  - b. pa u verifikuar dokumentacioni shkresor që dorëzojnë subjektet referuar kushteve kontraktuale,

*duke krijuar mundësinë që të përfitohet nga ato rimbursim në mënyrë të padrejtë.*

*Së treti, në lidhje me planifikimin e kontrollit të depove, u konstatua:*

- se nuk kishte kritere të vendosura për përzgjedhjen e tyre për kontroll, por i lireshin një indicie apo një informacioni verbal, ose planit të auditimit të ardhshëm;
- anulimi i kontrollit, pa asnjë arsye në Depon Omega Pharma Group, ku nga auditimi i kësaj praktike u konstatuan shkelje e mangësi, si dhe rimbursim fiktiv nga subjektet farmaceutike në shumën 30,710,920 lekë, vetëm për barin "Ketosteril", të tregtuar nga kjo depo.



KLSH, jo vetëm ka rekomanduar arkëtimin e kësaj vlerë nga subjektet farmaceutike dhe nga kjo Depo, por për elementë të veprës penale të "shpërdorimit të detyrës" ka depozituar në Prokurori Kallëzim Penal për:

- ish Drejtorine Përgjithshëm,
- ish N/Drejtorin e Përgjithshëm,
- ish Drejtorin e Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik dhe
- Drejtorin e Drejtorisë së Informacionit dhe Analizës Statistike,

pasi, si rrjedhojë e anulimit të kontrollit me inventarizim dhe tematik për barin "Ketosteril" në Depon "Omega Pharma Group", të pa mbështetura në dispozita ligjore, nuk janë evidentuar problematikat që kjo Depo ka patur lidhur me shitjet fiktive të kryera për barin "Ketosteril", ku si rezultat subjektet farmaceutike janë rimbursuar padrejtësisht në sasinë 251,093 tableta, me vlerën 30,710,920 lekë dhe se nga institucioni nuk është vepruar për të parandaluar këtë fenomen abuziv, edhe pse në softi-n e tij ka patur të dhëna të mjaftueshme për veprimtarinë e kësaj Depoje.

*Së katërti, në drejtim të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, referuar zbatimit faktik të buxhetit sipas të dhënave fiskale të Qeverisë, krahasuar me ato të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor:*

- Rezulton një diferencë në të ardhurat për 166.5 milion lekë, të cilat i përkasin transfertës së buxhetit për shërbimin spitalor dhe që raportohen më shumë nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ndërsa, në shpenzime rezulton një diferencë për 3.5 milion lekë;
- Për vitin 2014, janë likuiduar shpenzime rimbursimi sipas listëtreguesve, gjithsej në vlerën 8,251,406 mijë lekë, nga 8,340,000 mijë lekë të programuara, ose shpenzimet e rimbursimit janë realizuar 98.9% e programimit.

*Realizimi në këto nivele të shpenzimeve të rimbursimit të barnave nuk është rezultat i menaxhimit efektiv të fondeve të planifikuara për këtë zë të shpenzimeve, por këtu ka ndikuar heqja e TVSH-së për barnat nga muaji prill 2014.*

Nëse do të ishte bërë korektimi i planit për heqjen e TVSH për barnat, treguesit e zbatimit të buxhetit do të ishin më të saktë, pra në këtë mënyrë do të kishim një linjë korrekte të raportimit.

- Likuidimet për trajtime mjekësore të pacientëve jashtë vendit, të miratuara me vendime të veçanta të KM përveç rasteve të rimbursimit të shpenzimeve për trajtime të kryera jashtë vendit, ishin kryer dhe shpenzime për mbulimin e mjekimit në spitalet private brenda vendit, *gjithsej në shumën 9,092,722 lekë, pa patur rregulla të mirpërcaktuar për këtë shërbim nga institucioni.*

### III. AUDITIMI NË OSU "NËNË TEREZA", TIRANË

Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", u auditua vetëm për procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt "Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e QSUT, Tiranë për vitin 2015", *pasi auditimi i plotë është në fazën e evadimit të tij.*

*Në këtë procedurë, kryer me "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit", konstatohet se:*

- KVO ka skualifikuar padrejtësisht bashkimin e operatorëve "Devis & Dimensione Të Reja" sh.p.k.
- Kjo ofertë duhej kualifikuar dhe shpallur fituese me vlerën 76,369,644.8 lekë pa t.v.sh., pasi oferta e paraqitur prej tij është më vlerë më të ulët se oferta e paraqitur nga "AGS" sh.p.k. prej 87,173,020.7 lekë pa t.v.sh., pra me një diferencë prej 10,803,376 lekë;
- Diferenca prej 10,803,375.9 lekë pa t.v.sh. përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet në buxhetin e institucionit.

KLSH, bazuar në nenin 280, 281 të K.Pr.P. i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, fillimin e *procedimit penal për konsumin e veprës penale shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*, të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, për:

- Kryetarin e KVO, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Hotelerisë,
- Anëtarin e KVO, me detyrë Specialist në Sektorin e Prokurimeve,
- Anëtarin e KVO, me detyrë Specialist në Sektorin e Financës,

*të cilët në përmbushje të detyrave të tyre funksionale kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjin, duke shkelur barazinë e pjesëmarrësve në tendera dhe sjellë si pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik në vlerën 10,803,375.9 lekë pa t.v.sh.*

D. AUDITIMI NË ADMINISTRIMIN E PRONAVE

8. AUDITIMI NË ZVRPP

*Referues: Selfo ZENELI - Kryeauditues,  
Qemal SHEHU –Audituesi i lartë,  
Qemal META – Audituesi i lartë.*



Nisur nga:

- Reformat e ndërmarra për implementimin dhe në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, e cila në vetvete përbën një “Kushtetutë të Financave”, aplikimi dhe zbatimi i tij në tërë veprimtarinë e Njësive të Qeverisjes Vendore;

- Reforma për Decentralizimin e Pushtetit vendor e nisur prej disa vitesh, e vazhduar dhe shoqëruar me transferimin e pronave, asetëve, resurseve dhe pasurive të tjera nga institucionet Qendrore në pronësi dhe

administrim të Njësive të Qeverisjes Vendore;

- Zbatimi i ligjit për buxhetin e shtetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,

gjatë periudhës 4 vjeçare dhe sidomos në vitet 2014-2015 nga strukturat e KLSH janë iniciuar problematika të reja, që janë përfshirë në Programet e auditimit, dhe konkretisht si më poshtë.

Problematika 1. Identifikimi, verifikimi i gjendjes juridike të pronës, asetit, pasurisë së transferuar në pronësi, përdorim apo në juridiksion të NJQV-ve Marrja nën administrim e pasurive lidhur me inventarizimin e gjendjes fizike e teknike dhe lidhur me posedimin për të evidentuar dhe rastet e përdorimit të paligjshëm të asetëve dhe aktiveve të qëndrueshme për shkak të mos inventarizimeve të rregullta

si gjatë fazave të procesit të transferimit, mbi bazën e të cilit është dhënë vendimmarrja nga Qeveria ashtu dhe në procesin përfundimtar dhe më pas.

Problematika 2. Aplikimi nga NJQV-të dhe Regjistrimi në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme i titujve të pronësisë së aseteve të qëndrueshme, të gjithë llojeve si: troje, ndërtesa, vepra infrastrukturore, regjistrimi dhe përditësimi i inventarëve kadastral dhe fuqisë lëndore e kullimore pyje, kullota toka bujqësore, fuqive bimore të bimësisë pyjore mjekësore e tanifere, vepra ujore dhe ujitëse së bashku me aksesoret përkatës, aktivet që lidhen me infrastrukturën dhe mobilimin e tokës bujqësore, pyjore, etj., të kaluara me status pronësie, përdorimi dhe apo të ndodhura në juridiksion territorial të Njësisë Qeverisëse, si fazë përfundimtare e përfshirjes në evidencën kontabile.

Problematika 3. Administrimi i marrëdhënive të menaxhimit, lidhur me zbatimin e planeve ekzistuese të menaxhimit dhe hartimin e planeve të reja për vënien në efikasitet të tyre, si dhe përfshirjen kostove dhe të ardhurave në buxhetin e njësisë NJQV-ve.

## KONKLUZIONE

Me përfshirjen dhe zgjerimin e tematikës së programeve të auditimit u arrit që me Vendim të Kryetarit të KLSH qartësohet dhe zgjerimi i fokusit të punës audituese si dhe të reformohet dhe mirë përcaktohet edhe emërtimi i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Gjithashtu përmendim Marrëveshjen e Bashkëpunimit të nënshkruar në muajin Dhjetor 2013, ndërmjet KLSH dhe Shoqatës së Njësisë të Qeverisjes Vendore, me synim rritjen e shkallës së transparencës dhe Bashkëpunimit në drejtim të auditimeve të cilësishme, dhënien e rekomandimeve lidhur me mirëadministrimin financiar e pasuror të NJQV-ve, dhe evitimin e tendencave e veprimtarive korruptive në administrimin e Buxhetit, përdorimin ligjor të territorit.

*II. Në auditimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) dhe Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP):*

*- Në auditimin e ZQRPP dhe ZVRPP fokusi është përqendruar në auditimin e trajtimit ligjor të regjistrimit të përfitimit të titujve të pronësisë shtetërore,*

publike dhe private, kjo e fundit e shkëputur dhe prejardhur nga dy format e para të pronësisë sipas llojeve të pasurive të paluajtshme;

- Nga auditimet në disa subjekte ka rezultuar se në 27 % të rasteve praktikat e regjistrimit të pasurive në zonat urbane kanë rezultuar me shkelje mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", Ligjin nr. 33/12, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme";

- Në mënyrë të përmbledhur rezultatet e auditimeve në ZVRPP-të sikundër u raportuan tregojnë për dëme ekonomike prej 329,723 mijë lekë, (pa përfshirë dëmin në natyrë për pasuritë me njësi matëse në natyrë) janë rekomanduar 292 Masa Organizative, 70 masa disiplinore dhe Kallëzime penale për 40 persona në 6 ZVRPP.

Kallëzimet penale me veprën "Shpërdorim detyre" lidhen me:

- Regjistrime tituj pronësie pa dokumentacionin e plotë dhe të nevojshëm ligjor;
- Transaksione dhe regjistrime pronësie pa dokumentacionin vërtetues për shlyerje detyrimesh, kryesisht të ndërtesave, pallateve ambienteve aksesori të tyre me shmangie nga tarifat përkatëse;
- Regjistrime titujsh pronësie pa formën e plotë ligjore dhe gjatë procesit të pa përfunduar të vlerësimit dhe verifikimit të titullit të pronësisë nga KVVTP dhe Gjykatat. Kjo kryesisht për pasuritë bujqësore.

#### Kallëzimet penale sipas Personave dhe Natyrës & Vlerës

Nr	Entitetet	Personat për kallëzim	Dëmi në 000 / lekë dhe në natyrë
1	ZVRPP Sarandë	3	6,742
2	ZVRPP Elbasan	4	Natyrë
3	ZVRPP Pogradec	5	Natyrë
4	ZVRPP Fier	6	100,125
5	ZVRPP Tiranë	8	Vlerë & natyrë
6	ZVRPP Shkodër	14	222,856
	<b>Totali</b>	<b>40</b>	<b>329,723</b>

Çështjet kryesore ku jemi fokusuar

Vëmendja është përqendruar:

A. Në regjistrimin e pronave dhe pasurive të tjera të paluajtshme të transferuara e të kaluara në pronësi të NJQV, sipas VKM-ve përkatëse dhe sipas dhënies e përcaktimit të titullit të pronësisë, *me qëllim që të vendoset mbrojtja e duhur ligjore mbi titujt e pronësisë shtetërore e publike për këto pasuri, dhe disa prej të cilave kanë hyre në marrëdhënie të dhënies në përdorim për afate të gjata kohore deri dhjetra vite, dhe për faktin që subjektet palë në marrëveshje kanë ndryshuar e ndryshojnë emërtimet për shkaqe të paqëndrueshmërisë së tyre nga ristrukturimi.*

B. në verifikimin dhe krahasimin e gjendjes faktike juridike të pasurive të paraqitura para daljes së VKM-ve përkatëse, pra saktësia e inventarizimit dhe verifikimit të gjendjes juridike sipas fazave të vendimmarrjes së miratimit të listave paraprake, me gjendjen juridike të paraqitur në VKM.

C. Saktësinë e regjistrimeve në Kartelat e regjistrimit të Pasurive të paluajtshme dhe paraqitja e tyre me saktësi në Hartat treguese, me synim ruajtjen e cenimit, përfitimit të paligjshëm apo përdorimin pa status të pronave publike, shtetërore kryesisht të llojeve troje, ndërtesa, infrastrukturë e mobilime të tokave bujqësore e sipërfaqeve pyjore, vepra e aksesore ujore, të pa vënë nën administrim apo të lëna jashtë inventarëve nga NJQV, apo nga ish njësitë ekonomike të ish ndërmarrje shtetërore, kooperativa bujqësore të ndodhura në territor e juridiksion të Komunave apo Bashkive.

D. Saktësia në administrimin e KPP-ve lidhur me veprimet apo transaksionet për identifikimin, veçimin dhe regjistrimin në pronësi "shtet", seksioni C të pasurive me sipërfaqe tepër mbi AMTP, rastet e regjistrimeve të pronave me mbivendosje, dhe më keq regjistrimet e pronave pa tituj pronësie; të cilat i sjellin detyrime pasurore dhe monetare Buxhetit të Shtetit, gjatë procesit të zbatimit të reformës së ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, njëherazi me këtë, marrëdhëniet ndërmjet ZVRPP-ve dhe KVVTP-ve lidhur me *shkëmbimin e informacionit të konfirmimit të gjendjes juridike të pasurive të verifikimit të titujve të pronësisë së tokës bujqësore me synim saktësimin e titujve të pronësisë përfituar me AMTP dhe shpejtimin e procesit të regjistrimit të tokave bujqësore si dhe lidhur ngushtësisht me këtë*

sigurimin e ruajtjen dhe miradministrimin e fondeve buxhetit të shtetit të destinuar për kompensimin e ish pronarëve.

E. Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces (e cila deri në një shkallë shpreh performancës e shërbimit të kësaj zyre shtetërore ndaj publikut) të pa përfunduara shprehur me të ardhura të përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar qytetarëve aplikues, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës në disa ZVRPP ndaj publikut, mos administrimin në arkiv të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 "Për arkivat", dhe me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", pra lidhur me ngritjen e funksionimin e Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm për shmangien e fenomeneve korruptive në fushën e administrimit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

*Tabela: Praktikave në proces me shkelje afati dhe të papërfunduara, për aplikimet për regjistrim të pasurive të paluajtshme*

Nr.	Entitetet e Audituar	Praktika në proces nr.	Vlera në 000/lekë, tarifa të paguara dhe shërbim i pa marrë
1	ZVRPP Korçë	1356	5398
2	ZVRPP Kavajë	833	5340
3	ZVRPP Sarandë	3256	13492
4	ZVRPP Pogradec	548	790
5	ZVRPP Tiranë	15533	55 269
TOTAL		21 526	80 289

KLSH ka konstatuar Pamjaftueshmëri e nivel të ulët të performancës së punës ZVRPP -ve shprehur në lidhje me:

a. Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara të cilat arrijnë kufij të konsiderueshëm, me të ardhura të përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP ndaj publikut, mos administrimin në arkiv të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të

aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, në kundërshtim e ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 "Për arkivat".

b. Si dhe pamjaftueshmërinë e performancës dhe pamjaftueshmëri e bazës nënligjore aktuale, në përmbushje të rritjes së transparencës së zyrës lidhur me shërbimin ndaj publikut dhe forcimit të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm lidhur me integritetin e punonjësve në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", lidhur me mungesën e një rregullore të brendshme të Funksionimit të Administratës së ZVRPP Korçë, të miratuar nga Kryeregjistruesi për periudhën e mëparshme dhe për vitet 2011-2012, lidhur me faktin se Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 "Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", e cila është ende ajo e viteve 1999, e shoqëruar me ndryshime të pjesshme, përveç se duhet përmbledhur ribërë e plotë, por nuk ka si objekt funksionimin e Administratës së ZVRPP, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit, pra nuk është e përshtatur me kërkesat e ligjeve nr. 9936, datë 26.6.2008, dhe zbatimit të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

c. Për pasojë nuk ka një përcaktim të kryerjes së detyrave lidhur me përgatitjen e evidencave informacionit në tërësi dhe sidomos lidhur me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve lidhur me mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë, si dhe vjeljen e opinionit të tyre për cilësinë afatin e shërbimit dhe sidomos lidhur me evidentimin tërësor, raportimin e praktikave në proces evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësisë së zgjatjes dhe shkeljes së afateve, evidentimin dhe ndjekjen periodike të zgjidhjes së pronave të regjistruara me mbivendosje, trajtimin dhe përgjigjen e ankesave, etj., pra mungon instalimi i Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB), në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

## REKOMANDIMI

### A. MASA PËR PËRMIRËSIM LIGJOR

1. Nga ZQRPP të hartohen, përditësohen e miratohen:

a. "Rregullorja për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", pasi rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999, është ajo e para 14 vjetëve, e cila ka



humbur aktualitetin dhe të përshtatet me ndryshimet ligjore, në zbatim të Ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme".

b. Rregullorja tip e Funkionimit të ZVRPP dhe Organigrama në përputhje me Strukturën Organizative, harmonizuar me përmbajtjen, përcaktimet, përshkrimet e vendeve të punës, me synim të ngritjes dhe funksionimit të Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) të Njësisë, për rritjen e transparencës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj publikut, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", trajtuar hollësisht në faqen 115-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Nga ZORPP të rishikohen, urdhrat e Kryeregjistruesit nr. 1049, datë 10.9.2012 "Për zbatimin e VKM nr. 576, datë 29.8.2012 "Për caktimin e Listës së Shërbimeve që Ofron ZRPP", Urdhri nr. 1191, datë 5.11.2012 "Për afatet e trajtimit dhe përpunimit të kërkesave nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", ku afati maksimal i përfundimit të procedurës zgjat nga 1 ditë deri 30 ditë, pasi: Gjithashtu nga auditimet e ushtruar në ZVRPP ka rezultuar se të dy urdhrat e mësipërm nuk i japin zgjidhje problemeve në drejtimet si më poshtë:

- Disa qindra praktika kanë mbetur ende tek punonjësit edhe pas dërgimit të Aktverifikimeve (AV), brenda afatit mujor, ndërsa ato duhej të arkivoheshin në arkivë, dhe duhej bërë edhe një njoftim përfundimtar kërkuesit, duke e vënë në dijeni se praktika ndodhet e arkivuar si dhe për shërbimin e pa marrë (dokumentin e pa marrë), është kreditor për shumën përkatëse të vlerës së paguar në aplikim. Kjo masë do të rriste transparencën ndaj publikut, dhe do të siguronte integritetin e ZVRPP dhe të punonjësve të saj.
- Të ardhurat e vjela nga aplikimet e qytetareve dhe duke mbetur praktikat pa zgjidhur dhe në proces, janë të ardhura të arkëtuara sa kohë që shërbimi-produkt nuk është kryer nga kjo zyrë ndërsa qytetari ka paguar duke mos marrë produktin- shërbimin e kërkuar.
- Për vetë natyrën e burimit këto të ardhura janë të pamërituara pa dhënë shërbimin.
- Nuk është çelur llogaria "Kreditorë për shërbime të pa kryera dhe në proces", ku të evidencoheshin këto të ardhura të marra nga qytetarët për shërbime të pa kryera, si dhe nuk janë arkivuar praktikat në arkivë, e duke mos i lënë në duar të punonjësve me afate 1-2 e më shumë vite, në kundërshtim me afatin e përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative KPA, si dhe hap pas hapi me

sjelljen e dokumentacionit të munguar nga qytetarët, të vazhdonte procedura e tërheqjes së praktikës për përpunim nga arkiva dhe përfundimin (mbylljen) e praktikës me përfundimin e kryerjes së shërbimit ndaj qytetarit. Kjo mënyrë e të vepruar rrit transparencën, shmang varësinë e qytetarit dhe krijimin e idesë subjektivizmit dhe apo dhe të paragjykimit të shërbimit të kësaj zyre shtetërore ndaj qytetarit taksapagues.

- Dorëzimi dhe arkivimi në arkivë i praktikave në proces menjëherë pas kryerjes së aktverifikimit nga punonjësi përpunues dhe dërgimit apo njoftimit të qytetarit, bashkë me njoftimin ti bëhet e ditur qytetarit se kjo zyrë është kreditore ndaj tij për shumën e paguar dhe shërbimin e pakryer e lënë në proces si dhe dokumentacioni i tij ndodhet i arkivuar pranë ZVRPP, në pritje deri në 1 muaj, pas këtij afati qytetarit aplikues i kthehet shuma e paguar.

Gjithashtu KLSH ka rekomanduar e kërkuar rishikimin e Statusit Juridik lidhur me menaxhimin e këtij entiteti.

Me hollësisht, nga auditimet në ZVRPP-të lidhur me regjistrimet e pasurive private dhe shtetërore, administrimin e dokumentacionit dhe zbatimin e procedurave ligjore për periudhën 2014-2015.

Fokusi kryesor në auditimet e ZVRPP-ve ka synuar në *drejtim të përmirësimit e pasurimit të përgatitjes së programeve të auditimit* duke përfshirë e kombinuar në programe problematikat dhe indicjet e hasura në auditimet e mëparshme lidhur me marrjen e vënien nën administrim të aseteve nga NJQV-të dhe pasuritë e përfituara nga ALUIZN-i përfshirë këtu ndryshimet e herë pas hershme të akteve nënligjore të cilat për vetë natyrën e procesit ato janë të shpeshta. Në këtë lloj auditimi gjithashtu është përdorur metoda e kombinuar duke përdorur edhe problematikat, gjetjet dhe fenomenet lidhur me administrimin e aseteve të qëndrueshme, pasurive publike shtetërore nën administrim të Njësive të Qeverisjes Vendore si bashkitë, ish-komunat apo ente të tjera. Ky kombinim kryesisht ka synuar marrjen dhe vënien nën administrim dhe regjistrimin e tyre si fazë përfundimtare ligjore e transferimit dhe regjistrimit në ZVRPP pra marrjen e formës së duhur përfundimtare juridike të titujve të pronësisë. Konkretisht gjatë periudhës në fjalë janë audituar disa ZVRPP ku janë evidentuar gjetjet dhe nga KLSH dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse.

GJETJE

1. Në disa ZVRPP, si: Tiranë, Sarandë, Shkodër, etj., gjatë viteve 2012, 2013 dhe 2014 dhe 6-mujorin e I-rë 2015, ka patur bashkëpunim të pamjaftueshëm, ndërmjet ZVRPP-ve, dhe Komisioneve të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP), pranë Prefektit të Qarkut, reflektuar në konstatimet e mëposhtme:

- a. KVVTP, pranë Prefektit të Qarkut Tiranë, për periudhën 2012-6-mujori I-rë vitit 2015 i ka drejtuar ZVRPP Tiranë 2209 kërkesa për informacion, verifikim, konfirmim të Titujve të pronësisë së tokës bujqësore, për të cilat nga ana e ZVRPP Tiranë, janë kthyer përgjigje për 836 kërkesa (ose 37%), nuk ka kthyer përgjigje për 1373 kërkesa (ose 63%) me tejkallim afati deri 5 vjet. Përgjigjet e kthyer nga KVVTP për 836 përgjigjet, janë me vonesa dhe në tejkallim të afatit, të cilat përkujnë nga disa ditë deri në 10 muaj, pasqyruar në tabelën emërtuar "Tabela e përgjigjeve të kërkesave të KVVTP-ZVRPP për periudhën 2012-6/mujori I parë 2015"; veprime këto në kundërshtim me KPA me Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", i ndryshuar, dhe me UKM nr. 2, datë 13.6.2013 "Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë e Paluajtshme të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)".
- b. Mos dhënia e përgjigjeve për 1373 kërkesa dhe shkelja afateve ligjore të kthimit të përgjigjeve janë me pasoja në mos pasqyrimin e ngjarjeve në KPP, parandalimin e transaksioneve, rritjen e praktikave në proces me aplikime të papërfunduara, vonesat në regjistrim të Pasurive bujqësore, praktika në kundërshtim me nenet 59, 60 dhe 74, si dhe në mos përmbushje të funksionit të ZVRPP përcaktuar në nenet 19, 20 dhe 25 të Ligjit nr.33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme".
- c. Mungesa e dokumentacionit fizik në arkivë i 2209 kërkesave, lënia në përdorim të specialistëve të zonave, mos lidhja e kërkesës në dosje të veçanta përfshirë gjithë dokumentacionin shoqërues deri në përfundimin e Vendimmarrjes dhe mos dorëzimi në arkiv me vonesa deri në 5 vjet, praktika që janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 "Për Arkivat", dhe për shkeljen e afatit 1 muajor të KPA, me Urdhrat e regjistruarit, dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 "Për Punën në ZVRPP", të ndryshuar dhe me Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 "Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në ZRPP", dhe që

ngarkon me përgjegjësi Regjistruerit sipas viteve si dhe përgjegjësit e specialistët e zonave, përcaktuar në tabelën e mësipërme emërtuar "Personat përgjegjës për kërkesat pa përgjigje ndaj KVVTP dhe për përgjigje të vonuara 2012-2015".

Rekomandim: KLSH ka rekomanduar Regjistruerit e ZVRPP-ve, të marrin masa, për të inventarizuar dhe çelur dosjet përkatëse për 2209 kërkesa për informacion, verifikim, konfirmim të Titujve të pronësisë së tokës bujqësore të KVVTP drejtuar ZVRPP, duke administruar në arkivë shkresat, që kanë shoqëruar këto kërkesa. Ndërsa për 1373 kërkesa, për të cilat nga ZVRPP Tiranë nuk janë kthyer përgjigje në shkelje të afateve ligjore, të zbatohen procedurat dhe të filloje pasqyrimi në KPP deri në zgjidhjen e plotë ligjore për regjistrimin e pasurive bujqësore, të kthimit të përgjigjeve duke pasqyruar ngjarjet në KPP, me synim parandalimin e transaksioneve, uljen e praktikave në proces me aplikime të papërfunduara, eliminimin e vonesave në regjistrim të Pasurive bujqësore, pasqyruar në: Tabela e përgjigjeve të kërkesave të KVVTP-ZVRPP për periudhën 2012- 6-mujori i I-rë 2015 dhe Kërkesa, Projekt vendime dhe Vendime të KVVTP për ZVRPP për vitet 2012-6-mujori i I-rë 2015.

2. Në disa ZVRPP, si Tiranë, për periudhën 2012-6-mujori i I-rë vitit 2015, i kanë drejtuar KVVTP-ve, pranë Prefekturave të Qarkut, etj., 235 kërkesa për verifikim, vlerësim të Titujve të Pronësisë së tokës bujqësore, për të cilat KVVTP Prefektit të Qarkut Tiranë ka kthyer përgjigje për 38 kërkesa (ose 16%), nuk ka kthyer përgjigje prej 5 vjetësh, për 197 kërkesa (ose 84%), duke tejkaluar afatin 1 muaj; ndërsa të 38 përgjigjet janë kthyer me vonesa dhe në tejkallim të afatit nga disa ditë deri në 3-4 muaj; veprime këto në kundërshtim me KPA me Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", i ndryshuar, me UKM nr. 2, datë 13.6.2013 "Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë, të Paluajtshme, të Fituara me Atin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)", që ngarkojnë me përgjegjësi Strukturat e KVVTP, por dhe personat e ZVRPP që nuk kanë rikërkuar më tej, ecurinë e tyre.

a. Mos dhënia e përgjigjeve për 197 kërkesa dhe shkelja afateve ligjore të kthimit të përgjigjeve janë me pasoja në mos pasqyrimin e ngjarjeve në KPP, parandalimin e transaksioneve, rritjen e praktikave në proces me aplikime të papërfunduara, vonesat në regjistrim të Pasurive bujqësore, pra në kundërshtim me nenet 59, 60 dhe 74, si dhe në mos përmbushje të funksionit të ZVRPP përcaktuar në nenet 19, 20 dhe 25 të Ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 Gjithashtu, që gjithashtu tregon edhe për bashkëpunim të pamjaftueshëm të

KVVTP-së, ndaj ZVRPP Tiranë, shkelje e afateve dhe procedurave të KPA, dhe mos reagim i ZVRPP Tiranë, për ta prezantuar problemin në Komisionin Qeveritar të Tokës dhe Sekretariatit Teknik të Komisionit Qeveritar të Tokës, mosveprim në kundërshtim me Ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", i ndryshuar dhe me UKM nr. 2, datë 13.6.2013 "Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë, të Paluajtshme, të Fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP).

- b. Mungesa e dokumentacionit fizik në arkiv për 235 *kërkesave*, lënia në përdorim të specialistëve të zonave, mos lidhja e kërkesës në dosje të veçanta me gjithë dokumentacionin shoqërues deri në përfundimin e Vendimmarrjes, dhe mos dorëzimi në arkiv në periudhën 5 vjet, vijonë në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 "Për Arkivat", dhe për shkeljen e afatit 1 mujor të KPA, me Urdhrat e regjistruarit, *Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 "Për Punën në ZVRPP"*, të ndryshuar, dhe me *Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 "Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në ZRPP"*.

*Rekomandim:* KLSH ka rekomanduar Regjistruarit e ZVRPP-ve, të marrin masa, të inventarizohen dhe çelen dosjet përkatëse të 235 *kërkesave* për verifikim, konfirmim të Titujve të Pronësisë së Tokës bujqësore të ZVRPP drejtuar KVVTP, duke kthyer shkresat origjinale në arkivë, dhe për 197 *kërkesa* pa përgjigje, dërguar për shqyrtim në KVVTP, të rishqyrtohen AMTP-të nga ZVRPP Tiranë dhe për ato AMTP që dalin detyrim dhe kompetencë e ZVRPP pasi të identifikohen pasuritë, të zbatohen procedurat ligjore të regjistrimit me synim kryerjen e shërbimit të paguar dhe të pa marre të qytetarëve.

3. Në *disa* ZVRPP, nuk ka patur një evidentim, ndjekje dhe informim të brendshëm të stafit, për pronat e regjistruara me mbivendosje, të llojit tokë troje, objekte, dhe, kryesisht ndaj pronës shtetërore dhe ndaj pronave private, duke evidentuar një performancë të dobët menaxhimi, mungesë transparence, trajtim i pabarabartë i palëve, si pasojë në *disa* raste dhe krijimin e regjistrimeve me mbivendosje nga vetë këto Zyra, në kundërshtim me Ligjin nr.7843 datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", Ligjin nr. 33, datë 21.03.2012 dhe me aktet tjera nënligjore.

*Rekomandim:* KLSH duke vlerësuar rëndësinë këtij problemi me ngarkesa të theksuara sociale ka hyrë në thellësi të auditimi të këtyre çështjeve dhe ka

rekomanduar rast pas rasti Regjistruetit përkatës duke kërkuar masat ndëshkimore ndaj personave shkaktarë, evidentimin e pasurive me mbivendosje dhe publikim e tyre brenda stafit, si masë parandaluese, si dhe, në çdo rast ndjekjen e procedurave lidhur me nxjerrjen e urdhrave për ndarje apo bashkim pasurie, dhe zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" dhe Rregulloren e ZQRPP nr.184, datë 8.4.1999 "Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme" të ndryshuar, duke e shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që argumenton veprimin.

*Gjithashtu* KLSH ka rekomanduar Regjistruetit e ZVRPP-ve, të bëjnë identifikimin dhe evidentimin e pasurive të regjistruara me mbivendosje dhe të ndjekin të gjitha procedurat ligjore, në zbatim të përcaktimeve të pikës 3, neni 37, neni 59 dhe pika 1 e nenit 60 të Ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", dhe të bëjë njoftimin e palëve, Zyrën e Avokatit të Shtetit (ZAVSH), kur rasti lidhet me pronë shtetërore, për ndjekjen e procedurave ligjore për zgjidhjen e mbivendosjes, lidhur me pasuritë rezultuar me mbivendosje.

4. Në disa ZVRPP, nuk janë ndjekur hapat për instalimin e Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm në sistemin e administrimit të dokumentacionit, gjendje kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", pasi:

1. Nuk ka një rregullore të brendshme të Funksionimit të Administratës së ZVRPP-ve, të miratuar nga Kryeregjistrueti për periudhën e mëparshme dhe për vitet 2012-2015 të bazuar ne organikat dhe organigramat dërguar nga Kryeministri me Urdhrat nr. 196, datë 04.08.2014 "Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Urdhrin nr. 33, datë 2.4.2013, të Kryeministrit "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", dhe Urdhrave nr. 58, datë 23.04.2009, nr. 33, datë 02.04.2014 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Sistemit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme".

Për pasojë nuk ka një përcaktim, përshtkrim të kryerjes së detyrave, lidhur me ushtrimin e kompetencave dhe mbajtjes së përgjegjësi të secilit specialist sipas sektorëve, Regjistruetit, zv.Regjistruetve dhe juristëve, lidhur me përgatitjen e evidencave, data base të informacionit në tërësi, sidomos lidhur me administrimin e dokumentacionit, trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve, për mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve, lidhur me vjeljen e opinionit të tyre për cilësinë afatin e shërbimit dhe sidomos lidhur me evidentimin tërësor,

raportimin e praktikave në proces evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësisë së zgjatjes dhe shkëljes së afateve, evidentimin dhe ndjekjen periodike të zgjidhjes së pronave të regjistruara me mbivendosje, trajtimin dhe përgjigjen e ankesave, etj. Pra mungon Sistemi i Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB), gjendje kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Gjithashtu, mungojnë dhe nuk janë përcaktuar, shkruar, kushtet e pranimit, testimi fillestar dhe në vlerësim të aftësive profesionale, trajnimit dhe aftësimit të marrjes në punë të punonjësve në ZVRPP.

Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 "Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", përveç se është një rregullore tekniko ligjore e cila është ende ajo e viteve 1999, e shoqëruar me ndryshime të pjesshme, përveç se duhej përmbledhur e bërë e plotë, duhet përshtatur me ligjin aktual. Kjo nuk ka si objekt funksionimin e Administratës së ZVRPP, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit dhe zbatimit të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" (*Trajtuar hollësisht në faqet 235-243 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: ZQRPP dhe ZVRPP-të, të ndjekin hapat e duhura ligjore, për vendosjen dhe instalimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, lidhur me Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) dhe të hartojnë, miratojnë e zbatojnë dokumentet ligjore:

a. Rregulloren e brendshme të Funkcionimit të Administratës së ZVRPP Tiranë, të miratuar nga Kryeregjistruesi bazuar në organikat dhe organigramat dërguar nga Kryeministri me Urdhrat nr.196, datë 4.8.2014 "Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Urdhrit nr.33, datë 2.4.2013, të Kryeministrit"; ku të përfshijnë (shkruhen) kushtet e pranimit, testimi fillestar dhe në vazhdim të aftësive profesionale, trajnimit dhe aftësimit të marrjes në punë të punonjësve në këtë ZVRPP, statusi i të punësuarve si dhe përcaktim të kryerjes së detyrave, ushtrimit e kompetencave dhe mbajtjes së përgjegjësive të secilit specialist sipas sektorëve, Regjistruesit, zv.Regjistruesve dhe juristëve, detyrimet lidhur me përgatitjen e evidencave, database informacionit në tërësi administrimin e dokumentacionit, si dhe të përcaktohen e vendosen SMKB (Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm) nëpërmjet vënies nën administrim dhe administrimit të dokumentacionit tërësor dhe të praktikave në proces (mos lënia e tyre për kohë të gjatë tek specialistët).

b. Të hartojë Rregulloren Tekniko-Ligjore të përshtatur e përditësuar me ligjin e ri dhe bazën tjetër ligjore të re të ndryshuar, pasi Rregullorja tekniko-ligjore aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, përveç se është një rregullore tekniko ligjore e tejkualuar në kohë dhe me ndryshime të pjesshme, që nuk përshtaten me ligjin aktual.

5. Nivel i ulët i performancës dhe transparencës së punës së ZVRPP Tiranë i shprehur në:

- a. Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara të cilat prej 5 vitesh deri në vitet 2015, arrijnë në rreth mbi 15 533 kërkesa (pa përfshirë v.2015), nga të cilat nga ZVRPP, janë përfituar të ardhura në vlerën 55.27 milion lekë, pa dhënë shërbimin e faturuar në sportel. Kjo ka sjellë mungesë transparence të punës së ZVRPP Tiranë ndaj publikut, mos administrimin në arkivë të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, në kundërshtim e Ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”.
- b. Mungesën e një performace, në përmbushje të rritjes së transparencës së zyrës, lidhur me shërbimin ndaj publikut dhe forcimit të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, lidhur me integritetin e punonjësve në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Mekanizmin Financiar dhe Kontrollin”, lidhur me mungesën e rregullores së brendshme të Funkzionimit të Administratës së ZVRPP Tiranë, me mungesën e rishkrimit dhe aktualizimit Rregullores aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”. Kjo rregullore, është e pa përshtatur me kërkesat e Ligjeve nr. 9936, datë 26.6.2008, dhe me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- c. Për pasojë nuk ka një përcaktim të qartë të detyrave e përgjegjësive për përgatitjen e evidencave informative në tërësi, shërbimit të IT, trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve lidhur me mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë, me vjeljen e opinionit të tyre për cilësinë afatin e shërbimit, lidhur me evidentimin tërësor, raportimin e praktikave në proces evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësive së zgjatjes dhe shkeljes së afateve, evidentimin dhe ndjekjen periodike të zgjidhjes së pronave të regjistruara me mbivendosje, trajtimin dhe përgjigjen e ankesave, pra mungon instalimi i Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB), në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë



8.7.2010 "Për praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara prej 5 vitesh deri në vitet 2015, të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin".

Rekomandim: *KLSH ka rekomanduar* Regjistruesit të ZVRPP Tiranë të marrë masat për inventarizimin e dokumentacionit, të kryejë kontrollin ligjor të rregullshmërisë së praktikave të mbetura në proces dhe të evadohen *aplikimet* e praktikave, që aktualisht janë në proces, të analizohen dhe kthehen të ardhurat e përfituara, pa dhënë shërbimin e faturuar në vlerën e cila ka sjellë mungesën shërbimit të detyruar me ligj të ZVRPP Tiranë ndaj publikut. Të inventarizohen, administrohen në arkiv dokumentacioni përkatës i praktikave, si dhe të evidentohen e inventarizohen praktikat në proces të vitit 2015.

7. Në disa raste në regjistrimin e pallateve, në Kartelat e Pasurive të Paluajtshme (KPP) nuk janë regjistruar në rubrikën "Përshkrimi i veçantë" dhe kornizën "Për pjesën e përbashkët" për pallatin në tërësi dhe për çdo aksesori të tij (apartament, shesh pushimi, shkallë, ashensor, kabinë, depozita uji, sistem ngrohje, etj.). Pra nuk janë llogaritur e ndalur taksa e kalimit të pronësisë ndaj investitorëve përkatësisht në sipërfaqe totale prej 18866 m<sup>2</sup>, me një dëm ekonomik në vlerën 18,913,000 lekë (*sipërfaqe 18866 m<sup>2</sup> x 1000 lekë/m<sup>2</sup>*).

Këto veprime e mosveprime, janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" neni 50, "*Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa*", pika 2, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.1996 "Për Sistemin e taksave vendore", i ndryshuar neni 28, pika 2. Mosveprime qëndrojnë në faktin se nuk i janë ndalur firmës ndërtuese që në regjistrim, pasi apartamentet dhe njësitë e shitura qytetarëve përfshijnë në çmim dhe vlerën e këtyre ambienteve të përbashkëta.

Rekomandim: *KLSH ka rekomanduar* ZVRPP Tiranë, të marrë masa për të plotësuar, kartelat e pasurive të paluajtshme, seksioni për sipërfaqet e përbashkëta sipas përqindjes së pjesëmarrjes në përputhje me Udhëzimin Metodik për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme", nr. prot. 76, datë 13.09.1999 si dhe Ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme". Gjithashtu në çdo rast për pasuritë pallat për njësitë e katit nëntokë si kabina elektrike, ambientet si dhoma e pastrueseve, ambjente shërbimi për hidraulikët, depozita e ujit dhe sistemi i pompave dhe ambjenti teknik për ashensorët, të hapen kartelat përkatëse të pasurisë dhe pas plotësimit të dokumentacionit arkëtimin e dëmit ekonomik ndaj subjekteve si e ardhur e munguar për buxhetin e Pushtetit Vendor.

8. Në disa raste mungon e nuk ishte bërë inventarizimi i dosjeve të dokumentacionit të referencave të regjistrimit të pasurive, dhe në disa raste nuk ishin firmosur nga specialistët përkatës, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP”.

Rekomandim: KLSH ka rekomanduar ZVRPP të marrin masa që në administrimin e dokumenteve dhe inventarëve të dosjeve të pasurive, të merren masa për zbatimin e plotë të kërkesave të përcaktuara me Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren e ZORPP nr.184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme” të ndryshuar, rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP”.

9. Janë konstatuar keqadministrim i mbajtjes së KPP-ve, të cilat janë mbyllur pa vulën dhe firmën e regjistruarit në kundërshtim me Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 si dhe Udhëzimit Metodik, nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Rekomandim. KLSH ka rekomanduar të marren masa për plotësimin e kartelave të pasurive të paluajtshme, me nënshkrimet e duhura nga punonjësit që kryejnë veprimet në kartelë, të plotësohen datat përfundimtare, të mbyllën kartelat, të përcaktohen në cilin volum dhe faqe vijojnë pasuritë e ndara, si dhe të mos kryhen më veprime në kartela të pasurive të paluajtshme, me urdhër të panënshkruar dhe të pavulosur nga Regjistruari, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Metodik, nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

10. Në disa ZVRPP si Tiranë, Sarandë, Shkodër, Pogradec, etj., KLSH ka konstatuar mungesë bashkëpunimi, performancë të pamfjateshme me Gjykatat dhe sidomos me Komisionet Vendore të Verifikimit dhe Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP), të tokës bujqësore, lidhur me mungesën e shkëmbimit të informacioneve konfirmuese dhe mosndjekjen e procedurave për hartimin e dokumentacionit për regjistrimin, identifikimin e pasurive objekt, si dhe nuk ka kryer evidentimin e raportimin e ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe zbatimit e pasqyrimin në KPP për periudhën 2012, 2013, 2014 dhe 2015, lidhur me 87 (nga 170) vendimet marrë nga Gjykata e Shkallës Parë Administrative Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë për të cilat në 45 raste ZVRPP ka qenë palë kërkuese, ku gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve sipas vendimeve të cilat i përkasin ZVRPP-Tiranë, të cilat i janë dërguar në ZVRPP Tiranë për regjistrim

të pavlefshmërisë së plotë dhe të pjeshme dhe regjistrim "shtet" të 91 AMTP-ve me mbi 143 pasuri me sipërfaqe totale prej 866096 m<sup>2</sup>, nga e cila: shlyerje të detyrimit ndaj shtetit për sipërfaqen e tjetërsuar prej 59 045 m<sup>2</sup> në vlerën 21,830,420 lekë, kthim e regjistrim në pronësi "shtet" të sipërfaqes prej 839047 m<sup>2</sup> tokë bujqësore të llojit "arë", "vresht", "ullishtë", "pemëtoare".

- Në asnjë rast nuk ishte vendosur masë kufizimi mbi pasuritë, gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit.
- nuk është regjistruar "Shtet" asnjë metër kundrejt 839 047 m<sup>2</sup>.
- nuk janë vendosur barrë mbi pasuritë e tjetërsuara në 21 raste për 59045 m<sup>2</sup>, me vlerën prej 21,830,420 lekë (*deri në përfundimin e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët me objekt vlefshmërinë e titujve të pronësisë*) që ka sjellë si pasojë mos arkëtim dhe dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Nga auditimi i vendimeve të KVVTP Prefekti Qarkut Tiranë dhe Vendimeve të Gjykatave e Shkallës Parë Administrative Tiranë, me palë paditëse Prefekti Qarkut Tiranë, të paditur mbajtësit përkatës të titujve të pronësisë me AMTP, përfaqësues të familjeve bujqësore dhe palë e tretë ZVRPP Tiranë, rezulton se gjithnjë ka qenë në mungesë, duke mos marrë pjesë në gjykim.

Rekomandim: KLSH ka rekomanduar Regjistruesin e ZVRPP Tiranë të identifikojë pasuritë objekt të vendimeve, të ndjekë procedurat për hartimin e dokumentacionit, regjistrimin, evidentimin e raportimin të ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe zbatimit e pasqyrimin në KPP për periudhën 2012, 2013, 2014 dhe 2015 lidhur me 87 vendimet e Gjykatës së Shkallës Parë Administrative Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë për të cilat në 45 raste ZVRPP ka qenë pale kërkuese, ku gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve sipas vendimeve që i përkasin Zonës 1, ZVRPP Tiranë të dërguara për regjistrim të pavlefshmërisë së plotë dhe të pjesëshme dhe regjistrim "shtet" të 91 AMTP-ve me mbi 143 pasuri me sipërfaqe totale prej 886 096 m<sup>2</sup> për të cilat:

- a. Të kërkojë kufizim, kthim e regjistrim në pronësi "shtet", të sipërfaqes prej 839 047 m<sup>2</sup> tokë bujqësore të llojit arë, vresht, ullishtë, pemëtoare.
- b. Të vendosë masat kufizuese për pasuritë ku nuk është vendosur kufizim në sipërfaqen 849 047 m<sup>2</sup>, gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit,

c. Të vendoset kufizimi mbi 21 pasuritë e tjetërsuara me sipërfaqe 59045 m<sup>2</sup>, me vlerën prej 21,830,420 lekë *(në të dyja rastet ka përfunduar procesi gjyqësor vetëm në shkallë të parë me rrëzimin e padisë, ndërkohë që nga ZVRPP deri në marrjen e vendimit nga gjykata nuk është ndërmarrë asnjë veprim për kufizimin mbi këto pasuri)*, deri në përfundimin e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët.

## B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Gjithashtu KLSH, për shkeljet e konstatuara nga auditmi në ZVRPP-të, si Tiranë, ka rekomanduar 12 masat zhdëmtuese mbështetur në Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale 228,513,887 lekë.

## C. MASA DISIPLINORE

Për shkeljet e dhe moszbatimin e disiplinës ligjore të punës nga personeli i ZVRPP-ve, KLSH ka kërkuar masa disiplinore, ndaj personave, si më sipër, mbështetur në Kreu IV, gërma "c" dhe "ç" dhe neni 37, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, dhe në Ligjin nr. 33/2012, datë 29.4.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", si dhe në kontratën individuale të punës.

5. AUDITIMI NË NJQV-BASHKITË

*Referues: Bajram LAMAJ – Drejtor Departamenti,  
Kristaq GJURGJAJ – Auditues i lartë,  
Skënder MUÇA – Auditues i parë.*



Për vitin 2015 nga Departament i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Asete të Qendrueshme, u parashikuan të auditohen 55 subjekte gjithsej dhe janë realizuar 61 auditime të evaduar dhe pa evaduar 3 auditime të tjera, ose 6 subjekte mbi parashikimin.

Për vitin 2015, ne kemi audituar 48 subjekte të NJQV, nga këto 21 bashki dhe 25 ish komuna, institucionin e Prefektit Shkodër dhe Këshillin e Qarkut Vlorë. Rezultatet e auditimeve në Njësitë e Qeverisjes Vendore

në vitin 2015, kanë qenë në nivel të lartë dhe me tregues të mirë të evidentuar dhe për të cilët kemi dhënë dhe rekomandimet përkatëse, si për përmirësimin e gjendjes, por dhe për zhdëmtimin e dëmit të evidentuar nga personat përgjegjës.

Janë rekomanduar vetëm për NJQV, në vitin 2015, për kallzim penal në 14 subjekte për 65 persona, nga të cilat: 8 bashki me 40 persona dhe 6 komuna me 25 persona. Për ta janë dërguar materialet pranë prokurorive të rretheve gjyqësore. Pra kemi një rritje të forcës ndëshkuese të paligjshmërisë në veprimtarinë ekonomike të këtyre NJQV, si: Bashkia Pogradec 6 persona, Bashkia Kavajë 12 persona, Bashkia Fier dhe Patos nga 4 persona dhe komuna Velipojë 10 persona nga këta tre ish kryetar komune dhe të tjerët anëtarë të ndarjes së tokës, komuna Novoselë 3 persona. Këta janë dërguar kryesisht për shpërdorime në administrimin e aseteve, ku kanë dhënë me qira e shitur pyje e kullota në kundërshtim me ligjin dhe pa zhvilluar procedurat e caktuara ligjore, siç është rasti flagrant i komunës Velipojë, Balldren i Ri dhe Novoselë. Po kështu kemi dërguar dhe për shkelje të barazisë në tendera me efekte ekonomike.

## a. Mbi masat organizative për NJQV:

Për vitin 2015 janë rekomanduar 956 masa organizative dhe janë realizuar 517 rekomandime ose në masën 54%.

Në 37 subjektet e verifikuara për zbatimin e rekomandimeve nga 842 masa organizative janë zbatuar 224 masa organizative, 224 janë në proces dhe 168 masa nuk janë realizuar, si ZVRPP Pogradec 20 masa, Bashkia Kuçovë 13 masa, Bashkia Pogradec 10 masa organizative, etj.

## b. Mbi masat për shpërblim dëmi:

Nga auditimet e 48 subjekteve të evaduara deri më datën 31.12.2015, kanë rezultuar gjetje nga auditimi në vlerën 1,291 milion lekë. Sqarojmë se shumën e gjetjeve e kanë rritur raportimi si mungesë të ardhurash në ish-Komunën Velipojë, për vlerën 242 milion lekë dhe ish-Komunën Balldren i Ri Lezhë, për vlerën 430 milion lekë, e cila përfaqëson vlerën e qerasë së paarkëtuar për dhënie me qira të sipërfaqes kullotë prej 4.12 ha ose rreth 50% të gjetjeve gjithësej.

Nga të dhënat për 48 subjektet e verifikuara,rezulton se nga rekomandimet tona prej 1,291 milion lekë, pranohen dhe konsiderohen të zbatuara në vlerën 1,260 milion lekë, pra nuk pranohen në masën 31 milion lekë, ose pranohen rreth 85-90% të rekomandimeve, duke mos u pranuar dhe mos zbatuar nga 4-5 subjektet, në vlerën për rreth 31 milion lekë. Kryesisht nuk pranojnë rekomandimet e KLSH këto subjekte: Bashkia Patos, në vlerën 4.252 mijë lekë; Bashkia Tiranë, ka pak shpresa arkëtimi vlera prej 13,934 mijë lekë (rekomandim për ndërmarrjet e vartësisë), Bashkia Fier, e cila nuk pranon shumën 8,878 mijë lekë; Komuna Novoselë (aktualisht njësi Administrative e Bashkisë Vlorë), në vlerën 3,313 mijë lekë, detyrime këto për qerata e tokave, të cilat nuk janë të regjistruara në ZVRPP; Bashkia Divjakë, në vlerën prej 1,317 mijë lekë, me arsyetimin se janë plotësuar dokumentacioni që mungonte në prokurime, etj. Me argumentimet e këtyre subjekteve nuk jemi dakord dhe jemi duke përgatitur shkresat dhe do u rikërkojmë edhe njëherë zbatimin e rekomandimeve tona dhe njoftimin me shkrim në periudhën 6 mujore, sipas ligjit organik të KLSH.

## c. Mbi masat disiplinore dhe administrative:

Nga 48 subjektet e evaduara për vitin 2015 janë rekomanduar 722 masa disiplinore dhe administrative, realizuar 376 masa disiplinore.

Për periudhën e vitit 2015 të detajuara masat disiplinore paraqiten si më poshtë:

d. Për prokurimet publike

Nga auditimi i aktivitetit të buxhetit të vitit 2015, nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme në subjektet e audituara, 809 procedura prokurimi të zhvilluara me vlerë 15,401 milion lekë janë audituar 518 procedura prokurimi në vlerën 10,958 milion lekë, përkatësisht 64% të numrit dhe 72% të vlerës, nga subjektet e audituara janë konstatuar me shkelje 481 procedura prokurimi, me një efekt financiar prej 297 milion lekë, e cila ka ardhur si rezultat i shkeljeve të rregullave të prokurimit publik, në drejtimet e mëposhtme:

- *Nga mos llogaritja e vlerës së kontratës në 244 procedura prokurimi (neni 28);*
- *Për shkelje të nenit 12 në 99 procedura prokurimi;*
- *Në mos përcaktimin e dokumenteve të tenderave në 213 procedura prokurimi (neni 41);*
- *Në mos përcaktimin e qartë të specifikimeve teknike, në 127 procedura prokurimi (neni 23);*
- *Në hapjen dhe shqyrtimin e ofertave në 211 procedura prokurimi (nenet 45,52 dhe 57);*
- *Në kualifikimin e padrejtë në 107 procedura prokurimi (nenet 44, 55, 56);*
- *Në skualifikimin e padrejtë në 138 procedura prokurimi (neni 47);*
- *Në mos hartimin e raporteve për titullarin në 46 procedura prokurimi;*
- *Në mbikëqyrjen e dhe zbatimin e kontratave në 66 procedura prokurimi;*
- *Për mos arkivimin e dosjeve në 67 procedura prokurimi.*

Të dhëna mbi subjektet e evaduara, grupet e auditimit, rekomandimet për dëmin ekonomik, numri masave organizative, masave disiplinore dhe kallëzimeve Penale, për vitin 2015 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr. Prog.	Nr.	Emërtimi i subjekteve	Dëmi Rekomandime, në 000 mijë lekë	Masa Organizative	Masa Disiplinore dhe Administrative	Kallëzime penale
a	b	c	1	2	3	4
	I	BASHKITË	415,017	484	451	36
1	1	Bashkia Himarë	85,373	38	41	--
2	2	Kuçovë	24,941	21	22	5
3	3	Mamurras	8	19	10	--
4	4	Ersekë	14,769	16	25	--
5	5	Pogradec	22,892	27	38	6
6	6	Fier	10,101	28	27	4
7	7	Memaliaj	5,115	28	6	2
8	8	Durrës	52,375	30	41	--
9	9	Vlorë (tematik)	0	4	13	--
10	10	Orikum	2,807	11	3	--
11	11	Bashkia Tiranë	90,357	29	20	--
12	12	Bashkia Divjakë	1,648	23	12	--
13	13	Bashkia Selenicë	32,018	11	9	--
14	14	Bashkia Kukës	21,045	31	24	3
15	15	Bashkia Kavajë	32,821	28	57	12
16	16	Bashkia Patos	8,069	22	28	4
17	17	Bashkia Pukë	303	22	16	--
18	18	Bashkia Fushë Krujë	2,446	20	18	--
19	19	Bashkia Korçë	3,950	30	18	
20	20	Bashkia Gjirokastër	14,070	37	18	
21	21	Bash Berat (Koncesion)	0	9	5	
	II	KOMUNAT	866,134	442	257	23
22	1	Gradisht, Lushnjë	1,363	15	5	--
23	2	Fan, Mirditë	357	17	10	
24	3	Bradashesh, Elbasan	1,842	18	10	--
25	4	Çëravë, Pogradec	5,282	20	5	--
26	5	Dajt, Tiranë	941	15	17	--
27	6	Vllahinë, Vlorë	9,664	14	17	--
28	7	Pustec, Korçë	1,241	19	4	--
29	8	Armen, Vlorë	37,788	6	8	1



**Kontrolli i Lartë i Shtet t**

Nr. Prog.	Nr.	Emërtimi i subjekteve	Dëmi Rekomandime, në 000 mijë Lekë	Masa Organizative	Masa Disiplinore dhe Administrative	Kallëzime penale
30	9	Perondi, Berat	7,437	21	4	7
31	10	Livadhja, Sarandë	1,350	14	6	--
32	11	Dropulli sipërm	3,379	12	9	--
33	12	Xhafzotaj, Durrës	0	17	11	--
34	13	Kotë, Vlorë	9,978	25	8	--
35	14	Prezë, Tiranë	4,736	9	13	--
36	15	Novoselë, Vlorë	18,684	24	12	3
37	16	Xarrë, Sarandë	2,743	22	8	--
38	17	Shëngjin, Lezhë	25,060	27	23	
39	18	Otlak, Berat	4,162	6	14	
40	19	Grykë-Çajë, Kukës	130	14	6	3
41	20	Shkodër	243,360	43	6	10
42	21	Portëz, Fier	0	6	4	
43	22	Mbrostar, Fier	5430	12	2	
44	23	Bushat, Shkodër	35,278	25	11	
45	24	Petrelë, Tiranë	6,005	15	18	
46	25	Balldre, Lezhë	430,121	12	9	1 proc
47	26	Gostimë, Elbasan	9,803	14	17	
	III	ZVRPP	242,600	292	70	14
48	1	ZVRPP Sarandë	6,421	43	3	3
49	2	ZVRPP Pogradec	303	39	8	5
50	3	ZVRPP Krujë	0	17	2	--
51	4	ZVRPP Fier	152	78	11	6
52	5	ZVRPP Shkodër	5,868	63	16	
53	6	ZVRPP Tiranë	229,856	52	30	
	IV	ALUIZNI	211,013	49	32	6
54	1	ALUIZNI Korçë	1,969	7	3	3
55	2	ALUIZNI Fier	33,284	11	5	3
56	3	ALUIZNI Gjirokastër	11,315	19	7	7 proc
57	4	ALUIZNI Durrës	164,445	12	17	
58	V	PREFEKT SHKODËR	69	24	5	
	VI	KËSHILLA QARKU	0			

Nr. Prog.	Nr.	Emërtimi i subjekteve	Dëmi Rekomandime, në 000 mijë lekë	Masa Organizative	Masa Disiplinore dhe Administrative	Kallëzime penale
	VII	INSTITUCIONE TË TJERA				
59	1	Ujësjiellësi Berat-Kuçovë	8,718	11	25	--
60	2	Shkolla e Mesme e Përgjithshme "Petro Sota", Fier	113	14	2	
61	3	Zbatimi i rekomandimeve viti 2014				
		TOTALI	1,754,000	1303	851	79
		ZVRPP Elbasan (viti 2014)				4
		Bashkia Rrëshen (viti 2014)				4

IV. Shkeljet të disiplinës financiare sipas natyrës, për periudhën e vitit 2015, paraqitet sipas strukturës:

*në 000/lekë*

Nr.	Natyra e shkeljeve	Gjetjet	
		Vjetori 2014	Vjetori 2015
1	Në tatime e taksa	172,626	284,301
2	Nga shitja e dhënia me qira	33,900	621,711
3	Në sistemin e pagave, shpërblime e sig shoqërore	24,470	35,284
4	Në shpenzimet operative	18,971	18,187
5	Në urbanistikë	38,432	63,322
6	Në prokurimet	379,024	297,087
7	Të tjera dhe në fushën e legalizimeve	731,984	434,112
	Gjithsej	1.399,407	1,754,004

Siç u treguam më sipër, Departamenti jonë dhe këtë vit i ka tejkaluar objektivat e vëna për vitin 2015 dhe tregon për një punë të cilësishme dhe të qëndrueshme nga viti në vit, megjithë vështirësitë që kemi patur në punë tonë të përditshme, konkretisht në subjekte, ku për hir të vërtetës jo të gjitha auditimet janë mirëpritur nga subjektet si Bashkia Patos, Bashkia Memaliaj, Bashkia Kukës, Kavajë, etj.

## E. AUDITIMI NË SISTEMET INFORMATIKE

### 11. PËRDORIMI I QASJES SË VIZUALIZIMIT TË TË DHËNAVE NË AUDITIMET IT

*Referues: Kozma KONDAKÇIU – Drejtor Drejtorie,*

*Marenglen SINANI – Audituesi i parë.*



Vizualizimi i informacionit apo paraqitja interaktive e të dhënave nëpërmjet kombinimit të artit, shkencës dhe statistikës për të përforcuar njohjen njerëzore është një term i përgjithshëm që përshkruan çdo përpjekje për të ndihmuar njerëzit të kuptojnë rëndësinë e të dhënave duke e vendosur atë në një kontekst vizual.

Të dhënat përfshijnë informacione numerike, jo numerike si dhe çdo informacion tjetër. Kjo teknikë na lejon nëpërmjet qasjeve intuitive të zbulojmë

dukuri mes informacioneve të mëdha, të pa strukturuara dhe shpesh abstrakte.

Analiza e të dhënave është një pjesë e domosdoshme e të gjitha hulumtimit në vizualizimin e informacionit.

Fillesat e kësaj fushe të “re” na humbasin në lashtësi.

*“E vetmja gjë e re në botë është historia që nuk e dini” - Harry S Truman.*


Gjurmët e para të dokumentuara të vizualizimit i përkasin periudhës së paleolitit (nga greqishtja palaios - i vjetër, lithos-gur) në fund të "Epokës së Akullnajave" në formën e vizatimeve në rërë ose gërvishtje në shkëmb.



Në luftën për të përballuar vështirësitë klimatike njeriu i lashtë u strehua në shpella, u vesh me lëkurët e kafshëve dhe mësoi të nderzë zjarrin. Gjuetia e kafshëve të mëdha, e kryer me vegla primitive, kushtëzonte nevojën e gjuetisë kolektive.

Në këto kushte në shpellën Lascaux, në jug të Francës<sup>4</sup>, rreth 17300 vjet më parë njeriu i paleolitit vizatoi (vizualizoi) kafshë, njerëz, si një udhërrëfyes për gjuetinë dhe lidhjen me botën shpirtërore.

Shekulli i II solli një hop konceptual në organizimin e të dhënave në kolona dhe rreshta. Në shekullin XVII, filozofi dhe matematikani francez René Dekart<sup>5</sup> zhvilloi një sistem koordinativ, i cili shpreh figurat gjeometrike me ndihmën e ekuacioneve algjebrike. Në fund të shekullit të 18, skocezi William Playfair<sup>6</sup>, inxhinier, politikan dhe ekonomist, pa në punimet e Dekartit potencialin për pasqyrimin grafik të të



dhënave sasiore. Duke shpikur disa lloje grafikësh e vizualizimesh ai u bë themeluesi i metodave grafike e statistikore.

Në shekullin 19, Londra u përfshi nga kolera. Besohej se sëmundja shkaktohej nga era e keqe e mjergullës "miasmas". Dr. John Snow<sup>7</sup> dyshoi se uji i pijshëm i ndotur ishte shkaku dhe për të vërtetuar teorinë e tij ai shënoni në hartën Londrës çdo rast të kolerës me një pikë të zezë dhe çdo pompë uji publik me një

"X". Duke analizuar shpërndarjen e pika të zeza në lidhje me pompat e ujit, gjeti origjinën e shpërthimit kolerës. Harta e tij nuk është vetëm një moment i rëndësishëm historik në shëndetin publik, por edhe një zbulim i madh në shfaqjen vizuale të informacionit, ku statistika abstrakte mjekësore u koordinua me një imazh gjeografik.

Në gjysmën e dytë të shekullit 20, Jacques Bertin<sup>8</sup> përdori grafikët sasiore për të përfaqësuar informacionin intuitiv, në mënyrë të qartë, të saktë, dhe me efikasitet.

<sup>4</sup> <https://en.wikipedia.org/wiki/Lascaux>

<sup>5</sup> <http://www.britannica.com/biography/Rene-Descartes>

<sup>6</sup> William Playfair and the Psychology of Graphs Ian Spence University of Toronto

<sup>7</sup> [https://en.wikipedia.org/wiki/John\\_Snow\\_\(physician\)](https://en.wikipedia.org/wiki/John_Snow_(physician))

<sup>8</sup> [https://en.wikipedia.org/wiki/Jacques\\_Bertin](https://en.wikipedia.org/wiki/Jacques_Bertin)

John Tukey<sup>9</sup> dhe Edward Tufte<sup>10</sup> shtynë kufijtë e vizualizimit të dhënave. Tukey me qasjen e tij të re statistikore eksploruese, në analizën e të dhënave dhe Tufte me librin e tij "Paraqitja vizuale e informacionit sasior".

Me përparimin e teknologjisë realizimi me dorë i vizualizimit, i lë vendit atij interaktiv, të realizuar me programe kompjuterike, si SAS<sup>11</sup>, Minitab<sup>12</sup>, Gephi<sup>13</sup>, Tableau<sup>14</sup>, IDEA<sup>15</sup> dhe gjuhëve të programimit D3<sup>16</sup> e Python<sup>17</sup>.

Teknikat për Analizimin Interaktiv të të dhënave kanë përfshirë çdo fushë të jetës dhe pa dyshim edhe atë të auditimit. KLSH në zbatim të rekomandimeve të Simpoziumit për Teknologjinë e Informacionit mbajtur në Mars 2014 me rastin e 300 vjetorit të themelimit të Gjykatës së Auditimit të Gjermanisë si dhe Kongresit të IX-të të EUROSAI të mbajtur në Qershor 2014, në Hagë, për zbatimin e Teknikave Inovative në Auditim nëpërmjet vizualizimit të tyre, po investon në zhvillimin e burimeve njerëzore dhe Mjeteve Analizuese dhe Vizualizuese.

Gjatë vitit 2015, për herë të parë u përdor në auditim analiza Interaktive e riskut nëpërmjet vizualizimit, për dhënien e një opinionit në nivel makro (dhe jo vetëm), në 4609 procedura të prokurimit të realizuara gjatë vitit 2014.

Nga prokurimi i 43,246 milion lekëve u sigurua një efektivitet prej 8.7% (ulje fondi), pra procesi në pamje të parë duket se ka arritur qëllimin e tij.



*Pamje e vizualizuar e prokurimeve publike të vitit 2014<sup>18</sup>*

---

<sup>9</sup> [https://en.wikipedia.org/wiki/John\\_Tukey](https://en.wikipedia.org/wiki/John_Tukey)

<sup>10</sup> <http://www.edwardtufte.com/tufte/>

<sup>11</sup> [https://www.sas.com/en\\_us/home.html](https://www.sas.com/en_us/home.html)

<sup>12</sup> <https://www.minitab.com/en-us/>

<sup>13</sup> <https://gephi.org/>

<sup>14</sup> <http://www.tableau.com/>

<sup>15</sup> <http://www.casewareanalytics.com/>

<sup>16</sup> <https://d3js.org/>

<sup>17</sup> <https://www.python.org/>


Pas vizualizimit të këtij procesi, për Autoritetet Kontraktore, për vlerat më të mëdha të prokurimeve, si Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mbrojtjes, u konstatuan zona me risk të lartë për marrëveshje, mungesë transparence, mosefektivitet të përdorimit të fondeve, fakte këto që vërtetohet edhe nga gjetjet e auditimeve tona në këto autoritete kontraktore.

Në autoritetin kontraktor Ministria e Shëndetësisë vizualizimi vë në dukje se vetëm katër firma kanë fituar 44% të procedurave të prokurimit, apo 22% të fondit të shpenzuar.



Vizualizim i prokurimeve publike të zhvilluara nga autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë<sup>19</sup>

Në autoritetin kontraktor Ministria e Brendshme vizualizimi vuri në pah se 72% e procedurave të prokurimit janë në zona me risk, gjë që tregon për dobësi në procedurat e planifikimit, llogaritjes së fondit limit dhe transparencës së procesit.




Përcaktimi i riskut në prokurimet publike të zhvilluara nga autoriteti kontraktor Ministria e Brendshme<sup>2</sup>

<sup>18</sup> burimi i të dhënave APP

<sup>19</sup> Burimi i informacionit APP

Në Autoritetin kontraktor Ministria e Mbrojtjes, vizualizimi identifikoi se vetëm 3 operatorë ekonomik, të zonës me vlera më të mëdha të fondit limit dhe me efektivitet pranë 0%, zënë 28.5% të fondit total të prokuruar nga ky autoritet kontraktor.



Vizualizimi i prokurimeve publike në Autoritetin kontraktor Ministria e Mbrojtjes<sup>20</sup>

Analiza e zhvilluar për identifikimin e zonave me risk të lartë tregon se procedurat e prokurimit publik dhe sistemi i prokurimit elektronik si mjet për realizimin e tij, shprehin dobësi dhe zhvillohet nën presionin e interesave për përfitime.

Përdorimi i teknikave vizualisuese, në auditim, është sot një realitet i diktuar jo vetëm nga sasia e madhe e informacionit, që po rrethon gjithmonë e më shumë ambientin e auditimit, por edhe për vlerat e shtuara që ai i ofron atij.

Është e vështirë të parashikohet saktësisht se si vizualizimi i të dhënave do të ndryshojë Auditimin, por një gjë është e sigurt, ai do të bëhet gjithmonë e më i rëndësishëm për sa kohë qasja jonë në të dhënat do të vazhdojë të rritet.

<sup>20</sup> Burimi APP

## F. ARRITJET NË AUDITIMET E PERFORMANCËS

## 12. IMPAKTET E AUDITIMIT TË PERFORMANCËS SI SHTYLLA MODERNIZIMI INSTITUCIONAL

*Referues: Rinaldo MUÇA – Drejtor Departamenti,  
Gjovalin PREÇI – Kryeauditues,  
Alfred ZYLFI – Kryeauditues.*

## I. PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT DHE TRENDI BASHKËKOHOR



*“Auditimi i Performancës është një shqyrtim i pavarur i eficiencës dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizmave të saj, me fokus të veçantë ekonomikitetin dhe me synim përmirësimin”. Ky është përkufizimi i përgjithshëm që jep INTOSAI në standardet e veta 3000-3100, të cilat adresojnë pikërisht këtë lloj auditi në nivel institucionesh supreme të auditimit. Auditimi i performancës mbështetet mbi vendimet e marra ose objektivat e përcaktuara nga ekzekutivi dhe mund të kryhet për të gjithë spektrin e sektorit publik.*

Ai dallon nga auditet stanaarde financiare dhe ato të ligjshmërisë, sepse është më fleksibël në përzgjedhjen e subjekteve, objekteve, metodave dhe dhënien e opinionëve. Nga vetë natyra e tij, ky lloj auditimi ndërthur metodat investigative me ato shkencore të kërkimit dhe përpunimit të informacionit, operon mbi baza të larmishme dijesh dhe eksperiencash, është më i hapur ndaj gjykimeve dhe interpretimeve dhe nuk kryhet sipas një protokollit standard paraprak. Është kusht vital për cilësinë e këtij lloji auditimi, që të aplikohen perspektiva të ndryshme e për rrjedhojë dhe audituesit duhet të vijnë nga sfera të ndryshme të aktivitetit njerëzor.

Auditimi i performancës është një nga mënyrat moderne përmes të cilit taksapaguesit, financierët, vendim-marrësit, ekzekutuesit, media dhe shoqëria në



përgjithësi “ushtrojnë kontroll” dhe penetrojnë në mënyrën se si kryhen punët dhe si arrihen rezultatet. Kriteret e këtij lloji auditimi janë të shumta dhe përmenden: vlera e shtuar, zinxhirët kompleksë të politikave, prania e risqeve, ndërhyrjet strukturore, obligimet ndërkombëtare, emergjenca sociale, materialiteti financiar, vizibiliteti i programit, mundësia për auditim, etj., etj.

Auditimi i performancës nuk ka si synim të kritikojë sipërmarrjet qeveritare. Duke evidentuar shkaqet, proceset, funksionet, kapitalin human dhe financiar të përfshirë në kryerjen e “biznesit” qeveritar, ky lloj auditimi synon korrektimet e duhura, aplikimin e teknikave më të fundit shkencore, përmirësimin e 3 E-ve dhe tek e fundit rritjen e mirëqenies sociale përmes aktivitetit ekonomik publik. Auditimi i performancës është në vetvete formë modernizimi për atë që auditohet dhe atë që auditon.

Por cilat janë shtyllat kryesore mbi të cilat mbështetet auditimi i performancës? Të gjitha programet dhe sipërmarrjet qeveritare (dhe pjesa më e madhe e proceseve që ato gjenerojnë) mundën, të paktën teorikisht, të analizohen nën lupën e një formule që përshkruan se si ato lëvizin nga një pozicion në tjetrin, duke shfrytëzuar burime të ndryshme, me qëllim arritjen e objektivave të caktuara. Në auditimin e performancës, formula që studion mbarëvajtjen e punëve mbështetet mbi dy pyetje-shtylla kryesore:

A po bëhen gjërat siç duhet?

A po bëhen gjërat që duhen?

Pyetja e parë fokuson kryesisht “prodhuesin” dhe adreson problemin nëse vendimet e marra po zbatohen siç duhet. Kjo pyetje zakonisht shoqërohet me një perspektivë normative, që do të thotë se audituesi kërkon të dijë nëse zbatuesi i procesit i është përmbajtur rregullave ose kërkesave. Me qëllim zgjerimin e analizës, pyetja mund të shtrihet edhe mbi faktin nëse aktivitetet e realizuara janë ato të duhurat – duke e marrë të mirëqenë që proceset e përzgjedhura janë të mira. Deri në këtë fazë të procesit, auditimi i performancës fokusohet kryesisht mbi ekonomikitetin dhe eficiensën e operacioneve (aspekti mikro).

Objekti i analizës zgjerohet së tepërmi me pyetjen e dytë – nëse po bëhen apo jo gjërat e duhura. Me fjalë të tjera, nëse janë aplikuar politikat e duhura siç duhet,

apo janë përdorur burimet adekuate. Kjo pyetje i referohet efektivitetit ose ndikimit në shoqëri. Në fakt, pyetja mund edhe të nënkuptojë se një sipërmarrje qeveritare – ose një masë e përzgjedhur për të arritur një objektiv specifik – po i ekspozohet riskut që të konstestohet nga audituesi. Një auditues performance, për shembull, mund të zbulojë një masë që është inefektive dhe jo në përputhje me objektivat. Por, në momentin që audituesi fillon të dyshojë nëse vetë përkushtimi publik është ose jo i arritshëm, ai/ajo duhet të tregojë kujdes për të mos tejkaluar kornizën e punës së vet duke shkelur kufirin dhe duke u futur në territor politik.

Funksioni i auditimit të performancës nga institucionet supreme të auditit nisi të aplikohet në fundin e viteve 60 nga GAO amerikane. Ky lloj auditi në Amerikë është shtrirë që prej atëherë në nivelet shtetërore dhe lokale të vendim-marrjes financiare. Shumë vende të tjera kanë sot një ekspertizë të pasur në auditet e performancës. Mund të përmenden NAO britanike, Bunderechnungshof-i gjerman e ai austriak, Algemene Rekenkamer-i holandez apo dhe Gjykata Sillovene e Auditimit. Në secilin e prej këtyre vendeve, auditimi i performancës së institucioneve publike siguron jo vetëm rritjen dhe përmirësimin ekonomik të vendit, por është një formë e shprehjes së zbatimit të ligjit, rritjes së transparencës, përfshirjes sociale në vendim-marrje, pra tek e fundit një formë e aplikimit të demokracisë.

Një qeverisje e mirë shprehet përmes një performance të mirë dhe vendet e zhvilluara perëndimore e kanë kthyer fokusin e tyre pikërisht tek auditet e performancës. Dekadat e fundit kanë qenë dëshmitare të ndryshimeve të thella ekonomike, sociale, politike, klimatike e demografike. Lëvizjet e popullsisë, ndryshimi i moshës mesatare të saj, rritja e kufizimeve në energji, burime ekonomike e monetare, kërkesat për rritje të vazhdueshme të mirëqënies, etj., të gjitha këto kanë rritur ndërgjegjësimin e publikut për aktivitetin ekonomik qeveritar. Të amplifikuara edhe nga kriza e viteve të fundit, performanca është bërë sot një çështje e të gjithëve, qofshin këta punonjës të sektorit privat apo atij publik. Pikërisht për këto arsye, në secilin prej vendeve të sipër-përmendura, këto lloj auditesh zënë rreth 30-40% të punës audituese. Me përdorimin e mjeteve moderne të komunikimit të informacionit, ndikimi që raportet e institucioneve supreme të auditit kanë mbi performancën ekonomike qeveritare është sot më i madh se ndonjëherë. Vetëm në Slloveni, Gjykata e Llogarive citohet nga mediat 8-10 herë në muaj për gjetjet e saj, duke qenë kështu një nga institucionet avangardë në ruajtjen e fondeve dhe transparencës publike. Në Holandë, raportet e auditëve të

performancës citohen dhe futen në referencat e doktorantëve, planeve strategjike të zhvillimit të institucioneve, manualët e operacioneve, etj. Në Britani, auditet e performancës nuk kufizohen vetëm në çështjet apo institucionet britanike, por e kanë kthyer vëmendjen mbi probleme në rang planetar e global, siç janë problemet e klimës dhe ato të energjisë. Gjithçka ka vetëm një emërues të përbashkët: rritjen e ndërgjegjësimit të strukturave vendimmarrëse, me synim përmirësimin e bërjes së gjërave, në mënyrë shkencore dhe bashkëkohore.



### AUDITIMI I PERFORMANCËS NË KLSH



Në vitet 2013, 2014 e 2015 auditimi i performancës është shndërruar në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Institucioni po përballlet çdo ditë me një sfidë të fortë për ta përqëndruar punën tek auditimi i performancës, pse ai i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike. Sfida më e madhe për këtë lloj auditimi është që ai mos të zbatohet thjesht si procedurë, por të konceptohet si një filozofi e të menduarit dhe vepruarit nga i gjithë stafi i KLSH-së. Një filozofi pune që konsideron se auditimi nuk është një qëllim në vetvete, por në rradhë të parë një instrument parandalimi, instrument korrigjimi dhe këshillimi për institucionin që auditohet.

Gjatë periudhës qershor 2014–dhjetor 2015, KLSH ka incijuar, realizuar dhe evaduar në total 14 auditime performance, 10 prej të cilave janë evaduar dhe 3 janë në proces nga Departamenti i Auditimit të Performancës, ndërsa 1 është evaduar nga Departamenti i të Ardhurave në Buxhetin e Shtetit. Fushat ku është përqëndruar puna e departamentit kanë qenë:

1. Reformat qeveritare;
2. Projektet & shërbimet social-ekonomike;
3. Projektet infrastrukturore;
4. Projektet mjedisore & energjitike;
5. Projektet & shërbimet social-kulturore.


Ecuria e auditimeve të performancës ka ardhur në rritje, si në terma të cilësisë, ashtu edhe të sasisë. Një paraqitje grafike e kësaj ecurie, në terma departamentale, jepet si vijon:





Metodologjia e përdorur:

- Mesazhet audituese;
- Teknikat e përdorura;
- Piramida e pyetjeve, sipas vlerësimit të riskut;
- Kriteret e auditimit, përfshirë edhe indikatorët e performancës;
- Ndarja e punëve dhe respektimi i afateve;
- Klasifikimi i gjetjeve, konkluzioneve e rekomandimeve sipas 3 "e"-ve;
- Impakti auditues;
- Zhvillimi i auditimit në formën e projektit.



## II. AUDITIMI I PERFORMANCËS – IDE DHE PRAKTIKË NË PËRMIRËSIM TË VAZHDUESHËM



Pak më shumë se katër vjet më parë, z. Bujar Leskaj, paraqiti pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, Projekt-idenë për zhvillimin e KLSH-së, në të cilën ka theksuar se një nga shtyllat e modernizmit të këtij institucioni do të jetë *“Përmirësimi i metodologjisë së kontrollit, duke kthyer vëmendjen tek auditimi i performancës, krahas rritjes së eficiencës së auditit financiar”*.

Më vonë kjo ide u materializua në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2013-2017, duke përcaktuar një nga objektivat kryesore *përmirësimin e cilësisë dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës, si dhe një nga sfidat më madhore të KLSH-së (Objektivi nr. 3).*

Pas përpjekjeve të vazhdueshme, me ndihmën dhe mbështetjen edhe të institucioneve ndërkombëtare u arrit që ky lloj auditimi të gjente përkufizimin e vet në veprimtarinë juridike të KLSH: *“Auditimi i performancës” ka të bëjë me auditimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit* (Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 3, pika 4).

Veç këtyre, zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i auditimeve të performancës ka kërkuar mbështetja metodologjike, e cila është siguruar me disa botime dhe hartimin e Manualit të Auditimit të Performancës. Përgatitjes së kësaj baze i parapriu *Udhëzuesi i Auditimit të Performancës ISSAI 3000 & 3100*, i konceptuar në formën e një udhëzuesi, ai përcakton krejt strukturën që udhëheq konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e auditimit të performancës. Përmbajtja e këtij manuali është guri i parë i themelit në ngrehinën e re të auditimit të performancës këtu në Kontrollin e Lartë të Shtetit

I një rëndësie të veçantë ishte *Manuali i Auditimit të Performancës*. Ky manual synon të japë udhëzime bashkëkohore për audituesit që kryejnë auditime performance në Kontrollin e Lartë të Shtetit, duke bërë një përshkrim të të gjitha

fazave që përshkon cikli i auditimit të performancës, nisur nga planifikimi strategjik e deri tek kompletimi i raportit auditues dhe procesi ndjekës. Në këtë mënyrë edhe vetë audituesit kanë mundësi të provojnë në praktikë cilësinë e auditimit, duke e krahasuar çdo fazë dhe hap veprimtarisë tyre me kërkesat e Manualit.

Përvoja SAI-eve të zhvilluara evropiane ka ndihmuar në botimin e *Indikatorëve të Performancës sipas NAO-s Britanike*. Indikatorët synojnë të jenë mjaftueshëm të plotë, pasi vlerësimi i performancës është sot një aspekt kyç i proceseve menaxheriale vendim-marrëse dhe ky vlerësim nuk mund të realizohet apo të raportohet e krahasohet, nëse më parë nuk specifikohet në terma cilësorë e sasiorë metrika parametrizuese e kësaj performance.

Arritjet në auditimet e performancës realizohen domosdoshmërisht edhe *me trajnimet dhe kultivimi i kapaciteteve të stafit*. Që Auditimi i Performancës të jetë një nga dy aktivitetet më të rëndësishme në gjithë veprimtarinë e KLSH-së kërkon fuqizim profesional të kapaciteteve audituese, e cila po arrihet nëpërmjet trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, auditimeve paralele, vizitave studimore në institucione homologe me përvojë, auditimeve të përbashkëta brenda KLSH-së, si dhe pjesëmarrjes dhe aktivizimit të ekspertëve të fushës.

Pa u ndalur në numrin e konsiderueshëm të trajnimeve për çdo auditues në Departament dhe më gjerë në KLSH, do të dëshiroja *të vija theksin në dobinë e auditimeve paralele, si një ndër tre kategoritë e gjera të bashkëpunimit*, së bashku me auditimet pilot dhe auditimet e përbashkëta. Në këtë kuadër, KLSH përfundoi me sukses auditimin paralel në vendet e Ballkanit Perëndimor mbi eficiencën e energjisë, duke u fokusuar në burimet alternative të energjisë në Shqipëri.

### REZULTATE TË AUDITIMEVE MË TË SPIKATURA

Në këtë analizë vjetore, po paraqes rezultatet e dy auditimeve më të spikatura. Kështu, në auditimin e performancës *“Burimet alternative të energjisë në Shqipëri”* u arrit në konkluzionin përfundimtar se: Megjithëse institucionet publike përgjegjëse kanë kryer jo plotësisht përafrimin e legjislacionit sipas kërkesave të BE-së dhe kanë hartuar Draft-Planin Kombëtar të Veprimit të Burimeve të Rinovueshme dhe Eficiencës së Energjisë, ato nuk kanë arritur të përmirësojnë qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike, pasi: Strategjia Kombëtare e Energjisë nuk është monitoruar dhe zbatuar sipas skenarëve përkatës; Plani

Kombëtar i Veprimit prej më se tre vitesh nuk është miratuar akoma; ligji për burimet e rinovueshme vazhdon të jetë në proces përditësimi edhe pas më shumë se dy vitesh ende pa aktet e tjera nënligjore; si dhe kanë munguar iniciativat publike në këtë fushë për shkak të performancës së dobët të MEI-t dhe AKBN-së nga mungesa e financimeve buxhetore dhe ndarjes e dublikimit të kompetencave administrative brenda dhe midis tyre.

Departamenti i Performancës krijoi përvojën e parë audituese mbi cilësinë e ofrimit të shërbimit nga institucionet publike me auditimin "*Performanca e IQT në garantimin e cilësisë së tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj në Shqipëri*", një problem sa social, po aq edhe ekonomik, financiar, mjedisor, etj. Në përfundim u arrit në këtë mesazh auditimi: Mbrojtja e konsumatorit shqiptar në drejtim të furnizimit me naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre me cilësi brenda standardeve nga ana e ISHTI është e mangët, për shkak të:

- kuadrit rregullator të pa bashkërenduar dhe harmonizuar mirë për funksionimin e këtij institucioni;
- të burimeve njerëzore të pa trajnuara, të pa testuara, të pakualifikuara dhe të keqmenaxhuara;
- zbatimit me mangësi të procedurave të inspektimit;
- mungesës së materialeve e modernizimit të pajisjeve laboratorike dhe kryerjes së një numri të kufizuar të treguesve të analizave;
- problemeve në investime dhe menaxhimin financiar;
- si dhe për shkak të reduktimit të subjekteve të ndëshkuara dhe mos vjeljes së gjobave.

Duhet të vëmë në dukje se trajtimet e auditimeve të performancës janë shoqëruar me shkrime të audituesve në gazetë e përditshme, si dhe në mjaft raste kanë qenë objekt referimi i temave të ndryshme sociale dhe ekonomike në median vizive, me iniciativën e këtyre të fundit.



### 13. FORCIMI I LIGJIT PËRMES ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË KLSH-së

#### I. ZBATIMI I PROJEKTIT TË QENDRËS PËR TRANSPARENÇË DHE INFORMIM TË LIRË ME MBËSHTETJEN E USAID NË KUADËR TË ASSISTIMACT

*Referues: Erald KAPRI – Koordinator i QTIL.*



Qëllimi i projektit është rritja e përgjegjshëmrisë së institucioneve publike për zbatimin e ligjit, forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe rritja e transparencës përmes zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

Objektivat:

- Rritja dhe promovimi i efektivitetit të kapaciteteve kontrolluese dhe monitoruese të KLSH-së; Identifikimi i hapësirave që cojnë në shmangien e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së;
- Nxitja e institucioneve të administratës publike për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së;
- Promovimi dhe nxitja e bashkëpunimit mes institucioneve të kontrollit dhe atyre të zbatimit të

ligjit në luftën kundër korrupsionit; rritja e kapaciteteve monitoruese të shoqërisë civile.

Janë monitoruar 23 institucione publike, afërsisht 15% e institucioneve të cilat janë audituar nga KLSH për të ardhurat dhe shpenzimet përgjatë vitit 2014:

- Përzgjedhja e institucioneve është bazuar në përmbledhësen e raporteve të KLSH për vitin 2014 bazuar tek numri i masave dhe rekomandimeve të propozuara dhe shkeljeve të gjetura.
- Janë përzgjedhur institucionet me lëvizjen më të madhe të parave; institucione me kallëzime penale ndaj zyrtarëve të ndryshëm.

Komunikimi me KLSH, transparenca:

QTIL ka pasur mbështetjen e plotë të KLSH në zbatimin e projektit. Që në fillim të tij mes KLSH dhe QTIL u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi, bazuar në nenin

8-Bashkëpunimi, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Memorandumin i bashkëpunimit nr. prot. 496, datë 12.05.2015, ndërmjet Kontrollit të Lartë Shtetit dhe Qendrës për Transparencë dhe Informim të Lirë, për realizimin e projektit “Forcimi i zbatimit të ligjit nëpërmjet zbatimit të rekomandimeve të KLSH”, u frymëzua ndërkaq nga moto e KLSH-së “Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve”.

Pjesë e punës është edhe udhëzimi i kryetarit të KLSH-së, z. Leskaj, nr. 3, datë 3.11.2015, “Për ndjekjen e zbatimit rekomandimeve”, që vlen për unifikimin e raportimit të zbatimit rekomandimeve, udhëzim i cili merret si referencë edhe nga Drejtoritë e ndryshme të Auditimit.

Në vijim kryetari i KLSH-së urdhëroi ngritjen e një grupi pune të përbërë nga 7 veta, auditues, juristë, mes të cilëve tre drejtorë, të cilët iu gjendën stafit të QTIL për të gjitha problemet që lidheshin me sigurimin dokumentacionit, shpjegimin proceduave dhe komentimin e rekomandimeve më natyra të ndryshme nga ana e KLSH.

Dëmi ekonomik i gjetur në institucionet e monitoruara:

QTIL ka përzgjedhur për të monitoruar 23 institucione të cilat sipas raporteve të KLSH i kanë shkaktuar një dëm ekonomik buxhetit të shtetit në shumën 8,379,465 mijë lekë nga 11,198,404 mijë lekë. Ndryshe QTIL ka monitoruar insitucionet që kanë shkaktuar 75% të totalit.

QTIL ka monitoruar gjithsej:

833 rekomandime, që mund të jenë ligjore, organizative, disiplinore, administrative dhe shkaktim dëmi.

Nga këto rekomandime ka gjetur se:

- 321 rekomandime ose afërsisht 39% janë realizuar;
- 355 rekomandime ose afërsisht 43% janë në proces realizimi;
- 79 ose 10% nuk janë realizuar, nga këto të fundit kemi dy mospranime, 5 observacione dhe 3 kundërshtime të masës.

Për 47 rekomandime ose 5.6% e tyre QTIL nuk ka përgjigje të saktë për shkak të mungesës së dokumentacionit ose përgjigjeve nga institucionet e monitoruara.

### Monitorimi i padive penale

QTIK ka monitoruar situatën e padive penale të kryera nga KLSH në prokuritë e rretheve Tiranë, Elbasan, Fier, Korçë. Gjithsej janë 47 padi penale nga të cilat: 31 në Tiranë, 10 në Elbasan, 1 në Korçë, 5 në Fier.

Nga verifikimet e kryera në prokuritë përkatëse, nëpërmjet një task force të Prokurorisë së Përgjithshme rezulton:

- vetëm një çështje ose 2% e tyre ka shkuar në proces gjyqësor, por edhe ajo për arsye procedure;
- në hetim janë 24 raste ose 51% e tyre, përfshirë dhe 5 raste të AlbPetrol, që janë dërguar për kompetencë në Gjykatën e Krimeve të rënda;
- Është pushuar hetimi për 22 raste ose 47% e tyre.

### Gjetjet:

Rekomandimet e KLSH-s shihen, në pjesën më të madhe të institucioneve, si të rëndësishme dhe që ndihmojnë transparencën dhe luftojnë korrupsionin.

Zyrtarë të institucioneve të monitoruara nuk shprehen rreth faktit nëse rekomandimet duhet të jenë të detyrueshme apo jo.

Rekomandimet e KLSH-s kanë gjetur zbatim ose zbatim të pjesshëm, në pjesën më të madhe të rasteve.

Rekomandimet e KLSH janë ndjekur nga një plan pune për zbatimin e tyre, urdhër i brendshëm ose grafik veprimesh, në të gjitha institucionet.

Mjaft prej institucioneve pretendojnë se kanë zbatuar rekomandimet, në diferencë nga vlerësimi i KLSH-së.

- Tek vlerësimi i rekomandimeve si zbatim i "pjesshëm", vërehet se shpesh janë në kundërshtim të plotë me rekomandimet e KLSH. *(Konkretisht, masat për largim nga puna zbatohen vetëm me vërejtje. Po kështu edhe në shpërblimet e dëmeve në rastet kur dëmi nuk është marrë i plotë).*
- Në lidhje me masat për shpërblim dëmi, institucionet ankohen për vështirësinë në mbledhjen e këtij shpërblimi në kohë *(përfshihen proceset gjyqësore, proceset e ankimit dhe nevojitet feedback nga disa institucione).*

- Shumë prej rekomandimeve kryesore dhe të rëndësishme shpesh lihen të fundit për t'u zbatuar. (*Siç është rasti me drejtorinë e Doganës për çështjen e mungesës së dokumentacionit në praktika doganore*).

Institucionet ngarkojnë një person nga sektori juridik, që merret me KLSH-në dhe rekomandimet e saj, përveç grupeve të punës

Rekomandimet shihen si detyrim në disa raste dhe në të tjera nuk shihen si detyrime. Por ka raste kur zyrtarët nuk janë të qartë rreth faktit se janë apo jo të detyrueshme.

Shpesh nuk kuptohen problematikat specifike në institucione të ndryshme. (*"Konkretisht ne na është kërkuar që supervizori dhe projektuesi duhet të jenë të ndarë. Por në punën tonë me donator të huaj kjo shpesh mbetet e pamundur"- FSHZH*).

Zbatimi i plotë i rekomandimeve shpesh varet gjithnjë nga politika dhe vullneti i titullarit.

Ndodh që rekomandimet janë të paplota dhe standarde. (*"Konkretisht, në rekomandimin për prokurimet dhanë sygjerime për të mos blerë një lloj pajisje filtrimi. Në fakt, tenderi është specifik dhe jo standard, siç e kërkon KLSH"-AKM*)

Grupet e auditimit në ndonjë rast nuk kanë ekspertë të fushës.

Ka probleme me kontrollet në institucionet që kanë një komunikim të madh me kompanitë private (AKBN) Na bazë të ligjit, kompanitë nuk kanë detyrim ndaj KLSH. Psh ato nuk mund të japin të dhëna financiare sepse janë konfidenciale. Por kjo lloj praktike mund të çojë deri në arbitrazh me kompanitë, sepse ato mund të ankohen për mënyrën se si i trajton shteti shqiptar.

Ka paqartësi në rekomandimet "shpërblim dëmi", kur dëmi krijohet nga t.v.sh. e papaguar për shkak se kjo t.v.sh. kompensohet më vonë.

Rekomandimet e KLSH-s gjejnë rezistencë në institucione të pavaruar apo kompani me aksione shtetërore.

Në rastin e masave disiplinore, KLSH ndodh që rekomandon përcaktimin e këtyre masave nga shërbimi civil dhe në raste të tjera bën vetë propozimet.

Në raportin e KLSH ka raste kur konstatohet dëme të mëdha ekonomike, të cilat nuk janë ndjekur nga propozime të ashpra (*dogana e Tiranës*).

Disa prej rekomandimeve të vitit 2013 vijuan të ishin në fuqi për institucionet gjatë vitit 2014 pasi ende nuk i kanë përmbushur.

### REKOMANDIMET

Për KLSH:

Institucionet duhet të njihen paraprakisht përmes vendimit të KLSH me statusin e rekomandimit pavarësisht se kjo është e përcaktuar edhe në ligj.

Rekomandimet me problematika duhet të evidentohen si të tilla dhe të jenë fleksibël në afatet që jepen për zbatimin e tyre. Po ashtu edhe vetë KLSH duhet të jetë fleksibël edhe në vlerësim.

KLSH duhet të përfshijë në grupin e audituesve edhe ekspertë për çështje specifike kur del e nevojshme gjatë auditimit ose që në fillim të auditimit.

Disa mosmarrëveshje për rekomandime të caktuara mund të diskutohen në institucionet e audituara përgjatë auditimit ose në përfundim të tij dhe të përfshihen tek rekomandimet varësisht nga rezultati i diskutimit të tyre.

Raporti përfundimtar i KLSH të bëjë përpjekje të shmangë rekomandime që janë evazive, ose të shmangë gjuhën evazive në rekomandime.

Do të ishte e këshillueshme që KLSH t'i përmbahet një grile të përbashkët raporti në të gjitha kontrollet.

KLSH kundërshtohet në disa raste për shkak të referencave ligjore të ndryshme. KLSH duhet të krijojë mundësinë e tryezave që të koordinojnë masat për zbatimin e rekomandimeve me institucionet e monitoruara kur shikohet e arsyeshme qoftë edhe nga njera pale.

KLSH shpenzon në disa raste shumë kohë për të evidentuar shkaktim dëmi në shuma të vogla që shkojnë nga 100 dollarë deri në 800 dollarë.

KLSH ka vijuar të bëjë kontrolle tematike dhe ne inkurajojmë që të bëjë të tilla në vazhdimësi dhe për të gjitha institucionet.

Për kompani apo institucione me ndikim të madh në ekonominë e Shqipërisë kontrollet mund të bëhen më të shpeshta.

KLSH ka rekomanduar ngritjen e një komisioni të posaçëm parlamentar, për analizimin e veprimtarisë dhe situatës së krijuar ndër vite në shoqërinë "AlbPetrol" sh.a. Patos, në veçanti për punësimet, largimet nga puna, mosrespektimin e ligjit dhe kontratave të punës, etj., si dhe zgjidhjen e problemeve të akumuluar përsa i përket keqmenaxhimit dhe ristrukturimit të kësaj shoqërie në raport me punonjësit e AlbPetrolit ndër vite të përfaqësuar nga Sindikata e Punonjësve. QTIL e përshëndet këtë qëndrim të KLSH.

Po ashtu QTIL inkurajon zbatimin e rekomandimit të KLSH që në rastin e privatizimit të AlbPetrol apo edhe në struktura të ngjashme në sektorin e hidrokarbureve, të mbahet përparësi e lartë për kompani me kredenciale të larta profesionale nga aleatët strategjikë të vendit tonë, si nga SHBA, Mbretëria e Bashkuar apo Gjermania.

Për institucionet:

Nevojitet mbajtja e një regjistri kombëtar për masat disiplinore dhe administrative për punonjësit shtetërorë me kontratë. *(Për punonjësit e administratës civile ka një regjistër në DAP).*

Ka raste kur institucionet konsiderojnë se nuk kanë kompetencë për të trajtuar rekomandimin e KLSH-së. Në këtë rast duhet evidentuar mënyra se si rekomandimi mund të trajtohet dhe nga kush, ose KLSH duhet të rishikojë rekomandimin në mënyrë që të gjejë një formë dhe rrugë të përshtatshme për të shkuar tek zbatimi i tij.

Disa institucione nuk lëshojnë plan veprimi por urdhër. Shpeshherë urdhëri lë për të dëshiruar.

Organizimi i brendshëm i ndërmarrjeve është i ndërtuar në disa shkallë ku në qendër përdoren metoda moderne të menaxhimit ndërsa në zyrat lokale ende vijohet me standardet e vjetra të menaxhimit sidomos atij financiar. KLSH e ka konstatuar këtë problem dhe lind nevoja për një skenar të përbashkët në mënyrë që jo vetëm administrata e një institucioni por edhe të gjithë institucionet të kenë të njëjtin standard të menaxhimit financiar.

KLSH ka gjetur se rekomandime apo masa të dhëna nga audituesit e brendshëm të institucionit, nuk janë ndjekur në zbatimin e tyre. Zyrat e auditimit në institucione janë jofunksionale, për shkak se nuk kanë në përbërje të tyre profesionistë dhe për shkak se ndryshon shpesh drejtuesi i zyrës së auditit ose persona që kryejnë këtë detyrë.

II. AUDITIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË KLSH-së

*Referues: Niko NAKO – Kryeauditues.*

*Nikoleta PIRANJANI – Audituese e lartë.*



Auditimi i zbatimit të rekomandimeve është një nga detyrimet ligjore të raportimit të KLSH dhe pjesë e raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në nenin 31, pika 3 të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve Ligji i Ri i KLSH, nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, referuar standardeve

ndërkombëtare të auditimit mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të rezultuara nga procesi i auditimit, ka sanksionuar në një nen të veçantë, detyrimin ligjor që subjektet e audituara duhet të informojnë KLSH brenda 20 ditëve nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit, për pranimin e rekomandimeve dhe hartimin e programeve (Planveprimeve) për realizimin e rekomandimeve, dhe gjithashtu brenda 6 muajve të raportojnë në KLSH ecurinë e tyre.

Sanksionimi me nene të veçanta në ligjin e ri të detyrimeve të subjekteve për zbatimin dhe raportimin e realizimit të rekomandimeve është një risi pozitive në mbështetje të rolit auditues të KLSH, ku nga njëra anë mbrohen të drejtat e subjekteve në lidhje me paraqitjen e shpjegimeve dhe komenteve referuar rekomandimeve të propozuara, por të kontestuara nga ana e tyre dhe nga ana tjetër, detyrimin e tyre në njohje të funksioneve kushtetuese të KLSH dhe bashkëpunimin institucional me KLSH-n, në drejtim të realizimit dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve.

Në zbatim të Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, referuar neneve mbi detyrimet e institucioneve për zbatimin e rekomandimeve, një punë korrekte është bërë në drejtim të përgatitjes së Rregullores së Brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH dhe një sërë manualesh, me specifikat e llojeve të auditimit. Një ndihmë e veçantë u është dhënë audituesve me Udhëzimin e miratuar nga Kryetari KLSH, z. Bujar Leskaj, nr. 3, datë 03.11.2015 “Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ku janë përshkruar dhe unifikuar të gjithë procedurat e auditimit të zbatimit të rekomandimeve.

Udhëzimi i miratuar paraqet në mënyrë të unifikuar procesin e auditimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit në subjektet e audituara, në reflektim të kërkesave ligjore dhe të detajuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së, si dhe është pasqyrim i përvojës më të mirë të veprimtarisë audituese të Institucionit. Ky udhëzim ka synuar, që nëpërmjet praktikave më të mira të sjellë një mënyrë auditimi, që reflekton aspektet e ballafaqimit të rekomandimeve të paraqitura në subjektet e audituara, përmes argumentimit të nevojës për veprime vetëkorrigjuese e vetërregulluese, si një domosdoshmëri për të rritur përgjegjshmërinë në mirëmenaxhimin e funksioneve dhe fondeve të institucioneve publike.

Gjithashtu ky udhëzim shërben dhe si udhërrëfyes për audituesit e KLSH-së, në drejtim të rritjes së profesionalizmit, argumentimit ligjor dhe objektiv të rekomandimeve për zbatim, lënë Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës së funksioneve të tyre me kosto minimale, në zbatim të tre “e”-ve, efektivitet, eficiencë, ekonomikitet, si dhe procedimin dhe dëmshpërblimin e dëmeve reale nga punonjësit përgjegjës.

Nën kujdesin e Kryetarit të KLSH-së, një nga parimet e punës së ndërtuar ka qenë që në fillimet, filozofia e hapjes dhe e transparencës me publikun, marrëdhënia e bashkëpunimi me institucionet homologe dhe institucione të tjera të vendit, ku aktualisht janë nënshkruar Memorandume bashkëpunimi, si me: Ministrinë e Financave; Inspektoratin e Deklarimit dhe Kontrollin e Pasurive; Shoqërinë Civile; Institutin e Eksperteve Kontabël; etj. Këto bashkëpunime morën jetë dhe u mbështetën edhe me kuadrin ligjor, ku KLSH në mbështetje të nenit 8-të, “Bashkëpunimi”, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ka hartuar dhe



Memorandumin e bashkëpunimit nr. 496, datë 12.05.2015, ndërmjet Kontrollit të Lartë Shtetit dhe Qendrës për Transparencë dhe Informim të Lirë, për realizimin e projektit *“Forcimi i zbatimit të ligjit nëpërmjet zbatimit të rekomandimeve të KLSH”*, nën moton *“Eksperiencia e përbashkët u shërben të gjithëve”* e iniciuar dhe vëzhguar nga USAID.

Në zbatim të kësaj transparence për 23 subjektet e përzgjedhura ose mbi 15% të numrit të përgjithshëm të auditimeve të kryera për vitin 2014, KLSH ka vënë në dispozicion të kësaj Qendre të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, si të dhëna për vitin 2014, në lidhje me vendimet e kryetarit të KLSH, shkresat përcjellëse të Raporteve Përfundimtarë të Auditimit dhe përgjigjet e subjektit të audituar apo subjekte, të cilave i kemi rekomanduar marrje masash të ndryshme, si: Agjencisë së Prokurimit Publik; Ministrisë Publike dhe Transporteve, për heqjen e licencës mbikëqyrësve apo kolaudatorëve të punimeve, etj.; të dhënat e Kallëzimeve penale për vitin 2014, për 41 raste për 149 persona dhe të dhënat për vitin 2014, që disponon dhe ka publikuar KLSH, në lidhje me rekomandimet për Masa shpërblim dëmi, Masa Disiplinore, Administrative, si dhe Masat Organizative. Për të gjitha këto informacione risi e punës së 4 viteve të fundit, ka qenë bërja publike e vendimmarrjes së Kryetarit të KLSH në faqen web për çdo auditim të përfunduar duke thyer tabunë e mungesës së informimit. Materiali i përgatitur nga Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë, ka evidentuar punën e bërë nga KLSH pas vitit 2012 në drejtim të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, duke filluar së pari me rekomandimet e masave sa më objektive dhe në shërbim të përmirësimit punës dhe strukture të subjekteve të audituara, rekomandime të mbështetura në dispozita ligjore. Në këtë material krahas vlerësimit të punës të KLSH, nga kjo Qendër janë rekomanduar marrja e masave për përmirësimin e metodës së punës audituese në zbatimin e rekomandimeve, duke e shoqëruar këtë material edhe me një anketë me pyetësorë konkrete, mbi punën e veprimtarinë e KLSH, përgjigjet e të cilave, janë bërë prezent gjithë Departamenteve të Auditimiti, dhe njëkohësisht strukturat përkatëse të KLSH janë duke hartuar plan veprimin përkatës, me fokus se çfarë të përmirësojmë dhe bëjmë më mirë, me qëllim rritjen e masës së realizimit të rekomandimeve, sidomos rekomandimet për shpërblim dëmi.

Për veprimtarinë audituese të vitit 2015, KLSH konform kompetencave ligjore ka lënë një sërë rekomandimesh të natyrës a- Përmirësimeve ligjore, b- Organizative,

c- Shpërblim dëmi, d- Masa Disiplinore dhe Administrative, si dhe f- Kallëzime penale. Këto rekomandime në shkallë institucioni paraqiten:

- a. Masa Organizative të rekomanduara janë 2,457 masa;
- b. Shpërblim dëmi është rekomanduar në total për shpërblim dëmi në vlerën 53,714,088 mijë lekë;
- c. Masa Disiplinore dhe Administrative janë rekomanduar 1,590 masa;
- d. Kallëzime penale 51, për 159 persona.

Rekomandimet e lëna nga secili departament referuar auditimeve të realizuara gjatë vitit 2015 paraqiten si më poshtë vijon:

### 1. Departamenti i Pushtetit Vendor:

#### *1. Mbi realizimin gjithsej të rekomandimeve*

Në përgjithësi detyrat e rekomanduara nga KLSH-ja, janë vlerësuar nga subjektet e audituara, duke hartuar (program) plan veprimet përkatëse duke kthyer përgjigjet për pranimin e rekomandimeve si dhe ecurinë e zbatimit të tyre, këtë e tregon dhe fakti i pranimit dhe realizimit, apo numrit të rekomandimeve në proces realizimi.

#### a. Mbi masat organizative:

Nga 856 masa me karakter organizativ të rekomanduara janë zbatuar apo janë në proces zbatimi 584 masa (zbatuar 256 në proces zbatimi 328) ose në masën 68%, 14 subjekte kanë realizuar në masën 100 dhe kanë mbetur pa u realizuar nga 29 subjekte 163 masa organizative. Për mos realizim të masave organizative, përmendim subjektet: ZVRPP Pogradec -20 masa organizative, Bashkia Kuçovë- 13 masa, Bashkia Pogradec -10 masa, etj.

Krahas masave për shpërblim dëmi ekonomik dhe masave të tjera si disiplinore dhe administrative, një rol pozitiv ka luajtur dhe rekomandimi i masave organizative, të cilat përveç eliminimit të mangësive kanë ndihmuar subjektet duke u njohur me legjislacionin në fuqi, përmirësuar dukshëm organizimin e punës dhe përmirësimin e gjendjes.

Në rekomandimet tona për masa organizative, jemi përmbajtur parimit që masat të mos jenë formale por si produkt i konstatimeve gjatë auditimit, me synimin për përmirësimin e punës të subjekteve të audituara. Megjithëse, ende në këtë drejtim na mbetet shumë për të bërë, duke rekomanduar masa sa më objektive dhe të mbështetura në bazë ligjore, si dhe duke i kushtuar rëndësi auditimit të riskut të

*menaxhimit*, e cila do të rrisë dukshëm edhe realizimin e tyre. Kjo ka ardhur dhe nga një komunikim paraprak që kryejmë me subjektin gjatë procesit të auditimit dhe dërgimit të rekomandimeve me Projektraportin, pra në këtë vit kemi thelluar bashkëpunimin direkt dhe indirekt (nëpërmjet informacionit në IT, etj.) si dhe në formë këshillimi me subjektet mbi rëndësinë dhe vlerën që ka zbatimi i rekomandimeve në përmirësimin e qeverisjes në njësitë publike (vendore apo të tjera). Është rritur arkëtimi i debitorëve nga taksat vendore, pasi nisur nga rekomandimet e KLSH, Ju janë dërguar bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë". Këtë e tregon edhe fakti që si rezultat i zbatimit të masave organizative për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, taksat vendore, etj., janë arkëtuar në buxhetet e Njësive të Qeverisjes Vendore, shuma të konsiderueshme të cilat kanë ëpërmirësuar dukshëm gjendjen financiare të tyre dhe një pjesë e tyre është përdorur për likuidimin e faturave të papaguara në vite.

### b. Mbi masat disiplinore dhe administrative

Nga 649 masa disiplinore dhe administrative (gjoba), janë pranuar 406 masa po kaq janë zbatuar ose në masën 63%, 13 subjekte kanë realizuar në masën 100% dhe kanë mbetur pa u realizuar nga 30 subjekte 243 masa.

Po kështu nga mjaft Inspektorate ndërtimore urbanistike të bashkive dhe komunave, nuk janë ndjekur procedurat ligjore për nxjerrjen e vendimeve të gjobave, edhe në rastet kur kanë nxjerrë vendimet e gjobave nuk kanë ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e tyre.

a. Për Masat Disiplinore: Nga 507 masa disiplinore, janë zbatuar 354 masa ose në masën 70%, 18 subjekte kanë realizuar në masën 100% dhe kanë mbetur pa u realizuar nga 25 subjekte 153 masa. Gjatë auditimit rezulton se në mjaft raste masat disiplinore zgjidhje kontrate e punësimit" janë zëvendësuar më masën "Vërejtje më Paralajmërim", ose "Vërejtje me shkrim", ku për efekt të përllogaritjeve ato në total janë konsideruar të realizuara, por në disa raste kur nuk kanë marrë asnjë lloj mase, kemi rikërkuar zbatimin e tyre. Për mos realizimin e masave disiplinore përmendim: Bashkia Kavajë nuk ka zbatuar 26 masa disiplinore, Bashkia Fushë-Krujë nuk ka zbatuar 10 masa disiplinore, Bashkia Fier 14 masa disiplinore, Bashkia Durrës 12 masa disiplinore, Bashkia Kukës 11 masa.

Gjatë auditimeve të ushtruara për vitin 2015 janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore në fushën e zbatimit dhe projektimit të ndërtimeve. Mbështetur në nenet 9 dhe 16 të Ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me Ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, bazuar në Vendimin e Këshillit Ministrave, nr. 42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", ndryshuar me VKM nr. 92, datë 19.02.2014, Kreu VII, "Sanksione", pika 1, shkronja (a), konstatohen ose provohen deklarime të rremë,

- KLSH i ka rekomanduar *Komisionit të dhënies së Licencave*, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (duke ju dërguar shkresë zyrtare dhe procesverbalet e mbajtura për konstatimin e shkeljes), që për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksionet për heqjen e licencave të mbikëqyrësve dhe kolaudatorëve nga 1-2 vjet.

#### c. Mbi masat e shpërblimit të dëmit:

Nga 43 subjekte të verifikuara masat për shpërblim dëmi nga 586,790,000 lekë janë pranuar dhe realizuar 529,535,000 lekë, ose në masën 90%. Problem paraqiten 7 subjekte të cilat nuk kanë zbatuar dhe argumentuar mos pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH, në vlerën prej 48,416,000 lekë, duke ulur realizimin të rekomandimeve, për arsye dhe pretendime të ndryshme. Subjkeet më tipike të cilat nuk pranojnë haptaz rekomandimet e KLSH, përmendim:

- Bashkia Fier nuk pranon rekomandimin në vlerën prej 8,979,000 lekë, e cila përfaqëson dhenie shpërblime dhe pagash punonjësve të Bashkisë, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, jane paguar Drejtorët në Bashki me tëpër se Tabelat e pagave.
- Bashkia Patos, në vlerën 4,252,000 lekë, mos llogaritje e saktë e findit limit në fushën e prokurimeve publike.
- Bashkia Divjakë, në vlerën 1,317,000 lekë, e cila përfaqëson mos pagesën e dëmit ekonomik të shkaktuar nga mungesat e dokumentacionit në fushën e prokurimeve, për të cilat Bashkia Divjakë pretendon se ky dokumentacion është plotësuar dhe nuk pranon të kryeje ndalesat ndaj personave përgjegjës.

2. Departamenti i Auditimit të Buxhetit qëndror, Administratës së Lartë Publike, Kontrollit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Referuar auditimit të zbatimit të rekomandimeve të realizuar në 22 subjekte , janë rekomanduar gjithsej 494 masa nga të cilat janë zbatuar plotësisht 282 ose 57%, pjesërisht 7 masa, ose 1% janë në proces zbatimi 105 masa ose 22% . Nga masat e konstatuara konstatohen 100 masa të pazbatuara ose 20% e atyre të propozuara.

Në lidhje me masat konkrete realizimi paraqitet si më poshtë vijon:

a. Rekomandime për ndryshime të dispozitave ligjore. Nga departamenti për përmirësimin e dispozitave ligjore janë propozuar 23 rekomandime, nga të cilat 6 rekomandime janë zbatuar plotësisht, janë zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, 13 rekomandime janë në proces zbatimi për të cilat është shprehur dakortësia e rekomandimit dhe 3 rekomandime rezultojnë të pa zbatuara.

b. Rekomandime për masa organizative. Nga Departamenti për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 275 masa organizative, nga të cilat 174 janë zbatuar plotësisht, 6 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, për 72 rekomandime kanë nisur procedurat e zbatimit të tyre pra rekomandimet konsiderohen në proces zbatimi dhe 23 rekomandime nuk janë zbatuar.

c. Rekomandime për shpërblim dëmi. Nga KLSH për dëmet e shkaktuara janë propozuar 115 masa për shpërblimin e dëmit në vlerën totale prej 11,920,480,019 lekë, nga të cilat janë zbatuar 63 rekomandime për vlerën 11,521,303,973 lekë dhe nuk janë zbatuar 36 rekomandime për vlerën 277,743,159 lekë.

d. Nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit qëndror, Administratës së Lartë Publike, Kontrollit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm janë rekomanduar:

- 7 masa administrative, të cilat janë pranuar dhe zbatuar të gjitha;
- Rekomanduar 74 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 32 rekomandime, janë në proces zbatimi 4 dhe nuk janë zbatuar 38 prej tyre.

3. Departamenti i Auditimit të të ardhurave të buxhetit të shtetit

Referuar auditimit të zbatimit të rekomandimeve të realizuar në 18 subjekte, nga ky departament janë rekomanduar gjithsej 318 masa (organizative, administrative, dhe disiplinore), nga të cilat janë zbatuar plotësisht 175 masa, masa zhdëmtimi janë rekomanduar 96, në vlerë 4,983,376 mijë lekë, ku janë realizuar 40 masa në vlerë

296,866 mijë lekë. Pa realizuar ose në proces janë 56 masa, në vlerë 4,686,510 mijë lekë.

Në lidhje me masat konkrete realizimi paraqitet si më poshtë vijon:

a. Rekomandime për ndryshime të dispozitave ligjore. Nga departamenti për përmirësimin e dispozitave ligjore janë propozuar 7 rekomandime, nga të cilat 6 rekomandime janë zbatuar plotësisht. Për 1 (një) rekomandim nuk ka përgjigje dhe konsiderohet i pa zbatuar.

b. Rekomandime për masa organizative. Nga Departamenti për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 139 masa organizative, nga të cilat 94 janë zbatuar plotësisht, dhe për 105 rekomandime nuk është kthyer përgjigje.

c. Rekomandime për shpërblim dëmi. Nga KLSH për dëmet e shkaktuara janë propozuar 96 masa për shpërblimin e dëmit në vlerën totale prej 4,242,496 mijë lekë, nga të cilat janë zbatuar 40 rekomandime për vlerën 296,866 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar 56 rekomandime për vlerën 4,686,510 mijë lekë.

d. Nga Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit janë rekomanduar dhe 31 masa administrative, nga të cilat janë pranuar 15 masa dhe për 16 masa nuk ka kthim përgjigje.

e. Rekomanduar 148 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 66 rekomandime, dhe nuk janë zbatuar 82 prej tyre pasi nuk ka kthim përgjigje nga subjektet për to.

#### 4. Departamenti i Auditimit të Invesimeve dhe Projekteve me Financim të Huaj, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Referuar auditimit të zbatimit të rekomandimeve të realizuar në 24 subjekte, nga ky departament janë rekomanduar gjithsej 933 masa (organizative, administrative, dhe disiplinore dhe shpërblim dëmi) nga të cilat janë zbatuar plotësisht 363 masa apo 39% e tyre, në proces realizimi 292 masa ose 31% dhe të pa zbatuara 278 masa ose 30% e tyre.

Në lidhje me masat konkrete realizimi paraqitet si më poshtë vijon:

a. Rekomandime për masa organizative. Nga Departamenti për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 459 masa organizative, nga të cilat 154 janë zbatuar plotësisht ose 34%, janë në proces 217 masa ose 47% e tyre dhe nuk janë zbatuar 88 masa ose 19% e tyre.

b. Rekomandime për shpërblim dëmi. Nga Departamenti për dëmet e shkaktuara janë rekomanduar 176 masa për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale prej 39,029,671 mijë lekë, nga të cilat janë zbatuar 72 rekomandime për vlerën 333,396 mijë lekë dhe janë në proces zbatimi 59 masa, për vlerën 38,321,571 mijë lekë ose 98% dhe nuk janë zbatuar 45 masa, në vlerën 374,704 mijë lekë ose në masën 1%.

c. Nga departamenti janë rekomanduar 5 masa administrative, nga të cilat janë zbatuar 4 masa dhe një masë rezulton e pa zbatuar.

d. Janë Rekomanduar 226 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 133 masa ose 59% e tyre, janë në proces zbatimi 16 masa ose 7% e tyre dhe nuk janë zbatuar 77 masa ose 34% e tyre.

### 5. Departamenti i Auditimit të Performancës

Nga ky departament gjatë punës audituese janë lënë 51 rekomandime për të cilat subjektet kanë sjellë planet e veprimit, ku rezulton se janë pranuar rekomandimet e KLSH, të cilat referuar afateve të realizimit të tyre, specifikave që ka auditimi i performancës, si dhe kohështrirja e realizimit të rekomandimeve rezulton se rekomandimet e dhëna janë në proces realizimi. Në këtë proces kanë rezultuar dy rekomandime të pa realizuara.

Është e rëndësishme të përmendim se realizimi i rekomandimeve kërkon domosdoshmërisht bashkëpunimin institucional dhe të kuptuarit nga institucionet publike të audituara, rëndësia e funksioneve kushtetuese të KLSH si dhe për rrjedhojë zbatimi i rekomandimeve të dhëna prej saj në përfundim të procesit të auditimit.

Jo nga të gjithë institucionet publike të audituara është gjetur ky bashkëpunim dhe kuptim, në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të lëna. Këtu është e rëndësishme të përmendim disa prej tyre të cilat në procesin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve rezultojnë me nivele të larta të mosrealizimit të tyre apo me neglizhencën e hartimit të plan veprimeve me afate dhe punonjës përgjegjës në zbatimin e këtyre plan veprimeve.

Institucionet të cilat paraqiten më dobët në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të KLSH sipas departamenteve paraqiten si më poshtë vijon:

1. Bazuar në korrespondencën me subjektet brenda afatit 20 ditor, lidhur me planin e masave për rekomandimet e lëna gjatë auditimit, rezulton se nga masat e rekomanduara, nuk janë pranuar 13 rekomandime ose 3%, nga të cilat 8 rekomandime i përkasin Bankës së Shqipërisë, (3 rekomandime janë për përmirësime ligjore, 2 rekomandime për masa organizative dhe 3 rekomandime për shpërblim dëmi në vlerën 44,662 mijë lekë), AMF një rekomandim masë shpërblim dëmi në vlerën 819 mijë lekë, MPB një rekomandim masë organizative, MAS një rekomandim masë shpërblim dëmi në vlerën 108,021 mijë lekë dhe ISSH dy rekomandime masa shpërblim dëmi në vlerën 16,328 mijë lekë.

U konstatua se në disa institucione qendrore rezulton se, nuk janë marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve. Kështu Ministria e Kulturës nuk ka zbatuar asnjë nga rekomandimet, Ministria e Arsimit dhe Sporteve nuk ka zbatuar 38% të rekomandimeve, Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka zbatuar 65% të rekomandimeve, Qendra Kombëtare e Regjistrimit nuk ka zbatuar 52% të rekomandimeve, etj.

Gjithashtu nuk janë zbatuar masat në Ministrinë e Mbrojtjes për 41 masa disiplinore të rezultuara të pa zbatuara.

2. Në pushtetin vendor ndër institucionet më problematike është Bashkia Fier, e cila rezulton me mosrealizim të masave shpërblim dëmi, të cilat nuk i ka pranuar në vlerën 8,979 mijë lekë, po kështu kjo Bashki nuk ka zbatuar 14 masa disiplinore.

Nuk kanë zbatuar masat disiplinore Bashkitë: Fushë Krujë, 10 masa; Pogradec 14 masa; Durrës, 12 masa; Kavajë, 21 masa; Patos, 10 masa.

3. Në Institucionet mjedisore rezulton një numër i konsiderueshëm masash disiplinore, shpërblim dëmi dhe organizative të pa zbatuara, si: subjekti Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, AlbPetrol sh.a., me 17 masa disiplinore të pa zbatuara; Hekurudha Shqiptare sh.a., etj.

4. Në sektorin e tatimeve dhe doganave vlen të përmenden DRT Durrës me 21 masa disiplinore të porealizuara, DRT Kukës me 5 masa disiplinore të pa realizuara, Dega e Doganës Shkodër 16 masa disiplinore të pa realizuara, Dega e Doganës Kapshticë me 8 rekomandime të masave disiplinore të pa realizuara.

Në të ardhmen në ushtrim të detyrave ligjore audituesit e KLSH duhet të shtojnë bashkëpunimin me institucionet publike në mënyrë që procesi rënies dakord për rekomandimet e propozuara të përfundojë gjatë procesit të auditimit dhe



shqyrtimit të Projektraportit, në mënyrë që dhe niveli i realizimit të tyre referuar dakortësisë të jetë në nivelet maksimale.

Sigurisht përmirësime të vazhdueshme duhet të ketë në rritjen e nivelit të cilësisë dhe kuptueshmërisë së rekomandimeve, fusha të cilat janë janë dhe pjesë e trainimeve të vazhdueshme të stafit të KLSH-s.

## 14. FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE NËPËRMJET PZHV

*Referues: Edvin STEFANI – Drejtor Drejtorie,  
Artur HASANBELLIU – Drejtor Drejtorie,  
Sali AGAJ – Auditues i lartë.*

*Aplikimi i instrumentit:*

Nga kryerja e vlerësimit bazuar në instrumentin e indikatorëve të performancës (*Ngritja e kapaciteteve përmes promovimit të të mësuarit dhe shkëmbimit të njohurive*) referuar dimensioneve dhe aspekteve të vlerësuara rezulton se Promovimi dhe Zhvillimi i Vazhdueshëm profesional si kontribuues i përsosmërisë individuale, të grupit dhe të institucionit është realizuar në nivele të larta. Kërkesat dimensionale janë:

- Plan për Zhvillim Profesional dhe Trajnimi, vlerësuar me 3 nga 4 pikë të mundshme, ku si sfidë mbetet trajnimi i diferencuar në bazë të nevojave individuale;
- Procedura dhe Praktika për përzgjedhjen e stafit për trajnim bazuar në aplikimet dhe konsideratat e kompetencave të nevojshme, vlerësuar me 3 nga 4 pikë të mundshme, ku si sfidë mbetet përfitimi i informacionit mbi nevoja individuale të gjithsecilit;
- Monitorimi dhe vlerësimi i dijeve të përfutuara nga trajnimi, vlerësuar me 3 nga 4 pikë të mundshme, ku si sfidë mbetet testimi i diferencuar sipas temave të trajnimit;
- Angazhimi në nivele të larta trajnuese, vlerësuar me 4 nga 4 pikë të mundshme, 28 ditë mesatare për individ me mbulim tërësor të stafit;
- Bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm dhe SAI homologe dhe shkëmbimi i eksperiencave, vlerësuar me 4 nga 4 pikë të mundshme, ku niveli i përfaqësimit institucional shfaqet i lartë;

- Nxitja e shkëmbimit të njohurive dhe ngritjen e kapaciteteve në mbështetje të dorëzimit të rezultateve, vlerësuar me 3 nga 4 pikë të mundshme, ku si sfida mbetet rritja e informacionit mbi nivelin e trajnuesve dhe të procesit të përfitimit të dijeve nga të trajnuarit.

### Analiza e punës së Drejtorisë së Metodologjisë dhe Trajnimit

Trajnimi i stafit dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional përbën domosdoshmëri për zhvillimin institucional. Ngritja e kapaciteteve përmes promovimit të të mësuarit dhe zhvillimit të metodologjisë është pjesë e rekomandimeve të të gjithë faktorëve ndërkombëtarë, e shprehur në strategjinë për zhvillim të KLSH-së.

ECA ose Gjykata Evropiane e Audituesve, përmes direktivës numër 10/2012 pjesë e raportit “Mbi efektivitetin dhe zhvillimin e stafit në Komisionin Evropian” 2012 – 2013, sugjeron trajnimin e vazhdueshëm të stafit, si element kyç në arritjen e rezultateve institucionale.

Cilësia e punës sonë audituese është një domosdoshmëri. Komisioni Evropian e sheh cilësinë e raporteve dhe rekomandimeve tona si një ndër kriteret për vlerësimin e performancës sonë si institucion. Gjithashtu zhvillimi ynë institucional shihet si një kriter që duhet të plotësohet nga një vend kandidat për Bashkimin Evropian. Komisioni shprehet se e bazon vendimmarrjen e tij në lidhje me politikat brenda BE-së, mbi statistika të certifikuara më parë nga SAI-t e vendeve përkatës, duke evidentuar rëndësinë e zhvillimit institucional.

Fondi Monetar Ndërkombëtar e thekson gjithashtu këtë, për Qeverinë Shqiptare, ku përmes Kodit të Transparencës Fiskale reflektohen praktikat më të mira mbarë botërore, në të cilin përmirësimi dhe niveli i lartë i audituesit të jashtëm siguron një risk më të vogël në vlerësimin e performancës qeveritare.

Në vijim të Rezolutës së Dytë të Kombeve të Bashkuara, kushtuar forcimit dhe mbështetjes së institucioneve supreme të auditimit dhe organizatës së tyre INTOSAI, dhe në zbatim të rekomandimeve të Progres Raporteve të Bashkimit Evropian institucioni ynë përjetoi një hap të madh përpara në përputhje me standardet INTOSAI dhe EUROSAI, përmes ligjit të ri. Domosdoshmëria për trajnim shprehet qartazi dhe në ligjin e ri në nenin 8 pika 2, ku cilësohet *“Bashkëpunimi nënkupton anëtarësimin, pjesëmarrjen në formë të përshtatshme për auditimin, shkëmbimin e eksperiencave dhe kryerjen e trajnimeve të përbashkëta, ku në çdo rast Kontrolli i Lartë i Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat e Republikës së Shqipërisë”*, në nenin 39 *“Trajnimet Profesionale”* ku cilësohet se *“Punonjësit e*

Kontrollit të Lartë të Shtetit gëzojnë të drejtën për t'u trajnuar profesionalisht, sipas planifikimeve të bëra nga institucioni, në përputhje me nevojat e evidentuara", si dhe se *"Kontrolli i Lartë i Shtetit siguron një proces sistematik dhe të planifikuar të trajnimit, zhvillimit profesional dhe certifikimit, i cili përfshin shtimin dhe përditësimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për kryerjen me efektivitet të detyrave të auditimit, në bashkëpunim me ASPA-n, me institucione të tjera të larta të auditimit apo me organizata profesionale, vendase apo Ndërkombëtare"*.

Trajnimi në KLSH shihet si një faktor ndryshimi drejt një evolucioni ku secili anëtar i stafit të krijojë vetëbesim, nivel të lartë profesional, bashkërendim të forcave audituese dhe klimë bashkëpunimi.

Përtej punës së bërë deri më tani në lidhje me trajnimet e realizuara gjatë vitit 2015, gjatë vitit 2016 do të realizohet projekti IPA. Ai zhvillohet në kuadër të artikullit 90 të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim të Bashkimit European. Përmirësimi i kapaciteteve do të realizohet në referencë të praktikave më të mira audituese të sektorit publik të BE-së si dhe në përputhje me standardet e INTOSAI.

## TRAJNIMI I VAZHDESHËM PROFESIONAL

Dimensioni i zhvillimit të vazhdueshëm profesional që kontribuon në rritjen e aftësive individuale, të grupit dhe të institucionit është shprehur në planin vjetor të trajnimeve për vitin 2015, i cili parashikon jo vetëm sasinë e ditëve të trajnimit, seminareve dhe konferencave, por edhe një shtrirje të trajnimeve përgjatë gjithë vitit.

Treguesi i Performancës së pjesëmarrjes në trajnime e vendos KLSH-në në nivelet e larta të Institucioneve Homologe të Auditimit të Lartë Ndërkombëtar. Rezultatet e arritura tregojnë për një qasje të qëndrueshme dhe të suksesshme ndaj procesit të trajnimit, si rruga kryesore për zhvillimin profesional. Duke iu referuar të dhënave informuese lidhur me pjesëmarrjen për periudhën 5 vjeçare, 2011- 2015, është shumë e dukshme se si reformimi i sistemit të trajnimeve si pjesë integrale e reformës institucionale në KLSH është zhvilluar e plotë, duke përfshirë çdo aspekt të ndërtimit dhe forcimit të kapaciteteve; shtrirja e tij ka qenë gjithëpërfshirëse duke i siguruar çdo individ të drejtën dhe mundësinë e të mësuarit dhe të trajnuarit.

Në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit 2015-2017, politika e zhvillimit të kapaciteteve audituese është përkthyer në 3853 ditë trajnime nga të cilat 2899 janë zhvilluar nga vetë KLSH dhe 954 ditë trajnime jashtë KLSH-së. Evolucioni i ditë trajnimeve në pesë vitet e fundit paraqitet:


Ecuria e Trajnimit në 5 vitet e fundit në ditë persona të trajnuar



Ecuria e trajnimeve ka arritur pjekurinë e saj, duke reflektuar një konsolidim të procesit. Ditët e trajnimit janë realizuar me një shtrirje përgjatë gjithë vitit duke mbuluar të gjithë personelin.

Grafiku i mëposhtëm tregon progresin tepër të rëndësishëm dhe të madh që është bërë lidhur me pjesëmarrjen në trajnime:

Progresi i pjesmarrjes në trajnime, ditë mesatare trajnimi për punonjës




Gjatë vitit 2015 është mbuluar me trajnim i gjithë stafi i KLSH-së. Trajnimi përfshin të gjithë nivelet e administrimit dhe është hartuar në bazë të nevojave të përpiluara nga diskutimet me Drejtorët e Departamenteve dhe Kryeaudituesit. Për vitin 2016 mbetet që të punohet më tej drejt një përmirësimi të hartimit të planit duke identifikuar nevojat personale dhe zhvillimin individual të gjithsecilit. Trajnimi me module të diferencuara sipas eksperiencës dhe formimit profesional të gjithë secilit mbetet një sfidë për të ardhmen, e kufizuar kjo nga burimet e financimit dhe të

trajnimet. KLSH është një institucion në të cilin përfshihen disa profesione si ai i ekonomistit, juristit, inxhinierit, informaticienit, matematicienit, etj. Ky diversitet që në vetvete përbën një avantazh e duhet të orientohet përmes politikave trajnuese bashkërenduese dhe të diferencuara.

### SHKËMBIMI I NJOHURIVE NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL

Sipas dimensionit të shkëmbimit të eksperiencave dhe bashkëpunimit me kolegët dhe grupet rajonale, gjatë vitit 2015 është realizuar një larmi e burimeve të informacionit. Burimet kryesore jashtë institucionit ishin trajnimet nga ekspertë të jashtëm, nga institucione të tjera brenda vendit, trajnime dhe seminare jashtë vendit në bashkëpunim me institucionet homologe.




#### Burimet kryesore të trajnimit

- Trajnime jashtë vendit
- Trajnime nga ekspertë të huaj
- Trajnime brenda institucionit
- Trajnime nga institucione të tjera brenda vendit

Nga këto burime janë realizuar trajnime si në fushën e metodologjisë së auditimit, ashtu dhe në fushën e kuadrit rregullator të subjekteve të auditimit.

#### Fusha e trajnimit




- Trajnime të fushës së subjektit të audituar
- Trajnime të metodologjisë audituese

Trajnimet janë realizuar nga një larmi burimesh dhe në të gjithë fushat e trajnimit. Nevojat për njohuri në fushën e metodologjisë audituese kanë predominuar në trajnimet e vitit 2015, kjo shprehje e faktit se audituesit kanë njohuri mbi kuadrin

rregullator, por përmirësime priten në fushën e përfaqësuesve ndaj subjekteve të auditimit. Për këtë gjatë të vitit 2015 janë përpiluar rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit, manuali i auditimit financiar, manuali i auditimit të përputhshmërisë si dhe udhëzimi për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.


### Burimet dhe metodologjia e trajnimit



Në qëllim të përfitimit të njohurive të reja dhe ndarjes së eksperiencës janë organizuar trajnime jashtë KLSH-së dhe brenda saj. Trajnime nga jashtë janë të organizuar në bashkëpunim me SAI homologe të vendeve të tjera apo institucione të tjera ndërkombëtare që ofrojnë trajnime të fushës së auditimit si dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare të fushës.

Rëndësi e veçantë i është dhënë organizimit të trajnimeve të posaçme për stafin e ri. Këto trajnime bëjnë të mundur që treguesi për 30 ditë trajnimi/person për stafin e sapo rekrutuar të arrihet për një periudhë kohore më pak se një vit.

### Tipi i trajnuesit



Në shkëmbim të eksperiencave të, reja në trajnimet e vitit 2015 janë organizuar trajnime nga ekspertë të jashtëm. Mbetet sfidë rritja e trajnimeve nga trajnues jashtë KLSH-së me qëllim shkëmbimin e eksperiencave si dhe organizimi i "Vlerësimeve mes Kolegësh", apo *Peer Review*, që do të ofronte një informacion të rëndësishëm mbi ecurinë e punës, i cili do të shërbente në drejtim të zhvillimit profesional.

## METODOLOGJIA DHE FORMAT E TRAJNIMEVE

Në përputhje me dimensionin e shumëllojshmërisë së procesit të trajnimit dhe zhvillimit të metodologjisë, me qëllim rritjen e nivelit të përthithjes së njohurive për zhvillimin e mëtejshëm profesional, gjatë vitit 2015, është kryer një punë e madhe në drejtim të zhvillimit të metodologjisë dhe diversifikimit të formave të trajnimit. Bazuar në strategjinë e implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI, në përputhje me planin e veprimit për zbatimin e strategjisë së KLSH-së për vitin 2013 – 2017 dhe në përmbushje të aktiviteteve të parashikuara në matricën e programit mbështetës buxhetor të BE-së, sipas objektivave të shtyllës VI, të strategjisë së menaxhimit të financave publike, 2014 -2020, me vendim nr 196 datë 31.12.2015 u miratua Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë dhe Manuali i Auditimit Financiar. Në përputhje me standardet ISSAI dhe udhërrëfyesve të IDI-t INTOSAI, në bazë të praktikave më të mira Europiane këto manuale do të zbatohen në auditimin e përditshëm gjatë vitit 2016 dhe në auditimet pilot të parashikuara.

Gjatë vitit 2015 janë realizuar tre forma të trajnimit profesional, ajo e trajnimit përmes kurseve on line, apo *e-learning*, *trajnimeve face-to-face*, apo trajnimeve me kontakt direkt dhe avancim profesional përmes shkëmbimit të eksperiencave të përbashkëta përmes pjesëmarrjes në *seminare-workshop-eve*.

*Trajnime në klasë me kontakt direkt, ose Face-to-Face.* Me një fleksibilitet në përshtatshmërinë për nevojat për trajnim, ky tip trajnimi ka zënë vendin kryesor në format e trajnimit të zhvilluara. Trajnimet e realizuara ishin në formën e trajnimeve në grupe të vogla, ku një vend të madh i lihet diskutimeve me interaktivitet mes trajnuesit dhe të trajnuarit. Transmetimi përmes materialeve në Power Point dhe video projektor, ka ofruar një metodologji që lehtëson procesin e përfitimit të dijeve. Në këtë dimension, gjatë vitit 2015, u krye dhe investimi duke shtuar një sallë të dedikuar trajnimeve, përmes tjetërsimit të ambienteve të pashfrytëzuara në



pronësi të institucionit. Vlen të theksohet përfitimi nga kjo metodë trajnimi si pasojë e nivelit të lartë të bashkëveprimit trajnues – i trajnuar, ndonëse duhet të përmirësohet procesi i vlerësimit trajnues – i trajnuar.

Këto trajnime janë zhvilluar si brenda KLSH-së, ashtu dhe jashtë saj.

*Trajnime brenda vendit:* Trajnime që janë organizuar duke u mbështetur nga ekspertë të brendshëm e të jashtëm, nga organizata apo institucione kombëtare apo ndërkombëtare si më poshtë:

- Trajnime në nivel institucional në KLSH: të cilat u organizuan mbi bazë ditore nga trajnues/auditues të lartë, kryeauditues dhe Drejtues të Lartë të KLSH dhe u fokusuan në përditësimin e njohurive të fushave të veçanta dhe auditimit;
- Trajnime brenda çdo Departamenti Auditimi individualisht në formën e tryezave të diskutimit profesional në terma të rasteve nga praktikrat audituese;
- Trajnime nga Ekspertë të huaj, që përfshinë trajtimin e tematikave specifike të profesionit të auditimit në formatin e prezantimeve të kombinuar me raste studimore nga eksperiencat e vendeve të tjera.

*Trajnime jashtë vendit:* Trajnime të organizuar në bashkëpunim me SAI homologe të vendeve të tjera apo institucione të tjera ndërkombëtare që ofrojnë trajnime të fushës së auditimit si dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare të fushës. Gjatë këtij viti u trajnuan jashtë vendit 136 persona, ose 83% e stafit auditues.

- Trajnime të organizuara në formën e vizitave studimore dhe trajnimeve në Institucionet Homologe SAI të vendeve të ndryshme në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit që KLSH ka nënshkruar dhe vijon të nënshkruajë me këto institucione për shkëmbim eksperiencash dhe të dijeve midis audituesve të vendeve të ndryshme. Gjykata Turke e Llogarive dhe NIK i Polonisë kanë vijuar të jenë ofruesit kryesorë për trajnime të stafit të KLSH pranë institucioneve të tyre duke u kthyer kështu dhe në mbështetësit më të fuqishëm në procesin e ndërtimit të kapaciteteve audituese të pajisura me njohuri dhe eksperiencat ndërkombëtare.

*Trajnime përmes kompjuterit, ose e-learning.* Trajnimet *online* u ofruan kryesisht nga CEF, Slloveni Këto trajnime ishin në fushën e buxhetimit, në të cilën u realizuan 188 ditë njerëz, apo 13 punonjës; një formë trajnimi e re, e cila po zë një vend gjithnjë e në rritje. Kjo formë ofron një bibliotekë të gjerë trajnimi, sipas nevojave të përdoruesit dhe përbën një sfidë për zhvillim në të ardhmen. Aktualisht është duke u punuar në drejtim të formimit të bibliotekës sonë virtuale, duke shfrytëzuar

fondin e pasur të botimeve, materialet e trajnimeve brenda KLSH-së dhe eksperiencat e marra nga trajnimet nga jashtë.

*Konferenca – Seminare – Workshop-e.* Shkëmbimi i eksperiencave të përbashkëta përbën tiparin kryesor të avancimit profesional.

- Pjesëmarrja në Kongreset e Organizatave Profesionale Ndërkombëtare, INTOSAI, EUROSAL, etj., ka mundësuar prezantimin e KLSH me një profil të ri, të orientuar drejt një të ardhme për një auditim publik modern dhe të mbështetur fuqishëm në Standardet e INTOSAI-t ISSAI.
- Seminare trajnimi të organizuara nga institucione publike ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të financave publike dhe auditimit. Megjithë mundësitë e limituara, KLSH është përpjekur të shfrytëzojë më së miri pjesëmarrjen në seminare dhe trajnime të organizmave profesionale ndërkombëtarë për punonjës publikë sikurse është CEF/Qendra e Ekselencës në Financë, Trajnim "Auditimi i TI-së" ECA Luksemburg, trajnim "Menaxhimi Financave Publike" Hagë, Holandë etj. Si një traditë tashmë e konsoliduar, audituesit që kanë marrë pjesë në të tilla trajnime dhe seminare kanë shpërndarë midis kolegëve eksperiencat dhe njohuritë e fituara.
- Pjesëmarrje dhe kontribut aktiv në takimet e Grupeve të Punës dhe Komisioneve të organizuara nga INTOSAI dhe EUROSAL; Politika e hapur ndaj eksperiencave ndërkombëtare në fushën e auditimit publike ka sjellë një ndryshim rrënjësor lidhur me konceptimin përfaqësimit të Auditimit Publik Shqiptar në rrjetet profesionale ndërkombëtare. Angazhimi i stafi të KLSH në Grupe Pune, Task Force dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare ka shkuar përtej pjesëmarrjes së thjeshtë, KLSH është vendosur në nivelet e kontribuuesve më aktiv duke treguar profesionalizëm të lartë. Sot KLSH është pjesë e disa Grupeve të punës të INTOSAI-t dhe EUROSAL-t si dhe pjesë e Task Forcës për Etikën, etj.

Realizimi i dimensionit në këtë fushë sugjeron në nivel të kënaqshëm të angazhimit institucional, duke realizuar një përfaqësim në nivel të lartë të përfaqësimit ndërkombëtar.

## **PËRSHTATSHMËRIA E TRAJNIMEVE ME ANALIZËN E NEVOJAVE**

Në lidhje me dimensionin e përshtatshmërisë së llojit të temave të trajnimeve me nevojat për zhvillim dhe trajnim, gjatë këtij viti është bërë një punë e

konsiderueshme. Programi i Veprimtarisë së Trajnimit të stafit të KLSH për vitin 2015 përcaktoi drejtimet kryesore të trajnimit përfshirë tematikat risi, pjesëmarrësit dhe kohën e zhvillimit të trajnimit si dhe trajnuesit. Duhet theksuar se, gjatë implementimit si rezultat i rishikimit dhe vlerësimit të herëpashershëm të nevojave të stafit u organizuan dhe trajnime jashtë programit të cilat kishin si qëllim, mbajtjen e trajnimit në terma realiste dhe sa më afër nevojave aktuale për njohuri në fushat specifike profesionale.

Si sfidë mbetet trajnimi i diferencuar me qëllim aplikimin e trajnimeve që marrin parasysh specifikat individuale profesionale dhe personale.

Trajnimet risi të këtij viti janë në fushën e teknologjisë së informacionit si "Manuali i Auditimit IT", "Përdorimi i Teknikave CAAT", në fushën e "Auditimit të Performancës", krahas temave në fushën e metodologjisë si ato "Mbi Auditimin Financiar", "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë", "Mbi auditimin në fushën e Prokurimeve, etj.

Trajnimet përfshinë njohuri mbi katër llojet e auditimit atë të Sistemeve të IT, Auditimin e Përputhshmërisë, Auditimin Financiar dhe Auditimin e Performancës.

Për zhvillimin profesional dhe trajnimin në disiplinat përkatëse të auditimit, KLSH ka identifikuar profesionet e "auditimit" ose "kuadrot", që dëshiron të zhvillojë në mënyrë që të ushtrojë mandatin e tij. Për këtë tashmë KLSH ka një strukturë organizative, e cila mbulon veprimtarinë e saj përmes Drejtorëve të Departamenteve dhe kryeaudituesve.

Në KLSH mbetet për të përcaktuar përgjegjësia për krijimin e një plan zhvillimi për çdo profesion apo auditues. Për këtë duhet kryer mbulimi me trajnime dhe kualifikime i të gjithë stafit të saj si në nivel drejtues, ashtu dhe zbatues dhe sipas karakteristikave të gjithsecilit, duke e bërë të gjithë stafin pjesëmarrës në planifikim. Ristrukturimet e kryera gjatë vitit kanë patur parasysh zhvillimin profesional specifik të të gjithë personelit, duke i angazhuar në auditime apo departamente më të përshtatshme për secilin prej karakteristikave individuale, sipas kërkesave të përshtatshme në kompetencat e duhura për nivelet e ndryshme të stafit në çdo profesion apo kuadro.

### *Faktorët kufizues të procesit, risqet dhe përgjigja ndaj risqeve*

Në vlerësimin që i bëhet procesit trajnues, vlerësohen katër nivele apo shkallë. Secila nga këto përbën një nivel risku që duhet të merret parasysh në vlerësimin e suksesit të procesit të trajnimit.

- *Qëndrimi dhe kënaqësia e të trajnuarit.* Nuk mjafton që të dish, duhet një vend ku të transmetohet dija dhe një mënyre pedagogjike e transmetimit të saj. Vlerësimi se sa i trajnuari kënaqet nga trajnimi varet shumë nga lehtësitë që i krijohen atij si në komoditetin e qëndrimit gjatë trajnimit, teknologjisë interaktive të përdorur, ashtu dhe në nivelin e pedagogjisë së trajnuesit. Këto janë dy pika relativisht më të dobëta të përjetuara gjatë vitit 2015. Në vitin 2016 pritet të zvogëlohen këto risqe pasi është bërë një punë e madhe si në drejtim të krijimit të një sale të dedikuar për trajnim, ashtu dhe në drejtim të angazhimit të ekspertëve të huaj trajnues, pjesë e programit IPA.
- *Ndryshimet në njohuritë dhe aftësitë e të trajnuarit.* Mungon një feedback se si kanë ndryshuar dijet e të trajnuarit. Sipas studimeve të ECA është vërejtur një perceptim i ndryshëm mbi efektivitetin e trajnimit nga trajnuesit dhe pjesëmarrësit në trajnim, kjo më e lartë në trajnimet mbi gjuhën, e pasuar nga trajnimet mbi IT dhe trajnimet e përgjithshme. Të pakta kanë qenë rastet në të cilët, përmes testeve interaktive, i trajnuari është njohur me ndryshimin e dijeve të tij të marra nga trajnimi. Në vitin 2016 pritet të zvogëlohen këto risqe pasi do të organizohen mundësitë për vetëvlerësim të dijeve, duke publikuar teste të zgjidhura në formën e *pyetjeve – përgjigjeve*, të cilat do të jenë disponibël për audituesit on-line.
- *Ndikimi i dijeve në punën e përditshme.* Ndonëse ka një lidhje të fortë e të njohur mes trajnimit dhe përmirësimit të cilësisë së punës, matja e saj paraqet vështirësi. Hartimi i pyetësorëve mbi llojet e temave të nevojshme për trajnim përbën një fakt tashmë në KLSH. Tipet e trajnimit, larmia e burimeve, shkëmbimi i eksperiencave me auditues jashtë KLSH-së, ka zvogëluar këtë risk. Në vitin 2016 është zvogëluar ky risk përmes bashkëpunimit të ekspertëve të KLSH-së në hartimin e temave të trajnimit me ekspertët e IPA.
- *Ndikimi në rezultatet e institucionit.* Personalisht jam i mendimit se ka një lidhje të fortë mes rezultateve të arritura nga institucioni dhe dijeve të marra nga trajnimi, ndonëse ky nuk është katalizatori i vetëm. Vlerësimi i ndikimit në rezultatet e institucionit mbetet në mundësi të Drejtorëve të Departamenteve, duke vlerësuar kritere, si cilësia dhe sasia e materialeve të evaduar, numri dhe cilësia më e lartë e dokumentacionit të audituar në një kohë sa më të shkurtër.

ANEKS

Dimensionet në të cilat është kryer vetëvlerësimi janë Planet dhe Proceset në fushën e Zhvillimit dhe Formimit Profesional, si dhe në fushën e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në disiplinat përkatëse të Auditimit.

Tabela: "Vlerat dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit" sipas dimensioneve dhe kritereve të SAI.

*Parimi 12: Ngritja e kapaciteteve përmes promovimit të të mësuarit dhe shkëmbimit të njohurive.*

Dimensio	Baza për vlerësim	Vlerësimi
SAI duhet të promovojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional që kontribuon në përsosmërisë individuale, të grupit dhe organizative.	<p>Praktikat e zhvillimit profesional të SAI-t duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:</p> <p>a) SAI zhvillon dhe zbaton një plan për zhvillim profesional dhe trajnim i cili përmban:</p> <p>I. Hyrje dhe familjarizimi me stafin e ri;</p> <p>II. Trajnime të brendshme mbi politikat dhe proceset e SAI-t;</p> <p>III. Trajnime për aftësitë personale (p.sh. aftësi komunikimi dhe shkrimi, aftësi analitike, aftësi prezantimi, aftësi intervistimi, etikë, mbikëqyrje);</p> <p>b) Plani vjetor i SAI-t për zhvillim profesional dhe trajnim është:</p> <p>I. në linjë me strategjinë e burimeve njerëzore;</p> <p>II. i lidhur me qëllimet/objektivat e përcaktuara në planet strategjike dhe operacionale të SAI-t;</p> <p>III. i bazuar në ose lidhur me nevojat për trajnim të identifikuar në vlerësimet e performancës së stafit.</p> <p>c) SAI ka procedura ose praktika për</p>	<p>3.</p> <p>Ka një plan zhvillimi dhe një plan vjetor.</p> <p>Sfidë mbetet trajnimi më i diferencuar me qëllim aplikimin e trajnimeve që marrin parasysh specifikat individuale profesionale si dhe përcaktimi i planit të zhvillimit personal.</p>

<p>SAI duhet të ketë një strategji të zhvillimit profesional, duke përfshirë trajnimin, që është i bazuar në nivelet minimale të kualifikimeve, përvojës dhe kompetencës së nevojshme për të kryer punën e SAI-t.</p>	<p>përzgjedhjen e stafit për të marrë pjesë në trajnime dhe të marrin kualifikime profesionale të përcaktuara, dhe zgjedhja është e bazuar në aplikimet dhe konsideratat e kompetencave të nevojshme.</p> <p>d) Të gjithë punonjësit profesionistë (udhëheqësit, menaxherët, audituesit, etj.) duhet të kenë një plan zhvillimi të bazuar në një vlerësim vjetor dhe zbatimi i planit duhet të monitorohet.</p> <p>e) Ekzistojnë mekanizma për të monitoruar dhe vlerësuar rezultatin e zhvillimit profesional dhe trajnimin e stafit.</p> <p>Për zhvillimin profesional dhe trajnimin në disiplinat përkatëse të auditimit, SAI duhet të:</p> <p>a) identifikojë profesionet e "auditimit" ose "kuadrot" që dëshiron të zhvillojë në mënyrë që të ushtrojë mandatin e tij;</p> <p>b) caktojë përgjegjësitë për zhvillimin e çdo profesioni apo kuadrit të një personi apo personave me përvojë dhe autoritet të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm në SAI;</p> <p>c) zhvillojë kërkesat të përshtatshme për kompetencat e dhura për nivelet e ndryshme të stafit në çdo profesion apo kuadro;</p> <p>d) hartojë dhe zbatojë një plan zhvillimi profesional dhe trajnimi në çdo profesion apo kuadrove, që mbulon, sipas rastit:</p> <p>I. Trajnim i brendshëm mbi standardet e auditimit, politikat dhe procedurat e SAI-t</p> <p>II. Mësimi në punë dhe skemat e mbikëqyrjes/udhëzimit;</p> <p>IV. Trajnimi profesional ose</p>	<p>4.</p> <p>Trajnimi është realizuar në nivel të diferencuar për audituesit e rinj dhe për ata më me eksperiencë.</p>
---	--	--

<p>12.3. SAI-t duhet të përpiqen të sigurojnë që personeli i tyre ka kompetenca profesionale dhe mbështetjen e kolegëve dhe të menaxhimit për të bërë punën e tyre.</p>	<p>akademik/anëtarësimi i organeve përkatëse profesionale ose akademike;</p> <p>IV. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional.</p> <p>Përzgjedhja e stafit realizohet përmes testimeve me shkrim dhe verbale.</p> <p>Stafi trajnohet në forma të ndryshme me seminare, trajnime ballë për ballë dhe kontakteve të drejtpërdrejta.</p>	<p>3</p> <p>Mbetet si sfidë mundësia më e lartë për një feedback, informacioni si të nivelit të trajnuesit ashtu edhe e të trajnuarit.</p>
<p>12.4. SAI duhet të nxisë shkëmbimin e njohurive dhe ngritjen e kapaciteteve në mbështetje të dorëzimit të rezultateve.</p>	<p>Rezultatet e auditimit publikohen në faqen zyrtare, të aksesueshme nga të gjithë audituesit. Organizohen seminare ku shkëmbehet eksperiencia dhe botohen artikuj mbi punimet më të mira audituese. Janë organizuar auditime në të ftohtë rezultatet e të cilëve i janë komunikuar audituesve.</p>	<p>4</p> <p>Niveli i përfaqësimit dhe informimit është i lartë.</p>
<p>12.5. SAI duhet të përfitojë nga puna e të tjerëve, duke përfshirë edhe SAI-t kolegë, INTOSAI dhe grupet rajonale përkatëse të punës.</p>	<p>Janë organizuar trajnime jashtë në bashkëpunim me SAI homologe ku pjesëmarrja është mbi 90% e stafit. Burimet e trajnimit janë nga më të larmishmet.</p>	<p>3</p> <p>Mbetet si alternative realizimi i një vetëvlerësimi mes kolegësh, apo <i>peer review</i> me SAI homologe</p>
<p>12.6. SAI-t duhet të përpiqen për të bashkëpunuar me profesionin e auditimit në mënyrë që të rrisin</p>	<p>Janë lidhur marrëveshje si ajo me Institutin e Ekspertëve Kontabël, Shoqatën e Kontabilistëve dhe Financierëve, Institutit Shqiptar të Shkencave, etj.</p> <p>Janë angazhuar ekspertë të jashtë për trajnim</p>	<p>4</p>

profesionin.	të stafit auditues.	
12.7. SAI-t duhet të përpiqen të marrin pjesë në aktivitete të INTOSAI-t dhe të ndërtojnë rrjete me institucionet e tjera dhe SAI relevante, për të mbajtur të ngritur vëmendjen ndaj çështjeve të reja dhe për të nxitur shkëmbimin e njohurive për të përfituar nga SAI-t e tjera.	KLSH ka marrë pjesë në kongrese dhe konferenca shkencore të INTOSAI dhe EUROSAI-t në nivele angazhimi të larta.	4 Niveli i lartë i përfaqësimit



15. ETIKA DHE INTEGRITETI NË KLSH

*Referues: Miranda HAXHIA – Audituese e lartë, anëtare e Komisionit Ad-hoc të Etikës në KLSH,  
Bashkim SPAHIJA – Ish-auditues, anëtar i Komisionit Ad-hoc të Etikës në KLSH,  
Ibrahim NDREU – Përgjegjës Sektori, Kryetar i Komisionit Ad-hoc të Etikës në KLSH.*



Matja e performancës së SAI-ve (institucioneve supreme të auditimit) në bazë të dimensioneve të vlerësimit minimumi është, hartimi i një instrumenti rregullator për organizimin e brendshëm të tij. Në zbatim të kërkesave të ISSAI 30, Kodit Ndërkombëtar të Etikës për audituesit në sektorin publik, sipas të cilave “është përgjegjësi e SAI-t të zhvillojnë Kodin etik në përshtatje me mjedisin” u hartua Kodi Etik i KLSH-së.

Bazuar dhe në kërkesat e nenit 37 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, sipas të cilit “Punonjësit e KLSH-së duhet të ushtrojnë

*detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj, ..... dhe në Kodin e Etikës”, me Vendimin nr.56, datë 30.4.2015 të Kryetarit të KLSH u miratua Kodi Etik i Kontrollit të Lartë të Shtetit.*

Përgatitja dhe miratimi i një Kodi Etike për KLSH-në, është fryt i një pune këmbëngulëse dhe nxitje për t’ju përgjigjur kërkesave të kohës, si domosdoshmëri e nevojës për rishikimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe konkretisht ISSAI 30, Kodit të Etikës. Një rol të rëndësishëm në risitë që solli ky kod në përmbajtjen e tij, ka luajtur dhe KLSH, si pjesë përbërëse e grupit të punës, krahas SAI-ve të tjera, për rishikimin e Kodit Etik të INTOSAI-t, ISSAI 30. KLSH dha kontributin e saj duke propozuar draftin për trajtimin e parimit “Kompetenca profesionale”, që u mirëprit nga anëtarët e SAI-ve të tjera, anëtarë të INTOSAI-t.

*Çfarë është dhe çfarë përmban Kodi i Etikës në përgjithësi bazuar në parimin e ISSAI 30?*

Ai është një deklaratë gjithpërfshirëse e vlerave dhe parimeve, të cilat duhet të udhëheqin punën e përditshme të audituesve. Ky kod duhet të marrë parasysh kërkesat etike të nëpunësve civilë në përgjithësi dhe kërkesat e vaçanta të audituesve duke përfshirë detyrimet profesionale të tyre.

Rëndësi themelore e një SAI, është të shihet me besim, ku etika dhe besueshmëria duhet të jetë jashtë çdo dyshimi, prandaj kërkohet vendosja e standardeve të larta etike për audituesit publikë. Të gjitha këto standarde duhet të promovohen nga audituesit, duke zbatuar kërkesat etike të koncepteve të integritetit, pavarësisë, objektivitetit dhe kompetencës. SAI duhet të shihet nga të gjithë me një ndjenjë besimi, sigurie dhe kredibilitetit.

Përmbajtur këtyre parimeve dhe vlerave, Kodi i Etikës së KLSH-së në veçanti, përcakton standardet etike si dhe ofron udhëzime e kërkesa të nevojshme për tu zbatuar nga punonjësit e KLSH, me synim që gjatë veprimtarisë së tyre, të reflektojnë parimet dhe vlerat themelore të funksionimit të një Institucioni Suprem Auditimi.

Audituesit shtetërorë të KLSH-së janë përgjegjës për reputacionin e institucionit dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre duhet të “udhëhiqen sipas shembullit” e të jenë “model të integritetit”. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm se sjelljet e tyre, kanë një impact të fortë në mënyrën se si perceptohet institucioni, si ndikojnë në forcimin e autoritetit dhe kredibilitetit institucional dhe për pasojë në perceptimin e aktivitetit të KLSH-së si një vlerë, dobi dhe e mirë e përbashkët për të gjithë qytetarët. Për këtë qëllim, Kodi Etik i KLSH-së pajis audituesit me një bashkësi parimesh, vlerash dhe standardesh, në të cilat bazohet sjellja etike e tyre në funksion të përmbushjes së pritshmërive të palëve të interesuara.

Kodi i Etikës, ashtu sikurse i gjithë kuadri ligjor rregullator i veprimtarisë menaxheriale audituese të KLSH-së, duhet të lexohet dhe zbatohet në lidhje organike me to. Për pasojë, është detyrim i çdo audituesi, që në përmbushje të detyrave të tij, të zbatojë standardet dhe kërkesat etike në nivelin e përcaktuar në këtë kod, çdo devijim do të konsiderohet shkelje e këtij kodi.

Në zbatim të Kodit të Etikës në KLSH, me Vendim të Kryetarit të KLSH-së është ngritur Komisioni i Etikës, i cili funksionon si një organizëm ad-hoc i gjyqimit

profesional. dhe përbëhet nga 3anëtarë. Komisioni trajton, verifikon, këshillon dhe u jep zgjidhje çështjeve, dilemave, ankesave që kanë të bëjnë me zbatimin e kërkesave të këtij kodi parashikuar nga nenet 13, 17, 21, 22. Referuar funksionit të tij ad-hoc, Komisioni i Etikës për vitin 2015, ka marrë në shqyrtim raste të thyerjes së Kodit Etik të KLSH-së dhe në bashkëpunim me Sektorin e Etikës dhe Integritetit, i cili ka kryer 711 inspektive në drejtim të zbatimit të Kodit Etik, ka propozuar për 14 raste, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore. Ndër to përmendet dhe një rast i shkeljes së paanshmërisë dhe neutralitetit politik, si pasojë e deklarimeve në media që dëmtojnë reputacionin e institucionit.

Shpesh në punën audituese ndeshemi me dyshime (dilema), të cilave duhet ti jepet një zgjidhje vetë ose me ndihmën e kolegëve, drejtuesve duke dhënë përgjigje pyetjeve të tilla: a është vendimi ose sjellja ime në përputhje me ligjin, standardet ndërkombëtare të auditimit dhe me Kodin Etik të KLSH-së ose çfarë efekti do të ketë vendimi apo sjellja ime për mua, kolegët, për KLSH-në ose institucionet e tjera?

Në ndihmë për të dhënë përgjigjen e duhur për këto pyetje dhe të tjera të këtij lloji, është dhe aneksi "Shënime Shtesë: Zgjidhja e dyshimeve (dilemave) lidhur me zbatimin e Kodit Etik të KLSH-së e cila është pjesë integrale e këtij Kodi.

Që një SAI të shihet me besim, audituesit duhet të zbatojnë kërkesat etike të një koncepti tjetër, siç është koncepti i integritetit. Nëpunësit civilë dhe për rrrjedhojë audituesit shtetërorë që janë të tillë, veprojnë me integritet në ato raste kur zbatojnë vlerat dhe standardet e një administrimi të mirë. Integriteti mbulon jo vetëm kërkesat e moskorrupsionit, por dhe vlera të tilla si ndershmëria, sinqeriteti, konsiderata, respekti, mirësjellja, etj. Për rrrjedhojë, integriteti është një product i administrimit të mirë dhe praktikave të mira të punësimit. Integriteti është parakusht për performancën e vazhdueshme dhe efektive të sektorit publik. Një qeveri, apo një organizatë të cilës i mungon integriteti humbet besimin e publikut duke çuar në humbjen e autoritetit për vetveten. Standardet e larta të integritetit dhe transparencës në punën e përditshme të një SAI rrisin rolin e tij si institucion model për përgjegjshmërinë. Ligji është kufiri i poshtëm dhe pikënisja minimale morale. Rregullat dhe ligjet nuk mund të mbulojnë të gjitha situatat. Tensioni më i lartë është atje ku rregullat mungojnë ose janë të pasigurta. Në situatë të tilla audituesit duhet të jenë në gjendje të krijojnë një opinion të pranueshëm moralisht dhe të veprojnë me përgjegjësi në përputhje me vlerat dhe standardet e një administrimi efektiv.

Pikërisht në kuadrin e përpjekjeve për zhvillimin e institucioneve dhe mekanizmave për promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në sektorin publik, KLSH ka vënë në dispozicion të audituesve të sektorit publik, një botim specifik që i përket metodologjisë së vetëvlerësimit të integritetit në institucionet supreme të auditimit (INTOSaint). Manuali i vetëvlerësimit i përgatitur nga Gjykata e Auditimit të Holandës fillimisht u projektua për organizatat e sektorit publik në përgjithësi dhe më tej u përshtat për të përmbushur nevoja specifike të Institucioneve Supreme të Auditimit.

KLSH, aplikoi në praktikë për herë të parë vetëvlerësimin e integritetit të saj institucional në vitin 2014, duke mundur cënueshmërinë dhe elasticitetin ndaj shkeljeve të integritetit dhe rekomandoi masa për përmirësimin e menaxhimit të integritetit.

## 16. KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA

*Referues: Irena ISLAMI – Drejtore Drejtorie,  
Amantja PATOZI – Specialiste/Audituese e parë,  
Alma SHEHU – Audituese e parë.*



Në zbatim të planit strategjik të zhvillimit të institucionit, DKBMJ ka ndjekur dhe realizuar objektivat e vendosura në fushën e komunikimit, botimeve, marrëdhënieve me partnerët vendas dhe të huaj, me qytetarët, median, aktivitetet e rëndësishme vjetore të KLSH-së si konferencat, analizat, 90 vjetorin e institucionit, etj.

Transparenca e aktivitetit të KLSH-së është një nga treguesit kryesorë të modernizimit të institucionit dhe të komunikimit të tij shumë dimensional sepse ajo rrit besimin e qytetarëve

ndaj institucionit dhe ndihmon në shmangien e ndikimit të interesave personale në punën e tij. Komunikimi luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm për të nxitur transparencën, veçanërisht në aspektin e konsultimit me qytetarët, të cilët nëpërmjet aksesit që kanë në informacion njohin vendim-marrjen e institucioneve dhe mund të shprehin pikëpamjet e tyre për çështje me interes për ta.

### Botimet

KLSH vjen në katër vitet e fundit 2012-2015 me një kolanë botimesh prej 51 titujsh. Çdo vit dinamika e botimeve të institucionit rritet me 10 përqind, duke ruajtur cilësinë, thellësinë e analizës, gjerësinë e informacionit dhe plotësinë e mesazheve të përmbajtura në çdo titull dhe përmbajtje libri. Botimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, krahas regjistrimit besnik të përmbajtjes së auditimeve të institucionit, të gjetjeve dhe rekomandimeve të çdo auditimi kryesor, përçojnë drejtimet strategjike të reformimit të tij, që janë rritja e kontributit për përmirësimin e qeverisjes publike, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit dhe ngritja e kapaciteteve të audituesve të KLSH-së në nivelin e një audituesi modern evropian.

Gjatë vitit 2015, Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë ka vijuar me sukses punën në këtë drejtim, duke i shtuar 35 botimeve të viteve 2012-2014, 16 botimet e 2015, me titujt e mëposhtëm:

- Analiza vjetore e punës 2014;
- Raporti vjetor i Performancës, KLSH 2014 (shqip/anglisht);
- Revista kërkimore shkencore "Auditimi Publik" nr. 9, 10 dhe 11 (shqip/anglisht);
- Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës;
- Indikatorët e performancën;
- Standardet e Auditimit të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (GAO);
- Manuali i Auditimit të IT;
- COBIT 4.1, Objektivat e Kontrollit për IT;
- Konferenca e tretë Shkencore e KLSH-së (anglisht);
- 90 vjet KLSH, ceremonitë dhe aktivitetet;
- ALBUM, 90 vjet KLSH;
- Kodi i Etikës së INTOSAI-t (ISSAI 30), Kodi i Etikës së Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA) dhe Kodi i Etikës së KLSH-së;
- Audituesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm, volumni III dhe volumni IV.

Ndër këta tituj vlen të veçojmë tre numra të *Revistës Shkencore "Auditimi Publik"*, e cila arriti në numrin 11 të saj. Këtë vit kanë vijuar bashkëpunimin me ne për realizimin e Revistës personalitete të fushës së Ekonomisë nga vendi si dhe personalitete të njohura dhe me eksperiencë nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) nga vende të rajonit e më gjerë, si Prof.Ass.Dr.Recai Akyel, zv.President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Logarive; z. László Domokos, President i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Hungarisë, auditues nga SAI Kroat, nga Gjykata Gjermane e Auditimit, Prof.Dr. Ilia Kristo, Prof. Dr. Hysen Çela, Prof. Asoc. Adriatik Kotorri, auditues të KLSH-së, etj.


BOTIMET e KLSH-së 2012-2015







Me fokus në edukimin profesional të audituesve publikë, KLSH sjell tek lexuesit e interesuar, që përfshijnë jo vetëm audituesit por dhe studentët, profesionistë të fushave të tjera të lidhura më auditimin, botimin e Standardeve të Auditimit të Qeverisë së SHBA, rishikim i vitit 2011, si udhëzues të këshillueshëm për t'u lexuar, studiuar dhe përdorur kur është e përshtatshme, pasi parimet dhe udhëzimet që ky botim sjell janë një prej praktikave më të zhvilluara ndërkombëtare të auditimit shtetëror, ato të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA.



KLSH do të vijojë të pasurojë kolanën e botimeve të tij edhe për vitin 2016, gjatë të cilit janë parashikuar të botohen 16 tituj dhe janë përcaktuar tashmë 14 prej tyre:

- Revista "Auditimi publik" nr. 12 (shtator-dhjetor 2015);
- Audituesit e KLSH-së në Shtypin e përditshëm, Volumi V (korrik-dhjetor 2015);
- Analiza vjetore, 2015;
- Konferenca e IV-t Shkencore e KLSH-së;
- Revista "Auditimi publik" nr. 13 (janar-prill 2016);
- Raporti Vjetor i Performancës, KLSH 2015;
- Audituesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm, Volumi VI (janar-qershor 2016);
- Revista "Auditimi publik" nr. 14 (maj-gusht 2016);
- Direktiva 2014/24 /BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të BE-së, e datës 26 shkurt 2014 mbi *Prokurimin Publik*;
- Korniza e matjes së Performancës së SAI-ve;
- SAI dhe Parlamenti (partneriteti);
- Botimi i ISSAI-ve, 1- 400;
- Auditimet e Performancës në KLSH, 2012-2015;
- 4 vjet të Revistës Shkencore "Auditimi Publik", 2012-2015.

Botimi i librave ka sigurisht edhe kosto financiare. Çdo libër është mesatarisht 250 faqe dhe tirazhi mesatar është 250 kopje/botim. Fatura financiare është 480 lekë/kopje ose 120,000 lekë/botim.

Ne po punojmë dhe jemi të bindur që KLSH do ti realizojë objektivat ambiciozë që i ka vendosur vetes në fushën e botimeve, si pjesë integrale e zbatimit të strategjisë 2013-2017 (rishikuar për periudhën 2015-2017) për rritjen e transparencës dhe komunikimit me publikun, me qëllim modernizimin e institucionit.

### Projekti IPA

Në kuadër të asistencës për Shqipërinë dhe të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit, IPA 2013, komponenti i I-rë, KLSH ka fituar një financim nga Bashkimi Evropian për *“Forcimin e kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm”* me vlerë 2.11 milion euro. Ky projekt binjakëzimi është ndër 7 projektet e përzgjedhur nga BE për t’u implementuar në mënyrë të decentralizuar nga institucionet e shtetit shqiptar dhe DKBMJ do të veprojë si homolog për partnerin e binjakëzimit.

Ky projekt i financuar nga BE, me kohëzgjatje 2 vjeçare pritet të fillojë shumë shpejt dhe është pa diskutim një mbështetje e fortë por është njëkohësisht edhe një nga sfidat e radhës së KLSH-së, i cili ka treguar në vitet e fundit që po punon fort dhe po realizon cilësisht objektivat e tij, duke ecur në mënyrë të sigurt në rrugën e tij të modernizimit, atë të realizimit të *Auditimeve* të tij në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe praktikat më të mira të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Disa nga output-et e këtij projekti janë:

- Udhëzues për institucionalizimin e marrëdhënieve mes SAI-t dhe parlamentit;
- Ngritja e një sistemi IT për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së;
- Rishikimi i Manualit të Auditimit Financiar dhe të përputhshmërisë, si edhe ai i Auditimit të Performancës;
- Auditime të përbashkëta;
- Auditime pilot;
- Rishikimi i Politikave të Burimeve Njerëzore;
- 6 vizita studimore, në Poloni, Kroaci, Holandë, ECA ( me 12-15 auditues);
- Trajnime, etj.


KLSH, si institucioni përfitues i projektit ka parashikuar në buxhetin e tij të vitit 2016 pjesën e bashkëfinancimit dhe ka ngritur strukturat përkatëse në KLSH që do

të merren me menaxhimin dhe implementimin e projektit, duke bashkëpunuar gjithashtu me Ministrinë e Integritimit dhe me drejtorinë e Kontraktimeve dhe Financimeve në Ministrinë e Financave, në mënyrë që të përmbushë në kohë dhe me cilësi të gjitha detyrat në etapat e ndryshme të implementimit të projektit.

### Komunikimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka një një qasje krejt të re ndaj komunikimit me publikun, referuar edhe standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, sipas të cilëve": ... *Një SAI i pavarur, efektiv dhe i besueshëm është një komponent thelbësor në një sistem demokratik, ku përgjegjshmëria, transparenca dhe integriteti janë pjesë e domosdoshme e një demokracie të qëndrueshme...* (ISSAI 12, "Vlerat dhe dobitë e SAJ-ve - sjellja e ndryshimeve në jetën e qytetarëve), dhe ka rritur gradualisht transparencën e veprimtarisë së tij, duke arritur në fund të vitit 2015 që të jetë i pranishëm 6.6 herë më shumë me informacione dhe mesazhe në median e shkruar dhe të pesëfishojë prezencën e tij në median audiovizive, krahasuar me vitin 2010.

Gjatë 2015, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat tona për shtyp me një numër prej 922 artikuj, njoftime, editorialë dhe komente analitike, përkundrajt 867 gjithsej përgjatë 2014, ose 7% më shumë. Gazetarët u janë përgjigjur prononcimeve tona, problematikave të dala nga auditimet e ushtruara nga ana jonë dhe aktiviteteve të ndryshme gjatë këtij viti. Transparenca e veprimtarisë së KLSH-së po rritet nga viti në vit dhe ne jemi gjithnjë e më të hapur e bashkëpunues me median. Kjo evidentohet lehtëazi edhe nëpërmjet shifrave të grafikut të mëposhtëm:



Prezenca e audituesve të KLSH-së në shtypin e përditshëm nuk është më një risi për KLSH-në, por është rrjedhë normale e punës për audituesit, që gjetjet dhe rekomandimet e tyre kryesore të mund t'i shtjellojnë me shkrime dhe analiza në shtypin e përditshëm. Nga blogjet mbi temat që kanë zgjedhur për të dalë në publicistikën shqiptare dhe mënyrën e shtrimit të problemeve dhe zgjidhjet që japin, audituesit marrin ide dhe shtytje për shkrime të tjera.

Kjo është arsyeja që vëllimi i fundit i pranisë së audituesve të KLSH në shtypin e shkruar përmban gjithnjë e më shumë shkrime konkrete për problematikat që hasen më shpesh në jetën e përditshme të qytetarit që merr shërbime publike, por dhe që janë më të mprehtat, të cilat janë evidentuar nga auditimet e vitit të kaluar. Gjatë 2015, ne kemi qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetat me 116 shkrime shkrime, të shkruara nga 50 auditues të KLSH-së. Gjatë tri viteve, 2012-2015 audituesit e KLSH kanë botuar 375 artikuj.

Shkrimet e botuara gjatë viteve 2013, 2014 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2015 janë botuar tashmë në 4 vëllime, me titull "Audituesit e KLSH-së në median e shkruar". Brenda tre mujorit të parë të këtij viti, do të botohet volumi i V-të që i përket shkrimeve të botuara në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2015. Të katërta vëllimet janë pjesë e kolanës së botimeve të KLSH-së.

KLSH nxjerr çdo tre muaj buletinin statistikor, në të cilin përfshihen dëmi ekonomik i konstatuar, të ardhurat e munguara, masat disiplinore dhe administrative të rekomanduara, si edhe kallëzimet penale të dorëzuara në Prokurori, për auditimet e përfunduara në periudhat respektive.

Interneti është sot zemra e komunikimit për të gjitha institucionet moderne sepse është i prekshëm nga të gjithë dhe është shumë efikas.

Për këtë arsye, faqja jonë e WEB-it është dritarja kryesore e komunikimit tonë me qytetarët sepse u jep atyre mundësinë që të kenë akses të drejtpërdrejtë në informacion dhe të informohen shpejt lidhur me çështjet që ju interesojnë.

KLSH ka rritur bashkëpunimin dhe partneritetin me organizatat e shoqërisë civile në kryerjen e vrojtimeve dhe analizave të përbashkëta për nivelin e korrupsionit dhe shkallës së transparencës në administratën publike.

Nën shembullin e SAI-ve të zhvilluara evropiane dhe në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, të parimeve të transparencës së plotë dhe integritetit, mbështetur në standardin ISSAI 5600 "Udhëzim për Rishikimin mes

Kolegëve”, KLSH po përpiket të angazhojë partnerë të ndryshëm (SAI dhe OJF të fushës) në mini “Peer Review”, me qëllim përmirësimin e punës në drejtime të caktuara.

Në vijim të eksperiencës pozitive që kemi pasur në këtë drejtim në 2014, gjatë të cilit kemi realizuar katër *Mini Peer Review*, përkatësisht me Lëvizjen Europiane Shqipëri, KKK, Institutin “G&G” Group dhe Gazetën Ekonomia. Në vitin 2015 “Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë”, në bashkëpunim me USAID-in kanë realizura projektin “Forcimi i Ligjit përmes zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së”, i cili mund të konsiderohet pa dyshim një *Mini Peer Review* e mirëfilltë.

Raporti final i këtij projekti dhe rekomandimet e dhëna për KLSH-në, në drejtim të përmirësimit të punës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së janë profesionale dhe dobi prurëse për ne. Si institucion jemi duke hartuar një plan veprimi të detajuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ana e OTIL.

Të gjitha këto projekte janë parë si *Mini Peer Review* dhe kanë nxjerrë produkte konkrete të bashkëpunimit me OJF-të, ku janë evidentuar përveç arritjeve dhe mangësitë e dobësitë. Të gjitha rekomandimet e dhëna nga këto organizata do të shikohen me prioritet nga KLSH me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen.

Gjithashtu, KLSH iu përgjigj pozitivisht vitin e kaluar kërkesës së INTOSAI-t, drejtuar të gjithë Institucioneve Supreme të Auditimit, anëtarë të kësaj organizate, nëpërmjet së cilës i ftonte që të ishin pjesë e një Peer Review për pavarësinë e SAI-ve. Kontrolli i Lartë i shtetit u vetëofrua për të qënë pjesë e këtij procesi, duke vlerësuar si parësore pavarësinë e SAI-ve për realizimin e misionit të tyre.

Kontrolli i Lartë i Shtetit është përzgjedhur nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit si përfaqësues i EUROSAT-t për të realizuar këtë proces. Procesi do të realizohet nga auditues të Gjykatës Austriake të Auditimit, në periudhën 8 -19 shkurt 2016 dhe janë marrë të gjitha masat që ky proces të realizohet në kohë dhe me transparencë të plotë. Peer Review do të sigurojë KLSH një informacion të pavarur lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitetit të tij me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 1, 10, 11 dhe 12.

Gjatë vitit 2015, ne kemi lidhur marrëveshje bashkëpunime me Komitetin Shqiptar të Helsinkit edhe me Organizatën “Integrimi Urban”, duke e çuar në 18 numrin e partnerëve tanë me të cilët kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

Në datën 19 shkurt 2015, në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH-së dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit, përfaqësuar nga zj. Vjollca Meçaj, Drejtoresh Ekzekutive dhe z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së.

Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, KLSH do të angazhohet të bashkëpunojë me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, si një prej OJF-ve më me eksperiencë, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe më gjerë.

Bashkëpunimi do të jetë me veprimtari dhe projekte konkrete. KLSH ka qenë në vazhdimësi i hapur për bashkëpunime të tilla dhe ka eksperiencën të mira në këtë drejtim dhe me OJF të tjera, kryesisht në katër vitet e fundit. Nënshkrimi i marrëveshjes me Komitetin Shqiptar të Helsinkit e plotëson këtë kuadër dhe është një vlerë më tepër në këtë drejtim sepse fusha e aktivitetit të këtyre organizatave është e ndryshme dhe plotësojnë në mënyrë të natyrshme njëra tjetrën.

Nëpërmjet realizimit të kësaj marrëveshjeje, KLSH është në përmbushje të detyrave për ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e standardave profesionale në auditim, nëpërmjet trajnimeve, workshop-eve dhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta.

Në datën 1 tetor 2015, në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH-së dhe organizatës jo-fitim prurëse "Integritet Urban", përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv i saj, z. Artur Çani.

Në zbatim të marrëveshjes me organizatën "Integritet Urban", KLSH është angazhuar dhe do të angazhohet për shkëmbimin e të dhënave me interes reciprok, duke hapur edhe një dritare tjetër komunikimi me publikun me qëllim rritjen e transparencës dhe modernizimin e institucionit. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi do të krijohet mundësia e shfrytëzimit të të dhënave të ndryshme të publikuara nga "Integritet Urban", të cilat mund të shërbejnë si indicie për fillimin e auditimeve nga ana e KLSH-së.

Bashkëpunime me profesoratin e Universiteteve, me Organizatat e Profesionistëve të fushës dhe me OJF-të ka përvijuar ngushtë edhe përgjatë vitit 2015, duke vlerësuar maksimalisht kontributin e tyre për Revistën Shkencore të KLSH-së, Konferencat Shkencore të KLSH-së, trajnimet, rekrutimet e stafit, etj. Një shembull konkret është edhe zhvillimi i analizës vjetore për vitin 2014 në ambientet e Universitetit "Ismail Qemali", në Vlorë dhe zhvillimi i analizave të punës të Departamenteve të Auditimit, në fund të vitit 2015, në Universitetet Publike në

rrethe të ndryshme të vendit, si në: Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan; Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë; Universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër dhe në Universitetin e Tiranës.

Në rritjen e transparencës dhe informimin e publikut një rol të pazëvendësueshëm kanë luajtur botimet e KLSH-së, të cilat kanë arritur shifrën 51 botime në katër vjet.

Intensifikimi dhe rritja cilësore e komunikimit të KLSH-së ka sjellë rezultate, veçanërisht në rritjen e vëmendjes së medias për raportet e auditimit dhe për institucionin në tërësi, si edhe në rritjen e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucionit.

KLSH është shumë e hapur edhe ndaj ankesave të qytetarëve, të cilat na adresohen me postë të zakonshme ose elektronike. Këto letër-ankesa të qytetarëve, administrohen me profesionalizëm nga punonjësit e KLSH-së në funksion të tematikës që trajtojnë dhe qytetarët marrin në çdo rast përgjigje për shqetësimin e ngritur, me përjashtim të rasteve kur çështjet e ngritura nuk janë kompetencë e KLSH-së. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka trajtuar gjatë 2015, 382 *letra dhe ankesa*, për probleme të ndryshme, nga të cilat 130 *rezultuan jashtë kompetencave dhe juridiksionit të institucionit*. Nga 252 kërkesa dhe ankesa në kompetencë të KLSH, 143 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigja përkatëse, ndërsa 109 janë në procesin e verifikimit.

Në zbatim të planit të Zhvillimit strategjik të institucionit dhe me mbështetjen e projektit IPA të BE-së, KLSH do të ripunojë strategjinë e tij të komunikimit për të qenë sa më pranë Kuvendit, publikut dhe medias, duke sjellë vazhdimisht ide të reja, të cilat janë domosdoshmëri për të qenë inovativë, atraktivë dhe në koherencë me ndryshimet e shpejta të TI.

KLSH, siç u theksua, edhe në Kongresin YOUNG EUROSAI, do të përdorë gjithnjë e më shumë mjetet moderne të komunikimit si Facebook, Twitter, forumet e diskutimit *on line*, komunikimin e thjeshtë dhe konciz, sepse sot është koha e përcjelljes së shpejtë dhe e vizualizimit të informacionit.

### Bashkëpunimi me SAI-et partnere dhe me ndërkombëtarët

Në zbatim të të gjitha orientimeve dhe realizimit të objektivave të dhëna nga Kryetari i KLSH-së, për vitin 2015, janë ndjekur të gjitha procedurat për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të përcaktuara ku veçojmë vizitat dhe pjesëmarrjen e Kryetarit të KLSH në aktivitetet e mëposhtme:

Takim pune në zyrat e Auditimit të Qeverisë të SHBA, me z.Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i GAO-s;

- Pjesëmarrjen në Simpoziumin e 23-të, të UN/INTOSAI, në Vjenë;
- Pjesëmarrjen në Konferencën e EUROSAT/OLACEFS, në Quito, Ekuador;
- Pjesëmarrjen në Konferencën e V-të të EUROSAT-ARABOSAI, më datat 7-9 dhjetor 2015, në Doha, Katar;

Pjesëmarrja në Konferencën e 10-të "Mbi Menaxhimin e Borxhit" të Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD);

- Vizita Zyrtare në SAI-n Kroat;
- Vizitë zyrtare në SAI-n Polak;
- Konferenca e 7 vjetore e ZAP-it të Kosovës, etj.

Përgjatë vitit 2015 shumë personalitete të EUROSAT-t kanë vizituar KLSH-në dhe kanë zhvilluar takime pune me Kryetarin e KLSH-së:

Z. Vitor Manuel da Silva Caldeira, President i Gjykatës Europiane të Audituesve;

Z. Josef Moser, President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t;

Z. Recai Akyel, zv.President i Bordit Drejtues të EUROSAT-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive;

Z. Ivan Klesić, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Kroacisë;

Z. Milan Dabović, President i Senatit të Institucionit Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi;

Z. Radoslav Sretenović, President i Institucionit të Auditimit Shtetëror të Serbisë;

Z. Milenko Sego, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Bosnje Hercegovinës;

Z. Wojciech Kutyla, zv.President i NIK-ut Polak dhe z. Jacek Jezierski, ish President i NIK-ut Polak;

Z. Cosmin Nicula, zv.President i SAI-t Rumun;

Z. Artan Venhari, zv.Auditues i Përgjithshëm i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës;

Z. Naser Ademi, zv.Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Maqedonisë, etj.





Foto në Sallën e Seancave Plenare të Kuvendit të Shqipërisë, gjatë Ceremonisë së kremtimit të 90 vjetorit të KLSH-së. Nga e majta në të djathtë: z. Milan Daboviç, President i Senatit të SAI-t të Malit të Zi; z. Naser Ademi, zv.Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Maqedonisë; z.Radoslav Sretenoviç, President i Institutit të Auditimit Shtetëror të Serbisë; z. Recai Akyel, zv.President i EUROSAT-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive; z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit; z.Josef Moser, President i Gjykatës Austriake të Auditimit (26 maj 2016).



Foto gjatë vizitës në Muzeun Arkeologjik të Durrësit. Nga e majta në të djathtë: Në rreshtin e parë: z.Recai Akyel, z. Vitor Manuel da Silva Caldeira, z.Milan Daboviç, z.Milenko Segò, z.Radoslav Sretenovic.Në rreshtin e dytë: z.Wojciech Kutyla, z.Fiqiri Kllari dhe delegacionet shoqëruese (26 maj 2015).



*Foto e marrë në ambientet e jashtme të Bashkisë Orikum, pas akordimit të titullit "Oytetar Nderi" të z.Vojciech Kutyla, zv.President i SAI-t polak dhe z.Jacek Jezierski, ish President i SAI-t Polak nga z. Gëzim Çapoj, Kryetari i Bashkisë Orikum, në foto janë dhe z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Këshilltarët e Bashkisë Orikum, Grupi "Jehona Labe", Delegacioni i SAI-t Polak dhe auditues të KLSH-së (24 maj 2015).*



*Kryetari i KLSH-së, z. Bujar LESKAJ me Grupin e Audituesve nga Kosova, në ambientet e Galerisë së Arteve në Tiranë (26 maj 2015).*

KLSH ka marrë pjesë në shumë grupe pune dhe aktivitete të organizuara nga INTOSAI dhe EUROSAI dhe konkretisht në grupin e punës për rishikimin e ISSAI 30

(Kodi i Etikës). KLSH ka qenë aktiv dhe ka paraqitur propozimet e tij në 3 takimet e zhvilluara gjatë vitit 2015. Versioni i përfunduar i ISSAI-t 30 do të paraqitet për miratim në Kongresin e ardhshëm të INTOSAI-t, që do të zhvillohet gjatë vitit 2016. Gjatë vitit 2015, KLSH ka marrë pjesë në dy takime të grupit Task Force të EUROSAI-it për "Auditimin dhe Etikën" (TFA&E). Në cilësinë e anëtarit të këtij grupi dhe të interesit në rritje të institucionit për këtë çështje, KLSH ka ndjekur gjithnjë me interes aktivitetet e këtij grupi pune të rëndësishëm të EUROSAI-t, i cili trajton një prej çështjeve më aktuale për administratën publike, etikën, e cila është e lidhur direkt me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Trajtimi i kësaj teme është me rëndësi prioritare për institucionet supreme të Auditimit, të cilat janë të ngarkuara me mbikëqyrjen e menaxhimit të shëndoshë të financave publike. KLSH ka qenë gjithashtu aktive dhe ka marrë pjesë në 2 Takimet e Grupit të punës për Auditimin e fondeve të alokuara për fatkeqësitë dhe katastrofat, në takimet e grupit të punës për auditimin e Mjedisit, në Grupin e Punës për auditimet IT, etj. Përgjatë vitit 2015, theksojmë pjesëmarrjen e KLSH-së në 59 aktivitete të rëndësishme si kongrese, konferenca, takime, seminare, trajnime, (këto të fundit edhe në kuadrin e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me SAI-et homologe), etj. Ndër më të rëndësishmet përmendim pjesëmarrjet në:

Takimin e Punës "Komisioni Stabilizim Asocimit" në Bruksel;

Seminarin mbi Integritetin dhe antikorrupsionin, zhvilluar në Hungari;

Kongresin mbi prokurimet publike në Slloveni;

Konferencën Young EUROSAI, zhvilluar në Izrael;

Trajnimet pranë TCA dhe NIK-ut polak;

Takimet për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta me vendet anëtare, kandidatë dhe parakandidatë për në BE, etj.

Përgjatë vitit 2015, ka vijuar bashkëpunimi i suksesshëm me SNAO-n dhe JWGAA. Kështu, audituesit e KLSH-së kanë marrë pjesë në sesionet e trajnimit të organizuar nga SNAO "Mbi Materialitetin dhe auditimet e mbështetura mbi përzgjedhjen e kampioneve", që u realizua në qytetin e Vlorës si dhe workshop-et mbi auditimet paralele të performancën dhe konkretisht mbi "Eficiencën e energjisë".

Mjaft i rëndësishëm dhe frytdhënës është dhe pjesëmarrja e audituesve të KLSH në trajnimet e organizuara nga Gjykata Turke e Llogarive, ku gjatë vitit 2015 u trajnuan 36 auditues (176 auditues në vitet 2012-2015).

Referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar me NIK-un Polak 24 auditues u trajnuan pranë këtij institucioni lidhur me tema që lidhen me llojet e ndryshme të auditimit që realizohen nga ky institucion.

Gjatë vitit 2015 kanë marrë pjesë në aktivitetet jashtë vendit 136 auditues ose 775 ditë në total, thënë ndryshe të gjithë punonjësit e KLSH-së kanë qenë të paktën një herë jashtë vendit (me përjashtim të audituesve që për arsye të ndryshme personale nuk mund të udhëtonin jashtë vendit).

Të gjitha këto aktivitete kanë ndikuar pa dyshim në rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH dhe gjithashtu kanë motivuar punonjësit në punën e tyre të përditshme sepse ndihen të vlerësuar për kontributin që japin në realizimin e objektivave të institucionit.

#### Internshipi i ECA-s dhe fellowship i GAO-s

Përfitim i statusit të vendit kandidat për nën BE, solli për KLSH-n edhe intensifikimin e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit konkret me ECA-n, Gjykatën Europiane të Audituesve. Një tjetër vlerë shtuar kjo për institucionin ku KLSH përfiton nga përvojat më mirë një prej institucioneve më prestigjioze evropiane. Për herë të parë, tre auditues të KLSH-së kanë qenë pjesë e strukturave të ECA-s për një periudhë 5 mujore, duke përfutur nga programet e internshipit të këtij institucioni, të drejtë për të kontribuar pranë departamenteve dhe drejtorive të ndryshme të ECA-s. Ky bashkëpunim po vijon dhe aktualisht një audituese e KLSH-së po e ndjek këtë program dhe gjatë vitit 2016 edhe tre auditues të tjerë të KLSH-së do të fillojnë në muajin mars internshipin pranë ECA-s.



Në kuadër të këtij bashkëpunimi të suksesshëm, z.Vitor Caldeira, President i ECA-s me ftesë të Kryetarit të KLSH-së, na nderoi me pjesëmarrjen e tij në ceremoninë e 90 vjetorit të KLSH-së, të zhvilluar në maj të vitit të kaluar.

KLSH ka rivendosur bashkëpunimin me GAO-n dhe në muajin mars të

këtij viti, një audituese e KLSH-së do të marrë pjesë në një fellowship 4 mujor pranë kësaj zyre, që do të jetë pa dyshim një eksperiencë pozitive dhe shumë dobi prurëse për ne.

## Kremtimi i 90 vjetorit të KLSH-së

Në datën 26 maj 2015, në sallën e Seancave Plenare të Kuvendit të Shqipërisë, u zhvillua ceremonia e 90 vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në këtë ceremoni morën pjesë personalitete të larta të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) nga Europa, drejtues të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) si dhe personalitete të larta të shtetit shqiptar, drejtues të Institucioneve të pavarura Shqiptare, deputetë, përfaqësues të OJF-ve, të profesionistëve të fushës së Ekonomisë dhe Auditimit dhe të Medias.

Ceremoninë e nderuan me pjesëmarrjen e tyre, z. Josef Moser, President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe njëkohësisht Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t, z. Vitor Caldeira, President i Gjykatës Europiane të Audituesve, z. Recai Akyel, zv. President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive, z. Ivan Klesic, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t kroat, z. Milan Dabovic, President i SAI-t të Malit të Zi, z. Milenko Sego, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Bosnje dhe Hercegovinës; z. Radoslav Sretenovic, President i SAI-t të Serbisë; z. Wojciech Kutyla, zv. President i NIK-ut Polak; z. Naser Ademi, zv. Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Maqedonisë, z. Cosmin Nicula, zv. President i SAI-t të Rumanisë, z. Artan Venhari, zv. Auditues i Përgjithshëm i ZAP-it të Kosovës, si dhe përfaqësues të institucioneve të rëndësishme të BE-së, si z. Robert Gielisse, nga DG Budget dhe z. Joop Vrolijk, SIGMA.



Një përshëndetje krejt e veçantë për 90 vjetorin e KLSH-së ishte ajo e z. Gene Dodaro, Kontrollorit të Përgjithshëm të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA, i cili nëpërmjet një video mesazhi i përcolli stafit të KLSH-së urimet për 90 vjetorin e institucionit.

Kujtesa institucionale e një organi kushtetues si KLSH është e një



rëndësie parësore për të lexuar drejt vlerat dhe kontributin e tij përgjatë viteve, por edhe gabimet dhe momentet e kthimeve prapa. Për këtë arsye të gjitha ceremonitë e organizuara me këtë rast janë përmbledhur në dy botime të KLSH-së të vitit 2015,

“90 vjetori i KLSH-së” dhe “Albumi i 90 vjetorit të KLSH-së”, të cilët na shërbejnë neve dhe audituesve që do të vijnë në të ardhmen për të njohur më mirë institucionin por edhe opinionit publik dhe qytetarëve për të kuptuar më mirë rolin e këtij institucioni të rëndësishëm kushtetues.

Objektivat për 2016

Realizimi i 16 botimeve të parashikuara për 2016, duke ruajtur dhe përmirësuar cilësinë e tyre do të vazhdojë të mbetet një prioritet për institucionin sepse ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve audituese, krahas rritjes së transparencës me publikun.

Për këtë vit janë parashikuar 16 botime, me të cilat kolona e botimeve të KLSH-së do të arrijë shifrën 67 dhe nëse ecim me këtë ritëm në fund të vitit 2018, kolana e botimeve të KLSH-së do të ketë 100 tituj.



Implementimi i IPA që sigurisht do të ketë edhe vështirësi, duke pasur parasysh që do të jetë viti i parë i aplikimit;

Realizimi i strategjisë së komunikimit të KLSH-së si output i IPA;

Vijimi i implementimi me projekte konkrete i marrëveshjeve të bashkëpunimit me OJF-të dhe shoqatat e Profesionisteve të fushës dhe realizimi i Mini Peer Review të tjera. Këtu mund të përmendim kërkesën që i kemi bërë së fundmi institucionit të Avokatit të Popullit, për realizimin e një mini Peer Review nga ky institucion. Duke pasur parasysh rolin dhe misionin e Avokatit të Popullit, ne i kemi propozuar që të realizojnë një Peer Review, duke dërguar një grup komisionerësh të Avokatit të Popullit në KLSH, që do të mund të trajtonin një nga tematikat e mëposhtme:

Vlerësimi dhe mënyra e trajtimit të letrave dhe ankesave të qytetarëve nga KLSH;

Vlerësimi i marrëdhënieve të punës në KLSH (rekrutimi, ngritjet në detyrë, karrierat profesionale, etj.), në këndvështrimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut, kuadrit ligjor në fuqi, etj.

Bashkëpunim konkret me përfaqësitë e Bankës Botërore dhe USAID-it në Shqipëri, për mundësinë e projekteve të përbashkëta për zhvillimin e kapaciteteve audituese;

Realizimi i Konferencës së katërt shkencore të KLSH-së, "Analiza e Riskut";

Ruajtja e nivelit të shkrimeve të Revistës Shkencore të KLSH-së dhe përmirësimi i tyre, duke qenë sfidantë në radhë të parë me veten, në mënyrë që revista të ruajë karakterin e saj shkencor dhe emrin që ka krijuar.

## 17. KONTROLLI I CILËSISË

*Referues: Koço SOKOLI – Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Standardeve,  
Pullumb BEQIRAJ – Auditues i lartë,  
Prof. Dr. Jorgji BOLLANO – Kryetar i Këshillit  
Kombëtar të Kontabilitetit.*



Në zbatim të ISSAI-t 40 "Kontrolli i cilësisë", Urdhërit të Kryetarit të KLSH-së, nr. 149, datë 03.12.2015 "Për Kontrollin e Sigurimit të Cilësisë", ndryshuar me Urdhërin nr.155, datë 17.12.2015, grupi i shqyrtimit të dosjeve të auditimit, përzgjodhi në mënyrë rastësore 44 dosje auditimi ose 27% të auditimeve të kryera dhe të evaduara brenda muajit dhjetor 2015, një rritje e konsiderueshme krahasuar me vitin 2014 ku u kontrolluan 32 dosje ose 20% e dosjeve.

Vlerësimi i dosjeve të auditimit rezulton si më poshtë:

Vlerësimi i dosjes	Viti 2015		Viti 2014		Viti 2013	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Shumë mirë	2	4.5	0	0	2	7
Mirë	35	79.5	24	75	20	69
Mjaftueshëm	7	16	2	25	7	24
Totali	44				29	

Kontrolli i sigurimit të cilësisë, si një proces i cili synon të garantojë një përmirësim të vazhdueshëm të punës audituese në zbatim të standardeve kombëtare dhe



ndërkombëtare të auditimit, ka qenë dhe mbetet në vazhdimësi një ndër objektivat kryesorë të veprimtarisë së KLSH-së.

Sigurimi i cilësisë, bazuar në standardet kombëtare e ndërkombëtare, është konsideruar si kërkesë e domosdoshme për të identifikuar objektivisht mangësitë, përmirësimet që duhen bërë dhe masat efektive që duhen marrë për përmirësimin e punës në të ardhmen, në mënyrë që të sigurohet një cilësi sa më e lartë e punës audituese dhe njëkohësisht t'i shërbejë ligjvënësit, ekzekutivit dhe publikut për t'u njohur me transparencën e përdorimit dhe administrimit të fondeve publike. Referuar kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, procesi i sigurimit të cilësisë së auditimeve të kryera nga KLSH, konsiderohet si një proces i bashkërenduar, ku në radhë të parë kërkohet që KLSH të miratojë praktikrat dhe procedurat e nevojshme për t'u siguruar që detyrat e auditimit janë kryer në shkallën e duhur të cilësisë, dhe në radhë të dytë, që KLSH të kryejë rishqyrtimet e sigurimit të cilësisë të auditimeve në një shkallë më të lartë, duke vendosur më pas që këto praktika dhe procedura të jenë të detyrueshme për zbatim në mënyrë që të ushtrohet efekti i duhur në kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë në të ardhmen. Për arritjen e objektivit kryesor, kryerjen e auditimeve në cilësinë më të lartë të mundshme, KLSH ka synuar krijimin e një sistemi të menaxhimit të plotë të cilësisë, i cili të mbulojë të gjithë sferën e veprimtarisë së tij. Për këtë arsye, janë hartuar dhe zhvilluar në vazhdimësi, politika, sisteme, procedura, instrumente dhe masa të tjera të përshtatshme për të siguruar që KLSH është organizuar në mënyrë kompetente për të prodhuar punë e raporte të një cilësie sa më të lartë dhe të besueshme për ligjvënësit e taksapaguesit. Vendosja dhe ndjekja me përgjegjësi e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, ka krijuar një siguri të arsyeshme që KLSH dhe personeli i këtij institucioni, i kryejnë detyrat e tyre me besueshmëri e efektivitet të lartë në përputhje me detyrimet Kushtetuese e ligjore, Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH, Kodin Etik, praktikrat bashkëkohore të auditimit të institucioneve homologe, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t.

Për realizimin e objektivit kryesor të KLSH-së në kryerjen e auditimeve të një cilësie sa më të lartë, është thelbësore ekzistenca e një sistemi të menaxhimit të plotë të cilësisë, i cili të mbulojë të gjitha drejtimet e veprimtarisë së institucionit.

Në grupin e shqyrtimit të cilësisë u përfshinë auditues me përvojë nga çdo departament auditimi si dhe u angazhuan ekspertë të jashtëm.

Për shqyrtimin e cilësisë së dosjeve, grupi i audituesve pati në dispozicion praktikën dokumentare të vitit të mëparshëm, por edhe tre tipe formularësh vlerësimi, që i përkasin llojeve të auditimit (ligjshmërie-rregullshmërie, financiar dhe performance).

Në zbatim të Urdhërit të Kryetarit, nr. 149, datë 03.12.2015 i ndryshuar, raporti për sigurimin e cilësisë edhe për këtë vit do të shqyrtohet dhe do të analizohet nga çdo departament, ku përveç rezultateve dhe rekomandimeve të përgjithshme, do të analizohen dhe dosjet e secilit departament. Gjithashtu, raporti i sigurimit të cilësisë dhe konkluzionet përkatëse do të jenë pjesë e raportit vjetor të veprimtarisë së KLSH-së.

Një nga faktorët që ka ndikuar pozitivisht në sigurimin e cilësisë të punës audituese për vitin 2015, është edhe përgatitja e studiuar e programit vjetor të veprimtarisë së KLSH-së që lidhet me punën e bërë në përcaktimin e prioriteteve të mundshme, argumentimin dhe përfshirjen në programin e auditimit të subjekteve të auditimit mbi bazën e vlerësimi të riskut dhe përcaktimit të materialitetit, duke i kombinuar këto auditime edhe me detyrimet kushtetuese e ligjore që ka KLSH-ja, për auditimin periodik të tyre.

Në hartimin e programit vjetor të auditimit të KLSH, janë mbajtur në vëmendje edhe ankesat dhe kërkesat për auditim të bërë nga publiku dhe subjekti, si dhe është marrë në konsideratë dhe interesi i lartë i publikut dhe medias për subjekte dhe çështje të ndryshme.

Hartimi e zbatimi i programeve të auditimit konform Rregullores së Brendshme të KLSH-së e manualeve të auditimit, përzgjedhja e përcaktimi i grupeve të auditimit me numrin e aftësitë e kërkuara që sigurojnë zbatimin e programit, nxjerrja e konkluzioneve të drejta dhe formulimi i drejtë i rekomandimeve, masat me karakter organizativ për përmirësimin e gjendjes të marra gjatë periudhës së auditimit, propozimet për përmirësimin e dispozitave ligjore e nënligjore, masat e marra nga subjektet për programimin e detyrave për zbatimin e rekomandimeve, flasin për një arritje të kënaqshme të sigurimit të cilësisë, si dhe të rritjes së besueshmërisë e objektivitetit të konkluzioneve dhe vendimeve të strukturave drejtuese e zbatuese të KLSH-së.

Referuar konstatimeve të dala nga shqyrtimi i dosjeve të auditimit, rezulton se krahas punës së bërë dhe rezultateve të arritura në drejtim të sigurimit të cilësisë,

në procesin e programimit, zbatimit, raportimit të përfundimeve të auditimeve dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, u konstatuan edhe disa të meta e mangësi në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme dhe Manualin e Auditimit, ndaj të cilave kërkohet të reflektohet me masa konkrete tekniko-administrative të qëndrueshme, të cilat do të influencojnë në arritjen e një niveli më të lartë të sigurimit të cilësisë në të gjithë veprimtarinë e KLSH-së.

Këto të meta dhe mangësi në një pjesë të mirë të tyre përsëriten nga viti në vit që tregojnë:

- Mosvlerësimin e duhur të punës nga ana e audituesve;
- Moskompetencë në kryerjen e auditiveve.

Kështu mund të përmendim:

i. Lidhur me përzgjedhjen me përparësi të subjektit duke u mbështetur tek materialiteti dhe risku rezultoi se nga 44 dosje të kontrolluara 13 prej tyre kishin mangësi;

ii. Lidhur me mbledhjen e informacionit paraprak rezultoi se 50% e shoqërive të kontrolluara nuk kishin të inventarizuar ndonjë informacion paraprak të nevojshëm për grupin e auditimit me qëllim përcaktimin sa më të saktë të çështjeve të auditimit, afatit dhe emërimin e ekspertëve të jashtëm;

iii. Lidhur me hartimin e programit të auditimit në përputhje me kërkesat e ligjit dhe rregullores së brendshme dhe standardeve të auditimit rezultoi se nga 44 dosje, 8 dosje ose 18% e tyre nuk plotësonin këtë kërkesë.

Në mënyrë të përmbledhur konkluzionet e sigurimit të cilësisë për 44 dosje auditimi të shqyrtuara, rezultuan si më poshtë:

### METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Në përfundim të auditimit, ku nënkuptohet se auditimi ka ezauruar kërkesat optimale të ligjit, rregullores së brendshme dhe standardeve të auditimit, për secilin nga kriteret e vlerësimit të përshkruara në vijim, jepet një opinion nëpërmjet dhënies së komenteve të shkurtra të shoqëruara me një vlerësim numerik nga 1 në 4, ku: 1=shumë mirë, 2=mirë, 3=mjaftueshëm dhe 4=jo mjaftueshëm. Shuma e vlerësimeve numerike pjesëtohet me numrin e kriterëve që janë vlerësuar.

## I - Faza e Planifikimit Auditimit / Hartimi i programeve të Auditimit.

1. Përzgjedhja me përparësi e subjektit dhe përfshirja e tij në planin e auditimit, a është e argumentuar?

Pothuajse të gjitha dosjet e përzgjedhura, subjektet e audituara janë pjesë e programit vjetor të auditimit të KLSH-së të miratuar nga Kryetari i KLSH-së me Vendimin nr. 1, datë 03.01.2015 "Për miratimin e programit vjetor të veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2015".

Në dosjen e auditimit "ZVRPP Pogradec", "Bashkia Durrës", "ZVRPP Krujë", "Drejtoria Rajonale Tatimore" Elbasan, "Posta Shqiptare" Tiranë, "Bashkia Divjakë", "Bashkia Kuçovë", edhe pse në programin vjetor janë detajuar arsyet pse është përzgjedhur subjekti, në dosje mungojnë të dhënat paraprake që i kanë shërbyer planifikimit të auditimit, metodat dhe teknikat e përdorura sipas kërkesave të rregullores së KLSH-së.

Në dosjet e auditimit "Ministria e Arsimit dhe Sportit", "Dega e Doganës, Tiranë", "KESH sh.a.", "Bashkia Pogradec", "Komuna Livadhja, Sarandë", rezulton se në përputhje me rregulloren është hartuar plani vjetor i departamentit ku përfshihen detyrat dhe periudha e përfundimit të tyre brenda vitit. Ndërsa në dosjet e auditimit bashkëlidhur këtij plani nuk janë argumentet mbi përzgjedhjen e subjektit në bazë të materialitetit dhe riskut të përcaktuar mbi bazën e dokumentacionit të mbledhur.

Ky fakt është evidentuar edhe në subjektin Dega e Doganës, Lezhë, ku në dosjen e auditimit gjendet "Vlerësimi i riskut gjatë planifikimit dhe rishikimi gjatë auditimit për efekt të raportimit", por tre ditë pasi ka përfunduar auditimi.

2. A është mbledhur informacioni paraprak për subjektin e audituar?

Në lidhje me këtë pikë të vlerësimit, rezulton se në dosjet e shqyrtuara nuk është inventarizuar ndonjë informacion paraprak që i nevojitet grupit të auditimit për të hartuar programin e auditimit me qëllim përcaktim sa më të saktë të çështjeve të auditimit, afatit të auditimit si dhe numrit të ekspertëve të jashtëm të nevojshëm për auditim.

Në disa raste nga ana e grupeve të auditimit nuk është zhvilluar takimi paraprak që i shërben kryerjes së auditimit, referuar kërkesave të rregullores së brendshme.

Konkretisht, në subjektin e auditimit Komuna Çërravë, lidhur me hartimin e programit të auditimit, duke pasur parasysh natyrën e auditimit dhe subjektin e audituar, grupit të auditimit i është lënë në dispozicion një kohë prej 7 ditësh, dhe kontaktin e parë me Kryetarin e Komunës Çërravë, grupi e ka marrë me datë 06.01.2015, ditën e fillimit të auditimit. Takimi rezulton se nuk është dokumentuar nga grupi i auditimit.

Në subjektin e auditimit Dega e Doganës, Lezhë, në dosje ndodhet informacioni mbi takimin paraprak me subjektin që auditohet, por informacioni paraprak nuk është i plotë ku përfshihet mbledhja dhe analiza e fakteve dhe e të dhënave rreth subjektit të audituar, pyetësorët të cilat do ti shërbejnë hartimit të programit të auditimit brenda 5 ditëve nga marrja e detyrës së auditimit. Në këtë dosje gjendet pyetësori në të njëjtën datë që ka filluar auditimi, çka tregon se pyetësori është formal, siç parashikohet në rregulloren e brendshme.

Ndërsa në dosjen e auditimit të subjektit KESH sh.a., ndodhet informacioni mbi takimin paraprak me subjektin që auditohet, por informacioni paraprak nuk është i plotë ku të përfshihet mbledhja dhe analiza e fakteve dhe e të dhënave rreth subjektit të kontrolluar, pyetësorët të cilat do ti shërbejnë hartimit të programit të auditimit brenda 5 ditëve nga marrja e detyrës së auditimit.

Në dosjet e auditimit të subjekteve Dega e Doganës, Tiranë; Ujësjellës Kanalizime, Bulqizë; Bashkia Divjakë, nuk ndodhet informacioni mbi takimin paraprak me subjektin që auditohet, i cili duhej të mbahej 5 ditë mbas njoftimit, parashikuar në rregulloren e brendshme.

Në dosjen e auditimit "ZVRPP" Pogradec, rezulton se takimi paraprak me subjektin të jetë kryer 7 ditë pas afatit të përcaktuar. Por informacioni paraprak nuk është i plotë. Konstatohet se mungon informacioni ku përfshihet mbledhja dhe analiza e fakteve dhe e të dhënave rreth subjektit të kontrolluar, pyetësorët të cilët do t'i shërbejnë hartimit të programit të auditimit brenda 5 ditëve nga marrja e detyrës së auditimit. Ky fakt është konstatuar edhe në dosjen e auditimit "Bashkia Durrës".

Në subjektet e auditimit Bashkia Pogradec dhe ZVRPP, Krujë, lidhur me hartimin e programit të auditimit, grupit të auditimit nuk i është lënë kohë e mjaftueshme, siç parashikohet në rregulloren e brendshme "Letrat e punës" për grumbullimin dhe përpunimin e informacionit. Kontakti i parë me Bashkinë Pogradec është realizuar në datën e fillimit të auditimit në bazë të programit, ndërsa në ZVRPP Krujë, takimi ndërmjet Regjistruerit të ZVRPP Krujë e specialistëve të saj me përfaqësuesit e KLSH

është dokumentuar me dokumentin "Takim me Titullarin e Institucionit", një ditë pasi ka filluar programi i auditimit.

Në subjektet e auditimit: Bashkia Pogradec; ZVRPP, Krujë; Komuna Livadhja, Sarandë; ISSH; Komuna Prezë, Tiranë; Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, grupet e auditimit për hartimin e programit nuk kanë të dokumentuar se kanë grumbulluar dhe përpunuar informacionin përkatës.

Në subjektin e auditimit Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Tiranë, nuk është përgatitur pyetësori, mbi organizimin, funksionimin dhe zbatimin akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni.

Në dosjen e subjektit të auditimit "Ministria e Mbrojtjes", rezulton se grupi i auditimit nuk ka bërë mbledhjen e informacionit paraprak për subjektin e audituar dhe nuk është bërë analiza e fakteve ose e të dhënave të mjaftueshme, me qëllim arritjen e konkluzioneve të besueshme dhe të vlefshme rreth subjektit për hartimin e programit të auditimit, si rrjedhojë programet e auditimit janë të ngjashme pa u thelluar në veprimtarinë dhe specifikat e subjektit, gjë që ka sjellë shpesh përfshirjen e pikave pa risk në programin e auditimit.

Në dosjen e subjektit të auditimit, "Në Ministrinë e Kulturës, Agjencinë e Shpëtimit Arkeologjik dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës", nga ana e grupit të auditimit për sa i përket fazës e mbledhjes së të dhënave, analizës së tyre dhe mungesës së letrave të punës për një bashkëpunim paraprak me punonjësit e subjektit të audituar, nuk është bërë analiza e fakteve ose e të dhënave të mjaftueshme, me qëllim arritjen e konkluzioneve të besueshme dhe të vlefshme rreth subjektit për hartimin e programit të auditimit.

3. A është hartuar programi i auditimit në përputhje me kërkesat e ligjit, rregullores së brendshme dhe standardeve të auditimit?

Programi i Auditimit është hartuar pjesërisht në përputhje me kërkesat e Ligjit, Rregullores së Brendshme dhe Standardeve të auditimit.

Mangësia në procesin e planifikimit konsiston në faktin se në dosjen e auditimit nuk ka informacion paraprak.

Mungesa e këtij informacioni paraprak të grumbulluar për subjektin që do të auditohet para hartimit të programit ka bërë që në disa raste të mos ketë një përcaktim të saktë e objektiv, të drejtimeve të auditimit.

Në subjektet: ALUIZNI Fier; Bashkia Kuçovë; Bashkia Divjakë; Ministria e Mbrojtjes, rezulton se në programin e auditimit, nuk është futur si pikë auditimi vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, e cila duhet të ishte e detajuar mbi bazën e pesë komponenteve si, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informim komunikimi dhe monitorimi.

Konkretisht në dosjet e auditimit të ushtruara në Komunën Çëravë dhe ALUIZNI Fier, pika 4 të programit duhet të ishte ndarë në dy pika të veçanta, përkatësisht njëra mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit dhe tjetra mbi menaxhimin e aktiveve të njësisë publike. Takimi paraprak me subjektin është bërë pas dërgimit të programit të auditimit.

Në subjektin ALUIZNI Korçë, konstatohet se megjithëse në njoftimin për fillimin e auditimit thuhet se KLSH sipas programit vjetor të auditimit, do të ushtrjë auditim financiar në këtë subjekt, ndërsa në fakt programi i auditimit dorëzuar në subjektin e auditimit, nuk është hartuar sipas modelit dhe praktikave të auditimit financiar të përcaktuar në rregulloren e brendshme por sipas modelit të auditimit të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare.

Në dosjen e auditimit "Komuna Prezë", "Bashkia Divjakë", "Porti Detar sh.a., Vlorë", nuk ndodhet i dokumentuar informacioni i grumbulluar mbi subjektin i cili duhet ti shërbente hartimit të programit të auditimit. Në dosje nuk ndodhet "Informacion mbi subjektin e auditimit, dhe veçoritë e tij" si dhe "shpenzimet për kryerjen e tij", bazuar në kërkesat e rregullores së brendshme. Takimi paraprak me subjektin është bërë pas dërgimit të programit të auditimit.

Në dosjen e auditimit "Ministria e Kulturës, Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës", është konstatuar se: pyetja kryesore është zbërthyer vetëm në dy nën pyetje dhe formulimi i saj ka ndikuar në gjenerimin e një mesazhi evaziv auditimi; ndërtimi i piramidës së pyetjeve nuk ndjek ndonjë kriter të logjikshëm, për sa i përket analizës së tyre dhe mungesës së letrave të punës për një bashkëpunim paraprak me punonjësit e subjektit të audituar, për pasojë ndërtimi i piramidës së pyetjeve nuk është detajuar sikurse e kërkon metodologjia e këtij auditimi; ka munguar analiza e riskut në sistemin e piramidës së pyetjeve, për arsye se risku nuk është markuar me gjenerimin e përgjigjeve, teknikat e vjeljes së informacionit nuk kanë qenë profesionale në drejtim të ndërtimit të pyetësorëve si dhe kanë munguar anketat dhe kjo tregon se ka munguar bashkëpunimi me punonjësit e këtij institucioni; evidenca audituese nuk është e mjaftueshme,

dokumentimi i gjetjeve është i njëanshëm dhe i pa testuar me të gjitha palët e përfshira në auditim.

4. Përzgjedhje e përshtatshme e numrit të audituesve dhe aftësive të kërkuara, përfshirë dhe ekspertët e jashtëm. Procedurat për shmangien e konfliktit të interesit, pranimin e programit dhe ndarja e detyrave për çdo kontrollor është e dokumentuar?

Në përgjithësi përzgjedhja e numrit të audituesve ka qenë e mirë dhe e mjaftueshme.

Për të gjitha dosjet, në afatet e auditimit duhej të merreshin parasysh dhe detyrat e tjera me të cilat mund të ngarkohen audituesit të cilat kanë sjellë edhe shtyrjen e afateve të auditimit.

Në subjektin ALUIZNI Fier, rezulton se ndarja e detyrave nuk është e dokumentuar për çdo auditues.

Në dosjet e subjekteve Ministria e Bujqësisë, ISSH, ALUIZNI Korçë, mungon dokumentimi i procedurave për shmangien e konfliktit të interesit, ndarja e detyrave, si edhe pranimi i tyre nga secili auditues, sipas kërkesave të rregullores dhe dokumenteve standarde të auditimit.

Në subjektin e auditimit "Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit", sipas programit të auditimit, metoda e auditimit është përcaktuar tematike. Në drejtimet e auditimit nuk është përcaktuar se cili drejtim dhe cila periudhë apo cila degë do të auditohet. Po kështu, në ndarjen e drejtimeve të programit për secilin auditues nuk është përcaktuar periudha dhe drejtimet e auditimit që do të auditohet me zgjedhje nga çdo auditues.

5. Përcaktimi i afateve për kryerjen e auditimit.

Përcaktimi i afatit për kryerjen e auditimit kryesisht ka qenë i mjaftueshëm. Në disa raste ka rezultuar se afati i auditimit ka qenë më pak se minimumi i ditëve të përcaktuara në dokumentet standarde.

Konkretisht në subjektin ALUIZNI Fier, planifikimi për afatin e auditimit rezulton se nuk ka qenë i mjaftueshëm, pasi është shtyrë edhe me 12 ditë kalendarike. Në subjektin Bashkia Kuçovë, afati i auditimit është shtyrë 7 ditë. Kjo dëshmon për një planifikim jo të mjaftueshëm të afatit të auditimit.



Në dosjen e subjektit Ministria e Bujqësisë, afatet për kryerjen e auditimit nuk janë përcaktuar në mënyrë specifike. Nuk është hartuar ndarja e detyrave për çdo kontrollor, pranimi i këtyre detyrave sipas afateve të përcaktuara në program në përputhje me rregulloren dhe dokumentet standarde të auditimit.

### II-Faza e Kryerjes së Auditimit

1. Është respektuar Programi i Auditimit sipas drejtimeve të caktuara, kërkesave të ligjit, rregullores së brendshme, standardeve të auditimit.

Nga shqyrtimi i dosjeve rezulton se është respektuar në përgjithësi programi i auditimit, sipas drejtimeve të përcaktuara.

Në subjektet e auditimit Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Tiranë dhe Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, rezulton se për katër pika auditimi të përcaktuara në programin e auditimit, nuk janë mbajtur aktverifikimi apo procesverbal. Këto pika programi janë ezauruar duke u pasqyruar në projekt raportin e auditimit.

Ndërsa në dosjet e auditimit ZVRPP Krujë dhe Komuna Livadhja, Sarandë, në disa raste rezulton se nuk përputhet numri rendor i faqeve ku është shkruar çështja përkatëse me numrin e tyre me faqen përmbledhëse. Ky problem rezulton edhe në raportin përfundimtar të auditimit.

2. Janë përdorur përshtatshëm procedurat dhe teknikat e auditimit për mbledhjen e provave.

Për mbledhjen e provave në përgjithësi janë përdorur përshtatshëm procedurat dhe teknikat e auditimit konformë Rregullores së Brendshme, por në disa ka rezultuar se:

- Në dosjen e subjektit Komuna Çëravë, nuk gjenden evidenca të mjaftueshme në dosje që shërbejnë si dokumentacion justifikues për punën audituese, si p.sh. aktrakordimet për të ardhurat dhe shpenzimet me degën e thesarit, evidencën e realizimit të investimeve, regjistrin e parashikimit dhe të realizimit të prokurimeve verifikime të ligjshmërisë së vendimeve, kontrata qiraje, aktverifikime dhe procesverbale të mbajtura nga subjekti, informacione të ndryshme, etj.

- Në dosjen e subjektit Ministria e Bujqësisë, janë hartuar pyetjet dhe nënpyetjet e auditimit si hap kryesor për zhvillimin e auditimit dhe fokusimin e problemit në auditimin e performancë, por pyetjet audituese nuk janë markuar me teknikat përkatëse të vjeljes së informacionit në programin e auditimit, projektraport e raport; në dosje nuk janë të dokumentuara pyetësorët për publikun apo palët e tjera të interesit, të përdorur gjatë auditimit.

- Në dosjet e auditimit ZVRPP Pogradec, Bashkia Durrës, Bashkia Pogradec, Ministria e Arsimit dhe Sportit, ZVRPP Krujë, Komuna Livadhja Sarandë nuk ka dokumente për metodat dhe teknikat e auditimit si vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, verifikimin e transaksioneve, informacione, pyetësorë, etj., në përputhje me rregulloren e brendshme.

3. Janë ballafaquar e ndjekur deri në fund çështjet e dala gjatë auditimit, që përfshinë fazat e auditimit në terren, raportimin dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Në varësi të specifikave të subjektit të auditimit është e nevojshme të aplikohen metodat dhe teknikat sipas kërkesave të rregullores së brendshme, por konstatohet se në subjektin në Komunën Çeravë, për disa observacione grupi i auditimit nuk është shprehur për marrjen parasysh ose jo të argumentit kundërshtues nga subjekti i audituar.

Konkretisht KESH sh.a., çështjet e trajtuara në të gjitha fazat e auditimit nuk janë ballafaquar dhe ndjekur deri në fund të auditimit. Nuk ju është kthyer përgjigje (koment) vërejtjeve për disa aktverfikime dhe procesverbale me argumentimin se ato (vërejtjet) nuk janë paraqitur brenda afatit 7 ditor.

Në dosjen e subjektit Ministria e Bujqësisë, rezulton se subjekti auditues ka dërguar informacionin mbi projektraportin jashtë afatit prej 20 ditësh.

Në dosjen e auditimit ZVRPP Pogradec, mungon i dokumentuar takimi i mirëkuptimit i organizuar në nivel drejtuesish brenda 10 ditëve nga kthimi i projektraportit.

Edhe në dosjen e subjektit Bashkia Durrës, nuk ka gjurmë të kryerjes së takimit të mirëkuptimit, brenda 10 ditëve nga kthimi i projektraportit siç e kërkon rregullorja e brendshme.

Në dosjen e auditimit Ministria e Arsimit dhe Sportit, në përfundim të auditimit, takimi përmbyllës nuk është i dokumentuar.

Në dosjet e auditimit Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Tiranë dhe Bashkia Divjakë është konstatuar se disa nga observacionet e paraqitura nuk janë shqyrtuar dhe nuk janë trajtuar në raportin përfundimtar të auditimit. Në raportin përfundimtar të auditimit janë lënë të njëjtat sqarime dhe shpjegime siç janë lënë në projekt raportin e auditimit, në të cilin përshkruhen observacionet e procesverbaleve, ndërsa observacionet për projektraportin nuk janë sqaruar dhe nuk janë përshkruar në raportin përfundimtar. Gjithashtu për sa i përket ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve në zbatim të Rregullores së brendshme, në dosje nuk ka dokumentacion që të tregoj, se është kryer auditim mbi zbatimin e detyrave dhe rekomandimeve.

Në dosjen e auditimit Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Berat, për problemet e trajtuara në projektraportin e auditimit të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar, nuk është kryer ballafaqimi i grupit të auditimit me subjektin e audituar, nuk ka dokument që të vërtetojë se është kryer ky ballafaqim. Pas dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve, rezulton se nuk është kthyer përgjigje për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve. Për sa i përket ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve në zbatim të Rregullores së brendshme, në dosje nuk ka dokumentacion që të tregoj se, është kryer ky auditim.

Në dosjen e auditimit Posta Shqiptare, Tiranë, ka ndryshime të gjetjeve dhe rekomandimeve midis projektraportit dhe raportit përfundimtar të auditimit.

4. Proçesverbalet, aktverifikimet dhe dokumentet e tjera të punës audituese janë të mbajtura në përputhje me kërkesat e ligjit dhe rregullores së brendshme.

Në përgjithësi aktverifikimet dhe procesverbalet janë mbajtur, konform Rregullores së Brendshme dhe dokumenteve standarde përkatëse. Në disa raste procesverbalet dhe aktverifikimet janë nënshkruar vetëm nga një auditues në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme, konkretisht në subjektet:

Në subjektin e auditimit Komuna Çëravë, lidhur me gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit janë në mënyrë të parregullt, ku evidentohen fotokopje duke mos mbajtur kopjet origjinale me numrin e protokollit të subjektit të audituar dhe në disa raste nuk janë protokolluar në subjektin e audituar por i janë dorëzuar në dorë personave përgjegjës. Rezulton se nga këto parregullsi nuk janë respektuar dokumentet standarde sipas rregullores së brendshme të KLSH. Në vijim në këtë dosje auditimi

rezulton se në disa procesverbale dhe një aktverifikim, nuk ka firmosur përgjegjësi i grupit, kërkesë kjo e rregullores së brendshme, përcaktuar në "Dokumente dhe formularë standard të auditimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare". Ky fakt është evidentuar edhe në subjektin ALUIZNI Fier, në një procesverbal.

Në dosjen e subjektit Ministria e Bujqësisë, mungojnë pyetësorët që janë shpërndarë publikut. Në dosje nuk ka dokumente për metodat dhe teknikat e auditimit si hartimin e pyetjeve që përfshihen në programin e auditimit dhe pyetësorët që u shpërndahen publikut.

Në dosjet e auditimit Komuna Prezë; Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, Bashkia Divjakë, konstatohet se disa aktverifikime, janë përpiluar dhe nënshkruar nga një auditues, jo në përputhje me dokumentet standarde, po ashtu edhe një procesverbali me nuk është nënshkruar nga përgjegjësi i grupit por vetëm nga përpiluesi i tij i cili është auditues i çështjes të trajtuar sipas ndarjes së pikave të programit të auditimit.

Në dosjen e auditimit Ministria e Kulturës, Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës, në rastin e gjetjeve të trajtuara në aktverifikime nuk ka dalë përgjegjësia konkrete për arsye se konkluzionet dhe gjetjet janë të përgjithshme, pa rezultate konkrete dhe jo të adresuara në përputhje me detyrën funksionale të çdo punonjësi në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

Në dosjen e auditimit "Ministria e Mbrojtjes", rezulton se në vendim grupi i auditimit ka rekomanduar për zhdëmtim dëmi ndaj Kompanisë përkëtesë një vlerë prej 54,000 euro më pak se çfarë është konstatuar në procesverbal.

5. Janë respektuar afatet për kryerjen e auditimit. Kërkesa për shtyrje afati a është e argumentuar e miratuar nga Kryetari dhe a ka rezultuar efektive.

Në përgjithësi janë respektuar afatet e auditimit, për punën në terren.

Në disa dosje auditimi, kërkesa për shtyrje afati të auditimit nga grupi i punës ka qenë e argumentuar.

6. A është bërë e dokumentuar takimi përmbyllës mbas përfundimit të auditimit në terren për problemet e dala që do të trajtohen në projektraport.

Në disa dosje, nuk ka dokument që vërteton mbajtjen e takimit përmbyllës mbas përfundimit të auditimit në terren për problemet e dala, që do të trajtohen në

projektraport, në kundërshtim me kërkesat e Rregullores së Brendshme "Takimi përmblyllës i auditimit në terren" konkretisht në: Komunën Çëravë, Degën e Doganës Tiranë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ZVRPP Krujë, AMF.

Në subjektin ALUIZNI Fier, për çështjet e dala gjatë fazës së auditimit në terren, grupi i auditimit nuk ka kryer dhe dokumentuar ballafaqimet me punonjësit përgjegjës të subjektit të audituar për të diskutuar për konstatimet e grupit të auditimit gjatë punës në terren.

Në dosjet e subjekteve Ministria e Bujqësisë, Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Kukës, për çështjet e trajtuara në të gjitha fazat e auditimit nuk ka të dokumentuara në formë shkresore takime me punonjësit.

### III- Faza e Raportimit dhe Evadimit të Materialeve të Auditimit

1. Forma dhe përmbajtja e Raportit të auditimit është në përputhje me rregullat e brendshme të përcaktuara. A është bërë takimi përmblyllës mbas shqyrtimit të observacioneve të projektraportit, para hartimit të raportit përfundimtar.

Format e raporteve të auditimit janë në përputhje me rregullat e brendshme të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme si dhe "Dokumentet standarde të auditimit".

Në dosjet e auditimit të subjekteve Komuna Çëravë, ALUIZNI Fier, ka rezultuar se në projektraport e auditimit dhe në raportin përfundimtar të auditimit, vlerësimi për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të ishte trajtuar në bazë të 5 komponenteve si, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informim komunikimi dhe monitorimi dhe se, grupi i auditimit duhet të dilte me kunkluzionin se si ka funksionuar ky sistem, mirë apo dobët. Takimi përmblyllës rezulton se është bërë pas shqyrtimit të observacioneve të projektraportit.

Në dosjen e auditimit Ministria e Financave, nuk është respektuar afati i nisjes së projekt raportit të auditimit. Nuk është organizuar takim përmblyllës 5 ditë pas shqyrtimit të observacioneve të ardhura për projektraportin e auditimit, siç ishte cilësuar në shkresën e dërguar të projektraportit të auditimit në subjekt.

Në dosjet e subjekteve Ministria e Bujqësisë, ZVRPP Krujë, Komuna Livadhja, Sarandë, nuk ka të dokumentuar, takim përmbyllës me subjektin.

Në dosjen e auditimit ZVRPP Pogradec, rezulton se raporti përfundimtar i auditimit është evaduar rreth 2 muaj pas projekt raportit duke tejkaluar afatin prej 30 ditëve në total sipas kërkesave të rregullores së brendshme.

Në dosjet e auditimit Bashkia Pogradec, Komuna Livadhja Sarandë, Bashkia Divjakë, rezulton se nuk ka dokumentacion justifikues për realizimin e takimit për shqyrtimin e projekt raportit.

Në dosjen e auditimit "ZVRPP Krujë", forma dhe përmbajtja e raportit të auditimit është në përshtatje me rregulloren e brendshme. Në disa raste nuk përputhet numri rendor i faqeve ku është shkruar çështja përkatëse me numrin e tyre me faqen përmbledhëse.

Në dosjen e auditimit Ministria e Kulturës, në Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe në Institutin e Monumenteve të Kulturës, në rastin e gjetjeve të trajtuara në raportin e auditimit nuk ka dalë përgjegjësia konkrete për arsye se konkluzionet dhe gjetjet janë të përgjithshme, pa rezultate konkrete dhe jo të adresuara në përputhje me detyrën funksionale të çdo punonjësi në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

2. Terminologjia e përdorur në Raport është lehtësisht e kuptueshme nga personat të cilëve iu drejtohet dhe termat teknike janë të shpjeguara qartë.

Terminologjia e përdorur në raport përgjithësisht është e kuptueshme nga personat të cilëve iu drejtohet dhe termat teknike janë të shpjeguara qartë, konform Rregullores së Brendshme.

Në dosjen e auditimit Ministria e Kulturës, në Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe në Institutin e Monumenteve të Kulturës, raporti i auditimit në përgjithësi nuk e ka të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e objektivave të auditimit, për të garantuar një kuptim të mjaftueshëm dhe të qartë mbi gjendjen në subjektin e audituar dhe nuk është lehtësisht i kuptueshëm nga personat të cilëve u drejtohet dhe objektiv.

3. Zbulimet dhe konkluzionet e paraqitura në raport janë të formuluar me kujdes, të identifikuar qartë, të argumentuara dhe të mbështetura në prova/evidencë, domethënëse dhe të arsyeshme. Nuk ka ndryshime të pa

justifikuara e të pa argumentuara mes Projektraportit dhe Raportit.

Në përgjithësi, nuk ka ndryshime të pa justifikuar e të pa argumentuara mes Projektraportit të Auditimit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimit. Zbulimet dhe konkluzionet e paraqitura në Raport, referuar Projektraportit janë të identifikuar dhe argumentuara, në zbatim të Rregullores së Brendshme.

Përrjashtim nga ky fakt është rasti i subjektit Komuna Çëravë, ku rezulton se pas vendimit të Kryetarit të KLSH-së, është konfirmuar revokimi i zbatimit të rekomandimit të dhënë në shkronjën "C" në raportit përfundimtar të auditimit.

Në dosjen e auditimit Ministria e Kulturës, në Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe në Institutin e Monumenteve të Kulturës, raporti i auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës përpiluar nga grupi i auditimit nuk janë formuluar qartë dhe të argumentuara. Nuk rezultojnë ndryshime midis Projektraportit dhe Raportit Përfundimtar.

4. Është bërë vlerësimi me kujdes i të gjithë observacioneve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar dhe pasqyrimi i tyre në Raport. Janë bërë takime ballafaqese me subjektin dhe janë dokumentuar.

Në përgjithësi është bërë vlerësimi i të gjithë observacioneve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar dhe pasqyrimi i tyre në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 si dhe rregullores së brendshme.

Nuk është organizuar takimi i mirëkuptimit në nivel drejtuesish brenda 10 ditëve nga kthimi i projektraportit, apo nuk është organizuar e mbajtur sipas rregullores së brendshme, sipas të cilës është detyruese të mbahet protokoll i veçantë, në të cilin reflektohen të gjitha vërejtjet e bëra, sqarimet dhe kundërshtimet për Projektraportin, si dhe Procesverbali i takimit përmbyllës vendoset në praktikën e auditimit, konkretisht në subjektet:

Në subjektet Komuna Çëravë, ALUIZNI Fier, Komuna Prezë, është bërë vlerësimi i pjesshëm i vërejtjeve të subjektit të audituar si për procesverbalet dhe aktverifikimet, ashtu dhe për projektraportin dhe janë pasqyruar në projektraport dhe raportin përfundimtar të auditimit, por nuk janë bërë takimet ballafaqese me subjektin pas shqyrtimit të observacioneve për projektraportin.

Në dosjen e subjektit Ministria e Bujqësisë, nuk rezulton dokument që të jenë kryer takime me punonjësit dhe nuk është organizuar takimi ballafaques në nivel drejtuesish.

Ky fakt është konstatuar edhe në dosjet e auditimit “ZVRPP Pogradec”, “Bashkia Durrës”, “Porti Detar sh.a., Vlorë”, ku rezulton se nuk është organizuar takimi i mirëkuptimit në nivel drejtuesish brenda 10 ditëve nga kthimi i projektraportit.

Në dosjen e subjektit Avokati i Popullit, nuk është kryer dhe dokumentuar takimi ballafaques me subjektin, para hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në dosjet e subjekteve Bashkia Pogradec dhe A.M.F, takimi ballafaques me subjektin, para hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nuk rezulton e dokumentuar.

Në dosjen e auditimit Bashkia Divjakë, nuk janë bërë takimet ballafaqese me subjektin pas shqyrtimit të observacioneve për projekt raportin e auditimit dhe as para përfundimit të raportit përfundimtar të auditimit.

5. Kanë ekzistuar marrëdhëniet profesionale dhe korrekte me subjektin në zbatim të standardeve dhe rregullave të etikës.

Për këtë pikë vlen të theksojmë se nga të gjitha grupet e auditimit kanë ekzistuar marrëdhënie profesionale dhe korrekte me subjektin, në zbatim të standardeve dhe rregullave të etikës, konform Rregullores së Brendshme. Nga ana e subjektit në shkresat ku kanë sjellë observacionet kanë shprehur dhe vlerësimin e tyre pozitiv për punën e kryer nga grupi i auditimit.

Në dosjen e subjektit Dega e Doganës, Tiranë në zbatim të rregullores dhe standardeve të etikës është organizuar takimi për fillimin e auditimit por nuk ka takim përmbysës me titullarin mbas përfundimit të auditimit përcaktuar në rregulloren e brendshme dhe as takim me persona përgjegjës. Nuk është organizuar takimi i mirëkuptimit në nivel drejtuesish brenda 10 ditëve nga kthimi i projektraportit.

Në dosjet e subjekteve Ministria e Bujqësisë, Bashkia Durrës, Komuna Prezë, nuk figuron dokumenti për takimin e mirëkuptimit organizuar në nivel drejtuesish nga kthimi i projektraportit me observacionet përkatëse.

6. Rekomandimet janë të formuluar qartë dhe të argumentuara. Nuk ka ndryshime të pajustificuara e të paargumentuara nga ato të propozuara në



projektvendim.

Në përgjithësi rekomandimet janë të formuluar qartë dhe të argumentuara. Nuk ka ndryshime nga ato të propozuarat në projektvendim, konform pikave të Rregullores së Brendshme.

Në dosjen e subjektit Komuna Çëravë, grupi i auditimit ka dhënë rekomandime të cilët janë të argumentuara pjesërisht me bazën ligjore, dhe mendimit të Drejtorit të Departamentit dhe Kryeaudituesit të cilët kanë monitoruar dhe vlerësuar procesin auditues, dhe vendimit të Kryetarit të KLSH që ka konfirmuar revokimin e zbatimit të rekomandimit të dhënë në shkronjën C në raportit përfundimtar të auditimit. Projektvendimi nuk ndodhet në dosjen e auditimit. Nuk është plotësuar dokumenti nr. 17, për vlerësimin e cilësisë së kontrollit, nga Drejtori i Departamentit dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike. Ky dokument nuk është evidentuar edhe në dosjen e subjektit ALUIZNI Fier.

Në dosjet e auditimit "ZVRPP Pogradec", "Bashkia Durrës", "ALUIZNI Korçë", "Komuna Prezë", për vlerësimin e cilësisë në dosje nuk ndodhet dokumenti nr. 17 "Vlerësimi i cilësisë dhe kontrollit" nga kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit.

Në dosjen e auditimit Ministria e Arsimit dhe Sportit, rezulton se Projekt Vendimi dhe raporti përfundimtar i auditimit nuk është firmosur nga i gjithë grupi i auditimit por vetëm nga përgjegjësi i tij.

7. Evidencat e rezultateve të auditimit janë të mbajtura sipas afateve, formës dhe përmbajtjes të parashikuara në Rregulloren e Brendshme dhe formularëve standard të miratuar.

Evidencat e rezultateve të auditimit janë të mbajtura sipas afateve, formës dhe përmbajtjes të parashikuara në Rregulloren e Brendshme dhe formularëve standard të miratuar, konform kërkesave të Rregullores së Brendshme si dhe formularëve standarde për këtë lloj auditimi.

Në dosjen e subjektit Dega e Doganës Tiranë, mungojnë shënimet e mbajtura nga audituesit gjatë procesit auditues përcaktuar në rregulloren e brendshme.

Në dosjen e subjektit Komuna Çëravë, evidencat e rezultateve të auditimit nuk janë të mbajtura sipas afateve, formës dhe përmbajtjes të parashikuara në rregulloren e brendshme dhe formularëve standarde të miratuar, janë firmosur nga përgjegjësi i grupit dhe nuk janë firmosur nga pjesëtarët e grupit të auditimit.

Në dosjen e subjektit Ministria e Bujqësisë, nuk ndodhet bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, fleta ku shënohen për çdo auditues pikat e trajtuara, gjetjet, konkluzionet, rekomandimet dhe faqet respektive në raport, në mënyrë që të evidentohen rezultatet e auditimit dhe përgjegjësia individuale.

Ky fakt është konstatuar edhe në dosjen e auditimit ZVRPP Pogradec.

Në dosjen e auditimit Komuna Prezë, dërgimi i raportit të auditimit është bërë jashtë afatit me një javë.

Në dosjen e auditimit Ministria e Arsimit dhe Sportit, evidencat e rezultateve të auditimit janë të mbajtura sipas, formës dhe përmbajtjes të parashikuara në rregulloren e brendshme dhe formularëve standardeve të miratuar por nuk janë firmosur nga i gjithë grupi i auditimit.

Në dosjen e auditimit Porti Detar sh.a., Vlorë, mungonin shënimet e mbajtura nga audituesit, si dhe dokumente të ndryshëm sqarues apo ndihmës për auditimin e kryer.

## REKOMANDIME

### 1. Faza e planifikimit të auditimit:

1. Për mbarëvajtjen e punës audituese, hartimin e një programi auditimi sa më të plotë dhe përdorimin sa më racional të burimeve njerëzore e materiale, grupet e auditimit të marrin masa për zbatimin e Rregullores së Brendshme, ku është parashikuar njoftimi i subjektit para fillimit të kontrollit, që ka për qëllim vënien në dispozicion të dokumentacionit për marrjen e informacionit paraprak, sigurimin e ambienteve e pajisjeve për një punë normale të audituesve, si dhe kërkesa të tjera në vartësi të specifikave dhe natyrës së auditimit apo subjektit. Hartimi i programeve të auditimit pa bërë më parë njohjen e subjektit, ka sjellë si pasojë hartimin e programeve jo të plota, janë përcaktuar si pika auditimi megjithëse subjekti nuk ka ushtruar aktivitet në lidhje me to, ka ndryshime të afateve të auditimit, që tregon mos thellim para hartimit të këtyre programeve

2. Nga drejtuesit e departamenteve, të merret masa dhe të kihet parasysh në përcaktimin e grupeve të auditimit përdorimi më racional i planifikimit të burimeve njerëzore, të vlerësohet në mënyrë të atillë që në auditim krahas numrit të përshtatshëm të audituesve të caktohet edhe stafi me aftësitë dhe eksperiencën e duhur, në mënyrë që cilësia e aftësive të grupit t'i përgjigjet kompleksitetit të

auditimit. Mos shfrytëzimi optimal i burimeve njerëzore ka sjell shtimin apo pakësimin e anëtarëve të grupit pas hartimit të programit të auditimit.

3. Drejtuesit e Departamenteve të marrin masa, për të përcaktuar afatin e auditimit në përputhje me afatet e përcaktuar në Rregullore, pasi si pasojë e mospërcaktimit të afatit të duhur, ka lindur nevoja e shtyrjes së afatit të auditimit.

### II. Faza e kryerjes së Auditimit

Gjatë punës audituese në terren, audituesit duhet të marrin masa për hartimin e aktverifikimeve dhe procesverbaleve në përputhje me kërkesat për hartimin e dokumenteve sipas Rregullores së Brendshme. Nga shqyrtimi vihet re se hartimi i aktverifikimeve dhe procesverbaleve nuk është bërë në përputhje me parashikimet e rregullores pasi ka raste që:

- Nuk është përcaktuar përgjegjësia për personat përkatës që kanë kryer shkeljen;
- Në rastet e përcaktimit të përgjegjësisë ka raste të mungesës së argumentimit bindës për personin që është ngarkuar me përgjegjësi.
- Aktverifikimet, të përpilohen dhe nënshkruhen nga jo më pak se një auditues.

### III- Faza e Raportimit dhe Evadimit të Materialeve të Auditimit

1. Grupet e auditimit duhet të marrin masa për trajtime sa më të plota e të qartë të observacionet e sjella nga subjektet dhe personat e ngarkuar me përgjegjësi, gjë të cila në disa rast në dosjet e shqyrtuara, nuk kanë dhënë sqarime të plota për observacionet e bëra për Projektraportin, ku duhet të përshtrohet shkurt thelbi dhe përmbajtja e observacionit dhe argumentimi me dispozita ligjore kur nuk merret në konsideratë, e që për observacionet e pabazuara të mos përdoret thjesht fraza “nuk qëndron observacion”, me qëllim përforcimin e konkluzionit të audituesve për shkeljet e konstatuara, rritjen e sigurinë dhe besueshmërisë të konkluzioneve e rekomandimeve të auditimit, kërkesë kjo e parashikuar në ligjin e KLSH-së dhe të Rregullores së Brendshme.

2. Grupet e auditimit duhet të marrin masa për të përmirësuar trajtimin më të plotë të drejtimeve të programit të auditimit ku mungojnë gjetjet dhe konkluzionet.

Projektraportet e Auditimit dhe në veçanti Raportet Përfundimtare janë shumë të gjata dhe janë kopje e thjeshtë e procesverbaleve dhe aktverifikimeve të mbajtura. Përshkrimi i zbulimeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit duhet të jetë një përmbledhje e problemeve të dala gjatë auditimit, si dhe ky raport duhet të jetë më konciz dhe jo kopje e Projekt Raportit, kërkesa këto të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme.

3. Grupet e auditimit duhet të marrin masa për të faktuar realizimin dhe takimet përmblyëse me subjektin para hartimit të Projektraportit ku ballafaqohen deri në fund çështjet e dala gjatë auditimit. Në disa raste ballafaqimet nuk janë dokumentuar mire ose nuk janë dokumentuar fare, në kundërshtim kërkesat e Rregullores së Brendshme.

4. Përgjegjësi i grupit të auditimit të marri masa për plotësimin e dokumentit "16", në mënyrë që të evidentohen rezultatet e auditimit dhe përgjegjësia individuale. Bashkëlidhur Raportit Përfundimtar, duhet të shënohen për çdo auditues pikat e trajtuara, masat e rekomanduara dhe faqet respektive të raportit për Auditimet e Ligjshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare, për arsye se në disa raste ka munguar, veprim ky në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme.

5. Nga grupet e auditimit të merren masa, që në projektvendim, për shkeljet e rënda ligjore të konstatuara, të propozojnë masë disiplinore për të gjithë personat e ngarkuar me përgjegjësi, për arsye se në disa raste u konstatua se masat e rekomanduara nuk janë në përputhje me shkeljet e konstatuara, nuk janë vlerësuar në shkallën e duhur nga grupet e auditimit dhe drejtuesit e departamentit për rastet e konstatimit të shkeljeve dhe përcaktimit të masës së rekomanduar dhe të përgjegjësisë të personave përkatës, veprim ky në kundërshtim me ligjin organik të KLSH-ës dhe Rregullores së Brendshme.

6. Nga Drejtorët e Departamenteve dhe nga kryeaudituesit të merren masa për të plotësuar dokumentin "Vlerësimi i cilësisë së kontrollit", për arsye se në disa dosje ky formular mungon, veprim ky në kundërshtim me Dokumentet dhe Formularët standard të auditimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare.

7. Përgjegjësi i grupit të auditimit dhe antarët e grupit, të marrin masa për të plotësuar dosjen e auditimit me letrat e punës dhe shënimet e mbajtura nga audituesi, për arsye se në shumicën e dosjeve të shqyrtuara mungonin këto letra, veprim ky në kundërshtim, me Formularët standard.

8. Grupet e auditimit duhet të marrin masa për të dorëzuar në kohë pranë zyrës së arkivit dosjet e përfunduara të auditimit, siç përcaktohet në Urdhërin nr. 59 datë 30.04.2015 i ndryshuar. Në disa raste rezultoi se dosjet e auditimit janë dorëzuar me vonesë pranë zyrës së arkivit.

Në përfundim për 44 dosje të përzgjedhura, nga shqyrtimi rezultoi se 2 dosje janë vlerësuar me 1 (një) shumë mirë, 35 dosje me 2 (mirë), 7 dosje me vlerësimin 3 (mjaftueshëm).

#### IV. REKOMANDIM

Duke vlerësuar performancën e arritur në drejtim të përmirësimit të sigurimit të cilësisë së punës audituese, si dhe duke reflektuar ndaj të metave e mangësive të vërejtura gjatë shqyrtimit të dosjeve të auditimit për kontrollin e sigurimit të cilësisë, për përmirësimin e punës në të ardhmen rekomandojmë:

*Në zbatim të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH, qëllimi i shqyrtimit për sigurimin e cilësisë së punës audituese është që drejtuesit e lartë të institucionit të marrin siguri të arsyeshme që auditimet janë kryer në përputhje me standardet dhe metodat e miratuara dhe në zbatim të detyrimeve kushtetuese e ligjore. Gjithashtu zbatimi i këtij procesi shqyrtimi shtron kërkesa për të identifikuar e pasqyruar objektivisht mangësitë, përmirësimet që duhen bërë dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e punës në të ardhmen, prandaj është detyrë e drejtuesve të departamenteve që konkluzionet e rekomandimet e raportit të sigurimit të cilësisë të trajtohen në analizat e departamenteve dhe të mbahen parasysh në vlerësimin vjetor të punës së kontrollorëve.*

AUDITUESIT E RINJ NË KLSH:

KONTRIBUTI, INOVACIONI NËN MOTON: “UNË, KLSH DHE EUROSAI”

FJALA E HAPJES

NGA DREJTORI I DEPARTAMENTIT JURIDIK DHE ZBATIMIT TË STANDARDEVE,  
Z. ERMAJ YZEIRAJ



I nderuar z. Kryetar,  
të nderuar të ftuar,  
të nderuar koleg!

Më lejoni pikë së pari t’ju uroj të gjithëve mirëseardhjen në këtë konferencë të veçantë të audituesve të rinj të KLSH-së e organizuar për herë të parë në historikun 90 vjeçar të institucionit tonë, duke i uruar njëkohësisht suksese.

Së dyti dëshiroj të shpreh kënaqësinë e veçantë që ndjej në rolin e moderatorit të kësaj konference pavarësisht faktit që si më i vogli në

moshë nga stafi drejtues në KLSH unë kam qenë alternativa e vetme për tu konsideruar pak a shumë si pjesë e të rinjve të KLSH.

Kjo nuk është konferenca e vetme që KLSH ka organizuar dhe zhvilluar përgjatë këtyre viteve por padyshim ajo sot duket si më e veçanta. Pikërisht për shkak të faktit që kjo konferencë është organizuar tërësisht nga të rinjtë dhe për të rinjtë e KLSH-së.

Në fakt ndarja në të rinj dhe në të vjetër nuk është se ka ndonjë rëndësi në institucionin tonë pasi ndarja e vërtetë që ekziston është ajo ndërmjet audituesve shumë të mirë, të mirë dhe atyre që nuk plotësojnë dot kriteret për të qenë pjesë e këtij institucioni. Të jesh i ri nuk është aspak një disfavor për të bërë karrierë në

KLSH por përkundrazi përbën një avantazh. Shpejtësia me të cilën brezi i ri arin të përthithë dhe vërë në praktikë eksperiencën e brezave të mëparshëm në KLSH është mbresëlënëse. Energjia që të rinjtë mbartin gjithashtu është impulsi që i nevojitet ritmit të institucionit.

Disa prej audituesve të rinj të KLSH-së të pranishëm këtu në sallë sot dhe që do kemi kënaqësinë ti dëgjojmë në referimet e tyre, kanë shumë pak vite që kanë filluar punë në KLSH. Disa 3 disa 2 madje disa prej tyre ende nuk kanë bërë vitin. Por prapë të gjithë kanë arritur të kuptojnë dhe janë përfshirë menjëherë në tempin e çmendur që përshkon ditët tona normale të punës. KLSH ka kohë që nuk fle më. Në të gjitha kuptimet e fjalës. E shtuna dhe e djela janë shpesh herë ditë të zakonshme pune.

Shpesh herë kam qenë anëtar apo kryetar në komisionet e marrjes në punë, ku pas rezultateve të testimit me shkrim, një nga një të gjithë kandidatët hynin në sallë për tu intervistuar. Në fakt ndonëse i pyesja për eksperiencat e tyre në punë, kualifikimet e tyre apo njohuritë e tyre mbi çështje të ndryshme profesionale, kam dashur gjithnjë ti bëj vetëm një pyetje në bazë të së cilës do të vendosja për pranimin ose jo të tyre në KLSH. Dhe kjo pyetje është "A e doni punën dhe sa?" .

Por në fakt përgjigjen e kësaj pyetje nuk mund ta marrësh nga asnjë person gjatë intervistimit pasi këtë përgjigje mund ta japë vetëm puna e tyre.

Si frika, shkathtësia, respekti apo presioni mund të jenë efektive në funksion të qëllimit të kryerjes me sukses dhe brenda afatit të një pune apo detyre, por asgjë, e theksoj, asgjë, nuk krahasohet me produktin e një pune të bërë me dashuri për punën.

Dhe këto vite, të shumta kanë qenë punët e bëra me dashuri për punën, për KLSH për atë çka shumë prej nesh besojmë dhe dëshirojmë të kontribuojmë çdo ditë, mirëqeverisjen e vendit.

Nëse do mungonte ky aspekt thelbësor në KLSH:

sot nuk do kishim fituar betejën gjyqësore me administratën tatimore,

sot nuk do kishim një ligj të ri të KLSH-së, tërësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare por një ligj të cunguar,

sot nuk do kishim me dhjetëra botime standarde, manuale, madje dhe shkrime të audituesve në gazeta, mjafton të përmend që për 20 vjet 1991-2011 KLSH kishte vetëm 12 botime ndërsa vetëm këto 4 vitet e fundit kemi bërë 51 botime,

sot nuk do ishim kaq aktiv dhe të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, ku vetëm këto 4 vite kemi bërë në total 170 kallëzime penale për 527 persona,

sot nuk do kishim mbështetjen dhe respektin e opinionit të gjerë publik dhe faktorit ndërkombëtar,

sot ndoshta as unë dhe as ju nuk do të ishim këtu në këtë konferencë.

Çfarë KLSH ka arritur përgjatë këtyre viteve të fundit, do mbetet për shumë kohë një periudhë e veçantë në historinë e këtij institucioni dhe nëse ju keni patur fatin të ishit pjesë e cilësdo prej betejave, sfidave dhe sukseseve të këtij institucioni ju duhet të ndiheni krenar.

Të qënit pjesë e këtij institucioni duhet t'ju bëj të ndiheni të privilegjuar. Roli dhe misioni kushtetues i këtij institucioni mbetet i pazëvendësueshëm. Dikur një institucion i heshtur dhe në letargji sot ndër të paktit institucione aktiv dhe të besueshëm në luftën kundër korrupsionit dhe antikulturës së pandëshkueshmërisë.

Në fakt nuk është aspak e lehtë të qënit pjesë e KLSH, të qënit auditues në KLSH. Gjithnjë duke kërkuar, zbuluar, kontrolluar, verifikuar, mësuar, përshtatur, rifreskuar, sakrifikuar, përballur me presionin, me abuzimin, me tundimin, gjithnjë në kërkim të një modeli perfekt dhe një shembulli për të tjerët.

Sfidat që ne kemi përballuar gjatë këtyre viteve mund të mos ngjajnë me ato që mund të vijnë për KLSH-në në të ardhmen, por nëse secili prej jush ka kuptuar çelësin e suksesit të këtyre viteve dhe ka përvetësuar kulturën e punës në KLSH, nuk ka sfida që ky institucion dhe ju që në të ardhmen do jeni drejtuesit e tij nuk do ta përballojë.

KLSH nuk e sfidon vetëm pushteti dhe presioni i tij mbi kontrollin dhe transparencën që KLSH imponon me auditimet e tij por edhe vetë periudha në të cilën ne po jetojmë. Ne jemi dëshmitar të revolucioneve të jashtëzakonshme teknologjike që ndikojnë në të gjitha aspekte të jetës tonë, telefonat smart, proceset që kryhen përmes sistemeve kompjuterike, të dhënat komplekse dhe voluminoze që procedohen në databazat kompjuterike, dokumentat elektronik, sistemet kompjuterike të menaxhimit të punës së institucioneve të rëndësishme si organet e administratës tatimore dhe doganore, thesari, prokurimi publik, etj. Nuk do jetë e largët dita kur edhe firma nuk do hidhet më në letër por nënshkrimi do jetë i gjithi elektronik.



Dhe ky nuk është një evolucion por një revolucion. Dhe ne duhet të jemi gati për sfidat që ai do sjellë.

Zhvillimi i madh teknologjik dhe social ngrenë pyetjen themelore që i përket përmbushjes së misionit tonë si Institucion Suprem i Auditimit në të cilin operojmë.

SAI-et nuk janë më "Audituesit Ekskluziv". Ne nuk jemi të vetmit që i sigurojmë informacion publikut dhe legjislativit. Ne kemi shumë "konkurrentë" në aspektin e informimit dhe të dhënave.

Ne duhet të pyesim veten nëse mënyrat tradicionale janë akoma mënyrat më efektive për të kryer auditimet; mënyrat më të mira për të ruajtur besimin e opinionit të gjerë publik; dhe mënyrat më të mira për tu lidhur me të, veçanërisht më të rinjtë.

Cili është roli jonë si SAI në këtë realitet dhe a jemi gati ta bëjmë rolin tonë?

A janë SAI-t gati për sfidat dhe ndryshimet e së ardhmes?

Këto pyetje kanë kohë që janë në qendër të vëmendjes dhe axhendës së EUROSAI-t dhe INTOSAI-t, pjesë e të cilave jemi dhe ne. Ato nuk janë pyetje të thjeshta dhe për të cilat ekzistojnë tashmë përgjigje të qarta dhe të konsoliduara. Përkundrazi ato mbeten ende pyetje të paezauruara në kërkim të ideve të reja, ide që shumë mirë mund të vinë nga vetë brezat e rinj.

Për këtë kemi vendosur si temë të kësaj konference temën "Unë, KLSH dhe EUROSAI". Si punonjës të rinj ju keni potencialin për të qenë liderët e ardhshëm të institucionit.

Unë personalisht nuk jam ndonjë tifoz i çmendur i futbollit. Por ama ndeshjet e Barcelonës i shikoj gjithnjë me qejfin më të madh. Por jo vetëm se aty luan Messi, Neymar, Suarez, etj., por më shumë për shkak të faktit që ata luajnë si një ekip i vërtetë. Për ta çdo ndeshje mbetet një sfidë pavarësisht sa i dobët duket kundërshtari. Ata pasojnë, koordinohen, sulmojnë, mbrohen, triblojnë, luftojnë. Ata fitojnë. Kjo është ajo çka ata bëjnë dhe kjo bën dhe një indiferent si puna ime që të bëhet fansi i tyre.

Nëse ne, nëse ju, do të mund të krijojmë një ekip të tillë, çdo sfidë do ishte e përballueshme dhe ne do shijonim gëzimin që vetëm një fitore mund ta japë. Dhe për ta ndjerë këtë lloj gëzimi ju duhet të jeni pjesë e ekipit dhe të veproni si të tillë.

Pavarësisht se sot disa nga betejat e KLSH-së ju i shikoni nga stoli i rezervave do vi dita kur për disa nga ju trajneri do vendosë t'ju testojë në fushën e vërtetë dhe mbi ju do bjerë bara dhe shpresa e gjithë ekipit për të shënuar dhe fituar. Dhe ju duhet të jeni gati.

I nderuar z. Kryetar,


Më mirë se me Barcelonën nuk besoj se mund ta mbyllja fjalën time, madje mbase e ekzagjeroj pak që e krahasoj KLSH me Barcelonën, por dhe ne kemi patur betejat dhe fitoret tona, gëzimi i të cilave ka justifikuar gjithë punën tonë.

Duke e mbyllur këto fjalën time, i uroj suksese të gjithë pjesëmarrësve në këtë konferencë.

## 1. KUADRI I MATJES SË PERFORMANCËS SË SAI-t

*Referues: Ina SOKOLI – Audituese e parë,  
Marcela MORA<sup>21</sup>.*

### Abstrakt



*SAI PMF i siguron SAI-t një kuadër për një vetëvlerësim të preformacës kundrejt Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) dhe praktikave më të mira ndërkombëtare të institucioneve të auditimit. Kjo është shumë e rëndësishme për një SAI i cili zbaton, dëshiron të zbatojë ose dëshiron të vlerësojë veten e vet me ISSAI-t dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare. Ky mjet nuk është i detyrueshëm të përdoret nga i gjithë komuniteti i INTOSAI-t. Përdorimi i këtij vlerësim do të kontribuojë në përmirësimin e rritjes së kapaciteteve nëpërmjet promovimit të përdorimit të matësve të preformacës dhe menaxhimit dhe do të*

*ndihmojë në identifikimin e mundësive për të forcuar performancën e SAI-t.*

*Në përputhje me objektivat e "Vlera dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit - duke bërë një ndryshim në jetën e qytetarëve", SAI PMF do të sigurojë SAI-t me një bazë objektive për të demonstruar rëndësinë e tyre të vazhdueshëm për qytetarët dhe aktorëve të tjerë. Ai aspiron për të vlerësuar kontributin e KLSH ndaj menaxhimit të fort financiar publik, qeverisjes së mirë dhe llogaridhënies, dhe përpjekjet për të luftuar korrupsionin. Ajo do të japë SAI një mundësi për t'u bërë organizata modei, udhëhequr me shembull në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies përmes raportimit të besueshëm publik të preformacës së tyre.*

### Përdorimi i SAI PFM

SAI PMF ka për qëllim të përdoret për të përcaktuar se sa mirë vepron një SAI në krahasim me praktikatat e mira ndërkombëtare, si dhe për të identifikuar pikat e forta dhe dobësitë e saj.

---


<sup>21</sup> Marcela MORA – Koordinatore në Sekretariatit e Donatorëve të INTOSAI-t.

Vlerësimi duhet të bazohet në fakte. Përdorimi i SAI PMF është vullnetar. Vendimi për të kryer një vlerësim duke përdorur SAI PMF i takon manaxhimit të lartë vendimmarrës së SAI në fjalë. Një vlerësim duke përdorur SAI PMF mund të pasohet nga një vlerësim më i plotë i nevojave për të përgatitur një program të zhvillimit të kapaciteteve. SAI-t mund të dëshirojnë për të kryer një vlerësim SAI PMF për disa arsye:

- Si një hap drejt zbatimit të ISSAI: të mësojnë se ku nevoja për ndryshim është më e madhe në mënyrë që të ndjekin parimet kyçe të ISSAI, të rrisi kuptimshmërinë ndaj praktikave më të mira.
- Të tregojë përparimin, vlerën dhe përfitimet për shoqërinë; të masi progresin me kalimin e kohës si dhe tia u demonstrojë këtë aktorëve të jashtëm, tregojnë për palët e interesuara se si ata mund të kontribuojë në forcimin e menaxhimit të financave publike, promovimin e qeverisjes së mirë, promovimin e transparencës dhe llogaridhënies dhe luftimin e korrupsionit.
- Matja e brendshme e performancës/raportimi vjetor; për të përmirësuar ose futur procedurat e matjes të performancës të brendshme
- Për të marrë mbështetjen për përpjekjet e zhvillimit të kapaciteteve; duke treguar angazhim për të ndryshuar dhe për krijimin e një baze performance.

Në varësi të qëllimit të vlerësimit, mund të kryhet si:

- a) një vlerësim nga vetë SAI,
- b) vlerësimi nga kolegët e një SAI tjetër ose organe të INTOSAI, ose
- c) vlerësimi i jashtëm nga konsulentët, donatorët, auditues të jashtëm apo ekspertëve të tjerë.




SAI PMF mund të aplikohet për të gjitha këto tri qasje. Pavarësisht nga qasja, duhet të planifikohen masa të pavarur për sigurimin e cilësisë. Vendimi në lidhje me publikimin ose jo të rezultateve të vlerësimit SAI PMF duhet të merret nga Kryesuesi i lartë vendimmarrës se SAI-t në fjalë. Para se të merret vendimi, duhet të konsiderohen me kujdes përfitimet e mundshme dhe rreziqet e botimit. Udhëzime të mëtejshme për një shqyrtim të tillë është dhënë në udhëzuesin e SAI PMF për Vlerësuesit.

SAI PMF përdor Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve të Auditimit Suprem (ISSAI) si pikë referimi kryesor ndaj të cilit matet performanca. Shumica e treguesve janë zhvilluar në bazë të ISSAI. Pas miratimit të një serie të plotë të ISSAI në Kongresin INTOSAI-t në vitin 2010, shumë SAI janë aktualisht në procesin e implementimit të standardeve.

Pse SAI-et përdorin SAI PMF?


Arsyet kryesore pse SAI-t duhet të përdorin SAI PFM janë:

- Për të identifikuar pikat e forta, të dobëta dhe zonat ku mund të përmirësohet
- Përmirësimi i cilësisë së auditimit duke nxitur implementimin e ISSAI
- Rritja e performancës së brendshme të menaxhimit dhe llogaridhënies
- Nevoja e vlerësimit për të asistuar planin strategjik
- Një bazë për të demonstruar progresin e ardhshëm në performancë.
- Të udhëhiqemi nga shembulli në sektorin publik – vlerësim dhe raportim mbi performancën.



Për më tepër, jo të gjithë SAI-t synojnë zbatimin e ISSAI-ve, për shkak të kufizimeve në mandatin e tyre. Për këto SAI, SAI PMF mund të mos jetë qasja më e përshtatshme për vlerësimin e performancës, dhe publikimi i rezultateve të një vlerësimi të tillë mund të japë një pamje mashtruese të punës së SAI-t.

Kuadri i indikatorëve të SAI PMF



Dhe pikërisht kriteret merren nga ISSAI-t ose nga praktikat më të mira ndërkombëtare.

Shembull pikëzimi:

Rasti: SAI angazhohet në mënyrë aktive me median për të komunikuar raportet e veta të auditimit dhe gjetjet, edhe pse ende nuk mban konferenca shtypi kur nxjerr raportet e auditimit të performancës së vet institucionit. Komunikimet për shoqërinë civile dhe qytetarët janë përmes faqes së internetit të SAI-t dhe përdorimin e shumtë të radios, duke qenë forma mbizotëruese e komunikimit në vend. SAI nuk ka zhvilluar ende mekanizma për mbledhjen e ankesave ose bilbilfryësve nga publiku.



Konkluzione:

- Qëllimi kryesor i SAI PMF;
- Rëndësia e matjes, raportimit dhe monitorimit;
- Rëndësia e vlerësimit jo vetëm si themel normativ por edhe për të treguar situatën aktuale;
- Sfidat që ndikojnë në performancën e SAI-t;
- Si të përmirësohemi.

*Për më shumë:*

<http://www.bhutanaudit.gov.bt/publi%20cation/SAI%20PMF%20Report%20Bhutan.pdf>

[http://oagnep.gov.np/uploads/022-207172-004\\_Peer%20Review%20by%20SAI-India%20SAI-PMF%202014\(1\).pdf](http://oagnep.gov.np/uploads/022-207172-004_Peer%20Review%20by%20SAI-India%20SAI-PMF%202014(1).pdf)


[https://cgrfiles.cgr.go.cr/publico/docsweb/rev\\_dig/inf\\_olacefs\\_2015/index.html#/1INTOSAI.Donor.Secretariat@idi.no](https://cgrfiles.cgr.go.cr/publico/docsweb/rev_dig/inf_olacefs_2015/index.html#/1INTOSAI.Donor.Secretariat@idi.no)



2. BASHKËVEPRIMI KLSH – MEDIA, NJË MJET PËR RRRITJEN E PËRGJEGJSHMËRISË SË QEVERISË DHE BESUESHMËRISË SË INSTITUCIONIT TEK PUBLIKU

*Referues: Jonild HOXHAI – Auditues i parë.*

Shkurtimisht mbi KLSH dhe Median



Konstituimi i KLSH – së në Shqipëri daton në mars të vitit 1925 me Statutin e Republikës ku kontrolli financiar trajtohet në artikujt e këtij Statuti. Megjithatë forma më të hershme të kontrollit kanë ekzistuar që prej vitit 1912 me Shpalljen e Pavarësisë së Qeverisë së Vlorës ku përmendet nevoja për kontrollin e financave. Me kalimin e viteve vlen të përmendet fakti se deri para viteve '90 ky institucion ka qenë i privuar nga pavarësia dhe po ashtu edhe media.

Për sa i përket kësaj të fundit, në ndryshim nga vendet e tjera ish-komuniste të Lindjes ku kalimi nga tregjet e kontrolluara të medias në tregjet e lira u bë në mënyrë graduale, në Shqipëri ky ndryshim u bë në mënyrë të menjëhershme. Kështu nga dy gazeta të kontrolluara deri para viteve 90, u kalua në gati 30 të tilla të përditshme kryesore dhe të pavarura në ditët e sotme (180 në total përfshirë ato të përjavshme ose mujore).

Për promovimin e rolit të Institucionit të KLSH tek publiku dhe administrata si dhe publikimin e një informacioni lehtësisht të arritshëm, medias i është kushtuar një vëmendje e veçantë për të shpalosur objektivitetin e punës dhe transparencën mbi aktivitetet publike.

KLSH në Media

Një metodë për një shpërndarje sa më të mirë të gjetjeve nga ana e KLSH ka qenë edhe media. Kështu institucioni, në tërësi por edhe nëpërmjet audituesve ka rritur

prezencën e tij duke trajtuar problemet dhe duke i bërë publike ato në bashkëveprim me median.

Një ndryshim i ndjeshëm në drejtim të këtij ndërveprimi, konstatohet edhe nga shkrimet e të përditshmeve në Shqipëri sidomos nga viti 2012 e në vazhdim. KLSH, si një Institucion Suprem Auditimi për të qenë një institucion shembull, ka qenë gjithnjë e më prezent në media duke rritur transparencën e veprimtarisë së tij. Konkretisht në fund të vitit 2015 është rritur prezenca me informacion në median e shkruar me gati gjashtë herë më shumë si dhe është katërfishuar prezenca e tij në median audiovizive, krahasuar këto me vitin 2010.

Një fryt tjetër i këtij ndërveprimi KLSH – Media është edhe ai prezencës së audituesve në shtypin e shkruar. Këto botime jo vetëm shtjellojnë plotësisht çështjet nga audituesit por trajtohen si fenomene prezentë në shoqëri duke i vënë këto publikime para qytetarëve dhe duke i njohur atë me situatën.

Vlen të theksohet fakti se një pjesë e mirë e këtyre botimeve, përveçse janë një vlerë e shtuar, ato bëjnë prezentë për publikun edhe zhvillimet e institucionit, rritjen e kapaciteteve audituese të stafit nëpërmjet trajnimeve, etj.

Nëpërmjet këtyre shkrimeve dhe shfrytëzimit të të gjitha mjeteve të mundshme të komunikimit, institucioni është munduar të bëjë një përjasje mes audituesit dhe qytetarëve si një mbështetës dhe përkrahës në zgjidhjen e fenomeneve korruptive apo burokratike.

Në total numërohen 51 botime të institucionit nga viti 2012. Konkretisht botimet dhe prezenca janë sipas tabelës.

#### Efekti i ndërveprimit me median

Një rezultat i bashkëpunimit me median ka qenë dhe vlerësimi maksimal i ankesave të publikut, për çështje të ndryshme për trajtim nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili është institucion shumë i hapur ndaj ankesave të qytetarëve, të cilat administrohen me profesionalizëm nga punonjësit e KLSH-së në funksion të tematikës që trajtojnë.

Kështu nga viti 2010 deri më sot është rritur më shumë se gjashtë herë numri i ankesave nga qytetarët. Konkretisht nga 65 në vitin 2010 në gati 400 në vitin 2015. Ky fakt tregon se institucioni jo vetëm ka gjetur mënyrën e duhur për të qenë sa më pranë publikut, por ka arritur të fitojë edhe besueshmërinë e tij nëpërmjet një

Ilogaridhënieje sistematike ndaj tij. Llogaridhënia dhe transparenca janë dy mjete shumë të fuqishme sidomos në luftën kundër korrupsionit dhe promovimit të tyre e ka kaluar konceptin për Kontrollin e Lartë të Shtetit në një tjetër dimension, atë të një strukture të përgjegjshme për rolin dhe detyrën që mbart. Shumëkush është i ndërgjegjshëm që sot KLSH është në një shkallë më lartë, ka një tjetër ngjyrë dhe është gjithnjë e më tepër afër me publikun.

Viti	Nr. i Ankesave
2010	65
2011	-
2012	358
2013	401
2014	394
2015	382

#### Paralelizmi KLSH – Media

Kryesisht deri tani kemi folur për KLSH dhe Media. Në kuadër të temës së sotme sot dua të ndalem tek fjala informacion. Kuptohet lidhja që kanë që të dyja këto njësi, si KLSH dhe Media me fjalën informacion.

MEDIA	KLSH
Informacionin është input (indicie)	Informacionin është input (indicie)
Informacionin është output (TV, media, gazetë, radio, etj.)	Informacionin është output (raport)
Informacionin e kërkon sa më të saktë dhe afër realitetit	Informacionin e kërkon sa më të saktë dhe afër realitetit
E ndjeshme në drejtim të besueshmërisë nga publiku	E ndjeshme në drejtim të besueshmërisë nga publiku
Përqasja me publikun (nëpërmjet lajmeve)	Përqasja me publikun (nëpërmjet raporteve)
Trajtojnë probleme (Shpesh deri në zgjidhje të tyre)	Trajtojnë probleme (Shpesh deri në zgjidhje të tyre)
Gëzojnë të drejtën për informacion (në përputhje me kuadrin ligjor)	Gëzojnë të drejtën për informacion (në përputhje me kuadrin ligjor)
Nëpërmjet punës promovon veten dhe fiton kërkesat e sipërmarrjeve për reklamë në media	Nëpërmjet punës promovon veten dhe fiton besueshmërinë e publikut

Dua të sjellë edhe një herë në vëmendje dobinë e publikimit të informacioneve të punës së KLSH-së dhe atyre të audituesve në media, si një elementët mjaft i rëndësishëm i cili së bashku me profesionalizmin, transparencën, integritetin, objektivitetin, kredibilitetin, pavarësinë, paanshmërisë dhe kompetencat e duhura e afron KLSH-në gjithnjë e më tepër me publikun.

Ndajë, një sfidë për të gjithë ne si auditues të rinj të Kontrollit të Lartë të Shtetit do të ishte kontribuimi në media nëpërmjet shkrimeve lidhur me fenomenet të cilat i hasim çdo ditë në punën tonë audituese dhe trajnimet lidhur me përsosjen arsimore – profesionale apo praktikat më të mira, duke qenë gjithnjë konkretë dhe me të gjitha cilësitë që përmenda pak më sipër. Në këtë mënyrë, nëpërmjet shkrimeve, do të kemi një ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e përgjegjshmërisë së qeverisë dhe besueshmërisë ndaj institucionit tonë tek publiku.

Referencat:

- *Drejtoria e Komunikimit Botimit dhe e Marrëdhënieve me Jashtë por ato janë gjithashtu lehtësisht të aksesueshme edhe ne faqen web të KLSH-së: [http://www.klsh.org.al/web/THE\\_SUPREME\\_STATE\\_AUDIT\\_1\\_2.php](http://www.klsh.org.al/web/THE_SUPREME_STATE_AUDIT_1_2.php);*
- *Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit;*
- *Audituesit e KLSH në shtypin e përgjithshëm Vëllimi i III – të.*

### 3. LIDHJA ME ISSAI-ve DHE IPSAS-eve. PSE ËSHTË E RËNDËSISHME?

*Referues: Aulona JONUZI – Audituese e lartë.*



Auditimi i pavarur kërkon baza të shëndosha të raportimit financiar dhe këtë e ofron parimi i kontabilitetit rritës. Objektivi kryesor i një auditimi është të rrisë besueshmërinë e informacionit të raportuar nga audituesit, duke u mbështetur mbi saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit. Nëse mungon informacion i saktë mbi raportimin financiar, raportet e auditimit do të përmbajnë opinione të modifikuara dhe kufizime në qëllimin e raportimit. E kur kjo ndodh, objektivi kyç i sipërpërmendur humbet. Kështu është e qartë që sistemet e raportimit dhe menaxhimit financiar

duhen strukturuar në mënyrë të tillë që të mundësojnë auditime të pavarura.

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit – ISSAI 1200 (ISA 200): “Objektiva e një auditimi financiar është që të mundësojë audituesin të shprehë një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në përputhje me kuadrin raportues financiar të aplikueshëm në fuqi, në të gjitha aspektet materiale. Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme, nëse pasqyrat nuk përmbajnë gabime materiale ose raste fraud-i si edhe të raportojë mbi këto pasqyra sa i takon gjetjeve të tij/të saj”. Duke zbatuar parimin e lëvrimin të pasqyrave gjatë procesit të buxhetimit dhe kontabilizimit, veçanërisht në mungesë të një kuadri raportues të mirëthemeluar (siç janë IPSAS), puna e audituesve padiskutim do të jetë e shtrembëruar, duke cënuar përputhshmërinë me ISSAI-t gjithashtu.

Ajo që më shtyu të shkruaj mbi temën është pikërisht konstatimi në disa raste i mungesës së referencave të sakta gjatë auditimit të pasqyrave financiare dhe si rrjedhojë e një raportimi të cunguar. Në Shqipëri mungon një kuadër rregullator unifikuar standardesh financiare e kjo vihet re gjatë auditimeve të ndryshme, që

konstatohen se njësi të ndryshme publike aplikojnë parime të ndryshme kontabiliteti.

Në kontekstin e sektorit publik, pasuria lidhet me kapitalin e vetë, por pasuria nuk është thjesht “të bësh para”; është më së shumti të menaxhosh burimet, e kur bëhet fjalë për shembull për “Asete të trashëgimisë kulturore”, atëherë çështja merr edhe më shumë rëndësi. Pasi vlera e këtyre objekteve duhet të reflektojë edhe vlerën kulturore të objektit. Gjatë vlerësimit të tyre dhe regjistrimit kontabël, vështirësitë konsistojnë në faktin se këto objekte të trashëgimisë kulturore janë të pazëvendësueshme dhe vlera e tyre rritet me kalimin e kohës, edhe pse kushtet fizike të tyre përqehësohen; si edhe rezultojnë të vështirë të përcaktosh jetëgjatësinë e objektit, e cila në disa raste mund të jetë e pambarimtë (objekte arkeologjike psh). Por nëse ne auditojmë atë çfarë raportohet, pra Asetet e regjistruara me një vlerë minimale (çmimet e para 90-tës), dhe amortizimin e tyre me ...çfarë normë (?)...sikur të jetë një aset i zakonshëm, e që në mungesë të IPSAS ashtu trajtohen (si asetet e çfarëdo), atëherë në rast të një auditimi financiar, ne si auditues shohim a është regjistruar saktë asetit? A ka vendin e duhur në Bilanc? Dhe a mbart vlerën e saktë? Po të gjitha këto pyetje, në referencë të kujt? Ka referenca të cingëruara për asetet e trashëgimisë kulturore, të cilët janë veçanërisht të rëndësishëm për kulturën, historinë dhe identitetin e vendit. Në këtë kontekst njohja e tyre merr rëndësi edhe gjatë raportimit financiar, pasi përdoruesit janë të interesuar për të vlerësuar nëse burimet publike po përdoren në mënyrën e duhur lidhur me to. Nga ana tjetër një raportim financiar i shëndoshë, është mjet i domosdoshëm për vendimmarrje të shëndoshë. Mbi ç’vlera do të sigurohen këto asetet? Mbi ç’vlera do të përlllogariten kostot e mirëmbajtjes? Kush e përcakton vlerën e saktë të asetit? Po normën e amortizimit? Nëse këto objekte humbasin si do të përcaktohet vlera e dëmit? Këtu mund t’i bëjmë referencë Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik (IPSAS 17), me qëllim që vlerësimi dhe kontabilizimi i kryer nga institucioni të rezultojë i besueshëm dhe objektiv. Në këtë kontekst, puna e audituesve do të jetë më e besueshme dhe objektive gjithashtu.

Proceset për një vendimmarrje efektive duhen bërë mbështetur mbi informacion të besueshëm, të cilin kontabiliteti i mbështetur mbi parimin e lëvrimit të parasë nuk e ofron.

Në parim, ajo që ne masim i jep formë asaj çfarë duam të ndjekim... e më pas ajo çfarë ndjekim padyshim përcakton atë që masim! E kështu nëse askush nuk merr

iniciativën të ndryshojë, ngelim brenda një rrethi vicioz, duke qenë edhe shkak, por edhe pasoja e asaj që krijojmë. Si auditues në KLSH, tashmë standardet ISSAI janë "bibla" që udhëheq punën tonë të përditshme. Duke u unifikuar puna e audituesve bëhet më e matshme, si edhe përmbush më së miri qëllimin e saj, atë të llogaridhënies dhe transparencës. Por çfarë auditojmë ne? Ajo çfarë "masim" ne është pika e fillimit. E nëse inputi i punës sonë, do të jetë i cënuar, atëherë puna jonë do të jetë e cënuar gjithashtu.

Parë nga ky këndvështrim, raportimi financiar në sektorin publik, mbështetur në standardet ndërkombëtare - IPSAS, së bashku me auditimin e mbështetur mbi standardet ndërkombëtare - ISSAI, janë hapa të domosdoshëm për t'u ndërmarrë me qëllim adresimin korrekt të çështjeve të menaxhimit dhe raportimit financiar publik. Vlerat dhe benefitet që duhet të ofrojë çdo SAI, bëjnë diferencën në jetët e qytetarëve. Nisur nga ky parim i rëndësishëm që rrjedh nga ISSAI 20 "Parimet e transparencës dhe llogaridhënies", implikimi është i dyanshëm: Të dhënat që shërbejnë si objekt auditimi, duhet të reflektojnë standarde të larta të kontabilizimit dhe raportimit financiar në sektorin publik dhe anasjelltas. Ndërsa në njërin krah të implikimit plotësohet kushti: KLSH mbështet punën e vet mbi standarde ndërkombëtare - ISSAI (njohur tashmë edhe në ligjin e ri të KLSH-së, edhe pse aplikimi i këtyre standardeve ka nisur rreth 3 vite më parë); në Shqipëri vijon të mungojë një proces kontabilizimi dhe raportimi financiar, mbështetur mbi një kuadër të provuar dhe të unifikuar standardesh, ato IPSAS.

Kontabilizimi dhe raportimi i shëndoshë ka rëndësi në kuadër të menaxhimit korrekt të financave publike. Kështu, për ta ilustruar me një shembull dukurinë, sjellim rastin e Zelandës së Re, si vendi i parë në botë që ka konsoliduar pasqyrat financiare vjetore. Sot, ky vend jo vetëm vazhdon me sukses publikimin e këtyre pasqyrave çdo vit, brenda 4 muajve nga fundi i vitit; ai gjithashtu publikon pasqyra financiare mujore, brenda 6 javëve, që do të thotë: "nëse qeveria merr një vendim, me impakt fiskal jo të favorshëm, ky lajm do të jetë në gazeta brenda 6 javëve!".

Aplikimi i kontabilitetit rritës është i rëndësishëm në terma të menaxhimit të performancës dhe jo në terma të kontabilitetit në vetvete. Pasqyrat financiare ndërtuar mbi parimin e kontabilitetit rritës, japin informacion të saktë mbi nivelin e borxhit si edhe mundësitë për ta menaxhuar më mirë atë; sigurojnë informacion të saktë sa i takon kostos së shërbimit që njësi publike po ofron për qytetarët duke rritur përgjegjshmërinë e këtyre njësive; por çfarë është e rëndësishme gjithashtu

kontabiliteti rritës, mbështetur mbi IPSAS është i rëndësishëm më së shumti në kuadër të krahasueshmërisë (të kostove me sektorin privat ose edhe mes shtetesh) e cila merr rëndësi gjatë vendimmarrjes në kontekstin e 3 “e”-ve. Po në Shqipëri, a ofron transparencë raportimi financiar? Nëse njëzia publike merr një vendim, a jemi në gjendje të llogarisim impaktin fiskal? A marrim informacion mbi nivelin e saktë të borxhit, mbështetur mbi pasqyrat financiare? A shërbejnë këto pasqyra si mjet efektiv, në vendimmarrje? Raportimi financiar në Shqipëri ofron thjesht një pamje të flukseve hyrëse dhe dalëse të parasë, duke mos ofruar informacion në terma të menaxhimit të performancës. Aplikimi i kontabilitetit rritës, mbështetur mbi IPSAS merr rëndësi pikërisht në këtë kontekst.

Bazuar mbi standardet INTOSAI, parimet themelore të auditimit diktojnë se me rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, rritet kërkesa për përgjegjshmëri publike e personave ose njësive që menaxhojnë fondet publike, duke diktuar kështu nevojën e ekzistencës së një procesi llogaridhënieje, i cili të funksionojë në mënyrë efektive (ISSAI 20 – Parimet e Transparencës dhe llogaridhënies). Nga ky këndvështrim, nën regjimin e parimit të lëvrimit të parasë, nëse kuadri i punës nuk është i saktë dhe i plotë, puna e audituesve është veçanërisht e rrezikuar.

Shoqëria civile dhe publiku i gjerë gjithashtu, ka nevojë të përdorin informacion financiar. Informacioni është një e mirë publike, sa më shumë të jemi të informuar rreth asaj çfarë po ndodh me paratë tona, aq më mirë do të jetë e aftë të funksionojë demokracia jonë.

IPSAS janë dizenuar që të aplikohen në pasqyrat financiare të gjithë njësive të sektorit publik dhe janë zhvilluar më së shumti dhe kryesisht për një kontekst kontabël mbështetur mbi parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Mirëpo, ndërsa aplikimi i IPSAS nuk mund të zgjidh probleme që lidhen psh me borxhin publik, përdorimi i saktë i informacionit që vjen pikërisht nga aplikimi i këtyre standardeve do të ndihmojë vendimmarrësit dhe grupet e interesit për të vlerësuar implikimet që vijnë nga vendimet fiskale të propozuara ose të ndërmarra nga qeveritë (p.sh. mungesa e një kuadri ligjor dhe rregullativ sa i takon vlerësimin të objekteve të trashëgimisë kulturore, për të cilat na vijnë në ndihmë standardet). Për të dhënë siguri, raportimi financiar i mbështetur mbi IPSAS – një kuadër raportues dhe set standardesh me cilësi të lartë – synon të realizojë auditime shumë cilësore të pasqyrave financiare qeveritare. Kjo çështje është e rëndësishme, veçanërisht për audituesit e sektorit publik, institucionet supreme të auditimit dhe



Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), e cila është përgjegjëse për dhe në interesa të – auditimit të informacionit qeveritar dhe raportimit. Përdorimi i IPSAS ofron një bazë solide dhe kritere të përshtatshme mbi të cilat ngrihet puna e audituesve.

Nevoja për kontabilitet të mbështetur mbi parimin e angazhimeve njihet gjithashtu nga Parlamenti Evropian, projekt-rezoluta legjislative e të cilit mbi "Raporti mbi propozimin për direktivën e Këshillit sa i takon kuadrit buxhetor të shteteve anëtare" përfshin: "*... vendet anëtare duhet të kenë sisteme kontabiliteti të cilat aplikojnë parimin e angazhimeve dhe që mbulojnë gjithë nën-sektorët e qeverisjes së përgjithshme siç përcaktohet në Rregulloren (EC) Nr. 2223/96 (ESA 95). Këto sisteme duhet të jenë subjekt i kontrolleve dhe auditit të pavarur (Parlamenti Evropian, 2011)*".

Nëse procesi i raportimit financiar do të eci me të njëjtat ritme, në kuadër të përqafimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit dhe kontabilizimit financiar, sikundër auditimi me standardet e auditimit (me ISSAI-të), atëherë gjasat për një menaxhim të mirë të financave publike janë më të larta; adresimi i qartë i përgjegjësive gjithashtu; si edhe vlerësimi i saktë i kostos së shërbimeve të ofruara për publikun e gjërë.

Kështu nëse bëjmë një analizë të trendit të aplikimit të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, shohim se aplikimi i standardeve IPSAS ka ngelur pothuajse në stanjacion (IPSAS vetëm janë përkthyer dhe nuk konstatohen masa reale për implementimin e tyre). Është vërtetuar tashmë, nga vende që aplikojnë standardet se ajo çfarë shënon mungesën e progresit janë përfitimet që do t'i ofronte Shqipërisë, aplikimi i standardeve të kontabilitetit rritës. Këto përfitime ndahen në dy grupe, të cilat të dyja mbështesin rritjen ekonomike të qëndrueshme dhe krijimin e vendeve të punës, si edhe krijojnë besim dhe siguri te qytetarët, bizneset dhe investitorët. Grupi i parë i referohet përfitimeve pozitive që kontribuojnë direkt në rritjen e qëndrueshmë ekonomike, nëpërmjet përmirësimit të procesit të vendim-marrjes publike. Grupi i dytë ka të bëjë më së shumti me rritjen e masave mbrojtëse nga risqet dhe dështimet e kontrollit, dhe rezultatet nga rritja e transparencës qeveritare dhe përforcimin e përgjegjshmërisë. Një nga mësimet e nxjerra nga kriza financiare, veçanërisht e Greqisë, ishte të kuptuarit e dobët që qeveritë kishin sa i takon pozicionit fiskal të tyre.

Ndërkohë që KLSH ka nisur më herët përpjekjet për aplikimin e standardeve ndërkombëtare ISSAI, dhe i ka intensifikuar ato edhe më shumë pas vitit 2012 me përkthime manualesh, standardesh si edhe kryerje të auditimeve financiare pilot, mbështetur mbi ISSAI-të, maksimizimi i përpjekjeve të KLSH u reflektua pastër në Ligjin e ri Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në nenin 6 të të cilit përcaktohet se: “Kontrolli i Lartë i Shtetit auditon në përputhje me Kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore, manualet në fuqi, si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij, duhet të reflektojë shkallën më të lartë të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe IFAC-it, si dhe rezolutat e Kongreseve të INTOSAI-t dhe EUROSAT-t”. Por ndërsa ligjërisht KLSH e ka autoritetin për implementimin e standardeve, në kuadër të mungesës së një seti të unifikuar standardesh të raportimit financiar, faktikisht ka vështirësi në implementimin e tyre.

Jack Welsh ka thënë: Nëse norma e ndryshimit së jashtmi tejkalon normën e ndryshimit së brendshmi, atëherë fundi është afër!

Implementimi i ISSAI-ve duhet të shërbejë si nxitës për fillimin e implementimit të IPSAS-eve, në kuadër të një menaxhimi më të mirë të financave publike.

#### Referencat:

- Guthrie, J., 1998. *Application on accrual accounting in the Australian public sector- rethoric or reality?*, *Financial Accountability & Management*, 14 (1), fq. 1-19.
- *New Perspectives on Corporate Social Responsibility*, Linda O’Riordan, Piotr Zmuda, Stefan Heinemann.
- *Achieving High Performance in the Public Sector*, André A. de Waal.
- *Preparatory work for the modernisation of public sector accounting systems on an accrual basis*, European Commission, Eurostat.
- *Public Governance and Territorial Development*, OECD Paris, *The Principles of Budgetary Governance*.
- *Europe Slow to Adopt New Accounting Standard Despite Greek Crisis*, Simon Nixon.
- *Auditimi real në Qendrën e Studimeve Albanologjike*.
- *Financial Regulation/EU and IPSAS*.

#### 4. SFIDAT E MARRËDHËNIES AUDITUES – SUBJEKT I AUDITUAR

*Referues: Jorida ZHEGU – Audituese e parë,  
Yaron FISHMAN<sup>22</sup>*

Qëllimi i këtij punimi, është të sigurojë një skemë që synon të shqyrtojë sfidat që sjell asimetria e informacionit në marrëdhënien “auditues – subjekt i audituar”. Ky punim sjell një këndvështrim të procesit auditues nga kolegu i SAI-t Izraelit z.Yaron Fishman, gjithashtu qasjen në një studim të përditësuar me praktikat audituese në KLSH, me qëllimin e përvetësimit të njohurive nga praktikat që rrjedhin nga eksperiencia e përbashkët, të cilat i shërbejnë profilit të punës tonë. Çështjet që do paraqiten në këtë punim kanë të bëjnë me prezantimin në formë skematike të sfidave me të cilat përballet një auditues relativisht i ri në aktivitetin që ai ndërmerr, gjatë procesit të auditimit dhe problematikat me të cilat ai përballet gjatë këtij procesi, duke e shpjeguar hap pas hapi dhe sipas praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare duke vënë në zbatim standardet ISSAI, gjatë dokumentimit të punës audituese që nga programimi dhe deri tek përfundimi i auditimit. KLSH synon që të ndërtojë dhe zhvillojë një kuadër të plotë dhe gjithëpërfshirës të standardeve të punës audituese, të tillë që të reflektojë pajtueshmëri me ISSAI-t, të aftësojë dhe pajisë audituesit me njohuritë dhe dijet e nevojshme për kryerjen e auditimeve cilësore, në përputhje me Standardet dhe Praktikrat më të mira ndërkombëtare të Auditimit Publik. Miratimi i Ligjit nr 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i mbështetur dhe vlerësuar me nota të larta pozitiviteti nga Organizmat e BE-së, dhe ekspertët ndërkombëtarë, si



---

<sup>22</sup> Yaron FISHMAN – Auditues në SAI-n Izraelit.

një ligj plotësisht në pajtueshmëri me standardet e INTOSAI-t, shënoi momentin historik për KLSH dhe vendosi një gur themeli për auditimin publik në Shqipëri<sup>23</sup>.

Iniciativa dhe përkushtimi i KLSH për të siguruar që veprimtaria audituese të kryhet në pajtueshmëri me ISSAI-t, njihet më herët. Botimi i librit “Standardet e INTOSAIT” në Dhjetor 2012 i hapi rrugën një tërësie botimesh të Udhëzuesve të INTOSAI- ISSAI të niveleve të tjera të cilët do të bëheshin më vonë baza e njohjes me kërkesat e këtyre standardeve nga audituesit e KLSH ashtu dhe palëve të tjera të interesuara. Botimi “Standardet e Auditimit INTOSAI” përfshin një përmbledhje të tre niveleve të para (ISSAI 1,10, 20, 30, 40, 100, 200, 300, 400) dhe është ndjekur nga botime të tjerë të ISSAI-ve, që përcaktohen si tepër të rëndësishëm dhe vendimtar për të mbështetur rrugën e ndryshimit që KLSH ka ndërmarrë dhe ndjek me vendosmëri prej disa vitesh tashmë.

Botimet e ISSAI-ve përfshijnë:

*Udhëzuesi i Auditimit të Performancës, ISSAI 3000-3100*<sup>24</sup>;

*Manual i Auditimit të Departamentit të Performancës*<sup>25</sup>;

*Indikatorët e performancës*<sup>26</sup>.

Botimet e mësipërme janë në funksion të përmbushjes së objektivave strategjik për rritjen e cilësë dhe numrin e auditimeve të performancës nëpërmjet implementimit të ISSAI dhe praktikave me të mira të fushës.

“Udhëzuesi i Auditimit Financiar, ISSAI 1000-2999 (Shënimet Praktike)”, sjell përpara audituesit shqiptar një punë rreth 12 vjeçare të komunitetit ndërkombëtar të auditimit suprem, për të vendosur rregulla të qarta në auditimin financiar.

“Udhëzuesi për Auditimin e Përputhshmërisë, ISSAI 4000, 4100, 4200”. Auditimi i përputhshmërisë, krahas auditimit financiar dhe auditimit të performancës, është ndër auditimet bazë të shkencës së auditimit suprem publik. Ai promovon transparencën, me anë të përgatitjes së raporteve të besueshme nëse fondet publike janë shpenzuar, si dhe menaxhimi dhe proceset publike, janë kryer në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Botimi në shqip i këtyre ISSAI-ve

<sup>23</sup> [http://www.klsh.org.al/web/Baza\\_Ligjore\\_90\\_1.php](http://www.klsh.org.al/web/Baza_Ligjore_90_1.php)

<sup>24</sup> [http://www.klsh.org.al/web/Botime\\_445\\_1.php?kc=0,1,13,0,0](http://www.klsh.org.al/web/Botime_445_1.php?kc=0,1,13,0,0)

<sup>25</sup> [http://www.klsh.org.al/web/Botime\\_445\\_1.php?kc=0,1,13,0,0](http://www.klsh.org.al/web/Botime_445_1.php?kc=0,1,13,0,0)

<sup>26</sup> [http://www.klsh.org.al/web/Botime\\_445\\_1.php?kc=0,1,13,0,0](http://www.klsh.org.al/web/Botime_445_1.php?kc=0,1,13,0,0)  
[http://www.klsh.org.al/web/Plani\\_Strategjik\\_92\\_1.php](http://www.klsh.org.al/web/Plani_Strategjik_92_1.php)

mbështet hartimin dhe zhvillimin e Manualeve specifike për çdo lloj auditimi, si Manuali i Auditimit Financiar, Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë dhe së fundmi Manuali i Auditimit të Performancës<sup>27</sup>.

Problematikat që synohet të marrin një përgjigje gjatë procesit auditues janë:

- Si mund të veprojmë kur ndodhemi përpara sfidave që sjell asimetria e informacionit në marrëdhëniet auditues – subjekt i audituar?
- Sigurimi i njohurive të thelluara mbi sfidat që rrjedhin nga informacioni asimetrik në marrëdhënien auditues- subjekt i audituar.
- Sigurimi i mjeteve për të shqyrtuar sfidat që rrjedhin nga informacioni asimetrik në marrëdhënien auditues - subjekt i audituar.

### Çështja e asimetrisë së informacionit - Aspekte teorike

*Bazat e menaxhimit të procesit auditues janë:*

- Evidencat;
- Kriteret;
- Gjetjet;
- Konkluzionet;
- Rekomandimet.

Sipas ISSAI 12: Një nga objektivat e KLSH-së është “të bëjë një ndryshim në jetën e qytetarëve, duke forcuar llogaridhënien, transparencën dhe integritetin e qeverisë dhe enteve të sektorit publik.

Sipas ISSAI 4001<sup>28</sup> - Parimet kryesore të auditimit të përputhshmërisë, për evidencat Audituesit duhet të marrin evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbuluar fushën që auditohet.

Ndërsa për kriteret audituesit duhet të identifikojnë kriteret e përshtatshme për të siguruar bazën e të dhënave për vlerësimin e evidencave audituese dhe përpunimin e gjetjeve dhe konkluzioneve të dala nga auditimi.

---

<sup>27</sup> [http://www.klsh.org.al/web/Revista\\_Shkencore\\_441\\_1.php](http://www.klsh.org.al/web/Revista_Shkencore_441_1.php)  
[http://www.klsh.org.al/web/Plani\\_Strategjik\\_92\\_1.php](http://www.klsh.org.al/web/Plani_Strategjik_92_1.php)

<sup>28</sup> [http://www.klsh.org.al/web/Plani\\_Strategjik\\_92\\_1.php](http://www.klsh.org.al/web/Plani_Strategjik_92_1.php)  
<http://www.reg.co.il/yes2/workingsessions.ehtml>

Cështja e asimetrisë së informacionit- Aspekte logjike

Nëse menaxhojmë mbledhjen e një evidence të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të identifikuar kriteret e duhura atëherë kemi parasysh skemën:

Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet = Kriteret + Evidenca

Duke marrë në konsideratë faktorin kohë dhe duke patur parasysh asimetrinë e informacionit, fazat e auditimit janë:

1. Fillimi i Auditimit është i cili procesi vendos subjektin e audituar përballë audituesit dhe gjatë këtij procesi lind pyetja kryesore për informacionin që audituesit duhet të ketë në fillim të auditimit.
2. Auditimi, gjatë së cilës duhet të mbahet në ekuilibër marrëdhënia auditues – i audituar, për shkak të asimetrisë së informacionit, duke pasur parasysh edhe sfidat e identifikimit të problematikave që lindin gjatë mbledhjes së informacionit në subjektin që auditohet. Në mënyrat që zgjedh audituesi për tu marrë me sfidat që sjell asimetria e informacionit, duhet të ketë parasysh përdorimin e mjeteve bazë dhe ato të avancuara, që janë mbledhja e evidencave të mjaftueshme audituese dhe identifikimi i kriterit të përshtatshëm për të audituar subjektin.
3. Përfundimi i Auditimit është procesi i cili ka të bëjë me përpunimin e gjetjeve nga konkluzionet dhe rekomandimet dhe si rrjedhojë publikimin e raportit përfundimtar të auditimit.

Stafi profesionist auditues është i ekspozuar ndaj asimetrisë së informacionit për shkak të dy aspekteve madhore kryesore të menaxhimit auditues:

- a. Sfidat nga evidencat që vijnë si pasojë e dështimit të stafit të subjektit të audituar për t'i dhënë stafit auditues evidencë/prova auditimi.
- b. Njohuritë dhe eksperiencia e stafit të audituar është më e madhe sesa ajo e stafit auditues.

Dy nga pyetjet kryesore që i lindin stafit auditues, gjatë procesit auditues janë:

1. Si mund të mbledhim evidencë të përshtatshme audituese për të mbuluar fushëveprimin e auditimit?
2. Si mund të identifikojmë kriteret e duhura për të siguruar një bazë vlerësimi për të përpunuar evidencën, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet?

Gjatë procesit auditues, stafi auditues përballet me sfidat që sjellin kriteret e përdorura. Stafi i subjektit të audituar dështon t'i sigurojë informacion stafit auditues<sup>29</sup> për shkak të:

Mungesës së dokumentacionit, si p.sh. protokollit, përmbledhjes së diskutimeve, llogaritjes;

Aksesit të pjesshëm ndaj sistemit të informacionit auditues, si p.sh e-mailit, si e dhënë private e audituesit;

Stafi auditues i dalë në pension ose stafi i mbetur në entin e audituar;

Sjellja strategjike. Stafi auditues nuk ka vullnet për të bashkëpunuar ose bashkëpunim i pjesshëm.

Audituesi për të marrë informacion nga subjekti i audituar në rastin më të mirë duhet të përdorë sjellje strategjike, duke bashkëpunuar me subjektin e audituar dhe duke pasur parasysh detyrimet ndaj publikut që kanë zyrtarët e audituar, gjithashtu këto zyrtarë duhet të kenë aftësinë për të pranuar kritika, si dhe eksperiencën e mirë me ish-auditues.

Në rastin e bashkëpunimit të pjesshëm audituesi, gjendet përballë sfidës që rrjedh nga mungesa e vullnetit të subjektit të audituar, për të treguar informacion mbi entin që auditohet (plotësisht ose pjesërisht) dhe me dorëzimin e pjesshëm ose të vonuar të dokumentacionit duke dhënë dëshmi të pasigurta. Kjo sjell si pasojë vështirësi në analizimin dhe nxjerrjen e konkluzioneve. Mungesa e bashkëpunimit nga stafi i audituar mund të vijë si pasojë e eksperiencës së keqe në auditime të mëparshme nga kontrolli i lartë i shtetit, frika nga rezultatet e auditimit dhe për rrjedhojë sjell tek stafi auditues, krijimin e vështirësive për auditimin si një strategji, për të sjellë pritshmërinë e zvogëlimit të forcës së auditimit në subjektin e audituar.

### Mjetet bazë për t'u marrë me sfidat e evidencave nga procesi auditues

Sfidat që sjellin evidencat gjatë procesit auditues, bëjnë që stafi auditues të përdorë një strategji auditimi duke krijuar një marrëdhënie të mirë me stafin e audituar,

---

<sup>29</sup> <http://www.reg.co.il/yes2/workingsessions.ehtml>

duke marrë masa për të zhvilluar e biseda të vogla por pa teprim, zvogëlimin e frikës që mund të vihet re tek stafi i audituar, ndjeshmëri dhe durim ndaj vështirësive të subjektit të audituar, vendosmëri dhe këmbëngulje në kërkesat për informacion, përgatitja për takime dhe kërkesat për informacione, marrje e informacionit për stafin e audituar (pyetje për kolegët, kërkime në google), biseda me stafin e audituar të dalë në pension, biseda me stafin me eksperiencë të cilët nuk janë subjekt auditimi, biseda me stafin nga ente të cilat janë në konflikt me entet e audituara dhe kujdesin nga konfliktet e interesit dhe analizimi i informacionit dhe nëse është e mundur leximin e ankesave mbi entin që auditohet.

### Mjete të avancuara për trajtimin e sfidave nga evidencat/provat gjatë procesit auditues

#### *Përdorimi i mjeteve lojë/teori:*

Gjatë procesit të auditimit, audituesi duhet të ketë parasysh që në kërkesat për informacion dhe marrjen e përgjigjeve nga subjekti i audituar, të ketë konceptet bazë se çfarë të pyesë, si të pyesë, kë të pyesë dhe kur të pyesë. Për një përgjigje sa më koncize nga subjekti i audituar, stafi auditues duhet të përdorë stimuj dhe sinjalizues për të zbuluar problematikat që vijnë si pasojë e mungesës së bashkëpunimit nga subjekti i audituar. Stimujt pozitivë që stafi auditues përdor në subjektin e audituar për marrjen e informacionit mund të përmbliidhen në formë pyetësorësh të cilët evidentojnë profesionalizmin e subjektit të audituar. Në rastet e mungesës së bashkëpunimit nga subjekti i audituar, stafi auditues mund të evidentojë përgjegjësinë e subjektit të audituar në çështjet që shqyrtohen nga auditimi dhe nëpërmjet kësaj taktike të marrë informacionin e kërkuar, duke bërë të njëjtën pyetje dhe duke kombinuar të dhënat nga burime të ndryshme. Në rastet e informacionit të papritur nga burime të ndryshme, drejtuar stafit auditues masat që duhen marrë janë dëgjimi dhe krahasimi me kujdes i përgjigjeve të subjektit të audituar, sepse mund të zbulojë informacion mbi subjektet e tjera të audituara. Një tjetër sfidë që i paraqitet stafit auditues është kur stafi i audituar nënvlerëson drejtimin e auditimit, dhe mund të zbulojë informacion mbi subjektet të reja për auditimin aktual ose auditime të ardhshme, duke u ndjerë përgjegjës për gjetjet që nuk konsideroheshin më parë.

Sfidë e rëndësishme me të cilën përballët një auditues relativisht i ri gjatë procesit auditues është fakti se njohuria dhe eksperiencia e stafit të audituar në subjektin e



audituar, është më e madhe se ajo e stafit auditues<sup>30</sup>, dhe kriteret për të zbutur asimetrinë e informacionit që lind si pasojë e marrëdhënies subjekt i audituar-auditues janë eksperiencia e stafit auditues, edukimi profesional, programet e vazhdueshme trajnuese, konferencat profesionale, bashkëpunimi me kolegët, burimet e brendshme të të dhënave, informacionet në brendi të subjektit që auditohet dhe informacioni i vlefshëm publik.

Një aspekt i rëndësishëm i riskut me të cilin përballet një auditues në subjektin e audituar është sjellja strategjike e subjektit të audituar duke kundërshtuar pranimin e kritikave dhe të kriterëve audituese.

Për trajtimin e sfidave nga kriteret gjatë auditimit stafi auditues ka si mënyrë kryesore dhe strategjike:

- a. Përdorimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit ISSAI;
- b. *Kriteret ligjore dhe legislative*: kushtetuta, ligjet bazë, aktet ligjore dhe nënligjore, vendimet e bashkisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga qeveria dhe parlamenti, vendimet gjyqësore, udhëzimet dhe opinionet e Prokurorit të Përgjithshëm, rekomandimet nga Komisionet Hetimore Parlamentare, propozimet ligjore – vërejtjet shpjeguese të cilat tregojnë informacion të dobishëm, protokollat e mbajtura në Parlament nga Komisionet Parlamentare;
- c. *Kriteri qeverisës*: VKM (Vendimet e Këshillit të Ministrave), rekomandimet e Komisioneve Qeveritare;
- d. *Kriteret e subjekteve të audituar*: dokumente të publikuara, dokumente të brendshme të papublikuara;
- e. *Raportet e Institucionit Suprem të Auditimit*: gjetje nga auditimi i mëparshëm, konkluzione dhe rekomandime, reagimi i subjektit të audituar nga raportet e mëparshme;
- f. *Kriteret ndërkombëtare*: rregullore ndërkombëtare bankare, rregulloret ndërkombëtare për sigurimet, standardet ndërkombëtare për mjedisin, rregullore nga subjekte të tjera ndërkombëtare, literatura profesionale dhe punë kërkimore.

---

<sup>30</sup> <http://www.reg.co.il/yes2/workingsessions.ehtml>

Ekulibri i asimetrisë së informacionit mund të ndryshojë në favor të audituesit duke bërë analiza vetë vlerësuese dhe llogaritje<sup>31</sup>, prezantim të shkallës së rëndësës së gjetjeve, zbulimi të ndikimit në llogaritjet e audituesit. Analizat vetë vlerësuese, mund të zbulojë paragjykimet në llogaritjet e subjektit të audituar. Konsideratat e parëndësishme janë të vështira për tu provuar megjithatë këto konsiderata mund të shpien në paragjykimet nga audituesi për llogaritje të qëllimshme në llogaritjet e bëra nga stafi i audituar. Audituesi në këtë rast mund të përdorë analiza ekonomike dhe statistikore, të cilat duhet të bazohen në literaturë profesionale dhe kërkimore, kritere ndërkombëtare, kontroll të llogaritjeve të kryera nga subjekti i audituar ose ristrukturimi i llogaritjeve nga subjekti i audituar.

Një analizë intensive dhe e rinovuar mund të forcojë gjetjet ose mund të zbulojë gjetje të reja. Përdorimi dhe kombinimi i disa kritereve bazë dhe të avancuara mund të kontribuojë në fuqinë e gjetjeve dhe mjetet e avancuara gjatë procesit auditues, mund të zbulojnë gjetje në çështje ku mjetet bazë nuk mund të veprojnë, si p.sh Auditimi i Performancës (Ekonomiciteti, Efienca dhe Efektiviteti)<sup>32</sup>. Kombinimi i kritereve nga burime të ndryshme nëpërmjet një analizë intensive dhe të rinovuar mund të forcojë gjetjet ose mund të zbulojë gjetje të reja.

Risku i auditimit nga mjetet e avancuara për të trajtuar asimetrinë e marrëdhënies subjekt i audituar-auditues, mund të vijë si pasojë e përdorimit të një literature profesionale dhe kërkimore e cila mund të jetë subjekt kontradikte me një literaturë tjetër, ose kriteri ndërkombëtar mund të mos jetë i përshtatshëm për kushtet lokale, krahasimet ndërkombëtare mund të jenë të paragjykuara për shkak të ndryshimeve të mënyrës së raportimeve nga shtete të ndryshme të cilat kanë standarde raportimi të papajtueshme me standardet ligjore kombëtare të auditimit ose llogaritjet e kryera nga vetë stafi auditues mund të jenë me gabime.

### Konkluzione:

Gjatë eksperiencës time të punës si audituese në KLSH dhe konkretisht që nga viti 2013 e në vazhdim, vlejnjë për tu theksuar politikat vendimmarrëse në institucion si shtysë konstante për të përmirësuar cilësinë e punës audituese, duke vënë në zbatim praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare sipas standardeve


<sup>31</sup>[http://www.klsh.org.al/web/IntoSAINT\\_Manuali\\_i\\_Vetevleresimit\\_te\\_Integritetit\\_per\\_Institucionet\\_Supreme\\_te\\_Auditimit\\_1103\\_1.php](http://www.klsh.org.al/web/IntoSAINT_Manuali_i_Vetevleresimit_te_Integritetit_per_Institucionet_Supreme_te_Auditimit_1103_1.php)

<sup>32</sup>[http://www.klsh.org.al/web/Indikatorete\\_te\\_Performances\\_1453\\_1.php](http://www.klsh.org.al/web/Indikatorete_te_Performances_1453_1.php)

ISSAI. Me praktikën më të mirë kombëtare kam parasysh, trajnimet nga kolegët auditues që kanë krijuar një profil të konsoliduar në institucion, materialet e të cilëve shërbejnë si një shkollë gjatë procesit të auditimit dhe që në raste të caktuara mund të shërbejnë si etalonë për studimin e çështjeve të cilat kanë rëndësi gjatë fazave nëpër të cilat kalon ky proces. Në këndvështrimin e marrëdhënies Auditues–Subjekt i Audituar, vlen për tu theksuar, zbatimi i Ligjit Nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe studimi i vazhdueshëm i Legjislacionit Shqiptar, i standardeve ISSAI si kërkesa kryesore për mbarëvajtjen e praktikës audituese në çdo fazë të auditimit, gjithashtu zbatimi i kodit të etikës si një nga standardet bazë të çdo ndërveprimi gjatë procesit auditues. Pavarësisht sa më lart audituesi në formimin e tij duhet të kërkojë me këmbëngulje të jetë sa më origjinal, të kultivojë nuhatjen në gjetjet e tij dhe për të arritur këtë, duhet medoemos të ketë njohuri të mjaftueshme për profilin e subjektit të cilin auditon. Studimi i subjekteve të cilat auditohen, është kriter thelbësor në mbarëvajtjen dhe evidentimin e pikave kyçe në të cilat do të shtrihet auditimi në tërësi. Qasja e audituesit në kërkesat për informacion ndaj subjektit të auditimit duhet të jetë e qartë, konçize dhe etike, për të zbutur sadopak asimetrinë në marrëdhënien Auditues –Subjekt i Audituar.

## 5. SAI NË NJË SHOQËRI MULTIKULTURORE

*Referues: Melina KABO – Audituese e dytë.*



Me mbylljen e vitit 2015 shoqëria shqiptare përmbylli një periudhë 25 vjeçare që nga rënia e komunizmit. Një shoqëri e mbyllur dhe e izoluar u rrëzua. Arsyet ishin të shumta, historike dhe konkrete, të brendshme dhe të jashtëme; porse është vendi të vëmë në pah se ajo shoqëri ishte tipike ku individi dhe shoqëria shkrihen në një të vetme me shtetin totalitar në krye të të cilit ishte udhëheqja e në majë qëndronte udhëheqësi i “pagabueshëm”. Bazuar në parimin dogmatik marksist se “ne jemi të pagabueshëm ndaj jemi të pakritikueshëm” udhëheqja e asaj kohe nuk pranonte as opozitë politike dhe as oponencë civile. *Edhe shifrat*

*financiare, ekonomike, monetare, jepeshin jo të sakta shpesh të fryra dhe ireale me qëllim për të krijuar jashtë vendit përshtypjen se në Shqipërinë Socialiste gjithçka shkante shumë mirë, vendi po përparonte duke sfiduar sistemin kapitalist. Është tipike për vendet komuniste dizinformimi i opinionit brenda dhe jashtë vendit.*

*“Demokracia përmes ligjit” ishte detyra në hyrje të viteve 90-të. Shteti Ligjor dhe Liritë e të Drejtat e Njeriut, kjo ishte traseja e reformimit të shoqërisë sonë që në fund të komunizmit kishte këto tipare: Shoqëri e prapambetur ekonomikisht, njerëzit pa prona dhe pa liri fjale, izolimi total, ndërgjegje e ulët juridike, kulturë e pamjaftueshme institucionale, mungesa e kulturës plurale, mos-egzistenca e tolerancës dhe bashkëjetesës në diversitet. Bota e sotme globale, edhe në vendet më të zhvilluara kapitaliste e me një demokraci tejet të zhvilluar është duke u ndeshur me problematika të thella si psh: “Kapitalizmi dhe demokracia nuk ndërtohen dhe udhëhiqen nga të njëjtët parime”; “Kriza e përfaqësimit” që nuk respekton parimin “jam i tatuar duhet të jem edhe i përfaqësuar”, apo më tej akoma. “Funksioni njohës është dobësuar dhe i është zënë vendi nga funksioni manipulativ” që manifestohet në sjelljen e politikanëve që kërkojnë votën e*

zgjedhësve; "duke ju premtuar atyre jo ato objektiva që mund të realizohen por atë që njerëzit duan dhe që në fakt politikanët nuk mund t'i bëjnë dot realitet, madje edhe për shumë kohë. Të gjitha këto dobësi, mund të përmbliidhen në një princip. *"Marrëdhënia me të vërtetën"*. Si është ky raport në shoqërinë shqiptare? A e ndërtojmë ne atë në mënyrë demokratike? A ka një sjellje institucionale ndaj së vërtetës jo thjesht në aspektin moral, por mbi të gjitha dhe para së gjithash në aspektin e financave publike. Pra a e dinë qytetarët se çfarë ndodh me taksat e tyre? Si mblidhen dhe sa mblidhen? Si hynë në buxhetin e shtetit dhe si rishpërndahen për shëndoshjen e gjendjes ekonomike dhe financiare? Si Ju rikthehen qytetarëve si investime publike? A administrohen financat publike me kujdes ligjor? Ka shpëdorime? Nëse ka, pse? Cili është shkaku apo cilët janë shkaqet? A njihet dëmi, po përgjegjësia? A merren masa për ta prevenuar gjendjen apo realitetet abuzive? Nëse shoqëria dhe qytetari, qoftë edhe ai në një zonë nënurbane apo në një hapësirë të largët rurale, nuk merr një informacion të tillë të freskët dhe të besueshëm në përgjigje të këtyre pyetjeve, atëherë në jemi në një shoqëri të hapur të lirisë dhe pluralizmit, por ne kemi ende një pjesë të shoqërisë që nuk interesohet për të ndërtuar mardhëniet me të vërtetën. Në kësi rrethanash demokracia është e parealizuar si duhet. Institucionalizmi mbetet i rrezikuar, ndërsa zhvillimi shoqërisë i penguar. Burimet e informimit janë të ndryshëm. Është media audiovizive dhe ajo e shkruajtur. Janë institucionet e specializuara që kanë detyrim ligjor dhe kushtetues që të informojnë dhe i tillë është KLSH (SAI). *Ndaj në Ligjin për KLSH që ka hyrë në fuqi më 1 janar 2015 tek Dispozita të Përgjithshme, Neni 2 Qëllimi, shkruhet: Kontrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet auditimeve, synon përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raporteve të tij.*

Roli i SAI-t është kryesor, ai si një "Watch Dogs" ndjek se si kuptohen dhe zbatohen detyrimet që burojnë nga Kushtetuta dhe Ligji. Sa njihen dhe si zbatohen rregullat dhe detyrimet administrative, dokumentare shkresore dhe të çdo lloji apo karakteri qofshin. KLSH ndjek me kujdes dhe me skrupulozitet se si pëdoren fondet publike që vijnë nga buxheti shtetit edhe kur ato përdoren nga subjekte shtetërore dhe publike, por edhe kur u delegohen si shërbime enteve apo subjekteve jo të tillë; por që përdorin fonde publike. SAI kontrollon performancën e institucioneve dhe

organeve publike që të evidentojë në proces dhe të sygjerojë se si mund të përmirësohen tre "e"-të; Efektiviteti, Efienca dhe Efektshmëria e performancës së institucioneve publike qëndore apo lokale qofshin ato. Publiku i gjërë duhet të dijë se çfarë kontrollon dhe auditon KLSH, ky institucion i lartë kushtetues. *Në ligjin për KLSH, Neni 3-Përkufizime, pika 15 thuhet: Subjekte të audituara janë të gjitha institucionet e qeverisjes qëndrore, organet e pushtetit vendor, institucionet e tjera qëndrore dhe vendore, që kryejnë funksione publike, institucionet e pavarura e shoqëritë tregtare apo të çdo forme tjetër, përfshirë ato financiare, ku kapitali shtetëror është mbi 50 për qind ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantojnë nga shteti.*

Oytetari duhet të kuptojë dhe të bëhet i përgjegjshëm se një aktivitet i tillë i KLSH-s është unikal në mbrojtjen e sovraniteteve të tyre të deleguara direkt apo indirekt si dhe të interesave direkte dhe indirekte, sepse e gjithë kjo veprimtari audituese ka të bëjë me interesin publik. Pa një veprimtari të tillë audituese ky interes është i cënuar dhe mund të mos respektohet ashtu si e përcakton Kushtetuta dhe Ligji.

*Në një shoqëri demokratike është parim themelor informimi i publikut. Mbajtja në terr informativ, informacionet e pjesëshme apo të vonuara dhe më keq akoma dizinformimi dëmtojnë seriozisht demokracinë funksionale në një shoqëri të multikulturalizmit. Qeveria mundohet që të justifikohet në çdo rast pavarësisht se e cilit krah politik mund të jetë ajo. Përpiqet të tregojë se po bën gjithçka që t'i shërbejë sa më mirë publikut, se pengesat janë shumë të mëdha porse ajo është gati të sfidojë. Madje shpesh justifikohet se shumë nga vështirësitë janë pasoja të keq qeverisjes së mëparshme. Mbajtja nën vëzhgim të punës dhe aktivitetit të pushtetit ekzekutiv, auditimi i vazhdueshëm nga SAI, nxjerrja e përfundimeve reale konkrete dhe të provuara nga më shumë se një burim i besueshëm, si dhe informimi që i bëhet Kuvendit të Shqipërisë (Parlamentit), duhet të mbajë një drejtpeshim të domosdoshëm. Pavarësisht se forcat politike mund të kenë qasje të ndryshme për problematikat shtetërore dhe administrimin e tyre, asnjëra prej tyre nuk mund të jetë mbi ligjin, apo në kundërshtim mbi të. SAI sheh me vërgjilencë këtë raport thelbësor. Si zbatohen kërkesat e ligjit? A ka devijime, shkelje, apo veprime korruptive? Tabloja reale bazuar në shifra, fakte dhe realitete që nuk mund të fshihen apo mohohen, u paraqiten subjekteve të audituara por puna nuk mbyllet këtu. Informohet Parlamenti në mënyrë të vazhdueshme. Informohet Prokuroria e Shtetit kur ka raste për ndekje penale. E megjithatë edhe kjo gjë nuk është*

plotësisht e mjaftueshme. Duhet informuar publiku i gjërë, si ai i thjeshti dhe ai i specializuari. Vetëm kështu SAI ndihmon në ngritjen e një opinioni publik aq të nevojshëm për të siguruar oponencën civile. *Prandaj në Ligjin për KLSH-n në KREU IV, E DREJTA E DISPONIMIT TË DOKUMENTEVE DHE INFORMACIONIT, Neni 34, shkruhet: Transparenca dhe informimi i publikut Kontrolli i Lartë i Shtetit, në respekt të detyrimit të tij ligjor për informimin e publikut, siguron natyrën publike të punës së tij nëpërmjet:*

*a) publikimit të raporteve të paraqitura nga KLSH-ja në Kuvendin e Shqipërisë;*

*b) publikimit të raporteve të auditimit në mënyrë elektronike;*

*c) konferencave për shtyp dhe metodave të tjera të informimit në media;*

*ç) publikimit të njoftimeve për shtyp dhe çdo informacioni tjetër që përcaktohet nga Kryetari i KLSH-së; me përjashtim të informacioneve dhe materialeve, të cilat përbëjnë sekret shtetëror, tregtar apo konsiderohen si konfidenciale, siç parashikohet dhe në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji.*

KLSH ka një përvojë pozitive dhe arritje, por nisur nga eksperiencat e përparuara ndërkombëtare do të sygjerohet krejt modestisht për të aplikuar eksperiencën e Gjykatës së Llogarive në Francë në dy aspekte:

1- Në marrdhëniet me parlamentin dhe gjithashtu në organizmin në të gjithë territorin për një mbulim më të mirë të problematikës. Dhe konkretisht më lejoni të citoj: Shërbim që gjykata i bën Parlamentin quhet "Misioni ndihmues i Gjykatës". Misioni i ndihmës së Gjykatës për Parlamentin është konsakruar nga rishikimi që ju bë kushtetutës në vitin 2008. Që nga viti 2004, Gjykata gjithashtu ka prerogativat në informimin e Parlamentit për çështjet e financave sociale. Gjykata është parë gjithë po aq, duke i besuar misionin e ndihmës shumë të drejtpërdrejtë mbi të gjitha çështjet relative në aplikimin të ligjeve të financimit për sigurimet sociale. Forma të tjera të Bashkëpunimit janë:

Raporti publik i përvitshëm që paraqitet para Asamblesë Kombëtare nga Kryetari i Gjykatës (ose si e quajnë francezët Presidenti i Parë) çka është parashikuar nga neni 146-1 i Rregullores së Asamblesë.

Raport të përvitshëm mbi financat publike lokale (V.O. Këtu shohim një veçori raportimin për financat e pushtetit lokal bëhen të specifikuar më vete) realizuar me iniciativë të Gjykatës.

Gjykata e Llogarive ndërton çdo vit një raport, që ka të bëjë me situatën financiare dhe menaxhimin e kolektivave territorial dhe të institucioneve të tyre publike. Ky raport i jepet qeverisë dhe Parlamentit.

Seancat e Rregullta veçanërisht përpara komisioneve të financës dhe të çështjeve sociale në mbledhjet e Asamblesë. Marrëdhëniet me Pubilkun ku raporti bëhet publik në muajin shkurt.

*Akti i certifikimit të llogarive të shtetit dhe akti i certifikimit të llogarive të skemës së përgjithëshme të sigurimit social bëhet në maj-qershor. Raporti mbi rezultatet e menaxhimit të buxhetit të shtetit bëhet në muajin maj, ndërsa raporti mbi gjendjen dhe perspektivat e financave publike bëhet në muajin qershor. Raporti mbi aplikimin e ligjeve të financimit të sigurimeve sociale bëhet në muajin Shtator. Kjo praktikë e analizës është mjaft interesante sepse ndihmon të kryhen analiza specifike dhe sigurisht edhe një vëzhgim të detajuar të financave publike duke adresuar problematikat dhe zgjidhjet e rekomanduara.*

2- Në organizmin në të gjithë territorin për një mbulim më të mirë të problematikës. Përvojë e GjLL-së është organizimi i decentralizmit të aktivitetit në të gjithë territorin e Francës, bazuar në Dhomat Rajonale dhe Territoriale të Llogarive. Një veprimtari e tillë mbështetet në atë që njihet si aplikimi ARIANE. Ky aplikim është realizuar duke përdorur dhomat rajonale dhe territoriale të Llogarive dhe trajton ndjekjen e procedurave të kontrollit thelbësor. Ajo ka të bëjë me mënyrën se si ekipi i kontrollit mund të përftojë të gjithë informacionin mbi funksionimin e kontrolleve. Plani ARIANE bazohet në pesë pjesë. Pjesa e parë ka të bëjë me lidhjet me planin ARIANE, pjesa e dytë, aktorët pjesëmarrës të planit, e treta, organizimi dhe shpërfaqja, e katërta, funksionet thelbësore të ekipeve të kontrollit dhe pjesa e pestë, funksione të tjera të ARIANE në dispozicion të ekipit të kontrollit.

Shteti dhe pushtetet janë çdo ditë edhe në lupën e shoqërisë civile. Aktorë të saj permanent apo me kohë të pjesëshme, mbikqyrin aktivitetet e ndryshme shtetërore. Shpesh edhe bashkëpunojnë me njëri tjetrin, aq sa edhe përfitojnë fonde publike për studimet apo aktivitete të tjera, që kanë të bëjnë me shoqërinë në vendin tonë. SAI e ka në modelin e punës së saj njohjen me këto studime, opinione apo përfundime. Audituesit tanë bëjnë ballafaqime me të dhëna të këtyre burimeve, gjejnë pikat e përbashkëta, aspektet komplementare nëse ka, dallimet në këndvështrime, apo mospërputhjet kur ato shfaqen. Në të gjitha rastet, gjykimet



e provuara të subjekteve të shoqërisë civile vlerësohen me shumë seriozitet. Një tjetër burim alternativ është media, ajo e shkruajtur, audiovizive por edhe rrjetet sociale on-line që provokojnë veprime me akses. Mediat e çdo natyre qofshin evidentojnë se çfarë ndodh, ku ka shkelje, abuzime, apo keqtrajttime të punonjësve. Nëse shikon gra të dhunuara në kronikat televizive, apo më keq akoma që në ditën e parë të vitit të ri 2016, mëson për vrasjen e një gruaje që ishte nën mbrojtje të organeve kompetente (në fakt rezultoi që mbrojtja nuk ka funksionuar) nuk mund të mos shqetësohesh të dish se çfarë ndodh me “Strategjinë kombëtare për mbrojtjen e grave të dhunuara”. Nëse ka një debat publik dhe mediatik për çmimin e biletës së shërbimeve të transportit urban, është mëse e përligjur të kontrollosh se si veprohet në nivele bashkiake. Mirë do të ishte që një problematikë e tillë në lidhje me transportin urban të kontrollohet njëherësh në disa nga qytetet kryesore, ose në disa nga rajonet e vendit në kushtet e ndarjes së re administrative dhe territoriale. Përfundimet e nxjerra do të ndihmonin për rregullime tërësore dhe jo riparime të pjesshme. Një aspekt tjetër i punës është diskutimi gjatjeve dhe rezultateve në Workshope të hapura me pjesmarrjen e specialistëve të fushave të ndryshme të cilët jo vetëm dëgjojnë përfundimet e audituesve të KLSH, por gjithashtu japin edhe ata mendimet e tyre, sygjerojnë alternative zgjidhjeje si dhe shprehin argumentet se ku dhe si mund të ndërhyhet për rregullimet e nevojshme dhe të mundshme. Në përputhje me detyrimet që burojnë në Nenin 33 pika 2 ku shkruhet se: *Kontrolli i Lartë i Shtetit, në varësi të qëllimit dhe detyrave të mësipërme, si dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, universitare dhe të shoqërisë civile, mund të angazhohet në organizimin e analizave të hapura vjetore të punës, konferencave shkencore në fushën e auditimit publik dhe menaxhimit financiar. Kontrolli i Lartë i Shtetit mund të angazhohet në botimin e revistave shkencore dhe profesionale, përkthime, botime, shpërndarje të publikimeve të organizatave ndërkombëtare të auditimit (të jashtëm), të institucioneve të tjera homologe që konsiderohen me interes.* KLSH përthith mendimin e specializuar edhe përmes diskutimeve të hapura në auditore universitetesh në bashkëpunim me departamentet apo dekanatet e tyre, si edhe ka ndodhur me Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, me universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan, etj. Një praktikë e tillë rritë sinergjinë e bashkëpunimit si dhe adreson më mirë problematikat e paraqitura. Mendimi akademik jep ndihmesën e tij, dhe përvoja e specialistëve të SAI sjell një paraqitje të gjallë dhe të freskët të gjendjes në institucionet publike. Kjo punë e frytshme

kulmon edhe me botime të përbashkëta mes pedagogëve të universiteteve dhe drejtuesve me përvojë të KLSH-së. Botime të këtij karakteri janë mjaft interesante dhe të frytshme. Në to gjen të mpleksur, përvojat teorike dhe ato aplikative, ligjësitë e përgjithshme me veprimin konkret në terren, dhe sigurisht përvoja e gjallë tejkalon pikërrëndesat teorike universitare sepse realiteti i gjallë lëviz më shpejt, ndryshon dhe përmirësohet çdo ditë. Pasqyrimi në librat universitare kërkon një farë kohe të reflektohet. Është me rëndësi të vëm në pah nevojën që kanë auditoret universitare për këto botime. Përvoja e gjallë e SAI që e sheh shtetin dhe mekanizmat e tij në punën e përditshme është e një rëndësie shumë të madhe. Studimet klasike shpesh largohen nga dinamizmi real, gjykojnë në mënyrë teorike dhe në kushte e rrethana ose të supozuara ose të tejkaluara, shpesh në to thuhet, supozojmë që..., etj., etj. Ndërsa botimet e KLSH-s kanë tjetër natyrë. Informacioni është i gjallë, është real dhe jo i supozuar, parashtron realitete konkrete dhe ofron zgjidhje të provuara. Gjatë ditëve të Panairit të Librit, personalisht vura re një interesim të madhë për botimet e KLSH-së. Në mënyrë të veçantë nga studentët dhe nga specialistë të kësaj fushe verprimitarie në Kosovë. Dëshiroj të nxjerr këtu një konkluzion. Në një shoqëri multikulturore, institucione si KLSH, jo vetëm përdorë ide dhe teori të konsoliduara gjatë punës dhe aktivitetit të tij, institucioni rekomandon ndryshime, krijon ide dhe sisteme të reja konceptuale që i shërbejnë jo vetëm praktikës së auditimit por edhe punës mësimore dhe akademike në auditoret universitare. Nisur nga dy përvojat e mia, dikur studente dhe prej një viti audituese në KLSH, do të sygjeroja modestisht se është më shumë interes që praktikat e punës së KLSH-së hynë në kurrikulat universitare të fakulteteve juridike dhe atyre ekonomike. Një praktikë e tillë pune do ti ndihmonte shumë aspirantët e rinjë. Do tejkalohet një lloj studimi klasik me gjëra klishe shpesh standarde. Në një shoqëri të hapur për ndryshim, multikulturalizmi vjen edhe si një përvojë e përfituar nga jashtë vendit. Një mundësi e tillë përftohet në trajnimet e adresuara. Takimi me auditues të huaj, shkëmbimi i përvojave, leksionet dhe praktikat që parashtrihen atje, zgjerojnë njohuritë tona profesionale. Gjithashtu trainimet on-line dhe testimet on-line, janë shprehje e një gjuhe të re komunikimi aq karakteristike për shoqërinë e sotme demokratike e multikulturale. Është e nevojshme që në çdo praktikë auditimi sipas rastit, sidomos kur në të plekset një problematik sociale, apo sjellja institucionale; të mbahet parasysh përvoja e huaj, e një apo më shumë vendi të BE-s apo edhe më gjërë. Një praktikë e tillë pune zgjeron këndvështrimin e auditimit por njëherësh institucionin që auditohet e vë përpara përgjegjësisë që të

ndërtojë strategji dhe praktika pune duke pasur pika referimi përvojat nga vendet e BE-s apo më gjërë. Nga përvoja ime si audituese po jap një shembull. Po auditorim "Strategjinë Kombëtare të Dhunës kundër Grave". Si funksiononin qendrat e mbrojtjes sociale. Ndërkohë sigurova të dhëna zyrtare se si funksionon kjo problematik në aspektin institucional në Zvicër. Vumë re një dallim esencial. Në qendrat e mbrojtjes në Zvicër, gratë e dhunuara nuk e takonin njëra tjetrën, sepse kështu ngarkesa e tyre shpirtërore dhe emocionale mund të rritej dhe efekti do të ishte negativ. Gjithashtu kështu ruhej privasia e secilës prej tyre. Takimi bëhej vetëm me psikologun. *Tek ne është një gjendje gati indinjuese. Të gjitha gratë e dhunuara ishin bashkë. Një gjendje e tillë luante një rol jo pozitiv. Mund të duket se kështu ato mund të çliroheshin se shikonin se nuk ishin vetëm, pra se kishte shumë syresh, porse një realitet i tillë luan rol negative sepse mund të krijohet përshtypja se kjo nuk është diçka dramatike që ka ndodhur vetëm me mua. Derisa ka kaq shumë gra të dhunuara, nuk duhet ta mendoj si një gjë kaq tragjike që lidhet me mua.* Shoqëria multikulturore si një shoqëri e pluralizmit politik liberaldemokrat, ka si parim lirinë dhe demokracinë. *Ndërsa shkolla dhe praktika historike anglosaksone ka një përkufizim thelbësor: Në fillim rregulli, pastaj liria.* Kjo do të thotë që pa rregullin dhe ligjin, liria nuk mund të realizohet, ajo degjeneron në veprime jashtë apo antiligjore dhe i hap udhë anarkisë. Pikërisht për këtë arsye në shoqëritë e sotme institucionale dhe demokratike, liria dhe të drejtat e njeriut, ndërtohen me ligj, funksionojnë me ligj dhe kontrollohen me ligj. Nëse veprimet institucionale nuk janë konform ligjit dhe e shkelin atë, atëherë ndëshkohen me ligj. Në këtë kuptim, veprimtaria e SAI në kushtet e liberaldemokracisë është edhe një institucion me shumë peshë për të mbrojtur lirinë si thelbi i demokracisë institucionale. Në të kundërt shteti dehumanizohet dhe humbet tiparet si dhe funksionet e tij demokratike duke u shndërruar nga një "public servant" (shërbëtor publik) në një "oligarchy servant" (shërbëtor i oligarkisë).


### Referencat:

- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;*
- *Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;*
- *Strategjia e Kontrollit të Lartë të Shtetit;*
- *Libri "Autoritarizëm në Tranzicion", Përparim Kabo.*

## 6. NDIKIMI I TEKNOLOGJISË NË PROFILIN PROFESIONAL TË NJË AUDITUESI

*Referues: Eni KABASHI – Audituese e dytë,  
Yrjada JAHJA – Audituese e parë.*

Sot në strukturën e KLSH-së rradhiten një sërë audituesish të rinj në moshë dhe në profesion, si unë. Institucioni ynë ka të inkorporuar në brendësi, politika për përshtatjen sa më efektive të punonjësve në punën audituese. Një ndër shembujt më efektiv dhe më frytdhënës është ndihma profesionale që çdo auditues me eksperiencë jep për audituesit e rinj të sapoardhur. Audituesit me eksperiencë në KLSH kanë dhënë kontributin e tyre jo vetëm në përmirësimin profesional të audituesve të rinj, por edhe në përsosjen e frymës së bashkëpunimit.



Të gjithë ne, me fillimin e punës në KLSH i jemi nënshtruar një trajnimi prezantues me punën e KLSH-së, bazës ligjore, standardet e aplikueshme në auditim si dhe me vetë procesin e auditimit. Por trajnimi në KLSH është një praktikë e vazhdueshme, duke u matur edhe me tregues performance. E gjitha kjo për të qenë sa më kompetentë dhe të aftë në punën tonë. Por KLSH gjithashtu përdor kritere të forta për rekrutimin e audituesve të rinj, duke u përqëndruar në aftësi të tyre, në vlerat shtesë që mund të sjellin për institucionin tonë.

Në botë sot, ato që konsiderohen karakteristika që çdo auditues duhet ti ketë janë:

- *Sjellje etike*-përgjatë karrierës audituese, audituesi duhet të zotërojë sjellje etike dhe të shmangë çdo tundim anashkalues ndaj çështjeve ku mund të ekzistojnë parregullsi dhe mashtrime
- *Vizion dhe instikt*- audituesi gjatë punës fiton aftësinë e njohjes së shpejtë të veprimtarisë së subjektit të audituar dhe në këtë mënyrë ai mund të përcaktojë nja strukturë të çështjeve me të cilat subjekti ndeshet dhe ti përkthejë ato në terma të

riskut. Gjithashtu audituesi fiton edhe instiktin e depërtimit në çështjet që ai i cilëson risikoze.

- *Aftësi njerëzore*- Profesion i auditimit nuk lidhet vetëm me analizimin dhe verifikimin, lidhet gjithashtu me njerëzit. Audituesit duhet të kenë aftësitë të bashkëpunojnë me punonjësit e subjekteve nën auditim. Shpesh, punonjësit e subjekteve të audituara kanë një farë ndrojtje, dhe për këtë audituesit duhet të shfaqin respekt dhe mirëkuptim.

Është një fat për brezin tonë, që jetojmë në një kohë ku teknologjia apo elektronika po bën një revolucion në drejtim të zbulimit sa më profesional dhe sa më praktik në fushën e shkencave ekzakte. Është pikërisht ky fakt tashmë i njohur ndërkombëtarisht i cili ka ndihmuar dhe ndihmon auditimin, në veprimatrinë e tij jo vetëm në përshejtimin e procesit të punës por kryesisht në saktësinë e rezultateve përfundimtare.

*Audituesit e sotshëm duhet të përqafojnë aftësitë e reja kompjuterike, si dhe përshejtojnë ritmin me të cilin përvetësojnë aftësitë e reja që janë duke u zhvilluar.*

Teknologjia është duke ndikuar në çdo industri, dhe profesion i audituesit nuk përjashtohet. Rritja e impaktit të teknologjisë në grumbullimin dhe analizimin e sasive të mëdha të të dhënave, është një aftësi gjithnjë e më shumë e kërkuar në procesin e auditimit.

Çdo ditë e më shumë, kompanitë dhe institucionet e auditimit po centralizojnë performancën e aktiviteteve të përditshme të auditimit. Kjo u ofron pjesëtarëve të grupeve të auditimit më shumë kohë për tu përqendruar në fusha jo të zakonshme dhe të përditshme të auditimit, fusha të cila kërkojnë analizë dhe gjykim profesional.

Aftësi të caktuara-si mendjemprehtësi biznesi, të menduar kritik dhe njohje e veprimtarive të insitucioneve nën auditim-janë gjithnjë të pritshme nga audituesit me eksperiencë. Sidoqoftë, bashkimi i teknologjisë me auditimin, si dhe zhvillimi i strukturave të grupeve të auditimit, sjell që këto aftësi të kalojnë në nivele më të larta dhe më të hershme në karrierën e audituesve.

Individët që nisin profesionin e audituesit, duhet të përgatiten për ndryshimin dhe zhvillimin e aftësive që pritet prej tyre. Është e rëndësishme që këto aftësi të zhvillohen që në vitet e universitetit.

Audituesit duhet të kenë një njohje të mirë të standardeve dhe udhëzimeve të auditimit dhe të kontabilitetit, dhe ky është një fakt që nuk ndryshon. Por, përse kohë që institucionet dhe kompanitë avancojnë, do të ndryshojë dhe avancojë edhe mënyra sesi ato do të auditohen. Audituesit kanë dhe do të vazhdojnë të kenë perfeksionuar procedurat e tyre për të qenë në gatishmëri dhe kompetentë ndaj fushave me risk ose veprimtarive komplekse që janë specifike për një subjekt nën auditim. Por sot, audituesit janë duke rimenduar qasjen e auditimit për një sërë subjektesh, kjo e ardhur nga mënyra universale sesi këto subjekte po ndyshojnë mënyrën e operimit.

Sasia e të dhënave që institucionet krijojnë është befasuese. Këto të dhëna, shpesh janë në sisteme të ndryshme, dhe shtrirja e informacionit mund të mos jetë gjithnjë e njohur dhe e kuptueshme brenda vetë institucionit. Sidoqoftë, të jesh i aftë të grumbullosh dhe analizosh me efektivitet dhe eficiencë këto të dhëna, është gjithnjë e më shumë e rëndësishme në kryerjen e auditimit. Përdorimi i teknologjisë në identifikimin, analizimin dhe interpretimin e të dhënave është një aftësi kyçe sot për audituesit.

Audituesit duhet të navigojnë efektivisht në sasinë e të dhënave për të vlerësuar besueshmërinë, përdorimin dhe përshtatshmërinë e tyre. Ata duhet të jenë të aftë të kuptojnë se çfarë të dhënash kërkojnë dhe, kur kërkojnë një sasi të madhe informacioni duhet të përcaktohet se cilat të dhëna nevojiten në fillim. Ata duhet gjithashtu të analizojnë informacionin e marrë, të paraqesin marrëdhëniet me të dhënat e tjera brenda dhe jashtë subjektit nën auditim si dhe të identifikojnë trendet dhe risqet e lidhura me to.

*Këto janë aftësi që shumica e audituesve i zhvillojnë pasi kanë hyrë në tregun e punës dhe pasi kanë fituar një farë eksperience. Por, këto aftësi kërkojnë prej audituesve të jenë të mprehtë në ndërtimin e qasjeve të auditimit, pasi disponueshmëria, përshtatshmëria dhe saktësia e informacionit në subjekte të ndryshme do të jetë e ndryshme dhe ajo që mund të jetë një e dhënë e rëndësishme për një subjekt, për një tjetër mund të mos jetë.*

Këto detyra sot kërkojnë edhe aftësi shtesë teknike të përfituara nga arsimi, duke përfshirë:

Teknologjinë e informacioni-vlerësimi i interaktivitetit, analiza e të dhënave si dhe njohja e sigurisë së informacionit (kritike për të përcaktuar nëse të dhënat janë të besueshme);

Analiza kritike-identifikimi i marrëdhënieve, identifikimi i anomalive dhe kryerja e krahasimeve;

Statistika-kryerja e analizave të relacioneve dhe parashikimeve si dhe vendosja e pritshmërive për testimet gjatë auditimit.

### Zhvillimet në auditim

Sipas modeleve të përdorura në institucione ose kompani auditimi, stafi me pak eksperiencë shpenzon kohën duke kryer detyra rutinë të auditimit (p.sh. kontrolli i bilanceve, kontrolli i mandat arkëtimeve dhe pagesave). Institucionet e auditimit janë duke centralizuar detyrat rutinë të auditimit duke lejuar në këtë mënyrë pjesëtarë e grupit të punojnë me aspekte të tjera të auditimit. Ky ndryshim në qasje, ofron për grupet e auditimit me pak kohë në dispozicion më shumë mundësi për tu përqendruar në detyra më të rëndësishme, përfshirë rishikimin e punës së kryer nga të tjerët si dhe përdorimin e të dhënave për vendosjen e pritshmërive në testet e auditimit.

Standardet e të dhënave të auditimit përcaktojnë një format standard të të dhënave ku do të mbështetet auditimi i një fushe të caktuar financiare të një biznesi ose veprimtarie. Këto standarde përfshijnë pyetësore checklistat të të gjitha çështjeve që duhet të merren në konsideratë për tu siguruar se të dhënat që do të trajtohen për auditim, janë të plota dhe të vlefshme. Implementimi i tyre në të ardhmen do të ofrojë audituesve të dhëna të shpejta, dhe e kombinuar me funksione të automatizuara do të ofrojë më shumë hapësira kohore për audituesit të përqendrohen në ekspertizën dhe gjykimin e tyre.

Përdorimi i monitorimit të automatizuar të transaksioneve dhe kontrolleve nga institucionet dhe organizatat, do të krijojë një mundësi për audituesit që të vlerësojnë këto aplikacione dhe teknika monitorimi. Audituesit do të mund të vlerësojnë statusin e platformës së monitorimit, qëllimin dhe përshtatshmërinë e rregullave dhe analizave.

Një aspekt tjetër i auditimit, i cili është duke u zhvilluar është analiza e të dhënave nga audituesit. Çdo ditë e më shumë kjo analizë do të përfshijë të gjithë popullatën e të dhënave dhe jo vetëm kampione, gjë që bëhet e mundur vetëm me anë të përdorimit të programeve elektronike të auditimit. Kjo qasje do të ofrojë një pamje më të plotë krahasuar me kampionimin.

Shembull i praktikës së teknologjisë në auditimet e kryera në KLSH

Kontrolli i Lartë i Shtetit vitet e fundit ka përqëndruar investime financiare dhe intelektuale në zhvillimin e teknologjisë së përdorur në mjediset e tij si dhe në teknologjinë e informacionit të përdorur në kryerjen e auditimit. Paketa Microsoft Office është mjeti më i përdorshëm në auditim, paketë për të cilën të gjithë audituesit e KLSH-së trajnohen vazhdimisht për njohjen e tyre si dhe për përditësimin me versionet më të fundit.

Në auditimet e fundit, të zhvilluara kryesisht nga Drejtoria e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, janë përdorur një sërë mjetesh të tjera teknologjike, për të depërtuar në mënyrë sa më efektive në auditim. Kështu, përmendim programin IDEA i cili ndihmoi audituesit në grumbullimin dhe analizimin e miliona të dhënave në sistemin e prokurimit publik dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Një praktikë e përdorur tashmë edhe në Gjykatën Europianë të Audituesve, është paraqitja e të dhënave me vizualizim. Kjo është një praktikë që kryesisht përdoret në fazën e grumbullimit të të dhënave dhe analizimit të tyre, për të parë me paraqitje grafike dhe vizualizim ajo çka nuk shihet drejtepërdrejtë tek të dhënat në formë numerike (*përdoret kur ndeshemi me një sasi të madhe të dhënash*).

Një risi e vitit që lamë pas është përmbushja e objektivit të dixhitalizimit të procesit të menaxhimit të veprimtarisë institucionale menaxheriale dhe audituese. Konkretisht ka përfunduar procesi i arkivimit të dokumentacionit në formë elektronik që nga viti 2012 deri në vitin 2015, e duke vazhduar kjo si praktikë për të gjitha materialet e mëtejshme. Kjo risi jo vetëm lehtësoje posedimin e materialeve jo më në formë fizike por në formë elektronike nëpërmjet CD por gjithashtu uli ndjeshëm mundësinë e ndërhyrjeve në material.



Zhvillimi i teknologjisë në Shqipëri dhe tërheqja e aftësive mbi teknologjinë e informacionit në KLSH, jep premisa shumë të mira për të ardhmen për grumbullimin, analizimin e të dhënave në kohë reale, me saktësi dhe eficiencë.

### KONKLUZIONET

Përdorimi i teknologjisë në procesin e auditimit sjell:

- Shpejtësinë dhe saktësinë në mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave;
- Kontrollë të implementuara për sigurinë dhe vlefshmërinë;
- Analizimi dhe verifikimi i të gjithë popullatës së të dhënave dhe jo vetëm një kampion përfaqësues;
- Fokusimi i audituesve në gjykimin profesional.

KLSH dhe ne, audituesit, jemi çdo ditë e më shumë në përvetësimin e metodave dhe trendeve të reja teknologjike që mundësojnë dhe lehtësojnë procesin e auditimit në terma të grumbullimit, verifikimit, analizimit së të dhënave.

Teknologjia ecën me hapa galopande drejt ndryshimeve kolosale, drejt përmirësimit dhe zhvillimit të sistemeve të fushave të ndryshme. Ndoshta nuk është e pamundur për të ecur paralel me të por për aq kohë sa ajo lë gjurmë, ndjekja e këtyre hapave do të bëjë të mundur njohjen dhe familjarizimin e këtyre zhvillimeve dhe nëse kjo fazë për ne do të quhet si fillimi i ciklit të jetës së një produkti, suksesi për fazën e zhvillimit është shumë më shpresëdhënës dhe frytëdhënës sesa vdekja e tij pa pasur një fillim.

## 7. TRAJNIMET NË KLSH

*Referues: Arminda Bushi – Specialiste, juriste.*

Zhvillimi i kapaciteteve audituese, rritja e kompetencave dhe aftësive profesionale nëpërmjet edukimit të vijueshëm profesional përmes trajnimeve, në KLSH, mbështetet në nenin 39 të ligjit të ri për organizimin dhe funksionimin e tij, i cili në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit në KREUN VI të tij, trajton trajnimet profesionale, duke sqaruar se:



Punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit gëzojnë të drejtën për t'u trajnuar profesionalisht, sipas planifikimeve të bëra nga institucioni, në përputhje me nevojat e evidentuara.

Kontrolli i Lartë i Shtetit siguron një proces sistematik dhe të planifikuar të trajnimit, zhvillimit profesional dhe certifikimit, i cili përfshin shtimin dhe përditësimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për kryerjen me efektivitet të detyrave të auditimit, në bashkëpunim me ASPA-n, me institucione të tjera të larta të auditimit apo me organizata profesionale, vendase apo ndërkombëtare.

Arritja e përfshirjes së një neni të veçantë në ligjin e ri të KLSH në lidhje me zhvillimin profesional dhe trajnimet ka rrjedhur natyrshëm si pasojë e zhvillimit të projekt idesë së propozuar nga Kryetari aktual në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë në vitin 2011 ku një ndër pikat e propozuara ishte:

*Zhvillim i burimeve njerëzore të KLSH në nivelin e parametrave të kërkuar nga INTOSAI dhe në përputhje me sfidat integruese të vendit si dhe përqëndrimi në kualifikimin dhe specializimin e audituesve (specializim sipas llojeve të auditimeve dhe sipas sektorëve) duke përmirësuar trajnimin dhe duke vendosur një sistem të edukimit të vijueshëm në vendin e punës.*

Ide të cilat duke qënë se ishin në përputhje të plotë dhe me standardet profesionale ndërkombëtare për institucionet supreme te auditimit, u gjykuan të ishin pjesë e planeve strategjike të zhvillimit të KLSH.

Kështu një nga objektivat që parashikohet në Strategjinë e Zhvillimit 2013 -2017 është dhe ngritja e kapaciteteve. Për arritjen e këtij objektivi, KLSH ka marrë pjesë në mënyrë aktive në shume aktivitete trajnimi, takime dhe grupe pune, konferenca dhe simpoziume, të cilat kanë synuar ndërtimin e kapaciteteve, rritjen e aftësive dhe njohurive profesionale të audituesve në funksion të rritjes së cilësisë së auditimit. Një ndër nën-objektivat e kësaj strategjia është edhe zhvillimi i trajnimeve profesionale i cili synon forcimin e kapaciteteve të stafit të KLSH-së kryesisht nëpërmjet rritjes së njohurive individuale nën kuadrin e zhvillimit profesional institucional. Ky proces kontribuon në krijimin e një trupe profesionale audituesish, të aftë të përballojnë misionin e institucionit dhe të realizojnë vizionin nëpërmjet kryerjes së auditimeve profesionale. Procesi kërkonte hartimin dhe miratimin e rregullave e procedurave të veçanta për realizimin e tij, në mënyrë të drejtë dhe transparente. Si pasojë e kësaj, në Tetor të vitit 2014, me Vendim të Kryetarit të KLSH u miratua struktura e re organizative e KLSH, e cila u pasua me krijimin e Departamentit të Politikave të Auditimit dhe të Drejtorisë së Auditimit të IT-së, pjesë e të cilit është edhe drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit Profesional, që mbulon ndërtimin dhe përditësimin e bazës metodologjike dhe zhvillimit profesional të audituesve për të kryer funksionin e auditimit në përputhje me standardet dhe kërkesat profesionale të fushës së auditimit dhe përballimin e sfidave të profesionit.

Procesi i Trajnimit, tashmë i riorganizuar dhe i rikonceptuar, ndikon në mënyrë të vazhdueshme në rritjen dhe aftësimin e audituesve duke qënë tërësisht i orientuar drejt përmirësimit të cilësisë së auditimit. Objektivi kryesor i trajnimit të audituesve synon të krijojë auditues kompetentë profesionale, të aftë të japin kontributin e tyre pozitiv në jetën e tyre profesionale dhe ambientin ku ata ushtrojnë detyrat e tyre. Por çfarë kuptojmë me trajnim dhe zhvillim profesional? A janë këto dy terma të njëjta apo në funksion të njëra tjetrës? Në fakt me trajnim në terma të thjesht do të kuptojmë pajisjen e të punësuarve me njohuritë e nevojshme bazë dhe aftësimin e tyre për punë. Ndërsa me zhvillim profesional i referohemi çdo aktiviteti të të mësuarit përmes procesit të trajnimit dhe procesit edukativ, i cili është i drejtuar drejt të ardhmes, ka nevojë për më tepër se nevojat e momentit, dhe ka të bëjë më

shumë me rritjen e performancës së menjëhershme të një institucioni. Ka një shumëllojshmëri të qasjeve të zhvillimit profesional, duke përfshirë konsultime, trajnim, përforsim praktike, studime, dhënie mendimi, mbikëqyrje dhe asistencë teknike.

Pra, roli i trajnimit dhe i zhvillimit profesional në KLSH duhet t'u sigurojë audituesve një bazë njohurish, aftësi dhe vlera profesionale, të cilat t'u mundësojnë atyre të zhvillohen në vijimësi dhe t'u përshtaten ndryshimeve gjatë gjithë jetës së tyre profesionale. Duke thënë këto kuptojmë se procesi i përmirësimit dhe rritjes së aftësive të stafit përmes aplikimit të sistemit të trajnimit në KLSH ka si qëllim:

- Të rrisë aftësitë dhe eficiencën në punën e tyre audituese;
- Të prezantoj të punësuarit e rinj me institucionin;
- Të fokusohet në përmirësimin e pikave të dobta të sistemit;
- Të përgatisë stafin për promovim dhe rritje profesionale në përshtatje me aftësitë e fituara;
- Të zhvillojë qëndrueshmërinë organizative dhe fleksibilitetin.

#### Performanca e trajnimeve dhe treguesit

Duke iu referuar të dhënave informuese lidhur me pjesëmarrjen në trajnime për periudhën 4 vjeçare, 2011- 2015 është shumë e dukshme se veprimtaria trajnuese e KLSH vjen në këto vite me tregues që pasqyrojnë performancë shumë të mirë dhe zhvillim të qëndrueshëm të sistemit të trajnimit të ngritur gjatë këtyre viteve në KLSH dhe njëkohësisht angazhimin serioz në përgjithësi të stafit auditues për të mësuar dhe për t'u zhvilluar profesionalisht. Arritjet dhe për më tepër tejkalimi i treguesve të vendosur në objektivat e planeve vjetore të dy viteve të fundit, dëshmojnë angazhimin dhe mbështetjen që KLSH i ka dhënë dhe vijon t'i japë procesit të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve audituese. Rëndësi e veçantë i është dhënë organizimit të trajnimeve të posaçme për stafin e ri. Me rëndësi ka qënë dhe është edhe përfshirja e trajnerëve të angazhuar të cilët përfshijnë kryesisht staf me cilësi të larta profesionale dhe drejtuese brenda KLSH (janë përfshirë kryeauditues, auditues të lartë dhe Drejtues të Drejtorive apo Departamenteve) ndërsa pjesa tjetër është mundësuar nga ekspertë të jashtëm. Reformimi institucional gjatë viteve të fundit ka vënë në fokus të politikave të zhvillimit kapacitetet audituese dhe krijimin e kompetencave të larta profesionale, procese këto që kanë zhvilluar

me sukses edhe sistemin e trajnimeve si pjesë integrale të reformës institucionale në KLSH në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse duke i siguruar çdo individ të drejtën dhe mundësinë e të mësuarit dhe të trajnuarit. Identifikimi i nevojave për trajnim duhet të jetë i lidhur si në aspektin e kërkesës së institucionit dhe në atë individual duke synuar:

- Ndryshime të përshtatshme për audituesit e interesuar;
- Analizimin i treguesve të performancës institucionale;
- Plotësimin e pyetësorëve;
- Përcaktimin e rrugëve me të përshtatshme për përmbushjen e nevojave të stafit për njohuri;
- Analiza e efikasitetit të të trajnuarve do të ishin disa metoda efikase për identifikimin e nevojave për trajnim.

Trajnimet i sjellin risitë e tyre nëpërmjet formave dhe metodologjive bashkëkohore sipas të cilave bëhet i mundur identifikimi i nevojave për trajnim, vendosja e objektivave specifike, zgjedhja e metodave trajnuese dhe zhvilluese, implementimi i programeve trajnues dhe zhvillues. Metodologji të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e nivelit të pjesëmarrjes së stafit në trajnime. Po ashtu ndikim të madh ka patur edhe organizimi dhe trajtimi i çështjeve të identifikuara nga procesi i vlerësimit dhe analizës së nevojave të stafit për njohuri dhe aftësi në fusha të ndryshme të auditimit apo fushat lidhur me të, orientimi drejt rezultateve/outputit, të cilët kanë bërë të mundur arritjen e objektivave të vendosur në programet vjetor për trajnimin. Vlerësimi i programeve trajnues dhe zhvillues kanë ofruar aktivitete të shumëllojshme të zhvillimit të stafit.

Në përshtatje me burimet, trajnimet e ofruara në KLSH janë të organizuara në:

- Trajnime brenda vendit: Trajnime që janë organizuar duke u mbështetur nga ekspertë të brendshëm e të jashtëm, nga organizata apo institucione kombëtare apo ndërkombëtare;
- Trajnime të brendshme mbi politikat dhe proceset e KLSH: të cilat janë organizuar mbi bazë ditore nga trajnues/auditues të lartë, të cilat janë fokusuar në përditësimin e njohurive të fushave të veçanta dhe të auditimit;
- Trajnime brenda çdo Departamenti Auditimi individualisht në formën e tryezave të diskutimit profesional në terma të rasteve nga praktikant auditues;

- Trajnime/workshop-e të ofruar nga ekspertë të huaj, që përfshinë trajtimin e tematikave specifike të profesionit të auditimit në formatin e prezantimeve të kombinuara me raste studimore nga eksperiencat e vendeve të tjera;
- Konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të zhvillimit të kapaciteteve në nivelet më të larta profesionale;
- Konferenca Shkencore Vjetore e KLSH e ideuar dhe realizuar në formatin e sesioneve plenare të cilat kanë një gërshetim mjaft efektiv të qasjeve profesionale me ato akademike;
- Trajnimet on-line (e-learning) të ofruara kryesisht nga IDI, Programi i 3 i-ve për implementimin e Standardeve të INTOSAI-t të cilat kanë si qëllim përgatitjen e facilitatorëve/moderatorëve dhe më pas të certifikimit të tyre për kryerjen dhe mbështetjen e procesit të vlerësimit dhe zbatimit të Strategjisë për Implementimin e ISSAI-ve në KLSH.
- Trajnimet e organizuara në bashkëpunim me ASPA-n, Shkollën e Administratës Publike për “Prezantimin e Nëpunësve në Administratën Publike” duke siguruar jo vetëm përmbushjen në aspektin ligjor detyrues por mbi të gjitha frytshmërinë dhe dobinë e trajnimit për stafin pjesëmarrës të nivelit të lartë drejtues dhe të audituesve. Po ashtu organizata të tjera profesionale e publike kanë mbuluar nevojat për trajnime në fusha specifike që kanë lidhje tepër të rëndësishme me ushtrimin e funksionit të auditimit sikurse janë Prokurimet Publike, Legjislacioni Evropian, Procesi i Planifikimit të Integruar, menaxhimi financiar dhe kontrolli, Gjurma e Auditimit.
- Trajnimet “Prezantim me Institucionin e KLSH” u ofrohet audituesve të rinj si një set trajnimi 15 ditor dhe ka si qëllim njohjen me ambjentin dhe kuadrin ligjor e procedural të KLSH, Standardet e Auditimit për SAI-t (ISSAI), Udhëzuesit për Auditimin Financiar, Auditimin e Përputhshmërisë dhe Auditimin e Performancës si dhe prezantimin e përgjithshëm të punës nga çdo departament auditimi.

Pra, kemi të bëjmë me trajnime që zhvillohen në vendin e punës dhe trajnime që zhvillohen jashtë vendit të punës, të cilat sigurisht kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre.

Trajnimet e zhvilluara në vendin e punës janë në përgjithësi me kosto më të ulët për institucionin (më efektive), nuk ndikojnë negativisht në punën audituese të institucionit pasi audituesit nuk largohen nga vendi i tyre i punës, zhvillohen me materiale të cilat tashme ata janë të familjarizuar dhe trajnerët janë kryesisht

persona të cilët i dinë nevojat e tyre konkrete për trajnim. Duke zhvilluar këto lloj trajnimesh fitohet një përvojë e drejtpërdrejtë me një standard të miratuar nga punëdhënësi, në rastin tonë nga Kryetari i KLSH. Gjithashtu ky lloj trajnimi është edhe produktiv pasi ne jemi duke punuar gjatë kohës që jemi edhe duke mësuar. *(për këtë i referohemi rastit të trajnime të organizuara në formën e tryezave të diskutimit brenda çdo departamenti)*. Një disavantazh i këtij lloj trajnimi është që audituesit përgjithësisht nuk certifikohen, në shumë raste audituesit janë më të përqëndruar në mbarëvajtjen e punës së tyre të përditshme audituese sesa në studimin e materialeve trajnuese

Metodat e trajnimit që zhvillohet jashtë vëndit të punës e ndajnë të trajnuarin (audituesin) nga vëndi i tij i punës, zhvillohen nëpër qendra trajnimi, kanë materiale për të studiuar ndaj audituesit përqëndrohesh më shumë në studimin e materialit sesa vënien në funksion të asaj për të cilën trajnohet, avantazhet e tyre janë se trajnimi bëhet më me baza realiste, vlen direkt për punën, ndalon të trajnuarit në bërjen e gabimeve të kushtueshme për institucionin pasi trajnimet bëhet nga specialistë të fushave të caktuara të cilët zakonisht ndajnë eksperiencë dhe raste studimore, të trajnuarit mund të pajisen me kualifikime ose me certifikata.

Si disavantazh të kësaj metode konsiderojmë konsumimin e kohës nga orari i punës dhe faktin që është një trajnim i kushtueshëm për institucionin.

### Përmbajtja e Trajnimeve

Programi i Veprimtarisë së Trajnimit vjetore të stafit të KLSH vit pas viti përcakton drejtimet kryesore të trajnimit përfshirë: tematikat kryesore, pjesëmarrësit dhe kohën e zhvillimit të trajnimit si dhe trajnuesit të cilët duhet të jetë shumë të aftë dhe të duhet të ketë aftësi të specializuara dhe njohuri për të trajnuar. Duhet theksuar se, gjatë implementimit si rezultat i rishikimit dhe vlerësimit të herëpashershëm të nevojave të stafit organizohen dhe trajnime jashtë programit të cilat përgjithësisht kanë si qëllim, mbajtjen e trajnimit në terma realiste dhe sa më afër nevojave për njohuri në fushat specifike profesionale.

Trajnimet përshinë njohuri kryesisht mbi 4 llojet e auditimit:

1. Auditimi i Sistemeve të IT;
2. Auditimi i Përputhshmërisë;

3. Auditimi Financiar;

4. Auditimi i Performancës.

Tematikat e trajnimeve zhvillohen në përshtatje me nivelin e zhvillimit aktual të secilit lloj por njëkohësisht duke u fokusuar në perspektivat e së ardhmes dhe Strategjinë e Zhvillimit. Rritja e cilësisë së auditimit përcakton nevojat gjithnjë në rritje për njohuri dhe dije të audituesve dhe në fusha të tjera që kanë lidhje të ngushtë me auditimin sikurse janë:

- Njohuri dhe përditësim mbi Legjislacionin kombëtar dhe Ndërkombëtar;
- Menaxhimi i Projekteve me Financim të Huaj;
- Përdorimi i mjeteve të IT në auditim, njohja dhe përfitimet e përdorimit;
- Integrimi në BE dhe Legjislacioni BE-së (acquis communautaire);
- Menaxhimi i Financave Publike.

Trajnimet në tematikat e mësipërme i ofrojnë audituesve një bazë të dobishme mbi të cilën ata mund të mbështeten për kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë dhe në pajtueshmëri të plotë me Standardet dhe Rregullat e Auditimit.

KLSH mbështetet fuqimisht në Standardet e INTOSAI-t duke i konsideruar si pjesë e përpjekjeve për rritjen e dijeve profesionale të institucionit. Standardi i Përgjithshëm i ISSAI 200, përcakton se “KLSH duhet të adoptojë politika dhe procedura për të zhvilluar dhe trajnuar punonjësit e tij për t’i aftësuar që të kryejnë detyrën e tyre në mënyrë efektive dhe për të përcaktuar bazat për avancimit profesional të audituesve dhe stafit tjetër”. Kështu burimet njerëzore si burimi më dinamik dhe më i rëndësishëm në KLSH janë në vëmendjen e menaxhimit për zhvillimet e mëtejshme. Për këtë arsye trajnimi dhe zhvillimi i stafit në fusha të ndryshme lidhur me auditimin kanë luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në arritjen e objektivave strategjike të KLSH. Audituesit e jashtëm publik për dhënien e sigurisë mbi përdorimin e fondeve publike duhet të zotërojnë jo vetëm tipare profesionale por edhe sjellje etike dhe integritet si pjesë të profilit të nëpunësit të lartë publik, për këtë arsye Kontrolli i Lartë i Shtetit nëpërmjet Sistemit të Trajnimeve synon të sigurojë ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve audituese, rritjen dhe zhvillimin e tyre profesional përfshirë përgatitjen dhe të mësuarit në nivel institucional dhe kombëtar si dhe inkurajimin e pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese ndërkombëtare, të udhëhequr nga motoja e INTOSAI-t “Experientia mutua omnibus prodest”, në mbështetje të së cilës çdo punonjës i KLSH është trajnuar të paktën një herë në një



nga institucionet homologe të vendeve të tjera me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi. Materialet dhe eksperiencia e marrë nga këto trajnime publikohet në faqen zyrtare të KLSH me synim ndarjen e kësaj përvoje me pjesën tjetër të stafit të KLSH. Mbështetja maksimale e drejtuesve, përdorimi i metodave më të përparuara teknologjike, modeli i mirë i të mësuarit janë disa nga faktorët kyç që influencojnë në trajnimin dhe zhvillimin e burimeve institucionale.

Së fundi, do të doja të ndaja me ju thënien e një mentori indian, i cili thotë: *që të trajnosh është e kushtueshme, por të mos trajnosh është akoma më e kushtueshme* (Training is expensive. Without training it is more expensive).

- Nehru-

Kryeministri i Parë i Indisë

nxënës i Gandit

Moto, e cila është kuptuar dhe zbatuar shumë mirë në institucionin tonë!


## 8. KONTROLLI I LARTË I SHTETIT NË PROCESIN GJYQËSOR

*Referues: Flavio XHUVELI – Jurist.*

*“Vetëm një funksion i pavarur i auditimit shtetëror të jashtëm mund të garantojë një raportim të padeformuar, të besueshëm dhe objektiv të gjetjeve të auditimit. Prandaj dhe pavarësia e institucioneve supreme të auditimit është e një rëndësie parësore për transparencën e administratës publike. Për më tepër, ajo ruan dhe mbështet eficiencën e funksionit kontrollues të Parlamentit, duke fuqizuar besimin publik në institucionet publike”. (Dr. Josef Moser, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI dhe President i Gjykatës së Auditimit të Austrisë-Parathënie e Librit për Deklaratën e Limës dhe Deklaratën e Meksikos-Ribotim-Tetor 2009).*

Roli i KLSH-së si institucion supreme dhe i pavarur

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar. Ai i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.<sup>33</sup> KLSH nëpërmjet auditimeve synon, përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raporteve të tij.<sup>34</sup> Roli dhe përgjegjësia e KLSH-së, si institucioni më i lartë i auditimit publik është që të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve shtetërore, nëpërmjet auditimeve të tij. Kjo veprimtari e KLSH-së shtrihet dhe në dhënien e rekomandimeve për ndryshime dhe përmirësim të akteve ligjore dhe nënligjore, duke synuar minimizimin e riskut të abuzimit me detyrën dhe fondet buxhetore, minimizimin e korrupsionit dhe tolerancës ndaj tij, shmangien e rasteve të konfliktit



<sup>33</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998.

<sup>34</sup> Ligji 154/2014 “Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 2.

të interesave, etj. Situata e korrupsionit në vendin tonë dikton nevojën e angazhimit të të gjithë institucioneve dhe shoqërisë për të krijuar një front unik kundër këtij fenomeni që kërcënon seriozisht progresin e Shqipërisë. SAI-t nuk e kanë parë mashtrimin dhe korrupsionit si qëllimin e tyre kryesor. Qasja ka qënë më tepër për të parandaluar korrupsionin, se sa në zbulimin e aktiviteteve të paligjshme. Nga ana tjetër publiku beson më shumë në rolin antikorrupsion të KLSH-së.<sup>35</sup> Ndryshimi i drejtimit të institucionit në dhjetor 2011 sollti ndryshime të rëndësishme në filozofinë e menaxhimit të këtij institucioni dhe në perceptimin që kishte opinion publik. Roli aktiv i KLSH këto 4 vitet e fundit ka rritur besimin publik ndaj institucionit dhe njëkohësisht dhe pritshmëritë e opinionit publik. Në reflektim të përjasjeve të INTOSAI-it por edhe SAI-eve të tjera homologe në luftën kundër korrupsionit, KLSH e ka reflektuar çështjen e korrupsionit dhe luftës ndaj këtij fenomeni, jo vetëm në veprimtarinë e tij audituese (sidomos gjatë këtyre viteve të fundit) por edhe në Planin Strategjik të KLSH 2013-2017. Më konkretisht, Plani Strategjik i KLSH 2013-2017, në objektivin e tij të pestë "Rritja e kontributit të KLSH-së për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit" thekson:

*"Institucioni do të vendosë më shumë theksin në analizën e risqeve dhe dobësive të sistemeve që auditon, duke synuar uljen e këtyre risqeve dhe parandalimin efektiv të korrupsionit, në bazë të standardit 1240, i cili përcakton qartë rolin e SAI-t. KLSH do të vazhdojë të luajë një rol efektiv në forcimin e qeverisjes së mirë, zbatimin e standardeve të etikës, si dhe ngritjen e vetëdijes për riskun e mashtrimit dhe korrupsionit. Funkcioni kryesor i KLSH-së në këtë luftë është nxitja e një mjedisi parandalues kundër mashtrimit dhe korrupsionit, duke përfshirë sistemet e menaxhimit financiar vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe identifikimin dhe korrigjimin e mangësive"*<sup>36</sup>.

Veprimtaria e KLSH-së jep indikacione të qarta se ky institucion punon fort për të kthyer përgjegjshmërinë në një nga tiparet e tij më të theksuar dhe këto përpjekje e bëjnë KLSH-në si një hallkë në përgjegjshmërinë publike, jo vetëm në sensin e të ndihmuarit të të audituarve për t'i mbajtur ata të përgjegjshëm por mbi të gjitha të kryejë këtë funksion duke treguar përgjegjshmëri.

---

<sup>35</sup> Plani Strategjik, botime KLSH, faqe 28.

<sup>36</sup> Konferenca e III-të Shkencore, Volumi i I, Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare, faqe 396.

## Ligji i ri i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe risitë e tij

Ligji 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, u diktua si pasojë e nevojës për të reflektuar në kuadrin ligjor ndryshimet e ndodhura në praktikë si brenda dhe jashtë vendit, që nga koha e miratimit të ligjit nr.8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” të ndryshuar. Gjatë periudhës midis ligjit të vjetër dhe miratimit të ligjit të ri të, ndodhen zhvillime të rëndësishme në veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në ekonominë e tregut, si dhe në legjislacionin e vendit tonë, i cili ishte përafshuar me atë të vendeve të përparuara të BE-së. Gjithashtu nevoja për ligjin e ri u pa dhe si një ndër detyrimet që rridhte nga neni 90 i MSA, i cili kërkonte përputhjen e auditimit të jashtëm të vendit tonë me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe në legjislacionin bashkëkohor të institucioneve homologe. Ligji i ri për KLSH-në reflekton Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), si dhe Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC). Dokumentet bazë të INTOSAI si “Deklarata e Limës” dhe “Deklarata e Meksikos”, gjejnë pasqyrim të plotë në ligjin e ri të KLSH-së. Ky ligji ishte produkti i punës së jashtzakonshme të Kryetarit KLSH-së, falë dhe ndihmës së partnerëve ndërkombëtar si DG-Budget dhe SIGMA. Në lidhje me projekt-ligjin e propozuar nga KLSH, në letrën e tij drejtuar KLSH në 18 tetor 2012, Drejtori i Përgjithshëm i DG-Budget, z. Herve Jouanjean (Zhuanzhan), pasi siguron për mbështetjen maksimale teknike të Komisionit European për amendimet e ligjit të KLSH, shprehet se “amendimet e sjellin institucionin e KLSH tërësisht në linjë me standardet INTOSAI”. z. Robert Gielisse, Drejtor Njësie në DG-Budget, i cili erdhi personalisht dy herë për ligjin e ri të KLSH, gjatë konsultimeve me palët e interesit në nëntor 2012, cilësoi se “Projekt ligji i ri jep një strukturë të qartë dhe terminologji të standardeve ndërkombëtare. Ai ka referenca të qarta për auditimet e performancës dhe përkufizim më të fortë të rolit dhe të drejtave të KLSH”. Sipas Gielisse, “Përputhja me standardet ndërkombëtare INTOSAI prezanton një etapë të rëndësishme të vendit për në BE. Certifikimi i audituesit është dëshmi e kompetencës mbi standardet e auditimit dhe lejon komunikim të standardizuar profesional. Amendimet e ligjit të KLSH janë një përparim i madh, ato e sjellin Auditimin e Jashtëm Publik në Shqipëri në një linjë me standardet ndërkombëtare”<sup>37</sup>. Për të thithur ekspertizën më të mirë në vend, përgjatë vitit 2012, Kryetari i KLSH organizoi tryeza pune me ekspert të së

<sup>37</sup> [http://www.klsh.org.al/web/pub/016\\_bujar\\_leskaj\\_1744\\_1.pdf](http://www.klsh.org.al/web/pub/016_bujar_leskaj_1744_1.pdf).

drejtës, ekspertë kontabilistë, përfaqësues të medias, gazetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, sugjerimet e të cilëve kanë qënë një ndihmesë e madhe në hartimin përfundimtar të projektligjit. Përpjekjet e KLSH-së për një ligj bashkohor dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, u finalizua me miratimin e ligjit 154/2014, që për nga rëndësia është reforma më e rëndësishme në historinë e KLSH. Ligji i ri për KLSH-në fut konceptet bashkëkohore të auditimit në kontrollin e jashtëm publik të vendit, zgjeron gamën e auditimeve me auditime të reja të përfshira në ligj, si ato të performancës, të auditimit të fondeve të BE-së, të teknologjisë së informacionit, lejon dhënien e opinionit për llogaritë e shtetit, forcon pavarësinë e institucionit kushtetues të KLSH-së dhe certifikon audituesit e tij. Miratimi i ligjit 154/2014, krijoi kushtet e nevojshme për një veprimtari të pavarur, gjithëpërfshirëse dhe efektive të KLSH.

E megjithatë, ligji i miratuar ka diferenca nga projektligji i propozuar nga KLSH. Një ndër problematikat e ligjit të ri është dhe mungesa e parashikimit në ligj për mosankimimet e raporteve të KLSH-së në gjykatë. Gjatë diskutimeve në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe Komisionin e Ligjeve, të projektligjit "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", Kryetari i KLSH-së, ndër të tjera propozoi parashikimin shprehimisht në ligjin për KLSH-në, të mos ankimimit në gjykatë të raporteve të KLSH-së dhe i gjetjeve dhe konkluzionve në to<sup>38</sup>. Ky propozim nuk kishte qëllim ti jepte KLSH-sëtribute mbiligjore, por duke iu referuar dhe praktikave më të mira ndërkombëtare synonte rritjen e përgjegjshmërisë së subjekteve të audituar në trajtimin që do ti bënin rekomandimeve të KLSH-së. Këtë trajtim ligjor e kanë aplikuar SAI të ndryshëm siç është Zyra Shtetërore e Auditimit të Hungarisë, e cila në ligjin e saj nr.66 të vitit 2011, në kapitullin 1, Statusi dhe Kompetencat e Zyrës pika (6) parashikon shprehimisht se: *"Raportet e auditimit të Zyrës Shtetërore të Auditimit dhe gjetjet dhe konkluzionet e tyre nuk mund të kundërshtohen në gjykatë apo autoritete të tjera"*. Gjykata e Auditimit të Sllovenisë, gjithashtu e ka të përcaktuar në ligjin e funksionimit të saj, përkatësisht nën pika (3) parashikon se: *"Aktet me të cilat ajo ushtron kompetencat e saj të auditimit nuk mund të ndryshohen apo të hidhen poshtë nga gjykatat apo organet e tjera shtetërore"*. Pikërisht, fakti se vende të tilla me demokraci më të konsoliduar se Shqipëria dhe eksperiencë më të madhe në procesin e auditimit, kanë aplikuar këtë parashikim ligjor, i cili duhet të shërbente si referencë dhe për ligjin e KLSH-së. E megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të KLSH-së kjo kërkesë u keqinterpretua me pretendimin se

---

<sup>38</sup> [http://www.parlament.al/web/pub/procesverbal\\_ligjet\\_21\\_04\\_2014\\_17036\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/procesverbal_ligjet_21_04_2014_17036_1.pdf).

cënonte një nga të drejtat themelore, siç është e drejta për tu ankuar ndaj një vendimi që cënon të drejtat dhe liritë e individëve. Raportet e KLSH-së nuk mund të konsiderohen kurrësi vendime që çenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, pasi ato rezervohen vetëm në konstatimin e faktit të shkeljeve dhe të sugjerimit për përmirësimin e gjendjes. Është pikërisht kjo mungesë parashikimi që krijon perceptim të gabuar në lidhje me ankimimet në gjykatë të raporteve të KLSH-së.

Kontrolli i Lartë i Shtetit si i paditur dhe nevoja për unifikim të praktikës gjyqësore Pavarsisht mungesës së përcaktimit në ligj të mosankimimit të raporteve të KLSH-së, për proceset gjyqësore me palë të paditur KLSH-në dhe me objekt "pavlefshmërinë e akteve të KLSH-së" ka ndjekur një praktikë mjaft efikase duke bërë një interpretim ligjor të mbështetur në Kushtetutë, ligje dhe që reflekton mendësinë e doktrinës më të mirë juridike. Paditë me objekt pavlefshmërinë e akteve të KLSH-së, duhet të rrëzohen si të pabazuara në ligj. KLSH në përfundim të auditimeve të cilat kryhen në subjektet e përcaktuara, duke iu referuar mangësive dhe shkeljeve ligjore dhe nënligjore të pasqyruara në raportet përfundimtare të auditimit, për përmirësimin e gjendjes, rekomandon titullarin e institucionit për marrjen e një sërë masash organizative, shpërblimi ose disiplinore sipas rastit. Proceduralisht dhe ligjërisht keto procedura administrative nuk mund të fillojnë nga KLSH, por nga vetë institucioni i audituar apo të cilit i adresohen rekomandimet. KLSH nuk ka tagrin ligjor të ndjekjes dhe zbatimit të procedurave ligjore në institucionet që auditon, por në fakt janë vetë institucionet që auditohen që në një analizë të përgjithshme të rekomandimeve të KLSH-së, kanë të drejtën ligjore të vlerësojnë rekomandimet dhe të fillojnë procedurat përkatëse në vlerësim dhe respektim të tyre. Gjithshtu, duke iu referuar nenit 105 të Kodit të Procedurës Administrative përcaktohet se: *"Konsiderohen akte administrative të gjitha vendimet e organeve të administratës publike të cilat krijojnë pasoja juridike në rastet individuale"*<sup>39</sup>. Një ndër veçoritë e aktit administrativ është dhe ekzistenca e elementit juridik. Elementi juridik i aktit administrativ e përcakton fakti nëse ky akt krijon ose shuan një marrëdhënie të caktuar juridike nëpërmjet vendosjes së normave të detyrueshme të sjelljes për subjektet, të cilët ju drejtohet. Ky element juridik është përcaktues për ardhjen e pasojave juridike, sepse vetë krijimi ose shuarja e një marrëdhënie juridike nënkupton ardhjen e pasojës konkrete, pa të

<sup>39</sup> Kodi i Procedurës Administrative 2009 botime QPZ, faqe 52.

cilën nuk kuptohen lindja apo shuarja e kësaj marrëdhënie<sup>40</sup>. Gjykatat duhet të çmojnë se nuk mund të ankimohen raportet e auditimit të KLSH-së, pasi nuk janë akte administrative që sjellin pasoja, por thjesht rekomandon për organin administrativ. Pra, raportet e KLSH-së nuk janë akte administrative pasi u mungon karakteri detyrues<sup>41</sup>. Në Vendimin nr.29, datë 27.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese: *“Gjykata vlerëson se edhe pse ligji i ka njohur KLSH-së, ashtu si dhe organeve të tjera kontrolluese, të drejtën të kërkojë marrjen e masave disiplinore, rekomandimet/propozimet e këtij organi nuk janë detyruese për organet që ju drejtohen”*<sup>42</sup>.

Praktikat e Gjykatave në Republikën e Shqipërisë, kanë filluar të mbështesin këtë qëndrim duke rrëzuar të gjitha paditë që kanë për objekt pavlefshmërinë e raporteve të KLSH-së, si të pabazuara në ligj. Vendimet e gjykatave janë në përputhje të plotë me arsyetimin e KLSH-së se raportet e KLSH-së nuk janë akte administrative. Megjithatë kjo praktikë ka nevojë të unifikohet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për shkak të nevojës së standardizimit të proceseve gjyqësore me objekt pavlefshmërinë e akteve të KLSH-së. Kjo nevojë lidhet me numrin e lartë të kërkesë padive me objekt të njëjtë që priten të shqyrtohen nga gjykatat. Më tepër se një nevojë e institucionit të KLSH-së, kjo është një domosdoshmëri për subjektet që iniciojnë procese gjyqësore me shkak rekomandimet e KLSH-së, për të kërkuar në mënyrën e duhur ligjore zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative. Ky unifikim praktike do të orientonte gjykatat për një proces gjyqësor të mbështetur në parimet e shtetit të së drejtës dhe do të shmangte interpretimet subjektive të gjykatave. Në këtë mënyrë do të garantohej e drejta për një proces të rregullt ligjor si një e drejtë kushtetuese dhe e përcaktuar në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Kontrulli i Lartë i Shtetit si person i tretë në gjykim dhe rëndësia e pjesëmarrjes në këto procese gjyqësore.

Proceset gjyqësore në të cilat KLSH është person i tretë, mbajnë numrin më të lartë të proceseve gjyqësore të KLSH-së. Në përfundim të auditimeve të kryera në subjektet përkatëse KLSH rekomandon subjektet për marrjen e masave për përmirësimin e

---

<sup>40</sup> E drejta Administrative, Sokol Sadushi, 2008, faqe 26.

<sup>41</sup> Ligji 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH-së”, neni 15, gërma c.

<sup>42</sup> [http://www.gjk.gov.al/web/Lista\\_e\\_Vendimeve\\_92\\_1.php](http://www.gjk.gov.al/web/Lista_e_Vendimeve_92_1.php).

gjendjes. Një pjesë e mirë e këtyre rekomandimeve i drejtohen për zgjidhje gjykatës për shkak të mungesës së kompromisit nga ana e subjekteve për të përmbushur detyrimin. Dy janë problematikat e evidentuara në këto procese gjyqësore:

a) Tendenca për t'ia ngarkuar KLSH-së përgjegjësinë për iniciimin e proceseve gjyqësore. Në fakt, gjetjet dhe konstatimet e KLSH-së, i nënshtrohen një procesi transparent ballafaqimi midis subjekteve të audituara dhe KLSH-së duke i dhënë mundësi subjektit të audituar të paraqes pretendimet dhe objeksionet për këto gjetje(nëse ka). Kjo procedurë transparente i jep mundësi subjektit të audituar të krijojë bindje mbi gjetjet e KLSH-së, në këtë mënyrë do të jetë më i qartë në kërkimin e zbatimit të rekomandimeve.

b) Dorëzimi i raporteve të KLSH-së, si të vetmet prova për t'iu paraqitur gjykatës. Vetë raporti i KLSH-së është akt, konstatimet e të cilit janë bazuar në prova materiale. Prania e KLSH-së, si person i tretë, në këto procese gjyqësore është shumë e rëndësishme, pasi jo vetëm i mundëson KLSH-së të mbrojë konstatimet dhe rekomandimet e lëna në subjekt, por edhe të monitorojë subjektet për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së. Pavarishtë se në këto procese gjyqësore ka qenë si person i tretë, KLSH ka treguar vëmendje maksimale duke i ndjekur në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha seancat gjyqësore dhe duke qenë dhe aktive me praninë e saj. Megjithatë prania e KLSH-së nuk duhet të shërbejë si justifikim nga subjektet iniciues të proceseve gjyqësore për t'ia deleguar KLSH-së barrën e provës bazuar te fakti se janë konstatimet e saj, por duhet të shihet si një vullnet i palëkundur i KLSH-së në raportimin e shkeljeve dhe vendosjen e ligjshmërisë.

#### Referencat:

- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, viti 1998;*
- *Ligji 154/2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";*
- *Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Shtator 2003;*
- *Kodi i Procedurës Civile I Republikës së Shqipërisë, Mars 2002;*
- *Kodi I Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë, Mars 2014;*
- *E Drejta Administrative, Dr. Sokol Sadushi, Shtator 2008;*
- *Plani Strategjik, botime KLSH Tiranë 2013;*
- *Konferenca III-të Shkencore, Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare, Volumi I-rë, Tiranë 2014;*
- *INTOSAINT Manuali i Vetëvlerësimit të Integritetit për Institucionet Supreme të Auditimit, Tiranë 2014;*
- *www.gjk.gov.al.*



## 9. AUDITIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

*Referues: Benard HAKA – Auditues i dytë,*


*Elira CUKALLA – Audituese e parë.*

*We are not retreating, we are advancing in another direction*

*Douglas MacArthur*

*Pajisjet elektronike dhe teknologjia e informacionit janë zbuluar dhe zhvilluar për një qëllim, që është lehtësimi dhe përmirësimi i proceseve që njerëzit kryejnë gjatë aktiviteteve të tyre ditore.*

Zhvillimet e fundit në teknologji dhe evoluimi i shpërndarjes së informacionit ndërmjet institucioneve të ndryshme, shtetërore apo private me publikun ka qenë dhe do të jetë një sfidë për shoqëritë në të gjithë vendet e botës për të kaluar në ato që quhen shoqëri të informatizuara. Përdorimi i teknologjisë së informacionit në vitet e fundit tregon dobinë e lartë publike të këtyre mjeteve dhe mbështetjen që ato i japin rritjes së cilësisë dhe efektivitetit në kryerjen e funksioneve publike. Ky përdorim po bazohet në modelin e ngritjes së rrjeteve të integruara me të gjitha garancitë e sigurisë së ruajtjes dhe përpunimit të informacionit sipas përcaktimeve ligjore të të drejtës së informimit, mbrojtjes së të dhënave personale e informacionit të klasifikuar, etj. Ky zhvillim i teknologjisë ka ndikuar në disa fusha të mjedisit e të bërit biznes. Ka rritur aftësinë për të kapur, ruajtur, analizuar dhe procesuar sasi të mëdha të dhënash dhe informacioni, të cilat kanë rritur fuqizimin e vendimmarrësit të biznesit. Teknologjia është kthyer në një komponent kritik për procesin e biznesit. Rritja e përdorimit të teknologjisë ka rezultuar në rritje të buxheteve, rritje të sukseseve dhe dështimeve, dhe rritje të ndërgjegjësimit për nevojën për kontroll. Si pasojë e kësaj rritje të vullshme të përdorimit të teknologjisë nga bizneset lindi nevoja për kontrollin e këtyre aseteve



teknologjike dhe bazën e tyre të të dhënave duke çuar në krijimin e konceptit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Koncepti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit u krijua nga mesi i viteve 1960, si auditim i procesit të të dhënave elektronike (*Electronic Data Process Auditing*). Përdorimi i parë i një sistemi të kompjuterizuar të kontabilitetit u përdor nga General Electric në vitin 1954. Ky lloj auditimi njohu zhvillim si rezultat i rritjes së teknologjisë në sistemet e kontabilitetit, si rezultat i nevojave për kontrollin e IT dhe impakti që kanë kompjuterat në saktësimin e shërbimeve. Auditimi IT ka pasur një histori relativisht të shkurtër në krahasim me auditimet e tjera dhe mbetet një fushë gjithnjë e në ndryshim. Duke parë këtë zhvillim të implementimit të teknologjive të reja dhe nevoja për tu adaptuar në këtë mjedis të ri e për të kuptuar teknologjinë ka bërë që të rritet nevoja për funksionimin e auditimit IT në dy drejtime:

- Audituesit e kuptuan se kompjuterat kanë ndikuar në aftësinë e tyre për të kryer funksionin e vërtetësisë/saktësisë;
- Menaxhimi i Korporatave dhe përpunimi i informacion çoi në përfundimin se kompjuterat ishin burimet kryesore për të konkurruar në mjedisin e biznesit dhe të ngjashme me burimet e tjera të vlefshme të biznesit brenda organizatës, dhe për këtë arsye, nevoja për kontroll dhe mundësia e auditimit ishte kritike.

Si fillim, audituesit me aftësi në auditimin IT shiheshin si burim teknologjik mbështetës për grupin e auditimit ku shpesh nga grupi i auditimit kërkohej ndihmë teknike. Me rritjen e sistemeve kompjuterike, u zhvilluan sistemet informacionit. Si një provë e këtij evolucioni, termi "EDP audit" (*Electronic Data Processing*) ndryshoi duke u zëvendësuar me termat e tilla si "Auditimi i Teknologjisë së Informacionit" dhe "Auditimi i Sistemeve të Informacionit".

*"Pra Auditimi i Teknologjisë së Informacionit nënkupton një ekzaminim të zbatimit të sistemeve IT-së për të garantuar nëse ato përmbushin nevojat e subjektit, pa kompromentuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elemente të tjera kritike të veprimtarisë e tij".*

Me rritjen e investimeve dhe varësinë në sistemet kompjuterike të subjekteve të audituara, u bë e domosdoshme për audituesin e IT të adoptojë një metodologji dhe qasje të saktë në mënyrën se si do të identifikojë risqet dhe integritetin e të

dhënave, abuzimet dhe privatësinë, si dhe të garantojë sigurinë se ekzistojnë kontrollet e minimizimit të këtyre risqeve. Për realizimin e këtyre auditimeve Institucionet Supreme të Auditimit kanë ndërtuar strategji dhe struktura të mirëfillta duke investuar në sistemet e informacionit dhe duke rekrutuar staf me profilin e të pasurit njohuri mbi teknologjinë e informacionit, si dhe në fusha të tjera.

*Ashtu si Institucionet e tjera homologe në Evropë dhe në botë, që kanë implementuar këtë auditimi, edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit ka bërë hapa, të rëndësishëm, në fushën e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe ndarjen e konceptit të IT nga Audituesi IT.*

Hapat e para për përgatitjen dhe zhvillimin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit në Kontrollin e Lartë të Shtetit zunë fill në vitin 2011. Duke hedhur idenë e zhvillimit të auditimeve me metodat dhe teknikat më bashkëkohore, duke futur kështu konceptin e IT Audit. Kjo ide u përforcua në planin strategjik të zhvillimit të KLSH-së për vitet 2013-2017 me objektiv Zhvillimin e Auditimit TI ku KLSH-ja synon të bëjë ndryshime themelore në përdorimin e Teknologjisë së Informacionit në punën e tij audituese. Në strategji u përcaktuan aleatët në hartimin e implementimin e metodologjive të auditimit të Teknologjisë së Informacionit ku vendin kryesor e zënë, SIGMA, IDI dhe Institucionet homologe të Polonisë, Turqisë, Sllovenisë, Kroacisë, etj.

Në dhjetor të vitit 2014 u realizua krijimi i Drejtorisë së Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, ku edhe në ligjin e ri për Kontrollin e Lartë të Shtetit, Ligji nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit Të Lartë Të Shtetit*", Auditim i Teknologjisë së Informacionit u sanksionua si një nga Auditimet më të reja që KLSH mund të realizojë dhe saktësisht në *Nenin 14 "Auditimi i teknologjisë së informacionit"* citohet: "*Në Auditimet e IT-së, Kontrolli i Lartë i Shtetit mbledh dhe vlerëson provat, për të përcaktuar nëse një sistem kompjuterik mbron asetet, ruan integritetin e të dhënave, lejon që synimet e subjektit që auditohet të arrihen në mënyrë efektive dhe përdor burimet në mënyrë eficiente*". Drejtorja e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është e përbërë nga pesë auditues të rinj dhe Drejtori i Drejtorisë.

Drejtorja e Auditimit të Informacionit, në vitin 2015 realizoi dy auditime nga të cilat njeri ishte auditim pilot i zhvilluar tek "*Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore*". Ky auditim është produkt i pjesëmarrjes së Grupit të Auditimit në programin e IDI-t (*Iniciativa për zhvillim e INTOSAI-t*) për zhvillimin e

Auditimit IT në Institucionet Supreme të Auditimit, dhe mbështetet në Manualin e Auditimit të IT dhe ISSAI 5310 *“Metodologjia e Rishikimit të Sigurisë së Sistemeve të Informacionit”*.

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1039/3, datë 19.01.2015.

Auditimi tjetër u zhvillua nga audituesit e KLSH-së në mënyrë të pavarur. Subjekti i audituar ishte *Agjencia e Prokurimit Publik (APP)*. Objektivi kryesor në këtë auditim ishte Auditim i sistemit të Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë e Prokurimit Publik për tu siguruar se ai mbështet nevojat e Agjencisë pa kompromentuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elemente të tjera kritike. Drejtimet kryesore në këtë auditim ishin, *Vlerësimi i ambientit, Verifikim i shkallës së sigurisë, Testime mbi input/output, Kontrolli i BCP, DRP, Kontrolli i të drejtave të përdoruesve dhe Vlerësimi i prokurimeve në fushën e IT*. Ky Auditim u realizua me sukses dhe gjeneroi një sërë rekomandimesh të rëndësishme.

Këto dhe të gjitha rekomandimet e tjera të bëra nga KLSH morën një feedback pozitiv nga subjekti për pranimin e të gjitha rekomandimeve dhe realizimin e tyre brenda afatit.

Auditime të planifikuara për vitin 2015	Auditime tërealizuara	Rekomandime gjithsej	Rekomandime të pranuar
2	AKBPM	7	-
	APP	10	19

Për vitin 2016 Drejtorja e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit ka parashikuar katër Auditime IT, ku një auditim është planifikuar në bashkëpunim me grupin e punës të Eurosai-t, konkretisht me projektin e vetëvlerësimit të auditimit IT që udhëhiqet nga SAI Zviceran, *zhvillimi i një vetëvlerësimi i një auditimi IT në KLSH*. Krahas zhvillimit të katër auditimeve IT të planifikuara do të merret pjesë apo jepet mbështetje, grupeve të auditimit në përdorimin e teknikave CAAT në auditimet e tjera (*përputhshmërie dhe rregullshmërie*).

Për konsolidimin e njohurive dhe aftësive të audituesve në KLSH janë organizuar trajnime të shumta duke u konkretizuar me marrëveshjet e bashkëpunimit që krijuan kushtet për zhvillimin e një procesi intensiv trajnimi mbi Auditimin e Teknologjisë së Informacionit me qëllim kryesor rritjen e kapaciteteve audituese të

stafit të KLSH, nëpërmjet sjelljes së njohurive të reja për audituesit dhe aftësimin e tyre për t'iu përshtatur kërkesave të profesionit në kryerjen e Auditimeve të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit. Krahas trajnimeve të brendshme, Auditues të KLSH kanë marrë pjesë në shumë <sup>43</sup>trajnime dhe konferenca jashtë vendit të tilla si :

- "Auditimi Teknologjisë së Informacionit në Sistemin e Thesarit në Shqipëri", nga projekti "SIGMA mbështetje për KLSH" Tiranë, shtator 2013;
- Vetëvlerësimi i IT dhe auditimit IT, Bernë të Zvicrës, janar 2014;
- "Auditimin e Sistemeve të Informacionit IT", në gjykatën Turke të Llogarive, prill 2014;
- Certifikimin në IT Audit të 3 audituesve nga IDI (e-learning qershor-korrik 2014);
- Procesi i vetëvlerësimit të IT me moderim nga SAI i Zvicrës, tetor 2014;
- "Roli i auditit të brendshëm në menaxhimin e riskut, mashtrimit dhe riskun në IT" në Qendrën e Ekselencës në Financë (CEF), Slloveni, tetor 2014
- "Planifikimi i Auditimit IT", organizuar nga IDI, Poloni, dhjetor 2014;
- Në Zyrën Federale të Auditimit të Zvicrës u mbajt takimi i grupit të punës mbi Vetëvlerësimin e Teknologjisë së Informacionit (ITSA) dhe Vetëvlerësimit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (ITASA), mars 2015;
- Trajnimi "Prezantimi me Auditimin e IT", në Gjykatën Europiane të Audituesve, mars 2015;

Vlen për tu përmendur që një zhvillim tjetër i rëndësishëm në KLSH, për Drejtorinë e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit ishte edhe botimi i manualeve dhe standardeve, të cilat ndihmojnë dhe lehtësojnë punën e audituesve në përmbushjen me sukses të misionit të audituesit. Në kolanën e botimeve të KLSH për vitin 2015 u botuan, *Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit* si dhe *Objektivat e Kontrollit për Teknologjinë e Informacionit* (COBIT) për tu ardhur në ndihmë jo vetëm stafit të KLSH-së por dhe atyre të Auditimit të Brendshëm, si dhe atyre që duan të bëhen Auditues të Teknologjisë së Informacionit.

<sup>44</sup>Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është botimi i parë i serisë së botimeve të KLSH në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe është produkt i grupeve të punës së Iniciativës për zhvillim të INTOSAI-t (IDI) dhe EUROSAI-t për përcaktimin e rregullave e standardeve në Auditimit e Teknologjisë së

---

<sup>43</sup> [www.klsh.org.al/](http://www.klsh.org.al/)

<sup>44</sup>IDI

Informacionit. Ky manual ka udhëzime të detajuara mbi fushat e Auditimit të IT-së, duke nisur me identifikimin e zonave e mundshme të auditimit, identifikimin e risqeve dhe vlerësimin e tyre, hartimin e planit si dhe kryerjen e auditimit.

<sup>45</sup>Libri “Objektivat e Kontrollit për teknologjinë e Informacionit” COBIT është një botim i Organizatës ndërkombëtare të Auditimit dhe Kontrollit të Sistemeve të Informacionit. Ai është një strukturë e përdorur gjerësisht në fushën e IT dhe përmbledh rekomandimet, praktikat dhe metodat më të mira të vlerësimit për kontrollet e përgjithshme IT dhe programet që zhvillohen në këto ambiente.

Këto dy botime dhe të tjera në vazhdim do të shërbejnë si mjete të fuqishme për shtimin e njohurive mbi menaxhimin dhe Auditimin e Teknologjive të Informacionit jo vetëm në KLSH, por kudo ku ato zbatohen.

Këto zhvillime të rëndësishme në fushën e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit në KLSH çuan gjithashtu edhe në krijimin e koncepteve të qarta për auditimin IT dhe të ardhmen e këtij auditimi. Sot, auditimi IT është një profesion me sjellje, qëllime, dhe cilësi të cilat karakterizohen nga standarde auditimi, në mbarë botën dhe karakterizohet nga një grup rregullash etike (*Sistemet e Informacionit të Auditimit dhe Shoqata e Kontrollit [ISACA] Kodi i Etikës*), dhe nga një program profesional i certifikuar (*Sistemet Audituese të informacionit të certifikuara [CISA]*).

Mund të themi se zhvillimi i teknologjisë kërkon hartimin e strategjive të reja dhe mundësive të reja në fushën e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, pra e thënë ndryshe, nevoja për auditues të specializuar me aftësi teknologjike është në rritje, po ashtu edhe kërkesa për profesionin e Audituesit IT është në rritje.

Duke parë këtë zhvillim të pandalshëm dhe galopant të teknologjisë së informacionit, Auditimi IT është i prirur të ketë një zhvillim të pakufizuar, duke marrë parasysh edhe kompleksitetin e legjislacionit dhe zhvillimin e teknologjive të reja që po zbulohen dhe zhvillohen me rritjen sigurisë së teknologjisë. Një politikë e tillë është në realizim e sipër në Kontrollin e Lartë të Shtetit ku njëkohësisht po investohet në infrastrukturën e sistemeve kompjuterike por edhe në rekrutimin e stafit të ri të Audituesve të Teknologjisë së Informacionit.

*Ne jemi të rinj në Auditimin IT dhe ky auditim sapo ka nisur të kristalizohet.*

<sup>45</sup> [Information Systems Audit and Control Association](#)

## 10. INFORMATIZIMI I PROCESIT TË AUDITIMIT

*Referues: Ildir DERVISHI – Auditues i parë.*



Nevoja gjithmonë më e shpeshtë për përdorimin e teknologjisë së informacionit në mënyrë që të rritet saktësia dhe ulur afatet e gjenerimit të të dhënave, sjell domosdoshmërinë e përdorimit të programeve kompjuterike për kryerjen e auditimeve nga ana e KLSH-së.

Krijimi i një program kompjuterik, duke u mbështetur në nevojat e audituesve, për të kryer një auditim sipas standardeve më të mira ndërkombëtare, bazuar në platformat kompjuterike më të avancuara të kohës dhe në një ndërfaqe kompakte, do të rriste efincencën, ekonomicitetin dhe transparencën e procesit të auditimit.

Njëkohësisht informatizimi dhe dixhitalizimi i procesit të auditimit, do të rriste shpejtësinë e përpunimit të të dhënave dhe do të ulte afatet e tij.

Një program i tillë do të zvogëlonte mundësinë e devijimit të gjetjeve gjatë auditimit, sepse për çdo proces dhe ndërhyrje të kryer do të lihen gjurmë elektronike.

Informatizimi i të gjithë fazave të procesit të auditimit, duke u mbështetur në një platformë kompjuterike e cila përputhet me programet (software) e tjerë dhe në të cilën mund të integrohen të gjithë diagramet e proceseve të auditimit, do të krijonte një program të thjeshtë në përdorim dhe me mjetet e nevojshme, duke plotësuar të gjitha kërkesat e audituesëve.

Duke qënë se volumi i informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë auditimit është gjithmonë në rritje, lind nevoja e menaxhimit të tyre në mënyrë elektronike. Ruajtja e informacionit në një bazë të dhënash të vetme, do të bënte të mundur aksesin dhe përdorimin e këtij informacioni në çdo moment nga audituesit.

Hapat e hedhur nga ana e KLSH në drejtim të përdorimit të programeve kompjuterike për të kryer procesin e auditimit, kërkon edhe zhvillimin e mëtejshëm të dixhitalizimit të veprimtarisë ose transaksioneve nga ana e subjekteve të audituara, në mënyrë që të merren të dhëna të cilat mund të përdoren dhe përpunohen nga programi në fjalë.

**Eksperienca evropiane në përdorimin e programeve kompjuterike në auditim**

Pas disa tentativash shumëvjeçare, duke filluar që prej vitit 1995, në Gjykatën Europiane të Audituesve (ECA) është vendosur në funksion të plotë një program kompjuterik, i cili shërben për të kryer gjithë procesin e auditimit në mënyrë elektronike. Me kalimin e viteve janë përdorur disa platforma kompjuterike, të cilat në fund konvergjuan në një program të vetëm kompjuterik i quajtur ASSYST II.

Në versionin fillestar ASSYST I, i cili është aplikuar për herë të parë në vitin 2004, shumë auditues e kishin të vështirë përdorimin e tij, për vet faktin se nuk mund të integroheshin të gjitha hallkat e auditimit brenda tij dhe gjithashtu ishte i vështirë në përdorin. Ndërkohë që shumë mjete të nevojshme për të bërë modifikimin e të dhënave dhe ruajtjen e tyre mungonin ose ishin të vështirë në përdorim. Një disavantazh tjetër i versionit fillestar të programit ishte pamundësia e shkëmbimit ose ruajtjes të të dhënave në një "sharepoint". Megjithëse versioni fillestar përdorej nga një pjesë jo e vogël e audituesve të ECA, nuk ishte arritur që ai të aplikohet në të gjithë llojet e auditimeve dhe të mbulonte nevojat e audituesve. Shumë funksione të cilat ishin pjesë e programit, rezultuan që nuk përdorreshin nga audituesit.

Për këtë qëllimin u vendos të krijohet nga vetë ECA, versioni i dytë i programit (ASSYST II), por duke kaluar fillimisht në një proces të gjatë, i cili konsistonte në krijimin e një projekti të mirëfilltë për implementimin e tij. Ky projekt, pjesë e të cilit ishin auditues dhe pjesëtarë të departamentit të teknologjisë së informacionit, konsistonte në: mbledhjen e të dhënave periodike nga audituesit për nevojat e tyre në lidhje me auditimin, bashkëpunimin me kompani/zhvillues të cilët operonin në fushën e ndërtimit të programeve kompjuterike, trajnimin e audituesve në lidhje me përdorimin e tij dhe aplikimin e programit në auditime pilot, në mënyrë që të merreshin "feedback" të bazuar në eksperienca reale.



Përfundimisht pas konsultimeve dhe provave të shumta, në vitin 2013 u aplikua programi ASSYST II, në mbështetje të plotë të auditimit. Duke filluar nga ky vit dhe deri më sot, kryhen trajnime dhe suport (mbështetje) të vazhdueshëm për të gjithë grupet e auditimit nga ana e pjesëtarëve të stafit të projektit.

Programi ASSYST II ka të gjithë elementët përbërës që mund të nevojiten për të kryer një auditim të plotë. Ai gjithashtu ndodhet edhe në "sharepoint", ku përdoruesit mund të shkëmbejnë ose modifikojnë të dhënat edhe kur ndodhen në subjekte të ndryshme auditimi.

Ky program kompjuterik është vazhdimisht në përditësim, ku modifikimet e kryera bënin të mundur çdo ditë përdorimin e tij nga i gjithë stafi i audituesve të ECA-s. Ndërfaqja kryesore e programit ASSYST II është paraqitur edhe në figurën 1:




Figura 1. Ndërfaqja e programit ASSYST II

Siç shihet në figurën e mësipërme, ndërfaqja e programit në anën e majtë të saj ka të listuar të gjithë auditimet në proces ose ata të cilët janë gati për të filluar. Ndërsa në anën e djathtë janë të gjitha funksionet për zhvillimin e auditimit, duke filluar nga formatet standarde për tu përdorur, programi i auditimit, lista e transaksioneve dhe lista e gjetjeve. Ndërsa në pjesën qendrore kryhet gjithë veprimtaria e audituese me përpunimin e të dhënave sipas llojit të auditimit.

Integrimi i procesit të auditimit në një program kompjuterik

Integrimi i procesi të auditimit në një program kompjuterik, fillimisht në KLSH ka kërkuar kryerjen e një analize biznesi të mirëfilltë, në të cilën janë përcaktuar të gjitha hapat e nevojshme për krijimin dhe aplikimin në mënyrë të suksesshme të këtij programi.

*Hapi i parë* për informatizimin e procesit të auditimit në një program kompjuterik është formulimi i projekt idesë dhe llogaritja e burimeve të nevojshme (njerëzore, financiare dhe kohore). Është i rëndësishëm fakti i krijimit të një grupi pune, i cili menaxhon të gjithë procesin e krijimit dhe implementimit të këtij programi, duke filluar nga mbledhja e informacioneve paraprake nga audituesit, vlerësimin e mundësisë të konvertimit të kërkesave të tyre në program duke u konsultuar vazhdimisht me programuesit, trajnimin e audituesëve dhe suportin e vazdhueshëm gjatë procesit të auditimit.

*Hapi i dytë* i kësaj analizë është ndërtimi i një diame procesesh, në të cilën përcaktohen proceset bazë ku kalon një auditim i plotë. Kjo diagramë ndërtohet duke u bazuar në standardet e auditimit, eksperiencave të mëparshme dhe pyetësorëve drejtuar audituesve të KLSH. Për auditime të ndryshme do të ketë diagrama procesesh të ndryshme, duke u bazuar tek lloji i auditimit (përputhshmërie, financiar, performance, tematik ose IT) dhe fushat në të cilën do të kryhet.



Figura 2. Shembull diame procesi auditimi

Duke krijuar diagramën e proceseve atëherë bëhet më i lehtë krijimi i templateve (modeleve) të cilët hidhen në program dhe shërbejnë si struktura e gjithë procesit të auditimit.


*Hapi i tretë* është përcaktimi i funksioneve që duhet të kryejë programi, duke konsideruar kërkesat e audituesëve.

Funksionet kryesore të programit mund të jenë:

- Krijimi i programeve të reja të auditimit ose modifikimi i atyre të mëparshëm duke marrë aprovimin e të gjithë pjesëtarëve të grupit të auditimit.
- Importimi i dokumentave të ndryshme nga institucionet e audituara dhe përpunimi i tyre në program.
- Një librari e unifikuar e cila përmban të gjithë legjislacionin e nevojshëm për çdo auditim dhe mund të përditësohet nga audituesit.
- Database të të gjitha gjetjeve dhe observacioneve duke filluar nga një vit i caktuar.
- Integrim i plotë dhe i thjeshtë me Microsoft Office.
- Ruajtja e informacioneve dhe dokumenteve të auditimit në një "databse" të vetme gjatë kryerjes së veprimtarisë audituese në subjekte të ndryshëm.
- Gjenerimi i gjetjeve ose raporteve.

*Hapi i katërt* përbëhet nga ndërtimi i programit nga programuesit duke u bazuar në diagramat e proceseve dhe funksionet bazë të kërkuara nga audituesit.

*Hapi i pestë* konsiston në implementimin fillestar të programit. Për të patur një numër më të madh "feedback" është e nevojshme përfshirja sistematike e audituesëve gjatë implementimit fillestar dhe testimit të programit, duke krijuar një marrëdhënie interaktive midis tyre dhe programuesve. Gjatë kësaj faze, është e nevojshme kryerja e një auditimi pilot duke përdor programin në fjalë, në mënyrë që të evidentohen pikat e forta dhe pikat e dobëta të tij dhe të kryhen korrigjimet e nevojshme.



*Figura 3. Ndërvarësia midis fazave të aplikimit të programit*

*Hapi gjashtë* përbëhet nga trajnimi i audituesëve, i cili është i lidhur me implementimin e programit. Procesi i trajnimit fillon nga dorëzimi i versionit të parë të programit dhe vazhdon sa herë programi ka nevojë për përditësime.

*Faza përfundimtare* është testimi dhe kolaudimi përfundimtar i programit dhe vendosja e tij në funksion të veprimtarisë audituese. Një numër sa më i madh i përdoruesve në këtë fazë do të bënte të mundur marrjen e një numri më të madh vlerësimesh dhe sugjerimesh, të cilat ndihmojnë në azhurnimin e mëtejshëm të programit.

## KONKLuzionET

Përfitimet në informatizimin e procesit të auditimit dhe përdorimit të një programi kompjuterik të unifikuar për të gjithë audituesit do të sillte:

1. Metodologji të unifikuar auditimi;
2. Krijimi i programeve standard të auditimit;
3. Dokumentim i të gjitha evidencave të mbledhura gjatë auditimit dhe ruajtja e tyre në një database;
4. Mundësia për të përdorur metodika ose praktika (template) të hedhura në sistem nga auditues të ndryshëm;
5. Standardizimi i procesit të auditimit;
6. Mbulimi i të gjithë procesit të auditimit;
7. Përdorimi i mjeteve të shumëllojshme të editimit;
8. Duke lënë gjurme elektronike gjatë gjithë procesit të auditimit, mbledhjes së evidencave dhe formulimit të projekt raportit do të shmangeshin devijimet e mundshme në çdo hallkë të tij;
9. Rritja e sigurisë të kontrollit të cilësisë;
10. Ruajtja e informacioneve dhe dokumenteve të auditimit në një server të vetëm, të cilat mund të përdoren nga vendndodhje të ndryshme nga ana e audituesit;
11. Menaxhim eficient i burimeve njerëzore;
12. Formulimi i raporteve dhe gjetjeve.

Por programi mund të ketë dhe disavantazhe të cilat mund të jenë, si pamundësia që të përdoret nga të gjithë audituesit, niveli i ulët i dixhitalizimit dhe informatizimit të subjekteve të cilat do auditohen.

Gjithashtu ky program duhet të ndërtohet duke konsideruar edhe nevojat në rritje të KLSH.

## 11. PËRFITIMET NGA BASHKËPUNIMET ME PARTNERËT

*Referues: Redina KARAPICI – Audituese e dytë.*



Një proverb i vjetër kinez thotë: "Njeriu i cili lëvizi malin filloi duke zhvendosur gurë të vegjël".

Dikush që e ka kryer tashmë një auditim në bashkëpunim me SAI-t e tjera do ta ketë shumë të lehtë të identifikojë këtë qasje. Bashkëpunimi shpesh fillon me vendosjen e sfidave të vogla në mënyrë të tillë që në fund të lëvizësh një mal. Vitet e para të shekullit të 21 janë karakterizuar nga një rritje ndërvarësie dhe harmonizimi. Ekonomia globale i ka

kapërcyer prej kohësh të gjitha kufijtë politikë. Qeveritë që deri më tani kanë vepruar brenda territorit të tyre duhet të jenë të përditësuar në lidhje me zhvillimet e shpejta në shumë fusha.

Përkundrajt këtyre zhvillimeve, bashkëpunimi është thelbi i zhvillimit dhe mirëqënies së përgjithshme në mjedisin që na rrethon. Duke bashkëpunuar, ne forcojmë shoqërinë, rrisim respektin ndaj vlerave të përbashkëta, zhvillojmë identitetet tona kulturore dhe ndajmë njohuritë. Prandaj bashkëpunimi është alternativa e vetme për qeveritë dhe, në të njëjtën kohë, për SAI-t që dëshirojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në të ardhmen.

Shkëmbimi i informacionit dhe mësimave të nxjerra zgjeron horizontin dhe hap një perspektivë të re mbi veprimet e dikujt për qeverinë e vet në krahasim me qeveritë e tjera. Në të njëjtën kohë, shkëmbimi i informacionit dhe njohurive po bëhet jetik edhe për Institucionet Supreme të Auditimit. Zhvillimi i vazhdueshëm e i mëtejshëm i auditimit të sektorit publik është absolutisht i nevojshme për të ecur në njëtin hap me ndryshimet e shpejta me të cilat po përballemi. Për këtë arsye, rritet nevoja për mbështetje teknike.

Nëse Institucionet Supreme të Auditimit dëshirojnë të luajnë një rol aktiv dhe jo sipërfaqësor në shoqëri, ata duhet të kryejnë misionet e tyre në mënyrë efikase dhe duhet në të njëjtën kohë të përgatiten për tu përshtatur me sfidat e një mjedisi politik dhe administrativ që ndryshon me shpejtësi. Në këtë kuptim, gjen vend më së miri shprehja e Henri Ford *"vendosja e kontakteve është fillimi, forcimi i tyre është progres, dhe puna së bashku është sukses"*.

Në vitet e fundit, bashkëpunimi mes SAI-t është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme. Hapat e parë për këtë zhvillim kanë ardhur si iniciativë kryesisht e INTOSAI përmes kongreseve të saj, komisioneve të përhershme, grupeve të punës, takimeve dhe seminareve, sidomos kohët e fundit, duke i dhënë një rëndësi të madhe zhvillimit të këtyre iniciativave. Shumë raste, bashkëpunimi kanë qenë edhe rezultat i iniciativave bilaterale dhe rajonale përmes të ciliave SAI-t kanë vënë në praktikë moton e INTOSAI *"nëpërmjet shkëmbimit të përvojave përfitojnë të gjithë"*.

Auditimet bashkëpunuese midis dy ose më shumë SAI-ve ndahen në tri lloje: paralele, të koordinuara dhe auditime të përbashkëta.

Misioni i Auditimit Paralel: lidhet me zhvillimin e një auditimi me tematikë të përbashkët, por metodologjia dhe përçasja e auditimit do të përcaktohet nga grupet. Auditimi kryhet në të njëjtën kohë nga dy apo më shumë organe auditimi në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri dhe me grupe të veçanta, të cilët zakonisht i raportojnë vetëm nivelit të tyre menaxherial dhe vetëm mbi çështje që parashikohen nga mandati i këtij organi.

Misioni i Auditimit të Koordinuar: mund të jetë një auditim i përbashkët me raporte të veçanta të auditimit nga SAI përkatës, ose një auditim paralel me një raport të vetëm auditimi, krahas raporteve të veçanta të cilat bëjnë dallimin e çështjeve kryesore për secilin SAI.

Misioni i Auditimit të Përbashkët: Vendimet kryesore janë të përbashkëta. Auditimi kryhet nga një grup auditimi i vetëm, i përbërë nga auditues të dy ose më shumë organeve të pavarura të auditimit. Në këtë rast, përgatitet një raport i vetëm dhe i përbashkët auditimi.

Bashkëpunimi mes SAI-ve nuk është një humbje kohe, por një nevojë për ta bërë sa më efektive këtë bashkëpunim, pasi ajo promovon rezultatet dhe zhvillimin e praktikave më të mira në të gjitha institucionet e përfshira. Ai shërben për zhvillimin dhe rritjen e njohurive të përgjithshme profesionale të audituesve të sektorit

publik. Shkëmbimi i mësimave dhe përvojave të fituara, si dhe i njohurive dhe metodologjive në fushat e interesave të përbashkëta mes SAI-ve, duhet parë si një motiv.

Ashtu siç parashikohet edhe në Nenin 5 të Deklaratës së Limës, shkëmbimi i eksperiencave dhe njohurive është një mjet efektiv për të ndihmuar SAI-t në përmbushjen e detyrimeve dhe funksioneve të tyre. Kjo gjë nënkupton shkëmbimin e njohurive, trajnimin e audituesve dhe këshillimin mbi metodologjitë më efektive të auditimit.

Është gjithmonë e nevojshme që njohuritë e fituara të përdoren kryesisht si bazë për nxjerrjen e konkluzioneve mbi përmirësimet e mundshme të funksioneve audituese, pasi organet e auditimit duhet ti kushtojnë tepër rëndësi kuadrin ekonomik dhe ligjor të vendit. Kjo qasje do të ndihmonte gjithashtu në shmangien e përsëritjes së gabimeve sistematike që janë identifikuar nga SAI të tjerë. Bashkëpunimi ndërkombëtar kontribuon në trajnimin e audituesve dhe mundëson familjarizimin e tyre me metodologji të reja pune, si dhe ofron njohuri mbi kuptimin e terminologjive teknike, ndër të tjera edhe në gjuhë të ndryshme.

Nën këtë frymë, institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i ka kushtuar vëmendje kryesore ndërtimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit me homologë apo grupe interesi. Vetëm në këto 4 vjet, KLSH ka nënshkruar rreth 30 marrëveshje bashkëpunimi me SAI homologe, shoqërinë civile, botën akademike, etj. Fryti i këtij bashkëpunimi, kanë qenë ndarja e eksperiencave, kontribuimi i këtyre aktorëve në ide dhe këshillime, ndihmesa në përmirësime ligjore dhe procedurale të funksionit auditues, si dhe realizimi i një numri të lartë trainimesh çdo vit.

Një ndër këto përfitime ka qenë dhe auditimi paralel i realizuar ndërmjet institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, nën mbikëqyrjen dhe këshillimin e vazhdueshëm të përfaqësuesve nga SAI Suedez. Ky auditim u realizuar me dy grupe të veçanta nga secili SAI, mbi një temë të përbashkët, atë të Sigurisë Rrugore. Krahas përfitimeve në kontekstin e hartimit, planifikimit dhe realizimit të auditimit, ky lloj bashkëpunimi bëri të mundur gjithashtu edhe njohjen reciproke me mjedisin ku operon SAI homolog, shqetësimet kryesore, si dhe sfidat e risqet me të cilat përballet secili SAI.

Përfitimet që rrjedhin nga inkorporimi i aktiviteteve të auditimit në aktivitete më të gjera bashkëpunimi dhe ndërtimi institucional:

Një mënyrë efikase për testimin në terren të metodologjive të ndryshme, përpara prezantimit të tyre final në manuale apo dokumente procedurash;

Një mjet praktik për prezantimin dhe zhvillimin e stafit dhe grupeve të auditimit, me procedurat më të reja. Shkëmbimi i eksperincës gjatë zhvillimit të një auditimi kontribuon direkt në zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit. Gjithashtu, zhvillimi në kohë reale i një auditimi mes SAI-ve, ndihmon audituesit të kuptojnë më mirë të plotë të gjithë procesin auditues, se sa si një seri hapash të veçuar.

Angazhimi i vazhdueshëm në auditime të përbashkëta në fusha të ndryshme, lehtëson zhvillimin qasjeve të qendrueshme dhe efektive. Po kështu, në periudha afatmesme dhe afatgjata, kjo praktikë rrit mundësinë e fleksibilitetit brenda stafit, i cili mund të kontribuojë në grupe pune të ndryshme, pa cënuar cilësinë e auditimit.

Bashkëpunimi mes SAI-ve, nuk është diçka e re dhe konsiderohet një praktikë që po njihet vetëm rritje. Aktualisht, të nxitur edhe nga iniciativat kryesore gjeo-politike, të tilla si procesi i zgjerimit të BE dhe globalizimi progresiv i përpjekjeve për forcimin e menaxhimit financiar dhe përmirësimin e qeverisjes, ritmi i ndryshimit është përsheptuar. BE dhe vendet kandidatë për anëtarësim, sëbashku me partnerët kryesor të tillë si Gjykata Europiane e Audituesve, SIGMA apo partnerë të tjerë, kanë treguar dëshirën dhe gadishmërinë e tyre në përgjigje të nevojave në rritje për asistencë teknike, të ndikuara nga këto ndryshime.

Disa nga mënyrat me të cilat këto organe u vijnë në ndihmë SAI-ve, janë:

Financimi në nivele të larta i programeve të binjakëzimit, të cilat përfshijnë zhvillime strategjike, metodologjike dhe menaxheriale, si dhe aktivitete trajnimit;

Rrjeti teknik i mbështetjes së SIGMA dhe i udhëhequr nga SAI partnere, nëpërmjet workshopeve dhe organizimit të takimeve dhe shkëmbimeve të njohurive me grupe ekspertësh mbi tema specifike;

Mundësi pjesëmarrje në auditimet e Gjykatës Europiane të Audituesve, mbi fondet e BE;



Pjesëmarrja në programe internshipi dhe shkëmbimesh;

Marrëveshje specifike dypalëshe mes SAI-ve.

Si një nga vendet kandidate për antarësim, edhe Shqipëria ka filluar të ndjejë përfitimet që sjell ky partneritet. Një ndër to ishte dhe mundësia që ju dha institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për zhvillimin e një internshipi pranë Gjykatës Europiane të Audituesve. Ky internship u zhvillua për një periudhë 5 mujore, nga data 01.03.2015 deri më 31.07.2015, në të cilin morën pjesë auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit me profile të ndryshme profesionale. Gjatë zhvillimit të internshipit, audituesit u caktuan dhe u angazhuan në departamente dhe funksione të ndryshme që lidheshin kryesisht me eksperiencën mbi auditimin financiar.

Kjo praktikë zhvillohet nga të gjitha institucionet e BE, të cilat hapin dyert për rreth 1300 stazhierë çdo vit. Programi i Internshipit zhvillohet për 3 deri në 5 muaj dhe është i organizuar në formën e trajnimeve dhe zbatimit të njohurive në praktikë. Ky program përfshin njohuri mbi BE, funksionimin dhe kuadrin e saj ligjor, si dhe mundësinë për të ndërvepruar dhe për të patur një rol në aktivitetin dhe funksionimin e përditshëm të çështjeve që lidhen me Komisionin European.

Po kështu, kontributi i KLSH rradhitet mes bashkëpunëtorëve të saj edhe si pjesë aktive e grupit të punës për rishikimin e ISSAI 30.

Këto aktivitete janë të formave të ndryshme, operojnë në nivele të ndryshme, si dhe përdorin një llojshmëri përfaqesesh, por në thelb ata kanë të njëjtin qëllim përfundimtar, krijimin e kapaciteteve dhe zhvillimin profesional të SAI-ve, nëpërmjet transferimit të njohurive dhe aftësive me partnerët.

## 12. STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT TË NJË SAI – SIPAS PRAKTIKËS NË KLSH

*Referues: Xhuljeta ÇELAJ- Audituese e parë.*



*“Shkëmbimi sistematik i informacioneve për shqetësimet e përbashkëta mbi përgjegjshmërinë publike midis qytetarëve - dhe shoqërinë civile e organizatat e sektorit privat – dhe SAI-ve, ndihmon në sigurimin e të gjitha aspekteve të qeverisjes janë të përgjegjshme ndaj qytetarëve.”*

*Raport mbi Simpoziumin e 21UN/INTOSAI mbi  
Auditimin e Qeverisjes,*

*Vjenë, 13 to 15 Korrik 2011*

Një nga aspektet më të rëndësishme në punën e një SAI, i cili ndikon djeshëm në perceptimin publik të punës së tij, është shkëmbimi sistematik i informacioneve me qytetarët, shoqëritë civile dhe organizatat e ndryshme të sektorit privat. Shkëmbimi i informacioneve me palët e interesuara, në këtë kontekst më së miri reflekton harmoni me vetë moton e INTOSAI-t, sipas së cilit vetëm nga shkëmbimi sistematik i dijeve dhe eksperiencave midis aktorëve të ndryshëm të përfshirë në punën e auditimit mund të përfitojnë të gjithë.

Në simpoziumin e 21-të UN/INTOSAI mbi “Auditimin e Qeverisjes” i mbajtur në Vjenë në viti 2011, u theksua pikërisht ky aspekt i punës audituese të SAI-ve. Ndër të tjera aty u vendos theksi edhe mbi llojin e përgjegjshmërisë që SAI-t duhet të kenë ndaj palëve të interesuar në procesin e auditimit. Aty u evidentua për herë të para se përgjegjshmëria ka edhe një dimension të sajën social, me anë të së cilit përshkruhen të gjitha ato situata ku qytetarët ndërjegjësohen ndaj problemeve të qeverisjes dhe me anë të mekanizmave të ndryshëm, formalë ose informalë, vendosin para përgjegjësisë qeverisjen.

Në një farë mënyre me anë të konceptit të përgjegjshmërisë sociale institucionet sfidohen të reagojnë ndaj problematikave që evidentohen nga poshtë. Ky është një mekanizëm përgjegjshmërie stimujt e së cilës vijnë nga vetë opinioni publik.

Duhet theksuar gjithashtu se ky koncept nuk ka vetëm të bëj me aftësinë e reagimit të institucioneve ndaj opinionit publik, por është ngushtësisht i lidhur me konceptin e transparencës. Me qëllim arritjen e këtij ndërveprimi midis publikut dhe institucioneve transparencën nuk duhet kuptuar thjesht në kontekstin tradicional të saj, thjesht si një hapje unilaterale e institucioneve ndaj qytetarëve, ajo duhet të jetë bashkëpunuese dhe ndërvepruese. Institucionet duhet ta vendosin veten në këtë kontekst të ri duke ju përgjigjur stimujve që vijnë nga ta.

Në një institucion suprem auditimi siç është Kontrulli i Lartë i Shtetit marrëdhënia e mbajtur me publikun e gjerë dhe palët e interesuar ka një rëndësi të veçantë, pasi institucioni ka si detyrim kushtetues të raportojë në Parlament – që është përfaqësuesi i vullnetit të lirë të qytetarëve – në lidhje me menaxhimin e parave publike. Në mënyrë të pa diskutueshme përgjegjshmëria e KLSH-së, në lidhje me punën audituese, shtrihet direkt tek qytetarët e thjeshtë.

Konkretisht për të arritur këtë shkallë llogaridhënie dhe transparence, KLSH ka miratuar në vitin 2013 Planin Strategjik 2013 – 2017 duke zbatuar një strategji të re komunikimi e cila ka theksuar më tej marrëdhëniet me publikun (qytetarët), Kuvendin, duke përfshirë edhe partnerë të tjerë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në Objektivin e 6-të të Planit Strategjik 2013-2017, KLSH ka parashikuar veprimtaritë që duhet të kryhen me qëllim arritjen e këtij objekti. Disa nga veprimtaritë e përfshira në objektin nr. 6 kanë të bëjnë me:

- Dyfishimin e pranisë me informacion dhe mesazhe në median vizive dhe të shkruar të vendit;
- Publikim i editorialeve dhe shkrimeve të tjera në mediat kryesore të shkruara për problematikën e auditimit publik në vend;
- Bashkëpunim dhe partneritet me organizatat e shoqërisë civile në kryerjen e vrojtimeve dhe analizave të përbashkëta për nivelin e korrupsionit dhe shkallës së transparencës në administratën publike;
- Publikimet: fletëpalosje, buletine, broshura dhe libra për forcimin e qeverisjes, rritjen e luftës kundër korrupsionit dhe të transparencës së administrimit publik;
- Organizimi i tryezave të punës, dëgjimeve publike, konferencave dhe simpoziumeve për rritjen e transparencës dhe shkallës së përgjegjshmërisë së

administratës publike në menaxhimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet;

- Botimi i revistës shkencore katërmujore "Auditimi Publik", e cila u shtyp për herë të parë në vitin 2012;
- Përgatitja për shtyp e raporteve, të cilat kalojnë nëpërmjet medias, duke dhënë mesazhe të rëndësishme në një mënyrë të lehtë, të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë.

Gjithashtu aty parashikohet edhe që institucion do të jetë i pranishëm në media me anë të artikujve të ndryshëm problematike, përgatitur nga menaxhimi apo auditues me përvojë, në mënyrë që të përcjellë një metodë të plotë dhe të qartë informuese për publikun.

Me miratimin e ligjit të ri organik, Ligji nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të shtetit", janë rrënjësor edhe më tepër konceptet e përgjegjshmërisë sociale të institucionit dhe transparencës ndaj publikut. Në nenin 34 të këtij ligji parashikohen në mënyrë të detajuar detyrimet ligjore të institucionit për informimin e publikut të cilat konsistojnë në:

- Publikimin e raporteve të paraqitura nga KLSH-ja në Kuvendin e Shqipërisë;
- Publikimin e raporteve të auditimit në mënyrë elektronike;
- Konferencat për shtyp dhe metodave të tjera të informimit në media;
- Publikimin e njoftimeve për shtyp dhe çdo informacioni tjetër që përcaktohet nga Kryetari i KLSH-së,

me përjashtim të informacioneve dhe materialeve, të cilat përbëjnë sekret shtetëror, tregtar apo konsiderohen si konfidenciale, siç parashikohet dhe në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji.

Komunikimi Strategjik sipas Praktikës së KLSH-së

Gjatë periudhës 2012 – 2016, KLSH ka vendosur në praktikë parimet dhe aktivitetet e përcaktuar në planin e tij strategjik dhe rritur nivelin e transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut në lidhje me punën audituese të tij. Disa nga këto aktivitete përfshijnë:

- Sigurimin e aksesit në informacionin e disponuar nga insitucioni përmes publikimit të raporteve të auditimit të plota dhe/ose të pjesshme;

- Publikimin e raporteve të monitorimit mbi Përdorimin e fondeve të KLSH;
- Publikimin e CV-ve dhe deklaratës së pasurisë personale të punonjësve të KLSH; Përfshirjen në grupet e auditimit e eksperteve të jashtëm, nga të cilët KLSH përfiton ekspertizën dhe rrit kapacitet e tij profesionale;
- publikimet në faqen zyrtare të KLSH, ndër të cilat është interesante edhe “Jeta Sociale”.

Për sa i takon bashkëpunimit me shoqërinë civile vlen të evidentohet nënshkimi i 18 Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me OJF dhe Universitete të vendit si për shembull: Instituti Shkencor Shqiptar - Open Data Albania; Transparency International Shqipëri; Shoqata e Konstablistëve dhe Financierëve; Qendra për transparencë dhe informacionin e lirë; Fakulteti i Gjeologji – Minierave, etj.

Ndërkohë gjatë vitit 2015, KLSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunime edhe me Komitetin Shqiptar të Helsinkit. Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, KLSH do të angazhohet të bashkëpunojë me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, si një prej OJF-ve më me eksperiencë, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe më gjerë.

KLSH ka nënshkruar gjithashtu edhe një marrëveshje me Organizatën “Integrimi Urban” e cila siguron se nëpërmjet këtij bashkëpunimi do të krijohet mundësia e shfrytëzimit të të dhënave të ndryshme të publikuara nga “Integrimi Urban”, të cilat mund të shërbejnë si indicie për fillimin e auditimeve nga ana e KLSH-së.

Për sa i takon komunikimit aktiv me publikun dhe median si një nga nën objektivat më të rëndësishëm të strategjisë së komunikimit të KLSH, kanë një rëndësi të veçantë disa aktivitete tashmë të konsoliduara të institucionit. Konkretisht, për periudhën 2012 – 2015 KLSH ka trajtuar dhe u ka kthyer përgjigje rreth 1263 letrave të ardhura në institucion nga qytetarët në lidhje me problematika të ndryshme. Audituesit e KLSH janë paraqitur në shtypin e përditshëm me 337 shkrime, për periudhën 2013-2015. Gjatë 2015, ata kemi qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetat me 116 shkrime shkrime, të shkruara nga 50 auditues të KLSH-së për aspekte konkrete të punës tepër specifike të auditimit.

KLSH gjithashtu ka pasqyruar gjërësisht në media aktivitetet e saj me rreth 2400 njoftime, editoriale, komenteve analitike, etj., ndërkohë që shkrimet e audituesve në shtypin e përditshëm janë përmbledhur në 3 botime.

KLSH ka publikuar me fondet e veta për periudhën 2012 – 2015 51 botime ndër të cilat kanë një vlerë të veçantë: Revista Kërkimore Shkencore Informativë, "Auditimi Publik" e cila tashme ka arritur në numrin e saj të njëmbëdhjetë; Manuale dhe Udhëzues; Standarde ndërkombëtare të Auditimit, të përkthyer në gjuhën shqipe.

KLSH gjithashtu prej tre vitesh merr pjesë në Panirin e Librit me botimet e realizuara me qëllim afrimin e lexuesve të interesuar tek botimet e fushës së auditimit të jashtëm publik (manuale, udhëzues, standarde, etj.). Këto botime mund të shkarkohen nga faqja zyrtare e KLSH-së pa asnjë kosto për publikun.

Gjithashtu në kuadrin e bashkëpunimit me Universitetet e vendit, me qëllim afrimin e botës akademike e më veçanërisht rritjen e interesit të brezit të ri ndaj punës së auditimit të jashtëm, por edhe në përputhje me praktikën INTOSAI gjërisht të inkurajuar nga INTOSAI, KLSH ka organizuar në ambjentet e Universitetit të Vlorës Analizën Vjetore të KLSH për vitin 2014, si edhe ka organizuar Analizën e Departamentit të Performancës në ambjentet e Universitetit të Elbasanit. Kjo traditë e nisur në vitin 2014 ka vazhduar edhe në vitin 2015 me organizimin e analizës së veprimtarisë së Departamenteve të KLSH pranë Universiteteve të Tiranës, Vlorës dhe Shkodrës.

Institucioni nuk ka punuar vetëm për të ruajtur një nivel transparence dhe llogaridhënie ndaj publikut në një nivel sa më të lartë, por ai është angazhuar edhe në arenën ndërkombëtare duke nënshkruar rreth 19 marrëveshje bashkëpunimi me SAI të tjerë homologë me qëllim rritjen e kapaciteteve audituese të institucionit. Në këtë kontekst i rëndësishëm është fillimi i Projektit IPA, i cili do të kontribuoj edhe më tej në këtë fushë.

Por angazhimi i KLSH-së në arenën ndërkombëtare nuk është kufizuar vetëm me marrëveshjet e bashkëpunimit, pasi institucioni ka qenë tepër aktiv në pjesëmarrjen në aktivitete të organizuara nga EUROSAI dhe INTOSAI si për shembull: antarsimi në Task Force Audit & Ethics e EUROSAI-t, në vitin 2013; publikimet informative të KLSH në revistën e INTOSAI-t, International Journal of Government Auditing.

KLSH ka marrë pjesë edhe në shumë grupe pune dhe aktivitete të organizuara nga INTOSAI dhe EUROSAI duke qenë aktiv në grupin e punës për rishikimin e ISSAI 30 (Kodi i Etikës) dhe ka paraqitur propozimet e tij në 3 takimet e zhvilluara gjatë vitit 2015. KLSH është pjesë e Grupit të Punës për Auditimin e fondeve të alokuara për fatkeqësitë dhe katastrofat dhe ka marrë pjesë në 2 takime të këtij grupi pune.

Gjatë vitit 2015, KLSH ka marrë pjesë në dy takime të grupit Task Force të EUROSAI-it për "Auditimin dhe Etikën" (TFA&E). Në cilësinë e anëtarit të këtij grupi dhe të interesit në rritje të institucionit për këtë çështje, KLSH ka ndjekur gjithnjë me interes aktivitetet e këtij grupi pune të rëndësishëm të EUROSAI-t, i cili trajton një prej çështjeve më aktuale për administratën publike, etikën, e cila është e lidhur direkt me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Trajtimi i kësaj teme është me rëndësi prioritare për institucionet supreme të Auditimit, të cilat janë të ngarkuara me mbikëqyrjen e menaxhimit të shëndoshë të financave publike.

Pavarësisht arritjeve të pa diskutueshme në qasjen inovative të institucionit ndaj komunikimit, transparencës dhe afërsisë ndaj qytetarëve në përgjithësi, evidentohet ende mungesa e një plani strategjik të veçantë për komunikimin institucional, prezenca e të cilit është vendosur tashmë në nivel institucionesh supreme të auditimit dhe INTOSAI si një praktikë e mirë e cila duhet ndjekur.

Gjithashtu një nga inovacionet më të rëndësishme që mjetet moderne të komunikimit i kanë vendosur në dispozicion SAI-ve dhe që rrisin pa dyshim nivelin e transparencës është e dhe përdorimi i rrjeteve sociale për të komunikuar me publikun.

Në këtë kontekst, publiku mund të konsiderohet si konsumator i produkteve të KLSH-së dhe të tërhiqet nga gjetjet e auditimeve në mënyrë krejt tjetër, përmes mediave sociale. Qëllimi do të ishte targetimi i atyre segmenteve të publikut të gjerë që janë përdorues dhe konsumatorë të publikimeve të mediave sociale dhe që përgjithësisht përbëjnë pjesën më të re të shoqërisë shqiptare. Roli i SAI-t në këtë kontekst është sa pozitiv aq edhe delikat, pasi vetë mjeti i komunikimit e ekspozon SAI-n ndaj kritikave dhe komenteve më të gjëra, prandaj për të vendosur në praktikë një aktivitet të tillë duhet një SAI i ndërgjegjshëm dhe i përgatitur.


Këto aspekte mund të konsiderohen si inovative dhe si sfidat më të reja të një insitucioni suprem auditimi i cili duhet të orientohet drejt kontekstit europian.

### 13. PROBLEMATIKAT E NDESHURA GJATË AUDITIMIT DHE “SHFRYTËZIMI” I TYRE PËR PËRMIRËSIMIN E PROCESVEVE NË TË ARDHMEN.

*Referues: Erion MUHO – Auditues i dytë,  
Alfonc GABLI – Auditues i parë.*

Në vendin tonë numri i shoqërive publike ka ardhur në ulje, aktiviteti që ato ushtrojnë luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Përdorimi i fondeve publike nga këto shoqëri, kalon nëpërmjet procedurave ligjore, ku peshën specifike më të madhe e zënë fondet e përdorura nëpërmjet procedurave të prokurimit.

Një ndër problematikat kryesore që vihet re gjatë auditimit në lidhje me prokurimet publike është Njësia e Prokurimit, pra personat të cilët udhëheqin një procedurë të tillë. E kemi zgjedhur këtë temë pasi është dukshëm një fenomen i cili ndodh në çdo subjekt të audituar dhe është një problem shqetësues i cili haset në shumicën e shoqërive publike.



Duke marrë shkas nga auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në disa prej institucioneve publike të një rëndësie të veçantë, vihet re se detaje të vogla bëjnë diferencën me pasoja ekonomike e financiare për to. Në mbështetje të VKM nr. 914, kreu I “Organizimi i prokurimit publik”, “Guri i themelit nëse do të vihet mirë qysh në fillim, gjithë muri do të shkojë pas tij”, çka do të thotë se, duke ndërtuar struktura të mirëfillta për procedurat e prokurimit, do të ketë më pak pasoja financiare dhe një përdorim të mirë të fondeve publike.

Bazuar në rregullat themelore të prokurimeve publike, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ajo çka konstatohet në institucionet publike, është mungesa e një stafi të specializuar dhe të trajnuar për kryerjen e procedurave të prokurimit publik.



Në këto kushte një ndër sfidat më të mëdha në punën e përditshme, të cilat hasen më shpesh nga audituesit, në aktivitetin e luftës kundër korrupsionit, ndër problemet më kryesore është prokurimi publik dhe zbatimi i kontratave. Të sjellim disa shembuj konkretë, referuar auditimeve në institucione dhe shoqëri publike:

1. Rasti i parë i referohet një institucioni publik, në të cilin gjatë auditimit të tenderit me objekt “Rikonstruksion linje...”, në pjesën më të populluar të qytetit është konstatuar se vendosja e një kriteri nga njësia e prokurimit, “Kërkimi i licencës për lëndë plasëse”, në një kohë kur në preventiv nuk ekzistojnë punime të tilla. Gjatë fazës së pranimit të ofertave, janë kualifikuar operatorë ekonomik me një ofertë më të lartë se një operator tjetër i cili ka dhënë një ofertë shumë herë më të ulët duke e skualifikuar pa të drejtë. Në këtë rast diferenca e një ofertuesi nga një tjetër është në vlera të konsiderueshme dhe mund të thuhet qartë se është në favorizim të një operatori preferencial duke mos respektuar parimin e mosdiskriminimit mbi kërkimin e çertifikatave të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Burimi i këtij informacioni është marrë gjatë auditimit të kryer në Ujësje të Bulqizës sh.a., ku anëtarët e Njesisë së Prokurimit ishin, kryetari i saj ishte i kontraktuar nga jashtë, dy të tjerët punonjës të ndërmarrjes me arsim të mesëm dhe për më tepër që nuk kishin njohuri të mirëfilltë mbi procedurat e prokurimit.

2. Rasti i dytë, është i një tenderi me objekt “Shërbim e mirëmbajtje pajisjesh laboratorike”, konstatohet se për shkaqe të arsyeshme zgjidhet procedura “Me negociim pa shpallje paraprake të kontratës”, duke marrë minimalisht 3 oferta. Në këtë rast është konstatuar se dy prej ofertave janë marrë në subjekte të cilat nuk kanë në ushtrimin e aktivitetit të tyre objektin e tenderit që do të prokurohet, duke sjellë për pasojë favorizime dhe diskriminim të shumë operatorëve për një konkurrencë të drejtë dhe të ndershme, p.sh. në një tender me objekt “Shërbim dhe mirëmbajtje pajisje laboratorike”, merret ofertë nga një subjekt që në aktivitetin e vet tregton “Blerje pajisjesh kompjuterike, skanerë, printerë, e fotokopje”. Ky rast është konstatuar gjatë auditimit në Agjencinë Kombëtare e Mjedisit, ku anëtarët e Njesisë së Prokurimit edhe pse ishin me arsimin përkatës dhe kishin njohuri mbi prokurimet (por jo të trajnuar nga APP-ja), përsëri lihej për të dëshiruar në mënyrën e menaxhimit të fondeve të cilat shpenzohen nëpërmjet sistemit të prokurimit publik.

3. Rasti i tretë, në një institucion që ka objekte të rëndësishme të veçantë, të cilat janë të detyruara të jenë të mbikëqyruara me roje private, konstatohet se nuk

përcaktohet saktë mbulimi i zonave më me risk, apo menaxhim i mirë i elementëve financiarë duke marrë në konsideratë dhe stafin e vet. Konkretisht në Ujësjetllës Vlorë sh.a., ku nga auditimi i zbatimit të kontratës së tenderit me objekt "Mbikëqyrje me roje private i stacioneve të pompimit", vihet re se në disa raste nuk ka patur roje dhe shërbimi është mbuluar nga punonjësit e ndërmarrjes. Duke bërë një analizë të tillë për të njëjtin turn i cili mbulohet me punonjësit e vetë institucionit, mund të mos jetë e nevojshme pajisja me roje private ku minimalisht pagesa për roje është thujse sa 2-fishi që paguhet punonjësit të institucionit. Në këtë rast nga njësia e prokurimit duhej bërë një detajim i mirëfilltë mbi nevojën e argumentuar të vendosjes së specifikimeve teknike dhe grafikut të domosdoshëm në kohë të caktuar për pajisjen me roje të stacioneve për secilin turn edhe kur është e nevojshme që të jetë një i tillë, duke përdorur burimet e veta për mbikëqyrjen e stacioneve, pra punonjësit e vet.

4. Rasti i katërt ka të bëjë me përlogaritjen e preventivit të punimeve për një tender me objekt "Rikonstruksion godine", nga një studio projektimi e cila është kontraktuar për të bërë preventivin dhe projektin e rikonstruksionit. Në preventivin e sjellë nga kjo studio, çmimet e zërave të punimeve nuk i referohen ligjit të punimeve të ndërtimit dhe manualeve përkatës. Në këtë rast ka një rritje fiktive të fondit limit pasi në Njësinë e Prokurimit nuk ka specialistë të fushës së ndërtimit duke bërë që çmimet e vendosura në preventiv të kalonin ato të miratuara ligjin e çmimeve të manualeve të ndërtimit e për pasojë duke sjellë efekte financiare për institucionin. Ky konstatim është evidentuar gjatë auditimit të kryer në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave ku edhe pse në organikën e këtij institucioni kishte specialist të fushës së ndërtimit, në NJP ishin vendosur punonjës të cilët nuk kishin njohje mbi këtë fushë.

Në shumë njësi zakonisht ndodh që vendosen nga eprorët e institucioneve, punonjës të rinj dhe të pa trajnuar, "thjesht për të firmosur" procedurën e prokurimit dhe dokumentet e tenderit.

Bazuar në këto argumentime të cilat sjellin pasoja financiare të cilat mund të përdoren për një shportë tjetër më të mirë, nëse menaxhohen siç duhet, si dhe shumë raste të tjera të natyrave të ndryshme objektivisht prokurimi, duket qartë se çdo problematikë vjen si pasojë e përzgjedhjes së *Njësisë së Prokurimit*.

Normalisht duhet që çdo prokurim të realizohet në përputhje me Ligjin nr. 9643, "Për prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", ku të paktën

njëri nga anëtarët e NJP të jetë i trajnuar apo specializuar në fushën në të cilët do të marrë pjesë në prokurim.

Nga Agjencia e Prokurimeve Publike si dhe institucionet e tjera mbikëqyrëse, mungon një monitorim i mirëfilltë dhe nuk ka një kërkesë llogaridhënie mbi Njësitë e Prokurimit të ngritura nga çdo institucion, duke harmonizuar kështu ngritjen e kapaciteteve prokurorese, pasi të qënurit në vëzhgim nga APP do të sjellë në të njëjtën kohë një zbatim më rigoroz të ligjit të prokurimit publik.

Të gjitha këto pasoja vijnë nga neglizhenca e vendosjes së një stafi të kualifikuar nga Autoritetet Kontraktore si dhe nga mungesa e një trajnimi për anëtarët e prokurimit nga Agjencia e Prokurimit Publik në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" kreu VII, "Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave", neni 57, si dhe të kreut XII "Manualet dhe trajnimi", neni 83, pikat 2 dhe 3.

Pra sikurse tregohet qartë në VKM se është i detyrueshëm që NJP të jetë e trajnuar dhe të monitorohet nga APP, duhet që të bëhet akoma dhe më e detyrueshme në çdo institucion planifikimi i nevojave për trajnimin e zyrtarëve të përfshirë në veprimtarinë e prokurimit publik.

Duke patur parasysh referencat ligjore të mësipërme, në lidhje me përgatitjen e kapaciteteve të NJP, vendosja e një stafi të mirëfilltë, i cili do të jetë udhëheqës në drejtim të shpenzimeve të kryera mbi prokurimet publike, do të ishte më se e mjaftueshme nëse do të zbatohen me rigorozitet çdo bazë ligjore pasi në të njëjtën kohë do të quhet dhe si një luftë kundër "korrupsionit".

Me një analizë të thjeshtë mos përzgjedhja e një Njësie Prokurimi e cila të jetë e trajnuar të kryejë procedurat e prokurimit, apo të ketë marrë më parë konsulencën e mjaftueshme ligjore, dhe duke mos qenë specialistë të fushës, themi se keqpërdorimi fondeve sjellë mos realizim mbi përdorimin e fondeve publike me Eficiencë, Ekonomicitet dhe Efektivitet.

Nga titullarët e autoriteteve kontraktore, nuk u kushtohet vëmendje procesit të prokurimit, duke qenë se një proces i tillë sipas LPP funksionon me delegime kompetencash (njësi prokurimi, komision vlerësimi, si dhe grupe pune ad-hoc të ngritura për çështje të tilla). Në nenin 12 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", pika 1, përcaktohet se: "*Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, që i janë vënë në dispozicion, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij*". Dhe është

pikërisht kjo pikë që i ngarkon me përgjegjësi titullarët e autoriteteve kontraktore, si përfaqësues ligjorë të autoritetit kontraktor, për mbarëvajtjen e procesit të prokurimit.



5. Rasti i pestë ka të bëjë me arsyetimin e kryerjes së shpenzimeve. Për çdo shpenzim të kryer (prokurim), autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë qartë nevojën për kryerjen e këtij shpenzimi (prokurimi), e cila duhet të jetë e miratuar në organet kompetente (Këshill Mbikëqyrës, Asambleja e Aksionarëve, Institucion epror, etj). Këto kërkesa janë të përcaktuara në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në

njësitë e sektorit publik", pika 36, e cila përcakton se: "*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe ato të mashtrimeve".*

Raste të tilla janë hasur në disa auditime të kryera, e konkretisht: Albkontrol sh.a. ka kryer procedura prokurimi për disa shërbime të cilat mund ti kryente me kapacitetet e veta të shoqërisë, ose shërbime të cilat ishin ekskluzivitet i institucioneve të tjera; Porti Detar Vlorë sh.a., i cili ka kryer procedura prokurimi për ambiente të cilat i ka lëshuar me qira ose administrohen nga institucione të tjera; Ujësjellës Kanalizime sh.a. Pogradec i cili ka kryer procedura prokurimi të cilat duhet ti faturoheshin abonentëve, por që nuk i janë faturuar, etj.

Janë të konsiderueshme shuma e dëmeve të konstatuara në Kontrolli i Lartë i Shtetit në këto nivele institucionesh, dhe ngritja e një NJP të specializuar sjell reduktim të kostove dhe përdorim më të mirë të këtyre fondeve.

Edhe pse nga auditimet e ushtruara nga KLSH, janë lënë rekomandime mbi marrjen e masave për ngritjen e NJP të specializuara nga institucionet shtetërore si dhe

trajnimin e vazhdueshëm të tyre dhe për kualifikim të mëtejshëm në fushën e prokurimeve, sërish konstatohet se në disa raste nuk merren në konsideratë këto rekomandime, ndërkohë që në shumicën e rasteve sërish ka problematika të tilla.

Në shumë raste, institucione të caktuara nxitohen në kryerjen e procedurave të ndryshme të prokurimit, pa e argumentuar më parë nevojën e kryerjes së tyre, si dhe pa patur parasysh elementët e eficiencës, ekonomikitetit dhe efektivitetit. Kjo ka ndikuar që shumë autoritete kontraktore kryejnë procedura të ndryshme çdo vit, ndërkohë që magazinat e tyre vazhdojnë të tejmbushen nga viti në vit. Si rezultat i prokurimeve pa një argumentim të saktë të nevojës, si dhe nga tejmbushja e magazinave më shumë shoqëri çdo vit kryejnë procedura të nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimin e materialeve të cilat nuk gjejnë më funksion në operacionet e shoqërisë.

6. Rasti i gjashtë ka të bëjë me përbërjen dhe funksionimin e këshillave mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore. Në shumë raste janë konstatuar që në përbërje të këshillave mbikëqyrës nuk ka specialistë të fushës sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 318, datë 08.04.2009 "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore", si dhe statusin apo rregulloren e këtyre shoqërive, por janë emëruar anëtarë të këshillit mbikëqyrës persona me profesione të ndryshme nga natyra e shoqërisë. Konkretisht në shoqëri Ujësjellës-Kanalizime SHA Fier, në përbërje të Këshillit Mbikëqyrës ka mësues, ushtarakë, etj., por jo inxhinierë të fushës. Në SHA Ujësjellës Kanalizime Pogradec është konstatuar se disa nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk kanë qenë të angazhuar në kryerjen e detyrave të tyre funksionale, duke mos marrë përgjegjësitë e caktuar nga aktet ligjore e nënligjore përkatëse, duke mos marrë pjesë nëpër mbledhje për periudha të gjata kohore. Në disa shoqëri të ndryshme me kapital shtetëror, është konstatuar se në këto shoqëri janë emëruar punonjës të afërm me anëtarët e këshillit mbikëqyrës. Në shumë raste vendimet e marra nga këto këshilla, janë marrë në kundërshtim me aktet ligjore përkatëse, si dhe janë konstatuar vendime të marra jashtë kompetencës së tyre.

Problem kryesor në përbërjen e këshillave mbikëqyrës, mbetet fakti që këto funksione shikohen si funksione politike, si dhe nga vetë anëtarët e këshillave nuk i japin rëndësi detyrave të tyre, duke i parë thjesht si një eksperiencë më shumë në CV e tyre. Këshillat Mbikëqyrës nuk i kryejnë detyrat e tyre themelore, përse i përket kontrollit dhe menaxhimit të shoqërisë, duke i lënë në shumë raste dorë të

lirë administratorëve të shoqërisë në administrimin e saj. Në lidhje me këtë çështje nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është kryer një auditim në të gjitha shoqëritë shtetërore anonime, në përfundim të të cilit problematikat e konstatuara janë të shumta.

7. Rasti i shtatë ka të bëjë me përdorimin e aktiveve të shoqërisë. Në bazë të pikës 30, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", çdo njësi është e detyruar të krijojë dhe përditësojë një regjistër kontabël të aktiveve që zotëron, konkretisht sipas përcaktimit si vijon: *"Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e s'kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia".*

Në pothuaj të gjitha rastet e audituara, shoqëritë shtetërore nuk e kanë të plotësuar këtë regjistër kontabël, madje në disa raste nuk dinë as numrin e aktiveve por vetëm vlerën kontabël të totalit të këtyre aktiveve (Porti Vlorë, AlbPetrol, UK Pogradec, Fier, etj.). Mënyra e deritanishme e mbajtjes është në kundërshtim të plotë me ligjin e kontabilitetit dhe standardet kontabile. Për më tepër as nga ekspertët kontabël që kanë kryer auditimin e këtyre shoqërive, nuk është evidentuar kjo problematikë, e për pasojë mbetet e paqartë arsyetimi i tyre në auditimin e kryer për aktivet. Nga mos hartimi i regjistrave të saktë kontabël të aktiveve që shoqëritë zotërojnë, është krijuar një risk i lartë dhe tek nxjerrja jashtë përdorimi e aktiveve, për arsye se nuk përcaktohen qartë të dhënat e aktiveve që nxirren jashtë përdorimi, e në raste të caktuara kanë ndodhur dhe abuzime.

8. Rasti i tetë ka të bëjë me lëvizjen e shpeshtë e drejtuesve të institucioneve, shoqëruar dhe me lëvizjen e stafit, duke krijuar problematika artificiale në menaxhimin e ndërmarrjes. Problematikat kryesore që lidhen me këtë çështje janë humbja e memories institucionale, risku i lëvizjes së stafit të kualifikuar dhe punësimi si personave pa aftësitë apo kualifikimet e duhura, rëndimi i shpenzimeve nga vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar duke mos-ndjekur procedurat e duhura administrative, si dhe mungesa të ndryshme dokumentacioni. Raste të tilla

ka patur në shumë shoqëri me kapital shtetëror, si p.sh.: AlbPetrol, Porti Detar Vlorë, Albcontrol, UK Fier, UK Pogradec, etj., ku efektet financiare negative të shkaktuara nga shpenzimet gjyqësore por edhe nga problematikat e hasura si rezultat i paaftësisë së stafit, kanë vënë në dyshim performancën financiare të shoqërisë.

Ndodh shpesh, e sidomos në periudha të ndryshimeve politike në qeverisjen qendrore dhe vendore, që drejtuesit e institucioneve pësojnë ndryshime. Si pasojë e ndryshimit të drejtuesve, ndodhin dhe ndryshime në stafin e institucioneve, duke mos kursyer as punonjësit kyç. Në këto raste pasojat janë të shumta, e më e rëndësishmja ndër to është humbja e memories institucionale.

Gjithashtu ka ndodhur që janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për punonjës të kualifikuar dhe në vend të tyre janë punësuar punonjës jo me kualifikimet e duhura. Kjo ka ndikuar në uljen e performancës së shoqërisë, si atë financiare dhe atë operative. Në shumë raste drejtuesit e rinj të institucioneve, nxitohen në largimin e punonjësve nga puna, duke mos respektuar kështu etapat administrative. Për pasojë, punonjësit e larguar i janë drejtuar gjykatave, duke rënduar së tepërmi kostot e këtyre institucioneve, për arsye se paguhen 2 apo më shumë persona për të njëjtin vend pune. Duke mos patur një përkufizim të qartë të dëmit ekonomik, si dhe duke mos ekzistuar rrugët ligjore për penalizimin e tyre dhe dëmshpërblimin e dëmit të shkaktuar, shumë drejtues institucionesh të ndryshme kanë patur dorë të lirë në lëvizjen e punonjësve.

### ROLI I KLSH-së.

Është domethënës roli i KLSH-së si gardiani i mbrojtjes së fondeve publike, i cili në çdo moment monitoron nëpërmjet auditimeve mënyrën se si menaxhohen dhe përdoren fondet publike duke bërë të mundur vënien përpara përgjegjësive personat të cilët sjellin këto pasoja dhe në anën tjetër tregon se si duhet të përdoren këto burime financiare. Në lidhje me përmirësimin në të ardhmen të proceseve të punës dhe vazhdimësinë e tyre, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në shumë auditime të kryera mbi konstatimet dhe problematikat e tilla, të trajtuara sa më sipër, janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes, por në disa raste problematike mbetet çështja e zbatimit të tyre.

14. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM ËSHTË ZHVILLIMI QË PLOTËSON NEVOJAT E SË TASHMES PA KOMPROMENTUAR NEVOJAT E SË ARDHMES.

*Referues: Blerina KËRÇUKU – Audituese e dytë,  
Kris ANASTASI – Auditues i dytë.*

*Zhvillimi i qëndrueshëm në drejtim të plotësimit të nevojave të së tashmes pa kompromentuar nevojat e së ardhmes.*

*WCED, 1987*

Abstrakti:



Kombet e Bashkuara dhe komuniteti i INTOSAI-t i kanë dhënë një rëndësi zhvillimit të qëndrueshëm. Në Simpoziumin e 23-të të Kombeve të Bashkuara dhe INTOSAI-t, theksohet roli që mund të luajnë Institucionet Supreme të Auditimit në këtë drejtim. SAI-t luajnë një rol jetik në lehtësimin e transparencës së veprimeve të qeverisë dhe sigurojnë që publiku informohet drejt dhe rregullisht mbi veprimet e qeverive. SAI-t nëpërmjet auditimit të zhvillimit të qëndrueshëm kanë përgjegjshmëri publike për të përcaktuar mënyrën e shëndoshë ose jo të

menaxhimit financiar. Për më tepër, pavarësia e SAI-t në kryerjen e auditimeve financiare, përputhshmërisë, performancës, etj., i vendos ata në një pozicion unik për të vlerësuar në mënyrë legjitime dhe të besueshme, efikasitetin dhe efektivitetin e politikave dhe ndaj detyrimeve të qeverisë.

1. Koncepti i auditimit të zhvillimit të qëndrueshëm

Edhe pse nuk ka një përkufizim të vetëm të zhvillimit të qëndrueshëm, ky koncept u përhap për herë të parë në vitin 1987, në Raportin e Komisionit Botëror mbi Zhvillimin dhe Mjedisin, me titull "E ardhmja jonë e përbashkët"<sup>46</sup>.

<sup>46</sup> WCED (1987), Our Common Future. World Commission on Environment and Development <http://www.un-documents.net>



Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm është një koncept i ri i cili ka fituar një përhapje globale për shkak të diskutimeve të gjera të tre komponentëve, mbrojtja e mjedisit, rritja ekonomike, dhe zhvillimit social, të cilat njihen si "shtyllat" e zhvillimit të qëndrueshëm.

Premisat themelore, ndoshta revolucionare në atë kohë, bënë të mundur integrimin e objektivave sociale, mjedisore dhe ekonomike, të cilat vunë në lëvizje ndryshime të mëdha në politikat qeveritare dhe programet rregulluese, duke tërhequr dhe partnerët joqeveritare në një kauzë të përbashkët.

Zhvillimi i qëndrueshëm është një paradigmë vizionare, e cila gjatë 20 viteve të fundit ka treguar se qeveritë, bizneset, dhe shoqëria civile ka pranuar zhvillimin e qëndrueshëm si një parim udhëzues, duke bërë progres për të përmirësuar situatën jetësore.

Në raportin e ardhmja jonë e përbashkët (1987), Komisioni Botëror mbi Mjedisin dhe Zhvillimin përcaktoi lidhjet komplekse midis problemeve të ndryshme mjedisore. Raporti vuri në dukje: "Nga hapësira, ne shohim një top të vogël dhe të brishtë dominuar nga retë, oqeanet, gjelbërim dhe tokat... Por jemi ne njerëzit të cilët e studiojnë tokën si një organizëm shëndetësor me të gjitha pjesët e saj. Ne kemi fuqinë për të pajtuar çështjet njerëzore me ligjet natyrore dhe të lulëzojmë në këtë proces, drejt zhvillimit të qëndrueshëm".

Zhvillimi i qëndrueshëm kërkon që çdo shtet të plotësojë disa element thelbësorë në mënyrë që ai të funksionojë:

- a. Barazi dhe drejtësi. Plotësimi i nevojave thelbësore të botës së varfër konsiderohet si një prioritet thelbësor.
- b. Afat-gjatë. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm, që nuk i përgjigjet vetëm nevojave të së tashmes por dhe të ardhmes, minimizimi i kostos efektive për të parandaluar degradimin e mjedisit, ekonomisë dhe shoqërisë.
- c. Integritet. Ndërlidhja dhe ndërvarësia që duhet të ekzistojë mes tre komponentëve mjedis-ekonomi-shoqëri.

Roli i aktivitetit ekonomik, si privat edhe publik, për zhvillimin e qëndrueshëm është që të respektojë të tre shtyllat, ekonomike, sociale, mjedisore. Kjo përgjegjësi nuk duhet të konsiderohet si një pengesë, por si një mundësi për zhvillimin e ekonomisë. Secila nga këto shtylla duhet të konsolidohet për të realizuar funksionin e saj.

Zhvillimi social: Për të pasur një të ardhme të qëndrueshme nevojat e njerëzve duhet të plotësohen në mënyrë të barabartë, si në kujdesin shëndetësor, strehim të përshtatshëm, ushqim, etj. Zhvillimi i qëndrueshëm i trajton këto nevoja si të rëndësishme për promovimin e barazisë, edukimit dhe pjesëmarrjes në bashkësitë lokale.

Mbrojtja e mjedisit: Planeti i tokës disponon sasi të kufizuara të burimeve. Aktiviteti njerëzor e konsideron mbrojtjen e mjedisit si një nga elementet e rëndësishme me qëllim sigurimin e të mirave në të tashmen duke menduar për brezat e ardhshëm. Çështjet aktuale përfshijnë ngrohjen globale, peshkim detar ashtu dhe shpyllëzimi në tokë.

Zhvillimi ekonomik: Njerëzit në të gjithë botën meritojnë standarde të qëndrueshme në mënyrën e jetesës. Përmirësimi i kujdesit mjekësor, arsimor, bëhet i mundur nëpërmjet gjenerimit të aktivitetit ekonomik. Ekonomitë e qëndrueshme gjithashtu duhet të jenë konkurrues në tregun botëror. Për shembull: n.q.s. një produkt është i shtrenjtë në vlerën e tij ai nuk mund të jetë i qëndrueshëm, për këtë arsye vlera e tij duhet të jetë fleksibel në raport me shtresën konsumatore. Qeveritë kanë rolin e tyre për të kontribuar që aktiviteti ekonomik të sjellë mirëqenie për të gjithë, dhe jo vetëm për një kategori të caktuar.

## 2. Roli i SAI në auditimin e zhvillimit të qëndrueshëm

Lidhja midis Institucioneve Supreme të Auditimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm mund të mos jetë e qartë për shumicën e njerëzve në shikim të parë. Zhvillimi i qëndrueshëm nuk mund të arrihet pa një qeverisje të mirë dhe qeverisja e mirë, nga ana tjetër, është mbështetur në masë të madhe nga puna e vlefshme e SAI. Prandaj, SAI mund të luajnë një rol jetik në informimin dhe mbështetjen e përpjekjeve për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm.

Konkretisht, në Shqipëri KLSH si institucioni më i lartë auditues informon publikun dhe Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë si dhe synon të rrisë përgjegjshmërinë në një shkallë më të gjerë për të gjithë, në përputhje me praktikatat më të mira të BE-së dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, duke kontribuar për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Në përbushje të të gjithë objektivave, KLSH e mbështet veprimtarinë mbi vlera dhe parime të tilla si pavarësia, objektiviteti, integriteti, përgjegjshmëria, profesionalizmi, interesi publik, bashkëpunimi dhe transparenca.

Hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik 2013-2017, po shërben si një "matës" për realizimin e objektivave afat-shkurtra dhe ato afat-mesme, në funksion të zhvillimit të kapacitetit institucional të KLSH, rritjes së kapaciteteve audituese dhe cilësisë së auditimit, përmirësimi të cilësisë dhe shtimit të numrit të auditimeve të performancës, zhvillimit dhe konsolidimit të auditimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimi i TI në auditim, rritjen e kontributit të KLSH për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit, si dhe rritjen e ndikimit të rolit të KLSH përmes komunikimit dhe bashkëpunimit. Nga miratimi i këtij plani kanë kaluar më shumë se dy vjet, dhe rezultatet e punës janë të dukshme jo vetëm brenda institucionit por dhe në raport me kapacitetet e ndërtuar për të përballuar sfidat e së ardhmes.

Miratimi i Ligjit të Ri të KLSH në muajin nëntor 2014, përmban ndryshime që rregullojnë në mënyrë përfundimtare pavarësinë e plotë institucionale të KLSH duke parashikuar njëkohësisht një konceptim modern të të drejtave dhe detyrave të tij sipas standardeve INTOSAI, rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të tij dhe rritjen e kapaciteteve administrative, certifikimin e audituesve, saktësimin e të drejtës së KLSH-së për të audituar programet e zhvilluara me fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë, dhe të së drejtës për të certifikuar llogaritë financiare, si dhe vendosjen në ligj në mënyrë eksplicite të dy formave më koherente të auditimit, të performancës dhe auditimit të IT, të përdorura gjerësisht nga institucionet tona homologe.

Krahas auditimit të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare (pjesë e ligjit të mëparshëm), tashmë me miratimin e ligjit të ri, KLSH kryen edhe dy lloje të tjera auditimi: auditimin e performancës dhe auditimin e teknologjisë së informacionit. Këto lloje auditimi rekomandohen nga institucionet ndërkombëtare, gjejnë zbatim në vende të tjera dhe i japin KLSH-së fytyrën e një institucioni modern auditimi. Auditimi i performancës ka filluar të praktikohet vitet e fundit dhe synon menaxhimin e subjekteve publike me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet. Nëpërmjet auditimeve të performancës KLSH është fokusuar në auditimin e çështjeve si: performanca e arsimit parashkollor, performanca e spitaleve, infrastruktura e shërbimit bibliotekar kombëtar, implementimi i politikave qeveritare për mbrojtjen

e mjedisit, burimet alternative të energjisë në Shqipëri, siguria rrugore, strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, etj.

Këto auditime performance dhe auditime të tjera në proces, janë një pikë e rëndësishme e diskutimeve në parlament dhe publikut të cilat lidhen me fusha të rëndësishme dhe sensitive (që janë pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm) jo vetëm nga organizatat joqeveritare dhe publiku i gjerë, por edhe nga vetë qeveritë, për rrjedhojë SAI-t të mund të kontribuojnë ndjeshëm në ruajtjen e zhvillimit të qëndrueshëm për sa kohë që pozicioni i tyre i pavarur dhe profesional është i garantuar.

Këto auditime, u sigurojnë SAI-ve pozitën e të qenit një institucion që kupton pasojat sociologjike dhe mjedisore dhe që këto politika janë pjesë integrale e aktiviteteve të qeverisë dhe ndikojnë në shpejtësinë dhe shkallën e zhvillimit të qëndrueshëm.

Auditimi i IT është një lloj i ri auditimi, më i avancuar se të tjerët dhe bëhet i domosdoshëm për të ndërlidhur menaxhimin financiar me progresin e shkencës dhe teknikës.

KLSH nëpërmjet konsolidimit me partnerë vendas dhe të huaj ka lidhur marrëveshje me shoqëritë civile si: Integrimi Urban, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Shoqatën e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë, Institutit Shqiptar të Shkencave, etj.. Marrëveshje janë nënshkruar dhe me shumë institucione homologe si Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, Maqedonisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Gjykatës së Audituesve të Austrisë, Gjykatës së Llogarive të Turqisë, SAI-n e Polonisë, etj. Por dhe me institucione të tjera si Prokuroria e Përgjithshme, Autoriteti i Konkurrencës, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik, Departamenti i Administratës Publike, etj.

Ky bashkëpunim nuk ka bërë gjë tjetër vetëm ka thelluar njohjen reciproke, nëpërmjet trajnimeve, veprimtarive të përbashkëta audituese, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm, përmirësimi i punës tonë sot do të ndikoj në vitet e ardhshme.

SAI-t nëpërmjet auditimit të zhvillimit të qëndrueshëm kanë përgjegjshmëri publike për të përcaktuar mënyrën e shëndoshë ose jo të menaxhimit financiar. Për më tepër, pavarësia e SAI në kryerjen e auditimeve financiare, përputhshmërisë, performancës, etj., i vendos ata në një pozicion unik për të vlerësuar në mënyrë

legjitime dhe të besueshme, efikasitetin dhe efektivitetin e politikave dhe ndaj detyrimeve të qeverisë.

KLSH si një institucion profesional i besueshëm, luan një rol në lehtësimin e transparencës së veprimeve të qeverisë i cili nëpërmjet lajmeve mediatike (vizive dhe të shkruara), u siguron publikut të informohet drejt dhe rregullisht mbi veprimet e qeverive.

### 3. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe programet

Ekzistojnë një sërë politikash dhe programesh individuale, të cilat ndikohen nga konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm. SAI mund të kontrollojnë se si ato reflektohen në politika individuale ose programe shpenzimesh. Për të qenë efektive, strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm duhet të ndiqen nëpër objektivat dhe synimet e përcaktuara për programet individuale.

Ka shumë fusha të politikës dhe programe të veçanta që preken nga konceptet dhe shqetësimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Programet, në të cilat përplasja midis objektivave sociale, ekonomike dhe mjedisore do të jetë më e dukshme dhe akute, janë p.sh. ndërtimi i rrugëve, peshkimi, subvencionet bujqësore dhe prodhimi i drurit ose energjisë. Në këta sektorë, objektivat e ndryshëm mund të punojnë kundër njëri-tjetrit. Megjithatë, në programe të tjera si p.sh. masat për të përmirësuar efikasitetin e energjisë, objektivat ekonomike, mjedisore dhe sociale mund të përkojnë dhe përforcojnë nevojën për ndryshim.

### Mundësitë për Auditimin e Programeve

Mundësitë për auditimin e programeve janë të shumta. Ato mund të përfshijnë çështje të zhvillimit ekonomik, progresit social, burimeve natyrore, etj. Në shumicën e rasteve, auditimet e fokusuara në zhvillimin e qëndrueshëm do të duhet të konkurrojnë me ide të tjera temash, për një vend në programin dhe prioritetet e SAI. Rrjedhimisht, tema do të duhet të jetë e auditueshme, të ofrojë vlerë të shtuar, të trajtojë çështje materiale dhe të ketë mundësi të mbyllet në kohë nëpërmjet burimeve në dispozicion.

Rëndësia e temës ka gjasa të reflektojë jo vetëm vlerën monetare, por edhe rëndësinë e ndikimit të programit. Për shembull, politika kundër ndotjes ka gjasa të përfshijë lloje të ndryshme instrumentesh të politikave, të tilla si stimuj ekonomikë,

iniciativa kërkimore dhe trajnuese, fushata arsimore publike dhe organizata të themeluara për licencimin e kompanive dhe ndjekjen e shkelësve. Në këtë rast, mund të mos nevojiten shumë para publike, por ndikimi i politikave mund të jetë i madh.

Qasja e adoptuar nga SAI nuk duhet të ndryshojë nga proceset e përdorura zakonisht për të zgjedhur tema për auditimin e performancës. Megjithatë, në identifikimin e temave, SAI-t mund të duan të shohin lidhjet midis programeve individuale dhe strategjisë së përgjithshme të qeverisë. Pyetjet tipike janë treguar më poshtë:

- A ka një lidhje midis objektivave strategjike dhe politikave specifike e programeve?
- A është e qartë se cilat politika pritet të arrijnë objektivat strategjike, dhe cili është përgjegjësi për dërgimin e tyre?
- A po i përmbush programi objektivat e tij?
- A po vepron qeveria në përputhje me ligjet e veta dhe a i ka përmbushur përgjegjësitë e saj në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare që ka nënshkruar?

Këto pyetje nuk kanë domosdoshmëri për qëllim të formojnë bazën për auditim, por mund të ndihmojnë SAI-n për të kuptuar kontributin e pritshëm të politikave dhe programeve individuale dhe se ku mund të gjenden dobësitë e mundshme.

#### 4. Ndërtimi i kapaciteteve brenda SAI

SAI për të zhvilluar aftësitë e tij trajtohen gjashtë etapa për ndërtimin e kapaciteteve.

##### Hapi 1: Qartësimi i mandatit

SAI duhet të shqyrtojë mandatin e vet për të përcaktuar nëse ka autoritetin për të kryer auditime në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm. Në shumicën e rasteve, SAI me kompetenca për të kryer auditime performance, kanë edhe mandat të mjaftueshëm për të shqyrtuar shumë aspekte të zhvillimit të qëndrueshëm.

##### Hapi 2: Zhvillimi i strategjisë

Faza tjetër është marrja në konsideratë e reagimit strategjik të SAI-t ndaj programit të zhvillimit të qëndrueshëm. Strategjitë që çdo SAI mund të adaptojë do të varen

nga një sërë faktorësh, duke përfshirë rëndësinë që i jepet temës në nivelin qeverisës; përvojën e SAI-t; dhe burimet në dispozicion për këtë lloj pune. SAI mund të vendosë për të kombinuar auditimet e zhvillimit të qëndrueshëm me programet e tyre kryesore, duke përzgjedhur tema për auditim jashtë programeve të zakonshme të qeverisë. Në raste të tjera, SAI-t mund të dëshirojnë të ngrenë ekipe të posaçme me ekspertizë të veçantë në këtë fushë.

### Hapi 3: Ndërtimi i kapaciteteve dhe ekspertizës brenda SAI

Ndërkohë që SAI-t fitojnë besim në përballimin e situatave komplekse, aq më shumë përpjekje kërkon auditimit i efektivitetit të programeve dhe masave të marra nga qeveria. Njëra mënyrë është duke shtuar stafin e specializuar, qoftë duke rekrutuar specialistë, ashtu edhe duke u konsultuar me specialistë të jashtëm në rrethana të caktuara. Për më tepër, SAI mund t'ju duhet të rishikojnë programin e tyre të trajnimeve, duke përfshirë edhe trajnimet dhe diskutimet me kolegët e tyre në vende të tjera që do të ndihmonte në zhvillimin e kapaciteteve.

### Hapi 4: Kryerja e auditimeve

Standardet që aplikohen në kryerjen e auditimeve që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm nuk duhet të ndryshojnë nga ato të llojeve të tjera të auditimit. Çështjet e auditimeve të zhvillimit të qëndrueshëm kërkojnë katër fazat e zakonshme: planifikimi, puna në terren, raportimi dhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve. Objektivat thelbësorë ngalen të pandryshuar, përkatësisht bërja e ndryshimit, promovimi i llogaridhënies dhe përdorimi i praktikave më të mira.

### Hapi 5: Mësimi nga eksperiencia e vetë SAI dhe nga të tjerët

Natyrisht që ka gjithmonë vend për përmirësim në një fushë të tillë në zhvillim, siç është auditimi i zhvillimit të qëndrueshëm. Shkëmbimi i eksperiencave me SAI të tjerë mund të ndihmojë në shkëmbimin e ideve dhe azhurnimin me zhvillimet e fundit. Në shumë vende të botës, anëtarët e INTOSAI kanë vendosur grupe rajonale mbi auditimin e mjedisit për të asistuar procesin e trajnimit. Në të ardhmen, këto grupe mund të adresojnë edhe çështje të zhvillimit të qëndrueshëm.

### Hapi 6: Të ketë ndikim

Pyetja më e dukshme është: “A po bëjmë një ndryshim dhe mbase më e rëndësishmja, a po bëjmë ndryshimin që donim të bënim?” Ashtu si me format e tjera të auditimit të performancës, SAI duhet të kenë një sistem të ndjekjes së

rekomandimeve dhe monitorimit të ndikimit. Një auditim performance mund të jetë efektiv vetëm kur gjetjet e tij bëhen publike. Një strategji e shëndetshme e komunikimit dhe raportimit është shumë e rëndësishme për të qenë të suksesshëm. Gjithmonë duhet shqyrtuar nëse formati i përdorur për bërjen e raportit e ndihmon apo pengon përcjelljen e mesazhit.

Zhvillimi i qëndrueshëm paraqet sfida të reja për Institucionet Supreme të Auditimit. Në këtë pjesë u sugjerua se duke e ndarë procesin në një seri etapash dhe me anë të shkëmbimit të eksperiencës, këto sfida mund të përballohen me besim dhe maturi.

Referencat:

*The Value and Benefits of Supreme Audit Institutions – making a difference to the lives of citizens, ISSAI 12.*

*Strategic Plan 2011-2016, INTOSAI.*

<http://www.intosai.org/>

*Sustainable Development: The Role of Supreme Audit Institutions, ISSAI 5130*

*WCED (1987), Our Common Future. World Commission on Environment and Development.*

<http://www.un-documents.net>

*Transparency International, "Anticorruption Handbook", 2004.*

*Ligji Nr. 154 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", 2014, KLSH.*

*Plani Strategjik 2013-2017, 2013, KLSH.*

*IntoSAINT, Manuali i Vetëvlerësimit të Integritetit për Institucionet Supreme të Auditimit, 2014, KLSH.*

*Strategjia e Implementimit të ISSAI 2015-2016, 2015, KLSH.*

*Udhëzues i Auditimit të Performancës, ISSAI 3000-3100, KLSH.*


*Manual i Departamentit të Auditimit të Performancës, 2015, KLSH.*



15. KOMUNIKIMI I SAI-t. PËRFSHIRJA E PUBLIKUT

*Referues: Elisa METAJ – Specialiste e Buletinit dhe e Statistikave,  
Amantia PATOZI –Specialiste/Audituese e parë.*

*Një komunikim efektiv dhe inovativ duhet të çojë drejt vlerësimit të punës rigoroze të SAI-ve dhe kontributit të tyre për transparencë dhe përmirësim të menaxhimit të institucioneve publike, së bashku me rritjen e besueshmërisë dhe kredibilitetin në to.*



1. Hyrje

Në dekadat e fundit, komunikimi konsiderohet të jetë një nga elementet thelbësor në hartimin e strategjisë së organizatave publike dhe private. Sektori publik gjithnjë e më shumë gjendet para sfidave të reja, të cilat kanë qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike ndaj qytetarëve.

Komunikimi luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm për të nxitur transparencën, veçanërisht në aspektin e konsultimit me qytetarët, të cilët nëpërmjet aksesit që kanë në informacion njohin vendimmarrjen e institucioneve dhe mund të shprehin opinionet e tyre për çështje që paraqesin me interes për ta.

Për një qeverisje të mirë dhe demokratike, transparenca përbën një nga elementët thelbësorë që duhet të garantohen për të gjithë qytetarët. Transparenca nënkupton ndarjen e informacionit, si edhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve në mënyrë të hapur me publikun. Aksesit i lirë ndaj informacionit luan një rol kyç në promovimin e transparencës dhe në parandalimin e korrupsionit. Për këtë arsye institucionet shtetërore duhet ta ofrojnë atë në kohë dhe në mënyrë të plotë për

qytetarët, me qëllim që të garantojnë një përdorim sa më efektiv të tij. Gatishmëria në dhënien e informacionit nga institucionet e administratës publike rrit përgjegjshmërinë e tyre në shërbimin ndaj qytetarëve. Institucionet Supreme të Auditimit duhet të promovojnë transparencën e aktivitetit të tyre, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje të drejtpërdrejtë për informacionin se si po përdoren paratë publike nga organet e qeverisjes së përgjithshme dhe ato lokale.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka një qasje krejt të re ndaj komunikimit me publikun, referuar edhe standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, sipas të cilëve:

*...Një SAI i pavarur, efektiv dhe i besueshëm është një komponent thelbësor në një sistem demokratik, ku përgjegjshmëria, transparenca dhe integriteti janë pjesë e domosdoshme e një demokracie të qëndrueshme... (ISSAI 12, "Vlerat dhe dobitë e SAI-ve-sjellja e ndryshimeve në jetën e qytetarëve) dhe ka rritur gradualisht transparencën e veprimtarisë së tij. Transparenca e aktivitetit të KLSH-së është një nga treguesit kryesorë të modernizimit të institucionit dhe të komunikimit të tij shumë dimensional. Kjo ka bërë që aktiviteti i tij të jetë më i perceptueshëm për qytetarët dhe median.*

Informimi i publikut është i sanksionuar edhe në nenin 33 të Ligjit nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Ndër mekanizmat kryesor të përdorur nga KLSH janë:

- Publikimi i plotë ose i pjesshëm i raporteve të auditimit;
- Publikimi i Raportit të Monitorimit mbi përdorimin e fondeve të KLSH;
- Publikimi i Buletineve ëdo 3 muaj duke raportuar për aktivitetin e auditimeve të kryerja.
- Publikimi i CV të drejtuesve të KLSH;
- Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në grupet e auditimit;
- Kryerja e mini peer review me organizatat jofitimprurëse me të cilat bashkëpunon KLSH;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me Universitete dhe OJF;
- Organizimi në ambientet e universiteteve i Analizës Vjetore të departamenteve të auditimit të KLSH-së;
- Komunikimi aktiv me publiku nëpërmjet medias;

- Organizimi i Konferencave Shkencore me pjesëmarrjen e akademikëve dhe profesorëve të fushave të ndryshme;
- Publikimi i revistës “Auditimi Publik” në të cilën përfshihen shkrime nga profesorë të fushave të ndryshme dhe botimeve të tjera ku përfshihen manuale, udhëzues dhe standarde të auditimit;
- Pjesëmarrja e KLSH në Panairin e Librit.

## 2. Parime të përgjithshme

Një nga mjetet më të rëndësishme në realizimin e kësaj të drejte është ekzistenca e një kuadri ligjor dhe zbatimi efektiv i tij në praktikë. Në legjislacionin shqiptar e drejta e informimit garantohej nga:

- Kushtetuta, neni 23;
- Kodi i Proçedurës Administrative (neni 13 e neni 20);
- Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, neni 7;
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 33 dhe neni 34.

Në funksion të së drejtës për informim, Kontrolli i Lartë i Shtetit garanton të drejtën e informimit duke u bazuar edhe në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 33 dhe neni 34.

Duke u bazuar në nenin 33, KLSH boton rregullisht buletin, i cili përmban në mënyrë të veçantë:

- a) Raportet përfundimtare dhe vjetore të auditimit;
- b) Konkluzionet dhe rekomandimet e auditimeve me rëndësi të veçantë;
- c) Llogaritë vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke përfshirë edhe opinionin e audituesve për to.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në varësi të qëllimit dhe detyrave të mësipërme, si dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, universitare dhe të shoqërisë civile, organizon analiza të hapura vjetore të punës, konferencave shkencore në fushën e auditimit publik dhe menaxhimit financiar. Kontrolli i Lartë i Shtetit boton revistën shkencore dhe profesionale, përkthime, manuale, botime të publikimeve të organizatave ndërkombëtare të auditimit (të jashtëm), të institucioneve të tjera homologe që konsiderohen me interes.

Ndërsa nëpërmjet nenit 34, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në respekt të detyrimit të tij ligjor për informimin e publikut, siguron natyrën publike të punës së tij nëpërmjet:

- a) Publikimit të raporteve të paraqitura nga KLSH-ja në Kuvendin e Shqipërisë;
- b) Publikimit të raporteve të auditimit në mënyrë elektronike;
- c) Konferencave për shtyp dhe metodave të tjera të informimit në media;
- d) Publikimit të njoftimeve për shtyp dhe çdo informacioni tjetër që përcaktohet nga Kryetari i KLSH-së;

Transparenca ka si qëllim të identifikojë mekanizmat ligjorë kryesorë dhe ato konkretë që garantojnë përfshirjen e informimit të publikut (qytetarëve).

Ndër format kryesore të ekzistencës së këtyre mekanizmave evidentojmë:

*Mekanizmin e transparencës*, i cili i referohet praktikave të zhvilluara nga institucionet e auditimit për të vënë në dispozicion të publikut informacion, lidhur me organizimin dhe funksionimin e institucionit.

Në përputhje me këtë program, KLSH vë në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al), një menu të veçantë të titulluar "Transparenca". ([http://www.klsh.org.al/web/Programi\\_i\\_Transparencës](http://www.klsh.org.al/web/Programi_i_Transparencës)).

*Mekanizmin e pjesëmarrjes*, i cili i referohet mekanizmave të bashkëpunimit dhe komunikimit që lehtësojnë ushtrimin e mbikëqyrjes aktive nga ana palëve të interesuara.

KLSH i bazon politikatat e komunikimit në tri shtylla themelore:

Imazhi i institucionit

KLSH vendos në dispozicion të publikut faqen e tij të internetit <http://www.klsh.org.al/>. Faqja e internetit është ndoshta kontakt i parë më i afërt dhe më i arritshëm për publikun, nëpërmjet të cilës janë të transmetueshme misioni, vizioni dhe mesazhi i KLSH.

Informacioni i bërë publik, është i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e KLSH-së është ndërtuar në një formë që mundëson informacion për publikun, në format lehtësisht të kuptueshëm. Skema e publikimit paraqitet si më poshtë:

- Struktura organizative e KLSH-së;

- Tekstet e plota të akteve ligjore dhe nënligjore, Kodi Etikë, manuale e standarde që ka lidhje me ushtrimin e auditimit sipas standardeve ndërkombëtare;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave KLSH, orarin e punës, emrin dhe kontaktet, për të drejtën e informimit;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin opinionet e tyre mbi ushtrimin e funksioneve të KLSH-së, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdoret për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve.

Në këtë kontekst mund të themi se KLSH vetëm për periudhën 2012-2015 ka trajtuar gjithësej 1263 letra nga qytetarët.

Komunikimi me qarqet akademike

KLSH organizon Konferencën Vjetore Shkencore, ku në fokus qëndron debati shkencore lidhur me sfidat me të cilat përballet KLSH dhe institucionet homologe të auditimit për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, kontributi për përmirësimin e qeverisjes dhe bashkërendimi i luftës kundër korrupsionit me institucionet e tjera. Gjithashtu KLSH organizon analizat vjetore në bashkëpunim të ngushtë me Universitetet, ku prezantohen dhe diskutohen ide mbi cilësinë dhe numrin e auditimeve të realizuara ndër vite.

*Komunikim të vazhdueshëm dhe bashkëpunues me Mediat*

Mediat konsiderojnë KLSH tashmë si një burim të besueshëm dhe të rregullt informacioni me interes për të gjithë shoqërinë. Audituesit e KLSH kanë qenë present në shtypin e përditshëm me 337 shkrime, për periudhën 2013-2015. Aktiviteti i KLSH-së është paqyruar në media në rreth 2400 njoftime, editoriale, komenteve analitike, etj.

## 16. STRATEGJIA E AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË, RRUGA DREJT MIRËQEVERISJES

*Referues: Julian ADILI – Auditues i dytë,  
Rezart GOLEMAJ – Auditues i dytë.*

Llogaridhënia publike është një vlerë thelbësore e shoqërive demokratike, e për vendet kandidate për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian (BE), është një detyrim thelbësor që duhet përmbushur për të qënë pjesë e familjes së madhe evropiane. KLSH është institucioni pararoje dhe mbrojtës i parimeve të mirëqeverisjes dhe transparencës në shërbim të qytetarëve. Neni 6 i Ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, e ka të përcaktuar Auditimin e Përputhshmërisë si një nga fushat kryesore të auditimit që do të ushtroj, duke përmbushur detyrën kushtetuese dhe Standardet ndërkombëtare të auditimit INTOSAI.



Si institucion i pavarur i auditimit të jashtëm, KLSH luan një rol vendimtar në sigurimin e përgjegjshmërisë efektive të mirëqeverisjes dhe transparencës ndaj qytetarëve për fondet publike, duke bërë:

- Identifikimin e rreziqeve ndaj interesave financiare të qytetarëve të RSH-së;
- Ofrimin e sigurisë të pavarur mbi menaxhimin financiar të RSH-së, dhe
- Këshillimin e politikëbërësit me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në praktikën e tij të punës, ka kryer në vijimësi auditime të përputhshmërisë, duke i gërshetuar shpeshherë me auditimet financiare. Gjatë viteve të fundit, KLSH i ka konsoliduar këto auditime, duke rritur gamën dhe numrin e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme ligjore dhe rregullative.

## II. Qëllimi dhe objektivi Auditimit të Përputhshmërisë

Auditimi Përputhshmërisë është një proces sistematik, i pavarur dhe i dokumentuar verifikimi i objektivave dhe vlerësimit të dëshmive të auditimit për të përcaktuar nëse plotësohen kriteret e specifikuar në politikat e institucionit dhe efektiviteti i tyre.

Në ligjin nr. 154/2014, 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në nenin 3, pika 5 "Auditim i përputhshmërisë" nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord.

### Objektivat e Auditimit të Përputhshmërisë

Auditimet e Përputhshmërisë përdoren nga KLSH për të arritur objektivat e mëposhtme:

- Për të ruajtur integritetin e sistemit rregullator;
- Adaptimin dhe përmirësimin me kërkesat ligjore;
- Përmes raportimit të auditimit publik, duke siguruar transparencë;
- Siguron që instrumentet ligjore të përdorura nga Subjekti janë përdorur në mënyrë të përshtatshme dhe efikase.

Në nenin 12 të ligjit nr. 154/2014, 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", thuhet se në auditimet e përputhshmërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë: a) nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

## III. Procesi i Auditimit të Përputhshmërisë

### III/A. Konsideratat Fillestare

- Përcaktohet tema dhe objektivi i auditimit të përputhshmërisë:

Në përgjithësi, vetë mandati i Institucionit Suprem të Auditimit përcakton nëse ai kryen detyra auditimi përputhshmërie apo jo. Nëse SAI kryen auditime përputhshmërie, ka përgjegjësinë të përcaktojë objektin dhe natyrën e punës që do

të kryhet dhe qasjen e duhur të auditimit. Në disa raste, organi legjislativ siç është parlamenti, mund t'i kërkojë SAI-t të kryejë një tip të caktuar auditimi. Kërkesa të tilla mund të pranohen me kusht që të mos komprometohet *pavarësia e audituesit* (ISSAI 200, 2.2.16). Sidoqoftë, i takon SAI-t të vendosë për qasjen dhe metodologjinë e auditimit që do të ndjekë.

- *Merren në konsideratë parimet me domethënie etike (pavarësia dhe objektiviteti):*

Pavarësinë e SAI-t dhe audituesit, duke përfshirë neutralitetin politik; Shmangien e konfliktit të interesit ndërmjet audituesit dhe subjektit të audituar; Nevojën që audituesi dhe SAI të kenë kompetencën e duhur; Ushtrimin e kujdesit dhe interesimit të duhur nga SAI dhe Audituesi për t'iu përmbajtur Parimeve Themelore të Auditimit.

- *Sigurohet procedura e kontrollit të cilësisë*

Ashtu si me llojet e tjera të auditimit, është e rëndësishme që gjatë kryerjes së auditimeve të përputhshmërisë SAI të ketë miratuar proceset dhe procedurat që sigurojnë kryerjen e punës me cilësi të mjaftueshme, që audituesit e sektorit publik që kryejnë auditime të këtilla të kenë kolektivisht kompetencat dhe aftësitë e nevojshme, dhe që puna e ekipit të jetë e drejtuar, e mbikëqyrur, dhe e kontrolluar në mënyrë të përshtatshme. Parimet Themelore të Auditimit të INTOSAI-t përcaktojnë etapat dhe ofrojnë udhëzime për të siguruar cilësinë e punës (ISSAI 200, 2.1.26 dhe 2.2.36).

### III/B. Planifikimi i auditimit

- *Përcaktohen palët e përfshira/baza ligjore:*

Audituesit e sektorit publik sigurohen që të ekzistojnë parakushtet e nevojshme për kryerjen e auditimit me efektivitet. Në planifikimin e auditimeve të përputhshmërisë, mund të identifikohen që në fillim palët e interesit të përfshira. Kjo është e rëndësishme për të përcaktuar bazën ligjore për kryerjen e auditimit, si mandati i SAI-t, duke përfshirë përgjegjësitë e audituesve të sektorit publik, si dhe statusin kushtetues dhe përgjegjësitë e subjektit të audituar.

- *Identifikohen objekti dhe kriteret:*



Objekti mund të marr shumë forma dhe të ketë shumë karakteristika të ndryshme. Objekti mund të jetë i përgjithshëm ose i një natyre shumë specifike. Disa janë sasiore dhe shpesh mund të maten me lehtësi (*për shembull performanca ose gjendja financiare*), ndërsa të tjerat janë cilësore dhe të një natyre më subjektive (*për shembull sjellja*). Megjithatë, objekti duhet të jetë i identifikueshm dhe të japë mundësi për ta vlerësuar objektin në bazë të kriterëve të përshtatshme.

Gjatë kryerjes së auditimeve të përputhshmërisë, identifikimi i kriterëve është një hap themelor në procesin e planifikimit të auditimit. Kriteret duhet të jenë të përshtatshme. Kjo do të thotë se kriteret duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme: të pranueshme, të besueshme, të plota, objektive, të kuptueshme, të krahasueshme, të disponueshme.

### - *Përcaktimi i materialiteti*

Materialiteti përbëhet nga dy faktorë: sasiore dhe cilësore. Në kryerjen e auditimeve të përputhshmërisë, materialiteti përcaktohet për: a) Qëllime planifikimi; b) Qëllime të vlerësimit të evidencave të përfuara dhe efektet e rasteve të identifikuara të mospërputhshmërisë, dhe qëllime të raportimit të rezultateve të punës së auditimit.

### - *Vlerësimi i riskut*

Vlerësimi i riskut përbën një pjesë thelbësore të kryerjes së një auditimi të sigurisë së arsyeshme. Për shkak të kufizimeve të natyrshme të një auditimi, auditimi i përputhshmërisë nuk ofron garanci apo siguri absolute se mund të diktojë të gjitha rastet e mospërputhshmërisë. Kufizimet e pandashme të auditimit të përputhshmërisë mund të përfshijnë faktorë, si:

- a) Gjikimi mund të aplikohet përmes menaxhimit në interpretimin e ligjeve dhe rregulloreve;
- b) Gabime njerëzore;
- c) Sistemet mund të projektohen në mënyrën e gabuar ose të mos funksionojnë në mënyrë efektive;
- d) Kontrollat mund të anashkalohen;
- e) Evidencat mund të fshihen ose të mos jepen.

## III/C. Kryerja e Adutimit dhe Mbledhja Evidencave

*- Mbledhja evidencave përmes mjeteve të ndryshme*

Gjatë kryerjes së auditimit të sigurisë së arsyeshme, audituesit e sektorit publik mbledhin evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat bazohen Përfundimet e audituesve. Parimet Themelore të Auditimit parashikojnë që *“duhen siguruar evidenca të arsyeshme, të përshtatshme dhe relevante në mbështetje të vlerësimit dhe përfundimeve të audituesve rreth organizimit, programit, veprimtarisë apo funksionit nën auditim”* (ISSAI 300, 3.5.1). Evidencat e auditimit mbledhen duke përdorur një shumëllojshmëri teknikash të tilla si:

a) Vrojtimi; b) Inspektimi; c) Hulumtimi; d) Ripërformanca; e) Konfirmimi; f) Procedurat analitike.

*- Dokumentacioni, komunikimi dhe kontrolli i cilësisë në vijim*

Dokumentimi ndjek hap pas hapi të gjithë procesin e auditimit. Audituesit e sektorit publik e përpilojnë dokumentacionin e auditimit të përputhshmërisë në mënyrë periodike duke e mbajtur atë, dokumentacion i cili regjistron kriteret e përdorura, punën e bërë, evidencat e siguruar, vlerësimet e bëra dhe rishikimin e realizuar. Krahas dokumentimit, një rëndësi e veçantë i vihet edhe komunikimit pasi ndihmon për ta bërë procesin më të efektshëm dhe konstruktiv.

## III/D. Vlerësimi i Evidencave dhe Formulimi i Përfundimeve

*Vlerësohet në se janë evidencat e mjaftueshme*

Audituesit e sektorit publik çmojnë nëse evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme aq sa për ta ulur riskun e auditimit në një nivel pranueshëm të ulët. Ky vlerësim ka të bëjë me ushtrimin e gjykimit dhe skepticizmit profesional, si dhe me marrjen parasysh të evidencave që edhe e mbështesin edhe duket se e hedhin poshtë informacionin e objektit.

Audituesit e sektorit publik çmojnë nëse në bazë evidencave të mbledhura ekziston një siguri e arsyeshme që informacioni i objektit në të gjitha aspektet materiale është në përputhje me kriteret e identifikuar. Për shkak të kufizimeve të genësishme të auditimit, nuk mund të pritët nga audituesit e sektorit publik që të identifikojnë të gjitha rastet e papërputhshmërive.

- *Konsiderohet materialiteti për qëllimin e raportimit dhe Formulimin e përfundimeve*

Evidencat e mbledhura çmohen në raport me nivelet e identifikuar të materialitetit me synim identifikimin e rasteve të mundshme të papërputhshmërive materiale. Përcaktimi i vlerës së gjetjeve bazohet në konceptin e materialitetit siç shprehet më lart. Gjetjet e auditimeve të përputhshmërisë duhen vendosur gjithashtu në perspektivën e duhur, për shembull rastet e raportuara të papërputhshmërisë mund të bazohen në një tërësi episodesh mospërputhshmërie apo në vlerën e ngjashme monetare (ISSAI 400, 4.0.19). Institucionet Supreme të Auditimit që veprojnë në formën e një Gjykatë Llogarish kanë të drejtë të shpallin vendime në lidhje me llogaritë. Në rastin e papërputhshmërive kjo gjë bën të mundur urdhërimin e rimbursimeve, vendosjen e gjobave, apo dënime të tjera të kësaj natyre.

- *Shkruhen rekomandimet dhe përgjigjet nga institucioni*

Përgjigjet nga entet e audituara që raportojnë pikëpamjet e zyrtarëve përgjegjës përfshihen në raport si pjesë e parimeve të cilave u referohemi si parime të papërputhshmërisë. Parimi i papërputhshmërisë është tipar unik e i rëndësishëm i auditimit të sektorit publik. Ky parim ka lidhje me mënyrën e paraqitjes së dobësive apo gjetjeve kritike në mënyrë të tillë që të çon drejt korrigjimeve (ISSAI 400, 4.0.20 dhe 4.0.24). Kjo përfshin përputhjen me faktet e njësisë së audituar për t'u siguruar që janë të plota, të sakta dhe të paraqitura qartë. Kjo mund të përmbajë sipas rastit përfshirjen e përgjigjeve për çështjet e ngritura të entit të audituar, fjalë-për-fjalë ose përmbledhtazi.

### III/E. Raportimi

- *Përgatitet raporti*

Raportimi është një pjesë e rëndësishme e auditimit të sektorit publik dhe përfshin raportimin e devijimeve dhe shkeljeve për të ndërmarrë veprime korrigjuese me qëllim që personat përgjegjës të japin llogari për veprimet e tyre. Si përfundim, Parimet Themelore të Auditimit përcaktojnë që në fund të çdo procesi auditimi duhet të paraqitet një raport me shkrim ku të përcaktohen qartë rezultatet e auditimit sipas një formati të përshtatshëm (ISSAI 400, 4.0.7 a).

Parimet e gjithëpërfshirjes, objektiviteti dhe afatet janë pjesë të rëndësishme në raportin e auditimit. Këtu përfshihet dhe aplikimi i parimeve të objeksionit që përfshijnë ballafaqimin e fakteve me subjektet e audituara si dhe përfshirjen e përgjigjeve përkatëse të zyrtarëve përgjegjës.

- *Proceset e ndjekjes*

Parimet themelore të auditimit theksojnë rëndësinë e dhënies së rekomandimeve konstruktive lidhur me ndjekjen në vazhdimësi të situatës, në funksion të korigjimit të dobësive të identifikuara (ISSAI400, 4.0.26). Në përgjithësi, procesi i ndjekjes në vazhdimësi të situatës përmirëson nivelin e zbatimit të masave korigjuese dhe jep informacion të dobishëm për institucionin e audituar, për përdoruesit e raportit, si dhe për audituesit e ardhshëm të sektorit publik.

Referencat:

- *Ligji nr. 154/2014, 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*
- *Botim i KLSH "Udhëzues për Auditimin e Përputhshmërisë";*
- *ISSAI 4000-4200;*
- *Compliance Audit Handbook, Published by: Department of Environment and Conservation NSE, AUS.*

17. NDËRTIMI I KAPACITETEVE DHE NDIKIMI NË PERFORMANCËN E KLSH

*Referues: Alkida LLAKAJ- Audituese e parë.*



Për të operuar në një mënyrë sa më efektive në përmbushjen e detyrave institucionale institucionet e auditimit detyrimisht duhet të kenë pavarësinë nga politika, mbështetjen e medias, besimin e publikut, aftësitë teknike profesionale dhe posedimin e kapaciteteve. *(Në përputhje me rezolutën e fundit të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, e cila i bën thirrje të gjithë vendeve anëtare për zbatimin e Deklaratës së Limës dhe asaj të Meksikos mbi pavarësinë e SAI-ve).*

Në lidhje me kapacitetet institucionale, është pikërisht INTOSAI promotori i forcimit të SAI-ve në nivel global, duke u krijuar mundësi atyre që të ndihmojnë qeveritë e tyre në përmirësimin e performancës, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në luftën kundër korrupsionit, si dhe për t'u siguruar në mirë përdorimin e fondeve publike.

Komiteti i Ndërtimit të Kapaciteteve të INTOSAI-t dhe organet rajonale për Iniciativa për Zhvillimin e INTOSAI (IDI), punojnë me SAI-t për të ndërtuar kapacitetet institucionale, profesionale dhe organizative. Kjo përfshin praktikë dhe asistencë në punë, duke shfrytëzuar bashkëpunimet kolegë-kolegë dhe ato midis SAI-ve. Mundësitë që na parashtrohen për rritjen e kapaciteteve janë diverse, prandaj është e rëndësishme të ndjekim etapat e adekuate.

#### Fillimi i duhur

Mbështetja e zhvillimit të kapaciteteve duhet të bazohet në nevojat reale të SAI-t. Kjo është mënyra e vetme për të siguruar stabilitet, reforma të qëndrueshme dhe efektive. Identifikimi i nevojave duhet të bëhet në funksion të zbatimit të "Biblës" institucionale, *planit strategjik*. Çdo nevojë e identifikuar dhe trajtimi i saj duhet të ndikoj pozitivisht në arritjen e planit. Një institucion pa një plan strategjik, është sikur një anije pa busullën e drejtimit, nuk ka objektiva të përcaktuara dhe puna

institucionale ka risk të jetë rastësore dhe jo cilësore, gjithashtu e bën të pamundur vlerësimin real të progresit institucional.

Duhet kohë

Forcimi i kapaciteteve kërkon kohë dhe përkushtim. Kjo kërkon ndërtimin e urave të bashkëpunimit, besimit dhe mirëkuptimit të ndërsjelltë ndërmjet palëve të interesit. Zhvillimi i kapaciteteve rezulton më efektiv kur është ndërtuar mbi partneritete afatgjata ku palët i njohin dobësitë dhe pikat e forta të njeri tjetrit, ku ekziston respekti reciprok pavarësisht madhësisë apo zhvillimit të SAI-t, sepse një SAI sa do i vogël të jetë ka gjithmonë një pikë të fortë dhe një kulturë pune nga e cila mund të përfitojnë edhe homologët më të avancuar.

“Ne s’mund të vrapojmë pa qenë të sigurtë se ecim...”

Dëshira për të avancuar nuk mjafton për të avancuar, një diagnostikim real i gjendjes së SAI-t do t’a bëjë më konkret planin e zhvillimit dhe rritjes së kapaciteteve. Prandaj është e rëndësishme të ndërmerren hapa të ngadaltë e të qëndrueshëm duke patur parasysh sa volum mund të menaxhojë realisht institucioni. Vendosja e objektivave duhet të bëhet mbi parimin që ato të jenë të realizueshme dhe të matshme, zhvendosja e fokusit në objektiva të tjera pa përmbushur ato aktuale duke u orientuar drejt sasisë do të jetë burim shpërqëndrimi dhe risku për performancën e SAI-t.

Shkëmbimi i dijeve

Rritja dhe formimi i kapaciteteve audituese është një proces konstant si në nivelin mikro (brenda institucionit) ashtu edhe në atë makro (ndërmjet institucioneve). Brenda institucionit, ky proces mund të realizohet nëpërmjet ndarjes së eksperiencës dhe njohurive nga audituesit më me eksperiencë tek audituesit më të rinj, dhe jo vetëm nëpërmjet trajnimeve teorike por edhe në praktikë gjatë punës audituese në terren. Një sinergji e tillë, është jo vetëm një potencial suksesi por edhe një siguri për trashëgiminë e kulturës institucionale në auditim.

Ndërtimi i kapaciteteve audituese fillon që në procesin e rekrutimit të audituesve të rinj, ku në bazë të profililit të studimeve kryhet edhe orientimi apo profilizimi në auditim. Ndërtimi i ekspertizës dhe profilizimi në auditim, rrit potencën dhe nivelin e profesionalizmit përballë palës së audituar. Orientimi profesional që në fazën e rekrutimit siguron institucionin për një menaxhim më efikas të burimeve njerëzore.

Bashkëpunimi në nivel rajonal

“Eksperienca e përbashkët na shërben të gjithëve”...është motoja e organizatës ndërkombëtare të auditimit dhe në kuadrin e kësaj fryme urat e bashkëpunimit mund të vendosen fillimisht me vendet fqinje për t’u shtrirë më pas në bashkëpunime me shtrirje më të gjerë gjeografike. Janë të shumtë faktorët ekonomik dhe social që bashkëpunimin midis nesh e sjellin në terma konkret. Kështu për të intensifikuar ndarjen e dijeve dhe eksperiencave mes SAI-ve, nëpërmjet teknologjisë është mënyra më efiçente dhe ekonomike. Më konkretisht, krijimi i një portali (forumi) online; i aksesueshëm nga audituesit e SAI-ve të rajonit, do të ishte një mundësi shumë e mirë për diskutimin e temave për auditim, ndarjen e gjetjeve apo të rekomandimeve në fusha të caktuara, në funksion të përmirësimit dhe huazimit të praktikave të suksesshme. Kjo teknologji, redukton kostot dhe mundëson komunikim në kohë reale.

### Mbështetja nga mjedisi i jashtëm

Forcimi i SAI-t nuk është vetëm çështje financash apo këshillash teknike në standardet e auditimit. SAI duhet të ketë burime të mjaftueshme në dispozicion. Gjithashtu duhet të suportohet në ndërtimin e një mjedisi që nxit llogaridhënien përmes transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut. Megjithëse këta faktorë janë kryesisht jashtë kontrollit të SAI-t, në terma afatgjatë vetë SAI mund të jetë në gjendje të ndikojë mbi to duke nxitur llogaridhënien e qeverisjes ndaj publikut dhe duke ndikuar në mënyrë direkte në përmirësimin e qeverisjes në përgjithësi dhe faktorëve politiko-ekonomik.

### Fokusi drejt rezultateve

Është jetike për një SAI të krijoj një bazë konistente të dhënash mbi performancën e tij, si një mënyrë për të vlerësuar veten në çdo kohë e për t’ju përgjigjur drejtë pyetjeve: Ku kam qenë? Ku jam aktualisht? Ku duhet të mbërrijë? Nëpërmjet vlerësimit të këtyre koordinatave bëhet më e qartë rruga drejt progresit institucional dhe vlerësimi objektiv i mundësive për ndërtimin dhe rritjen e kapaciteteve të SAI-t.

Ndërtimi dhe rritja e kapaciteteve për një përmirësim të qëndrueshëm e progresiv të SAI-t, nuk vjen në mënyrë rastësore, por kërkon objektiva, vendosshmëri dhe punë sfiduese, si e vetmja rrugë për t’ju përafuar gjithmonë e më tepër kornizës së SAI-ve më të suksesshme.

MESAZHI I KRYETARIT TË KLSH-së, Z. BUJAR LESKAJ  
PËR AUDITUESIT E RINJ TË KLSH-së

Të dashur kolegë auditues të rinj!

Më 26 qershor 2015, në fjalën e tij përpara trupës së programit Master në Auditimin Publik për audituesit e rinj të Gjykatës Austriake të Auditimit (ACA), Dr. Josef Moser, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i ACA theksoi: *“Në sajë të audituesve tanë jemi aty ku kemi arritur sot: punonjësit tanë janë aseti ynë më i madh. Ekspertiza dhe angazhimi i tyre përbëjnë bazat e performances së një SAI. Për këtë arsye, një nga prioritetet tona kryesore në procesin e përzgjedhjes së audituesve të rinj është për të siguruar*



*që ata të kenë kualifikimet e nevojshme. Megjithatë, si rezultat i globalizimit dhe përparimeve në shkencë dhe biznes, audituesit ballafaqar vazhdimisht me sfida të reja dhe çështje pak të njohura lidhur me metodat, standardet dhe procedurat e auditimit. Në këtë sfond, është me rëndësi jetike për t'i pajisur audituesit e rinj me trajnime sistematike dhe për të shkëmbyer njohuri dhe eksperiencë me audituesit më me përvojë dhe me ekspertë të institucioneve të tjera<sup>47</sup>”.*

<sup>47</sup> Dr. Josef Moser, fjala përpara studenteve të Programit Master në Auditimin Publik, në Vjenë, 29 qershor 2015, <https://executiveacademy.at/de/news/detail/auditors-need-to-be-better-trained-than-auditees/>



Si KLSH investimin për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit tonë, sidomos të atij më të ri, e kemi mbajtur gjithnjë parasysh. Në platformën për Zhvillimin Strategjik të Institucionit, të datës 14 Dhjetor 2011, paraqitur përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit, kam theksuar se institucioni është përballë sfidës së: "përmirësimit të metodologjisë së auditimit, duke kthyer vemendjen tek auditimi i performancës, krahas rritjes së eficiencës së auditimit financiar".

Sfidat që po hasim sot, ashtu sikurse e cilëson Dr. Moser, nuk mund t'i përballojmë pa siguruar vijimësinë e kapaciteteve profesionale nga audituesit më të vjetër tek ata më të rinj, duke u përshtatur me të rejat e fundit të globalizmit, teknologjisë së informacionit dhe botës së internetit.

Duke ndjekur orientimin strategjik të EUROSAI-t për ndërtimin e kapaciteteve audituese, KLSH, me një program shumë ambicioz trajnimesh brenda dhe jashtë vendit, arriti që në këto katër vite të rrisë me dhjetë herë numrin e ditëve të trajnimit në vit për auditues, nga 2.1 ditë në vitin 2011, në mesatarisht 22 ditë në vit, për katër vitet 2012-2015, ky i fundit i ngjashëm me atë të SAI-ve të zhvilluara.

Kemi rritur treguesit e ndërtimit të kapaciteteve tona audituese, por kemi ende shumë për të bërë që dijet dhe ekspertiza e audituesve më të vjetër të kalojnë tek ata më të rinj. Ju ftoj të gjithë ju, kolegë auditues të rinj, të bashkëpunoni më shumë me koleget tuaj më me përvojë dhe me stazh të gjatë pune në KLSH, të mos ngurroni t'u bëni pyetje të vazhdueshme dhe të kërkoni të ndani kohën e punës me ta. Askush nuk mund t'i dijë të gjitha dhe më shumë, vetëm pse përdor laptopin apo është gjithnjë i lidhur në internet me celularin e tij. Njohja e vërtetë kërkon dije të zhvilluara në praktikën e përditshme audituese.

Gjykoj se ju janë ofruar të gjitha mundësitë që të përfitoni sa më shumë prej audituesve më të vjetër dhe më me eksperiencë. Mos i humbisni këto mundësi. Pse të jeni ju të parët që do të ngeleni mbrapa me kohën, me gjithë moshën e re!

Në zbatim të orientimit të dytë strategjik të EUROSAI-t për promovimin dhe lehtësimin e zbatimit të Standardeve Profesionale ISSAI, ndërsa trashëgojmë një mjedis auditimi ku deri në fund të vitit 2011 për standardet profesionale ISSAI flitej shumë pak dhe njiheshin e përmendeshin nga auditues që në KLSH mund të numëroheshin me gishtat e njëjës dorë, arritëm të fusim në temat qendrore të trajnimeve për vitet 2012-2015, të katër nivelet e standardeve ISSAI, duke siguruar

një njohje të gjerë të tyre nga audituesit, si ata me përvojë, ashtu edhe ata të rinj. Sikurse e dini, rregulli në KLSH është që çdo auditues i ri bën 25 ditë në vit trajnim, ku kryesisht njihet me standardet ISSAI dhe mënyrën e zbatimit të tyre në praktikën audituese.



Këto standarde kërkojnë me insistim shkëmbimin e njohurive. Që nga Konferenca e parë "Young EUROSAI", mbajtur në Roterdam të Holandës, në nëntor të vitit 2013 dhe deri në atë të dytë në Izrael, në nëntor 2015, rrjeti i audituesve të rinj në lëvizjen "Young EUROSAI" ka ecur bindshëm. Audituesit e rinj në të gjithë Europën kanë filluar një praktikë të vazhdueshme të shkëmbimit të ndërsjellë të njohurive dhe informacionit. Në këtë traditë, ne si KLSH në punën e audituesve të rinj duhet të përqendrohemi në ngritjen e kapaciteteve audituese. Kjo është sfida juaj parësore, sa personale aq dhe e institucionit. Çdo auditues i lartë, kryeauditues dhe drejtor në KLSH ka nën mentorim një auditues të ri, për një periudhë të caktuar. Një organizim i tillë pune ju ndihmon ju audituesit e rinj të integrohni më shpejt, të ulni riskun e gabimeve, duke nxitur frymën e bashkëpunimit dhe krijimin e një klimë profesionale dhe dashamirëse pune. Si institucion do të bëjmë maksimumin për t'ju siguruar akses të plotë në informacion dhe mundësi ngritjeje në karrierën tuaj, por gjithçka varet nga angazhimi juaj në punën e përditshme, nga librat që lexoni dhe programet Master të kualifikimit që kryeni.

Po në zbatim të orientimit të dytë strategjik të EUROSAI-t për Promovimin dhe lehtësimin e zbatimit të Standardeve Profesionale ISSAI, nga kolana e 51 botimeve

të KLSH-së për vitet 2012-2015, veçoj librat "Standardet e Auditimit INTOSAI", "Manuali i Auditimit të Performancës", "Udhëzuesi i Auditimit Financiar (1000-2999)", "Udhëzues për Auditimin e Perputhshmerise", "Raportimi i Auditimit-Guide", "Standardet e Auditimit të Borxhit Publik (5410-5440)", "Standardet INTOSAI mbi mjedisin", "Etika në SAI dhe në Institucionet e tjera Publike", "Manuali i Vetëvlerësimit të Integritetit për Institucionet Supreme të Auditimit (INTOSaint)", "ISSAI 5220 dhe Kodi i Transparencës Fiskale", "Standardet e GAO's", "Indikatorët e Performancës", "Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës", "Manuali i Auditimit të IT". Te gjitha këto botime jo vetëm ju zgjerojnë dijet dhe njohuritë bazë të profesionit, por ju japin edhe të rejat e fundit në botën e standardeve ISSAI, e cila është gjithnjë në përditësim të vazhdueshëm.

Konstatoj me shqetësim një pjesëmarrje shumë të vakët tuajën në Klubin e Librit të KLSH. Ju për shkak të moshës së re, nevojës për të mësuar gjëra të reja dhe investimit për të ardhmen tuaj, duhet të keni etjen e pashuar për dijë, për të lexuar dhe mësuar më shumë. Ju ftoj të jeni pjesëtare aktive dhe jo formale e Klubit të Librit. Vetëm duke lexuar më shumë dhe pa pushim, duke përvetësuar standardet profesionale, mund të keni sukses në testimet që zhvillojmë për rivlerësimin e njohurive dhe ngritjen në detyrë, të cilat, sikurse e dini, do të jenë të vazhdueshme.

Duke marrë eksperiencën e vyer të një organizatë si INTOSAI, në bazë të motos së INTOSAI-t "Nga eksperiencia e përbashkët përfitojmë të gjithë", por edhe moton e Kongresit të IX-të, të EUROSAT-t "Kur ishte hera e fundit që kemi bërë diçka për herë të parë?", në zbatim të orientimit të katërt strategjik të EUROSAT-t për Qeverisjen dhe Komunikimin, dua të ndalem në dy risi të KLSH, botimet dhe prezenca në median e shkruar të vendit, të audituesve të tij.

Botimet e KLSH për vitet 2012-2015 vijnë në realizim të misionit kushtetues të institucionit për të informuar publikun dhe Kuvendin, si dhe në zbatim të standardeve profesionale ISSAI mbi komunikimin në kohë dhe gjerësisht të SAI-ve nëpërmjet mediave, faqeve të internetit dhe mjeteve të tjera. Mbi të gjitha, ato ndihmojnë forcimin e kapaciteteve tona audituese. Kush mund të më thotë nëse i ka lexuar të gjitha librat e kolanës "Botime KLSH"? Sa janë ata mes jush, që të paktën librat e standardeve të profesionit të audituesit brenda kësaj kolane, t'i kenë lexuar nga faqja në faqe, duke nënvizuar pjesët me të rëndësishme për dijet e tyre?

Titujt e botimeve të KLSH-së në këto katër vite janë vërtet impresionues, si për larmishmërinë e temave, ashtu dhe për sasinë e informacionit që përmbajnë si për

lexuesit e fushës së auditimit dhe të ekonomisë, ashtu edhe për lexuesin e thjeshtë të interesuar për fushën e auditimit.

Botimet, në kompleksin integral të tyre, përbëjnë një risi për KLSH-në në veçanti, por edhe për institucionet shtetërore në përgjithësi, duke qenë dëshmi të ecjes drejt modernizimit dhe profesionalizmit për institucionin. Ato variojnë nga libra për historikun e KLSH-së, publikime informuese për raportet vjetore të institucionit dhe marrëdhëniet me Kuvendin, tek botimet shkencore për standardet INTOSAI, për udhëzuesit e auditimeve të ndryshme, si ai financiar, i performancës, i përputhshmërisë, integritetit dhe raportimet për auditimet.

Në kolanën e botimeve të KLSH-së bën pjesë dhe një grup botimesh (katër tituj deri tani) krejt i veçantë, "*Audituesit e KLSH-së në median e shkruar*", referuar vitit 2013, vitit 2014 dhe gjysmës së parë të vitit 2015. Artikujt, analizat dhe editorialet e audituesve të KLSH-së të botuara në shtypin e shkruar periodik përbëjnë pa dyshim një vlerë të shtuar jo vetëm të publicistikës shqiptare, në këndvështrimin e profesionit të audituesit. Këto botime kontribuojnë jo vetëm në krijimin e një historie dinamike të institucionit me një frymë që i shërben një transparence më të madhe me publikun, por synojnë njëkohësisht dhe rritjen e kompetencës profesionale të nëpunësve të institucionit nëpërmjet vendosjes në një plan tjetër të nëpunësit auditues të këtij institucioni përballë të audituarve. Këto shkrime nuk janë botuar si *qëllim në vetvete* por si mjet për të tërhequr në këtë rrugë dhe nëpunësit e institucioneve të çdo niveli të administratës shtetërore, duke i shërbyer kështu jo vetëm evidentimit të nëpunësve të përgjegjshëm, por dhe kalimit në një fazë tjetër të luftës ndaj korrupsionit, për të kontribuar gjithnjë e më shumë dhe në drejtim të ndryshimit të perceptimit të publikut për nëpunësit, por dhe për institucionet publike në tërësi. Perceptimi i publikut vazhdon të mbetet një problem serioz që kërkon punë dhe vetëm punë intelektuale, të shoqëruar me shpalosje integriteti të vetë nëpunësve të institucioneve, si e vetmja rrugë për të pretenduar rezultatin. Nga KLSH kjo konceptohet si një sfidë që po realizohet dhe preket ditë pas dite. Shembulli është dhënë, tashmë mbetet vetëm për t'u ndjekur. Ju ftoj për një prani më të shpeshte tuajën në median e shkruar të vendit. Kemi disa shembuj të mirë audituesish të rinj që shkruajnë me kurajo dhe cilësi. Por këta janë ende shumë të paktë. Konsiderojeni si një sfidë tuajën personale brenda sfidës së institucionit, praninë tuaj të shtuar në median shqiptare. Është detyrë e çdo drejtuesi të administratës shtetërore të çdo rangu qoftë, që të nxisë e inkurajojë

nëpunësit që drejton me qëllim që ata ta ndjejnë veten si nëpunës dinjitozë të këtij Shteti që kontribuojnë për modernizimin e tij dhe luftën kundër korrupsionit.

Sfida jonë e përbashkët dhe madhore është modernizimi i mëtejshëm i aktivitetin tonë të auditimit, në mënyrë që praktikat e mira të ofruara nga EUROSAI dhe lëvizja “Young EUROSAI” të na orientojnë, duke ndihmuar vendin me një auditim sa më profesional, për progres real në rrugën e tij të anëtarësimit në BE, në përputhje të plotë me mandatin tonë kushtetues si KLSH dhe me pritshmeritë e qytetarëve dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Ju faleminderit!

PASOYRIMI NË MEDIAN VIZIVE, TË SHKRUAR DHE ELEKTRONIKE  
I ANALIZËS VJETORE TË KLSH PËR VITIN 2015, 1-2 SHKURT 2016.

Analiza Vjetore e KLSH-së për vitin 2015, transmetua më datë 1 shkurt 2016, me kronika të zgjeruara nga televizionet kombëtare: Ora News, News 24, TV Klan, ABC News, Top Channel, Top News, Vizion Plus, TVSH, Scan Tv, A1 TV, UTV, NTV, si dhe televizionet lokale të qyteteve të Vlorës, Elbasanit, Shkodrës, etj.





TV Klan



TOP CHANEL



ORA News



News 24





Scan TV



Analiza e KLSH



Analiza e KLSH

Vizion +



Më datë 1 dhe 2 shkurt 2016 në median elektronike dhe në shtypin e përditshëm u pasqyruan mesazhet e dhëna nga të ftuarit në Analizën Vjetore të KLSH-së, për vitin 2015, si dhe pjesë nga Raporti i paraqitur nga Kryetari i KLSH-së, z. Bujar LESKAJ.

Gazeta “Panorama”, faqe 7:

- Analiza e KLSH për 2015, Leskaj: Kontroll koncesioneve dhe borxhit. Nga Zamir Alushi.

Gazeta “Shqip”, faqe 5:

Leskaj: Do të tregojmë zyrtarët e korruptuar që i mbron qeveria. Kreu i KLSH-së: U qëndrojmë kallëzimeve dhe rekomandimeve. Në fokus për 2016, koncesionet dhe borxhi.

Presidenti dhe Kryeprokurori i japin mbështetje KLSH-së për luftën ndaj korrupsionit.

Llalla: Falë punës së KLSH u arrestua ish- ministri Ksera.

Nishani: Të jeni të ashpër!

Gazeta "Koha Jonë", faqe 8-9:

Presidenti flet në analizën e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2015.

Nishani: KLSH e ka ngritur në shkallën më të lartë besimin. Kreu i Prokurorisë së Përgjithshme, Llalla: Prokuroria mbetet aleat i KLSH-se kundër korrupsionit.

Guvernatori Sejko: Auditimi, kjo levë e rëndësishme. Manjani: Në qeveri administrohen shuma marramendëse financiare.

Për forcimin e besimit të qytetarit tek qeverisja.

Fjalimi i kreut të Kontrollit të Lartë të Shtetit në Analizën Vjetore të këtij institucioni.

Gazeta "Telegraf", faqe 2-3:

- Kreu i KLSH, Bujar Leskaj: Kemi kallëzuar në prokurori ministra dhe zyrtarë të lartë. Iglj Totozani: Të korruptuarit nuk duhet të mbeten pa u ndëshkuar.

Gazeta "SOT", faqe 6 -7:

- Lista me zyrtarët e korruptuar në Kuvend, KLSH dërgon edhe një herë në prokurori të gjitha kallëzimet penale ndër vite. Nga Kliti Topalli.
- Kryeprokurori: Falë punës së KLSH u arrestua Spiro Ksera, askush nuk është i paprekshëm.
- Leskaj: Krerët e institucioneve nuk shkarkojnë zyrtarët e gjetur me shkelje.
- Sejko: Të ndjekim shembujt e Kroacisë e Rumanisë. Shkëlqim Ganaj: Qytetarët kërkojnë qeverisje të mirë. KLSH: Është e nevojshme ngritja e Këshillit Fiskal.
- Ministri i Drejtësisë thirrje prokurorisë dhe KLSH: Hetoni aferat e qeverisë "Rama".
- Të gjitha koncesionet nën hetim, audituesit e KLSH gati të zbarkojnë nëpër ministri, pas Beqajt hapen letrat e Ahmetajt, Canit dhe Gjijnurit. Nga Adriatik Doçi.
- Kreu i shtetit vlerëson punën e KLSH.

Gazeta "55", faqe 2:

- Bujar Leskaj: "Dëmi i buluar gjatë 2012-2015, 8 herë më i madh se gjatë 2008-2011".

“Gazeta Shqiptare”, faqe 7:

- KLSH: Dëmi ne buxhet, 1 miliard euro. Gjatë periudhës 2012-2015 janë kallëzuar penalisht 527 zyrtare. Nga Ornela Manjani.

Gazeta “DITA”, faqe 4:

- Koncesionet e dhëna në sitën e KLSH-së.

Gazeta “Standard”, faqe 8:

- Bujar Leskaj: Kallëzimet në Prokurori do të përsëriten, audit gjithë koncesioneve. Nga Ervin Kaduku.

Gazeta “Shqiptarja.com”, faqe 6:

- Leskaj: Kërkesat për shkarkimin e shkelësve nuk zbatohen.
- Llalla: Hetimi ndaj Kserës nisi pas kallëzimeve të KLSH. Nishani: Përgjegjësitë për shkeljet janë individuale.

Gazeta “Ballkan”, faqe 2:

- Leskaj: Në 4 vjet, 128 mld lekë dëm shtetit.

Gazeta “Rilindja Demokratike”, faqe 10:

- Leskaj: Kontroll koncesioneve të qeverisë, është sfida e KLSH-së. Nga Entela Vrapi.
- Shumë prej denoncimeve të KLSH janë kthyer në akuza penale.

Gazeta “Integrimi”, faqe 2:

- Analiza vjetore e KLSH, Ylli Manjani: Bashkëpunim për të luftuar sa më shumë korrupsionin e zyrtareve të lartë.

Gazeta “Shekulli”, faqe 3:

- Bujar Leskaj: Në 4 vitet e fundit janë zbuluar shkelje me vlerë 128 miliard lekë. Dëmi ekonomik është 8 herë më i madh se në periudhën paraardhëse.

politika  
**Kryeprokurori Falë punës së KLSH u arrestuan Bpko Koço, akuzohet nuk çohet l papjekshmëri**

Më shumë se 100 ditë pas arrestimit të Bpko Koço, kryeprokurori i KLSH, akuzohet se nuk ka mundur të japë përgjigje të kërkimit të gjykatës për shkak të papjekshmërisë së tij në punën e kryer.

politika  
**Më shumë se 100 ditë pas arrestimit të Bpko Koço, akuzohet se nuk ka mundur të japë përgjigje të kërkimit të gjykatës për shkak të papjekshmërisë së tij në punën e kryer.**

Më shumë se 100 ditë pas arrestimit të Bpko Koço, kryeprokurori i KLSH, akuzohet se nuk ka mundur të japë përgjigje të kërkimit të gjykatës për shkak të papjekshmërisë së tij në punën e kryer.

**Lista me zyrtarët e korruptuar në Kuvend, KLSH dërgon edhe një herë në prokurori të gjitha kallëzimet penale ndër v**

Kryeprokurori i KLSH, Bpko Koço, ka dërguar në prokurori të gjitha kallëzimet penale ndër vjetore të zyrtarëve të korruptuar në Kuvend, duke kërkuar që të jenë tërhequr në përgjithësi nga detyra.

Kryeprokurori i KLSH, Bpko Koço, ka dërguar në prokurori të gjitha kallëzimet penale ndër vjetore të zyrtarëve të korruptuar në Kuvend, duke kërkuar që të jenë tërhequr në përgjithësi nga detyra.

Kryeprokurori i KLSH, Bpko Koço, ka dërguar në prokurori të gjitha kallëzimet penale ndër vjetore të zyrtarëve të korruptuar në Kuvend, duke kërkuar që të jenë tërhequr në përgjithësi nga detyra.

**[Shqiptarja.com]**

Shqiptarja.com është një platformë online që ofron informata të reja dhe analizat e fundit të situatës në Shqipëri.

**KLSH: 2016, auditim koncesioneve dhe performancës së borxhit publik**



**Tema**

**Bujar Leska: Në 4 vjet, 128 miliardë lekë dëm shoqëri**



**Të gjitha koncesionet nën hetim, audituesit e KLSH gati të zbardhajnë nëpër ministri, pra Beqajti hapen struktura e Ahmetajt, Çanit dhe Çiftkurrit**


Audituesit e KLSH janë gati të zbardhajnë nëpër ministri të të gjitha koncesionet nën hetim, duke hapur struktura të Ahmetajt, Çanit dhe Çiftkurrit.

**Leska: Mund të përfundohet kalimi i koncesioneve dhe një javë para se të jetë shpallur për rreth për shkak të**

Bujar Leska, kryeprokurori i KLSH, ka deklaruar se kalimi i koncesioneve mund të përfundohet brenda një javë para se të jetë shpallur për rreth për shkak të.

**Leska: Për 2016 KLSH do auditojë koncesionet dhe performancën e borxhit publik**

Bujar Leska, kryeprokurori i KLSH, ka deklaruar se për vitin 2016 KLSH do auditojë koncesionet dhe performancën e borxhit publik.



**Sh**

**KLSH: Në 4 vjet, me miliardë lekë dëm shoqëri**



**Tema**

Në 4 vjet, me miliardë lekë dëm shoqëri, KLSH ka audituar koncesionet dhe performancën e borxhit publik. Bujar Leska, kryeprokurori i KLSH, ka deklaruar se kalimi i koncesioneve mund të përfundohet brenda një javë para se të jetë shpallur për rreth për shkak të.





Shqip  
Koronimi i Beut: Çështja e Kosovës, Beut, Edi Rama

Edi Rama: Komiteti i bashkëpunimit  
**Leskaj: Do tregojmë zymëri e komptuar që i mbrojnë qeveria**



**Mamiani: Të priten dënimet**



**Analiza e KLSH, Leskaj: Kontrolli koncesioneve dhe borxhit**  
Faqe 7

**me di ka ma?**



**Zllka, at këto prona janë**

**Meta me Sekretarin Parlamentar të shtrëtit gjerman Brauksiepe: Në maj mbledhja e Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Tiranë**



**Investicioni, 513 miliona euro**



**Analiza vjetore e KLSH, kren Bujar Leskaj: "Dëni i zbuluar gjatë 2012-2015, 8 herë më i madh se gjatë 2008-2011"**



**Analiza vjetore e KLSH - Shtrëtit i lehtë strukturuar 1.25.50 miliona**





## FJALORI I SHKURTIMEVE

ALSAI	Albanian Supreme Audit Institution (Institucioni Shqiptar Suprem i Auditimit - KLSH)
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale
AMTP	Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
ARABOSAI	Arab Organization of Supreme Audit Institutions (Organizata Arabe e Intucioneve Supreme të Auditimit)
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
a.s.	anonymous society (shoqëri anonime)
CAAT	Computer Assisted Audit Tools (Teknikat Kompjuterike Ndhmëse të Auditimit)
CEZ	Ceske Energeticke Zavody
DRT	Drejtoria Rajonale e Tatimeve
DP	Drejtoria e Përgjithshme
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DTTTV	Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Tarifave Vendore



EC	European Commision – Komisioni European
ECA	European Court of Audit (Gjykata Europiane e Auditimit)
EEF	Extended Fund Facility
EPSAS	European Public Sector Accounting Standarts Standardet Europiane të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ESA	European System of Accounts (Sistemi European i Llogarive)
EUROSAI	European Organisation of Supreme Audit Institutions (Organizata Europiane e Institucioneve Supreme të Auditimit)
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GAO	Government Accountability Office (Zyra Qeveritare e Llogarive)
IDI	INTOSAI Development Initiative (Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t)
INCOSAI	International Conference of Supreme Audit Institutions (Konferenca Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit)
INTOSAI	International Organization of Supreme Audit Institutions (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit)
IntoSAINT	Mekanizmi i vetëvlerësimit të integritetit të Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Intucionioni Suprem i Auditimit
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
ISHSH	Instituti i Shkencës Shqiptare

ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISSAI	International Standards of Supreme Audit Institutions (Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit)
IPA	Instrumenti Para Asocimit
IPSAS	International Public Sector Accounting Standards (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik)
IT	Teknologjia e Informacionit
JWGAA	Joint Working Group on Audit Activities (Grupi i përbashkët i punës për aktivitetet audituese)
KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
KKK	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
KPA	Kodi i Procedurës Administrative
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
KVWTP	Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë
LC	Letër Kredi
LMH	Licencë Marrëveshje Hidrokarbure
Ltd	Private Limited Company (Kompani private me përgjegjësi të kufizuar)
MF	Ministria e Financave
MH	Marrëveshje Hidrokarbure

MEI	Ministria e Energjetikës & Industrisë, Tiranë
NAO	National Auditor Office (Dhoma Kombëtare e Auditimit)
NIK	Zyra Kombëtare e Auditimit e Polonisë
NjP	Njësia e Prokurimit
NjQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik)
OLACEF	Organización Latinoamericana y del Caribe de Entidades Fiscalizadoras Superiores (Organizata Latinoamerikane dhe e Karaibeve e Institucioneve Supreme të Auditimit)
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PMF	Performance Measurement Framework (Kuadri i Matjes së Performancës)
QSUT	Qendra Spitalore Universitare, Tiranë
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
QTIL	Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë
RSH	Republika e Shqipërisë
SAI	Supreme Audit Institution (Institucioni Suprem i Auditimit)
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucionit Suprem të Auditimit
SNAO	Swedish National Audit Office (Dhoma Kombëtare e Auditimit e Suedisë)

sh.a.	shoqëri anonime
SWOT	Strengths, Weaknesses, Opportunities and Threats (Pikat e forta, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet)
UNCTAD	United Nations Conference on Trade and Development (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin)
USAID	United States Agency for International Development (Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar)
t.v.sh.	tatimi mbi vlerën e shtuar
TCA	Turkish Court of Accounts (Gjykata Turke e Llogarive)
ZAP	Zyra e Audituesit të Përgjithshëm
ZVRPP	Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave



ISBN: 978-9928-159-42-7



9 789928 159427

Shqipëria Botuese  
Typshkronja **ILAR**<sup>©</sup>

Seria: botime KLSII - 02/2016/53